



Instituti Gjyqësor i Kosovës
Kosovski Institut za Pravosudje
Kosovo Judicial Institute

REVISTË SHKENCORE JURIDIKE E KANDIDATËVE TË
PROGRAMIT FILLESTAR PËR ARSIMIM LIGJOR

JUSTICIA

VITI III/2012, NUMRI 1/2012



JUSTICIA

**Revistë shkencore juridike e kandidatëve të Programit Fillestar për
Arsimim Ligjor 2011/2012 në Institutin Gjyqësor të Kosovës**

Viti IV, Nr 4/2012

Prishtinë, 2012

Botues
Instituti Gjyqësor i Kosovës

ANËTARËT E REDAKSISË

Armend Hamiti
Teuta Ibrahim
Musa Dragusha
Zef Prennrecaj

Dizajni dhe radhitja kompjuterike
Instituti Gjyqësor i Kosovës

© Instituti Gjyqësor i Kosovës/Kosovski Institut za Pravosudje/
Kosova Judicial Institute

Publikimi i kësaj reviste u mundësua nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, UNDP, Zyra në Kosovë



Financuar nga: Qeveria e Holandës



Lavdim Krasniqi Fjala hyrëse.....	6
Anita Nikçi-Morina ROLI I GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË FUSHËN E INTERPRETIMIT TË KUFIZIMEVE TË LEJUESHME TË LIRIVE DHE TË DREJTAVE TË NJERIUT	7
Arben Hoti & Arben Mustafaj DËNIMET ALTERNATIVE DHE EKZEKUTIMI I TYRE SIPAS LEGJISLACIONIT PENAL TË KOSOVËS.....	16
Armend Hamiti & Fatmire Cacaj & Florent Latifaj SHPËLARJA E PARAVE DHE RREGULLIMI I SAJ NË LEGJISLACIONIN E KOSOVË 29	29
Valon Kurtaj & Artan Sejrani DEKLARATA E TË PANDEHURIT SI PROVË NË PROCEDURËN PENALE.....	45
Avni Mehmeti & Burim Ademi & Besnik Feka & Faton Ademi NGJASHMËRITË DHE DALLIMET MES KONTRATËS MBI DHURATËN DHE KONTRATËS MBI CEDIMIN.....	Error! Bookmark not defined.
Atdhe Berisha HAPJA E TRASHËGIMISË	75
Pranvera Ademi KONFIRMIMI I AKTAKUZËS	82
Elife Uka & Binak Duqi PROVAT E PAPANUESHME NË PROCEDURËN PENALE.....	88
Ferki Xhaferi MJETET E JASHTËZAKONSHME TË GODITJES SË VENDIMEVE NË PROCEDURË KONTESTIMORE ME VËSHTRIM MBI KËRKESËN PËR MBROJTJEN E LIGJSHMËRISË	95
Fitore Sadikaj E DREJTA E MBAJTJES (USHQIMISË) SIPAS LEGJISLACIONIT NË KOSOVË	108
Zef Prenrecaj & Shpend Krasniqi TAKTIKA E PYETJES SË FËMIJËVE DHE TË MITURVE NË PROCEDURËN PENALE ...	117

Hana Canaj & Ibrahim Shala & Hunaida Pasuli VËSHTRIM ANALITIKO-JURIDIK TË DISA PREJ ASPEKTEVE KARAKTERISTIKE TE KONTRATA PËR VEPRËN – SIPËRMARRJEN	128
Kemajl Ademaj & Bahri Hyseni MARKAT TREGËTARE	145
Prenk Palushi & Mehmet Ndrecaj & Elheme Jashari KONFLIKTI ADMINISTRATIV – PADIA	169
Sherife Seferi-Tahiri POSEDIMI.....	183
Flamur Bogaj PROVAT DHE TË PROVUARIT	193
Latif Xhemajli & Sabit rama E DREJTA E AUTORIT.....	226
Minire Xhambazi EKZEKUTIMI I BURGIMIT PËR TË MITUR.....	239
Valbona Dervodeli DËNIMI, QËLLIMI DHE LLOJET	246
Bahtie Ademi URDHRI PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE.....	254
Islam Azemi & Behar Ymeri ADOPTIMI, ME NJË VËSHTRIM TË VEÇANTË NË TË DREJTËN TONË	260
Lutfi Shala & Nehat Qelaj I DËMTUARI - AUTORIZIMET DHE TË DREJTAT E TIJ NË PROCEDURË PENALE	271
Aziz R. Shaqiri PARIMI I LIGJSHMËRISË ME VËSHTRIM TË VEÇANTË NË LEGJISLACIONIN TONË PENAL	286
Naser Foniqi PARABURGIMI SIPAS KODIT TË PROCEDURËS PENALE TË KOSOVËS DHE KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT	296

Shashivar Hoti & Sadije Abdullahu-Sahiti EKZEKUTIMI NË LLOGARINË BANKARE: KONFISKIMI DHE BARTJA E SHUMËS.....	301
Musa Xh. Dragusha STANDARDET PROFESIONALE DHE ETIKE TË AVOKATIT	307
Liridon Maloku EKZEKUTIMI I MASAVE EDUKATIVE	326
Shabi Idrizi PROCEDURA E SHKURORËZIMIT.....	346
Teuta Ibrahimimi & Valbona Selimaj & Rrustem Begolli ETIKA GJYQËSORE DHE PROKURORIALE, RËNDËSIA E TË QENURIT I DREJTË, I PAANSHËM DHE I PAVARUR.....	354
LITERATURA.....	366



Të nderuar lexues të “Justicia”

Jam shumë i nderuar t’iu drejtohem për herën e katërt nëpërmjet kësaj reviste juridike e cila nga dita në ditë po zhvillohet.

Revista Justicia është botim i Programit Fillestar për Arsimim Ligjor të IGJK-së e cila përmban punimet e kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë të cilët ndjekin trajnimet për arsimim ligjor në kuadër të këtij programi.

Si edhe deri më tani ky punim përfshinë tema të larmishme të cilat trajtojnë çështje të ndryshme të së drejtës, legjislacionit pozitiv të vendit dhe atij ndërkombëtarë si dhe të praktikës gjyqësore.

Qëllimi i kësaj reviste përveç tjerash, është edhe në funksion të formimit profesional të kandidatëve në fushën e shkrimit ligjorë, hulumtimeve dhe publikimeve shkencore si dhe në mbështetjen e profesionistëve ligjor me literaturë juridike të kësaj natyre.

Kjo revistë botohet çdo vit, nga secila gjeneratë e kandidatëve të Programit Fillestar për Arsimim Ligjor dhe temat e kësaj reviste janë përzgjedhur dhe redaktuar nga vet kandidatët.

Shpresojmë se edhe ky numër i revistës “Justicia” do tu shërbej në punën profesionale profesionistëve të ndryshëm ligjor si dhe gjyqtarëve e prokurorëve.

Me qëllim të avancimit të kësaj reviste, mirëpresim komentet dhe sugjerimet tuaja.

Mr.Sc. Lavdim Krasniqi

Drejtor i Institutit Gjyqësor të Kosovës



Anita Nikçi – Morina

ROLI I GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË FUSHËN E INTERPRETIMIT TË KUFIZIMEVE TË LEJUESHME TË LIRIVE DHE TË DREJTAVE TË NJERIUT

1. Hyrje

Siç thekson në punimin e tij mbi Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut ish-Presidenti i kësaj Gjykate z. Luzius Wildhaber, shekulli 20 kishte filluar me të drejtën ndërkombëtare që shikonte shtetet vetëm si sovraane dhe aktorë të shfrenuar, të drejtën për të shkuar në luftë, dhe të drejtën edhe për të trajtuar shtetasit dhe të huajt si objekte, statusi ligjor i të cilëve përcaktohej vetëm me legjislacionin nacional.¹ Ky realitet në fushën e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut u ndryshua kur në fund të shekullit 20-të dhe fillim shekullit të 21-të edhe individët u legjitimuan si subjekte të së drejtës ndërkombëtare. Padyshim, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut sipas Wildhaber “është ilustrimi më spektakolar i këtij ndryshimi”.² Ky ndryshim është fundamental në fushën e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut duke bërë që parimi i integritetit territorial dhe sovranitetit shtetëror të balancohet me parimin e respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut si kategori jo vetëm nacionale por edhe ndërkombëtare. Andaj qëndrimi se shtetet dhe sovraniteti i tyre absolut qëndron mbi parimin e respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut konsiderohet i papranueshëm për doktrinën bashkëkohore të lirive dhe të drejtave të njeriut, si dhe për vete parimin e konceptit të shtetit të së drejtës si një vlerë fundamentale në hapësirën juridike evropiane.

Përderisa, zanafilla e lindjes dhe zhvillimit të lirive dhe të drejtave të njeriut është shumë e gjatë dhe daton që nga periudha antike, në këtu do të ndalemi që të analizojmë arsyet që quan në krijimin e konceptit supra-nacional të

¹ Luzius Wildhaber, *The European Court Of Human Rights: The Past, The Present, The Future*, 22 Am. U. Int'l L. Rev. 521.

² Ibid.

lirive dhe të drejtave të njeriut si dhe në ndërtimin e mekanizmit të Strasburgut si një ndër gjykatat më me ndikim në Evropë për sa i takon mbrojtjes së lirive dhe të drejtave fundamentale të njeriut. Një grup i vogël largpamës, avokatë idealiste, por të vendosur të parandalojnë përsëritjen e efekteve shkatërrimtare të luftës dhe krimeve të tmerrshme, argumentuan se mënyra më e mirë për të arritur këtë qëllim është që të garantohet respektimi i demokracisë dhe shtetit ligjor në nivel kombëtar.³ Ata besonin se vetëm me zbatimin kolektiv të të drejtave themelore do të ishte e mundur për të siguruar standardet e përbashkëta minimale që formojnë bazën e shoqërisë demokratike.⁴ Qeveritë anëtare të Këshillit të Evropës në përpjekje për të siguruar paqen dhe të realizojnë një bashkim më të ngushtë midis tyre mbështetur tek të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, përmes Konventës vendosën të marrin masat fillestare për zbatimin kolektiv të disa prej të drejtave të shpallura në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut. Rezultati është se për herë të parë individët mund të sfidojnë përmes ankesës individuale veprimet e qeverive të tyre para një mekanizmi ndërkombëtar në një procedurë që çon në një vendim detyrues gjyqësor.⁵ Krijimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ishte parë si një mekanizëm i cili do të pengonte kalimin e demokracive në diktatura.

2. Përmbajtja e Konventës dhe Detyrimet Pozitive

Konventa ka përcaktuar se palët i njohin çdo njeriu që përfshihet në juridiksionin e tyre të drejtat dhe liritë e përcaktuara me Konventë. Konventa bën elaborimin e lirive dhe të drejtave duke përcaktuar fushëveprimin e tyre por edhe duke përcaktuar kufizimet e lejueshme të cilat mund të aplikojnë shtetet në kuadër të juridiksioneve nacionale. Në kuadrin e të drejtave dhe lirive themelore, Konventa garanton të drejtën në jetë, ndalimin e torturës, të drejtën e gjykimit të drejtë, lirinë e shprehjes, lirinë e besimit, të drejtën e pronës dhe të drejtën e zgjedhjes, të drejta këto të cilat në përgjithësi sot trajtohen në kuadër të kushtetutave nacionale. Konventa e të Drejtave të Njeriut ka themeluar GJEDNJ si një mekanizëm juridik i natyrës subsidiare. Kjo për faktin se roli i këtij mekanizmi është në parim i natyrës dytësore ku Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës konsiderohen si autoritete të cilat në instancë të parë vihen në mbrojtje të lirive dhe të drejtave fundamentale. Megjithatë, roli i Konventës ka qenë dhe vazhdon të mbetet fundamental për shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Nënshkrimi dhe ratifikimi i Konventës për Mbrojtjen e Lirive dhe

³ Ibid.

⁴ Ibid.

⁵ Ibid.

të Drejtave Themelore tanimë është bërë një kërkesë faktike për të gjitha shtetet të cilat synojnë t'i bashkohen Këshillit të Evropës. Së këndejmi shtetet e ardhshme anëtare, përfshirë këtu edhe Republikën e Kosovës duhet të sigurohen se legjislacioni i cili në një mënyrë ose tjetrën afekton aspekte të lirive dhe të drejtave të njeriut duhet të jetë në përputhje me vlerat e përcaktuara nga Konventa për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut duke pranuar në të njëjtën kohë edhe autoritetin e Strasburgut si instancë vendimet e së cilës kërkojnë zbatim në kuadër të këtyre juridiksioneve nacionale.⁶

Gjykata Evropiane përbëhet nga një numër gjyqtarësh i barabartë me numrin e Palëve të Larta kontraktuese. Gjyqtarët duhet të kenë karakter të lartë moral dhe të plotësojnë kushtet e kërkuara për ushtrimin e funksioneve më të larta gjyqësore ose të jenë juristë me kompetencë të shquar. Gjyqtarët e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut veprojnë në cilësinë e tyre si individ dhe jo domosdoshmërisht përfaqësojnë interesat e shtetit nga i cili vijjnë. Gjatë mandatit të tyre, gjyqtarët nuk mund të ushtrojnë asnjë veprimtari që nuk pajtohet me kërkesat e pavarësisë, paanësisë ose të disponibilitetit për një veprimtari me kohë të plotë. Duhet theksuar se për shqyrtimin e çështjeve që i paraqiten, Gjykata vepron me komitete prej tre gjyqtarësh, me dhoma prej shtatë gjyqtarësh dhe me një Dhomë të Madhe prej shtatëmbëdhjetë gjyqtarësh. Gjyqtarët zgjidhen nga Asambleja parlamentare për çdo Palë të Lartë kontraktuese, me shumicën e votave të shprehura, mbi bazën e një liste prej tre kandidatësh të paraqitur nga Pala e Lartë kontraktuese. E njëjta procedurë ndiqet për plotësimin e Gjykatës në rast aderimi të Palëve të Larta kontraktuese të reja dhe për plotësimin e vendeve të mbetura bosh.

Duhet theksuar se, Gjykata mund të vihet në lëvizje nëse janë shterur mjetet e brendshme juridike, ashtu siç kuptohen sipas parimeve të së drejtës ndërkombëtare përgjithësisht të pranuar, dhe brenda një afati prej gjashtë muajsh nga data e vendimit përfundimtar të brendshëm. Konventa i njeh Gjykatës të drejtën për të pranuar kërkesa nga çdo person fizik, çdo organizatë joqeveritare ose nga çdo grup individësh që pretendon se është viktimë e një shkeljeje nga një palë e lartë kontraktuese e të drejtave të njohura. Por edhe shtetet mund të drejtohen Gjykatës për çdo shkelje të dispozitave të Konventës e të protokolleve të saj, për të cilat mendohet se janë shkaktuar nga një palët tjera kontraktuese.

⁶ Lauren C. Baillie, Protection of Religious Minorities in Europe: The Council of Europe's Successes and Failures, 23 American University International Law Review 617.

Por duhet theksuar se efektiviteti i sistemit të kontrollit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut varet në masë të madhe mbi nivelin e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës. Problemi qëndron në atë se vendimet e Gjykatës janë në karakter të natyrës deklarative dhe nuk kanë efekt të detyrueshëm juridik në kuadër të së drejtës së brendshme. Me fjalë të tjera Gjykata Evropiane nuk ka të drejtë që të kërkoj shfuqizimin, anulimin ose ndryshimin e dispozitave të brendshme apo të ndonjë vendimi gjyqësor. Kjo qasje gjyqësore juristifikohet me faktin se mekanizmi i Strasburgut është i natyrës dytësore respektivisht subsidiare, për faktin se është shteti i paditur dhe jo Gjykata që përcakton masat e nevojshme për të zbatuar detyrimet e saj.

Por çfarë është efekti i implementimit të sistemit të Konventës Evropiane sot?

Sicqë potencon Patricia Egli, mekanizmi i kontrollit të Konventës Evropiane konsiderohet të jetë më efektiv në kuadër të sistemit ndërkombëtarë për mbrojtjen e të drejtave individuale të njeriut deri më sot. Megjithatë, suksesi i sistemit ka sjellë me vete një ngarkesë në rritje që Gjykata është duke e u ballafaquar kohëve të fundit. Natyrisht kërcënimi kryesor për efektivitetin e sistemit të kontrollit është rritja eksponenciale e numrit e kërkesave individuale të paraqitura në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës Evropiane. Kjo mund të ilustruhet me shifrat e mëposhtme: numri i kërkesave individuale të regjistruar në vit në Gjykatë është rritur nga 404 në vitin 1981 në 44.100 në vitin 2004. Kjo flet për domosdoshërinë e reformimit të sistemit të Konventës Evropiane në të ardhmen.⁷

3. Efekti i Konventës Evropiane në sistemet juridike nacionale me theks të veçantë për Kosovën

Liritë dhe të drejtat e njeriut garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e cila pas miratimit të Deklaratës Kushtetuese të Kosovës për Pavarësi më 17 shkurt 2008 paraqet aktin më të lartë juridik, me rëndësi të veçantë në faqen e re të historisë politike dhe kushtetuese të Kosovës. Ndonëse e hartuar në frymën e Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, datë 26 mars 2007, Kushtetuta ndjek në mënyrë konsistente frymën e lirive dhe të drejtave të njeriut të përcaktuara me Konventën Evropiane. Sipas Kushtetutës, liritë dhe të drejtat e njeriut “rendi

⁷ Patricia Egli, Protocol No. 14 to the European Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms: Towards a More Effective Control Mechanism? 17 Journal of Transnational Law & Policy, (1) 2007.

kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mos diskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.“ Për më tepër, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës. Kushtetuta me tej përcakton se Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, duke specifikuar në mes tjerash se të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara me kushtetutë vlejnë edhe për personat juridikë për aq sa janë të zbatueshme. Duhet theksuar se Kushtetuta ka një qasje liberale ndaj të drejtës ndërkombëtare duke përcaktuar në mes tjerash se marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Kosovës, bëhen pjesë e sistemit të brendshëm juridik pasi të botohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Këto marrëveshje ndërkombëtare zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, me përjashtim të rasteve kur nuk janë të vetë zbatueshme dhe zbatimi i tyre kërkon nxjerrjen e një ligji.⁸ Ajo çfarë përbën një veçanti të Kushtetutës së Kosovës në fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut është fakti se Kushtetuta ka bërë konstitucionalizmin e disa marrëveshjeve ndërkombëtare me rendësi në fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut të cilat jo vetëm që gëzojnë status kushtetues por edhe janë drejtpërsëdrejti të aplikueshme në Kosovë. Kushtetuta përcakton se të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

- 1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- 2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;
- 3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;
- 4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;
- 5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
- 6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;
- 7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës;

⁸ Kushtetuta e Kosovës, neni 19.

8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.

Ndonëse autoritetet kosovare akoma nuk kanë ratifikuar instrumentet e mësipërme ndërkombëtare në fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut, ligjvënësi ka zgjedhur një rrugë jo të pazakontë për procesin kushtetutbërës duke bërë në këtë mënyrë konstitucionalizmin e këtyre traktateve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut. Duhet theksuar me tej se Kushtetuta shkon përtej katalogut të lirive dhe të drejtave të përcaktuara në Kapitullin II duke përcaktuar edhe një katalog të gjerë të lirive dhe të drejtave të komuniteteve. Këto janë të drejta që zbatohen për banorët që i përkasin një grupi të njëjtë kombëtar ose etnik, gjuhësor ose fetar, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Republikës së Kosovës (komunitetet), krahas të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës.

Janë tre momente të rëndësishme që duhet pasur parasysh kur shtrihet aspekti i ndikimit të Konventës Evropiane në sistemin juridik të Kosovës. Momenti i parë i referohet periudhës së administrimit ndërkombëtar të Kosovës ku rregullorja për të drejtën e aplikueshme në Kosovë kishte specifikuar detyrimin për autoritetet publike për të respektuar standardet e lirive dhe të drejtave të njeriut të garantuara me akte ndërkombëtare dhe në veçanti të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Së këndejmi Rregullorja e UNMIK–ut për të drejtën e aplikueshme në Kosovë (Rregullorja Nr. 24/99) kishte përcaktuar në mes tjerash detyrimin për autoritetet publike në Kosovë që të vejnë në zbatim standardet e pranuar ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, dhe në këtë kontekst edhe të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Për më tepër, Rregullorja në fjalë kishte përcaktuar heqjen e dënimit me vdekje. Heqja e dënimit me vdekje në Kosovë nuk ka se si të kuptohet ndryshe përveç se një ndikim i Protokollit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut i cili parasheh heqjen e dënimit me vdekje në kohe paqeje. Sipas këtij Protokollit, një shtet mund të parashikojë në legjislacionin e tij dënimin me vdekje për sa u përket veprimeve të kryera në kohë lufte apo në kërcënimin eminent të luftës; një dënim i tillë do të zbatohet vetëm në rastet e shprehura në ligj dhe në përputhje me dispozitat e tij. Shteti duhet t'i bëjë të ditur Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës dispozitat e rëndësishme të këtij ligji. Duhet theksuar se me miratimin e Protokollit të 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, palët kontraktuese janë pajtuar që të heqin dënimin me vdekje edhe në kohë paqeje duke vendosur për shfuqizimin e dënimit me vdekje në çfarëdo shtate, qoftë lufte apo paqeje. Ndonëse praktika e

shteteve anëtare të Këshillit të Evropës është e ndryshme për sa i takon mënyrës së harmonizimit të legjislacionit dhe sigurimit të përputhshmërisë së dispozitave nacionale me standardet e Konventës, misioni ndërkombëtar në Kosovë kishte zgjedhur Rregulloren me fuqi ligjore si instrument për të siguruar pajtueshmërinë e legjislacionit nacional me atë të Konventës Evropiane. Duket sikur që nga koha e instalimit të misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë ka pasur një qasje konsistente dhe të vazhdueshme në aspekt të përfaqimit të vlerave dhe parimeve të Konventës Evropiane si në kuptim të garancioneve juridike të cilat ofrohen me tekstin e Konventës Evropiane ashtu edhe praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Një manifestim i theksuar i këtij ndikimi të Konventës Evropiane është vetë Kushtetuta e Kosovës e cila në kapitullin 2 përcakton katalogun e lirive dhe të drejtave kushtetuese. Një krahasim i tekstit të Kushtetutës së Kosovës me dispozitat e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ndikon qartë shkallën e ngjashmërisë së të drejtave dhe lirive të garantuara në mes të akteve të sipërpërmendura dhe atë si në përmbajtje ashtu edhe në vetë aspektin e kufizimeve të përcaktuara. Për më tepër, siç kam potencuar me lartë neni 53 të Kushtetutës së Kosovës detyron autoritetet publike në Kosovë, veçanërisht autoritetet gjyqësore që me rastin e zgjedhjes së kontesteve gjyqësore të marrin parasysh praktikën e jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rrjedhimisht, ky nen vendos detyrime të qarta kushtetuese për gjyqtarin që gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor jo vetëm të kërkohet të vihen në jetë standardet e Konventës Evropiane por që në kontekst të përgjithshëm të merret në konsideratë Strasburgu si një mekanizëm gjyqësor vendimet e të cilit kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë ndikim të fuqishëm në drejtim të unifikimit të standardeve dhe parimeve për sa i takon vënies së kufizimeve të ligjshme në ushtrimin e lirive dhe të drejtave të garantuara me legjislacion. Një domosdoshmëri të këtillë të referimit te praktika e Strasburgut e gjejmë më së miri të shprehur në përvojën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës e cila në vazhdimësi ka nënvizuar rolin dhe ndikimin e Strasburgut në të zgjidhurit e rasteve konkrete. Së këndejmi në rastin Bislimi k. Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka bërë atë çfarë përbën një referim konsistent në praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut duke i dhënë neni 53 të Kushtetutës së Kosovës rëndësinë e saj. Çështja e lëndës së kësaj kërkesë ka qenë vlerësimi i kushtetutshmërisë së shkeljes së supozuar të lirisë së lëvizjes së parashtruesit të kërkesës të garantuar me Nenin 35 (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Sipas parashtruesit të kërkesës, atij i është shkelur e drejta për t'u larguar nga vendi pasi i ishte refuzuar lëshimi i pasaportës, e

cila kërkohet për të udhëtuar jashtë vendit. Parashtruesi i kërkesës më tej kishte pohuar se në sistemin ligjor të Kosovës nuk ka mjete efektive juridike për ta ushtruar të drejtën e tij për t'u larguar nga vendi.⁹ Duke vendosur mbi pranueshmërinë e kërkesës, Gjykata Kushtetuese se pari shqyrtoi nëse parashtruesi i kërkesës kishte përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë. Në lidhje me këtë, Gjykata iu referua nenit 113.7 të Kushtetutës, sipas të cilit “individët janë të autorizuar ta ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj” dhe nenit 47.2 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, i cili thotë se “individ mund të ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”. Pikërisht në lidhje me shterimin e mjeteve të rregullta juridike, Gjykata Kushtetuese i referohet praktikës gjyqësore të Strasburgut ku në mes tjerash përcaktoi se “sipas praktikës së mirëfilltë gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, parashtruesit e kërkesës duhet t'i shterin mjetet juridike vendëse që janë në dispozicion dhe efektive. Për më tepër, ky rregull duhet të zbatohet me një shkallë të fleksibilitetit dhe pa formalizëm të tepruar. Gjykata Kushtetuese argumentoi më tej se “rregulli i shterjes nuk është as absolut as në gjendje të zbatohet në mënyrë automatike; me rastin e shqyrtimit nëse ai është zbatuar, është me rëndësi të kihen parasysh rrethanat e posaçme të secilit rast individual. Kjo do të thotë ndër të tjera se ai duhet të ketë parasysh jo vetëm ekzistimin e mjeteve zyrtare juridike në sistemin ligjor të vendit në fjalë, por edhe kontekstin e përgjithshëm ligjor dhe politik në të cilin veprojnë, si dhe rrethanat personale të parashtruesit të kërkesës (shih aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin Akdivar kundër Turqisë, të 16 shtatorit 1996).”¹⁰ Duke i qëndruar besnikë jurisprudencës së Strasburgut, Gjykata Kushtetuese theksoi se “organet administrative janë element i shtetit që e respektojnë sundimin e ligjit, dhe interesat e tyre përkrijnë me nevojën për administrim të mirëfillte të drejtësisë. Në rastet kur organet administrative refuzojnë ose dështojnë ta zbatojnë ligjin, apo vonohen, garancitë që i gëzon një ndërgjyqës gjatë fazës gjyqësore të procedurës nuk kanë kurrfarë kuptimi”.

⁹ Shih rastin Valon Bislimi k. Këshillit Gjyqësor të Kosovës et.al.

¹⁰ Ibid.

4. Standardet interpretative të Strasburgut në fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut

Për më tepër ndikimi i Strasburgut në sistemet juridike nacionale në çështjet që kanë përfshirë aspekte të kufizimeve të lirive dhe të drejtave kushtetuese përfshinë testin tri partitë si një udhërrëfyes për gjykatat nacionale me rastin e vendosjes së kufizimeve të ligjshme në ushtrimin e lirive dhe të drejtave të njeriut. Ndër parimet të cilat Gjykata Evropiane ka zhvilluar është parimi i margjinës së vlerësimit. Sipas këtij parimi autoritetet gjyqësore nacionale kanë të drejtë në suaza të legjislacionit të tyre që me rastin e vënies së kufizimeve në liritë dhe të drejtat e njeriut të marrin në konsiderate rrethanat shoqërore, traditën dhe aspekte të tjera të veçanta për të çmuar nëse masa e kufizimit është më e përshtatshme për të arritur qëllimin legjitim. Kjo çmuarje e lire e shteteve anëtare të Konventës Evropiane nuk do të thotë domosdoshmërisht se shtetet anëtare kanë diskrecion të plotë me rastin e vendosjes së kufizimeve të ligjshme në ushtrimin e lirive dhe të drejtave të njeriut . Por ky parim shteteve nacionale ju ofron një hapësirë të vlerësimit me rastin e vënies së kufizimeve të ligjshme në ushtrimin e lirive dhe të drejtave të njeriut. Parim tjetër i rëndësishëm i zhvilluar nga jurisprudenca e Strasburgut është nëse ndërhyrja në ushtrimin e lirive dhe të drejtave të njeriut ka qenë e domosdoshme në një shoqëri demokratike dhe nëse kufizimet e bëra ka qenë të përcaktuara me ligj. Këto parime kanë ndihmuar në masë të konsiderueshme autoritetet nacionale në vlerësimet juridike dhe gjyqësore nëse një masë e ndërhyrjes ka qenë e drejtë në pikëpamje të pajtueshmërisë me përvojën jurisprudenciale të Strasburgut duke bërë në këtë mënyrë ndikimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut mjaft të rëndësishëm në drejtim të unifikimit të politikës jurisprudenciale në fushën e kufizimeve të lirive dhe të drejtave të njeriut.



Arben Hoti



Arben Mustafaj

DËNIMET ALTERNATIVE DHE EKZEKUTIMI I TYRE SIPAS LEGJISLACIONIT PENAL TË KOSOVËS

Hyrja

Penologjia, shkenca mbi ekzekutimin e sanksioneve penale ose si quhet në disa vende e drejta mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, është një disiplinë e rëndësishme e cila ka lëndën dhe metodat e veta të pavarura të studimit.

Në pjesën e parë të temës do të bëhet prezantimi historik i sanksioneve të dënimeve alternative, dhe qëllimi i dënimeve alternative, kurse në pjesën e dytë do të bëhet prezantimi i dënimeve alternative veç e veç në mënyrë sikurse janë paraparë me legjislacionin e Republikës së Kosovës si dhe ekzekutimi i tyre, dhe në pjesën e tretë atë të përfundimit do të behët një rezymë e evoluimit të shkencës së penologjisë gjatë periudhave të ndryshme historike, e bashkë me të edhe dënimet dhe ekzekutimi i tyre.

1. Dënimet alternative në sistemin e sanksioneve penale

Paraqitja dhe zhvillimi i dënimeve alternative¹¹

Gjerë në fund të shekullit XIX dënimet kryesore kanë qenë i vetmi lloj i sanksioneve penale që në të drejtën penale kanë mundur të shqiptohen ndaj kryesve të veprave penale.

Dënimi me kusht që sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës bën pjesë në kapitullin e dënimeve alternative si lloj i posaçëm i sanksionit penal është paraqitur në shekullin XIX si rezultat i njohurive se një numër i personave

¹¹ Dr. Ismet Salihu “ E Drejta Penale” Pjesa e përgjithshme Prishtinë 1995 fq 366

që i kanë dënuar gjykatat, kanë kryer vepra penale pak të rrezikshme dhe si persona që kanë kryer vepra penale për herë të parë.

Dënimi me kusht për herë të parë është paraqitur në SHBA dhe Angli me emrin “probation” Sprovim.

Në legjislacionet penale janë të njohur tri sisteme të dënimit më kusht:

- 1) Sistemi anglo-amerikan apo “probation” (i sprovimit). Si karakteristikë e këtij sistemi është se ndaj kryesit të veprës penale zhvillohet procedura penale, konstatohet fajësia e tij, mirëpo nuk i shqiptohet dënimi. Personi i tillë gjatë pezullimit të shqiptimit të dënimit vihet nën mbikëqyrjen e posaçme të cilën e ushtron personi zyrtarë i emëruar nga ana e gjyqit.
- 2) Sistemi evropian kontinental, karakteristikë e këtij sistemi të dënimit me kusht është se kryesin e veprës penale gjyqi e shpall fajtor dhe ia shqipton dënimin, mirëpo dënimin e shqiptuar nuk e ekzekuton, këtë e pezullon për një kohë të caktuar, me kusht që kryesi gjatë kësaj kohe të mos kryej veprë të re penale dhe t’i përmbushë kushtet e tjera që gjyqi mund t’ia caktoj me aktgjykim. Në këtë sistem nuk caktohet personi zyrtarë për përcjellje, mirëpo në rast të mos respektimit të tij mund të zëvendësohet me ndonjë dënim tjetër më të ashpër nga ana e gjykatës.
- 3) Sistemi i përzier i cili përmban elemente si të sistemit kontinental ashtu edhe të atij anglo-amerikan. Sipas këtij sistemi ndaj kryesit të veprës penale zhvillohet procedura penale, i shqiptohet dënimi dhe pezullohet ekzekutimi i tij, por gjykata mund ti caktoj edhe masë të posaçme të mbikëqyrjes për një kohë të caktuar.

1.2. Qëllimi i dënimeve alternative

Parashikimi i dënimeve dhe masave alternative si substitut, zëvendësimi i dënimit me burgim, është trend progresiv në të drejtën penale bashkëkohore dhe njëherit paraqet formë të rëndësishme në konceptin e sistemit të sanksioneve ndëshkuese.

Është i pamohueshëm roli i penologjisë, si shkencë e cila merret me ekzekutimin e sanksioneve penale por edhe si shkencë që merret me trajtimin dhe studimin edhe të disa sanksioneve tjera si p.sh. dënimet alternative, të cilat për një kategori të shkelësve të ligjit janë më efikase dhe

me to arrihet në tërësi qëllimi i dënimit, e i cili është gjithsesi risocializimi dhe jo dënimi si qëllim në vetvete.

2. Dënimet alternative në Kodin Penal të Kosovës

2.1. Kuptimi dhe llojet e dënimeve alternative

Në nenin 3 të Kodit Penal të Kosovës janë paraparë katër lloje të sanksioneve penale dhe këto janë:

1. Dënimet kryesore,
2. Dënimet alternative,
3. Dënimet plotësuese,
4. Vërejtja gjyqësore,

Në penologjinë moderne dënimeve alternative u kushtohet kujdes i veçantë, karakterit të këtyre dënimeve në luftimin e kriminalitetit. Pra në trajtimet juridiko-penale, kriminologjike dhe penologjike, këto dënime zënë vend të posaçëm. Ekziston bindja e bazuar se me aplikimin e dënimeve alternative, ndikohet dukshëm në pengimin e disa formave të kriminalitetit në botën bashkëkohore. Në këtë drejtim veçmas theksohet karakteri i tyre preventive dhe mbrojtës. Neni 41 i Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës ka përcaktuar si më poshtë:

(1) Dënimet alternative janë¹²:

- ◆ Dënimi me kusht dhe
- ◆ gjysmë liria

(2) Kur shqipton dënimin me kusht, gjykata po ashtu mund të shqiptojë:

- ◆ Urdhrin për trajtim të detyrueshëm rehabilitues,
- ◆ Urdhrin për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues dhe
- ◆ Urdhrin për punë në dobi të përgjithshme.

3. Dënimi me kusht dhe nocioni i tij

Dënimi me kusht është pezullim i ekzekutimit të dënimit të shqiptuar për një kohë të caktuar dhe me kushtet e caktuara. Qëllimi i dënimit me kusht është që kryesisht ti jepet qortimi, i cili e arrin qëllimin e dënimit përmes

¹² Kodi Penal i Kosovës neni 41

shpalljes së dënimit pa ekzekutimin e dënimit, dhe përmes kësaj të arrihet risocializimi i delikuentet.

Dënimi me kusht është paraparë në nenin 43 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës, ndërsa kushtet që duhet të përmbushen që të shqiptohet janë paraparë në dispozitën 44 të Kodit.

Sipas kësaj dispozite në grupin e parë të kushteve të cilat duhet të përmbushen që të shqiptohet dënimi me kusht, janë kushtet që i referohen dënimit të paraparë me ligj dhe dënimit të shqiptuar nga ana e gjykatës, dhe në grupin e dytë bëjnë pjesë kushtet të cilat i referohen personalitetit të kryesit të veprës penale dhe qëllimit të dënimit me kusht.

Lidhur me kushtet e para të parapara në nenin 44 par 1 që i referohen dënimit, dënimi me kusht mund të shqiptohet për vepra penale për të cilat është paraparë dënimi me burgim deri në pesë vjet, përjashtimisht për vepra penale për të cilat është paraparë dënimi me burgim deri në dhjetë vjet dhe nëse zbatohen dispozitat për zbutjen e dënimit (nenet 66 dhe 67 të KPK-së). Kurse kushti i dytë është që gjykata të shqipton dënim me gjobë ose deri në dy vjet burgim, qoftë për një vepër penale, qoftë për bashkim të veprave penale.

Siç shihet nga neni 44 par. 1 dhe 2 të KPK-së, si kusht që të shqiptohet dënimi me kusht, duhet që për veprën penale të jetë paraparë dënimi me burgim deri në pesë vjet apo të jetë paraparë dënimi me burgim deri në dhjetë vjet (nëse zbatohen dispozitat e zbutjes së dënimit), dhe kur gjykata shqipton dënimin me burgim deri në dy vjet apo dënimin me gjobë.

Po ashtu, që të mund të shqiptohet dënimi me kusht KPK ka paraparë që duhet që duhet të përmbushen edhe kushtet që i referohen personalitetit të kryesit, sikurse që janë sjellja e mëparshme, sjellja e kryesit mas kryerjes së veprës penale, shkalla e përgjegjësisë penale, rrethanat tjera në të cilat është kryer vepra penale.

Veçmas duhet theksuar se për të mundë gjykata të shqiptojë dënimin me kusht, duhet të përmbushen në mënyrë kumulative, si kushtet që i referohen dënimit të paraparë për atë vepër penale dhe dënimit të shqiptuar, ashtu edhe kushtet të cilat i referohen personalitetit të kryesit të veprës penale.

Nëse kryesit të veprës penale gjykata ia ka caktuar në mënyrë kumulative dënimin me kusht dhe dënimin me gjobë, dënimin me kusht mund t'ia

shqiptoj për të dy dënimet apo vetëm për dënimin me burgim (neni 44 par 4). Në rast të bashkimit të veprave penale, nuk është e mundur që për një veprë të shqiptohet dënimi ndërsa për veprën tjetër penale të shqiptohet dënimi me kusht ngase siç dihet sipas dispozitave për matjen e dënimin për veprat penale në bashkim, gjykata duhet të caktoj dënim unik i cili mund të jetë efektiv apo kushtëzohet të shqiptohet dënimi me kusht.

Kushti i përgjithshëm të cilin gjykata duhet të caktoj në çdo aktgjykim me të cilin shqiptohet dënimi me kusht është se personi i dënuar për kohën që e cakton gjykata e cila nuk mund të jetë më e shkurtër se një vit as më e gjatë se pesë vite, të mos kryej veprë tjetër penale, kjo ndryshe quhet edhe periudha e verifikimit. Pra koha e verifikimit e caktuar nga ana e gjykatës nuk mund të jetë më e shkurtër se një vit as më shumë se pesë, dhe fillon të rrjedhë prej ditës kur aktgjykimi i gjykatës me të cilin është shqiptuar dënimi me kusht bëhet i plotfuqishëm.

3.1. Revokimi i dënimin me kusht¹³

3.1.1. Revokimi i dënimin me kusht për shkak të veprave të tjera penale

Gjykata e revokon dënimin me kusht nëse personi i dënuar gjatë kohës së verifikimit kryen një apo më shumë vepra penale për të cilat është shqiptuar dënimi me burgim prej së paku dy apo më tepër vjet (neni 45 KPK)¹⁴.

Gjykata mund ta revokojë dënimin me kusht nëse i dënuari gjatë kohës së verifikimit kryen një apo më shumë vepra penale për të cilat është shqiptuar dënimi me burgim me më pak se dy vite ose dënimi me gjobë pasi t'i ketë vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat u përkasin veprave penale të kryera si dhe personit të dënuar dhe sidomos ngjashmëritë e veprave penale të kryera, rëndësisë së tyre dhe motivet për kryerjen e veprave penale.

Nëse e revokon dënimin me kusht, gjykata e shqipton dënimin unik për veprën penale të kryer më parë edhe për veprën e re penale, në pajtim me nenin 71 të KPK-së dhe duke i konsideruar dënimet e revokuara me kusht si të përcaktuara.

Nëse gjykata nuk e revokon dënimin me kusht, ajo mund ta shqiptojë dënimin me kusht a me burgim ose dënimin me gjobë për veprën e re

¹³ Neni 45 -Kodi Penal i Kosovës

¹⁴ Kodi Penal i Kosovës

penale. Nëse gjykata shqipton dënim me kusht për veprën e re penale, ajo e zbaton dispozitën e nenit 71 të KPK-së për ta shqiptuar dënimin e bashkuar me kusht për veprën penale të kryer më parë dhe për veprën e re penale dhe po ashtu e cakton një periudhë të bashkuar verifikimi e cila nuk mund të jetë më pak se një vit dhe më shumë se pesë vjet, duke filluar prej ditës kur ka hyrë në fuqi vendimi. Nëse gjykata shqipton dënimin me kusht për veprën e re penale, periudha kohore që kalohet në mbajtjen e dënimit me burgim nuk hiqet nga koha e verifikimit e vendosur me dënimin me kusht për veprën penale të kryer më parë.

3.1.2. Revokimi i dënimit me kusht për shkak të veprave penale të kryer më parë

Gjykata e revokon dënimin me kusht nëse pas shqiptimit të dënimit me kusht, me vendim të formës së prerë konstaton se personi i dënuar ka kryer një vepër tjetër para se të jetë dënuar me kusht, dhe nëse gjykata vlerëson se nuk do të kishte bazë për shqiptimin e dënimit me kusht po të dihej për atë vepër. Në raste të tilla, zbatohen dispozitat e nenit 45 par 3 të KPK-së që do të thotë se gjykata e revokon dënimin me kusht, dhe shqipton dënim unik për veprën penale të kryer më parë dhe për veprën e re penale.

3.1.3. Revokimi i dënimit me kusht për shkak të mospërbushjes së detyrimeve të caktuara

Nëse dënimi me kusht është kushtëzuar me përmbushjen e ndonjë detyrimi të paraparë në nenin 43 par. 3 të KPK-së dhe personi i dënuar nuk e përmbushë këtë detyrim në afatin e caktuar nga gjykata, gjykata mund të vazhdojë afatin e përmbushjes së detyrimit brenda afatit të verifikimit apo mund të revokojë dënimin me kusht dhe të ekzekutojë dënimin i cili i është caktuar me dënimin me kusht. Nëse gjykata konstaton se i dënuari për shkaqe të arsyeshme nuk ka mund ta përmbushë dënimin e përcaktuar më parë, gjykata e heqë paraparë me ligj.

3.2. Dënimi me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues

Gjykata mund ti shqiptojë dënimin me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues në rast se personi i dënuar e ka shkelur ligjin për herë të parë dhe është i varur nga droga dhe alkooli, nëse gjykata konstaton se faktori kryesorë që ka ndikuar në kryerjen e veprës penale është alkooli ose droga dhe se trajtimi i suksesshëm do të zvogëlonte rrezikun për

kryerjen e veprës së re penale pas shqyrtimit të raportit të shërbimit sprovues. Program i trajtimit mbikëqyret nga shërbimi sprovues. Dënimi konsiderohet se është mbajtur me kryerjen e suksesshme të programit të trajnimit rehabilitues. Nëse personi i dënuar largohet nga program i trajtimit rehabilitues apo nuk i përmbushë detyrimet lidhur me urdhrin për trajtim, gjykata mund ta zëvendësojë detyrimin e mëparshëm me një tjetër, mund ta shtyjë kohëzgjatjen e urdhrin për trajtim ose të revokojë dënimin me kusht dhe të urdhërojë ekzekutimin e dënimin të caktuar në dënim me kusht.

3.3 Dënimi me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues

Gjykata mund të shqiptojë dënimin me kusht me urdhrin për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues, nëse konsideron se integrimi i të dënuarit në shoqëri arrihet më mirë përmes mbikëqyrjes nga ana e shërbimit sprovues pas shqyrtimit të dosjes së shërbimit sprovues.

Kur shqipton dënimin me kusht me urdhrin për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues, gjykata e urdhëron personin e dënuar për të mbajtur kontaktin me shërbimin sprovues. Gjykata po ashtu mund të urdhërojë personit të dënuar të kryej një ose më shumë detyrime të parapara me nenin 43 par 3 ose nenin 51 të KPK-së. Kohëzgjatja e një detyrimi të paraparë me nenin 51 të KPK-së nuk mund të jetë më pak se gjashtë muaj ose më shumë se tri vjet.

Me rastin e zgjedhjes midis detyrimeve të parapara me nenin 51 të KPK, gjykata merr parasysh në veçanti moshën e personit të dënuar, gjendjen e tij të përgjithshme shëndetësore dhe mendore, mënyrën e jetesës dhe nevojat e tij, veçanërisht nevojat në lidhje me familjen, shkollën dhe punën, motivet që e kanë shtyrë të kryej veprën penale, sjelljet e tij pas kryerjes së veprës penale, sjelljet e tij në të kaluarën, rrethanat e tij të tjera personale dhe ato në lidhje me familjen që janë të rëndësishme për zgjedhjen e llojit të mbikëqyrjes dhe kohëzgjatjes së saj.

Nëse personi i dënuar nuk mbanë kontaktin me shërbimin sprovues ose nuk e përmbushë detyrimin e paraparë, siç është caktuar nga gjykata, gjykata mund ta zëvendësojë detyrimin e mëparshëm me një tjetër, ta shtyjë kohëzgjatjen e mbikëqyrjes brenda kohës së verifikimit ose ta revokojë dënimin me kusht.

3.3.1. Llojet e detyrimeve të përfshira në dënimin me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues

Me qëllim të kryerjes së një apo më shumë detyrimeve të mëposhtme, me dënimin me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues po ashtu mund të përfshihet:

- Mjekimi ose rehabilitimi në entin shëndetësorë;
- Nënshtrimi në programin e trajtimit mjekësor ose të rehabilitimit;
- Vizita te psikologu ose te këshilluesit e tjerë dhe veprimi në pajtim me rekomandimet e tyre;
- Aftësimi profesional në një profesion të caktuar;
- Kryerja e aktiviteteve punuese;
- Shfrytëzimi i pagës dhe të ardhurave të tjera ose i pasurisë për përmbushjen e detyrimeve familjare;
- Mos ndërrimi i vendbanimit pa lejen e shërbimit sprovues;
- Heqja dorë nga përdorimi i alkoolit apo drogës;
- Heqja dorë nga frekuentimi në vende apo lokale ku shërbehet pije alkoolike;
- Heqja dorë nga shoqërimi me persona të caktuar;
- Heqja dorë nga mbajtja e çfarëdo lloji të armëve.

3.4. Dënimi me kusht me urdhër për punë në dobi të përgjithshme

Pas shqyrtimit të raportit të shërbimit sprovues gjykata mund t'ia shqiptojë kryesit dënimin me kusht me urdhër për punë në dobi të përgjithshme të paraparë në paragrafin 1 të nenit 44 të KPK-së, nëse gjykata e shpall dënimin me gjobë deri në 2.500 euro ose me burgim deri në një vit. Puna në dobi të përgjithshme mund të caktohet vetëm me pëlqimin e personit të dënuar.

Nëse e shqipton dënimin me kusht me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, gjykata e urdhëron personin e dënuar të kryej pa pagesë punë në dobi të përgjithshme për një periudhë të caktuar prej 30 deri 240 orë pune. Shërbimi sprovues vendosë për llojin e punës në dobi të përgjithshme që duhet të kryhet nga personi i dënuar, cakton organizatën e veçantë për të cilën personi i dënuar do të kryej punë në dobi të përgjithshme, vendosë për ditët e javës gjatë të cilave puna në dobi të përgjithshme do të kryhet dhe mbikëqyrë kryerjen e punëve në dobi të përgjithshme. Puna në dobi të

përgjithshme kryhet brenda një periudhe kohore të përcaktuar nga gjykata, e cila nuk e tejkalon një vit.

Nëse e shqipton dënimin me kusht me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, gjykata, po ashtu, mundë t'i urdhërojë personit të dënuar të mbajë kontaktin me shërbimin sprovues ose kryerjen e një apo më shumë detyrimeve të parapara në nenin 43 par 3 të KPK-së, ose nenin 51. Kohëzgjatja e detyrimit të paraparë me nenin 51 nuk mund të jetë më e shkurtër se gjashtë muaj ose më e gjatë se tri vjet.

Neni 50 par. 3 zbatohet përshtatshmërisht për detyrimin e urdhëruar me këtë paragraf që do të thotë se gjykata me rastin e zgjedhjes së detyrimit për të dënuarin merr parasysh moshën e personit, gjendjen e tij të përgjithshme shëndetësore e mendore mënyrën jetesës dhe nevojat e tij, veçanërisht nevojat në lidhje me familjen etj.

Nëse personi i dënuar nuk e kryen punën në dobi të përgjithshme, nuk mbanë kontaktin me shërbimin sprovues ose nuk e kryen detyrimin nga neni 51 i KPK-së siç janë mjekimi ose rehabilitimi mjekësorë, nënshtrimi në programin e trajtimit mjekësorë ose të rehabilitimit etj të cilat i kemi përmendur më lartë, atëherë gjykata mund ta zëvendësojë detyrimin e mëparshëm me një tjetër, mund të shtyjë kohëzgjatjen e mbikëqyrjes brenda kohës së verifikimit ose të revokoj dënimin me kusht.

4. Gjysmë liria

Gjysmë liria është lloji i pestë i dënimit alternative i para parë me kodin penal të Kosovës. Gjysmë liria si lloji i dënimit alternative konsiston në atë që personit që i është shqiptuar dënimi me burgim i mundësohet çdo ditë brenda orëve të caktuara (6, 8 apo 10 orë) të mund të qëndroj në liri për të vazhduar punën profesionale të cilën e ka kryer edhe para kryerjes së veprës penale, të kryej punë familjare, apo punë tjera të cilat vlerëson gjykata. Si kusht për t'iu shqiptuar gjysmë liria si dënim alternativ, sipas nenit 53 të KPK-së është që gjykata të shqiptojë dënim me burgim deri një vit, dhe pastaj të urdhërojë ekzekutimin e dënimit në gjysmë liri për shkak të detyrimeve të personit të dënuar lidhur me punën, arsimimin, kualifikimin ose aftësimin profesional ose të arsyeve tjera të cilat i vlerëson gjykata.

Programin për implementimin e dënimit në gjysmë liri e përpilon drejtori i burgut në bashkëpunim me organin e shërbimit sprovues.

Kur e vuan dënimin në gjysmë liri, personi i dënuar detyrohet që të kthehet në burg pas kryerjes së detyrimeve jashtë burgut brenda kohës së caktuar nga gjykata. Nëse i dënuari nuk i përmbushë detyrimet që lidhen me punën, arsimin ose aftësimin profesional, nuk i kryen obligimet themelore familjare, nuk pranon trajtimin e nevojshëm mjekësorë apo rehabilitues apo nuk kthehet në burg pas kryerjes së detyrimeve të tij, gjykata e revokon urdhrin për ekzekutimin e dënimit në gjysmë liri dhe urdhëron mbajtjen e dënimit të mbetur në burg.¹⁵

Përfundim

Format e reagimit shoqëror ndaj sjelljeve kriminale, në evolucionin e tyre, shumë herë kanë pasur ndryshime dhe transformime të dukshme. Në të kaluarën përfaqësues të shkollave të ndryshme kanë zhvilluar koncepte të ndryshme lidhur me reagimin ndaj kriminalitetit dhe mënyrën e parandalimit të tij.

Format e para të reagimit shoqëror ndaj kriminalitetit kanë qenë shumë të vrazhda, pra qysh herët, ndaj sjelljeve dhe veprimeve të rrezikshme ka pasur përpjekje që të gjykohen, por edhe të eliminohen duke përdorur mjete dhe metoda të ndryshme.

Në fillim ishte periudha e reagimit privat, quhet e tillë ngase ndaj sjelljeve dhe veprimeve kriminale të individëve dhe grupeve, reagon vetë individi apo grupi, pastaj fillojnë forma tjera të reagimit shoqëror ndaj sjelljeve kriminale siç është përzënia – dëbimi që konsistonte në përzënie apo dëbim nga fisi, klani, grupi apo familja, si dënim aplikohet për veprime dhe sjellje të rënda kundër interesave të fisit apo të grupit të caktuar shoqërorë. Dëbimi nga fisi apo grupi shoqërorë, sipas mendimeve në literaturën penologjike për atë periudhë konsiderohet si dënim i rëndë dhe ishte i barabartë me dënimin me vdekje.

Më pas ekzistonin edhe forma tjera të reagimit privat ndaj sjelljeve negative siç ishte hakmarrja dhe gjakmarrja, të cilat kanë dominuar një kohë të gjatë. Hakmarrja është manifestuar në kthimin e së keqes, kthimin e dëmit të shkaktuar me një të keqe dhe me një dëm disa fish më të madh ndaj individit grupit apo fisit tjetër. Po ashtu shpagimi me dëmshpërblim ishte një nga format e reagimit privat e cila në thelb të vetin e kishte pajtimin dhe lidhjen e paqes në mes fiseve dhe grupeve duke paguar sasi të caktuar të

¹⁵ Kodi Penal i Kosovës

sendeve, mallrave dhe gjërave të tjera të cilat janë konsideruar si kundërvlerë adekuate për krimin e kryer dhe në këtë mënyrë, janë kënaqur kërkesat e palës së viktimës dhe kanë qetësuar në masë të madhe dëshirën dhe instinktin për gjakmarrje dhe hakmarrje.

Me paraqitjen e shteteve të para dhe me forcimin e pushtetit, funksionin e ndjekjes së krimeve dhe zbatimin e ndëshkimit e merr në duar shteti dhe organet e tij. Dallimi kryesorë në mes shoqërisë primitive dhe periudhës së reagimit publik ku shteti merr rolin e vet është se deliktet dhe shkeljet në shoqërinë primitive ishin të drejtuara kundër tërë grupit, ndërsa në shoqërinë publike shtetërore, krimi ishte i drejtuar në rend të parë kundër të mirave dhe interesave të shtresës në pushtët. Kjo i kontribuoi lindjes së etapës së shpagimit dhe frikësimit, përmes formave prej më brutaleve siç ishin dënimi me vdekje duke i djegur në zjarr, prerja e kokës dhe shumë metoda tjera si këto me të cilat ndëshkoheshin kryesit e delikteve. Dënimet trupore dhe dhuna fizike, gjithashtu janë aplikuar me të madhe në fazën e reagimit publik.

Pastaj vjen etapa humanitare e reagimit publik ndaj kriminalitetit e cila karakterizohet nga idetë dhe mësimet e para, që kundërshtonin sistemin barbarë të ndëshkimeve e sidomos format e torturës dhe frikësimeve që ndërmerreshin ndaj kryesve të veprave penale. Në këtë përudhë kontributin e tyre e kane dhënë shumë shkencëtarë siç ishin Jeremi Bentham dhe Cesare Bakarie ku ky i fundit ishte ithtar i flakët i parimit “ Nulla poene sine lege”. Ai, në këtë mënyrë është angazhuar që të eliminoj nga praktika gjyqësore dhe policore arbitrarizmin, subjektivizmin dhe njëanshmërinë e gjyqtarëve.

Pas këtyre përpjekjeve shekullore të teoricienët pas Revolucionit Borgjez Francez dhe pas shfaqjes së shkollave dhe rrymave të reja në të drejtën penale, siç ishin shkolla pozitiviste italiane dhe shkollave sociologjike të cilat shkolla kanë trajtuar dhe theksuar rëndësinë e individualizimit të dënimit në luftë kundër kriminalitetit. Shkolla pozitiviste italiane kërkon që të braktiset pikëpamja deri atëherë, dominuese, se krimi dhe dëmi janë konstruksione juridike dhe instrumente të represionit penal. Ajo insiston në studimin dhe njohjen e personalitetit të delikuentet në elementet subjektive të veprës penale. Në lëmin e mbrojtjes nga kriminaliteti ajo është kundër represionit dhe kërkon që kriminaliteti të parandalohet, duke shëruar dhe përmirësuar delikuentet. Në vend të dënimeve kjo shkollë propozon të aplikohen masat shëruese dhe mbrojtëse. Po ashtu edhe shkolla sociologjike dhe shkolla e mbrojtjes së re shoqërore kanë dhënë kontribut të çmuar në këtë rrugë të gjatë të individualizimit të dënimit dhe humanizimit të tij.

Dënimet alternative janë inauguruar si sanksione të veçanta duke ju falënderuar angazhimit dhe mendimeve të shkollave të njohura juridike – penale dhe kriminologjike, kontributin e të cilave e elaboruam më lartë.

Dënimet alternative janë një produkt i ri i hulumtimeve shkencore të shkencës së penologjisë, të shkencës penale dhe kriminologjisë, dhe padyshim avancimit progresiv të këtyre disiplinave, të cilat me anë metodave shkencore bëjnë të mundur luftimin e kriminalitetit.

Qëllimi i dënimit në kohët moderne nuk është hakmarrja apo shkaktimi i një të keqe kryesit të veprës penale, siç ka qenë gjatë historisë, por përkundrazi rehabilitimi i kryesit të veprës penale dhe kthimi i tij në shoqëri si një pjesëtarë i mirë, i përgjegjshëm dhe ndërgjegjshëm i saj, që pas vuajtjes së dënimit në bazë të individualizimit të dënimit edhe ai ta jap kontributin e tij për ndërtimin e një shoqërie sa më të mirë ku do të mbizotërojë rendi dhe ligji. Në këtë kontekst dënimet alternative e luajnë rolin e tyre shumë thelbësorë sidomos te individualizimi dënimit, pasi çdo kryes i veprës penale e ka personalitetin e tij, vjen nga një rreth i caktuar shoqërorë dhe kulturorë, kanë shkallë të ndryshme të arsimimit etj, dhe ndaj tyre nuk mund të shqiptohen dënime të njëjlojta, pasi që nuk do të arrihej qëllimi i dënimit. Pra dënimet alternative janë një instrument i vlefshëm në duart e gjykatave, që gjatë shqiptimit të dënimeve të kenë mundësi që dënimin t’ia përshtatin çdo kryesi të veprave penale me qëllimi e rehabilitimit dhe risocializimit sa me të mirë të tij.

Dënimi me kusht është një ato konstruksione të shkencës modern, i cili dënim në të shumtën e rasteve e arrin qëllimin e dënimit, e i cili është që kryesi i veprave penale mos ti përsërisë më ato, pas që dënimet e shkurtra me burg nuk janë treguar të suksesshme në luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit dhe disa shkencëtarë këtë ia atribuojnë ambientit të burgut i cili mund të kthehet në një “shkollë” për kryesit e veprave penale, sepse shoqërimi me kriminel ndikon negativisht te ta, dhe koha e shkurtër e kaluar në burg nuk mund ta shkaktojnë ndjenjën e pendesës tek i dënuari. Po ashtu dënimi me kusht është i përshtatshëm të aplikohet nën kushtet e parapara me ligj, te shkelësit të cilët për herë të parë bijën ndesh me ligjin, sepse kjo në kushte dhe rrethana të caktuara mund ti ndodhë gjithsekujt, aq më tepër kur teorinë si ato të Lombrozos, se” kriminelët lindin të tillë, dhe dallohen për nga tiparet e fytyrës” ka kohë që janë treguar se nuk qëndrojnë. Për këtë arsye dënimi me kusht si dënim alternative të cilin e ka paraparë edhe legjisllacioni i Kosovës mund të jetë shumë efikas në arritjen e qëllimit të

dënimit që çdo i dënuar ta ketë një shanse të dytë që të përmirësohet. Njëjtë si dënimi me kusht edhe dënimi me kusht me urdhrin për trajtim të detyrueshëm apo nën mbikëqyrjen e shërbimit sprovues ose dënimi me kusht me urdhër për punë në dobi të përgjithshme janë dënime të cilat i kontribuojnë individualizimit të dënimit dhe parandalimit të kriminalitetit.

Gjysmë liria është gjithashtu një nga sanksionet penale e cila mund të shqiptohet ndaj kryesve të veprave penale, i cili sanksion parashihet dhe me legjislacionin e Kosovës.

Sipas studimeve komparative në lëmin e penologjisë ky sistem i sanksioneve penale që aplikohet në shtetet skandinave në masë më të madhe se në pjesën tjetër të botës, është treguar shumë i suksesshëm në luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit, vende këto që e kanë shkallën e kriminalitetit pothuajse më të voglën në botë, përkundër SHBA-ve të cilat ende e aplikojnë dënimin me vdekje dhe kriminaliteti vazhdon të jetë i lartë.



Amend Hamiti



Fatmire Cacaj



Florent Latifaj

SHPËLARJA E PARAVE DHE RREGULLIMI I SAJ NË LEGJISLACIONIN E KOSOVË

Hyrje

Nëse nisemi nga një kusht paraprak se qëllimi i kryerjes së një vepre penale është fitimi i parave dhe mundësisht më shumë para se sa që mund të fitohen nga një punë e ligjshme, atëherë këto para të fituar nga kryerja e një vepre penale kur shpenzohen duhet shpenzuar në atë mënyrë që të mos e tërheqin vëmendjen e autoriteteve¹⁶.

- Nigel Morris-Cotterill, 1998

Shumë autoritete rregullatore dhe qeveritare tentojnë të japin kuotën me të cilën vlerësojnë çdo vit për sasinë e parave të shpëlara në gjithë botën, ose brenda ekonomisë së tyre kombëtare. Megjithatë, Task Forca e Veprimit Financiar (FATF) në një nga vlerësimet e saj të fundit del se "në përgjithësi është absolutisht e pamundur për nxjerrjen e një vlerësimi të besueshëm për shumën e parave të shpëlara, mirëpo, fondet e përfshira në shpëlarjen e parave janë rritur me shpejtësi dhe shuma e përgjithshme e shpëlarjes së parave është midis 2% dhe 5% të prodhimit ekonomik botëror, ose midis 590 milion \$ dhe 15 miliardë \$, shumica e të cilave është fituar nga trafikimi me narkotikë, qenie njerëzore, por edhe nga korrupsioni, mashtrimi dhe krimi i organizuar".

Pavarësisht nga vështirësitë në matjen, shuma e parave të shpëlara çdo vit është në miliarda dollarë, shifra këto që e bëjnë "shpëlarjen e parave" një industri më të madhe se ajo e armëve apo e naftës dhe paraqet një shqetësim të rëndësishëm politik për qeveritë.

¹⁶ Nigel Morris-Cotterill book "How not to be a money launderer", 2nd edition (Silkscreen publication, 1998)

Si rezultat, qeveritë dhe organizmat ndërkombëtarë kanë bërë përpjekje për të penguar, parandaluar dhe kapur pastruesit e parave. Institucionet financiare kanë ndërmarrë gjithashtu përpjekjet për të parandaluar dhe zbuluar transaksionet që përfshijnë para të “pista”.

Qëllimi i këtij shkrimi do të jetë shpjegimi se çka është shpëlarja e parave, një historik se cilat janë institucionet e njohura botërore kundër shpëlarjes së parave, metodat e veprimit, si dhe në Kosovë me cilat ligje është i rregulluar luftimi dhe parandalimi i shpëlarjes së parave.

1. Historiku i shpëlarjes së parave dhe masat e marra për parandalimin e saj

Shpëlarja e parave si shprehje është shprehje e re, për herë të parë është përdorur nga gazetat gjatë raportimit mbi skandalin “Watergate”, në SHBA në vitin 1973. Kurse në kontekstin gjyqësor apo ligjor për herë të parë u përdor në vitin 1982 në SHBA në rastin SHBA kundër \$4,255,625.39 (1982) 551 F Supp.314.

Që atëherë, termi Shpëlarja e parave është pranuar dhe është në përdorim në gjithë botën. Pra, shpëlarja e parave si një vepër penale ka tërhequr interesim në vitet 1980, posaçërisht në kontekst të trafikimit të drogës. Me çka filloi të ngritet vetëdija nga qeveritë perëndimore për të vepruar kundër shpërndarësve të drogës dhe për të krijuar legjislacionin që do t'i pengonte ata që fitimet e tyre të paligjshme të gjeneruara nga kjo veprimtari kriminale të mund ti paraqesin si të ligjshme. Lufta kundër shpëlarjes së parave është një pjesë thelbësore e luftës së përgjithshme për të luftuar aktivitetet e krimit të organizuar dhe kohëve të fundit financimin e veprimtarive terroriste.

U bë e qartë gjatë viteve që bankat dhe institucionet e tjera financiare kanë qenë një burim i rëndësishëm informacioni në lidhje me shpëlarjen e parave dhe krimeve tjera financiare të hetuara nga organet e zbatimit të ligjit. Njëkohësisht, qeveritë në mbarë botën filluan të njohin se krimet e pakontrolluar financiare paraqesin rreziqe gërryese për sistemet e tyre ekonomike dhe politike.

Task Forca e Veprimit Financiar Kundër Shpëlarjes së Parave (FATF)

Një nga përpjekjet e para të organizuara në nivel botëror për të trajtuar problemin e shpëlarjes së parave, është krijimi i Task Forcës së Veprimit Financiar kundër Shpëlarjes së Parave (FATF). FATF u themelua nga grupi G-7 në samitin e saj ekonomik në Paris në korrik të vitit 1989. Ky është një organ ndërqeveritar që ka për qëllim zhvillimin dhe promovimin e politikave, për të luftuar shpëlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit, si në nivel kombëtar ashtu edhe atë ndërkombëtar.

Të anëtarësuar në FATF aktualisht janë 34 shtete dhe 2 organizata rajonale. FATF shqyrton misionin e saj në çdo pesë vjet dhe do të vazhdoj të ekzistoj duke e kryer funksionin e vet deri sa qeveritë anëtare pajtohen se kjo është e domosdoshme.

Në vitin 1990 dyzet rekomandimet origjinale të FATF janë hartuar si një iniciativë për të luftuar keqpërdorimin e sistemeve financiare nga persona që bënin shpëlarjen e parave të fituara nga trafikimi i drogës. Në vitin 1996 këto rekomandime janë rishikuar për herë të parë, dhe në këtë vit janë miratuar nga më shumë se 130 vende dhe janë standarde ndërkombëtare kundër shpëlarjes së parave.

Në tetor 2001, FATF e ka zgjeruar mandatin e saj për t'u marrë me çështjen e financimit të terrorizmit dhe mori hap të rëndësishëm për krijimin e nëntë rekomandimeve të veçanta për financimin e terrorizmit. Këto rekomandime përmbajnë një sërë masash që synojnë luftën kundër financimit të akteve terroriste dhe organizatave terroriste dhe janë plotësuese të dyzet rekomandimeve të para. Këto rekomandime kanë vendosur standardet minimale për veprim për vendet për zbatimin e detajeve në përputhje me rrethanat e tyre të veçanta dhe kornizat kushtetuese. Në vitin 2003 FATF nxori një version të rishikuar të rekomandimeve.

Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN)

Fondi Monetar Ndërkombëtar është një forum për shkëmbimin e informacioneve, zhvillimin e qasjeve të përbashkëta për çështjet, dhe promovimin e politikave të dëshirueshme dhe standardeve, të cilat janë të domosdoshme në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. FMN-ja luan një rol të rëndësishëm në përpjekjet për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. FMN-ja është shqetësuar veçanërisht për pasojat e mundshme të shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit në ekonominë dhe sistemet financiare të anëtarëve të saj.

Këto përfshijnë rreziqe për besueshmërinë dhe stabilitetin e institucioneve financiare dhe të sistemeve financiare, rritjen e stabilitetit të lëvizjes së kapitalit dhe stabilitetit të investimeve të huaja. Tri fushat kryesore të punës të FMN-së në lidhje me luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit janë vlerësimet, asistenca teknike dhe zhvillimi i politikave.

Banka Botërore

Banka Botërore identifikon mangësitë në rregulloret e sistemit financiar dhe të mbikëqyrjes. Siguron asistencë teknike, trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve, mbështetjen në hartimin e legjislacionit dhe rregulloreve për parandalimin e pastrimit të parave dhe të abuzimeve të tjera financiare. Ajo gjithashtu ndihmon në krijimin e njësive të inteligjencës financiare dhe trajnimin personelit të tyre. Ndër qëllimet e kësaj përpjekje janë: mbrojtja e integritetit dhe stabilitetit të sistemit ndërkombëtar financiar duke ndërprerë burimet në dispozicion të terroristëve dhe duke e bërë më të vështirë për ata të angazhuar në krim të përfitojnë nga aktivitetet e tyre kriminale.

Banka Botërore ka një bashkëpunim të ngushtë me FATF për të siguruar që të gjitha fushat e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të jenë adresuar.

Moneyval

Moneyval më parë ishte i njohur si Komiteti i Zgjedhur i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave kundër Shpëlarjes së Parave. Sot, ka 27 anëtarë të përhershëm, 2 anëtarë të përkohshëm dhe 1 vëzhgues aktiv. Përveç kësaj, një numër i rëndësishëm i shteteve dhe organizatave kanë statusin e rregullt të vëzhguesit¹⁷. Qëllimi i Moneyval është për t'u siguruar që shtetet të kenë sisteme efektive për të luftuar shpëlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit në përputhje me standardet relevante ndërkombëtare në këto fusha. Moneyval reciprokisht vlerëson shtetet për të gjitha standardet relevante ndërkombëtare në sektorët e ligjeve, financave dhe të organeve të zbatimit ligjor.

Që nga qershori i vitit 2006, Moneyval-it është bërë anëtar pjesëmarrës në FATF. Ky status ofron një mundësi për më shumë vende në kuadër të

¹⁷ www.coe.moneyval

Moneyval-it për të marrë pjesë aktivisht në mbledhjet e FATF, si pjesë e Këshillit të Evropës delegacion i Moneyval.

Grupi EGMONT

Shtete të ndryshme të botës kanë zhvilluar sistemet për t'u marrë me problemin e shpëlarjes së parave dhe me ligjet e veçanta kanë krijuar agjencitë e specializuara shtetërore. Këto agjenci zakonisht njihen si "Njësitë e Inteligjencës Financiare" ose "NJIF".

Duke parë të mirat e rrjetit të NJIF-it, në vitin 1995, një grup i NJIF-ave në Pallatin Arenberg Egmont në Bruksel vendosi të formojë një grup joformal për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar. Që tani njihet si Grupi Egmont, këto NJIF takohen rregullisht për të gjetur mënyra për të bashkëpunuar në fushat e shkëmbimit të informacionit, trajnimit dhe shkëmbimit të ekspertizës.

Aktualisht janë 101 vende me njësi operative NJIF të njohura, me të tjerët në faza të ndryshme të zhvillimit. Grupi takohet një herë në vit, nuk ka sekretariat të përhershëm dhe funksionet administrative ndahen në bazë të radhës. Edhe pse fillimisht fokusi i NJIF Egmont ishte në thelb mbi shpëlarjen e parave, NJIF gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në përpjekjet ndërkombëtare për të luftuar financimin e terrorizmit.

Egmont grupi në vitin 1996 ka miratuar përkufizimin e mëposhtëm të një NJIF, i ndryshuar në vitin 2004 si pasojë për të pasqyruar rolin e NJIF në luftën kundër financimit të terrorizmit. Një agjenci qendrore kombëtare është përgjegjëse për marrjen (dhe sipas rastit, për të kërkuar), analizimin dhe shpërndarjen tek autoritetet kompetente informacionet financiare të zbuluara:

- a) në lidhje me dyshimin mbi të ardhurat nga krimi dhe financimin potencial të terrorizmit, apo
- b) që kërkohen nga ligjet ose rregulloret shtetërore, në mënyrë për të luftuar shpëlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit.¹⁸

Sipas Deklaratës për Qëllimin e Grupit Egmont, pjesëmarrja e Njësitit të Inteligjencës Financiare (NJIF) në Grupin Egmont ndikon për të inkurajuar

¹⁸ www.egmontgroup.org

bashkëpunimin ndërmjet tyre në interes të luftës kundër shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit.

2. Nocioni i shpëlarjes së parasë

Çka është shpëlarja e parave?

Nëse do të kishim bërë një anketë në rrugët e qytetit duke kërkuar përgjigje në pyetjen e mësipërme, përgjigja e përgjithshme nga shumica e njerëzve do të jetë se ata nuk kishin ide. Ky reagim tipik është një nga problemet që qeveria dhe organet e zbatimit të ligjit e kanë në luftën kundër këtij lloji të krimit. Kjo është mungesa e informacionit rreth shpëlarjes së parave që është në dispozicion të njerëzve në rrugë, që e bën atë një problem të padukshëm dhe kështu të vështirë për të trajtuar.

Ekzistojnë definicione të ndryshme të cilat përshkruajnë Shpëlarjen e Parave:

Shpëlarja e parave është proces me të cilin shuma të mëdha parash të fituara në mënyrë të paligjshme, e marrin pamjen kinse e kanë origjinën nga një burim legjitim¹⁹.

Shpëlarja e parave, është një akt i bërjes së parasë, që të duken se ato para vijnë nga burimi A kurse në të vërtetë ato para vijnë nga burimi B, pra përdoret për të fshehur origjinën e parave të paligjshme, si janë fituar ato para, duke i paraqitur ato të ardhura të fituar në mënyrë të ligjshme²⁰.

Shpëlarja e parave është procesi të cilin grupe kriminale apo individ të tillë, e përdorin për të maskuar fitimet e tyre ilegale duke i investuar ato. Shpërndarësit e drogës, grupet terroriste e grupe apo individ të ndryshëm kriminal përdorin shpëlarjen e parave për maskimin e aktiviteteve ilegale që zotërojnë.

Nëse bëhet me sukses shpëlarja e parave, kjo lejon kriminelët për të ruajtur kontrollin mbi të ardhurat e tyre dhe në fund të fundit për të siguruar një mbulesë legjitime për burimin e tyre të të ardhurave.

3. Metodatat e shpëlarjes së parasë

¹⁹ www.investopedia.com/terms/m/moneylaundering.asp

²⁰ Layton, Julia. "How Money Laundering Works"

“Shpëlarja e parave” është një proces që artikulohet në tri faza (hyrja, tjetërsimi dhe integrimi)²¹, të cilat bëjnë përzierjen (bashkimin) e fondeve të përfituara ilegalisht me fondet ligjore që venë në lëvizje ciklin ekonomik ligjor.

Faza e parë është “hyrja” në të cilën “pastruesi” fut paratë e “pista” në sistemin financiar ligjor, duke përdorur të gjitha instrumentet financiare që ka në dispozicion, si çeqet e udhëtimit, deri te metoda më e thjeshtë, siç mund të jetë ndarja e shumave të mëdha në pjesë më të vogla dhe depozitimi i tyre në banka, me emra të ndryshëm, që më vonë, ashtu si çeqet, do të ribashkohen dhe depozitohen në llogari bankare të lokaliteteve të tjera.

Faza e dytë është “tjetërsimi”. Kjo është faza gjatë së cilës fondet e futura më parë në sistemin financiar ligjor konvertohen ose thjesht transferohen nga njëra bankë në tjetrën, anembanë sistemit bankar të vendit.

Në fazën e tretë, të quajtur jo rastësisht “integrim”, fondet thuajse “të pastra” rihyjnë në ciklin ekonomik ligjor për t’u investuar ose konvertuar në mallra me vlerë ose pasuri të paluajtshme. Kështu pastrimi i parave është një fenomen që përmbledh në vetvete dy krime të ndryshme: i pari, krimi kryesor, i cili sjell të ardhura që kanë nevojë “të shpërlahen”, dhe i dyti, krimi që kryen tjetërsimin e prejardhjes ilegale të fondeve.

Metodat me të cilat mund të bëhet shpëlarja e parasë janë të ndryshme dhe mund të shkojnë nga e thjeshtë deri në metoda më komplekse.

1. *Kontrabandimi i valutës*- kjo është lëvizja fizike ilegale e valutës dhe të instrumenteve monetare jashtë nga një shtet në shtetin tjetër. Metodat e ndryshme të transportit nuk kanë lënë një gjurmë të dukshëm gjatë auditimit²².
2. *Strukturim i-* i njohur shpesh si "smurfing" është një metodë e hyrjes me të cilën paraja është kthyer në depozita më të vogla të parave të përdorura për të hequr dyshimin për shpëlarje parash dhe për të shmangur kërkesat e parapara të raportimit kundër shpëlarjes së parave²³.
3. Një nën-komponentë e strukturimit është përdorimi i *Parave të gatshme për ti konvertuar në mjete monetare* - kur “hyrja” është e

²¹ Këto tri faza disa ekspert i ndajn si fshehja, lëvizja dhe investimi

²² "National Money Laundering Threat Assessment"

²³ "Structuring Financial Transactions to Evade Reporting Requirements". Retrieved March 3, 2011

suksesshme në kuadër të sistemit financiar me anë të një banke ose institucioni financiar, të ardhurat pastaj mund të konvertohen në instrumentet monetare. Kjo përfshin përdorimin e overdraft kredive dhe urdhërpagesave²⁴.

4. *Pjesëmarrja e Bankës* - kjo ndodh kur një institucion financiar banka, është në pronësi apo e kontrolluar nga individë të paskrupullt të dyshuar për bashkëpunim me trafikant të drogës dhe grupet e tjera të krimit të organizuar. Kjo e bën procesin e lehtë për pastruesit. Liberalizimi i plotë i sektorit financiar, pa kontrolle të përshtatshme gjithashtu ofron hapësirë për shpëlarjen e parasë²⁵.
5. *Këmbimet e parave* - Në një numër të ekonomive në tranzicion liberalizimi i tregjeve valutore ofron hapësirë për lëvizjet e parasë dhe nga këto politika mund të përfitojnë personat e përfshirë në skemat e pastrimit të parasë.
6. *Komisioneret e letrave me vlerë* - komisioneret mund të lehtësojnë procesin e shpëlarjes së parave nëpërmjet strukturimit të depozitave të mëdha të hollave në atë mënyrë që fshehin burimin origjinal të fondeve.
7. *Përzierja e Fondeve* - vendi më i mirë për të fshehur para të gatshme është duke përzierë me një shumë të hollash të tjera. Prandaj, institucionet financiare mund të jenë “makinë” për shpëlarjen e parave. Mundësi tjetër është që të përdorin paratë nga aktivitete të paligjshme për të ngritur kompanitë. Kjo mundëson fondet nga aktivitetet e paligjshme që të mos pengohen në transaksionet ligjore.
8. *Blerje e pasurive/pronave* - Blerja e pronave me të holla në të gatshme është një metodë klasike e shpëlarjes së parave. Qëllimi i madh është për të ndryshuar formën e të ardhurave nga paratë e gatshme të dukshme në një formë më pak të dukshme por njëjtë të vlefshme.
9. *Prona/pasuria materiale e blerë me para të gatshme e shitur pastaj* - Pasuritë të cilat janë blerë me fonde të paligjshme mund të rishiten në vend ose jashtë vendit dhe në një rast të tillë të bëhet më e vështirë për të i zbuluar ato pasuri dhe për ti konfiskuar.
10. *Tregtia me prona* - shitja e pronës për të integruar paratë e pista në ekonomi është një praktikë e zakonshme në mesin e kriminelëve. Për shembull, shumë grupe kriminale përdorin si mburojë kompanitë për të blerë pronë, pra të ardhurat nga shitja do të konsiderohen legjitime.

²⁴ Po aty.

²⁵ "National Money Laundering Threat Assessment"

11. *Kompanitë “anonime” dhe kreditë e rrejshme* – kompanitë “anonime” themelohen zakonisht në ato shtete ku ekzistojnë ligjet për ruajtjen e sekretit të korporatës, me të cilën pastruesit e parasë marrin kredi kinse për të bërë biznes dhe duke paguar kreditë dhe interesin e kredisë, të ardhurat e tyre pastrohen në një transaksion në dukje të ligjshëm²⁶.
12. *Kompanitë “mburojë”*- janë kompani të rreme që ekzistojnë për asnjë arsye tjetër vetëm se për të pastruar paratë. Ata marrin paratë e pista kinse si pagesa për mallra ose shërbime por në të vërtetë nuk ofrojnë mallrat ose shërbimet, thjesht krijojnë pamjen e transaksioneve të ligjshme nëpërmjet faturave të rreme dhe të bilancit të hyrje daljeve.
13. *Kazinot-çipat* blihen me para në dorë, pastaj pas një periudhe kohore gjatë cilës loja e bixhozit ka mund të luhet ose nuk mund ndodhin çipat këmbehen në të holla, ose paguhen në emër të një pale të tretë. Pastruesit e parave mund të zotërojnë një kazino, një biznes i bazuar në para të gatshme dhe pretendojnë se sasi të mëdha të parave të gatshme të mbajtura janë fitimet e tyre nga kazino. Kjo kërkon që tatimet duhet të paguhen, por i jep pastruesve një mbulesë ligjore për aktivitetet e tyre të paligjshme²⁷.
14. *Transaksionet bankare*- për pastrimin e parave bëhen duke deponuar një shumë të parave në një llogari bankare. Këto fonde pastaj mund të transferohen në një bankë në një vend tjetër, në mënyrë ideale në një shtet që ka një mungesë të sistemit të raportimit. Këto fonde mund të transferohen përsëri në ndonjë bankë në botë dhe në këtë mënyrë të bëjë që paratë e tyre të pista të duken në rregull nga ana ligjore.
15. *Faturat e rrejshme të Import/eksportit* – Përdorimi i faturave të rreme nga kompanitë për import/eksport është provuar të jetë një mënyrë shumë efiçente e integritit të ardhurave të paligjshme përsëri në ekonomi. Kjo përfshin mbiçmimin e dokumenteve hyrëse për të arsyetuar fondet e deponuara në bankat vendore apo vlerën e fondeve të pranuar nga eksporti²⁸.

3.1 Interneti dhe shpëlarja e parave

²⁶ Financial Action Task Force. "Global Money Laundering and Terrorist Financing Threat Assessment"

²⁷ "National Money Laundering Threat Assessment"

²⁸ Baker, Raymond (2005). *Capitalism's Achilles Heel*. Wiley

Kohët e fundit, fenomeni i shpëlarjes së parave "të pista", domethënë atyre parave që rrjedhin nga aktivitete kriminale (trafikimi në të gjitha format e tij, krimet e ndryshme ekonomike etj.), ka marrë përmasa të frikshme.

Sipas disa studiuesve të shpëlarjes së parasë, interneti ofron një metodë të re dhe të padiktueshme të shpëlarjes së parasë e njohur si shpëlarje e parave përmes internetit. Interneti është asgjë më shumë se një sistem i mesazheve, për të lëvizur para, bankat lëvizin informacion me çfarëdo sistemi i mesazheve që e kanë në dispozicion nga ai kur fizikisht lëvizin pllakat prej ari nga një vend në një tjetër për kontrolle të përpunimit.²⁹

Në këtë kontekst, interneti është thjesht një mjet më efikas, më i lirë dhe më i sigurt i lëvizjes së informacionit financiar. FATF ka vënë në dukje se problemi kryesor është identifikimi i konsumatorëve që rrjedhin nga përdorimi i internetit dhe se problemi është i njëjtë si tek çdo marrëdhënie e kryer në distancë.

4. Si është rregulluar baza ligjore në Kosovë

Në Kosovë shpëlarja e parasë është një vepër penale e re, pasi që para vitit 1990 nuk kishte pothuajse fare rregullore në lidhje me shpëlarjen e parave në sistemin bankar të ish Jugosllavisë gjegjësisht të Kosovës. Bankat, në përputhje me politikën e asaj kohe, kanë hetuar vetëm depozitat private dhe transferimet me kërkesë të Sekretariatit të Punëve të Brendshme (MPB). Duke pasur parasysh specifikat nëpër të cilat kaloi Kosova në periudhën 1990-1999, në vitin 1999 u bë një tranzicion i shpejtë nga ekonomia e planifikuar në ekonominë e tregut. Më saktësisht, një ekonomi e bazuar në para të gatshme e bën Kosovën një vend mjaft të përshtatshëm për shpëlarje të parave, sikurse vendet tjera që janë në proces të tranzicionit politik dhe ekonomik. Pas luftës në vitin 1999 ka pasur një investim të madh në Kosovë, ku shumë njerëz u bënë të pasur. Pasurimi shumë i shpejtë dhe krijimi i kapitaleve të mëdha në Kosovë, gjoja se nga aktivitetet ekonomike, është një shtrembërim i realitetit dhe një kamuflim shumë i dukshëm i krimit të organizuar përmes shpëlarjes së parave.

Më 6 shkurt 2004 Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), e shpalli Rregulloren nr. 2004/2 mbi pengimin e pastrimit të parave dhe veprave të ngjashme penale.

²⁹ Nigel Morris-Cotterill book "How not to be a money launderer", 2nd edition (Silkscreen publication, 1998)

Për herë të parë në Kosovë u ndërmor diçka për sanksionimin e kësaj vepre penale, me këtë rregullore u themelua edhe Qendra e Inteligjencës Financiare.

Rregullorja e përmendur më lartë e definonte pastrimin e parave si vepër penale, sanksionet, kërkesat e raportimit dhe se kjo vepër është e dënueshme me burgim deri në dhjetë vjet dhe me gjobë deri në tri herë më shumë se vlera e pasurisë që është fituar nga vepra penale. Ajo cakton detyrime të tilla që bankat dhe institucionet financiare, OJQ-të, partitë politike, organizatat e biznesit, shërbimi doganor të raportojnë për aktivitete të dyshimta financiare tek Qendra e Inteligjencës Financiare, për të mbajtur të dhënat për klientët e tyre, si dhe për të trajnuar personelin e tyre, etj.

Ndërsa, që nga 24 nëntori 2010 është në fuqi Ligji nr. 03/L-196 për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit me të cilin ligj, disa mangësi që i kishte Rregullorja janë përfshirë në ligj dhe tani kemi një përafrim më të madh me rekomandimet e FATF si në përkufizimin e shpëlarjes së parasë, numrin e subjekteve raportuese, cilat vepra hyjnë në kompetencë ekskluzive të Prokurorisë Speciale gjithashtu edhe roli i Njësisë së Inteligjencës Financiare-Kosovë është më i qartë.

Përkufizimi sipas ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, thotë:

Shpëlarje e parasë është çdo veprim me synim maskimin e origjinës së parave ose prone tjetër, të fituara nga ndonjë vepër penale, ku përfshihet:

- 1. Konvertimi ose çdo transfer i parave që rrjedhin nga aktiviteti kriminal;*
- 2. Fshehja ose maskimi i natyrës, origjinës, vendit, lëvizjes, rregullimit, të drejtave, ose pronësisë në lidhje me paratë ose pronë tjetër të fituar nga aktivitetet kriminale.*

4.1 Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës

Zyra e Prokurorëve Special të Kosovës është themeluar me udhëzimin administrativ të UNMIK-ut nr.2006/15 për Themelimin e Departamentit Administrativ të Drejtësisë, të datës 30 shtator 2006, si pjesë e departamentit të drejtësisë së asaj kohe, kurs në nenin 4 parashiheshin kompetencat e saj që të merret me veprat penal të krimit të organizuar, korrupsionit, trafikimit me qenie njerëzore, terrorizmit dhe ato të motivuara nga urrejtja racore, fetare dhe kombëtare.

Kjo zyre me anë të Ligjit nr.03/L-052 për Prokurorin Speciale të Republikës së Kosovës, themelohet si organ prokurorial i përhershëm dhe i specializuar që vepron në kuadër të Prokurorit të Shtetit të Kosovës, kompetencat e saj parashihen në nenin 5 dhe janë të njëjta veç se në mënyrë më specifike ceken llojet e veprave penale të parapara në Kodin Penal të Kosovës dhe në ligjet e veçanta e që janë kompetencë e veçantë e saj.

Në kuadër të kompetencës ekskluzive të kësaj Prokurorie hyn edhe vepra e shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit më saktësisht veprat e parapara në nenin 26³⁰, 27³¹ dhe 28³² të Ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit.

Deri në muajin gusht të vitit 2011, kemi vetëm një dënim për shpëlarje parash është arritur nga kjo prokurori, dy aktakuza janë në pritje të konfirmimit kurse rastet tjera të shpëlarjes së parasë ende janë në fazën e hetimeve.

4.2 Njësia e Inteligjencës Financiare-Kosovë

Kjo njësi është themeluar si institucioni qendror i pavarur kombëtar përgjegjës për kërkimin, marrjen, analizimin dhe shpërndarjen tek autoritet kompetente dhe bërjen publike të informacionit në lidhje me shpëlarjen potenciale të parave dhe financimin e terrorizmit. Detyrat dhe kompetencat e NJIF-K-së parashihen me nenin 14 të ligjit.

Duke pasur parasysh përhapjen e legjislacionit në Kosovë ka agjenci të shumta të zbatimit të ligjit që janë të përfshira në zbulimin dhe ndjekjen e veprave penale të pastrimit të parave të tilla janë si Njësia e Inteligjencës Financiare-Kosovë, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, Njësia për hetime financiare, Policia e Kosovës – Departamenti kundër krimeve ekonomike, Shërbimi Doganat e Kosovës dhe institucionet e tjera të lidhura me zyrën e prokurorisë. Mirëpo, për të dhënë rezultate duhet një bashkëpunim më i ngushtë dhe i sinqertë midis këtyre institucioneve pasi që shpëlarja e parasë ekziston në Kosovë dhe pothuajse në mënyrë të lirë vepron.

5. Rasti Franklin Jurado

³⁰ Detyrimet shtesë të avokatëve, noterëve, kontabilistëve të certifikuar, auditorëve të licencuar dhe këshilltarëve tatimor

³¹ Detyrimet shtesë të transaksioneve për pasuritë e paluajtshme


³² Detyrimet shtesë të kazinove dhe shtëpive tjera të lojërave të fatit

Në fund të viteve 1980 fillim të viteve '90, ekonomist Franklin Jurado i cili kishte studiuar në Harvard duke përdorur një skemë shumë të ndërlikuar, udhëhoqi një operacion për shpëlarjen e parave për Lordin e drogës kolumbiane Josezoti Santacruz-Londono. Në formën e saj më të thjeshtë, operacioni shkoi kështu:

Hyrja: Jurado të hollat nga shitja e drogës në SHBA i deponon në llogaritë bankare në Panama.

Tjetërsimi: Ai pastaj i ka transferuar parat nga llogaria në Panama në më shumë se 100 llogari bankare në 68 banka në nëntë shtete të ndryshme në Evropë, gjithmonë transaksionet ishin me vlerë nën 10.000 \$ për të shmangur dyshimin. Llogaritë bankare ishin në emra të imagjinuar si dhe në emrat e dashnoreve të Santacruz-Londono dhe anëtarëve të tij të familjes. Jurado në Evropë pastaj krijoi edhe kompani "mburojë" në mënyrë që ti dokumentoj këto të holla si të ardhura të ligjshme.

Integrimi: Plani ishte që këto para të dërgohen në Kolumbi, ku Santacruz-Londono do ti përdorte për të financuar bizneset e shumta të tij të që ishin të ligjshme. Por Jurado u kap.



Jurado ka arritur që ti kanalizoj gjithsej 36.000.000 \$ të fituara nga trafikimi me drogë përmes institucioneve legjitime financiare. Skema Jurado u zbulua, kur një bankë në Monaco falimentoj dhe gjatë një kontrolli të mëvonshëm të auditimit u zbuluan llogaritë e shumta që qonin tek Jurado. Në të njëjtën kohë, fqinji i Jurados në Luksemburg ka paraqitur një ankesë për zhurmë, sepse Jurado kishte një makinë për numërimin e parave e cila punonte gjithë natën. Autoritetet lokale filluan menjëherë hetimet dhe një gjykatë në Luksemburg e shpalli atë fajtor për pastrimin e parave. Kur ai përfundoi dënimin e shqiptuar në Luksemburg, një gjykatë amerikane e shpalli gjithashtu atë fajtor, dhe e dënoi me shtatë vjet e gjysmë burg.

Kur autoritetet janë në gjendje për të ndërprerë një skemë të shpëlarjes së parave, mundi i bërë shpaguhet, sepse kjo çon në arrestime, konfiskimin e parave të pista dhe të pronës dhe nganjëherë çmontimin e një operacioni

kriminal. Megjithatë, shumica e skemave të pastrimit të parave veprojnë pa u vënë re dhe kanë efekte serioze në sigurinë sociale dhe ekonomike.

Përfundimi

Ashtu si në të kaluarën, veprimtaritë kriminale sigurojnë mundësitë e pafundme për një individ të etur për tu bërë i fuqishëm, i pasur,...

Në ditët e sotme, për të bërë shpëlarje të suksesshëm të parave është ndoshta edhe më e lehtë se kurrë më parë. Mjetet e ofruara nga avancimi teknologjik dhe udhëzimet e vëna në dispozicion në internet, biblioteka dhe në librari kanë hapur mundësi të pakufizuara për njerëzit me aspiratat e tilla për të filluar aktivitetin e tyre dhe për të gjetur mënyra për të vazhduar dhe mbuluar atë me sukses.

Fitimet në aktivitete kriminale janë aq të larta që është befasi që kriminelët mund të paguajnë ekspertët më të mirë në disa fusha për të kryer aktivitetet e tyre në mënyrën më të mirë të mundshme dhe për të mbuluar origjinën e të ardhurave të tilla. Zakonisht një kriminel i tillë është gjithmonë të paktën një hap përpara sistemit ligjor se ndryshe ai do të ishte kapur menjëherë.

Duke përcjellë zhvillimet e fundit në tregjet e botës dhe ndryshimet në sistemet ligjore, ndoshta mund të parashikojmë boshllëqet që do të përdoren nga kriminelët për të shmangur masat legjislative dhe për të mbuluar fitimet e tyre.

Duhet të përmendet se globalizimi dhe bashkëpunimi ndërkombëtar ju ka ndihmuar palëve (si atyre të zbatimit të ligjit edhe kriminelëve) në sigurimin e zonës operative për veprimtaritë e tyre. Një nga parakushtet e suksesit të luftës kundër shpëlarjes së parave është bashkëpunimi ndërkombëtar në këmbimin dhe ndarjen e informacioneve dhe veprimeve të përbashkëta të agjencive të zbatimit të ligjit. Çfarëdo që të bëjë një shtet nëse nuk është ndjekur nga të gjithë të tjerët veprimi nuk ka efekt, pasi që paraja është shumë lehtë për të lëvizur.

Agjencitë e zbatimit të ligjit në fakt duhet të veprojnë në mënyrë proaktive dhe të mendojnë si kriminelët me qëllim të parandalimit të shpëlarjes së parave. Kështu që është më e rëndësishme se kurrë që agjencitë e zbatimit të ligjit dhe të drejtësisë penale të kenë mjetet, ligjet, pajisjet dhe aftësitë e sofistikuara për të luftuar këto krime.

Për momentin situata është e tillë: nëse krimi ju ka sjellë tashmë fitimet pjesa më e madhe e punës është bërë për shkak se shpëlarja e parasë është një proces mjaft i shtrenjtë, por i thjeshtë, i shpejtë, efikas, duke ofruar shumëllojshmëri dhe mundësi të pafundme.



Valon Kurtaj



Artan Sejrani

DEKLARATA E TË PANDEHURIT SI PROVË NË PROCEDURËN PENALE

Hyrje

Në një çështje penale-procedurë penale rol të rëndësishëm zënë provat, ku prova është një fakt nga i cili varet ekzistimi apo mos ekzistimi i një vepre penale, ashtu si është përcaktuar në procedurë penale³³.

Duke u nisur nga konstatimet e lartë përmendura lidhu me provat, një rëndësi të posaçme shtjelluese në këtë publikim i kemi dhënë dëshmisë së të pandehurit. Procedura penale përbëhet prej këtyre stadeve: a) procedurës paraprake që përfshin fazën e hetimit, akuzimit dhe konfirmimit të aktakuzës; b) shqyrtimin gjyqësorë që përfshin marrjen dhe shpalljen e aktgjykimit; c) procedurën sipas mjetit juridik dhe procedurën e ekzekutimit të sanksionit penal³⁴.

Në këtë publikim, nuk do të jetë objekt shtjellimi deklarata e të pandehurit në të gjitha fazat e procedurës penale, por theks i veçantë do ti kushtohet deklaratës së pandehurit në fazën e hetimeve, respektivisht dhënien e të njëjtës para prokurorit dhe policisë. Gjithashtu, këtu nuk do të mbetet pa u trajtuar edhe pranueshmëria dhe papranueshmëria e deklaratës së të pandehurit si provë në procedurën penale.

Duke shfrytëzuar burime të ndryshme të natyrës juridiko teorike dhe praktike, e duke mos përjashtuar dhe krahasimin, respektivisht komparativitetin e legjislacionit tonë penal me disa legjislacione të shteteve të regjionit, jemi munduar të japim një punim-publikim i cili do të përmbajë informata qenësore sa i përket temës Deklarata e të Pandehurit si Provë në Procedurën Penale.

³³ Seminarski, Diplomski i Maturski Radovi /Pravni Fakultet-Sarajevo /Pojam i Vrste Dokaza, f. 3

³⁴ Stadet e Procedurës Penale / www.valonhasani.do.am / shfrytëzuar me datë 20 korrik 2011

Vështrime të përgjithshme të sistemit–tipit akuzator, inkuizitor dhe raportit me deklaratën e të pandehurit

E drejta procedurës penale, si dhe çdo degë tjetër juridike, formohet dhe zhvillohet në përputhje me kushtet historike konkrete të zhvillimit të marrëdhënieve shoqërore. Vështrimi i zhvillimit historik të procedurës penale si tërësi tregon se ajo rrjedh prej veprës penale dhe procesit të kuptuarit si çështje private të palëve, deri te vepra penale dhe procesi i të kuptuarit si çështje e rregullimit juridik dhe se kjo ka pasur për pasoj organizimin e nduarduart të rregullimit juridik.³⁵

Kështu i tërë zhvillimi historik i gjertanishëm ka hedhur në dritë tri tipe - sisteme themelore të procedurës penale e ato janë: tipi-sistemi akuzator (paditës), tipi-sistemi inkuizitor (hetues) dhe tipi-sistemi akuzator-inkuizitor.³⁶

Kur kemi të bëjmë me deklaratën e të pandehurit si provë në procedurë penale, është me rëndësi të veçantë të hedhim një këndvështrim tri tipeve - sistemeve themelore të procedurës penale dhe karakteristikave të tyre në raport me deklaratën e të pandehurit, varësisht dominimit të elementeve të njërit nga këto tipe të procedurës penale shfaqen edhe nduarshmëritë në raport me deklaratën e të pandehurit.

Sistemi-tipi akuzator dhe karakteristikat e tij

Tipi akuzator i procedurës penale zhvillohet në formë të kontestit ndërmjet dy palëve të barabarta-paditësit dhe të pandehurit.³⁷

Në fakt sistemi akuzator është një sistem ligjor ku palët përfaqësojnë pozicionet e tyre përpara një personi apo grupi njerëzish të pavarur, zakonisht një jurie ose gjykatës, që përpiqen për të përcaktuar të vërtetën e çështjes për dallim nga sistemi inkuizitor që ka një gjyqtar (apo një grup gjyqtarësh) detyra e të cilit është të hetoj rastin.³⁸

Në sistemin-tipin akuzator obligimi i paditësit (prokurorit) është që të ofroj prova të mjaftueshme para gjykatës për ta vërtetuar dhe bazuar fajësinë e të pandehurit, nëse dëshiron që gjykata ta shpallë fajtor të pandehurin. Barra e

³⁵ E Drejta e Procedurës Penale, Mr. Ejup Sahiti, fq.12-vi1986 / Cit. nga Dr. Vasileviq fq.17

³⁶ E Drejta e Procedurës Penale, Mr. Ejup Sahiti, fq.12-1986

³⁷ E Drejta e Procedurës Penale, Mr. Ejup Sahiti, fq.13-1986

³⁸ http://en.wikipedia.org/wiki/Adversary_system / shfrytëzuar me datë 25 korrik 2011

provave (onus probandi) në këtë tip-sistem bie mbi paditësin, sepse gjithashtu karakteristikë e këtij tipi-sistemi është dhe parimi (actore non probante, reus absolvitur), nëse paditësi nuk provon akuzën i pandehuri lirohet.

Gjykata në këtë tip-sistem është një arbitër në kuptimin e plotë të fjalës, ku e kryen funksionin e gjykimit në bazë të padis, respektivisht iniciativës së palës paditëse, ku gjykata asnjëherë nuk mund dhe nuk ndërmerr ndjekjen penale me vetë iniciativë.

Gjyqtarët në këtë tip-sistem të procedurës penale janë të paanshëm në sigurimin e një loje të drejtë - fer, procesi të rregullt ligjor, apo sigurimin e një drejtësie fundamentale.³⁹

Andaj si përfundim mund të theksojmë se sistemi - tipi akuzator është një sistem i drejtësisë penale ku pasqyrohet procesi i ndjekjes penale (i ndërmarrë nga prokurori) dhe i mbrojtjes (i ndërmarrë nga i pandehuri). Kjo është detyrë parësore e prokurorit dhe mbrojtjes që të pasqyrojnë pikëpamjet e tyre brenda kufizimeve dhe rregullave për të provuarit, ku gjyqtari vepron si një arbitër i paanshëm, i cili lejon që faktet, provat të pasqyrohen në këtë procedurë dhe bazuar në këto fakte të vijë deri tek vendimi meritor.⁴⁰

Bazuar në të thënat e lartë përmendura, ku procesi i ndjekjes dhe hetimit të veprave penale në këtë sistem - tip është barrë e prokurorit, andaj marrja e deklaratës së pandehurit bëhet nga ana e prokurorit apo policisë nën autorizimin e prokurorit, për dallim nga tipi inkuizitor ku këto veprime janë nën kompetencën e gjyqtari hetues (gjykatës).

Sistemi-tipi inkuizitor dhe karakteristikat e tij

Në sistemin-tipin inkuizitor për dallim nga ai akuzator, më nuk ekzistojnë kontesti apo procedura penale ndërmjet dy palëve asaj paditëse dhe të pandehurit, ku në sistemin-tipin akuzator gjykata është një arbitër në kuptimin e plotë të fjalës dhe e kryen funksionin e gjykimit në bazë të padisë, respektivisht iniciativës së palës paditëse, përkundër sistemit inkuizitor i cili nuk i përmban këto karakteristika.

³⁹ http://en.wikipedia.org/wiki/Adversary_system / shfrytëzuar me datë 25 korrik 2011

⁴⁰ Oxford Dictionary, Fifth Edition, Edited by Elizabeth A. Martin, fq.7

Përballë të pandehurit më nuk qëndron paditësi privat por inkuirenti-hetuesi në duar e të cilit janë të përqendruara tri funksionet themelore të procedurës penale. I pandehuri konsiderohet objekt ndaj të cilit zhvillohet procedura. Rrjedhimisht posa paraqitet dyshimi se i pandehuri ka kryer vepër penale inkvirenti ex officio e fillon ndjekjen penale ndaj tij.⁴¹

Në sistemin-tipin inkuizitor, procedura kalon nëpër dy stade-stadin e hetimeve dhe atë të gjykimit. Stadi i hetimeve e udhëhequr nga inkuirenti dhe prej nga e ka marrë emrin ky sistem-tip, është faza më karakteristike e këtij sistemi.

Sistemi-tipi inkuizitor është sistem ligjor ku gjykata apo një pjesë e gjykatës aktivisht është e involvuar në hetimin e provave të rastit, në krahasim me sistemin-tipin tjetër ku roli i gjykatës është i një arbitri të paanshëm ndërmjet prokurorisë dhe të pandehurit-mbrojtjes së tij.⁴²

Karakteristikat e këtij sistemi gjithsesi shprehen edhe sa i përket deklaratës së të pandehurit sidomos në fazën e hetimit, ku hetimi është i udhëhequr nga gjyqtari hetues (inkuirenti) andaj dhe marrja e deklaratës së të pandehurit në këtë tip të procedurës penale është e drejtë e gjyqtarit hetues përkundër sistemit akuzator ku hetimi është e drejtë ekskluzive e Prokurorit.

E veçantë për këtë sistem-tip të procedurës penale, përpos përparësive të theksuar për të njëjtin, si dobësi e këtij sistemi është akumulimi i tri funksioneve të procedurës në duart e një subjekti procedural-inkuirentit dhe se pozita procedurale e të pandehurit në procedurë është shumë e pa volitshme.

Ku është me rëndësi të theksojmë se përkundër karakteristikave të veta negative që ka sistem-tip inkuizitor ka lënë pas veti disa të arritura me një vlerë të përhershme.

Sistemi-tipi i përzier (akuzator-inkuizitor)

Sistemi-tipi i përzier i procedurës penale ka formën e procedurës kontradiktore. I pandehuri prapë e fiton cilësinë e subjektit procedural me të drejta dhe obligime të caktuara.

⁴¹ E Drejta e Procedurës Penale, Mr. Ejup Sahiti, fq.16-1986

⁴² http://en.wikipedia.org/wiki/Inquisitorial_system/ shfrytëzuar me datë 26 korrik 2011

Funksionet themelore të procedurës janë të ndara dhe ushtrohen nga ana e subjekteve të posaçme. Ndjekja bëhet kryesisht nga ana e organit të veçantë, Prokurorit, por ekziston edhe mundësia që në disa raste të angazhohet edhe i dëmtuari si paditës subsidiar, respektivisht si paditës privat.⁴³

Gjykimi zhvillohet në dy faza në fazë të hetimit dhe atë të gjykimit faza e hetimit përfshinë elemente të procedurës penale akuzatore, ku hetimi ndërmerret nga prokurori.

Në fazën e gjykimit vijnë zakonisht elementet e procedurës akuzatore si: parimi i publicitetit, parimi i gojor, i drejtpërdrejtë, kontradiktor, parimi i pjesëmarrësve laik në procedurën gjyqësore dhe vlerësimi i provave nga ana e gjykatës.⁴⁴

Me tipin e përzier të procedurës penale është bërë përpjekje që të dy tendencat antagoniste-tendenca e efikasitetit të procedurës penale dhe tendenca e ruajtjes së lirive të qytetarëve sa më tepër të harmonizohen.⁴⁵

Sistemi-parimi akuzator, inkuizitor dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës

Në legjislacionin penal të Kosovës, nuk janë paraqitur elementet e tipit akuzator në procedurën penale gjer me rastin e hyrjes në fuqi të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, ndërsa nga data 6 prill 2004, respektivisht me rastin e hyrjes në fuqi të këtij kodi vihen në pah dhe elementet e sistemit-parimit akuzator.

Është me rëndësi të theksohet se Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, përcakton apo përmban në vete elemente të tipit inkuizitor dhe akuzator, po më qartë thënë përcakton tipin e përzier të procedurës penale.

Me rastin e vënies në pah të elementeve të sistemit-tipit akuzator bëhet një ndryshim radikal në procedurën penale, ku theks të veçantë i kushtohet ngritjes së rolit të prokurorit dhe mbrojtjes (avokatit) në procedurë, ku gjykata apo gjyqtari mbetet një arbitër i cili e kryen funksionin e gjykimit.

Prokurori dhe mbrojtja janë palë të barabarta në procedurë, procedura zhvillohet në sistemin e një kontesti, ku në barrë të prokurorit është mbrojtja

⁴³ E Drejta e Procedurës Penale, Mr. Ejup Sahiti, fq.19-1986

⁴⁴ <http://dituriere.albanianforum.net/t17-e-drejta-e-procedures-penale/> shfrytëzuar me datë 21 korrik 2011

⁴⁵ E Drejta e Procedurës Penale, Mr. Ejup Sahiti, fq.19-1986

e interesit të përgjithshëm (shtetëror) dhe provimi i fajësisë së të pandehurit, ndërsa në funksionin e mbrojtjes (avokatit) është konsolidimi i mbrojtjes së të pandehurit. Roli i gjykatës është, roli i një arbitër të vërtetë i cili kujdeset për sigurinë dhe garancitë procedurale dhe zhvillimin e një procesi ku do të respektohen liritë dhe të drejtat themelore të njeriut.

Në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, është e përcaktuar se prokurori, respektivisht Zyra e Prokurorisë është organ i pavarur përgjegjës për hetimin e veprave penale, ushtrimin e ndjekjes penale ndaj personave të akuzuar për kryerjen e veprave penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare apo me propozimin e të dëmtuarit, për mbikëqyrjen e punës së policisë gjyqësore gjatë hetimit të personave të dyshuar për kryerjen e veprave penale dhe për mbledhjen e të dhënave dhe informacioneve për fillimin e procedurës penale.⁴⁶ Gjithashtu me Kodin e Procedurës Penale është e përcaktuar se e drejtë dhe detyrë themelore e prokurorit është hetimi i veprave penale dhe ndjekja penale e kryerësve të tyre.⁴⁷

Marrë në konsideratë atë që u theksua më lartë se hetimi i veprave penale dhe kryerësve të tyre është kompetencë e prokurorit, andaj dhe intervistimi i të pandehurit bëhet nga prokurori apo policia si e autorizuar nga prokurori për ndërmarrjen e veprimeve të ndryshme hetimore, apo intervistimin e të pandehurit.

Pasi që në sistemin tonë të procedurës penale, vihen në pah elementet e sistemit inkuizitor-akuzator, e ku veçanërisht hetimi dhe barra e të provuarit bie mbi prokurorin, këto deklarata të dhëna nga i pandehuri para prokurorit apo policisë shërbejnë si prova në të cilat prokurori bazon akuzën e tij ndaj të pandehurit, e që do të jenë objekt shtjellimi në këtë temë-punim.

I pandehuri

Sa i përket deklaratës të pandehurit, rëndësi dhe shtjellim të veçantë duhet kushtuar nocionit të të pandehurit apo thjesht se çfarë nënkuptojmë dhe kush konsiderohet i pandehur.

Para se të kuptojmë në aspektin gjeneral se çfarë dhe kush konsiderohet i pandehur, nuk do të ishte e arsyeshme që të lëshohemi në shtjellimin e deklaratës së të pandehurit si provë në procedurë penale.

⁴⁶ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës Neni 46 paragrafi 1

⁴⁷ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës Neni 47

I pandehur është personi kundër të cilit zbatohet procedura penale. Shprehja i pandehur përdoret edhe si shprehje e përgjithshme për të dyshuarin, për të akuzuarin dhe për të dënuarin.⁴⁸

Meqenëse Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, me shprehjen i pandehur nënkupton të pandehurin, akuzuarin dhe dënuarin, në këtë punim shprehjen apo termin i pandehur do ta përdorim në kuptim të të pandehurit në fazën e hetimit, respektivisht deklaratën e tij të dhënë në fazën e hetimit. I pandehuri është subjekt procedural ndaj të cilit është drejtuar kërkesa procedurale. Ai është subjekt qendror në procedurën penale, sepse procedura fillohet dhe zhvillohet në rastin kur ekziston dyshimi i bazuar (i themeltë) se i pandehuri ka kryer veprë penale. Në raport me paditësin e autorizuar i pandehuri është palë barabartë në procedurë penale. Barabarësia e tij me paditësin e autorizuar shihet nga fakti se për të pandehurin ekziston prezumimi i pafajësisë, sipas të cilit askush nuk mund të konsiderohet fajtor, derisa kjo të mos provohet me aktgjykim të formës së prerë.⁴⁹

Andaj i pandehuri në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, konsiderohet si palë e barabartë procedurale me paditësin e autorizuar, ku përpos që i posedon një sërë të drejtash të cilat ia garanton ligji, ai mbanë dhe përgjegjësi që dalin nga KPPK-ja, si përgjigjja në mënyrë të rregullt ftesave-thirrjeve të organit procedural, ku njëri nga qëllimet procedurale të këtij organi është dhe marrja e deklaratës të të pandehurit, e cila do të jetë objekt shqyrtimi në këtë punim-temë.

Deklarata e të pandehurit në kuptimin e përgjithshëm

Si burim për ndriçimin e të dhënave të rëndësishme në procedurën penale, vend i rëndësishëm i takon edhe personit kundër të cilit zhvillohet procedura penale, respektivisht të pandehurit dhe deklaratës së tij.⁵⁰

Bazuar në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës, zyra e Prokurorisë është përgjegjës për hetimin e veprave penale,⁵¹ këtë hetim zyra e prokurorisë e kryen vetë apo nëpërmjet policisë gjyqësore, mirëpo gjithnjë nën mbikëqyrjen e prokurorisë. Kështu që dhe deklarata e të pandehurit gjatë

⁴⁸ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, neni 151

⁴⁹ E Drejta e Procedurës Penale, Mr. Ejup Sahiti, fq.91-1986

⁵⁰ E Drejta e Procedurës Penale, Mr. Ejup Sahiti, fq.142-1986

⁵¹ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, neni 46

fazës së hetimit merret nga prokurori apo policia nën autorizimin e prokurorit.

Siç është theksuar se i pandehuri si subjekt i procedurës penale sipas rregullit duhet të jetë prezent gjatë gjithë procedurës penale në mënyrë që ti mundësohet organeve procedurale që ta marrin në pyetje.

Marrja e të pandehurit në pyetje bëhet për shkak të rëndësisë që e ka deklarimi dhe eventualisht pohimi i tij, si provë për ndriçimin dhe zgjidhjen e çështjes penale. Është evidente se asnjë e drejtë, si në të kaluarën ashtu edhe sot për shkak të rëndësisë që ka deklarata e të pandehurit, nuk ka mundur krejtësisht të heqë dorë nga marrja në pyetje. Kjo për arsye se i pandehuri më së miri apo nga deklarata e tij më së miri mundë të njihet se kush është kryerës i veprës penale.⁵²

Gjithashtu organet procedurale, organet që zhvillojnë procedurën penale shpesh herë nuk disponojnë prova të mjaftueshme për hetimin e një vepre penale, ku deklarata e të pandehurit paraqet një provë të rëndësishme e sidomos kur i pandehuri pohon kryerjen e veprës penale.

Sa i përket pohimit mund të themi se me rastin e marrjes në pyetje gjatë zhvillimit të procedurës penale, respektivisht në fazën e hetimit, i pandehuri mundë ta pranoj se e ka kryer veprën penale për të cilën dyshohet ose mund ta pranoj si të vërtet doni fakt i cili i ngarkohet.

Pohimi i të pandehurit për një vepër penale apo ndonjë fakt i cili i vihet në barrë në një çështje penale mund të jetë i pranueshëm vetëm atëherë kur kjo vepër penale apo ky fakt pretendohet ndaj tij nga prokuroria si organ i ndjekjes penale.⁵³

Jo rrallëherë, e sidomos gjatë fazës së hetimit deklarata e të pandehurit paraqitet si provë e vetme në një çështje penale, si udhërrëfyes i vetëm hetimi apo i orientimit të hetimit në drejtimin e duhur.

Andaj, deklarata e të pandehurit paraqet një provë të rëndësishme në procedurën penale, respektivisht në ndriçimin e çështjes penale.

⁵² E Drejta e Procedurës Penale, Mr. Ejup Sahiti, fq.142-1986

⁵³ <http://www.lawiki.org/shfrytëzuar> me datë 20 korrik 2011.

Deklarata e të pandehurit e dhënë në polici dhe prokurori

Hetimi për një çështje penale, ngrihet kundër një personi të caktuar kur ekziston dyshimi i bazuar se ka kryer vepër penale. Në hetime bëhet mbledhja e provave të cilat janë të nevojshme për të vendosur se a do të ngrihet akti akuzues apo do të ndërpritet, respektivisht pushohet hetimi.⁵⁴

Gjatë hetimit, respektivisht marrjes së deklaratës së të pandehurit, ligjvënësi parasheh mundësinë që organet procedurale ta ftojnë të pandehurin, e në kushtet e posaçme, respektivisht kur i njëjti nuk i përgjigjet ftesës se organeve procedurale të shoqërohet për tu marrë në pyetje.

Marrë në konsideratë se zyra e prokurorisë është organi të cilit i takon e drejta ekskluzive e hetimit të veprave penale dhe kryerësve të veprave penale,⁵⁵ ku një sërë aktiviteteve hetimore i ndërmerr nëpërmjet policisë gjyqësore, andaj gjithashtu theks të veçantë përpos deklaratës së të pandehurit të dhënë para prokurorit duhet kushtuar dhe deklaratës së dhënë në polici.

I pandehuri merret në pyetje gojarisht, ku gjatë marrjes në pyetje të pandehurit mundë ti lejohet të mbajë shënime. Marrja në pyetje të pandehurit duhet ti ofroj mundësinë për ti kundërshtuar arsyet e dyshimit kundër tij dhe për të nxjerrë në pah faktet në favor të tij.⁵⁶

Me rastin e marrjes në pyetje, apo deklarimit të të pandehuri para Prokurorit apo në Polici, organi (Zyra e Prokurorisë apo Policia) i cili udhëheqë veprimet procedurale gjatë çdo marrje në pyetje duhet ta informoj të pandehurin për veprën penale për të cilën ai dyshohet, për të drejtën për të heshtur dhe mos u përgjigjur në asnjë pyetje përveç identitetit të tij, të drejtën për përkthim falas nëse nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën e personit i cili e drejton procedurën e marrjes në pyetje, të drejtën për ndihmë në mbrojtje dhe konsultim me të parë gjatë marrjes në pyetje, faktin se deklarimi i tij mundë të përdoret si provë para gjykatës dhe faktin se ai mund të kërkoj marrjen e provave për mbrojtjen e tij.⁵⁷

Kur i pandehuri është i shurdhë ose memec, pyetjet i bëhen nëpërmjet një përkthyesi të kualifikuar për gjuhën e shenjave ose me shkrim, nëse marrja

⁵⁴ Zakon o krivičnom postupku sa komentarom, objašnjenjima i uputstvima za praktičnu primenu, 1977, faqe 122

⁵⁵ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, neni 46

⁵⁶ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, neni 233 par 2 dhe 3

⁵⁷ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, neni 231

në pyetje nuk mundë të zbatohet në këtë mënyrë, personi i cili di të komunikoj me të pandehurin ftohet në rolin e përkthyesit, por jo kur ka konflikt interesash.⁵⁸

Pasi që ligjvënësi parasheh detyrimin e organeve procedurale që gjatë marrjes në pyetje të të pandehurit duhen ta informojnë të njëjtin se ka te drejt të mos deklarohet dhe mbrohet në heshtje.

Mirëpo duhet theksuar se pavarësisht nga ajo se a hesht apo deklaron i pandehuri, ligjvënësi rreptësisht e ndalon dhe e dënon nxjerrjen e deklaramit, përkatësisht të pohimit të të pandehurit me shtrëngim.⁵⁹

Gjithashtu dhe në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut respektivisht në nenin 3, është ndaluar tortura, respektivisht askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, as dënimeve, trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese.⁶⁰ Ku qartë nga ky nen mundë të vijmë në përfundim se sado i madh të jetë interesi i zbulimit apo hetimit të një veprë penale apo kryerësit të saj nuk lejohet nga organet hetuese të përdorin metoda dhe forma të ndryshme të torturës, trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese gjatë marrjes në pyetje.

Këtu pikë së pari mendohet në zbatimin e metodave si ato kirurgjikale, përdorimin e mjeteve të ndryshme të cilat kanë ndikim në jetën shpirtërore apo emocionale të të pandehurit dhe e sjellin të njëjtin në deklaramin e asaj apo dhënien e deklaratës e cila është jashtë vullnetit të të pandehurit.

Në rast të shkeljes së dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, respektivisht dispozitave të cilat e rregullojnë çështjen e marrjes në pyetje-deklaratës të të pandehurit parashihen pasoja radikale, e sidomos me rastin e përdorimit të narkotikëve, materialeve të tjera subtropike, metodave çnjerëzore, të dhunshme, hipnozave etj.

Po që se është bërë një shkelje e këtillë, si është theksuar më lartë gjatë fazës së hetimit, qoftë nga prokurori apo policia, gjykata me propozimin e palëve bjer aktvendim me të cilin, deklaratën e të pandehurit e shpall si provë të kundërligjshme, respektivisht si deklaratë të nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e KPK-së, kështu që e njëjta veçohet nga shkresat e lëndës

⁵⁸ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, neni 232

⁵⁹ E Drejta e Procedurës Penale, Mr. Ejup Sahiti, fq.142-1986

⁶⁰ Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, neni 3, faqe 7

mbyllet në zarf dhe nuk mundë të shërbej si provë në procedurë, deklarimet e këtilla të të pandehurit janë të papranueshme.⁶¹

Me rastin e marrjes në pyetje të pandehurit duhet ti bëhen pyetje në mënyrë të qartë, të kuptueshme dhe me përpikëri, kështu që ti kuptoj plotësisht. Me këtë rast nuk duhet ti bëhen pyetje kapcioze apo sugjестive. Pyetjet kapcioze nënkupton formulimin e pyetjes asisoj që me rastin e hartimit të saj pyetësi niset nga supozimet se i pandehuri ka pohuar diçka që në realitet nuk e ka pohuar. Pyetja sugjестive është ajo pyetje e cila në vete përmban atë përgjigje si duhet përgjigjur. Në qoftë se thëniet e mëvonshme të pandehurit ndryshojnë nga ato të mëparshmet, e sidomos kur i pandehuri e revokon pohimin e vet, thirret ti paraqesë shkaqet pse e ka ndërruar deklaratën, respektivisht pse ka revokuar pohimin.⁶²

Marrë në konsideratë rëndësinë e deklaratës së të pandehurit si provë në ndriçimin e një çështjeje penale dhe angazhimin global në respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, dinjitetit të njeriut, ndalimin e çdo torture apo poshtërimi, prapë se prapë asgjë nuk e arsyeton dhunën dhe metodat e papranueshme të marrjes në pyetje të të pandehurit edhe përkundër rëndësisë së deklaratës të pandehurit në një çështje penale.

Procesverbali i marrjes në pyetje – deklarimit të pandehurit

Dokumentimi i veprimeve procedurale bëhet në procesverbal, procesverbali përpilohet nga Sekretari Administrativ i Prokurorisë, në formë të plotë apo të përmbledhur, me stenotipi, me mjete tjera teknike dhe kur mungojnë këto mjete teknike me dorëshkrim, apo nga zyrtari policor i cili zbaton veprimet procedurale të marrjes në pyetje të të pandehurit kur i pandehuri intervistohet nga policia.⁶³

Gjatë marrjes në pyetje dhe përpilimit të procesverbalit të marrjes në pyetje nga cildo organ procedural i përmendur më lartë, duhet shkruar: organin procedural para të cilit bëhet marrja në pyetje, respektivisht marrja e deklaratës të të pandehurit, vendin dhe kohën e fillimit dhe mbarimit të marrjes në pyetje, identitetin e personit zyrtar para të cilit jepet apo merret në pyetje i pandehuri, shënimet personale të pandehurit duke përfshirë emrin, mbiemrin, emrin dhe mbiemrin e prindërve, datën e lindjes, gjendjen familjare dhe ekonomike të tij, kohën e arrestimit nëse i njëjti është i

⁶¹ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, neni 235, faqe 100

⁶² E Drejta e Procedurës Penale, Mr. Ejup Sahiti, fq.144-1986

⁶³ Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, neni 115, faqe 64

arrestuar, emrin e mbrojtësit të tij, nëse i njëjti mungon konstatimin e këtij fakti.⁶⁴

Në procesverbal konstatohet çdo veprim procedural i ndërmarrë gjatë intervistimi të pandehurit, respektivisht mbretëron praktika marrjes në pyetje e të pandehurit duke i parashtruar pyetje lidhur me çështjen penale për të cilën dyshohet, ku përgjigjet e tij konstatohen në procesverbal në mënyrë të thuktë dhe të kuptueshme mirëpo gjithsesi duke e ruajtur përmbajtjen e përgjigjeve të dhëna nga i pandehuri.

Gjithashtu në procesverbal konstatohen dhe udhëzimet e dhëna të pandehurit në harmoni me nenin 231 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Kur i pandehuri nuk e kupton gjuhën e zyrtarit para të cilit jepet deklarata dhe angazhohet përkthim në gjuhën e të pandehurit apo gjuhën të cilën ai e kupton, përkthimi duhet të jetë profesional dhe duhet ta pasqyroj deklarimin e të pandehurit duke mos i ndërruar kuptimin e përgjigjeve të tij apo shtrembërimin e të njëjtave.

Procesverbali i hartuar gjatë marrjes në pyetje të të pandehurit, nënshkruhet nga personi zyrtar përgjegjës i cili ka zbatuar procedurën e marrjes në pyetje dhe i pandehuri, e gjithashtu dhe nga personat tjerë pjesëmarrës gjatë marrjes në pyetje. Nëse i pandehuri refuzon ta nënshkruaj procesverbalin, i njëjti fakt duhet të konstatohet në procesverbal me një shpjegim të të pandehurit se përse nuk dëshiron ta nënshkruaj.

Procesverbali i vihet në dispozicion të të pandehurit dhe mbrojtësit të tij me kërkesën e tyre në një gjuhë të kuptueshme për të pandehurin.⁶⁵

Procesverbalet e përpiluara në polici ruhen dhjetë vjet nga koha e përfundimit zyrtar të procedurës penale ose nga largimi i personit të ndaluar, nëse lirimi ka ndodhur më vonë se përfundimi i procedurës.⁶⁶

Në rastet kur ka dyshime rreth personave të cilët kanë marrë pjesë gjatë marrjes në pyetje ose kur mungon nënshkrimi i nëpunësit që e ka përpiluar, procesverbali është i pavlefshëm.

⁶⁴ Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, neni 115, faqe 64 dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, neni 219 par 2, faqe 92

⁶⁵ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, neni 219 par 4, faqe 91

⁶⁶ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, neni 219 par 5, faqe 91

Deklarata e të pandehurit dhënë në polici dhe prokurori, pranueshmëria e saj si provë në procedurë penale

Nga e gjithë ajo që u tha deri më tani lidhur me deklaratën e të pandehurit, mund të vijmë në përfundim se e njëjta paraqet një provë shumë të rëndësishme në një çështje penale, e sidomos kur ekziston pohimi i të pandehurit lidhur me veprën penale e cila i ngarkohet apo ndonjë fakt në çështjen penale.

Mirëpo rëndësi të theksuar duhet kushtuar pranueshmërisë dhe papranueshmërisë së deklaratës së të pandehurit në cilësinë e provës në një çështje penale.

Me rastin e intervistimit, marrjes në pyetje të pandehurit rëndësi të veçantë duhet kushtuar të drejtave të pandehurit të përcaktuara me nenin 231 të KPPK-së, ose në të kundërtën një deklaram i tillë nuk mund të shërben si provë në procedurë penale.

Historikisht është e njohur se për marrjen e deklaratës së të pandehurit, e sidomos për pohimin e tij për një vepër penale e cila i vihet në barrë, në kohërat e më hershme janë përdorur metoda dhe forma të ndryshme të shtrengimit dhe trajtimeve çnjerëzore, ku këto deklarata nuk kanë pasqyruar vullnetin e lirë deklarues të të pandehurit.

Edhe pse më rastet më të shpeshta i përkasin kohërave të hershme të historisë së njerëzimit, e me theks të veçantë pushteteve diktatoriale të ndryshme, ku respektimi i lirive dhe të drejtave të njeriut nuk ka qenë aktual, por prapëseprapë edhe në kohërat tona moderne nuk mund të përjashtohet mundësia e përdorimit të formave dhe metodave çnjerëzore, e të dhunshme për marrjen-nxjerrjen e deklaratës së të pandehurit.

Ku me përdorimin e formave dhe metodave çnjerëzore dhe të dhunshme, e duke mos përjashtuar edhe disa shtete për të cilat ekziston përshtypja se janë prijës së demokracisë botërore, është krijuar opinioni se janë shtete arbitrare të cilat nuk i respektojnë vlerat njerëzore.

Deklarata e të pandehurit nga organet gjegjëse procedurale hetimore, respektivisht nga prokurori apo policia duhet marruar në harmoni me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, respektivisht me dispozitat e neneve: 219 dhe 229 deri në nenin 236.

Dispozitat e nenit 155, 234 dhe 235 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, në mënyrë taksative ndalojnë përdorimin e metodave dhe formave të dhunshme dhe çnjerëzore për të ndikuar, respektivisht kufizuar lirinë e të pandehurit në formulimin dhe shprehjen e mendimit të lirë të tij.

Si forma, metoda më të shpeshta të dhunshme, çnjerëzore dhe të kundërligjshme janë si ato kirurgjikale, kanosja, premtimi i ndonjë përfitimi të paparaparë me ligj, dobësimi i kujtesës, përdorimin e mjeteve dhe materialeve të ndryshme të cilat kanë ndikim në jetën shpirtërore apo emocionale të të pandehurit dhe e sjellin të njëjtin në deklarimin e asaj apo dhënien e deklaratës e cila është jashtë vullnetit të tij.

Gjithashtu dhe në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut respektivisht në nenin 3, është ndaluar tortura, respektivisht askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës, as dënimeve, trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese,⁶⁷ ku qartë nga ky nen mund të vijmë në përfundim se sado i madh të jetë interesi i zbulimit apo hetimit të një vepre penale apo kryerësit të saj nuk lejohet nga organet hetuese të përdorin metoda dhe forma të ndryshme të torturës, trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese gjatë marrjes në pyetje.

Përdorimi i metodave, formave të dhunshme dhe çnjerëzore gjatë marrjes së deklaratës së të pandehurit, e në rast të shkeljes së dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, respektivisht dispozitave të cilat e rregullojnë çështjen e marrjes në pyetje-deklaratës të pandehurit parashihen pasoja radikale, e gjer tek veçimi dhe përjashtimi i deklaratës së të pandehurit si provë.

Po që se është bërë një shkelje e këtillë, si është theksuar më lartë gjatë fazës së hetimit, qoftë nga prokurori apo policia, gjykata me propozimin e palëve bie aktvendim me të cilin, deklaratën e të pandehurit e shpallë si provë të kundërligjshme, respektivisht si deklaratë të nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e KPK-së, kështu që e njëjta veçohet nga shkresat e lëndës mbyllet në zarf dhe nuk mundë të shërbej si provë në procedurë, deklarinimet e këtilla të të pandehurit janë të papranueshme.⁷⁷

Gjithashtu dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, theks të veçantë i kushton shkelje se nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nga organet gjegjëse hetimore.

⁶⁷ Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, neni 3, faqe 7

Gjykata më tej parasheh dhe dëmshpërblime për ankuesit për shkak të shkeljes së dispozitave të nenit 3 të konventës, ku të gjitha provat e nxjerra në kundërshtim me këtë nen janë të pa pranueshme në një proces gjyqësor.⁶⁸

Marrja e provës nuk është një kërkesë abstrakte apo formale, por konsiderohet se ajo është e rëndësisë primare për drejtësinë e një gjykim penal.⁶⁹

Andaj dhe një herë theksojmë, se marrë në konsideratë rëndësinë e deklaratës së të pandehurit si provë në ndriçimin e një çështjeje penale e në anën tjetër marrë në konsideratë dhe angazhimin global në respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe ndalimin e çdo torture apo poshtërimit, prapë se prapë asgjë nuk e arsyeton dhunën dhe metodat e papranueshme të marrjes në pyetje të të pandehurit edhe përkundër rëndësisë së deklaratës të pandehurit në një çështje penale.

Përfundimi

Në fjalën përmbyllëse të këtij punimi, ne si kandidat theksojmë se jemi munduar që sado pak ta shtjellojmë deklaratën e të pandehurit, e sidomos deklaratën e të pandehurit dhënë në Polici dhe Prokurori, respektivisht para organeve të cilat zhvillojnë procedurën hetimore penale dhe rëndësinë e saj si provë.

Pasi që deklarata e të pandehurit zë një vend të posaçëm në ndriçimin e një çështjeje penale, respektivisht në një hetim penal, andaj dhe përcaktimi për këtë temë është bërë si konsekuence e rëndësisë së saj.

Shtjellimi është orientuar në raportin i deklaratës së të pandehurit me sistemin-tipin akuzator, inkuizitor dhe tipin e përzier akuzatoro-inkuizitor, e theks të veçantë i është kushtuar deklaratës si provë në një çështje penale, marrjes së deklaratës nga policia, prokuroria dhe pranueshmërisë e papranueshmërisë së saj si provë.

Gjithashtu në këtë punim-temë nuk është lënë pa hedhur një shkëndijë, të paktën sipërfaqësisht në format dhe metodat e ndaluara, kundërligjshme,

⁶⁸ Nezakoniti Dokazi u Kaznenon Postupku Prem Praksi Evropskog Suda za Ljudska Prava, Prof.dr.sc.Davor Krapac, Faqe 1219, fusnota 29

⁶⁹ Nezakoniti Dokazi u Kaznenon Postupku Prem Praksi Evropskog Suda za Ljudska Prava, Prof.dr.sc.Davor Krapac, Faqe 1226, e cituar nga *Schenk c/a Švicarske* (1988)

çnjërëzore të marrjes së deklaratës së të pandehurit dhe papranueshmërisë së tyre si prova në një çështje penale.

Andaj shpresojmë se me këtë punim kemi arritur sado pak të mbërthejmë informatat dhe çështjet themelore sa i përket deklaratës së të pandehurit si provë, ku ndoshta i njëjti punim do ti shërbej lexuesit si burim për marrjen e informatave themelore.




Avni Mehmeti



Burim Ademi



Besnik Feka



Faton Ademi

NGJASHMËRITË DHE DALLIMET MES KONTRATËS MBI DHURATËN DHE KONTRATËS MBI CEDIMIN

Nocioni dhe rëndësia e kontratës

Nocioni “Kontratë” njihet që nga e drejta romake me termin “contractus”, që do të thotë kontratë apo marrëveshje mes palëve.

Kontrata është marrëveshje mes dy apo më tepër palëve, me të cilën krijohet, ndryshohet dhe shuhet një e drejtë apo detyrim i caktuar.

Kontrata konsiderohet njëra ndër punët më të shpeshta dhe më të rëndësishme juridike, përmes së cilës bëhet qarkullimi juridik i të drejtave dhe detyrimeve mes palëve. Në doktrinën juridike të të drejtave nacionale përdoren edhe shprehje tjera rreth kuptimit të vet kontratës. Pra përdoret emërtimi siç është “fakti juridik”, “marrëdhënie juridike” dhe “dokument juridik”. Kontrata është fakt juridik, sepse shpreh aftësinë e palëve që sipas vullnetit të caktojë përmbajtjen dhe sjelljen e tyre. Pra kontrata parimisht është akt autonom për krijimin e të drejtave dhe detyrave midis palëve. Është akt konstituiv sepse krijon një situatë të re midis tyre. Kontrata është “marrëdhënie juridike” sepse është një marrëdhënie e caktuar dhe e rregulluar në bazë të rregullave juridike. Kontrata është “dokumente juridik”, sepse me të është shprehur vullneti i palëve për krijimin e efektit të caktuar juridik. Si në rastin kur ky vullnet është i shprehur me shkrim, ashtu edhe në rastin kur lidhet gojarisht, ajo shërben si dokument dhe është institut i së drejtës së detyrimeve dhe vepër e palëve.⁷⁰

⁷⁰ Prof.Dr. Alajdin S.Alishani, Vep. e Drejta e Detyrimeve pjesa e Përgjithshme, Prishtinë 2002, fq.177.

Kontrata është një veprim i dyanshëm juridik, me të cilin arrihet ndonjë efekt juridik detyrimor.⁷¹

Sipas juristit të njohur francez Joseph Potheir, kontrata definohet si një marrëveshje midis dy apo më tepër personave, ku njëri i obligohet tjetrit të bëjë, të japi, të mos bëjë diçka – a donner afaire ou a ne pas faire quelque chose.⁷²

Kushtet e përgjithshme për lidhjen e kontratës

- Aftësia punuese e palëve
- Shprehja e vullnetit
- Lënda e kontratës dhe
- Baza e kontratës

Aftësia punuese e palëve - është kusht i përgjithshëm për lidhjen e kontratës. Kjo aftësi punuese nënkupton arritjen e moshës madhore për personat fizik, si dhe për personat juridik me konstituimin e tyre.

Këtë kusht palët duhet ta plotësojnë në momentin e lidhjes së kontratës në mënyrë që kontrata të jetë e vlefshme juridikisht. Sipas të drejtës së detyrimeve aftësia punuese e palëve ka përjashtime të veçanta. Parimisht personat fizik nuk mund të lidhin kontratë nëse nuk posedojnë moshën mbi 14 vjet, ndërsa nga mosha 14 deri në 18 vjet personat fizik posedojnë aftësi të kufizuar punuese që nënkupton se mund të lidhin disa punë juridike.

Ashtu siç u përcaktua më lartë personat nga mosha 14 vjeçare deri në 18, kanë aftësi të kufizuar punuese, dhe mund të lidhin punë të caktuara juridike të cilat punë i përcakton ligjdhënësi në mënyrë shprehimore dhe të cilat duhet të kenë lejen nga organi i posaçëm apo nga përfaqësuesi ligjor i këtyre personave.

Përjashtimisht kur personi nën moshën 14 vjeçare lidh kontratë, ajo kontratë mund të prodhojë efekte dhe të jetë e vlefshme juridikisht vetëm me kushte që ajo kontratë është në dobi të palës nën moshën 14 vjeçare.

⁷¹ Doracaku për përgatitjen e provimit të jurisprudencës, Botimi i dytë – shtesë Prishtinë 2006, Rifat Zylfiu, fq.423.

⁷² E adaptuar nga interneti - Google – Traite Des Obligations de Pothier

Personat juridik e fitojnë aftësinë e veprimit që nga momenti i regjistrimit pranë organit kompetent shtetërorë. Aftësia punuese e personave juridik kufizohet vetëm për sa i përket fushë veprimtarisë së tyre që e ushtrojnë, lidhja e kontratës jashtë aftësisë punuese nga ana personave juridik shkakton pavlefshmërinë relative të kontratës dhe si e tillë nuk prodhon efekte juridike, por se mund të konvalidohet nga palët kontraktuese.

Përveç kushtit paraprak tek personat juridik duhet të plotësohen edhe dy kushte tjera në mënyrë që punët juridike të prodhojnë efekte: personi fizik që vepron në emër të personit juridik duhet të ketë aftësi të plotë punuese dhe autorizime për lidhjen e kontratës që burojnë nga ligji, statuti dhe aktet e brendshme.

Shprehja e vullnetit - nënkupton pajtimin e vullnetit të palëve për lidhjen e kontratës.

Duke qenë se ky pajtim i vullnetit është një dukuri psikologjike, atëherë kontratës i paraprinë vendosja e palëve dhe vetëdija e tyre për lidhjen e saj. Vetëdija e palëve është aftësia fizike dhe mentale e tyre që me fuqinë e mendimit të tyre të krijojnë efektet e caktuara juridike midis tyre⁷³

Pajtimi i vullnetit duhet të jetë i dyanshëm, serioz dhe i shprehur në mënyrë të qartë.

Sipas LMD-së neni 26 shprehimisht ceket se kontrata është e lidhur kur palët janë marrë vesh për elementet esenciale të saj, që nënkupton se pajtimi i vullnetit duhet të jetë lidhur me elementet esenciale të kontratës.

Vullneti i palëve mund të shprehet në mënyra të ndryshme si: me fjalë, me shenja të rëndomta, me veprime konkludente, apo në mënyrë të heshtur me veprim aktiv ose me veprim pasiv.

Për sa i përket vullnetit të personave juridik, ky vullnet shfaqet çdo herë nëpërmjet vullnetit të organit të tij.

Lënda e kontratës – si një ndër kushtet e përgjithshme për lidhjen e kontratës nënkupton objektin për të cilin palët janë marrë vesh apo për çka është lidhur kontrata, dhe se pa ekzistimin e këtij kushti nuk mund të flitet se kontrata është e lidhur.

⁷³ Pr.Dr. Alajdin S. Alishani vep. e cituar më lartë faqe 195

Sipas doktrinës fanceze lënda e kontratës mund të jetë: *bërje (dare)*, *veprim (facere)*, *mosveprim (non facere)*, *pësim (pati)*. Lëndë e kontratës mund të jenë: sendet dhe te drejtat. Si sende mund të jenë: sendi i luajtshëm, i paluajtshëm dhe send i konsumueshëm, ndërsa si të drejta paraqiten: te drejtat reale (e drejta e pronësisë, hipotekës etj), si dhe të drejtat e detyrimeve (si e drejta e autorit, e pikjes, e drejta e mbajtjes etj).

Për të prodhuar efekte juridike lënda e kontratës duhet ti ketë disa veti të caktuara:

Duhet të jetë e mundshme, që nënkupton se lënda e kontratës mund të realizohet dhe përmbushet ndërmjet palëve kontraktuese;

Te jetë e caktuar, që nënkupton se lënda e kontratës është e caktuar, duke e ditur palët kontraktuese vlerën e saj në momentin e lidhjes së kontratës;
Të jetë e lejueshme, që nënkupton se lënda e kontratës nuk cenon dispozitat imperative të legjislacionit në fuqi si dhe normat morale të shoqërisë.

Baza e kontratës – Baza e kontratës është kusht i përgjithshëm që duhet të ekzistojë në momentin e lidhjes së çdo kontrate. Baza e kontratës është qëllimi apo arsyeja e drejtpërdrejt juridike që i shtyn palët të hyjnë në marrëdhënie kontraktuese. Në lidhje me nocionin e bazës së kontratës në aspektin e teorisë së të drejtës civile dhe asaj të detyrimeve, ekzistojnë disa pikëpamje-teori, që dallojnë në aspektin e shpjegimit të këtij nocioni. Ndër teoritë që njihen janë teoria kauzaliste, teoria antikauzaliste, objektive dhe e përzier.

Sipas teorisë kauzaliste bazë e kontratës është qëllimi që e ka shtyrë palën kontraktuese për të marrë detyrimin.

Sipas teorisë antikauzaliste bazë e kontratës është e panevojshme, sepse ajo që shpjegohet me anë të bazës, mund të shpjegohet me anë të lëndës së kontratës.

Sipas teorisë objektive baza paraqet barasvlerën ekonomike që e siguron ekzistimin e proporcionit material ndërmjet palëve kontraktuese.

Sipas teorisë së përzier subjektive-objektive, duhet filluar prej qëllimit të obligimit që është një kategori subjektive.⁷⁴

Ashtu siç u tha edhe më lartë, në të gjitha rastet duhet të ekzistoj baza e kontratës, dhe në rast se ajo mungon, është fiktive apo është e ndaluar, në këto raste kontrata do të konsiderohet absolutisht e pavlefshme (neni 52 i LMD-së).

Kontrata mbi dhuratën dhe kushtet për lidhjen e saj

Kontrata mbi dhuratën është marrëveshje mes dy apo më tepër palëve, ku në njërin anë paraqitet dhuratëdhënësi, dhe në anën tjetër dhuratëmarrësi.

Nga nocioni i kësaj kontrate rrjedhë se kjo kontratë ka disa karakteristika si vijon: është kontratë formale, pa shpërblim, e njëanshme, me anë të së cilës krijohet baza juridike për kalimin gjegjësisht bartjen e të drejtës së pronësisë për sendin e dhuruar nga dhuratëdhënësi tek dhuratëmarrësi.

Forma si kusht i veçantë për vlefshmërinë e kësaj kontrate - konsiderohet se është kontratë formale, për arsye së LMD, përcakton qartë se për të qenë e vlefshme kjo kontratë si dhe për të prodhuar efekte juridike, me rastin e lidhjes së kësaj kontrate përveç se duhet të protestohen kushtet e përgjithshme duhet të ekzistoj edhe forma e saj, që nënkupton lidhjen e saj në formë të shkruar, ndërmjet palëve kontraktuese.

Karakteristikë tjetër e kësaj kontrate është se kjo kontratë është pa shpërblim – e që nënkupton bartjen e pronësisë mbi ndonjë send apo të drejtë tjetër pasurore, nga dhuratëdhënësi tek dhuratëmarrësi pa shpërblim.

Karakteristik tjetër e kontratës mbi dhuratën është se kjo kontrate nga aspekti teorik konsiderohet e njëanshme – kjo pasi që njëanshmëria e kësaj kontrate shprehet vetëm për sa i përket prestimit apo detyrimit, e që nënkupton se vetëm dhuratëdhënësi merr detyrime në lidhje me ketë kontratë, ndërsa nga aspekti ligjor kjo kontratë është e dyanshme pasi që me rastin e lidhjes së kësaj kontrate për të prodhuar efekte juridike dhe për të qenë e vlefshme duhet të plotësohen si kushtet e përgjithshme ashtu edhe kushtet e veçanta nga të dy palët kontraktuese.

⁷⁴ Dr. Nerxhivane Dauti Vepra e cit: fq.59, viti 1998, Prishtinë

Si karakteristikë tjetër e kësaj kontrate është se, për sa i përket kushtit të përgjithshëm të çdo kontrate e që është aftësia punuese e palëve, te kontrata mbi dhuratën ky kusht ka disa specifika, nga se dhuratëmarrësi , mundë të lidhë kontratën mbi dhuratën që kur ka arritur moshën 7 vjeçare, por që nevojitet pëlqimi i përfaqësuesit ligjor apo i organit të posaçëm, kjo pasi që për persona fizik konsiderohen se nga ajo moshë mund të shprehin vullnetin e tyre te qartë, ndërsa nën moshën 7 vjeçare dhuratëmarrësi nuk mundë fare të jetë palë kontraktuese në këtë kontratë edhe sikur të ekzistoj pëlqimi i përfaqësuesit ligjor apo organit të posaçëm. Po ashtu si specifike tjetër është se dhuratëdhënësi mund të jetë palë kontraktuese në këtë kontratë, që nga momenti i arritjes së moshës 15 vjeçare, me kusht që të ekzistoj pëlqimi i përfaqësuesit ligjor apo organit te posaçëm.

Të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese në Kontratën mbi Dhuratën

Detyrat e Dhuratëdhënësit

Si detyra të dhuratëdhënësit janë: dorëzimi i sendit ose bartjes së të drejtës dhuratëmarrësit dhe detyra e shpërblimit të dëmit.

Dorëzimi i sendit-nënkupton se dhuratëdhënësi është i obliguar që t'ia dorëzoj sendin dhuratëmarrësit në momentin e lidhjes së kontratës sipas kushteve që përcakton kontrata mbi dhuratën dhe në vendin për të cilin palët janë marrë vesh.

Kjo nënkupton se dhuratëdhënësi ka për obligim që sendin e dhuruar t'ia dorëzoj pa të meta fizike dhe juridike, për të cilat ai ka qenë në dijeni.

Shpërblimi i dëmit- nënkupton se dhuratëdhënësi ka për detyrim që ta shpërblej dhuratëmarrësin për dëmin e pësuar nga sendi që është objekt i kësaj kontrate kur ai send ka qenë me të meta fizike dhe juridike dhe dhuratëdhënësi ka qenë në dijeni për to. Detyra për shpërblimin e dëmit vjen në shprehje kur kërkohet nga ana e dhuratëmarrësit, edhe përkundër faktit se kjo kontratë është kontratë mirëbërëse.

Detyrat e Dhuratëmarrësit

Si detyra të dhuratëmarrësit janë: pranimi i sendit, përmbajtja nga shkaktimi i dëmit dhuratëdhënësit dhe mirënjohja ndaj dhuratëdhënësit.

Të drejtat e Dhuratëmarrësit

Të drejta të dhuratëmarrësit janë: që të kërkoj dorëzimin e sendit nga dhuratëdhënësi, të kërkoj shpërblimin e dëmit në rast të shkakimit të tij.

Llojet e Kontratave mbi Dhuratën

Ekzistojnë disa lloje të kontratave mbi dhuratën: kontrata e përzier mbi dhuratën, kontrata mbi dhuratën pas vdekjes dhe kontrata mbi dhuratën me urdhër.

Mënyrat e Shuarjes së Kontratës mbi Dhuratën

Sikurse çdo kontratë tjetër edhe kontrata mbi dhuratën mund të shuhet në disa mënyra:

- **Me përmbushjen e kontratës** - që nënkupton se dhuratëdhënësi e ka përmbush detyrimin tij ndaj dhuratëmarrësit duke ia dorëzuar sendin apo duke ia bartur të drejtën;
- **Me mos-ekzekutimin e kontratës**- që nënkupton se dhuratëdhënësi nuk mund ta përmbush detyrimin ndaj dhuratëmarrësit për shkaqe objektive si shkatërrimi i sendit nga fuqia madhore - VIS MAJOR;
- **Me anulim**- rasti kur kontrata anulohet si rezultat e mosplotësimit të kushteve të përgjithshme apo të veçanta për lidhjen e kontratës mbi dhuratën;
- **Me revokim**- apo siç njihet ndryshe si tërheqje nga kontrata e dhuratës.

Për sa i përket revokimit teoria trajton disa shkaqe të revokimit të kontratës mbi dhuratën: revokimi i dhuratës për shkak të mosmirënjohjes nga ana e dhuratëmarrësit, revokimi i dhuratës për shkak të varfërimit të dhuratëdhënësit, revokimi i dhuratës për shkak të anulimit të kurorës dhe shkukurorëzimit me dhuratëmarrësin, revokimi për shkak të cenimit të drejtave të personave të tretë, revokimi për shkak të cenimit të pjesës së domosdoshme të trashëgimtarëve, për shkak të cenimit të detyrës së mbajtjes.

Kontrata mbi cedimin (bartjen dhe pjesëtimin e pasurisë për së gjalli)

Me Ligjin për Trashëgimin e Kosovës në nenin 58 përcaktohet se: “paraardhësi me anë të veprimit juridik për së gjalli mund t’ua cedoj dhe t’ua pjesëtojë pasurinë e vet pasardhësve të tij“

Nga kjo rezulton se për të ekzistuar kjo kontratë duhet të ekzistoj pajtimi i paraardhësit dhe pasardhësve si dhe të bëhet bartja e pasurisë dhe ndarja e asaj pasurie për të gjitha palët në atë kontratë e që kjo duhet të bëhet për së gjallë të tyre.

Si karakteristikë e veçantë e kësaj kontrate është se kjo kontratë mund të lidhet vetëm ndërmjet paraardhësit dhe pasardhësve të tij, të cilët sipas ligjit mbi trashëgimin kanë të drejt në trashëgimin e asaj pasurie.

Kushtet për vlefshmërinë e kësaj kontrate

Kushtet për vlefshmërinë e kësaj kontrate janë: pajtimi i të gjithë pasardhësve në kohën e arritjes së marrëveshjes, forma e kontratës që nënkupton se duhet të jetë në formë të shkruar dhe si nën kusht i kësaj thelbësor për të prodhuar efekte juridike është se kjo kontratë duhet të vërtetohet nga ana e gjyqtarit, para se të vërtetohet një kontratë e tillë në gjykatë, gjyqtari ka për obligim që t’i njoftojë palët kontraktuese për pasojat e lidhjes së kësaj kontrate e sidomos fakti se për të prodhuar efekt kjo kontratë duhet të pajtohen që të gjithë pasardhësit, se në çastin e vdekjes së ceduesit pasuria e tij do të përbëhet vetëm nga pasuria e përfshirë në kontratë. Kusht tjetër për të qenë e vlefshme kontrata mi cedimin dhe pjesëtimin e pasurisë për së gjalli, është edhe fakti se cedimi dhe pajtimi është i vlefshëm edhe kur pasardhësi që nuk ka dhënë pëlqimin sepse ka vdekur para ceduesit pa lënë pasardhës, ose pasardhësi ka heqë dorë nga trashëgimia, ose pasardhësi është bërë i padenjë.

Në qoftë se ndonjë pasardhës nuk ka dhënë pëlqimin atij nuk i humbet e drejta për ta dhënë këtë pëlqim edhe më vonë në të njëjtën formë siç e kanë dhënë pasardhësit tjerë.

Objekti i cedimit dhe pjesëtimin

Objekt i cedimit është vetëm pasuria për të cilën paraardhësi dhe pasardhësit janë marrë vesh në kohën e lidhjes së kësaj kontrate apo për një pjesë të asaj pasurie që disponon paraardhësi me të.

Dispozitat me të cilat parashikohet pjesëtimi i pasurisë të fituar nga ceduesi pas arritjes së marrëveshjes konsiderohen nule.

Pasuria që përjashtohet nga masa trashëgimore

Pasuria që është objekt i kontratës mbi cedimin dhe pjesëtimin mes palëve kontraktuese nuk hyn në masën trashëgimore, ndërsa pasuria që nuk ka qenë objekt i kontratës mbi cedimin dhe pjesëtimin, si dhe pasuria e krijuar pas lidhjes së kësaj kontrate nga paraardhësi hyn në masën trashëgimore dhe pas vdekjes së paraardhësit do të nënshtrohet shqyrtimit në përputhje me dispozitat e LTK-së (Ligjit për Trashëgiminë i Kosovës). Ndërsa pasuria që ka qenë pjesë e kontratës mbi cedimin dhe pjesëtimin nuk përbën pasurinë trashëgimore dhe as nuk mund të merret parasysh me rastin e përcaktimit të vlerës së pasurisë trashëgimore.

Kur konsiderohen pjesët e ceduara si dhurime?

Neni 62 i LTK-së përcakton se në disa raste pasuria e ceduar mund të konsiderohet si dhuratë, ndërmjet paraardhësit dhe pasardhësve të tij.

Pasardhësi i cili në momentin e lidhjes së kontratës mbi cedimin dhe pjesëtimin e pasurisë nuk e jep pëlqimin për atë pjesë të cedimit, pjesa e pasurisë që është përfituar nga pasardhësit e tjerë e të cilët kanë dhënë pëlqimin për cedimin e asaj pasurie do të konsiderohen si dhurime të bëra nga paraardhësi tek pasardhësit e tjerë.

Për t'u konsideruar kjo pasuri si dhurim medoemos duhet të plotësohen dy kushte:

- a) që njëri apo më tepër pasardhës të mos të ketë dhënë pëlqimin për kontratën e cedimit ndërsa të tjerët pasardhës ta kenë dhënë atë dhe,
- b) që paraardhësi të ketë vdekur dhe të kaloj pasuria e tij në shqyrtim trashëgimor.

Rast tjetër për tu konsideruar pasuria e ceduar dhe pjesëtuar si dhurim është edhe rasti kur ceduesit pas cedimit dhe pjesëtimin të bërë me marrëveshje me të gjithë trashëgimtarët, i lind fëmija ose paraqitet trashëgimtari i cili ka qenë shpallur i vdekur.

Ruajtja e së drejtës së paraardhësit me rastin e cedimit dhe pjesëtimin.

Paraardhësi i pasurisë së ceduar dhe pjesëtuar me kontratën e cedimit mund të ruaj disa të drejta e që janë:

1. E drejta e Uzufuktit në të gjitha të mirat e ceduara, ose në disa prej tyre;
2. Kontraktimi i rentës së përhjetshme në natyrë ose në të holla;
3. Kontraktimi i mbajtjes së përhjetshme nga pasardhësit.

1.1 Ruajtja e të drejtës së uzufuktit- nënkupton kur paraardhësi mban të drejtën për shfrytëzimin e të mirave që rrjedhin nga pasuria e ceduar tek pasardhësit. (p.sh marrja e qirasë në shtëpinë si pjesë e pasurisë së ceduar, apo marrja e të vjelurave periodike).

2.1 Kontraktimi i rentës së përhjetshme- nënkupton të drejtën e paraardhësit që në periudha mujore të marrë nga pasardhësit shumën e caktuara të të hollave apo kundërvlerën e tyre në natyrë.

3.1 Kontraktimi i mbajtjes së përhjetshme - nënkupton obligimin e pasardhësve ndaj paraardhësit që ketë të fundit gjatë gjithë jetës së tij ta mbajnë (ushqejnë, strehojnë, kujdesen etj).

Ruajtja e këtyre të drejtave të cekura më lartë nga paraardhësi mund të bëhet për vete, për bashkëshorten, për të dy së bashku, apo për personin e tretë.

Në qoftë se në kontratën mbi cedimin dhe pjesëtimin janë kontraktuar ndonjëra nga të drejtat e cekura më lartë për paraardhësin dhe bashkëshorten e tij, me rastin e vdekjes së njërit nga tyre uzufuktin, rentën apo mbajtjen e përhjetshme e gëzon në tërësi njëri nga këta dy që vazhdon të jetojë, vetëm në qoftë se nuk është paraparë diçka tjetër në kontratë.

Të drejtat e bashkëshortit të ceduesit

Kur paraardhësi në momentin e lidhjes së kontratës mbi cedimin apo pjesëtimin e pasurisë është i martuar, për të prodhuar efekte juridike kjo kontratë nevojitet pëlqimi i bashkëshortit. Ky pëlqim mund të jepet nga ana e bashkëshortit në vend në kontratë ose më vonë siç është paraparë me nenin 59 paragrafi 4 i LTK-së.

Pasiva e Paraardhësit

Pasiva e paraardhësit nënkupton detyrimet e tij ndaj personave të tretë që kanë ekzistuar gjër në momentin e lidhjes së kontratës për cedimin.

Pasardhësit me rastin e lidhjes së kontratës mbi cedimin fitojnë pasurinë e ceduar pa kurrfarë barre apo ngarkese, nëse nuk është paraparë diçka tjetër me kontratë. Kjo mënyrë konsiderohet si përjashtim i fitimit të pasurisë nga paraardhësi pa u ngarkuar me borxhet e tij, pasi që me rregulla të përgjithshme të trashëgimisë barten si të drejtat ashtu edhe detyrimet.

Edhe përkundër kësaj rregulle, kur pasardhësit nuk marrin detyrime për borxhet e paraardhësit, kreditorëve të paraardhësit nuk iu cenohet e drejta që të atakojnë kontratën e lidhur tashmë ndërmjet tyre, me qëllim të realizimit të drejtave të tyre ndaj paraardhësit. Kjo e drejtë e kreditorëve mund të realizohet nëpërmjet padisë pauliana, me të cilët goditen veprimet juridike të debitorit-paraardhësit, edhe pse këto veprime të tij janë pa shpërblim, por që cenojnë të drejtat e tyre, e që zvogëlojnë aktiven e tij dhe i pamundësojnë kreditorëve realizimin e të drejtave të tyre ndaj debitorit-paraardhësit.

Shuarja e kontratës së cedimit dhe pjesëtimit të pasurisë

Kontrata mbi cedimin dhe pjesëtimin e pasurisë mund të shuhet në këto raste:

- Me përmbushjen e kontratës-që nënkupton bartjen e të drejtave apo të sendit nga paraardhësi tek pasardhësit në përputhje me kushtet e kontratës së lidhur.
- Shkëputja e kontratës - nënkuptojmë të drejtën e paraardhësit që të shkëpusë kontratën dhe ta kërkojë kthimin e sendit apo të drejtës së ceduar për shkak të mosmirënjohjes që ka treguar pasardhësi ndaj tij. Paraardhësi ka të drejtë që ta kërkojë sendin e njëjtë të ceduar, dhe kur është i mundur kthimi i tij, pasardhësi detyrohet që ta bëjë atë, në të kundërtën pasardhësi detyrohet që ta bëjë kthimin e kundërvlerës së atij sendi.
- Mospërmbushja e kushteve nga ana e pasardhësit- nënkuptojmë rastet kur pasardhësi nuk përmbushë rentën, mbajtjen e përjetshme, apo pagimin e borxheve të paraardhësit ndaj kreditorëve apo personave të tretë, si kushte që burojnë nga kontrata për cedimin dhe pjesëtimin e pasurisë.

- Sipas nenit 66, pika 3 të LTK-së, në të gjitha rastet tjera kur pasardhësi nuk i përmbushë detyrimet e përcaktuara me marrëveshje, është pikërisht gjykata organi i vetëm i cili vlerëson se në këto raste ceduesi a ka të drejtë në kthimin e sendeve apo vetëm në përmbushjen e detyrimeve nga pasardhësi. Pikërisht në këto raste tregohet roli aktiv i gjykatës për shkak të rëndësisë së detyrimeve në lidhje me cedimin.

Rezervimi i të drejtave të trashëgimtarëve pas shuarjes së kontratës mbi cedimin dhe pjesëtimin e pasurisë

Pasardhësi nuk e humb të drejtën e tij për të marrë pjesë si trashëgimtar në masën trashëgimore, edhe përkundër faktit se është bërë zgjidhja e kontratës së cedimit dhe kthimi i sendit nga pasardhësi tek paraardhësi, por me kusht që i njëjti të mos jetë përjashtuar nga trashëgimia, apo të mos jetë i padenjë të trashëgojë, dhe të mos ketë hequr dorë nga trashëgimia.

Ngjashmëritë mes kontratës mbi dhuratën dhe kontratës mbi cedimin dhe pjesëtimin e pasurisë për së gjalli

- Si te kontrata mbi dhuratën ashtu edhe te kontrata mbi cedimin dhe pjesëtimin e pasurisë për së gjalli, krijohet baza juridike për bartjen e pronësisë nga pronarët tek personat e tjerë.
- Me këto kontrata bartet pronësia nga pronari tek personat e tjerë pa shpërblim apo kundërvlerë.
- Janë kontrata formale sepse për të prodhuar efekte juridike forma kërkohet me dispozita ligjore
- Janë kontrata komutative pasi qysh në fillim dihen të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese
- Janë kontrata konsensuale pasi nevojitet pëlqimi i palëve kontraktuese
- Janë kontrata INTER VIVOS që prodhojnë efekte juridike ndërmjet palëve kontraktuese për së gjalli
- Janë kontrata kryesore sepse nuk janë në varësi me kontratat tjera
- Janë kontrata me prestime të përkohshme sepse detyrimi i debitorit përbëhet prej një bërje apo mos bërje, prej një lëshimi të cilin e ekzekuton për një çast të caktuar,
- Janë kontrata të thjeshta sepse kanë elemente vetëm të një kontrate
- Janë kontrata individuale nga se me to saktësohen detyrat ndërmjet subjekteve

- Janë kontrata Intuitu Persona nga se për lidhjen e tyre merren parasysh cilësitë e veçanta të palëve kontraktuese
- Janë kontrata me përmbajtje të caktuar nga se me to është caktuara përmbajtja elementet dhe kushtet e tyre nga palët kontraktuese
- Te dy këto kontrata kreditorët mund ti mbrojnë të drejtat e tyre, duke i kundërshtuar veprimet e debitorëve, nëpërmjet padisë pauliana

Dallimet në mes të këtyre dy kontratave

Ekzistojnë këto dallime në mes të këtyre dy kontratave:

- Përderisa te kontrata mbi dhuratën aftësia punuese e dhuratëmarrësit përcaktohet se ai person duhet të jetë mbi moshën 7 vjeçare dhe njëkohësisht të ekzistoj pëlqimi i përfaqësuesit ligjor, ndërkaq te kontrata mbi cedimin personit të cilit i bartet pronësia në emër të tij nuk ka ndonjë kufizim në moshë, përveçse ai duhet të ketë aftësi fizike. Gjithashtu, pasardhësve te kontrata e cedimit iu lejohet që të hyjnë si palë kontraktuese edhe pas lidhjes së kontratës mbi cedimin, gjë që nuk është e evidente te kontrata mbi dhuratën;
- Me kontratën mbi dhuratën dhuratëdhënësi pasurinë e tij mund ta bartë tek çdo person tjetër në bazë të vullnetit të tij, ndërsa te kontrata mbi cedimin dhe pjesëtimin e pasurisë për së gjalli, ceduesi pasurinë e tij mund ta bartë vetëm tek pasardhësit e tij, dhe jo edhe tek personat e tjerë;
- Kontrata mbi dhuratën njihet nga aspekti i marrëdhënieve të detyrimeve, ndërkaq kontrata mbi cedimin dhe pjesëtimin e pasurisë për së gjalli, rregullohet me Ligjin mbi Trashëgiminë të Kosovës;
- Përderisa te kontrata mbi cedimin pasuria që bartet apo e drejta mund të jetë e ngarkuar me barrë dhe e shoqëruar me kushte tjera si: e drejta e uzufuktit, renta dhe mbajtja e përjetshme, të drejta këto të rezervuara në dobi të ceduesit dhe bashkëshortit të tij, apo personave të tretë, ndërsa te kontrata mbi dhuratën objekti i dhuratës nuk është e ngarkuar me barrë dhe nuk përmban kushte për dhuratëmarrësin;
- Për të prodhuar efekte juridike te kontrata mbi cedimin dhe pjesëtimin duhet dhënë pëlqimin të gjithë pasardhësit, ndërsa te kontrata mbi dhuratën pëlqimi kërkohet vetëm nga dhuratëdhënësi dhe dhuratëmarrësi si palë kontraktuese;
- Me kontratën mbi dhuratën dhuratëdhënësi nuk guxon ta cenojë pjesën e domosdoshme të pasurisë së trashëgimtarëve, ndërsa me kontratën mbi cedimin ceduesit i lejohet të përfshijë edhe pjesën e

domosdoshme, sepse në të përfshihet një pjesë e pasurisë apo e tërë pasuria me të cilën disponon ceduesi në momentin e lidhjes së kontratës mbi cedimin;

- Me kontratën mbi dhuratën, dhuratëdhënësi në cilësinë e kreditorit mund t'ia falë borxhet debitorëve, e cila konsiderohet si dhuratë, ndërsa me kontratën mbi cedimin, falja e borxhit do të konsiderohet dhuratë dhe jo cedim;
- Si dallim tjetër, konsiderohet edhe mënyra e vërtetimit të këtyre kontratave, sepse te kontrata mbi dhuratën vërtetimi i kontratës bëhet në mënyrë të thjeshtë, ku vetëm jepet vula e legalizimit të gjykatës në prezencën e palëve kontraktuese, ndërsa te kontrata mbi cedimin, gjykata hap procedurë gjyqësore jashtëkontestimore, ku i dëgjon dhe i njofton palët mbi pasojat që dalin nga kjo kontratë.

Përfundimi

- Për nga rëndësia të dy këto kontrata paraqesin mundësi të mirë të qarkullimit juridik të të drejtave dhe sendeve.
- Për dallim prej kontratës së dhuratës, kontrata mbi cedimin në sferën e punëve juridike paraqitet si risi dhe mundësi e mirë për ndarjen e pasurisë për së gjalli.
- Nga aspekti praktik, gjatë hulumtimit është vërejt se edhe pse kontrata mbi cedimin është risi, nuk është përqafuar mirë në sistemin tonë juridik, ngase hapja e procedurës gjyqësore për ndarjen e pasurisë për së gjalli e bën më të komplikuar një bartje të pronësisë tek personat tjerë, ndërsa kontrata mbi dhuratën është më e lehtë për të bartur të drejtën e pronësisë, për sa i përket edhe procedurës që duhet ndjekur.
- Pikërisht, për shkak se kontrata mbi cedimin është risi për sistemin tonë juridik, në disa regjione të Kosovës është vërejtur se Zyrat Komunale Kadastrale kanë hezituar të bëjnë bartjen e pronësisë në bazë të kontratës mbi cedimin, edhe pse këto kontrata kanë qenë në përputhje me aspektin ligjor.
- Te kontratat mbi cedimin edhe në rastet kur këto kontrata nuk i kanë plotësuar të gjitha kushtet apo kanë pasur mangësi (dhënia e pëlqimit e të gjithë pasardhësve), kur pëlqimin nuk e kanë dhënë të gjithë pasardhësit, kjo kontratë edhe si e tillë prodhon efekte juridike, mirëpo ato pjesë për të cilat nuk janë pajtuar të gjithë pasardhësit konsiderohen si dhurime.



Atdhe Berisha

HAPJA E TRASHËGIMISË

Marrëdhënie juridike, është ajo marrëdhënie e cila është e mbështetur në normat juridike civile përmes të cilave norma krijohet, ndryshohet apo shuhet ndonjë e drejtë subjektive. Në krijimin, ndryshimin apo shuarjen e ndonjë të drejte subjektive një rol thelbësorë luajnë faktet juridike.

Faktet juridike ndahen në dy grupe: në ngjarje dhe veprime.

Vdekja si titulli juridik për hapjen e trashëgimisë, bënë pjesë në grupin e parë të fakteve juridike. Duke u nisur nga kjo që thamë, edhe (nenin 4.1) i Ligjit për Trashëgimin thekson “trashëgohet për shkak të vdekjes dhe në momentin e vdekjes së personit fizik”⁷⁵. Në të njëjtën mënyrë do të shprehej edhe profesor Galgano se trashëgohet në momentin e vdekjes së personit: ky është momenti në të cilin pasuria humb titullarin e saj⁷⁶. Nga kjo rrjedh se vetë vdekja është një ngjarje natyrore e cila për pasojë, në njërën anë ka shuarjen e një të drejte subjektive, ndërsa në anën tjetër krijimin e sajë, pra, transformimin e pasurisë nga një subjekt që quhet trashëgimlënës tek subjekti tjetër që quhet trashëgimtar. Të njëjtin efekt e ka edhe shpallja e personit të zhdukur për të vdekur.

Në vazhdim do të bëhet fjalë për dy elemente që bëjnë të mundur hapjen e trashëgimit. Këto dy elemente janë: vdekja dhe shpallja për të vdekur e personit.

1. Vdekja

Thamë se vdekja është një rrethanë apo fakt juridik me anë të së cilës në njërën anë shuhen dhe në anën tjetër krijohen të drejtat subjektive.

⁷⁵ Shiko Regullore nr. 2005/7 për Shpalljen e Ligjit Për Trashëgimin të miratuar nga Kuvendi i Kosovës

⁷⁶ Galgano, F. (1999) E Drejta Private, Perkth. Alban Brati, Tiranë: Luarasi f. 825.

Vdekja e personit në vetvete prodhon atë gjendje juridike me anë të së cilës caktohet pasuria trashëgimore, e cila pasuri i nënshtrohet trashëgimisë⁷⁷. Vdekja e një personi bënë që pasuria e tij të humbë titullarin e sajë, por ajo akoma nuk përcakton transferimin e saj tek trashëgimtarët⁷⁸, këtë transmetim duke u bazuar në dispozitat e (nenit 125) të Ligjit të Procedurës Jokontestimore e shqyrton gjykata në procedurën për shqyrtimin e pasurisë trashëgimore, ku konstaton "...kush janë trashëgimtarët e personit të vdekurit, ose të personit vdekja e të cilit është shpallur me vendim gjyqësor, cila pasuri përbën pasurin trashëgimore të tij dhe cilat të drejta nga pasuria trashëgimore u takojnë trashëgimtarëve, legatarëve dhe personave të tjerë"⁷⁹.

Vdekja është një rrethanë që vërtetohet me anë të certifikatës nga libri amzë i të vdekurve. Në (nenin 33.1) të Rregullores mbi Shpalljen e Ligjit për Regjistrat e Gjendjes Civile, thekson se "Libër Amzë i të Vdekurve është libri ku mbahen të gjitha shënimet lidhur me faktet e të gjitha vdekjeve të ndodhura"⁸⁰ në po të njëjtin nen por në paragrafin 2 gjithashtu theksohet se "fakti i vdekjes regjistrohet në librin amzë së të vdekurve në bazë të paraqitjes me shkrim, ose në bazë të aktit të organit kompetent në vendin e vdekjes së të vdekurit"⁸¹. Sipas (nenin 38.1) të ligjit të njëjtë certifikatën e vdekjes e lëshon zyrtari i gjendjes civile sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të personit të interesuar⁸². Ndërsa në (nenin 37) gjithnjë sipas ligjit të njëjtë, parashihen të gjitha të dhënat që përmban certifikata e vdekjes, ato janë:

- a. Emri dhe mbiemri dhe mbiemri para martesës, i të vdekurit,
- b. Data muaji dhe viti i lindjes
- c. Data muaji, ora dhe vendi i vdekjes
- d. Gjendja martesore dhe gjinia
- e. Numri personal
- f. Shtetësia
- g. Vendbanimi dhe adresa
- h. Emri dhe mbiemri i prindërve
- i. Emri dhe mbiemri i personit përkatësisht institucionit që ka paraqitur

⁷⁷ Ibid.

⁷⁸ Ibid.

⁷⁹ Shiko Ligjin e Procedurës Jokontestimore, Ligji Nr. 03/L-007

⁸⁰ Shiko Rregullorja 2005/21 mbi Shpalljen e Ligjit Për Regjistrat e Gjendjes Civile nga Kuvendi i Kosovës

⁸¹ Ibid.

⁸² Ibid.

- vdekjen
- j. Natyrën dhe shkaqet e vdekjes
- k. Dhe shënime tjera relevante⁸³

2. Shpallja e personit të vdekur

Njësoj sikurse vdekja edhe shpallja e personit të vdekur është bazë për hapjen e procedurës trashëgimore. “Si ditë e hapjes së trashëgimit të personit që është shpallur i vdekur konsiderohet dita kur aktvendimi mbi shpalljen e personit të vdekur ka marr formën e prerë...”⁸⁴. Përse është më rëndësi momenti kur aktvendimi bëhet i formës së prerë? Përgjigje në këtë pyetje japin profesorët M. Vedrish dhe P. Klariç, ku sipas tyre, ky moment është i rëndësishëm për shkak se që nga ky moment caktohet vëllimi i pasurisë që duhet të trashëgohet, radhët e trashëgimisë si dhe zotësia për të trashëguar e trashëgimtarëve. Gjithashtu ky moment është i rëndësishëm edhe për fillimin e llogaritjes së afateve⁸⁵. Një momenti të tillë, rëndësi mjaft të madhi i kushton edhe Ligji Për Trashëgiminë, në (nenin 125.2) thuhet “në rast të shpalljes së personit i vdekur, afatet fillojnë të llogariten nga dita kur aktvendimi për shpalljen e personit të vdekur ka marr formën e prerë”⁸⁶.

3. Procedurat që ndiqen

Sipas (nenit 61) të Ligjit të Procedurës Jokontestimore “Propozimin për shpalljen e vdekjes së një personi mund ta paraqesë çdo person që për këtë ka interes juridik të drejtpërdrejtë, si dhe organi i kujdestarisë”⁸⁷. Gjithashtu duke ju referuar dispozitave të ligjit në fjalë, të (nenit 62), ky propozim “duhet të përmbaj: emrin e gjykatës të cilës i paraqitet; emrin e mbiemrin e personit që duhet të shpallet i vdekur; ditën e lindjes dhe vendbanimin ose vendqëndrimin e fundit; rrethanat nëpërmjet të cilave bëhet e besueshme vdekja e tij; provat me të cilat duhet të konstatohen këto rrethana; emrin e mbiemrin e kujdestarit ose përfaqësuesit ligjor të tij, për rastet kur ka të tillë dhe emrin e mbiemrin e personave që mund të jenë trashëgimtar”⁸⁸. Kompetente për shpalljen e personit të vdekur është gjykata komunale në

⁸³ Ibid.

⁸⁴ Shiko (neni 125.1) i Regullores nr. 2005/7 për shpalljen e Ligjit Për Trashëgimin të miratuar nga Kuvendi i Kosovës

⁸⁵ Vedrish, M dhe Klariç, P (2003) *Građansko Pravo. (sedmo izmijenjo i dopunjeno izdanje)* Zagreb: Narodne Novine d.d. f.658

⁸⁶ Shiko Regullorë nr. 2005/7 për Shpalljen e Ligjit Për Trashëgimin të miratuar nga Kuvendi i Kosovës

⁸⁷ Shiko Ligjin e Procedurës Jashtëkontestimore, Gazeta zyrtare, nr. 43/1986

⁸⁸ Ibid.

rajonin ku personi i zhdukur ka pasur vendbanimin e përhershëm të fundit...apo vendqëndrimin e fundit (neni)⁸⁹. Sipas (nenit 52.1) të ligjit të njëjtë “gjkata pasi të marr propozimin për shpalljen e personit të vdekur ... në mënyrë të përshtatshme verifikon a janë plotësuar parakushtet themelore për fillimin e procedurës. Në qoftë se po, ... boton shpalljen në “Gazetën Zyrtare të Kosovës” me të cilën konstaton se ka filluar procedura (neni 53.1). Në shpalljen për fillimin e procedurës për shpalljen e zhdukjes së personit nga propozimi, tregohen rrethanat qenësore mbi të cilat mbështetet propozimi, bëhet ftesa që ai të lajmërohet, kurse personat tjerë,që kanë informata për të, ftohen që gjykatës brenda afatit tre mujor nga dita e shpalljes, t’ia parashtrojnë ato (neni 53.2). Shpallja publikohet edhe në tabelën e shpalljeve të gjykatës, e do të publikohet në mënyrën e zakonshme edhe në vendin në të cilin personi nga propozimi ka pasur vendbanimin, respektivisht vendqëndrimin e fundit (neni 53.3)⁹⁰. Gjithnjë sipas ligjit të njëjtë në (nenin 54.1) pas kalimit të afatit në shpalljen e publikuar “gjkata do ta dëgjojë kujdestarin e personit nga propozimi, e sipas nevojës edhe propozuesin, dhe pasi të marrë edhe prova të tjera vendosë meritorisht mbi propozimin”.

Është me rëndësi të theksohet se çka përmban aktvendimi me të cilin personi shpallet i vdekur. Në kuptim të (nenit 65.1) të Ligjit Për Procedurën Jokontestimore “*në aktvendimin me të cilin shpallet vdekja e personit të zhdukur do të tregohet emri e mbiemri, vendbanimi ose vendqëndrimi i fundit i tij, emri e mbiemri i prindërve të tij, dita,muaji,viti dhe vendi i lindjes, pastaj të konstatohet dita muaji dhe viti e brenda mundësive edhe ora që konsiderohet si kohë e vdekjes së personit të zhdukur*”

Pas mbërritjes në gjykatë, propozimi për iniciimin e procedurës së trashëgimore, gjykata i thërret palët e interesuara dhe kërkon nga ta që të pranojnë trashëgiminë. Ky është një akt pa të cilin trashëgimia e të thirrurve nuk realizohet⁹¹. Trashëgimtari ligjor përpara se të ketë kaluar afati për pranimin e trashëgimit, mund të heq dorë nga trashëgimia. Heqja dorë, ashtu si pranimi është një akt i njëanshëm⁹² e njëjta ka karakter personal⁹³.

⁸⁹ Ibid,

⁹⁰ Ibid (neni 53.3)

⁹¹ Galgano, F. (1999) E Drejta Private, Perkth. Alban Brati, Tiranë: Luarasi. f. 83

⁹² Ibid., f. 836

⁹³ Antiq, O. dhe Balinovac, Z. (1996) Komentar Zakona o Nasledivanju, Beograd: Nomos f. 558

4. Deklarata për heqjen dorë nga trashëgimia

E drejta jonë trashëgimore i kushton rendësi esenciale shprehjes së lirë të vullnetit, i cili është edhe parim i të drejtës trashëgimore, sikurse në shumicën e të drejtave tjera. Në kontekst të kësaj është edhe deklarata për heqjen dorë nga trashëgimi. Pra, deklarata për heqjen dorë nga trashëgimi është shprehje e njëanshme e vullnetit e cila mund të jepet në procedurën e trashëgimit dhe e njëjta të shënohet në procesverbalin e shqyrtimit të trashëgimit.

Sipas sistemit të fitimit të pronësisë, që aplikohet në legjislacionin tonë, me vdekjen e trashëgimlënësit, trashëgimtarit i kalon si pronësia ashtu edhe posedimi mbi pasurin trashëgimore. Heqja dorë nga kjo e drejtë, ushtrohet vetëm atëherë kur një person është vënë në dijeni se është trashëgimtar i një pasurie trashëgimore.

Deklarata për heqjen dorë nga trashëgimi mund të bëhet në dy mënyra. E para është kur një deklaratë e tillë bëhet gjatë zhvillimit të procedurës dhe shënohet në procesverbal, ndërsa tjetra bëhet nga distanca, pra atëherë kur personi një deklaratë të tillë e shkruan, e vërteton në gjykatë apo në ndonjë organ tjetër dhe ja parashtron gjykatës kompetente, derisa zhvillohet procedura për ndarjen e trashëgimit.

Deklarata për heqjen dorë nga trashëgimia, nga pasardhësi i cili mungon në procedurë (deklaratë nga distanca) duhet të jetë e vërtetuar pranë organit kompetent konkretisht në Gjykatën Komunale.

Deklarata për heqjen dorë nga trashëgimi, vlen edhe për pasardhësit e atij që ka hequr dorë nga trashëgimi, përveç nëse shprehimisht ka deklaruar se heq dorë vetëm në emër të vet. Në rast se pasardhësit e personit që heq dorë nga trashëgimia janë të mitur, për heqjen dorë nga trashëgimia nuk nevojitet leja e organit të kujdestarisë. Trashëgimtari i cili ka hequr dorë nga trashëgimi në emër të vetin, konsiderohet sikur të mos ketë qenë trashëgimtar⁹⁴. Sipas (nenit 131.1), “në rast se trashëgimtari ka vdekur para se të përfundoj shqyrtimi i pasurisë trashëgimore dhe nuk ka hequr dorë nga trashëgimi, e drejta e heqjes dorë kalon tek trashëgimtarët e tij”⁹⁵, për shkak se “heqja dorë në dobi të trashëgimtarit të caktuar nuk konsiderohet

⁹⁴ Shiko (neni 130.4) i Regullores nr. 2005/7 për Shpalljen e Ligjit Për Trashëgimin të miratuar nga Kuvendi i Kosovës

⁹⁵ Ibid, (neni 131.1)

si heqje dorë nga trashëgimi, por si një deklaratë për dhurimin e pjesës trashëgimore tek trashëgimtari i caktuar⁹⁶.

Nga pasardhësit e trashëgimtarit i cili ka vdekur para se të heq dorë nga trashëgimi, varet se kujt dëshirojnë të ja dhurojë pjesën e pasurisë që në fakt do tu takonte atyre, sepse “pjesa e trashëgimisë së trashëgimtarit ligjor që ka hequr dorë nga trashëgimi trashëgohet sikur ky trashëgimtar të kishte vdekur para trashëgimlënësit⁹⁷. Gjithashtu edhe pjesa e trashëgimtarit me testament që ka hequr dorë nga trashëgimi, i takon trashëgimtarëve ligjor të trashëgimlënësit⁹⁸, gjë që e bënë të domosdoshme dhe e arsyeton të drejtën që u njëh ligji pasardhësve të trashëgimlënësit që ka vdekur para deklaratës për heqjen dorë nga trashëgimi, se kujë do t’ia dhurojë pasurinë me rastin e heqjes dorë të tyre. Këtë të drejtë e përforcon edhe dispozita e (nenit 135.1) në të cilën thuhet “deklarata për heqjen dorë nga trashëgimi nuk mund të revokohet⁹⁹, pra është një deklaram që do të prodhon efekt në të ardhmen dhe e bënë të domosdoshëm që pasardhësit të kenë kujdes me rastin e heqjes dorë nga trashëgimi.

Sipas (nenit 135.2) të Ligjit për Trashëgimin, trashëgimtari apo pasardhësit e tij që kanë dhënë deklaratën, mund të kërkojnë anulimin e kësaj deklarate në rast se deklarata është dhënë me kanosje, dhunë, për shkak të mashtrimit ose lajthimit¹⁰⁰. Këto janë bazat të mjaftueshme që të kërkohej anulimi i kësaj deklarate nga personat që kanë dhënë një deklaratë të tillë. Pra, të drejtën e kërkesës për këtë anulim e kanë titullarët e kësaj deklarate.

Heqja dorë nga trashëgimi do të jetë e pavlefshme kur ajo bëhet me kusht, me afat, ose për një pjesë të trashëgimit¹⁰¹, këtë pavlefshmëri e njëh edhe Ligji për Trashëgimin i Kosovës. Ndërsa sa i përket të drejtës që të heqin dorë nga trashëgimi, lind pyetja, kjo e drejtë a u takon të gjithëve trashëgimtarëve? Ligji i Trashëgimisë i Kosovës, këtë të drejtë ia mohon vetëm trashëgimtarit i cili ka disponuar tërë pasurinë ose një pjesë të sajë¹⁰², pra ky trashëgimtar nuk mundet të deklarohet për heqjen dorë nga trashëgimi.

⁹⁶ Ibid (neni 133.2)

⁹⁷ Ibid (neni 137)

⁹⁸ Ibid (neni 136)

⁹⁹ Shiko Rregullore nr. 2005/7 për Shpalljen e Ligjit Për Trashëgimin të miratuar nga Kuvendi i Kosovës

¹⁰⁰ Ibid. (neni 135.2)

¹⁰¹ Fuga, J. (2002) Trashëgimia Tiranë: Ilar, f. 42.

¹⁰² Shiko (neni 132.1) i Rregullores nr. 2005/7 për Shpalljen e Ligjit për Trashëgimin të Miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

Në fund duhet theksuar se heqja dorë nga trashëgimi që nuk është hapur nuk ka kurrfarë efekti juridik¹⁰³, për shkak se vetëm atëherë kur personi është vënë në dijeni të faktit që është trashëgimtar në një pasuri trashëgimore, vetëm atëherë ai mund të heq dorë nga trashëgimia e cila ka kaluar në favor të tij¹⁰⁴.

5. Aktvendimi për trashëgiminë

Pas administrimit të të gjitha provave dhe pas pranimit të deklaratave të trashëgimtarëve qoftë për pranimin e pjesës trashëgimore qoftë për heqjen dorë nga pjesa trashëgimore që u takon gjykata me aktvendim konstaton se cilëve persona u takon e drejta për trashëgim dhe këta persona i shpall trashëgimtarë duke u caktuar pjesët trashëgimore që u takojnë.

Sipas (nenit 171.2) të Ligjit Për Procedurën Jokontestimore, aktvendimi me të cilën është përfunduar procedura trashëgimore do të përmbajë: a) emrin dhe mbiemrin e të vdekurit dhe emrin e njërit nga prindërit e tij, datën e lindjes dhe shtetësinë e të vdekurit, e sipas mundësisë numrin personal të qytetarit, kurse për personat e vdekur në martesë edhe mbiemrin që e kanë pasur para lidhjes së martesës; b) paluajtshmërinë me të dhënat nga librat publike të nevojshme për regjistrim, si dhe sendet e luajtshme dhe të drejtat të tjera për të cilat gjykata ka konstatuar se bëjnë pjesë në pasurinë trashëgimore; c) emrin dhe mbiemrin e trashëgimtarit, vendbanimin e tij, marrëdhënien e trashëgimtarit ndaj trashëgimlënësit, a e trashëgon trashëgimlënësin në bazë të ligjit apo të testamentit, e po qe se janë më tepër trashëgimtarë edhe pjesën trashëgimore të secilit, nga ta të shprehur me vijë thyese, e sipas mundësisë numrin personal unik të trashëgimtarit; d) a është kushtëzua, afatizuar, kufizuar apo ngarkuar, dhe në dobi të kujt, e drejta e trashëgimtarit; e) emrin e mbiemrin, vendbanimin e personave të cilëve u ka takuar në pasurinë trashëgimore e drejta e legatit apo ndonjë e drejtë tjetër nga trashëgimia me shënimin e saktë të kësaj të drejte, dhe sipas mundësisë numrin personal të tyre.

¹⁰³ Ibid. (neni 134).

¹⁰⁴ Fuga, J. (2002) Trashëgimia Tiranë: Ilar, f. 42.



Pranvera Ademi

KONFIRMIMI I AKTAKUZËS

Hyrje

Është fakt se nga kriminaliteti, si dukuri shoqërore negative, nuk ka qenë dhe aktualisht nuk është imune asnjë shoqëri, pa marrë parasysh kohën e veprimit të saj dhe pa marrë parasysh rregullimin shoqëroro – politik të saj. Edhe sot çdo shoqëri njerëzore e organizuar në shtet nëpërmjet institucioneve të ndryshme ndërmerr masa preventive me të cilat synon të pengojë kryerjen e veprave penale. Reagimi shoqëror ndaj kriminalitetit nëpërmjet legjislacionit penal qëndron në përcaktimin e veprave penale dhe të sanksionit penal ndaj kryesit përgjegjës të veprës penale. Edhe Kosova në legjislacionin e saj të ri konkretisht në Kodin e Përkohshëm të Procedurës Penale ka bërë disa ndryshime për këtë dukuri, në krahasim me legjislacionin e vjetër. Këtu mund të ceket rasti i Konfirmimit të aktakuzës që në ligjin e vjetër nuk është paraparë kjo çështje, do të thotë konfirmimi i aktakuzës është një fazë e re e procedurës penale në krahasim me legjislacionin paraprak. Pas përfundimit të hetimit ose kur prokurori publik konsideron se informacionet që i disponon ai për veprën penale dhe kryerësin e saj paraqesin bazë të mjaftueshme për ngritjen e aktakuzës, prokurori këtë akt ia dërgon gjykatës kompetente. Kodi i Procedurës Penale i Kosovës (në vazhdim KPPK) në disa nene të posaçme e rregullon çështjen e aktakuzës dhe konfirmimit të aktakuzës.

Aktakuza

Në procedurën tone penale me termin aktakuzë nënkuptojmë disa akte akuzuese të posaçme. Kështu për vepër penale për të cilën zhvillohet procedura e rregullt ngritët aktakuza, ndërsa në procedurën sumare propozimakuza apo padia private.

Aktakuza është akt formal procedural i cili i paraqitet gjykatës nga ana e prokurorit publik ose paditësit subsidiar në formë të shkruar, ose përjashtimisht duke e shënuar në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor kur kemi të bëjmë me ndryshimin ose zgjerimin e aktakuzës.¹⁰⁵

Përmbajtja e aktakuzës është e përcaktuar me nenin 305 të KPPPK-së. Sipas këtij neni aktakuza duhet t'i përmbajë këto elemente: emrin dhe mbiemrin e të pandehurit dhe të dhënat e tij personale; të dhënat lidhur me kohën e qëndrimit të të pandehurit në paraburgim; nëse ndaj tij është caktuar paraburgimi, apo ndonjë masë tjetër alternative e paraburgimit; emërtimin ligjor të veprës penale; përshkrimin e veprës penale; arsyetimin e aktakuzës; përcaktimin e gjykatës ku do të mbahet shqyrtimi gjyqësor dhe propozimin për provat që duhet proceduar në shqyrtim gjyqësor, çka nënkupton edhe kërkesën për marrjen e aktgjykimit dënues.

Aktakuza i dërgohet gjykatës kompetente (gjyqtarit të procedurës paraprake) në kopje të mjaftueshme. Bashkë me aktakuzë dërgohet edhe lënda komplet e hetimit.¹⁰⁶

Nocioni i konfirmimi të aktakuzës

Ngritja e aktakuzës kundër të pandehurit dhe procedimi penal sipas saj është jo i këndshëm për të pandehurin, bile edhe atëherë kur procedura përfundon me lirimin e tij. Prandaj ligjvënësi ka paraparë kontrollin e aktakuzës në seancë për konfirmimin e aktakuzës, në mënyrë që të pengohet nxjerrja e tij në shqyrtim gjyqësor pa baza të mjaftuara. Mund të themi se seanca për konfirmimin e aktakuzës manifestohet gjithashtu në ruajtjen e autoritetit të organeve shtetërore i cili cenohet nëse në gjykatë arrijnë numër i madh i padive të pabazuara.¹⁰⁷

Veprimet e gjyqtarit para seancës për konfirmimin e aktakuzës

Kur gjyqtari çmon se aktakuza është përpiluar në pajtim me nenin 305 të KPPPK-së, ai menjëherë cakton seancë për konfirmimin e aktakuzës, ndërsa kur çmon se aktakuza nuk është në pajtim me dispozitat e cekura ia kthen prokurorit për ta ndryshuar dhe atë në afat brenda tri ditëve. Gjyqtari konfirmues gjithashtu shqyrton aktakuzën dhe lëndën penale për të parë se a përfshin a jo ndonjë provë të papranueshme ose referencë të tillë, p.sh.

¹⁰⁵ Dr.sc. Ejup Sahiti "E Drejta e Procedurës Penale" fq. 197

¹⁰⁶ Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës, neni 305, 306

¹⁰⁷ Dr. Sc. Ejup Sahiti "E Drejta e Procedurës Penale" fq. 198

provë e papranueshme si marrja në pyetje nga ana e prokurorit publik e të pandehurit, dëshmitarëve pa prezencën e mbrojtësve të të pandehurit, etj. Aktakuza i dërgohet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij së paku tetë ditë para seancës së konfirmimit.

Veprimet e të pandehurit

Pasi t'i dorëzohet aktakuza i pandehuri ka tri mundësi veprimi:

- 1) Të heq dorë nga shqyrtimi i aktakuzës dhe i provave,
- 2) Të heq dorë nga seanca për konfirmimin e aktakuzës dhe të paraqes kundërshtim me shkrim kundër aktakuzës ose pranueshmërisë së provës, ose
- 3) Të vazhdohet në seancë për konfirmimin e aktakuzës.

Kur i pandehuri heqë dorë nga shqyrtimi i aktakuzës dhe i provave, ai i parashtron gjyqtarit heqjen dorë me shkrim së paku tri ditë para seancës për konfirmim. Pastaj gjyqtari, varësisht nga vlerësimi i tij e anulon ose megjithatë e mban seancën për konfirmim.¹⁰⁸ Gjyqtari merr aktvendim për pranimin e akt dorëheqjes dhe anulimin e seancës së konfirmimit nëse ai është i bindur se i pandehuri kupton pasojat e akt dorëheqjes së tillë, dhe gjyqtari menjëherë e informon të pandehurin, prokurorin dhe të dëmtuarin për këtë aktvendim¹⁰⁹.

Mirëpo gjyqtari mund të merr edhe aktvendim për refuzimin e akt dorëheqjes së të pandehurit, dhe seanca e konfirmimit të vazhdojë sipas orarit të paraparë.

Seanca për konfirmim të aktakuzës

Seanca për konfirmim drejtohet nga gjyqtari i procedurës konfirmues. Në këtë seancë duhet të jenë të pranishëm prokurori publik dhe i pandehuri, ndërsa i dëmtuari ka të drejtë pjesëmarrje. Ndërkaq, dispozitat e KPPPK-së për publicitetin, udhëheqjen, shlyerjen dhe ndërprerjen e shqyrtimit gjyqësor zbatohen përshtatshmërisht edhe te seanca për konfirmimin e aktakuzës. Në fillim të seancës për konfirmim, gjyqtari e udhëzon të pandehurin për të drejtën e tij për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose të të mos përgjigjet në pyetje dhe, nëse ai deklaron për çështjen, se nuk ka për detyrë të

¹⁰⁸ Doracaku për përgatitjen e provimit të jurisprudencës, OSCE, Prishtinë 2004, fq. 243

¹⁰⁹ Kodi i Përkohshëm i Procedures Penale i Kosovës, neni 310

inkriminojë vetveten ose të afërmin, as të pranojë fajësinë; të mbrohet vetë ose, nëpërmjet ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij, të kundërshtojë aktakuzën dhe pranueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë.¹¹⁰

Pastaj, Prokurori lexon aktakuzën dhe pasi që gjyqtari është i bindur se i pandehuri e kupton aktakuzën, të pandehurit i ofron mundësin të pranojë fajin ose të deklarohet i pafajshëm. Nëse i pandehuri nuk dëshiron të bëjë ndonjë deklaram lidhur me fajin e tij, konsiderohet se ai nuk e pranon fajësinë. Gjatë seancës së konfirmimit, pandehuri dhe/ose mbrojtësi i tij dhe prokurori kanë të drejtë të japin deklaratë, por gjyqtari mund ta lejoj edhe të dëmtuarin të jap deklaratë. Mirëpo, gjatë kësaj seance nuk do të merret në pyetje asnjë dëshmitarë apo ekspert dhe as nuk do të prezantohen prova të tjera.

Hudhja e aktakuzës – pushimi i procedurës

Hudhjen e aktakuzës dhe pushimin e procedurës penale e bënë gjyqtari me aktvendim, kur ai çmon se:

- 1) Vepra me të cilën akuzohet nuk përbën vepër penale;
- 2) Ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale;
- 3) Ka kaluar afati i parashkrimit, vepra është përfshirë ma amnisti ose falje apo ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen ose
- 4) Nuk ka prova të mjaftueshme që mbështesin dyshimin e bazuar se i pandehuri ka kryer veprën me të cilën akuzohet.

Mirëpo ka edhe raste të tjera kur gjyqtari merr aktvendim për hudhjen aktakuzës ose pushimin e procedurës si: kur aktakuza nuk është ngritur nga paditësi i autorizuar, nëse propozimi i palës së dëmtuar ose leja e organit publik mungon ose është tërhequr apo nëse ekzistojnë rrethana të tjera të cilat përkohësisht e pengojnë ndjekjen.

Megjithatë, gjyqtari kur çmon se vepra penale në aktakuzë është në kompetence të një gjykate tjetër, ai merr aktvendim me të cilin gjykatën e shpall jokompetente dhe çështjen ia referon gjykatës kompetente. Kundër këtij aktvendimi palët mundën t'i parashirojnë ankesë kolegjit prej tre gjyqtarësh.

¹¹⁰ Po aty, neni 314

Konfirmimi i aktakuzës

Aktakuza konfirmohet me aktvendim nga ana e gjyqtarit kur ai çmon se:

- 1) Vepra me të cilën akuzohet përbenë vepër penale, pra është e përcaktuar si e tillë me dispozita të Kodit penal
- 2) Kur ekzistojnë rrethanat për përgjegjësinë penale
- 3) Kur vepra penale nuk është parashkruar dhe nuk është përfshirë me amnisti ose falje dhe kur nuk ekzistojnë rrethana të tjera që e përjashtojnë ndjekjen.

Provat e papranueshme

Siç dihet për pranimin e provës gjyqtari vendos me kërkesë të palës ose sipas detyrës zyrtare. Çështja lidhur me pranimin e provës mund të ngritët nga pala në kohën kur prova i paraqitet gjykatës dhe në rast të veçantë në seancën për konfirmimin e aktakuzës. Gjyqtari merr aktvendim të posaçëm për të deklaruar të papranueshme provën konkrete kur çmon se prova e tillë e marrë gjatë hetimit ose e propozuar nga prokurori për ta prezantuar në shqyrtim gjyqësor është e papranueshme.

Këtë aktvendim duhet arsyetuar dhe kjo prove e papranueshme veçohet nga shkresat e lëndës dhe vuloset. Prova e tillë ruhet në gjykatë ndaras nga shkresat e tjera dhe provat. Kjo Provë nuk mund të shqyrtohet e as të përdoret në procedurë, përveç në procedure të ankesës kundër aktvendimit mbi pranueshmërinë. Mirëpo, prova e cila me aktvendim është konstatuar si e papranueshme, në një faze të mëvonshme të procedurës me aktvendim mund të konstatohet si e pranueshme.¹¹¹

Përfundim

Në rastin e Kosovës, rruga për të arritur tek një sistem modern i drejtësisë penale me një respekt për të drejtat e njeriut dëshmon të jetë mjaftë e gjatë dhe e vështirë. Megjithatë, përderisa si komuniteti ndërkombëtar ashtu edhe ai vendës kanë shpresuar për një reformë më të mire, më të shpejtë dhe më të fokusuar, shumë pak mund të dyshojmë se është arritur një progres i qëndrueshëm. Gjatë përvojës sime në sistemin e praktikës gjyqësore në Kosovë kam vërejtur se edhe Konfirmimi i Aktakuzës i ka anët e veta pozitive po ashtu edhe ato negative.

¹¹¹ Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës, neni 154

Si anë pozitive e kësaj faze të re të procedurës penale mund të them se janë: kontrolli i aktakuzës në këtë seancë të konfirmimit, në mënyrë që të pengohet nxjerrja e tij në shqyrtim gjyqësor pa baza të mjaftuara. Gjithashtu anë tjetër pozitive është ruajtja e autoritetit të organeve shtetërore i cili mund të cenohet nëse në gjykatë arrijnë numër i madh i akuzave (pasive) të pabazuara. Anët negative sipas mendimit tim janë se me këtë faze të re të procedurës është bërë një zvarritje e madhe e procedurës. Këtë e them duke u bazuar në atë se i pandehuri pavarësisht se a e pranon a jo fajësinë, ai këtë deklaratë mund ta ndërroj në çdo faze tjetër të procedurës, apo shqyrtimit gjyqësor. Do të thotë nëse kemi një numër të madh të rasteve në gjykatë atëherë me këtë seancë do të zvarritet procedura.

Siç e kam cekur edhe më lart se konfirmimi i aktakuzës është faze e re e procedurës penale do të thotë me Ligjin e vjetër nuk ka qenë e paraparë. Po ashtu edhe në legjislacionin penal të Shqipërisë nuk është paraparë konfirmimi i aktakuzës. Edhe pse te ne është paraparë një sistem i tillë, mbetemi me shpresë se në një ardhme të afërt disa nga nenet e Kodit Penal dhe atij të Procedurës Penale do të ndryshojnë në mënyrë që sistemi i drejtësisë në Kosovë të jetë sa më efikas.



Elife Uka



Binak Duqi

PROVAT E PAPANUESHME NË PROCEDURËN PENALE

Në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës e drejta e mbrojtjes së të pandehurit është e siguruar dhe nuk lejohet përdorimi i provave të nxjerra në procedurën penale të cilat janë marr me shkeljen e dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Provat e marra me shkeljen e dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës konsiderohen të papranueshme dhe se në to nuk mund të mbështetet aktgjykimi siç është paraparë në nenin 153, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës ashtu që si të tilla ndahen nga shkresat e lëndës.¹¹²

Provat e pranueshme kanë qenë të parapara edhe me LPP, të ish Jugosllavisë ashtu që provat e marra nga Policia dhe Prokurori Publik duhet të jenë në pajtim të plotë sipas autorizimit të dhënë në mënyrën e paraparë më ligj. Policia dhe Prokurori Publik për veç tjerash janë të obliguar të mbledhin çdo informatë që mundë të jetë me interes për udhëheqje të suksesshme të procedurës penale (neni 151, par. 1, të LPP).

Gjatë marrjes në pyetje të pandehurin nuk mund të bazohet vendimi gjyqësor nëse është marr në pyetje pa praninë e avokatit, apo nëse i pandehuri gjatë marrjes në pyetje për herë të parë nuk ka siguruar mbrojtës as në afatin e paraparë me Kod edhe pse është njoftuar për të drejtën në mbrojtje, vetëm në rastin e mbrojtjes së detyrueshme, përndryshe do të jenë prova të papranueshme në procedurën penale.

Janë prova të papranueshme nëse gjatë marrjes në pyetje të pandehurit ndaj tij është përdorë forca (dhuna) kërcënimi apo mjetet të ngjashme (neni 259, par. 3 të LPP, të ish Jugosllavisë).

¹¹² Kodi i Procedurës Penale të Kosovës neni 153

Gjatë marrjes së dëshmisë së dëshmitarit nuk mund të merret vendimi gjyqësor nëse në cilësi të dëshmitarit është dëgjuar personi që nuk mund të dëgjohet si dëshmitarë (neni 226, i LPP,) apo nëse është dëgjua dëshmitari që është i liruar nga obligimi me dëshmi e nuk ka hekë dorë nga ajo e drejtë ose nëse deklarata e tij nuk ka hyrë në procesverbal apo nëse dëshmia e dëshmitarit është imponuar me dhunë, kërcenim apo mjete tjera të nevojshme (nenet 227, 228 Ligji i Procedurës Penale i ish Jugosllavisë).

Po ashtu nuk mund të merret si provë nëse ekspertizën e ka bërë (dhënë) eksperti që me ligje i ndalohej të jetë ekspert (neni 224 par. 1, LPP ish Jugosllavisë).

Përdorimi i provave të papranueshme iu nënshtrohet sanksioneve penale. Për tu përgjigjur personi zyrtar duhet vërtetuar më parë se janë përdorur provat e papranueshme. Gjykata që bënë vendimin është e obliguar që për shkaqet e aktgjykimit të tregoj me cilat prova është vërtetuar gjendja faktike, por nëse nuk i cek provat e tilla kishte me bërë shkelje absolute (esenciale) të dispozitave të procedurës penale (neni 364, par. 1, pika 11, e cila merret parasysh sipas detyrës zyrtare).

Nuk do të kishte shkelje nëse gjykata në arsyetim i cek provat e papranueshme që i ka përdorë gjatë marrjes së vendimit, deri te shkelja kishte me ardh nëse nga pakujdesia gjyqtari nuk e vëren se provat në të cilat thirret janë të papranueshme.

Në praktikë gjykata nuk i përmend provat e papranueshme në arsyetimin e aktgjykimit, vetëm provat e papranueshme i vlerëson duke pas parasysh paligjshmërinë nga ajo që ka marrë në dijeni nga provat e papranueshme, a përdorimin e tillë të provave të papranueshme nuk mund ta vërtetoi.

Ligji ka paraparë shkelje absolute të procedurës penale në qoftë se aktgjykimi bazohet në prova që me ligj janë paraparë se nuk mund të bazohet në ato prova vendimet (neni 364, par. 1, pika 8, LPP, i ish Jugosllavisë), mirëpo nëse nuk ka shkelje të tilla nëse duke pas parasysh se me provat tjera është e qartë që edhe pa ato prova do të bëhej i njëjti aktgjykim¹¹³.

¹¹³ Koment i ligjit të procedurës penale të ish Jugosllavisë autorë Dr.Tihomir Vasileviq Dr. Momçillo Gruboç Pjesa e dytë.

Provat e papranuara janë ato të cilat pretendojnë për të vërtetën materiale. Me rastin e marrjes së tyre janë shkel të drejtat e lirit për të drejtat e njeriut e të cilat janë të inkorporuar edhe në Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Po që se nuk është respektuar dinjiteti i personit, është keqtrajtuar fizikisht apo psikikisht, është kanosë apo janë përdorur drogë, torturë, shtrëngim ose mjete hipnotizuese, është mashtruar për ndonjë përfitim që nuk është paraparë me ligj, nuk është marr parasysh cilësia e personit që merret në pyetje, veprimi është ndërmarr nga organi jokompetent me që rast nuk ka ardhur në shprehje siguria juridike e personit ndaj të cilit është ndërmerr veprimi i caktuar, pastaj ti dobësohet kujtesa ose aftësia për të kuptuar siç parashihet në nenin 155, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Për të qenë provë e pranueshme procesverbali i marrjes në pyetje e të pandehurit të dhënë në polici ose te Prokurori Publik duhet që i pandehuri konform nenit 229, par. 1, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, të merret në pyetje më së voni para përfundimit të hetimit përveç kur procedura rezulton me pushim.

Në çështje të thjeshta mjafton që të pandehurit t'i epet mundësia për t'u përgjigjur me shkrim, pastaj i pandehuri konform nenit 231, të të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, të njoftohet për vepër penale për të cilën akuzohet, të drejtën për të heshtur dhe për të mos u përgjigjur në asnjë pyetje përveç informacionit mbi identitetin e tij, nëse nuk flet gjuhën e personit që drejton procedurës t'i ofrohet përkthimi falas, të ketë mbrojtës dhe të konsultohet me të para dhe gjatë marrjes në pyetje, faktin se deklarimi i tij mund të përdoret në gjykatë si provë, mund të kërkoj marrjen e provave në mbrojtjen e tij dhe për të drejtë e tij dhe për të drejtën e caktimit të mbrojtësit me shpenzimet buxhetore kur nuk është në gjendje t'i paguaj shpenzimet.

Pastaj duhet t'i ofrohet mundësi për t'i kundërshtuar arsyet e dyshimit kundër tij dhe të parashtroj fakte që shkojnë në favor të tij (233, par. 3, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës). Kurse konform nenit 234, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës ndaj të pandehurit duhet të kushtohet respekt ndaj dinjitetit dhe pyetjet të parashtrohen në mënyrë të qartë, të kuptueshme të përpiktë dhe atë pavarësisht nga pëlqimi i të pandehurit (neni 234 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës). Ndërsa sipas nenit 156, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës është paraparë se deklarimi i të pandehurit i cili është marrë në pajtim me dispozitat e neneve 229-236 është

i pranueshëm për Gjykatën dhe mund të përdoren në procedurën gjyqësore.¹¹⁴

Dëshmitarët e privilegjuar, neni 159, i Kodit të Procedurës Penale ka paraparë se si dëshmitar nuk mund të merret në pyetje personi i cili në deklarinim e vet do të shkelte detyrën e ruajtjes së fshehtësisë zyrtare ose ushtarake deri sa organi kompetent nuk e liron nga ky detyrim, mbrojtësi për atë që i pandehuri ia ka besuar atij në cilësi të mbrojtësit të vetë (bashkëpandehuri deri sa zbatohet procedurë e përbashkët) përbëjnë provë të papranueshme.

Kurse sipas nenit 161, dëshmitë e dëshmitarëve janë të papranueshme në rastin kur nuk mund të pyetet si dëshmitarë (neni 159 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës) personi nuk ka detyrim dëshmimi e nuk është vënë në dijeni për këtë shprehimisht nuk ka heq dorë nga kjo e drejtë apo kur udhëzimi dhe heqja dorë nuk është shënuar në procesverbal (neni 160 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës), personi është fëmijë i cili nuk kupton të drejtën e tij për të refuzuar dëshminë ose dëshmia e dëshmitarit është marr me forcë, kanosje ose me ndonjë mjetë tjetër të ngjashëm (neni 155, Kodit të Procedurës Penale të Kosovës).

Dëshmitari nuk ka detyrim që të përgjigjet në pyetje konkrete kur ka gjasa se e vë vetë vetën ose të afërmit e tij para turpit të rëndë, dëmit të konsiderueshëm material, ose ndjekjes penale. Dëshmitarit së pari i tërhiqet vërejtja se detyrohet të flasë të vërtetën dhe nuk guxon të heshtë asgjë, e pastaj i bëhet me dije se dhënia e dëshmisë së rrejshme është vepër penale. Udhëzimi i tillë duhet të shënohet në procesverbal në të kundërtën këto referenca do të ishin të papranueshme në procedurën penale.

Masat e fshehta të hetimeve janë urdhra nga Prokurori Publik neni 285, par. 2, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës e që janë:

1. fotografimi i fshehtë ose vëzhgimi me video në vende private,
2. monitorimi i fshehtë i bisedave në vende private, kontrollimi i dërgesave postare,
3. përgjimi i komunikimeve nga rrjeti kompjuterik, dërgimi të kontrolluar të,
4. dërgesave postare,
5. shfrytëzimin e përcjelljes ose vendosjes së mjeteve të përgjimit,

¹¹⁴ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës

6. blerje të stimuluar të ndonjë sendi,
7. simulimi të një vepre të korrupsionit dhe
8. zbulimi i të dhënave financiare.

Këto masa po që se nuk janë konfirmuar nga Gjyqtari i Procedurës Paraprake brenda 24 orëve nga lëshimi i urdhrin përbëjnë prova të papranueshme në procedurën penale.

Provat e mbledhura me masa të fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit janë të papranueshme nëse urdhri për masën dhe zbatimin e saj është i paligjshëm (neni 264, par. 1, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, ndërsa në par. 3 po të njëjtit nenë është paraparë para se aktakuza të merr formën e prerë gjykatësi për konfirmim të aktakuzës, sipas detyrës zyrtare rishikon materialin e mbledhur) për çka lëshon aktvendim me shkrim lidhur me ligjshmërinë e urdhrin për masën, në të kundërtën mosmarrja e aktvendimit masat e fshehta teknike të vëzhgimit dhe të hetimit nuk do të jenë të pranueshme.

Do të konsiderohen prova të papranueshme: të gjitha provat e mbledhura gjatë kontrollimit të banesës të lokaleve po që se: kontrolli është kryer pa urdhrin të Gjyqtarit të Procedurës Paraprake, urdhri është në kundërshtim me dispozitat e KPP, përbërja e urdhrin të Gjyqtarit të Procedurës Paraprake është në kundërshtim me kushtet e parapara me Kodin e Procedurës Paraprake të Kosovës, kontrolli është zbatuar në kundërshtim me urdhrin e Gjyqtarit të Procedurës Paraprake, personat prania e të cilëve është e detyrueshme nuk kanë qenë gjatë kontrollimit.

Neni 243, par. 1, të Kodit të Procedurës penale të Kosovës parasheh gjatë kontrollimit të shtëpisë ose lokaleve të tjera personi shtëpia, lokale ose pasuria e të cilit kontrollohet ose përfaqësuesi i tij kanë të drejtë të jenë të pranishëm dhe par. 2 i të njëjtit nen parasheh se gjatë kontrollimit të personit shtëpisë ose lokaleve të tjera kërkohet të jenë të pranishëm dy persona të rritur së dëshmitarë. Para fillimit të kontrollimit dëshmitarët paralajmërohen që me kujdes të vëzhgojnë zbatimin e kontrollit dhe mjafton për të drejtën e tyre për të bërë vërejtje, nëse kanë për përmbajtjen e procesverbalit të kontrollimit para se të nënshkruhet, pastaj kontrolli është zbatuar në kundërshtim me nenin 245, (kur është e domosdoshme dhe në masë të nevojshme, policia mund të hyjë në shtëpinë dhe lokalet tjera të personit dhe të zbatoj kontrollin pa urdhrin e Gjyqtarit të Procedurës Paraprake nëse: Personi përkatës me dije dhe vullnet pajtohet me kontroll,

personi thirret për ndihmë, kryesi i kapur në flagrancë gjatë kryerjes së veprës penale duhet arrestuar pas ndjekjes, arsyet për mbajtjen e njerëzve dhe pasurisë e kërkon një veprim të tillë ose personi kundër të cilit është lëshuar urdhërarresti nga Gjykata gjendet në shtëpi apo lokale tjera.

Përjashtimisht në rrethana të ngutshme kur urdhri me shkrim për kontroll nuk mund të merret në kohë edhe nëse ekziston rrezik real për vonesë që mundë të rezultojë me humbjen e provave, ose rrezik ndaj jetës ose shëndetit të njerëzve policia gjyqësore mund të filloj kontrollin në bazë të lejes gojore nga Gjyqtari i Procedurës Paraprake neni 245, par 3, të Kodit të Procedurës Penale.

Policia mund të zbatoj kontrollin e personit pa urdhër ose praninë e dëshmitarëve kur ekziston aktvendimi për sjelljen forcërisht të personit ose kurë e bënë arrestimin e tij nëse ekziston dyshimi i bazuar se personi mbanë armë apo ndonjë mjet për sulëm ose kur mundë të mënjanon, fshehë apo asgjësoj sendet të cilat ai duhet ti merr si provë në procedurën penale.

Gjithashtu provë e papranueshme është edhe kur procesverbali i këqyrjes dhe i rikonstruksionit të vendit të ngjarjes i kryer nga Prokurori dhe policia pa e njoftuar të pandehurin ose mbrojtësin e tij, (neni 254 par. 1, i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës)¹¹⁵. Edhe në legjislaturën e mëhershme veprimet e tilla gjatë hetimeve janë trajtuar si të patolerueshme. Por karakteristikë e tillë në regjimin e kaluar ka qenë dhuna e përdorur ndaj veprimtarëve shqiptar gjatë regjimit Jugosllav.

Gjykata e shkallës së dytë duke vepruar sipas detyrës zyrtare apo kur e miraton ankesën me aktvendim e anulon aktgjykimin e shkallës së parë dhe çështjen e kthen në rigjykim ku vërteton se ekzistojnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 403, par. 1, nën par. 8, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës përveç kur anulimi i aktgjykimit vetëm për këtë shkak do të ishte në dëm të të akuzuarit (neni 424, par. 1 dhe 2 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës).

Prezenca e provës së papranueshme nga shkresat e lëndës është edhe arsye e Kërkesës për Mbrojtjen e Ligjshmërisë (neni 451, par. 1, nën par. 2, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës) si dhe vendimi i Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut në dëm të të pandehurit (neni 452, par. 4, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës).

¹¹⁵ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës.

Për fund Provat e Papranueshme janë në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të qytetareve dhe mbështetën në dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Konventat ndërkombëtare veçanërisht mbrojtja nga tortura, veprimet çnjerëzore, e drejta në privatësi individuale dhe familjare dhe të drejtat minimale të mbrojtjes së të pandehurit nga akuzat që janë të përfshira me shkelje të ligjeve në fuqi e që janë në dëm të pandehurit.

Po ashtu janë sfidë kundër arbitraritetit të veprimeve të organeve shtetërore ku kryejnë funksionet e tyre kushtetuese, autorizimet ligjore, çështja e këtyre provave ka rëndësi të madhe si në pikëpamje teorike, shkencore dhe në vetë praktikën gjyqësore, por që nuk janë të rralla rastet kur hasim në prova të tilla qoftë nga mosnjohja e ligjit nga organet që marrin pjesë në procedurën penale ose arsye tjera që nuk kanë bazë ligjore.

Nga kjo mund të konstatojmë se kemi tri lloje të provave të papranueshme në procedurën penale.

1. Provat e mbledhura me cenimin e lirive dhe të drejtave të qytetareve, me ç'rast kryhen edhe veprat penale (nga KPK) nga personat zyrtar që zbatojnë KPP, si dhe marrja e deklaratës me dhunë (neni 163 i KPK), keqtrajtimi gjatë ushtrimit të detyrës (neni 164 i KPK), tortura (neni 165), cenimi i paprekshmërisë së banesës (neni 166 i KPK), kontrollimi i kundërligjshëm (167, i KPK), dhe cenimi i fshehtësisë së korrespondencës dhe bazave të të paautorizuar (neni 170 i KPK), përkatësisht cenimi i sigurisë dhe privatësisë së qytetareve të garantuara me kushtetutë;
2. Provat për të cilat shprehimisht është thënë në KPP se nuk mundë të mbështetet vendimi i Gjykatës (neni 153, par. 2, 264, par. 1, 2, 3, neni 246, 248, 235, 161, dhe,
3. Informacionet të cilat kanë burim provat e papranueshme (referencat), me këtë është marr në procedurën penale, koncepti i fryteve i “Frytet të pemës së helmuar”. Dispozitat e neneve 246, kontrolli i paligjshëm 254, par. 2, theksojnë se provat e gjetura përkohësisht rezultati i tyre është i papranueshëm me vet faktin se burojnë nga provat që sipas ligjit janë të papranueshme në procedurën penale¹¹⁶.

¹¹⁶ Moduli i PFAL, IGJK, Xhevdet Elshani dhe Mejdi Dehari Provat e papranueshme në procedurën penale.



Ferki Xhaferi

MJETET E JASHTËZAKONSHME TË GODITJES SË VENDIMEVE NË PROCEDURË KONTESTIMORE ME VËSHTRIM MBI KËRKESËN PËR MBROJTJEN E LIGJSHMËRISË

1.1 Mbi mjetet juridike në procedurën kontestimore

Në procedurën kontestimore hasim mjetet e rregullta të goditjes së vendimeve gjyqësore dhe ato të jashtëzakonshme. Ankesa në procedurë kontestimore është mjet i rregullt juridik me të cilën pala e pakënaqur ka të drejtë të kërkojë përmirësimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Ajo quhet mjet i rregullt juridik sepse paraqet pjesë të procedurës së rregullt kontestimore e cila sipas parimit të dy shkallësisë së procedurës mund të shqyrtohet në dy instanca.

Por, në procedurën kontestimore me ligj janë të parapara edhe mjete tjera juridike me të cilat arrihet përmirësimi i vendimeve joligjore të cilat janë sjellë si rezultat i procedurës së parregullt të përfunduar, por me të cilat janë cenuar të drejtat ose interesat juridike të palës, apo është cenuar edhe interesi publikë.

Këto mjete juridike nuk zbatohen rregullisht por në situatë ekskluzive, përkatësisht nën kushte të përcaktuara, të cilat i parasheh Ligjin nr. 03/l-006 për procedurën kontestimore, sepse ushtrohen kundër vendimeve të përfunduara, të plotfuqishme ose të ekzekutueshme, me të cilat procedura e rregullt është përfunduar, ose ndryshe thënë në këto vendime tani më janë krijuar raporte të caktuara civilo-juridike dhe janë fituar të drejtat ose caktuar obligime për palët. Prandaj, situatat e këtilla mund të jenë lëndë e shqyrtimit vetëm nën kushte të veçanta të parapara me ligj. Për këtë shkak

ato quhen mjete të jashtëzakonshme juridike, ndërsa qëllimi i tyre është që të eliminohen gabimet të cilat e cenojnë ligjshmërinë e vendimeve të sjella gjyqësore.

1.2 Mjetet e jashtëzakonshme të goditjes

Gjykata rëndom bie vendime të cilat vendoset mbi një çështje konkrete kontestimore. Këto vendime potencialisht mund të goditen me mjete juridike me qëllim që lëshimet qoftë të karakterit procedural apo material të jetë e mundshme të ri shihen dhe të riparohen. Kur një vendim i gjykatës merr formën e prerë ai e ka fuqinë ligjore dhe mund të ekzekutohet edhe pse ndoshta me të mund të shkelet ligji vendor apo ndonjë marrëveshje ndërkombëtare ndaj të cilës shteti ka marrë zotime se do të ketë fuqi ligjore qoftë përmes zotimit të njëanshëm duke e ingranuar në aktin më të lartë – kushtetutë apo në mënyra të tjera konform rregullativës ndërkombëtare. Me vendimin e formës së prerë dhe të kundërligjshëm, mund të dëmtohet jo vetëm interesi i palës në dëm të së cilës lëshohet vendimi, por njëkohësisht mund të dëmtohet edhe interesi publik.

Një trajtim jo adekuat i rasteve të paraqitura pran gjykatave dhe ku hasen shkelje të ligjit nga vet gjyqësori me anë të vendimeve të kundërligjshme, bënë që të mos jenë plotësuar synimet e ligjvënësist, e ndër të tjera synimi për të krijuar lehtësi për pjesëmarrësit në raporte civilo juridike e njëherit është dekurajuese dhe shndërrohet në pengesë të progresit, kurse një zhvillim i tillë gjyqësorin si shërbim publik e bënë jo të besueshëm.

Me qëllim që të ketë sa më pak vendime të kundërligjshme, të cilat po të ekzekutoheshin do të kishin impakt negativ, të cilat edhe do të ndikonin në besimin e publikut në gjyqësor, ligjvënësi në Ligjin nr. 03/1-006 për procedurën kontestimore, nga neni 211 deri në nenin 251, ka paraparë mjetet e jashtëzakonshme të goditjes, me të cilat synohet të evitohet apo minimizohet paligjshmëria në punën e gjykatave.

1.3 Revizioni

Nga neni 211 i LPK-së parashihen kushtet afatet dhe modalitetet e ushtrimit të revizionit si mjet i jashtëzakonshëm i goditjes. Për këtë mjet të goditjes vendos Gjykata Supreme e Kosovës, në trup gjykues, por paraqitja e këtij mjeti juridik nuk është pengesë për ekzekutimin e vendimit të gjykatës që nënkupton rrethanën se ky mjet ka karakter jo suspenziv. Revizioni mund të paraqitet kundër aktgjykimit të shkallës së dytë brenda afatit prej 30 ditësh

nga dita kur palëve iu dorëzohet aktgjykimi.

Ushtrimi i këtij mjeti juridik është i lidhur edhe për lartësinë e vlerës së kontestit nga se në rastet kur kontesti nuk kalon vlerën prej 3000€ revizioni është i pa lejueshëm. Përjashtim nga kjo rregull janë kontestet lidhur me ushqimin dhe kontestet e punës në të cilat pa varësisht nga vlera e kontestit revizioni është i lejuar. Gjykata e revizionit e shqyrton aktgjykimin e goditur vetëm në kufijtë e përmbajtjes së revizionit dhe vetëm në at pjesë të goditur me revizion, por duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale.

1.4 Vendimet e Gjykatës Supreme lidhur me revizionin

Sikur se vendimet e tjera në lidhje me Revizionin edhe aktvendimi mbi hedhjen poshtë të revizionit jepet nga gjykata e Revizionit në seancë të kolegjit. Gjykata e shkallës së parë nuk është e autorizuar ta hedhë revizionin duke u thirrur se ekzistojnë shkaqet në bazë të së cilave ai nuk mund të ushtrohet atëherë një gjë të tillë mund ta bëjë Gjykata Supreme.

Gjykata e revizionit ka kompetencë që me aktvendim ta hedhë poshtë Revizionin po që se konstaton se nuk është paraqitur brenda afatit të paraparë me ligj si në nenin 211.1 të LPK-së, po që se ai nuk është i plotë apo nëse është i palejueshëm. Gjykata Supreme vendimet e saj në lidhje me Revizionin i jep në formë të aktvendimit. Nga shkak se me vendim të Gjykatës Supreme vendoset mbi çështjen e natyrës procedurale andaj gjykata vendos me aktvendim.

Në rastin në të cilin Gjykata e Revizionit konstaton se Revizioni është i pabazuar për arsye se nuk ekzistojnë shkaqet nga të cilat paraqitet ai e as shkaqet për të cilat Gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, revizioni refuzohet si i tillë dhe vërtetohet aktvendimi i goditur. Në rastet kur kemi të bëjmë me revizionin kundër aktvendimit me të cilin hudhet poshtë ankesa kundër aktgjykimit të shkallës së parë atëherë me refuzimin e revizionit si të pathemeltë plotësohen kushtet që aktgjykimi të mbetet i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm.

Duke qenë se revizioni mund të paraqitet edhe si mjet i goditjes të aktvendimit me të cilat përfundon procedura në shkallë të dytë, në rast se gjykata konstaton se revizioni është i themeltë atëherë ajo jep aktvendim me të cilin e miraton revizionin dhe e prish aktvendimin e goditur si të kundërligjshëm dhe jo të drejtë. Poqë se është rasti me revizionin kundër e

aktvendimit me të cilin priset aktgjykimi i shkallës së parë dhe hudhet poshtë padia atëherë aktgjykimi i anuluar në procedurën sipas ankesës bëhet i formës së prerë dhe ekzekutiv.

Kur revizioni kundër aktvendimit me të cilin hudhet poshtë ankesa kundër aktgjykimit të shkallës parë tregohet si i themeltë, atëherë si pasojë e miratimit të revizionit paraqitet nevoja që në gjykatën e shkallës dytë të mbahet rishtas procedura sipas ankesës së hedhur poshtë. Nëse gjykata e pranon si të themeltë revizionin dhe e anulon aktvendimin e gjykatës së shkallës dytë mbi ankesën e hudhur poshtë, atëherë çështja juridike i kthehet gjykatës së shkallës parë për rigjykim.

Në teori qëndron pikëpamja se gjykata e revizionit vendimet e saja ia dërgon bashkë me dosjen e lëndës, gjykatës së shkallës dytë në numër të mjaftueshëm për palët dhe prokurorin publik², në praktikë dhe në ligj vështirë të definohet se cila gjykatë ka obligim që ta mbajë në dijeni prokurorin publik për vendimet e veta në lëndët kontestimore, madje nuk është definuar as cili prokuror publik, në mënyrë që të krijohen parakushtet për ushtrimin e mjetit tjetër të jashtëzakonshëm, kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Si rekapitullim mund të bimë në përfundim se gjykata e revizionit mund ta aprovoi revizionin, ta refuzoi revizionin, ti anuloi pjesërisht apo plotësisht vendimet e gjykatës të goditura me revizion si dhe ta ndryshoi vendimin e goditur gjyqësor. Dispozitat e LPK-së parashohin edhe mundësinë e ushtrimit të revizionit kundër aktvendimeve me të cilat ka përfunduar procedura në shkallë të dytë gjegjësisht kundër aktvendimeve të formës së prerë. Revizioni është i lejueshëm edhe kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë në rastet kur është vendosur mbi propozimin për përsëritjen e procedurës.

1.5 Përsëritja e procedurës

Palët në procedurën kontestimore mund të paraqesin propozimin për përsëritjen e procedurës dhe me këtë procedura e përfunduar me aktgjykim apo me aktvendim mund të përsëritet po që se janë plotësuar kriteret si në dispozitat e Ligjit nr. 03/1-006 për procedurën kontestimore, mbi këtë mjet të jashtëzakonshëm të goditjes. Kjo sidomos mundësohet po që se palës për çfarëdo arsye nuk i është dhënë mundësia që të marr pjesë në shqyrtimin e çështjes kryesore.

Paraqitja e këtij mjete mundësohet edhe në rastet kur në procedurën e përfunduar ka marrë pjesë në cilësinë e paditësit apo të paditurit personi që nuk mund të jetë palë ndërgjyqës, apo në rastet kur personin juridik nuk e ka përfaqësuar personi i autorizuar, mandej në rastet kur vendimi përfundimtar është marrë si pasojë e veprës penale të gjyqtarit, por edhe kur pala merr dijeni për fakte dhe prova të reja të cilat nuk janë paraqitur më parë dhe që do të mundësonin që për palën të merret vendim i favorshëm.

Ky mjet i goditjes po ashtu është i kushtëzuar me afatin e paraqitjes i cili lejohet pas kalimit të afatit prej 30 ditësh. Ligji nr. 03/l-006 për procedurën kontestimore në nenin 234.3 parasheh edhe afatin përfundimtar për paraqitjen e kërkesës për përsëritjen e procedurës dhe atë pas kalimit të afatit prej pesë vjetësh ky mjet juridik nuk mund të paraqitet, përveç se në rastet kur me ligj taksativisht janë parapa përjashtimet nga kjo rregull.

Propozimin për përsëritjen e procedurës të cilin palët e kanë paraqitur pas afatit ligjor, mandej propozimin e paraqitur si jo të plotë apo të pa lejuar, gjykata e shkallës së parë e hedh poshtë pa mbajtur seancë gjyqësore. Gjykata mund të lejoj përsëritjen e procedurës po që se gjen se për këtë janë plotësuar kushtet ligjore. Është një mundësi tjetër që ka lënë Ligji për procedurën kontestimore ku në rast të aktvendimit refuzues, ankesa kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë me të cilin refuzohet propozimi për përsëritjen e procedurës mund ti paraqitet të njëjtës gjykatë, e cila sipas ankesës vendosë në trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtar. Në rastet kur ky mjet i goditjes është paraqitur për arsyt për të cilat paraqitet revizioni, do të konsiderohet se është paraqit revizioni.

1.6 Aspekti krahasues

Lidhur me mjetet e jashtëzakonshme të goditjes zgjedhjet e ofruara nga ligjvënësit janë të ndryshme por qëllimi i ligjvënësit në parim është që gjithnjë të jap garanci në zbatimin e drejt të ligjit. Përkundrajt të gjitha garancive për rregullsinë e punës së gjykatave, nuk është përjashtuar mundësia që me vendim gjyqësor të cenohet norma juridike e natyrës procedurale ose materiale.

Me qëllim që të evitohet pasoja negative e vendimit të kundërligjshëm, ligjdhënësi përveç mundësive të tjera e parasheh edhe mundësinë paraqitjes së kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër vendimeve të formës së prerë pasi që të ketë përfunduar procedura kontestimore. Me mjetet e jashtëzakonshme të goditjes së vendimeve gjyqësore synohet edhe

njëjtësimi i praktikës gjyqësore i gjykatave në lidhje me zbatimin e ligjit. Një synim të tillë duhet të mbajnë gjykatat kur veprojnë si gjykata të shkallës së dytë në plan të përgjithshëm e të ne sidomos kjo barrë i bie Gjykatës Supreme, që me vendimet e nxjerra të ndikohet që të evitohet praktika e dëmshme me rastet e zbatimit të gabueshëm të normave ligjore sepse praktika e tillë mund të bëhet dukuri gjithsesi e dëmshme në qoftë se nuk jepen mundësitë ligjore për evitimin e praktikës së tillë.

Vështruar nga aspekti krahasues, varësisht edhe nga rregullativa e vendeve dhe synimi për të mbrojtur vlerat e caktuara, çështja e mjeteve të jashtëzakonshme të goditjes është rregulluar në mënyra të ndryshme, madje në legjislacione të ndryshme hasim edhe renditje tjetër të mjeteve të jashtëzakonshme të goditjes së vendimeve të formës së prerë nga ajo që jep Ligji nr. 03/1-006 për procedurën kontestimore. Ajo që është e përbashkët është se në parim janë mjete me karakter devolutiv dhe jo suspensiv të goditjes së jashtëzakonshme me të cilat konform ligjit kërkohet nga gjykata kompetente që të anulohet apo të ndryshohet vendimi gjyqësor i formës së prerë, me të cilin vendim cenohet Ligji vendor apo dispozitat nga Konventat Ndërkombëtare.

Derisa në ligjin në fuqi nr. 03/1-006, renditja e këtyre mjeteve fillon me revizionin si mjet i jashtëzakonshëm i goditjes, legjislacioni frëng në “Code de procédure civile” versioni i plotësuar me 1 maj 2011, dallojmë tjetër renditje ku revizioni është mjeti i dytë i goditjes që më tepër rezulton për shkak të mënyrës së organizimit të sistemit gjyqësor, ngase mjeti i parë i goditjes sipas kodit frëng të procedurës civile është Kundërshtimi Gjykatës së Lartë kurse si mjet i fundit në nenin 604, gjejmë kërkesën për përsëritjen e procedurës. Është mbresëlënëse sidomos neni 581 i po këtij kodi ku ligjvënësi frëng taksativisht parasheh dënimet në rast të përdorimit abuziv me mjete të jashtëzakonshmet goditjes dhe atë dënim me gjobë deri në 3000 Euro.

Legjislacioni kroat përpos që ka abroguar një numër të konsiderueshëm të dispozitave të ligjit të vjetër të procedurës kontestimore, nga hulumtimet e bëra nuk është hasur ndonjë ligj tjetër në lëmin e procedurës kontestimore, përpos Ligjit të vjetër të procedurës kontestimore “Zakona o parničnom postupku” i vitit 1977, dhe zgjedhjet janë po ato që kanë qenë të zbatuara në legjislacionin tonë para se të hynte në fuqi ligji nr. 03/1-006 për Procedurën kontestimore.

Por në ligjin mbi ndryshimet dhe plotësimet e ligjit mbi procedurën

kontestimore “Zakon o izmenama i dopunama zakona o parničnom postupku” nga data 14. korrik 2003, gjejmë zgjedhjet të ligjvënësit kroat të cilat në legjislacionin tonë mungojnë sidomos në procedurat pas vendosjes për vendimet e gjykatës vendore nga ana e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (neni 428a Ligji mbi ndryshimet dhe plotësimet e ligjit mbi procedurën kontestimore të Kroacisë).

Sa i përket dispozitave mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, ligji i vjetër i vitit 1977, ka dhënë zgjidhje adekuate në nenin 398 mbi ekspedimin e vendimeve të gjykatës së revizionit ku decidivisht është paraparë që një kopje e vendimit të gjykatës së revizionit i dorëzohet prokurorit publik kompetent, dispozitë kjo që nuk haset në ligjin në fuqi nr. 03/l-006 për procedurën kontestimore.

Deri sa shumica e legjislacioneve së pari japin përgjigje dhe udhëzime mbi paraqitjen e mjeteve të rregullta të goditjes një qasje tjetër hasim në legjislacionin e Kebekut në Kanada, dhe atë në kodin e procedurës civile të Kebekut “Code de procédur civile du Québec” në nenin 482 gjejmë kërkesën për revokimin e aktgjykimit që nga përmbajtja i përgjigjet propozimit për përsëritjen e procedurës. Edhe në këtë kod mjet i rregullt i goditjes është ankesa që mbulon një gamë të gjerë të situatave. Me faktin që në nenin 492 të po këtij kodi hasim se Prokurori i Përgjithshëm, sipas detyrës zyrtare mund të apeloj kundër vendimit të formës së prerë, në një procedurë dhe mundë të kërkoj mbrojtjen e interesit publik sikur të ishte palë në procedurë, mund të konkludojmë se edhe nëse taksativisht nuk janë parapa këto mjete të jashtëzakonshme, Kodi i Procedurës Civile të Kebekut i ka mbuluar zbrazëtitrat duke i dhënë tagër prokurorit të përgjithshëm që të apeloj çdo vendim të formës së prerë që do të dëmtonte interesin publik e që në Ligjin nr. 03/l-006 për procedurën kontestimore kjo e drejt i rezervohet prokurorit publik dhe atë përmes mjetit të jashtëzakonshëm – kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

2. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, legjislacioni dhe praktika gjyqësore

2.1 Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kompetenca dhe çështjet që kanë të bëjnë me paraqitjen e këtij mjeti juridik të jashtëzakonshëm janë paraparë në dispozitat në neneve 245 deri te neni 251 në Ligjin nr. 03/l-006 për procedurën kontestimore. Ky mjet i jashtëzakonshëm i goditjes së vendimeve të plotfuqishme të gjykatës është

mjet devolutiv dhe jo suspenziv i goditjes së veçantë me të cilin prokurori publik në cilësi të organit shtetëror të autorizuar, kërkon nga gjykata kompetente që të priset apo të ndryshohet vendimi gjyqësor i formës së prerë, me të cilin cenohet Ligji apo Konventa Ndërkombëtare. Karakteri devolutiv i këtij mjeti të goditjes nënkupton që në çështjen juridike në të cilën kishte vendos një gjykatë e rregullt, kompetenca do të transferohet te një gjykatë tjetër e rangut më të lartë. Por ky mjet juridik nuk e ka efektin suspenziv të cilin e ka ankesa e cila suspendon mundësinë e ekzekutimit dhe efektet tjera të vendimeve gjyqësore.

Nga sa u tha më sipër rezulton se e drejta e ushtrimit të këtij mjeti të jashtëzakonshëm të goditjes së vendimeve të formës së prerë nuk i takon as palëve ndërgjyqësve e as pjesëmarrësve të tjerë të Procedurës kontestimore, por ligjërisht kjo e drejtë është rezervuar një organi shtetëror dhe e gjithë kjo për të garantuar një funksionim më të mirë të zbatueshmërisë së ligjit nga se edhe aktiviteti i gjykatave duhet të drejtohet në rend të parë, kah ajo që ashtu siç parashihen edhe të zbatohen dispozitat ligjore.

Edhe në rastet kur për çfarëdo arsye pala nuk ka paraqitur mjet të rregullt - ankesë a mjet të jashtëzakonshëm të goditjes kundër vendimit të formës së prerë, qoftë revizionin ose propozimin për përsëritjen e procedurës, prokurori publik ka të drejtën të paraqes kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër vendimit të formës së prerë. Por kjo nuk e përjashton mundësinë që prokurori publik të paraqes kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë edhe kundër vendimeve gjyqësore të cilat tani më janë goditur me mjete të rregullta të goditjes si dhe me ato të jashtëzakonshme siç është revizioni ose propozimi për përsëritjen e procedurës.

Përmes këtij mjeti juridik do të synohet mbrojtja e ligjshmërisë gjatë ushtrimit të punës së gjykatave të cilat me vendimet e tyre edhe autoritetin që doemos duhet të gëzojnë, të ndikojnë që të evitohen praktikat e gabuara që potencialisht mund të krijohen me zbatimin e gabueshëm të normave ligjore. Qëllimi i ligjvënësit është që të mos lejoi që praktikat e tilla të shndërrohen në përditshmëri gjë që do të mund të ndodh në qoftë se nuk lihen mundësitë përkatëse për pengimin e një paraqitje të tillë. Ky mjet i jashtëzakonshëm, sipas dispozitave të ligjit në procedurën kontestimore është paraparë si institut procedural unik i kompetencës së prokurorit publik kompetent, me qëllim të goditjes së vendimeve të formës së prerë. Si konkluzion nga dispozitat e Ligjin nr. 03/1-006 për procedurën kontestimore, kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund ta paraqet askush tjetër përveç Prokurorit Publik.

Ligjin nr. 03/l-006 për procedurën kontestimore në nenin 249 ka paraparë edhe situatat kur për të njëjtën çështje janë paraqitur dy mjete të jashtëzakonshme juridike dhe atë kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e cila mund të paraqitet si masë e njëkohshme me revizionin. Në ato raste gjykata vendos me një vendim në të njëjtën procedurë për të dyja këto mjete.

Ky nen i mësipërm nuk është vetëm arsyetim i thjesht për mungesën e dispozitave mbi ekspedimin e vendimeve të gjykatës së revizionit gjë që ishte e paraparë me dispozitat e Ligjit të vjetër të procedurës kontestimore nga viti 1977 por njëherit shënon një ndryshim esencial duke qenë se prokurorit publik i lihet mundësia e gjerë e paraqitjes së kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë jo vetëm ndaj vendimeve të cilat do të kenë përfunduar nga gjykata e revizionit. Në këtë mënyrë kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e prokurorit, në një mënyrë a tjetër mbetet si mjet juridik i paralelet dhe një masë plotësuese me revizionin, mjet i cili iu përket te dy palëve ndërgjyqëse në procedurë kontestimore.

Ligji ynë nuk e kufizon mundësinë e paraqitjes së kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, vetëm kundër vendimeve të formës së prerë, me të cilat përfundon procedura para gjykatës së shkallës së caktuar. Një kufizimi i tillë parashihet për paraqitjen e revizionit kundër aktgjykimit (neni 211), dhe revizionit kundër aktvendimit (neni 228 al. 1), e edhe për paraqitjen e propozimit për përsëritjen e procedurës si mjet i goditjes së jashtëzakonshme (neni 232 al. 1).

Duke qenë se palët ndërgjyqëse kanë në dispozicion të tyre mjete të tjera të goditjes së jashtëzakonshme, atëherë për kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të thuhet se është mjet juridik që e ka për qëllim ta siguroj zbatimin e ligjit për interesin publik gjë e cila në disa legjislacione siç u përshkrua më sipër është edhe e definuar me dispozita përkatëse.

Në ligjin për procedure kontestimore janë rregulluar pos tjerash edhe çështjet si në vijim: vendimet gjyqësore të cilat mund të goditen me anë të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë neni 245 par 1 pika a) dhe b) dhe neni 245 par 2; shkaqet për të cilat paraqitet ky mjet neni 247.1 pika a), dhe b) ; afatet e paraqitjes neni 245 par 1; kompetenca gjyqësore për vendosje, kufijtë e shqyrtimit të vendimit të atakuar neni 251, si dhe aspekte tjera të procedurës që duhet të zhvillohet sipas këtij mjeti.

Si parim procedural por edhe parim që del nga dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore, është se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqitet vetëm kundër vendimeve të formës së prerë. Kjo do të thotë se, ky mjet i jashtëzakonshëm mund të paraqitet sikurse kundër aktgjykimeve të formës së prerë ashtu edhe kundër aktvendimeve të formës së prerë dhe pa marrë parasysh se, kush e lëshon një vendim të tillë gjykata e shkallës së parë, apo gjykata e shkallës së dytë. Mirëpo nga parimi i përmendur, ligji prapë se prapë lenë mundësinë për përjashtime.

Në nenin 245 par 3. të LPK-së parashihen edhe rastet kur nuk mund të paraqitet kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë. Ky mjet i jashtëzakonshëm nuk mund të paraqitet kundër vendimit të cilin gjykata e lëshon në lidhje me revizionin, apo kundër vendimit që është vendosur mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë. Ka zëra që pretendojnë se lidhur me mundësinë e paraqitjes së kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë në rastet si më sipër i mbetet praktikës gjyqësore dhe shkencës procedurale që të japë përgjigje në pyetjen, se a mund të paraqitet ky mjet i jashtëzakonshëm edhe kundër vendimeve mbi revizionin dhe mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Duke qenë se Gjykata Kushtetuese shqyrton aspektin kushtetues sipas kërkesës së palëve për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së vendimeve gjyqësore, përfshirë edhe vendimet mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë si mjet i jashtëzakonshëm, themi se ekziston edhe një mundësi më tepër për të konsideruar vendimet gjyqësore mbi mjetet e jashtëzakonshme.

Madje Gjykata kushtetuese shqyrton kërkesat e palëve vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet e mundshme të rregullta dhe të jashtëzakonshme, e në rast se do të lejohej ushtrimi i kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë në vendimet e gjykatës mbi revizionin apo kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë atëherë nuk do të plotësohej kriteri i kërkuar nga Gjykata Kushtetuese si më sipër, kurse shqyrtimi i të njëjtës çështje juridike nga një tjetër trup gjykues i të njëjtës gjykatë, përveç që do të mund të prodhonte efektin e rrethit vicioz, do të mund edhe të krijonte zvarritje të pa nevojshme procedurale e rezultatet nuk do të mund të pritej se do të jen inkurajuese.

Në teori janë paraqitur dilema se a mund të ushtrohet kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë në lidhje me vendimet e formës së prerë të cilat gjykata i jep në formë të aktvendimeve. Sa u përket aktvendimeve me të cilat gjykata vendos mbi çështjet e natyrës procedurale siç janë aktvendimet me të cilat drejtohet procedura, respektivisht mbi çështjet e tjera që nuk kanë cilësinë e

çështjes kryesore, në lidhje me mundësin e goditjes së tyre me anë të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, mbizotëron pikëpamja se këto vendime nuk mund të goditen me anë të këtij mjete të jashtëzakonshëm dhe nuk do të kishte asnjë arsye që të lejohet mundësi e tillë duke qenë se këto vendime mund të goditen në mënyrë indirekte duke u goditur vet vendimi përfundimtarë i cili mbështetet në vendimin e tillë paraprak në qoftë se një gjë e tillë ka ndikuar që edhe vet vendimi përfundimtar të jetë i kundërligjshëm.

Në teori hasim pikëpamje tërësisht të kundërta të cilat pikëpamje justifikojnë mundësinë e goditjes së aktvendimeve me të cilat nuk përfundon procedura kontestimore duke mbështetur këtë në faktin se ligji mbi procedurën kontestimore nuk e kufizon me asnjë dispozitë këtë mundësi e aq më tepër nuk thuhet askund decidivisht se ky mjet i jashtëzakonshëm mund të paraqitet vetëm ndaj aktvendimeve me të cilat përfundon procedura kontestimore. Në shkencë nuk ka pa pajtueshmëri në pikëpamje të mundësisë së paraqitjes së këtij mjete kundër aktvendimeve me të cilat vendoset meritorishtë mbi kërkesëpadinë kurse praktika gjyqësore nuk ka ndonjë qëndrim mohues në këtë pikëpamje edhe pse praktika gjyqësore në lidhje me këtë mjet të jashtëzakonshëm është temë në vete për çka do të flitet në shqyrtimet e mëtejme të kësaj mundësie të jashtëzakonshme. Rrjedhimisht, mund të thuhet se me anë të këtij mjete mund të goditen edhe vendime të tjera të nxjerra në formë aktvendimi gjithnjë kur këto vendime e kanë cilësinë e vendimeve përfundimtare sepse me to përfundon procedura kontestimore.

Sipas ithtarëve të teorisë që synon zgjerimin e gamës së aktvendimeve të cilat do të duhej të mos përjashtohen nga mundësia e trajtimit me këtë ilaç juridik, duke u thirrur në faktin se ngushtimi i gamës së aktvendimeve që do të mund të trajtohen përmes këtij mjete juridik, do të ishte edhe në kundërshtim me praktikën gjyqësore ku pretendohet se në praktikë gjyqësore me anë të këtij mjete të goditjes së jashtëzakonshme përveç aktvendimeve me anë të të cilave përfundon procedura kontestimore hasen situata ku me këtë mjet goditen edhe disa aktvendime të tjera me të cilat nuk ka përfunduar procedura. Kjo pikëpamje nuk mohon faktin se një numër i konsiderueshëm i aktvendimeve megjithatë nuk mund të trajtohen si aktvendime të cilat çmohen si të përshtatshme për tu goditur me këtë mjet të jashtëzakonshëm gjë që këtë spektër aktvendimesh i trajton si aktvendime të cilat nuk mund të goditen me këtë mjet të jashtëzakonshëm.

Parimisht, aktvendimet të cilat nuk mund të goditen me an të ankesës, nuk

mund të goditen as me anë të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë. Rast tipik të aktvendimeve që nuk mund të goditen me anë të ankesës në procedurë të rëndomtë, janë aktvendimet me të cilat drejtohet rrjedha e procedurës kontestimore. Kur flitet për mjetet e rregullta të goditjes së vendimeve të nxjerra në formë të aktvendimeve, një volum i gjerë i aktvendimeve mund të goditen me ankesë e si të tilla mund të goditen edhe me mjete të jashtëzakonshme përfshirë edhe kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, edhe pse në praktikë mund të hasim në përjashtime edhe nga kjo rregull.

2.2 Praktika gjyqësore

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë si mjet i jashtëzakonshëm edhe pse e rregulluar me dispozita të Ligjin nr. 03/l-006 për procedurën kontestimore, përkundër rëndësisë për evitimin eventual të gabimeve gjatë nxjerrjes së vendimeve gjyqësore, është një mjet i goditjes i cili nuk është edhe i shpeshtë në praktikën gjyqësore.

Arsyeja nuk është krejt në faktin se sistemi prokurorial është i mbingarkuar dhe nuk do të kishte mundësi që të merret me çështje kontestimore. Madje nuk mund të arsyetohen zërat të cilët në gjysmë satirë pohojnë se "prokurorët janë penalistë dhe si të tillë nuk mund të civilizohen, nga se janë tepër të penalizuar", kështu që nuk mund të pritet që të adresojnë një çështje civile. Arsyeja më tepër duhet kërkuar në faktin se Ligji nr. 03/l-006 për procedurën kontestimore, për shumë dilema nuk ka ofruar zgjidhje precize duke lënë në shumë çështje pa qartësi dhe zbrazësi juridike në pikëpamje të paraqitjes së këtij mjete të jashtëzakonshëm.

Derisa Kodi Kanadez në mënyrë decisive i jep tagër Prokurorit të Përgjithshëm që të inicioi këtë mjet të jashtëzakonshëm, duke precizuar qartë edhe mënyrën se si ky prokuror vije në dijeni mbi mundësinë e ndërhyrjes përmes këtij mjete të jashtëzakonshëm, dispozitat e Ligjit për procedurën kontestimore në këtë drejtim janë të pakta duke lënë edhe dilema. Kjo sidomos përplaset për zbatuesit potencial të dispozitave të këtij ligji për aq më keq nga se në këtë lëmi nuk kemi ndonjë punim me komente mbi zbatimin e dispozitave të Ligjit nr. 03/l-006 për procedurën kontestimore. Në këto rrethana praktika gjyqësore vepron e dekurajuar për të lënë mundësinë e pakt të veprimet dhe funksionalizimin e zgjedhjeve të ofruara përfshirë edhe kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë si mjet i jashtëzakonshëm i goditjes së vendimeve në procedurë kontestimore.

Në Ligjin për procedurën kontestimore siç u fol përciptazi edhe më sipër, nuk gjejmë dispozita të qarta të cilat rregullojnë mënyrën e dërgimit të çështjes tek prokurori publik kompetent për të ushtruar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, pa precizuar cili prokuror publik kompetent do të duhej ta ngrite këtë mjet, deri sa në rregullativat ligjore komparative qartë precizohet se vendimi mbi revizionin i dërgohet prokurorit publik të shtetit gjegjësisht prokurorit kompetent ku pasi të shqyrtoi revizionin, gjithmonë kur gjen se është prekur interesi publik, qoftë nga nxjerrja e një vendi të kundërligjshëm me të cilin është dëmtuar e drejta e individit e që indirekt mbrojtja e të drejtave të individëve përbënë edhe interes publik, prokurori i shtetit e ngrit kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Duke u përballur me mungesat si më sipër, praktika gjyqësore ka reaguar në mënyra të ndryshme, nga shmangja nga ushtrimi i këtij mjeti për të shmangur edhe mundësinë për të qenë në shënjestër të kritikës për zbatim eventuale të gabuar të dispozitave në lidhje me këtë mjet të jashtëzakonshëm, deri te përpjekjet për imponim të ushtrimit të këtij mjeti nga ana e palëve të interesuara, ku përgjigjet nga ana e prokurorisë kanë qenë gati në kufijtë e dilemës se "pse pikërisht prokuroria të merret me këso çështje, dhe a ka edhe ndonjë gjë tjetër që do të mund të ngarkohej mbi prokurori" e jo zyrtarisht edhe duke shprehur mungesë vullneti për të vepruar sipas autorizimeve të dhëna nga ligji.

Sido që të jetë pas kalimit të afatit për paraqitjen e këtij mjeti nga ana e prokurorit publik, palëve iu lirohet mundësia që ti drejtohen Gjykatës Kushtetuese, nga se mos ushtrimi i këtij mjeti nga ana e prokurorit publik, nuk i jep hapësirë Gjykatës kushtetuese që të thirret në klauzolën se nuk janë shpenzuar mjetet juridike siç u përshkrua më sipër.

Përfundimisht kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është një mjet i jashtëzakonshëm në procedurën kontestimore ushtrimi i të cilit është krye këput në dorë të prokurorit publik kompetent, vërja në funksion e të cilit do të kishte shumë rëndësi në shmangien e vendime të kundërligjshëm gjyqësore e në këtë mënyrë edhe në ngritjen e autoritetit të gjyqësorit përballë publikut të gjerë krejt me qëllim të vënies së drejtësisë në funksion të zbatimit të drejtë të ligjit. Andaj qoftë përmes punimeve me komente të njohur si "komentar" në Ligjin nr. 03/1-006 për procedurën kontestimore, qoftë në forma të tjera prokurorët kompetent duhet të inkurajohen që të ushtrojnë këtë mjet juridik për aq më tepër kur ligji ka lënë mundësi të gjëra për intervenim të prokurorit pa e limituar vetëm në rastet kur është vendosur me revizion.



Fitore Sadikaj

E DREJTA E MBAJTJES (USHQIMISË) SIPAS LEGJISLACIONIT NË KOSOVË

1. Hyrje

Mbajtja apo ushqimi siç njihet në legjislacion dhe teorinë juridike paraqet një institut juridik përmes të cilit i sigurohet mbajtje personit që ka nevojë respektivisht nuk ka mjete të mjaftueshme për ekzistencë dhe plotësimin e nevojave të domosdoshme jetësore. E drejta për të kërkuar mbajtje është e drejtë e garantuar me ligj dhe si e tillë paraqitet si detyrim ligjor për palën e cila sipas ligji është e detyruar të ofroj mbajtje.

Në këtë punim do të trajtohet e drejta e mbajtjes (ushqimit) në këndvështrim me dispozitat ligjore në Kosovë dhe me referenca të caktuara në mënyrën e zbatimit në praktik. Ky vështrim ka për qëllim të sqarohen dispozitat ligjore pasi që përbëjnë bazë të re ligjore me të cilin është rregulluar e drejta e mbajtjes (ushqimit).

2. Kuptimi i mbajtjes (ushqimit)

Me Ligjin e Familjes të Kosovës (këtu e tutje LFK),¹¹⁷ me një sërë dispozitash ligjore është rregulluar e drejta e mbajtjes respektivisht ushqimit, që shpesh quhet edhe si e drejta e alimentacionit. Me këtë institut juridik rregullohet e drejta e personave që nuk kanë mjete të domosdoshme për ekzistencë për të kërkuar mbajtje nga personat që sipas ligjit janë të detyruar të japin mbajtjen.

¹¹⁷ Ligji nr: 2004/32 Ligji për Familjen i Kosovës është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 20 Janar 2006, ndërsa ka hyrë në fuqi me datën 16 shkurt 2006, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.4/2006, date 1 shtator 2006.

Sipas LFK mbajtja financiare nënkupton detyrimin financiar dhe material.¹¹⁸ Sipas këtij kuptimi mbajtja mund të jepet në formë mjeteve monetare por edhe në formë të mirave materiale siç janë: veshmbathjet, ushqimi, etj. Në LFK është përdorur termi mbajtje që nënkupton se është fjala për ushqimin respektivisht alimentacioni, që paraqet një dallim në krahasim me Ligjin për Marrëdhëniet Martesore dhe Familjare të viti 1984 në të cilin përdorej shprehja “ushqimi”.¹¹⁹ Megjithatë, kur bëhet fjalë për mbajtjen e bashkëshortit të pasiguruar dhe fëmijëve LFK përdorë edhe shprehjen ushqim (alimentacion).¹²⁰ Edhe në teorinë juridike përdoren termet mbajtje financiare dhe ushqimi. Mirëpo ky formulim ligjor ka për qëllim të tregoj se detyrimi ligjor i ushqimit nuk ka vetëm qëllimin e dhënies së ushqimit apo edhe veshmbathjes por edhe sigurimin e të mirave tjera materiale dhe financiare të nevojshme për mbajtjen e një personi.¹²¹

Kjo mund të shprehet më së miri për detyrimin e prindërve për të mbështetur financiarisht fëmijët nëse janë në shkollim deri në arritjen e moshës 26 vjeçar.¹²²

Prandaj kuptimi i këtij instituti qëndron në detyrimin ligjor për dhënien e mbështetjes financiare, ushqimit, respektivisht të mirave materiale për ekzistencë për personin i cili sipas ligjit ka të drejtë të kërkoj këtë mbajtje.

3. Shtrirja (përfshirja) e mbajtjes

LFK e ka precizuar edhe shtrirjen e mbajtjes, duke sqaruar se deri në cilën shkallë dhe në çfarë mjeteve duhet të ofrohet një mbajtje. Shtrirja e mbajtjes duhet të jetë adekuate përkatësisht në përputhje me kushtet nën të cilat ka jetuar një person që kërkon mbajtje. Në rast se personi ka jetuar në kushte të rënda, mbajtja duhet të jetë e atillë që siguron së paku një minimum që nevojitet për të mbajtur një jetë të rëndomtë dhe dinjitoze.

Mbajtja përfshinë të gjitha kërkesat e domosdoshme për jetë (veshmbathje, ushqime, strehimin etj) duke përfshirë të gjitha shpenzimet e domosdoshme për shkollim dhe ngritje profesionale.¹²³ Në radhë të parë mbajtja duhet të

¹¹⁸ Ligji i Familjes i Kosovës, neni 278, par. 1.

¹¹⁹ Shih, Ligji martesën dhe marrëdhëniet familjare, Gazeta Zyrtare e KSAK, nr.10/1984, pjesa e gjashtë, neni 273, 279, 284-305.

¹²⁰ Shih, LFK, nenet, 289-316.

¹²¹ Shih, Prof.dr.Abdulla Aliu & Mr.sc.Haxhi Gashi, E drejta familjare, ligjërata të autorizuara, Prishtinë, 2007, fq. 299.

¹²² Shih LFK, neni 290, par. 2.

¹²³ Shih, LFK, neni 285.

ofrohet në para. Mirëpo, ekziston edhe alternativa tjetër, nëse personi i cili është i detyruar për dhënien e mbajtjes nuk ka mundësi financiare.

Në këto raste me leje të Organit të Kujdestarisë, lejohet dhënia e mbajtje edhe në formë tjetër. Ndërsa, çdoherë mbajtja jepet në fillim të muajt në formë të paradhënies.¹²⁴ Duke ju referuar dispozitave ligjore, del e qartë edhe nocioni i mbajtjes, sepse nuk reduktohet vetëm në ushqim por në radhë të parë në dhënien e mjeteve financiare, por gjithmonë duke nënkuptuar plotësimin e nevojave të domosdoshme për jetë normale të një personi.

4. Kushtet dhe personat me të drejtë dhe detyrë për mbajtje

Sipas ligjit vetëm personat të cilën nuk kanë mjete të nevojshme për ekzistencën e domosdoshme e kanë të drejtën për të kërkuar mbajtje.¹²⁵ Personat në vijnë e drejtë të gjakut janë të detyruar të ofrojnë mbajtje në mënyrë reciproke. Kjo do të thotë se një detyrim reciprok ekziston në mes të prindërve dhe fëmijëve, nipit/mbesës dhe gjyshit/gjyshes etj.¹²⁶ Detyrimi reciprok ekziston edhe midis bashkëshortëve. Nën kushtet e caktuar ky detyrim ekziston edhe në mes personave tjerë në gjininë e gjakut siç janë vëllai ose motra, gjininë e adoptimit, (adoptuesi dhe i adoptuari) si dhe në gjininë e krushqisë (detyrimi në mes thjeshtrit dhe njërkës ose njërkut).¹²⁷

Radha e personave për ofrimin e mbajtjes caktohet sipas rregullave të veçanta. Në radhë të parë bashkëshorti ka për detyrë ti ofroj mbajtje bashkëshortit tjetër. Nëse detyrimi ekziston në mes të disa të afërmeve së pari kanë detyrim pasardhësit e pastaj paraardhësit. Për personat në gjini gjaku detyrimi përcaktohet sipas rendit të trashëgimit. Nëse një person i detyruar nuk ka mundësi të ofroj mbajtjen, detyrimi kalon në personat e tjerë që sipas rendit të trashëgimit vijnë në radhë mbas personit që nuk ka mundësi të ofroj mbajtje.¹²⁸ Kur disa persona në rendin dhe pozitën e njëjtë janë të detyruar për dhënien e mbajtjes, në këtë rast detyrimi ndahet në mënyrë proporcionale në mes këtyre personave të detyruar.¹²⁹ Mirëpo, kur disa persona kanë nevojë për mbajtje dhe ndodhen në pozitën e njëjtë sipas ligjit, nëse personi që ka detyrë të ofroj mbajtje nuk është në gjendje që këtë ta bëjë për të gjithë personat, detyrim ndahet në mes të afërmeve tjerë që

¹²⁴ Shih, LFK, neni 286.

¹²⁵ Shih LFK, neni 279.

¹²⁶ Shih LFK, neni 278, par. 2 në lidhje me nenin 280.

¹²⁷ Shih LFK, nenet 289-332.

¹²⁸ Shih LFK, neni 282.

¹²⁹ LFK, neni 282, par. 4.

janë të detyruar derisa të realizohet mbajtja për secilin person në formën që e kërkon ligji.¹³⁰

Nëse personat të cili sipas ligjit janë të detyruar të ofrojnë mbajtje, nuk janë në gjendje që të sigurojnë mbajtje pa i rrezikuar mjetet e tyre financiare të domosdoshme dhe të arsyeshme nuk janë të detyruar të ofrojnë mbajtje.¹³¹ Mirëpo pyetja parashtrahet si do të veprohet në këto raste? Në këto raste detyrimi kalon në personat e tjerë të radhës, e cila llogaritet sipas radhës së trashëgimit, kur janë në pyetje anëtarët e gjinisë së gjakut dhe adoptimit. Një zinxhirë i këtyllë i detyrimit vazhdon derisa ka persona të detyruar. Duhet theksuar, se në mungesë të mjeteve financiare të domosdoshme, legjislativi siguron edhe të drejtën e anëtarëve të familjes, përkatësisht personave me nevojë që të kërkojnë ndihmë sociale edhe nga shteti, përkatësisht Qendrat Sociale Komunale.¹³² Me ligjin për shërbimet sociale dhe familjare (LSHSF) përcaktohet edhe kategoria e personave që gëzojnë të drejtën e ndihmës sociale.¹³³ Edhe fëmijët me sëmundje dhe të meta psikike dhe fizike gëzojnë përkrahje sociale nga shteti.¹³⁴ Ndërsa një vëmendje i është kushtuar edhe kategorive të prindërve që nuk kanë mjete për ekzistencë për të siguruar mjete nga burimet shtetërore.¹³⁵

5. E drejta e bashkëshortit për të kërkuar mbajtje

Bashkëshorti, respektivisht bashkëshortja e gëzon të drejtën e mbajtjes si gjatë ekzistimit të martesës ashtu edhe pas zgjidhjes së martesës. Përderisa ekziston martesë dhe marrëdhëniet familjare zhvillohen në rrjedhë normale e drejta e mbajtjes realizohet normalisht në kuadër të drejtave dhe detyrave të përbashkëta të bashkëshortëve për të kontribuar në mbajtjen e familjes. Gjatë jetës familjare bashkëshortët detyrohen për mbajtje të ndërsjellët, si dhe kur njëri bashkëshort nuk ka mjete materiale.¹³⁶

Në këtë drejtim realizimi i të drejtës së mbajtjes nuk paraqitet si problem. Problemi kryesor parashtrahet gjatë procedurës së zgjidhjes së martesës e

¹³⁰ LFK, neni 284.

¹³¹ LFK, neni 280, par. 1.

¹³² Shih LFK, neni 5; Shih Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare, nr.02/L-17, neni 1.

¹³³ LSHSF, neni 1.3, Përkufizimet, përcakton se “Person në nevojë nënkupton cilindo person që gjendet në territorin e Kosovës, pa marrë parasysh statusin apo vendin e origjinës, i cili ka nevojë për shërbime sociale për shkak: 1) se është fëmijë pa përkujdesje prindërore, 2) të sëmundjes trupore apo aftësisë së kufizuar fizike, 3) të sëmundjes mendore...”.

¹³⁴ Shih Ligji për përkrahje materiale familjeve dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme, nr. 03/L-022, i miratuar me dt.1.16.05.2008, i shpallur me 14.06.2008.

¹³⁵ Shih Ligji nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale, i miratuar me 11.07.2003, i shpallur me 18.08.2003, neni 4.

¹³⁶ Shih Prof.dr. Abdulla Aliu & Mr.sc.Haxhi Gashi, vepra e cituar, fq. 305.

deri në formën e prerë të vendimit gjyqësor si dhe pas zgjidhjes së martesës. Me ligj i njihet bashkëshortit e drejta e mbajtjes kur ka zgjidhje të martesës qoftë me anulim apo me shkurorëzim. Mirëpo një e drejtë e tillë i njihet vetëm nëse plotësohen kushtet e kërkuara me ligj, që në teori përmende si kushte të domosdoshme atëherë kur bashkëshorti: a) nuk është fajtorë për prishjen e martesës; b) nuk është i aftë për punë dhe c) nuk ka mjete të domosdoshme për jetesë.¹³⁷ Kushte të tilla kërkohen edhe sipas LFK. Sipas LFK bashkëshorti i cili nuk ka mjete të mjaftueshme për mbajtje financiare, nuk është i aftë të punoj, ose për arsye të tjera nuk mund të punësohet ka të drejtë të kërkoj mbajtje nga bashkëshorti tjetër, por në përputhje me mundësit e tij financiare.¹³⁸ Një kërkesë e tillë mund ti refuzohet nga gjykata nëse bashkëshorti që kërkon mbajtje është me keqbesim, dhe e ka braktisur bashkëshortin pa ndonjë arsye të bazuar.¹³⁹ Mirëpo, bashkëshorti nuk mund ta realizoj këtë të drejtë nëse bashkëshorti tjetër nuk mund të ofroj mbajtje pa i rrezikuar mjetet e domosdoshme për ekzistencën e tij.¹⁴⁰ Ligji e lejon edhe mundësin e bashkëshorti për të kërkuar mbajtje kur është duke e mbajtur fëmijën e përbashkët dhe për këtë arsye nuk mund të punoj. Gjithashtu, kjo e drejtë mund të kërkohet edhe për rastet kur bashkëshorti është i moshuar dhe nuk mund të punoj, për shkak të sëmundjeve, paaftësisë psikike.¹⁴¹ Duhet thënë se edhe bashkëshorti që jeton në bashkësi faktike por që asnjëri prej bashkëshortëve nuk ka martesë të ligjshëm dhe nuk ka pengesa martesore, i gëzon të gjitha të drejtat sikur bashkëshorti në martesë, duke përfshirë edhe të drejtën e mbajtjes.¹⁴² Mbajtja mund të kërkohet vetëm nëse ekziston nevoja, gjegjësit bashkëshorti nuk ka mjete jetë normale. Nëse bashkëshorti ka mjete dhe të ardhura që realizohen nga pasuria nuk mund të kërkoj mbajtje.¹⁴³ Por Ligji nuk e detyron asnjë person, përfshirë edhe bashkëshortin për të dhënë mbajtje nëse nuk ka mundësi financiare. Kjo do të thotë se nëse bashkëshorti që ka detyrim ligjor për të dhënë mbajtje nuk ka kushte për ekzistencën e tij, apo i rrezikon mjetet e domosdoshme për jetë normale, nuk është i detyruar të jep mbajtje.

Kërkesa për mbajtje paraqitet gjatë procedurës së zgjidhjes së martesës. Kështu me të njëjtin vendim me të cilin gjykata e zgjidh martesën vendose edhe për të drejtën e mbajtjes së bashkëshorti. Nëse kërkesa nuk është paraqitur në procedurën e zgjidhjes së martesë një kërkesë e tillë mund të

¹³⁷ Valentina Zaçe, “Marrëdhëniet martesore sipas legjislacionit shqiptar”, Tiranë, 1999, fq. 155.

¹³⁸ LFK, neni 298, par. 1.

¹³⁹ LFK, neni 298, par. 2.

¹⁴⁰ Shih LFK, neni 280, par. 1.

¹⁴¹ Shih LFK, nenet 300-303.

¹⁴² Shih, LFK, neni 39.

¹⁴³ LFK, neni 304.

paraqitet në procedurë të ndarë gjyqësore brenda 2 viteve nga zgjidhja e martesës nëse janë plotësuar kushtet ligjore: 1) kushtet për dhënien e mbajtjes kanë ekzistuar para zgjidhjes së martesës/shkurorëzimit e deri në seancën kryesore dhe 2) brenda kësaj kohe është shfaqur paaftësia për punë ose ndonjë lëndim trupor apo shëndeti.¹⁴⁴

Mbajtja, respektivisht e drejta e bashkëshorti për mbajtje vazhdon deri sa ekzistojnë kusht ligjore të cilat u përmenden më lartë në bazë të cilave edhe lejohet mbajtja. Me mbarimin e këtyre kushteve, çdonjërit prej tyre i pushon edhe e drejta për të kërkuar mbajtje. E drejta për të kërkuar mbajtje pushon edhe me kalimin e kohës nëse me vendim të gjykatës është caktuar për kohë të caktuar, me vdekjen e cilitdo bashkëshorti, ose me lidhjen e martesës së bashkëshortit i cili kërkon mbajtje.¹⁴⁵

5. E drejta e fëmijës për mbajtje

Mbajtja dhe përkujdesja për fëmijët është detyrim ligjor i prindërve.¹⁴⁶ Detyrimi ligjor i prindërve për ti mbajtur fëmijët vazhdon deri sa fëmija të ketë arritur moshën madhore. Mirëpo, nëse fëmija është në shkollim, ky detyrim vazhdon deri sa fëmija të arrin moshën 26 vjeçare.¹⁴⁷

E drejta e mbajtjes nënkupton ofrimin e kushteve të nevojshme për jetesë si ushqimin, veshmbathjen, strehimin, shkollimin dhe përkujdesjen për fëmijën. E drejta për përkujdesje dhe mbajtje ekziston si për fëmijët e lindur në martesë ashtu edhe për ata të lindur jashtë martesës, respektivisht prindërit e të cilit nuk janë të martuar në kohën e lindjes së tij.¹⁴⁸ Në këtë mënyrë LFK i ka barazuar plotësisht fëmijët martesor dhe fëmijët jashtëmartesor sa i përket të drejtave dhe detyrova, përfshirë edhe të drejtën e mbajtjes. Fëmijët e gëzojnë të drejtën e përkujdesjes si gjatë jetës së përbashkët me prindër por edhe atëherë kur jetojnë të ndarë me prindërit e tyre. Fëmijët mund të jetojnë ndaras nga prindërit në situata të ndryshme prej të cilave duhet veçuar, ndarjen e bashkëshortëve ose kur prindërve ju kufizohet e drejta prindërore apo ju merret në tërësi. Përderisa zhvillohet jeta normale familjare dhe fëmijët jetojnë së bashku me prindërit, e drejta e mbajtjes realizohet në kuadër të jetës së përbashkët. Por edhe gjatë zhvillimit të kësaj jete, fëmijët e kanë të drejtën për të kërkuar nga prindërit

¹⁴⁴ LFK, neni 316.

¹⁴⁵ Prof.dr.Abdulla Aliu & Mr.sc.Haxhi Gashi, veper e cituar, fq. 309.

¹⁴⁶ Shih LFK, neni 3, pika 2 në lidhje me nenin 290, par. 1

¹⁴⁷ LFK, neni 290, par. 2.

¹⁴⁸ LFK, neni 3, pika 4.

realizimin e përkujdesjes dhe ushqimit, nëse një gjë të tillë nuk e kryejnë prindërit. Mospërkujdesja ndaj fëmijëve përfshirë edhe mbajtjen mund të sjell sanksionin juridiko-familjar për prindër në kufizimin ose marrjen e të drejtës prindërore. Mirëpo edhe nëse prindit i merret apo i kufizohet e drejta prindërore, prindi nuk lirohet nga detyrimi për dhënien e mbajtjes për fëmijën e tij.¹⁴⁹

Kur ka zgjidhje të martesës detyrimi i prindërve për mbajtjen e fëmijëve vazhdon edhe pas zgjidhjes së martesës. Me të njëjtin vendim me të cilin zgjidhet martesa, mund të caktohet edhe detyrimi i prindërve për mbajtje.¹⁵⁰ Gjykata me vendim cakton se te cili prind mbesin fëmijët për përkujdesje. Ndërsa prindit tjetër i cakton detyrimin për ofrimin e mbajtjes financiare. Nëse e detyrimi i mbajtjes nuk është caktuar me vendimin e gjykatës për zgjidhjen e martesës, një e drejtë e tillë mund të kërkohe më vonë në procedurë tjetër.¹⁵¹

Kur prindërit arrin marrëveshje lidhur me mbajtjen e fëmijëve, gjykata ka kompetencë të vendos se marrëveshja a është në interes të fëmijëve. Nëse marrëveshja nuk është në interes të fëmijëve gjykata mund të vendos ndryshe.¹⁵² Vendimi i gjykatës lidhur me besimin e fëmijëve për mbajtje mund të ndryshohet me kërkesën e njërit prind nëse ndryshojnë kushtet dhe rrethanat në të cilat gjykata e ka bazuar vendimin, si. p.sh prindi që përkujdeset për fëmijën nuk e ushtron si duhet këtë detyrim, ose prindi i cili ofron mbajtjen financiare nuk ka mjete të nevojshme për ekzistencën e tij. Një detyrim i prindërve për ti mbajtur fëmijët ekziston edhe pas arritjes së moshës madhore të fëmijës, nëse fëmija vuan nga ndonjë sëmundje psikike apo fizike dhe derisa zgjasin këto rrethana.¹⁵³

7. E drejta e prindërve për të kërkuar mbajtje

Me ligj është caktuar detyrimi i të gjithë anëtarëve të familjes për të dhënë mbajtje për anëtarët e tjerë të afërm. Një detyrim i tillë ekziston edhe për fëmijët për t'u përkujdesur për mbajtjen e prindërve të tyre nëse këta nuk kanë mjete për jetesë, janë të moshuar apo nuk janë të aftë për punë.

¹⁴⁹ Më gjerësisht shih, LFK, neni 293.

¹⁵⁰ Shih Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë, C.nr. 288/07. Me këtë vendim gjykata e ka zgjidhur martesën dhe ka caktuar besimin e fëmijëve njërit prind, ndërsa po me të njëjtin vendim gjykata ka caktuar edhe detyrimin e prindit tjetër për dhënien e mbajtjes 100 euro për secilin fëmijë. Po ashtu shih Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë, C.nr.95/06.

¹⁵¹ Shih Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, C.nr. 619/2008.

¹⁵² Shih, LFK, neni 325, par. 2.

¹⁵³ Shih LFK, neni 291.

Mirëpo gjykata mund të refuzoj kërkesën e prindit për mbajtje nëse prindit ju ka marrë e drejta prindërore ose vetë prindi nuk ka ofruar mbajtje për fëmijën e tij.¹⁵⁴

Një vendim i tillë vjen në konsideratë pasi që kjo do të paraqet padrejtësi ndaj fëmijës, përderisa prindi nuk është kujdesur për fëmijën e tij në kohën kur ka pasur kusht dhe ka qenë i detyruar për përkujdesje ndaj fëmijës.

8. Përfundimi

1. E drejta e mbajtjes (ushqimit) është një institut i cili në mënyrë të specifikuar është rregulluar me ligjin në fuqi. Një e drejtë e tillë ekziston në mes të gjithë anëtarëve të familjes. Mbajtje mund të kërkojë vetëm personi që ka nevojë për mbajtje, dhe plotësohen kushtet specifike të caktuara me ligj, kurse mbajtjen duhet ta jap personi që sipas ligjit është i detyruar për mbajtje. Radha e detyrimit për të dhënë mbajtje caktohet sipas radhës së personave që thirren në trashëgim, fillimisht pasardhësit e pastaj paraardhësit e personit që kërkon mbajtje.

2. Bashkëshortë mund të kërkojnë mbajtje gjatë martesës si dhe pas pushimit të martesës. Pas zgjidhjes së martesës e drejta e mbajtjes (ushqimit) rrjedhë vetëm nëse bashkëshorti nuk ka mjete për jetesë, është i pa aftë për punën dhe nuk është fajtor për prishjen e martesës. Në anën tjetër për tu realizuar kjo e drejtë, bashkëshorti tjetër duhet të ketë mjete të mjaftueshme për të dhënë mbajtje.

3. Fëmijët e gëzojnë të drejtën e mbajtjes si gjatë jetës së përbashkët me prindër ashtu edhe në rast të jetës së ndarë. Prindërit kanë detyrim ligjor për mbajtjen e fëmijëve edhe kur jetojnë ndarazi me ta si rezultat i prishjes së martesës apo kur prindit i merret fëmija për shkak të marrjes së drejtës prindërore. E drejta e fëmijës për të kërkuar mbajtje vazhdon deri në moshën madhore. Në rast se fëmija është duke vazhduar shkollimin, kjo e drejtë vazhdon deri në arritjen e moshës 26 vjeçare.

4. Ligji parasheh të drejtën edhe për prindër për të kërkuar mbajtje nga fëmijët nëse ata nuk kanë mjete për jetesë ose janë të pa aftë për punë. Por një e drejtë e tillë mund të realizohet vetëm nëse prindërit i kanë përmbushur detyrat e mbajtjes ndaj fëmijëve në kohën kur prindërit kanë pasur detyrë dhe kushte për ta realizuar mbajtjen.

¹⁵⁴ Shih LFK, neni 294.

5. Në të gjitha rastet, e drejta e mbajtjes mund të kërkohet vetëm me procedurë gjyqësore. Vendimi i gjykatë lidhur me vendosje për mbajtje mund të ndryshohet kur ndryshojnë rrethanat që kanë sjell vendimin gjykatës për mbajtje.



Zef Prenrecaj



Shpend Krasniqi

TAKTIKA E PYETJES SË FËMIJËVE DHE TË MITURVE NË PROCEDURËN PENALE

1. Hyrje

“Drejtësia për të miturit është pjesë përbërëse e procesit të zhvillimit kombëtar të çdo vendi, në kuadrin e përgjithshëm të drejtësisë shoqërore për të gjithë të rinjtë, duke kontribuar kështu, njëkohësisht, në mbrojtjen e të rinjve dhe në ruajtjen e paqes dhe të rendit në shoqëri”.¹⁵⁵

2. Taktika e pyetjes së fëmijës

Thëniet e fëmijëve dhe të rinjve nuk duhet konsideruar si të pasigurta. Por, në çdo rast është e nevojshme që ato të shqyrtohen. Sidoqoftë, është me rëndësi të veçantë që thëniet e fëmijëve t’u ofrohet kujdes i madh sikurse edhe thëniet e të rriturve, për shkak të sugjestionit të tyre të madh, fantazisë më të shprehur dhe zhvillimit më të dobët të menduarit.

2.1 Faza e parë e zhvillimit të fëmijës

Faza e parë e zhvillimit të fëmijës¹⁵⁶, në të cilin ai jeton në botën e tij meditative bashkë me gjësendet rreth saj, konsiderohet si fazë e shpjegimit aktiv. Kjo fazë zakonisht zgjat prej 2 deri 4 vjeç. Fëmija në këtë moshë praktikisht mezi merret si dëshmitar sepse kufjet e vrojtimit dhe fantazmës i ka mjaft të pasigurt dhe të luhatshëm. Thëniet e tyre i shfrytëzon kryesisht për orientim lidhur me atë se ku mund të gjendet prova. Mirëpo, praktika i njeh dëshmitaret prej moshës 3 deri 4 vjeç, të cilët kanë bërë thënie të caktuar dhe të sakta. Megjithatë, edhe në këto raste, fuqia e provës nuk ka

¹⁵⁵ Neni 1.4. – Tërësia e Rregullave Minimale të Kombëve të Bashkuara në Lidhje me Dhënien e Drejtësisë për të Mitur (Rregullat e Pekinit), Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme, në rezolutën e saj 40/33 të 29 nëntorit 1985, Përmbledhje Aktesh Ndërkombëtare, Tiranë, 1994, fq. 205.

¹⁵⁶ Latifi, V., Kriminallistika, Prishtinë, 2006, fq. 145.

qëndruar aq në vetë thënien se sa në përcaktimin e fakteve në bazë të thënieve.

2.2 Faza e dytë e zhvillimit të fëmijës

Faza e dytë e zhvillimit të fëmijës¹⁵⁷ vazhdon prej moshës 4 deri në 8 vjeç dhe kjo është shumë me rëndësi. Në këtë fazë kalohet në vrojtimin e gjërave dhe të ngjarjeve ashtu si ato duken në realitet. Interesimi për realitetin zgjohet prej këtu. Fëmija tani përpiqet ta kuptoi lidhshmërinë e brendshme të procesit, të ngjarjes dhe të gjërave. Kërkon shpjegime për të gjitha, është plotë kureshtje. Fëmija fillimisht flet për vrojtimet optike.

Në fazat e më vonshme fëmija tregon për ndodhitë akustike, për shembull, reprodukon fjalët e tjetërkujt. Rrallë ndonjë fëmijë në moshën 8 vjeçare mund të tregojë se çfarë ka menduar apo ndjerë në moment të caktuar. Rrezikun më të madh në këtë fazë e paraqet sugjestionimi i madh i fëmijës. Këtë burim të skenimit të së vërtetës e rrit edhe fakti se në atë moshë fëmija nuk mund të rrëfej në mënyrë të lidhur.

Pyetjet abstrakte nuk i kupton dhe në çdo konkretizim të pyetjeve rritet rreziku nga sugjestionimi. Përveç kësaj fëmija nuk i ka të qarta nocionet. Të dhënat për kohën janë plotësisht të pasigurta: “sot”, “dje”, “nesër” i ngatërron.

2.3 Faza e tretë e zhvillimit të fëmijës

Faza e tretë e zhvillimit prej viteve 9 deri në 12, më së shumti e cilëson etja, kureshtja për njohje, e cila shpije kah aftësia e plotë për vrojtim¹⁵⁸. Në fund të kësaj faze fillon mosha e pjekurisë (pubertetit). Fëmija fillon të meditojë për vetveten, përcjellë zhvillimin e tij dhe largohet nga mjedisi i tij. Pjesa më e madhe tyre kërkon zgjidhjen e problemeve të vështira me tërheqje me vetvete. Personaliteti i tij tani është aq shumë në qendër të vëmendjes sa që vërehet qartazi.

3. Pyetësi për përcaktimin e personalitetit të fëmijës

Teoria dhe kriminalistika e kanë formuar pyetësin, i cili ndihmon në përcaktimin e personalitetit të fëmijës. Ky pyetësor është krijuar në vitin

¹⁵⁷ Po aty fq. 145

¹⁵⁸ Latifi, V., Kriminallistika, Prishtinë, 2006, fq. 145.

1923. Prej atëherë ai është botuar në shumë libra e revista dhe vërtet ka vlerë të madh për praktikën. Mund të shfrytëzohet me modifikim edhe në përcaktimin e personalitetit të fëmijës parashkollor. Pyetëtori ka këto rubrika:¹⁵⁹

- emrin, mbiemrin dhe moshën e fëmijës;
- në cilën masë informanti ka pasur rast ta njohë fëmijën (sa vjet i mëson fëmijët, sa kohë i jep mësim fëmijës që ne na intereson, numri i nxënësve në klasë etj.);
- shkalla e zhvillimit trupor (pjekuri e hershme apo fëmijë i prapambetur, sëmundje e gjatë, konstatimin e mjekut të shkollës apo ndonjë mjeku tjetër);
- shkollimi (a e ka përsëritur klasën, a ekzistojnë pengesa në zhvillimin shpirtëror, a ka ndjekur shkollë për hendikopatë);
- mendimi për pjekurin shpirtërore të fëmijës (talenti, zhdërvjelltësia shpirtërore, topitja, shpjegimi i vlerësimeve kryesore);
- aftësia e të folurit (flet me shkathtësi, vështirë, belbëzon);
- aftësia e të vërejturit (saktësisht apo sipërfaqësisht);
- aftësia e të mbajturit mend (shkalla e sigurisë së reproduktimit e të përjetuarit, të rrëfyerit gojorë rrëfyerit gojorë, me shkrim);
- veprimi i fantazisë (si shfaqet ajo, p.sh., në lojë të lirë, në vizatim e në modelim të lirë, në rrëfim, në fajësim e rrejshëm të shokëve etj.);
- qëndrimi intelektual ndaj të përjetuarit (p.sh. pjesëmarrja në mësim, mos kujdesi, përgjumshmëria, mendjelehtësia, qëndrimi i dalluar kritik ose jo kritik);
- sjellja ndjemore (topitja, shkalla e përmbajtjes, ndjeshmëria, imitimi, zemërimi, hakmarrja dhe sadizmi);
- sjellja morale (sjellja në shkollë dhe jashtë saj, qëndrimi ndaj shokëve, vlerësimi i sjelljes);
- sjellja seksuale (naiviteti, kërshira seksuale, gjendja e arsimimit seksual, vërejtja e fëmijës rreth përjetimit seksual të tjetrit, jeta seksuale imagjinatave, bisedat seksuale, mbishkrimet e vizatimeve, punët seksuale, qëndrimi erotik i hershëm ndaj personave të gjinisë tjetër ose të së njëjtës, ndaj shokëve ose të rriturve, xhelozia e natyrës seksuale);
- vetëdija (krenaria, spitullimi në veshje e në qëndrim, vetëkënaqësia, dëshira për të luajtur rol, xhelozia e natyrës jo seksuale, shkallët e shfaqjes së jo vetëdijes, me inat, me modesti, thjesht me

¹⁵⁹ Latifi, V., Disa Vrojtme Mbi Sjelljet Delikuede të të Miturve dhe Fëmijeve, „E drejta nr.1“, Prishtinë, 1997, fq. 34 – 35, cituar sipas Vodeneliq, V. Kriminalistika, 1981, fq. 213 – 214.

- vetëkënaqje, në mënyrë të tërhequr, me frikë etj.);
- sjellja e fëmijës ndaj mësuesit dhe ndaj të rriturve (në mënyrë naive, të natyrshme, me besim, përshtatshëm, bezdisshëm, tërheqeshëm, frikshëm, luhatshëm, evitueshëm etj.);
- ndikimi i mjedisit në shtëpi dhe në shkollë (pozita shoqërore dhe sjellja normale e prindërve, stabilizimi i jetës familjare, edukata shtëpiake, ndikimi i vëllezërve he motrave, i shokëve në lojë, i shokëve të shkollës);
- atmosfera në klasë dhe vartësia e fëmijëve për të;
- konstatime, vërejtje të tjera (autoriteti i fëmijës, talenti në sport, dëshira për lexim, interesimi për literaturë, shkuarja e shpeshtë në kinema, në ballo, në disko klube etj);
- mendimi i përgjithshëm i informatorit për vërtetësinë e fëmijës – vërtetësia morale, vërtetësia psikologjike, fëmija vetëdashës, gënjen lehtë, tejet rrenacak, ndoshta periodikisht ndryshe, besnikëria e të kujtuarit, sugjestiviteti, fantazia zbukuruese etj);
- mendimi i posaçëm për përshtatshmërinë që fëmija të paraqitet në gjyq si dëshmitar (i sigurt, më pak i sigurt, plotësisht i sigurt, dëshmitar i rrezikshëm);

Në bazë të këtyre 20 pikave, organi që zhvillon procedurën ose pyetësi përcakton personalitetin e fëmijës ose të riut. Ai duhet të krijojë portret plastik për fëmijën, ta fitojë përshtypjen personale për dëshmitarin e vogël. Këto përshtypje duhet të shënohen në letër në formë të posaçme, në bazë të pyetësorit. Në praktikë do të ishte rrezik shumë i madh të nënçmohen mundësitë dhe shkalla e pjekurisë së fëmijës. Është rrënjësor mendimi shumë i gabuar se fëmijët nuk i kuptojnë shumë gjëra të cilat kinse janë rezervuara vetëm për njerëzit e rritur.

Fëmijët shpejt kuptojnë çfarë mendimi dhe sjellje pritet prej tyre, prandaj dinakërisht shtiren dhe i fshehin ndjenjat e tyre të vërteta. U përshtaten sa për sy e faqe kërkesave, duke u shtirur se nuk dinë asgjë për "çështjet e ndaluara", vetëm që të rriturve mos t'ua prishin "lojën".

Në këtë mënyrë, të rriturit arrin rezultate pedagogjike tejet negative. Fëmijët krijojnë fshehurazi rrethin e tyre jetësor dhe në dritën e vërtet tregohen vetëm para moshatareve të tyre, duke u mbyllur para të rriturve, të cilët janë rrethuar aureolën e autoritetit të pagabuar. Fëmijët shpesh mësojnë të nxjerrin fitim nga pamja e gabuar që për ta krijojnë të rriturit dhe kur bëjnë faj arsyetohen me "me mos dijen fëmijërore". Kjo vlen edhe për çështjet seksuale: Fëmijët e kuptojnë menjëherë se ato gjëra nuk duhen t'i

përmendin para të rriturve, se ato për ta janë të ndaluara. Kështu është krijuar jeta e dyfishtë fëmijërore: mendojnë një gjë ndërsa tjetër gjë flasin para prindërve.

Si rezultat i kësaj pedagogjike të gabuar, kur organi i procedurës ose punëtori social i pyesin prindërit a është e zgjuar tek fëmijët e tyre kureshtja seksuale, ata me bindje të plotë do ta mohojnë. Rrenën te fëmijët dhe te të rinjtë duhet kuptuar në mënyrë serioze pedagogjike. Rrena është fillimi dhe vazhdimi i bastardimit të karakterit të njeriut.

Nëse shndërrohet në shprehi, bën që ai person të jetë i pamoralshëm dhe i dëmshëm për mjedisin social, prandaj trajtohet si i padëshirueshëm. Ai që rren edhe shpif, trillon dhe vjedh. Nga rrenacaket rekrutohen spiunët dhe tradhtarët.¹⁶⁰

Imagjinata intensive jo rrallë bën që fëmija ta trillojë bindshëm dhe ta paraqes situatën në të cilën nuk mashtrohen vetë e të tjerët, por vërtetë beson në frytin e imagjinatës së tij.

Hajmann Kinderaussagen Halle thotë:¹⁶¹ "Loja me thënien është vetëm formë e caktuar e lojës së fëmijës në përgjithësi, thënia e fëmijës shpesh është vetëm shprehje loje e shfaqjeve subjektive momentale, së cilës nuk është e domosdoshme t'i përgjigjet diçka objektive ose ajo është shumë larg". Fëmija me këtë rast, shumë herë jeton në botën fantastike të krijuar për te, e mbron nga sulmet të jashtme nëse ajo është në dyshim - me kokëfortësi të madhe. Në këtë rast shpesh kemi të bëjmë me diçka të tepruar, zmadhim ose zvogëlim të fotografive reale të kujtesës, fëmija i dallon tiparet nga një kompleks i kujtesës dhe i futet një kompleks tjetër, e shpesh - e kjo është në të vërtetë arritja më karakteristike e fantazisë kombinuëse - shkrihen komplekse të tëra të shfaqjes me komplekset tjera.¹⁶²

Me rastin e zbatimit të parimit të shpejtësisë së pyetjes, nuk është e këshillueshme që fëmijët të pyeten pasdite ose në mbrëmje, por ky proces duhet të kryhet paradite, kur fëmija është i zgjuar dhe i pushueshëm. Fëmija nuk duhet ta pres pyetjen. Hapi i parë i pyetjes së fëmijës është largimi i frikës dhe vënia e kontaktit. Nëse pyetet fëmija që e vijon shkollën, koha më optimale e pyetjes mund të zgjasë 45 minuta. Nëse pyetja vazhdohet, pauza

¹⁶⁰ Breda, R., Pedagogjia Familjare, Pejë, 2003, fq. 314.

¹⁶¹ Cituar sipas Vodeneliq, V., Kriminalistika, Prishtinë, 1981, fq. 203.

¹⁶² Latifi, V., Kriminallistika, Prishtinë, 2006, fq. 148.

është e domosdoshme.¹⁶³ Vështirësitë dhe pengesat që paraqiten me rastin e pyetjes së fëmijëve dhe të të miturve më shumë janë pasojën e jo profesionalitetit dhe veprimit të gabuar tekniko - taktik sesa e vetive psikologjike të tyre. Prandaj, procesi i përgatitur mirë e në mënyrë profesionale i pyetjes do të sjellë rezultate të dobishme dhe të sigurta. Për çfarë motivosh gënjën fëmija, Locard shpjegon:¹⁶⁴

1. fëmija gënjën për tu mbrojtur,
2. fëmija gënjën, sepse i nënshtrohet sugjestionit,
3. fëmija gënjën nga smira, kënaqësia,
4. fëmija gënjën për shkak të dizekuilibrit seksual.
5. fëmija gënjën, sepse nuk është i vetëdijshëm për pavërtetësinë e thënieve të tij.

Thëniet e fëmijëve mund të jenë të sakta me besnikëri fotografike, por mund të jetë edhe prodhim i thjesht fantazisë. Fëmijët prej moshës 7 deri 9 vjeç, respektivisht 10 vjeç mund të jenë dëshmitar të shkëlqyeshëm. Prej 8 deri 10 vjeç duhet të marrin parasysh një faktor të ri me rastin e vlerësimit të thënies së fëmijës: gjininë. Djemtë në këtë moshë janë shumë të interesuar për të gjitha aktivitetet jetësore. “Psikologjia naive është e mendimit se nga goja e fëmijëve del vetëm e vërteta. Sipas saj fëmija nuk di të gënjëjë, ai është “shpirt” i pastër. Thëniet e djemve dhe vajzave gjithsesi kërkojnë verifikim të kujdesshëm.

Organi procedues nuk guxon kurrë të flas me fëmijë me ton fëmijëror. Ai do të pyes me seriozitet dhe me urtësi, pothuaj si të rriturit. Do të sillën ndaj tyre si me ndonjë të barabartë me të. Do të shprehet në mënyrë të qartë me fëmijën dhe nuk do ta pyes për gjërat që ai nuk do t’i kuptoi. Esenca e taktikës së pyetjes shtrohet në mënyrën: kur pyetësi ia arrin të zhvillojë bisedë të gjallë, shtiret se për çështje penale di çdo gjë ka herë, duke u paraqitur me e gjithëdijeshmerisë dhe pagabueshmërisë, ndërsa bisedën e zhvillon se, gjoja ende i lipset të sqarohen disa hollësi; gradualisht pa e diktuar fëmija, futet në bisedë të thellë, intensive dhe interesante me pyetje kritike, të maskuara në shumë pyetje neutrale.

Fëmijët në të shumtën e rasteve janë sugjektiv, veçmas para autoritetit të të rriturve. Për këtë arsyeje, rëndësi shumë të madhe ka ajo që fëmijës, menjëherë, prej fillimit, sa herë që është e mundur, mos t’i jepet mundësi

¹⁶³ G. Dudycha e t.j., Pssychlogy For Low Enforcement Officers, Springfild, 1985, fq. 85.

¹⁶⁴ Cituar sipas Vodineliq, V., Kriminalistika, Prishtinë, 1981, fq. 204-205.

dhe kohë të bisedojë me prindër, me fëmijë e persona të tjerë e të marrë në vete ndikimin e sugjestionimit.

Fëmijët me fantazi të zhvilluar mund ta imponojnë thënie nën ndikimin e filmit, të literaturës dhe të mjeteve tjera të informacionit ose të thashethemeve e të mjedisit e të shokëve të shkollës etj. Fëmija nuk duhet të pyetet vetëm për veprimin e kryerjes së veprës penale, por edhe për situatën në të cilën ka ndodhur vepra dhe për shumë rrethana shqetësuese e sidomos për ato që kanë të bëjnë me rrethana jetësore. Sa më shumë që thënia kufizohet në të treguarit e kryerjes së veprës penale në vakum dhe pa dimensione kohore, ndërsa gjithnjë e më shumë gërshetohet me një kuadër ngjarjesh dhe me parashtrimin e reaksioneve psikike, si edhe me sferën jetësore individuale të të pandehurit – me sigurinë më të madhe mund të vërtetohet se kryes është vetëm i pandehuri ose anasjelltas.¹⁶⁵

4. Taktika e pyetjes së të miturve

Në trajtimin e të miturve si kryerës të veprave penale, rëndësi të madhe ka moshja e tyre e adoleshencës në veçanti. Fjala adoleshencë vjen nga latinishtja “adolescere” që do të thotë “rritem” ose “piqem”, martohem. Është një etapë e zhvillimit social, emocional dhe intelektual që e zhvendos të riun drejt të rriturit. Është një periudhë rritje midis fëmijërisë dhe moshës së rritur. Kjo është krejtësisht dukuri sociale dhe kulturore. Fillimi dhe fundi i adoleshencës është i ndryshëm jo vetëm në kultura të ndryshme, por edhe në individ të veçantë. Sido çoftë, është një moshë e ndërmjetme të cilën duhet ta kalojë duhet ta kalojë çdo njëri për të arritur pjekurinë dhe statutin e të rriturit.

Pjekuria ose maturimi, është ajo gjendje apo moshë e jetës kur personi e kompletton zhvillimin e tij fizik, emocional, shpirtëror, social dhe intelektual. Formimi i një prej cilësive të mësipërme nuk presupozon formimin e njëkohshëm dhe të cilësive të tjera. Katërmbëdhjetë vjeçar që është pjekur fizikisht, mund të jetë pjekur edhe në sfera të tjera. Kjo është një nga veçorit e adoleshencës. Puberteti është periudha kur individi arrin pjekurin seksuale dhe bëhet i aftë të riprodhojë vetën. Ky është koncepti i ngushtë i pubertetit. Ndërsa koncepti i gjerë i tij presupozon disa vjet gjatë të cilave zhvillimi fizik lidhet me pjekurin graduale seksuale, me formimin e karakteristikave primare dhe sekondare seksuale. Zhvillimet e adoleshencës marrin ngjyrë të theksuar sociale dhe psikologjike, ato reflektohen kryesisht

¹⁶⁵ Latifi, V., Kriminallistika, Prishtinë, 2006, fq. 149.

në raportet që krijojnë adoleshenti me të rriturit dhe moshataret, në qëndrimin që mban ndaj vetes dhe në përcaktimin e vendit të vet në shoqërinë e të rriturve.¹⁶⁶

Tashmë njihet roli i lëvizjes demografike në fushën e kriminalitetit. Në shumë shtete në kohën e zhvillimeve intensive ekonomike, politike e shoqërore, masë e madhe banoresh të zonave e rajoneve të ndryshme kanë lëvizura duke u përqendruar në qytete apo qendra të reja industriale. Kur këto përqendrime bëhen masive, praktikisht vështirësohen mundësitë për kushte normale jetese. Duke shikuar për rolin e zhvillimeve demografike ndaj kriminalitetit në Shqipëri, Papandilje¹⁶⁷ thekson se, zhvillimet demografike kaq spontane, të çrregullta, jashtë çdo regjistrimi, vrojtimi i kontrollit sollën rezultatin që përjetohet.

Mijëra e mijëra fëmijë e të rritur merren duke shitur rrugëve me synimin që të mbajnë familjen nga kërcënimi i urisë. Shumë të tjerë i drejtohen detit dhe maleve për në shtetet fqinjë. Vajzat bëhen pre e prostitucionit, elementet e ndikuara nga papunësia dhe rruga, rritin radhët e të inkriminuarve, për rrjedhojë kriminaliteti zgjerohet.

Kriminaliteti i të miturve është pjesë përbërëse e kriminalitetit në përgjithësi. Në shumë vende, ai studiohet veçmas nga kriminaliteti i të rriturve. Studimi i tij ka rëndësi të veçantë. Njohja dhe parandalimi i tij është një ndër drejtimet kryesore në shoqërinë e sotme. Kohët e fundit, kriminaliteti i të miturve, është vënë në qendër të studiuesve kriminologjik dhe kriminalistik. Studime të ndryshme kanë treguar se numri i të miturve të inkriminuar po rritet, ndërkohë që edhe numri i krimeve të drejtuara ndaj tyre po rritet në mënyrë të ndjeshme. Me kriminalitetin e të miturve do të kuptojmë tërësinë e krimeve të kryera nga personi nën moshën 18 vjeç. Në rast se do t'i përmbahemi përkufizimit juridiko – penal, veprat e kryera nga personat nën 14 vjeç nuk mund të llogariten në këtë tërësi. Realiteti tregon se një pjesë e të rinjve e fillon aktivitetin kriminal që nga mosha e hershme. Statistikat zyrtare në Shqipëri,¹⁶⁸ për shembull edhe në botë tregojnë se fëmijët e këtyre moshave kryejnë krime të rënda si: vrasje, vjedhje, përfshihen në trafikimin e drogës etj.

Taktika e pyetjes së të miturve varet nga pozita e tyre procedurale (dëshmitar ose i pandehur) dhe nga disa veçori psikike që kanë të bëjnë me

¹⁶⁶ Dragoti, E., Adoleshenti, Tiranë, 1999, fq. 13, 14.

¹⁶⁷ Papandilje, j., Vështrim Kriminologjik, Tiranë, 2000, fq. 93.

¹⁶⁸ Vasilika, h., Hyrje në Kriminologji dhe Penologji, Tiranë, 2000, fq. 69.

perceptimin, kujtesën dhe riprodhimin. Duke u nisur nga fakti se në të gjitha fushat e jetës veçohet mosha e personave të mitur, edhe zbulimi dhe luftimi i delikuencës së të miturve mund të trajtohet veçanërisht. Njëherësh duhet theksuar se të drejtat e të miturve, në aspekte të ndryshme, rregullohen me norma ndërkombëtare që kanë ndikim në trajtimin e tyre.

Pyetja e të miturve duhet t'i përfshijë ato rrethana që kuptohen dhe perceptohen nga ata. Të miturit janë përgjithësisht të mirë po të drejtohen dhe trajtohen mirë. Organi procedues duhet të përgatitet seriozisht kur pyet dëshmitar ose të pandehur të mitur. Të fitoi besimin e të miturit. I mituri ta shohë si mbrojtësin e tij. Këto rrethana e lirojnë dhe e bëjnë të miturin të saktë në shpjegimet e tij.

Pyetësi duhet të vendos kontaktin psikologjik. Pyetja e të miturit (të pandehurit ose dëshmitarit) nuk duhet të fillojë drejtpërdrejt me pyetjet që i interesojnë organit procedues, por me bisedë të lirë. Kjo e liron atë të njihet me shkallën e zhvillimit mendor të të miturit për tu afruar me të. Organi procedues duhet ta pyes të miturin hollësisht dhe po qe e mundur vetëm një herë. Për të njëjtën rrethanë një pyetje e dytë nuk është e këshillueshme. I mituri, si rregull nuk i ka mundësitë fizike e mendore të përqendrohet për një kohë të gjatë dhe t'i kuptoi dhe e t'i riprodhojë me saktësi rrethanat që ka parë ose dëgjuar me rastin e kryerjes së veprës penale. Me këtë rast duhet theksuar se pyetja e të pandehurit të mitur ka disa veçori. I pandehuri i mitur ka frikë të tregojë për bashkëpunëtorët e tij, veçanërisht për organizatorët ose përgjithësisht për ata se janë më të mëdhenj se ai. Meqenëse i mituri e kupton shtrebur ndjenjën e shoqërisë, ndonjëherë ai e merre përsipër fajin dhe e konsideron këtë si akt heroizmi.¹⁶⁹

Organi procedues është i detyruar të bëjë verifikimet e nevojshme kur ka arsyeje për të besuar se i pandehuri është i mitur. Të pandehurit të mitur i sigurohet ndihmë juridike dhe psikologjike, në praninë e prindit ose të personave të tjerë të kërkuar nga i mituri dhe të pranuar nga organi i procedurës. Ndihma për të pandehurin e mitur është e detyrueshme. Mbrojtësi i të pandehurit të mitur duhet të marrë pjesë pa tjetër në të gjitha veprimet për të cilat parashikohet prania e të pandehurit.

Njohja dhe garantimi i të drejtave të të pandehurit në të gjitha fazat e procedimit penal është një nga treguesit kryesor të karakterit demokratik të sistemit procedural të një shteti. Respektimi i këtyre të drejtave nga organet

¹⁶⁹ Begeja, S.. Kriminialistika, Tiranë, 1997, fq.407 – 410.

që procedojnë, nga ata që ushtrojnë ndjekjen penale, që hetojnë e gjykojnë, që realizojnë drejtësinë e bazuar në barazinë dhe debatin e palëve.¹⁷⁰

Me rastin e pyetjes së fëmijës duhet njohur fazat e ndryshme të zhvillimit shpirtëror të tyre. Lidhur me këtë, H. Gross¹⁷¹ e shumë autorë të tjerë (si Grassbergeri në librin e tij “Psikologjia gjyqësore” në bazë të psikologut Charlotte Buhler) kanë konstatuar:

Fëmija, për arsyeje të përvojës së pamjaftueshme dhe të përmbajtjes më të vogël të asaj përvoje, më tepër anon kah apercepcionet e gabuara sesa të rriturit;

- aftësia për vrojtim te fëmija zhvillohet gradualisht;
- për shkak të qëndrimit tejet egocentrik të fëmijës, ngjarja shpesh merr atë domethënie që fëmija dëshiron t’i japë.

Me rastin e pyetjes së të riut, zbatohet edhe parashtrimi i provave. Fiksimi i rezultateve të pyetjes të të miturve bëhet me mbajtjen e procesverbalit.

Çrregullimet e personalitetit, përdorimi i drogës dhe mjedisi negativ kanë ndikim të shprehur në paraqitjen e delikuencës së të rinjve. Me këtë duhet veçuar disa karakteristika të çrregullimit të personalitetit antisocial që mund të gërshetohen me sjellje devijante të të rinjve. Çrregullimi i personalitetit antisocial karakterizohet me një mënyrë sjelljeje shoqërisht të rrezikshme dhe kriminale, e qëndrueshme dhe shumë e zgjatur, që nuk njihet dhe nuk përfill të drejtat e njerëzve. Këta individë kryejnë vazhdimisht dhe në mënyrë të përsëritur veprime të egra, të dhimbshme, makabre, ndaj personave të tjerë. Personat me çrregullim personaliteti antisocial janë të ngurtësuar emocionalisht, nuk kanë dhembshuri morale, nuk përfillin ndjenjat e të tjerëve, nuk kanë keqardhje për të tjerët, janë violent. Personat me çrregullim personaliteti antisocial kryejnë veprime të rrezikshme kriminale për shkak të inferioritetit dhe impulsivitetit, të hakmarrjes dhe përfitimt. Këta persona shfaqin tipare të sjelljes së tyre që në fëmijërinë e hershme.

Faktorët presispozues të çrregullimit të personalitetit antisocial janë çrregullimet deficitare të vëmendjes në fëmijëri, mungesa e disiplinës prindëror në pubertet, abuzimi me fëmije (heqja nga shtëpia, rritja e tyre pa

¹⁷⁰ Islami, H., Panda, I., Spahiu, K., Hoxha, A., Procedura Penale e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 1996, fq. 42.

¹⁷¹ Vodineliq, V., Kriminalistika, Prishtinë, 1981, fq. 202.

praninë e të dy prindërve). Çrregullimi i personalitetit antisocial fillon në adoleshencë, me akte të vogla kriminale, dhe më vonë ato rëndohen duke shfaqur veprime kriminale tepër violente dhe makabre.

Kur mishërohen, personat me çrregullime të personalitetit antisocial mund të zbuten. Çrregullimet e personalitetit antisocial takohet pesë herë më tepër midis kushërinjve të gjinisë së parë për meshkujt. Në rrethin familjar të çrregullimit të personalitetit antisocial ka persona neurotikë të somatizuar dhe të droguar. Në zhvillimin e çrregullimit të personalitetit antisocial luajnë rol si faktorët gjenetik, ashtu edhe ata rrethanor të mjedisit.¹⁷²

5. Përfundimi

Prandaj, përfundimisht bazuar në atë që u trajtua dhe u shtjellua më lartë konkludojmë se, organi procedues gjatë marrjes në pyetje të fëmijës dhe të miturit duhet të shfrytëzojë disa rregulla psikologjike taktike siç janë:

1. Organi procedues nuk guxon kurrë të flas me fëmijë me ton fëmijëror. Ai do të pyes me seriozitet dhe me urtësi, pothuaj si të rriturit;
2. Pyetja e të miturve duhet t'i përfshijë ato rrethana që kuptohen dhe perceptohen nga ata sepse të miturit janë përgjithësisht të mirë po të drejtohen dhe trajtohen mirë;
3. Organi procedues duhet të përgatitet seriozisht kur pyet dëshmitar ose të pandehur të mitur. Të fitoi besimin e të miturit. I mituri ta shohë si mbrojtësin e tij. Këto rrethana e lirojnë dhe e bëjnë të miturin të saktë në shpjegimet e tij. Pyetësi duhet të vendos kontaktin psikologjik;
4. Pyetja e të miturit (të pandehurit ose dëshmitarit) nuk duhet të fillojë drejtpërdrejt me pyetjet që i interesojnë organit procedues, por me bisedë të lirë. Kjo e liron atë të njihet me shkallën e zhvillimit mendor të të miturit për tu afruar me të;
5. Organi procedues duhet ta pyes të miturin hollësisht dhe po qe e mundur vetëm një herë. Për të njëjtën rrethanë një pyetje e dytë nuk është e këshillueshme dhe,
6. Të drejtat e të miturve në aspekte të ndryshme duhet të respektohen. Të miturit duhet të trajtohen me kujdes.

¹⁷² Latifi, V., Kriminallistika, Prishtinë, 2006, fq. 156.



Hana Canaj



Ma.Sc. Ibrahim Shala



Hunaida Pasuli

VËSHTRIM ANALITIKO-JURIDIK TË DISA PREJ ASPEKTEVE KARAKTERISTIKE TE KONTRATA PËR VEPRËN – SIPËRMARRJEN

Vërejtje hyrëse

Përcaktimi që të shkruhet një punim analitiko-juridik me synimin e hulumtimit profesional shumëdimensional me nëntekstin përcaktues në drejtim të të kërkuarit dhe të hulumtuarit shkencor përbën pozicion të veçantë të përcjellur me konsideratë si dhe përkushtim, por njëherit ka paraqitur detyrë dhe barrë të madhe e të rëndë për ta përballuar dinjitetshëm dhe me sukses.

Pra, synimi final, për më tepër misioni për ti hyrë mbarështimit të këtij punimi analitiko-juridik, pikërisht të ndërlidhur me disa prej aspekteve më karakteristike, më të rëndësishme si dhe më të dobishme të kontratës për veprën – sipërmarrjen, natyrisht gjatë tërë kohës së hulumtimit prej anës së autorëve ka qenë ballafaqim dhe përballja me një mori vështirësish, paqartësish e të panjohurash, mposhtja dhe zotërimi i të cilave ka kërkuar angazhimin tonë të plotë, përkushtimin e ngulmët për sendërtimin dhe arritjen e qëllimit të fiksuar rreth grumbullimit, sistemimit dhe përfundimisht gatimin e brumit të tezave me cakun final dhe fundamental, sa do për të qenë modest t'i shërbejnë akëcilit lexues, opinionit në përgjithësi, ndërkaq në veçanti për të ndikuar dhe influencuar pozitivisht në formësimin sa më të kompletuar të juristit që ai në degën e shkencës të marrëdhënieve të detyrimeve të është përfitues i dijes.

Për më tepër në këtë drejtim, qëllimi dhe synimi dominant ka qenë për të dhënë sa do pak një kontribut modest konkret i mbështetur dhe i bazuar kryekëput në përvojat teorike dhe praktike të studimit dhe të hulumtimit të gjertanishëm për këtë lloj të kontratës, përkatësisht për kontratën për veprën - sipërmarrjen.

Mirëpo në tërë këtë përcaktim dhe orientim tonin, jemi shumë të vetëdijshëm, në mos asgjë të tjetër, kemi siguruar një kontribut ndriçues nuancash perceptimesh për përsiatje të freskëta.

Për të qenë edhe më real, sistemimi parimisht ka ngelur në rrafshin e një strukture juridike, përkatësisht nuancat dhe refleksionet, për të dhënë ndonjë risi nga e gjitha, me pretendimin pikëvështrues për të siguruar dhe arrirë nga diçka prej të pathënave, por në asnjë rast pa humbur apo deformuar përmasat e të arriturave që kanë qenë e të cilat e karakterizojnë dhe përbëjnë trendet e traditës të kësaj dege të së drejtës, në këtë kontekst për kontratën për veprën – sipërmarrjen. Në esencë, hartimi i këtij punimi diskuton për të arriturat në fushën e hulumtimit shkencor-juridik që i kanë përmbushur nëpërmjet të literaturës përkatëse që i është dedikuar këtij lloji të kontratës e të cilët do ti analizojmë dhe citojmë në bërthamën e këtij punimi.

Aspektet më karakteristike të nocionit të kontratës për veprën-sipërmarrjen (Locatio conductio operis)

Edhe pse, në një mënyrë apo tjetër, nocioni-përkufizimi për konceptin shkencor teoriko-juridik, të lidhura për temën në shqyrtim janë prej të shumtëve të njohura, mirëpo një parashtrim, një analizë më e thelluar nuk e përjashton mundësinë që të lëkund të avancuarat për të qenë gjithnjë të njëjta dhe statike.

Nga ky këndvështrim, ne do të përqendrohemi dhe fokusohemi që në mënyrën sa më të përshtatshme dhe kuptimplotë të vështrojmë aspektet teoriko- praktike për kontratën për veprën. Pra në këtë kontekst, ndërlidhur me konceptet themelore dhe bazike ekzistuese për kontratën mbi veprën – sipërmarrjen do të përqendrohemi si dhe fokusohemi në çështjet më me interes për temën në shqyrtim, në mënyrë që të dalë sa më e rrumbullakuar, sa më kuptimplote si dhe sa më domethënëse.

Mirëpo përpara së të bëjmë prezantimin e përpjekjeve tona për temën për të cilën jemi përcaktuar e shohim të rrugës dhe vlerësojmë për lexuesit dhe opinionin në përgjithësi, të dobishme dhe me interes që marrëdhëniet e

detyrimeve kur krijohen dhe lindin në kundërshtim me vullnetin e subjekteve, atëherë thuhet se kemi të bëjmë me rastet e shkaktimit të dëmit, fitimit të pa bazë juridike, zgjerimit të punëve të huaja pa autorizim dhe porosi si dhe rastet kur marrëdhëniet e detyrimeve krijohen dhe rrjedhin drejtpërdrejt prej urdhrit të ligjit apo të dispozitave të tij.¹⁷³

Mbi bazën e pozicionimeve të akceptuara dhe veçura të të sipërthënave, në mënyrë shumë refleksive rezulton që në fundament marrëdhëniet e detyrimeve janë raport – marrëdhënie juridike (*vinculum iuris*), ku një person quhet Kreditor (Creditor), ka të drejtë të kërkojë prej një personi tjetër që quhet Detor (Debitor), një dhënie (dare), bërje (facere) mos bërje dhe pësim (fati).¹⁷⁴

Për këto aspekte si dhe karakteristika jemi shumë të vetëdijshëm që do të mund të shkruhej gjatë, por do ti lejonim vetes komoditet real objektiv të të shkruarit hulumtues për të përmyllur dhe rrumbullakuar në mënyrën se në marrëdhëniet detyrimore së paku janë dy subjekte, ku njëra kërkon diçka kreditori, kurse pala apo subjekti që ka borxh është debitor. Mirëpo ajo çfarë duhet për të reflektuar gjithmonë, është fakti që ky shpjegim i ynë i mësipërm, nuk është i tëri, përkatësisht i plotë, nga se nuk del gjithherë që është si dhe të jetë vetëm debitori, por në rolin e kreditorit – është debitori, kurse në rolin e debitorit mundet që të jetë kreditori, e pikërisht siç do të mund të shohim dhe vërejmë një gjë e tillë shprehet edhe të kjo kontratë që është objekti i hulumtimit, trajtimit dhe shqyrtimit.

Kontrata për veprën–sipërmarrjen është një raport, përkatësisht marrëdhënie juridike midis kryerësit të punëve dhe porositësit, në të cilën kryerësi i punës detyrohet që të kryej punën e caktuar siç mund të jetë prodhimi ose riparimi i ndonjë sendi, kryerja e ndonjë pune fizike ose intelektuale, kurse porositësi detyrohet që për këtë të paguajë shpërblim të caktuar (neni 600 i LMD-së).¹⁷⁵ apo siç akcepton në mënyrë shprehimore Ligji i detyrimeve – Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë në nenin 860 par. 1 “Sipërmarrja është kontratë më të cilën njëra palë (sipërmarrësi) detyrohet, që me mjetet e saj dhe duke marrë përsipër rrezikun, të kryejë një vepër (punë), ose të bëjë një shërbim apo një zbatim të pavarur të punimeve, ndërsa pala tjetër ta pranojë atë kundrejt çmimit të caktuar në kontratë”.¹⁷⁶ Kështu në këtë drejtim, duke veçuar përkufizimin, atëherë fitojmë qasjen e shprehur në

¹⁷³ Prof. Alajdin Alishani, “E Drejta e Përgjithshme e Detyrimeve”, Prishtinë, 2003, fq.38.

¹⁷⁴ Mr. Alajdin Alishani, “Mbi disa çështje themelore të së drejtës së detyrimeve”, Përparimi, nr.9, 1973, fq.793.

¹⁷⁵ Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (“Gazeta Zyrtare e RSFJ-së”, nr.29), 26 maj 1978, fq.1239.

¹⁷⁶ http://www.ligjet.info/kodicivil/pjesa_v/titulli_ii/kreu_vii/, fq. 7/8/2011.

vijim: Kontrata për veprën – sipërmarrjen hyn në grupin e kontratave mbi shërbimet që sipas zhvillimit të saj historik, në fillim është paraqitur si kontratë e së drejtës civile e cila ka pasur të bëjë me kryerjen ose riparimin e sendit për shërbimet personale–fizike dhe intelektuale si dhe në transportimin e sendeve dhe të personave. Pra kjo kontratë është e evidente që ka ekzistuar qysh në të drejtën romake e më emërtimin: *locatio conduction operis*.

Me zhvillimin e forcave prodhuese si dhe me nismën dhe konstituimin e marrëdhënieve tregtare, fushëveprimi i kontratës së veprës është zgjeruar dhe ka vepruar në orbitën e jetës ekonomike, duke qëndruar dhe “rezistuar”, për ti mbajtur edhe për më tej karakteristikat vetanake të saja të mëparshme.

Në anën tjetër, në mënyrë refleksive shihet prej të hulumtimeve kërkimore që kjo kontratë është bërë institut i së drejtës ekonomiko-tregtare, ashtu që lënda e saj në kushtet bashkëkohore është bërë shumë më e llojlojshme, për çka për të dhënë një pasqyrë më të konkretizuar dhe reale e objektive do ti qasemi në nëntitujt tjerë vijues ndërtues të këtij punimi – hartimi analitko-juridik.

Kjo kontratë ka ngjashmëri me kontratën mbi punën dhe kontratën mbi shitjen. Nëse me kontratë caktohet natyra e punës dhe rezultati që realizohet më të, kurse kryerësi i punës është i pavarur në punë, për këtë do të lidhet kontratë mbi veprën¹⁷⁷. Ato janë sipas dispozitave të nenit (630–647 i të LMD-së)¹⁷⁸, kontrata për ndërtimin, me dispozitat nga neni (847–858) të LMD-së, kontrata për kontrollimin e mallit dhe shërbimeve me dispozitat e nenit 56–61 të Ligjit për të Drejtën e Autorit, kontrata për të drejtën e autorit.

Mirëpo është më rëndësi për tu përmendur fakti se edhe në rastin kur lënda e kontratës përputhet më lëndët e kontratave të sipërpërmendura, të cilat janë të mëvetësuar mund të konsiderohet se ka të bëjë me kontratën e veprës në kuptimin e ngushtë të saj. Në ekzistimin tashmë të treguar dhe të specifikuar që si nënloje të kontratës së veprës të cilat nuk janë kodifikuar si lloj i posaçëm i kontratës, por se nga pikëpamja e saj e rëndësisë ekonomike dhe shoqërore i kanë po ato specificitete, madje edhe ato janë të ndara në tipe të posaçme të kontratave në kuadër të kontratës për veprën – sipërmarrjen dhe

¹⁷⁷ Dr. Sc. Nerxhivane Dauti, “E Drejta e Detyrimeve”, Prishtinë, 2001, fq.341.

¹⁷⁸ Po aty, fq.341.

me rastin e vendosjes së kontesteve konkrete për ato raste, duhet kujdesur për cilësitë e tyre.

Këso lloj kontratash janë posaçërisht, kontrata për punën kërkimore shkencore, kontrata për projektim, kontrata për consulting, kontrata për dhënien e ndihmës teknike etj. Te kjo kontratë është shumë më rëndësi që të ruhemi së tepërmi që ajo të mos barazohet me kontratën për punën. Këtë fakt po e theksojmë sepse këto kontrata përpos që kanë ngjashmëri të theksuara të caktuara, kanë edhe dallime evidente. Dallimi kryesor midis tyre është se kontrata për veprën–sipërmarrjen është kontratë intuitu personae. Pastaj te kontrata për veprën, nuk është caktuar mënyra dhe rezultati i punës, nga se kryerësi i punës ka pavarësi të caktuar në kryerjen e punëve të caktuara, kurse kontrata për punën ose në bazë të saj punëtori është i obliguar ta kryejë punën që ia ka besuar punëdhënësi ose si e kërkon natyra e vendit të punës.

Te kontrata për veprën, lënda e kontratës është rezultat i punës ose rezultat i dhënies së shërbimit, ndërkaq lënda e kontratës për punën është puna që e kryen i punësuari në bazë të kontratës për punën ose në bazë të natyrës së punës.

Kështu në këtë aspekt me të drejtë mund të nënvizohet se më rëndësi tek kontrata mbi veprën–sipërmarrjen është kryerja e punës së caktuar, ndërmarrja e veprimit të caktuar, prodhimi i sendit të caktuar ose krijimi i veprës së caktuar. Prodhimi mund të jetë një punë mekanike, një punë letrare, një punë artistike ose një punë shkencore. Kryerësi i punës ose duhet të prodhoj sendin ose të ndreq sendin, të bartë sendin deri në vendin e caktuar, të mbajë ligjëratë të caktuar, ose të kryejë ndonjë veprim intelektual në shkencë. Vetëm atëherë mund të thuhet së është lidhur kontrata për veprën kur në fakt kryerësi i punës obligohet ndaj porositësit për ta prodhuar një send, p.sh. të prodhoj një tavolinë, ta ndreq derën e thyer, të kryej ndonjë punë që kërkon angazhim fizik dhe intelektual. Prej lidhjes së kësaj kontrate duhet të realizohet rezultati i caktuar.

Mirëpo, kështu gjithnjë nuk ndodhë në praktikë, p.sh. kur kryerësi i punës obligohet për ta hapur pusin, mirëpo uji nuk del, ose obligohet për të hapur një minierë, por nuk e gjen xehen e caktuar, megjithëkëtë në parim, në shumicën e këtyre dhe të rasteve të tjera, kryerësi i punës arrin rezultat të caktuar. Ajo se çfarë është esenciale te kjo kontratë është fakti se, ai që e kryen punën ose që e merr përsipër të arrihet rezultati i caktuar, së pari duhet të jetë bona fides dhe duhet ti respektoj rregullat e profesionit.

Së këndejmi, përvijimet e konstatuara të mësipërme, ndërlidhur me akcent të veçantë më konstatimin e drejt që duhet shumë për të qenë të kujdesshëm, përkatësisht për tu ruajtur që kontrata për veprën të mos na ngatërrohet, apo për më drejt, të mos na barazohet më kontratën për punën për ç'gjë mund edhe të gjenden raste të ndodhura në jetën praktike.

Përndryshe, ndonjëherë në praktikë punëdhënësi për ti ikur kryerjes së obligimeve të cilat rezultojnë nga marrëdhënia e punës, me punëtorët në vend të kontratës mbi punën lidhin kontratë mbi vepër, natyra e të cilave punë ngjan në dy qenësi. Në këto raste punëdhënësit i ofrohet mundësia e punëdhënësit punësimin me orar jo të plotë.¹⁷⁹

Specificitetet që e karakterizojnë kontratën për veprën

Pasi që në mënyrë rrjedhimore përshkruam dimensionet më domethënëse të nocionit për kontratën për veprën–sipërmarrjen, në vijim do të paraqesim pikat më karakteristike analitiko-juridike të specificiteteve që karakterizojnë këtë kontratë:

- Kontrata për veprën ose sipërmarrjen është kontratë me emër (contractus nominatus), sepse e ka emrin e caktuar dhe rregullativën e caktuar shprehimisht në kodet civile dhe në ligjet mbi marrëdhëniet e detyrimeve,¹⁸⁰
- Kjo kontratë është kontratë me shpërblim, për shkakun dhe arsyen që porositi për atë që merr prej kryerësit të punës e jep kundërvlerën e caktuar,
- Është kontratë e dyanshme detyruese, sepse lidhja e saj e plotfuqishme iu krijon dhe realizon të drejta dhe detyra të porositisit dhe kryerësit të punës dhe në këtë lidhshmëri, rezulton që porositi për atë që merr prej kryerësit të punës, e jep kundërvlerën e caktuar – shpërblimin,
- Është kontratë komutative për faktin që prej momentit të lidhjes së kontratës për veprën – sipërmarrjen palët si kreditori, ashtu edhe debitori i din të drejtat dhe detyrat e veta,¹⁸¹
- Kjo kontratë është kontratë me prestime afatgjate nga fakti që prestimet nga kjo kontratë ekzekutohen brenda një kohe më të gjatë,

¹⁷⁹ <http://poslovni.hr/sklopiti-ugovor-o-djelu-ili-o-radu-162400.aspx>, 7/15/2011

¹⁸⁰ Dr. Sc. Nergjivane Dauti, “E Drejta e Detyrimeve”, Prishtinë, 2001, fq. 342.

¹⁸¹ Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (“Gazeta Zyrtare e RSFJ-së”, nr.29), 26 maj 1978, fq.1187.

- Është kontratë jo formale. Ligji për marrëdhëniet e Detyrimeve e sipas parashikueshmërisë, pikërisht konform të nenit 67,¹⁸² për plotfuqishmërinë e saj nuk parasheh kurrfarë forme të posaçme, është i mjaftuar pajtimi i vullnetit të palëve kontraktues. Mirëpo megjithëkëtë, ka përjashtime të kontrata për të drejtat e autorit, ku kërkohet gjithsesi forma me shkrim si dhe të kontrata për projektim dhe të gjitha kontratat për shërbimet intelektuale e të cilat e paraqesin kontratën e veprës. Por edhe në këso rasti, kontrata mund të konvalidohet nëse i mungon forma e shkruar në kontekstin, nëse ka ekzistuar në tërësi ose pjesërisht,
- Kjo kontratë është kontratë e thjeshtë, ngase përfshinë elementet e një kontrate. Megjithëkëtë elementet e kësaj kontrate mund të jenë të përziera edhe më elementet e disa kontratave të tjera për shembull kur lidhet kjo kontratë për ta prodhuar sendin, ose për ta ndrequr sendin me material të vet, atëherë paraqiten, ndeshen dhe hasen elementet e kontratës së shitjes, të kontratës së komisionit dhe kontratës për veprë, madje në të shumtën e herëve, mund të ndodhë që kjo kontratë të jetë në grupin e kontratave të adezionit, sepse ka raste kur kjo kontratë përpilohet nga njëra palë kontraktuese, ku përmbajtja e kontratës caktohet para se ajo të dihet.
- Është kontratë kauzale, sepse palët dhe personat e tretë dinë për qëllimet e detyrimit. Kjo kontratë sikurse edhe kontratat tjera, mund të lidhet duke e lidhur që më parë parakontratën për veprën në mënyrë që më vonë të lidhet kontrata kryesore për veprën. Ekzekutimin e kontratës, kryerësi e bënë në mënyrë të mëvetësishme në emrin e tij dhe në llogari të tij. Sipas kësaj kjo kontratë dallohet prej kontratës për urdhrin (neni 749–770) të LMD-së.¹⁸³ Parimisht lënda e kontratës duhet të jetë puna e caktuar, por përjashtimisht lënda e kontratës mund të jetë edhe e caktueshme (neni 50 i LMD-së), është ky rast kur sipas natyrës së sendit nuk mundet në mënyrë të padyshimtë përpara të caktohet se në çka përbëhet puna, por ajo është e mundshme të bëhet në mënyrë indirekte nëpërmjet të kontraktimit ose kriteriumit për caktimin e vëllimit të punës. Ky rast do të jetë të riparimet, ndreqjet, remonti i makinave, ndreqja gjenerale e automobilave etj.

Si një rekapitulim, me të drejtë do mund të konkludohej që lënda e kontratës së veprës–sipërmarrjes do të duhej të jetë: e mundshme, e lejuar e

¹⁸² Prof. Alajdin Alishani, “E Drejta e Përgjithshme e Detyrimeve,” Prishtinë, 2003, fq. 207.

¹⁸³ Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (“Gazeta Zyrtare e RSFJ-së”, nr.29), 26 maj 1978, fq.1254.

nëse nuk i përmban në vete këto cilësi, kontrata është nul. Këtë e determinon dhe përkufizon dispozita relevante nga neni 48 i LMD-së.

Në mënyrë meritore dhe të saktë do të mund të konstatojmë si dhe të përmbyllim që ligji parasheh katër (4) kategori të punëve që mund të jenë lëndë e kontratës së veprës e ato janë:

1. Punimi i një sendi
2. Ndreqja e një sendi
3. Puna fizike dhe
4. Shërbimi intelektual

Karakteristikat esenciale lidhur me kushtet për lidhjen e kontratës për veprën-sipërmarrjen

Për të ekzistuar kontrata mbi veprën–sipërmarrjen, gjithsesi është e domosdoshme që të plotësohen këto kushte përkatëse:

- Të ekzistojë pajtimi i vullnetit të porositësit dhe të kryerësit të punëve (esentialia negotii),¹⁸⁴
- Të ekzistojë aftësia punuese e palëve kontraktuese,
- Të ekzistojë lënda e kontratës si dhe
- Të ekzistojë baza e kontratës.¹⁸⁵

Kushtet e sipërpërmendura janë kushte të përgjithshme për plotfuqishmërinë e çdo kontrate në të drejtën e detyrimeve. Ndërkaq elementet esenciale për ekzistimin e kësaj kontrate për të cilën palët duhet të merren vesh janë: puna ose veprimi që duhet të kryhet, shpërblimi që duhet të paguhet dhe zgjatja kohore e kësaj kontrate.

Prej shqyrtimeve dhe hulumtimeve të vëmendshme, është karakteristike për të vënë në pah që dispozitat e kësaj kontrate janë me karakter dispozitiv nga fakti që palët kontraktuese mund të merren vesh për ndonjë element tjetër esencial të kësaj kontrate.

Qasje nga këndvështrimi i aspekteve karakteristike për lëndën e kontratës për veprën – sipërmarrjen

¹⁸⁴ Dr. Sc. Nerxhivane Dauti, “E Drejta e Detyrimeve”, Prishtinë, 2001, fq. 434.

¹⁸⁵ Dr. Alajdin Alishani, “E Drejta Detyrimeve”, 2001, fq. 208.

Duke iu qasur me kujdes mund të vihet gjerë te konstatimi real që lënda e kontratës së veprës – sipërmarrjes është element esencial i saj. Në fakt, si determinante rezulton të është veprimi që duhet të kryhet ose puna që duhet të ndërmerret për tu arritur rezultati i caktuar. Kështu që nisur prej këtyre aspekteve për kryerjen e punës ose të veprimit të caktuar kryerësi i punës duhet të bëjë angazhim fizik dhe intelektual. Kjo punë siç kemi përsiatur së hulumtuari edhe më lartë duhet decidivisht të jetë e mundshme, e lejueshme dhe e caktuar. Zaten këto paraqesin momentin relevant juridik, këto janë kushte që e shoqërojnë çdo lëndë të çdo kontrate në qarkullimin e mallrave dhe në dhënien e shërbimeve.¹⁸⁶

Mirëpo në praktikë kur diskutohet për lëndën e kontratës, zakonisht thuhet se atë e kemi kur prodhojmë një tavolinë, kur ndreqet një derë, kur kompletohet një pjesë muzikore, kur bëhet hartimi i një projekti të një ndërtese, kur shkruhet një dramë, kur përpilohet një punim shkencor, kur bëhet skulpturimi i një busti, kur bëhet realizimi i një roli artistik ose kur mbahet një ligjëratë në fakultet. Sikundër edhe po duket tashmë sheshit, përkatësisht po mund të vërehet, lënda e këtyre kontratave që përbëhet nga puna e caktuar ose veprimi i caktuar mund të jetë: sendi trupor, një send i luajtshëm, një send i paluajtshëm ose një send jotrupor, qepja e një palë rrobave, ndreqja e një palë këpucëve, vjelja e një vreshti, vjelja e misrit, mbajtja e një ligjërate, luajtja në ndonjë pjesë teatrale janë veprime konkrete që kryhen ose mund të kryhen pas lidhjes së kontratës për veprën ose sipërmarrjen.

Për kryerjen e të gjitha këtyre veprimeve, ose lidhur me prodhimin e sendit, ndreqjen e sendit, kryerjen e ndonjë pune fizike ose intelektuale si dhe të ndërmarrjes së ndonjë veprimi, kryerësi i punëve duhet të përdor mjetet mekanike ose vetëm fuqinë e vet fizike ose aftësinë psikike e cila duhet dhe nevojitet në këto raste.

Pasimi i obliguar për tu paguar kundërvlera–shpërblimi për punën e kryer

Duke përbërë elementin thelbësor të kontratës për veprën, puna ose veprimi që duhet të kryhet, pasohet me detyrimin për tu paguar kundërvlerë – shpërblimi ose çmimi i shërbimit. Në të shumtën e rasteve shpërblimi caktohet me marrëveshjen e palëve.

¹⁸⁶ Po aty, fq. 209.

Mirëpo në raste kur lënda e kësaj kontrate nuk është e mundur për tu caktuar përpara, atëherë shpërblimi mund të jetë i caktueshëm. Parimisht shpërblimi caktohet në të holla. Andaj është tepër refleksiv e dhëna dhe fakti që për caktimin e lartësisë së çmimit – shpërblimit për punën e kryer, ose rezultatin e arritur duhet të respektohen ligjet e tregut, rregullat e ekuivalencës së prestimeve dhe rregullat e parimit bona fides. Kur theksohet kjo, atëherë mendohet që shpërblimi të detyrohet për të qenë rezultat i punës së kryer.

Pastaj kërkohet që shpërblimi të është i drejtë, sepse nëse nuk është i drejtë, atëherë kjo kontratë edhe mund të mos krijoj efekte juridike, pasi mund të sulmohet për shkak të dëmtimit pa masë ose mund të revidohet ose të zgjidhet për shkak të rrethanave të ndryshuara. Kjo edhe nënkupton faktin se kontrata për veprën, siç edhe u përmend edhe më sipër, është kontratë e dyanshme pasi që secila palë kontraktuese mbështetën në parimin e prestacioneve të ndërsjella ekuivalente (neni 15 i LMD-së).¹⁸⁷

Në këtë kontekst, nuk do të duhej lejuar vetes të bëhej lëshim për të mos përmendur edhe faktin shumë domethënës se te ndryshimi i çmimit të kontraktuar mund të vij para së gjithash për shkak të rrethanave të cilat do të lindnin pas lidhjes së kontratës e të cilat do ta vështirësonin përmbushjen e obligimit të njëjës palë sipas kushteve të përcaktuara me nenin 139 të LMD-së.¹⁸⁸

Kurse në rastet më të rralla, por që në praktikën detyrimore juridike janë të mundura për të ndodhur, kur çmimi i shërbimit – shpërblimi të mos jetë caktuar as në kontratë, as në bazë të ligjit, as nuk i është besuar caktimi i tij personit të tretë, atëherë lartësia e shpërblimit caktohet nga ana e gjykatës më kërkesë të palës ose të palëve.

Në këso rrethanash, gjykata në procedurën me kompetencë dhe juridiksion gjyqësor do të duhej të merrte parasysh:

- Vlerën reale të punëve,
- Kohën e nevojshme për kryerjen e punës dhe
- Shpërblimin e rëndomtë për kryerjen e kësaj pune.

Këtë çështje e ka zbërthyer në mënyrë të përshtatshme LMD me nenin 623, paragrafi 1, 2, 3, 4.¹⁸⁹

¹⁸⁷ Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (“Gazeta Zyrtare e RSFJ-së”, nr.29), 26 maj 1978, fq. 24.

¹⁸⁸ Po aty, fq. 25

¹⁸⁹ Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (“Gazeta Zyrtare e RSFJ-së”, nr.29), 26 maj 1978, fq. 1241.

Pasqyrimi kontekstual i afatit të zgjatjes së kontratës

Në parim sipas rregullave të kontratës për veprën, palët kontraktuese në bazë të kontratës caktojnë afatin e zgjatjes së saj dhe ky afat caktohet shprehimisht me marrëveshjen e palëve, ndërsa kjo kontratë mund të rrjedhë edhe heshtazi. Ndërsa nëse është i caktuar afati i saj, atëherë ajo shuhet me skadimin e këtij afati. Mirëpo kur ky afat nuk është i caktuar dhe palët sillen sikur se afati të ketë qenë caktuar, si rregull konsiderohet së palët kanë bërë vazhdimin e kësaj kontrate.

Në këso rastesh, zgjatja e kësaj kontrate ka parasysh rregullat e standardeve të caktuara për tu kryer puna ose që të arrihet rezultati i dëshiruar. Afati i zgjatjes së kësaj kontrate ka vlerë të caktuar, prandaj konsiderohet si element esencial i saj, sepse brenda kësaj kohe duhet të kryhen të gjitha punët lidhur me arritjen e rezultatit.

Theks për efektet e kontratës së veprës – sipërmarrjes

Sikurse asnjë kontratë e lidhur ndërmjet të palëve, edhe kontrata për veprën – sipërmarrjen në marrëdhëniet e detyrimeve, krijon efekte të caktuara juridike midis porositësit dhe kryerësit të punëve. Pra thjesht ata reflektojnë, përkatësisht shprehen në të drejtat dhe detyrimet e kryerësit të punëve (veprës) dhe porositësit të punëve.¹⁹⁰ Në këtë kuptim të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese mund të krijohen vetëm nëse është lidhur kontrata e plotfuqishme e veprës – sipërmarrjes.

Të drejtat dhe obligimet e kryerësit të punëve të kontrata për veprën – sipërmarrjen

Sikur u nënvizua më sipër, kryerësi i punëve ka detyrë kryesore që ta kryejë punën ashtu siç është kontraktuar (neni 607 par 1 i LMD-së).¹⁹¹ Ai duhet ta kryej këtë punë, për kohë të caktuar, e kur koha nuk është e caktuar, duhet ta kryej për kohën e cila është e duhur apo që është e nevojshme dhe e kuptueshme për punë të tilla (neni 607 par. 2 i LMD-së). Ai nuk përgjigjet për vonesën e shkaktuar së porositësi nuk e ka dorëzuar materialin më kohë ose kur kjo vonesë ka kushtëzuar që këtyre punëve t'ju kërkoi ndryshimet e caktuara, apo kur porositësi nuk ka paguar avansin (neni 607 par. 3 të LMD-së).

¹⁹⁰ Dr. Sc. Nerxhivane Dauti, "E Drejta e Detyrimeve", Prishtinë, 2001, fq. 344.

¹⁹¹ Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve ("Gazeta Zyrtare e RSFJ-së", nr.29), 26 maj 1978, fq.1239).

Përndryshe, vonesa jashtë këtyre rasteve do të shkaktoj përgjegjësinë e tij për kryerjen e punëve. Kryerësi i punëve ka për detyrë që të kujdeset për materialin që e merr nga porositësi se a i përgjigjet ai material kryerjes me cilësi të punëve për arritjen e rezultatit të caktuar, ndryshe do të përgjigjet për dëmin që eventualisht i shkaktohet porositësit (neni 606 par. 1 të LMD-së).

Kryerësi i punëve ka për obligim që t'ia tërheq vërejtjen porositësit rreth mungesave të dekretit të tij, si dhe për rrethanat e tjera për të cilat ka ditur ose është dashur të dijë se janë më rëndësi. Kryerësi i punëve është i obliguar që t'ia dorëzojë punën e kryer porositësit të caktuar me kontratë (neni 613 par. 1 i LMD-së) e që paraqet fazën e fundit të përmbushjes së kontratës së veprës, kurse dorëzimi konsiderohet kur veprën e kryer ose rezultatin e arritur e ka pranuar porositësi. Sa i përket vendit të dorëzimit, nëse ai nuk është caktuar ai caktohet sipas natyrës së punës ose rrethanave të tjera.

Kryerësi i punës nuk mund të thirret në dispozitat relevante nga neni 615 – 616 të LMD-së, kur faktet mbi të metat reale dhe përkatëse kanë qenë të njohura ose nuk kanë mundur të ngelin të panjohura. Mirëpo kur porositësi në mënyrë të rregullt e ka lajmëruar kryerësin e punëve se puna e kryer ka ndonjë të metë, ka të drejtë të kërkojë për të evituar të metën duke caktuar një afat të kuptueshëm neni 618 par 1 i LMD-së, kurse ka të drejtë në shpërblim të dëmit që e ka pësuar për shkak të të metës në punën e kryer neni 618 par. 2 i LMD-së.

Në qoftë se evitimi i të metave kërkon shpenzime të tepruara, kryerësi i punës mund të refuzoj që të bëjë evitimin e të metave, nga se sikur në rastin e tillë, porositësi e ka të drejtën e zgjedhjes: ose ta zvogëlojë lartësinë e shpërblimit ose ta zgjidhë kontratën dhe për secilin rast ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit konform të nenit 618 par. 3 i LMD-së. Kur puna e kryer përbënë vepër të papërdorshme, ose është kryer në kundërshtim me kushtet e kontratës, ekziston e drejta që pa u kërkuar paraprakisht evitimi i të metave, të kërkojë zgjidhjen e kontratës dhe shpërblimin e dëmit (neni 619 i LMD-së).¹⁹²

¹⁹² Po aty. Fq.1241.

Të drejtat dhe detyrat e porositësit

Të drejtat e porositësit

Sipas rregullave të kontratës së veprës, porositësi ka të drejtë të kërkojë që ti dorëzohet puna e kryer, të kërkojë për t'iu evituar të metat, zvogëlimin e shpërblimit, ose zgjidhjen e kontratës dhe në secilin rast të ndodhur për të kërkuar dëmshpërblimin e dëmit, të kërkon respektimin dhe zbatimin e kontratës për kryerjen e punës së caktuar, ose për arritjen e rezultateve të caktuara, të tërheq vërejtjen kryerësit të punëve që ta zgjedh materialin e mirë – kualitativ si dhe të ndërmarr veprime ku i mbron interesat e tij.

Detyrat e porositësit

Porositësi ka për detyrë që të pranojë punën e kryer, me kusht që puna të jetë kryer sipas rregullave të kontratës dhe rregullave të punës konkrete (neni 622 i LMD-së). Këtu vjen në shprehje parimi i ekuivalencës së prestimeve dhe detyrave të ndërsjella të palëve kontraktuese, e gjerë në përmbushjen e kontratës. Pastaj të paguajë shpërblimin për punën e kryer. Shpërblimi caktohet zakonisht në bazë të kontratës.

Pra lartësia e shpërblimit mund të jetë caktuar me tarifë të obligueshme ose me ndonjë akt tjetër obligues (neni 623 i LMD-së). Porositësi nuk është i detyruar për të paguar shpërblimin para se ta kontrollojë punën e kryer dhe para se të pranojë punën, përveç rastit kur është kontraktuar ndryshe (neni 623 par. 3 i LMD-së). Njësoj, përkatësisht ngjashëm veprohet nëse është kontraktuar kryerja e punës dhe dorëzimi i punës pjesë, pjesë.

Kur shpërblimi është kontraktuar në bazë të llogaritjes së bërë, atëherë ai nuk mund të kërkojë rritjen e shpërblimit edhe në rast të për kryerjen e punës së kontraktuar është shpenzuar më tepër kohë pune si dhe janë bërë më tepër shpenzime se sa kanë qenë të parapara më kontratë e në kontekstin që saktësinë dhe parametrat i ka caktuar kryerësi i punës sipas parashikueshmërisë që përmban neni 624 par 1 i LMD-së.

Në qoftë se si rrjedhim i rrethanave të paparashikuara ka ndodhur rritje ose ulje e kostos së materialeve ose e krahut të punës, që përcaktojnë një rritje ose një zbritje në një masë më të madhe se një e dhjeta e çmimit të përgjithshëm të caktuar, sipërmarrësi ose porositësi mund të kërkojnë rishikimin e çmimit. Ky rishikim mund të caktohet vetëm për masën e

diferencës që tejkalon një të dhjetën. Mirëpo kur gjatë punimeve hasen vështirësi, është fjala për raste specifike, sikur në rastin e vështirësive të karakterit gjeologjik, hidrik dhe të tjera të ngjashme me to, të paparashikuara nga palët e që e bëjnë mjaft të vështirë detyrën e sipërmarrësit, ky ka të drejtë për kompensim të përshtatshëm.¹⁹³

Rreziku i dëmtimit ose i zhdukjes së sendit

Nëse prej fillimit të punës e deri në kryerjen e saj paraqitet zhdukja ose dëmtimi i punës së kryer, shtrohet pyetja se kush e bartë rrezikun për humbjen ose dëmtimin e asaj pune. Përgjigjen në këtë çështje e gjejmë në dispozitat e neneve 625 par. 1, 2 dhe 3, nenit 626 par. 1 dhe 2 dhe në nenin 627 të LMD-së.

Në rastin kur kryerësi i punës e ka dhënë materialin për prodhimin e sendit dhe sendi dëmtohet ose zhduket nga çfarëdo shkak para se ai ti dorëzohet porositësit, atëherë rrezikun për këtë e bartë kryesi i punës dhe ai nuk ka të drejtë ta kërkoj shpërblimin për materialin e dhënë dhe as të kërkoj shpërblimin për punën e kryer (neni 626 par. 1 i LMD-së). Pra, para dorëzimit të punës nëse ka ardhur deri të zhdukja ose dëmtimi i tij rrezikun e bartë kryerësi i punës.

Në qoftë se porositësi i punës e ka kontrolluar punën e kryer dhe e ka pranuar atë, konsiderohet se sendi i është dorëzuar atij, ndonëse sendi ka ngelur të kryerësi i punës (neni 625 par 2. i LMD-së). Nëse porositësi ka rënë në vonesë për shkak të mosmarrjes së sendit të ofruar, rreziku i zhdukjes ose i dëmtimit të sendit kalon të porositësi. Pra këtu rrezikun e bartë porositësi sepse ka rënë në vonesë në marrjen e sendit të kryer. Këtë rrezik porositësi e bartë edhe kur konsiderohet se sendi i është dorëzuar atij. Kurse kryerësi i punës ka të drejtë në shpërblim vetëm nëse sendi është zhdukur ose dëmtuar pas rënies në vonesë të porositësit ose nëse porositësi nuk është përgjigjur ftesës së kryerësit të punës për ta kontrolluar sendin. Pra faji në këtë rast qëndron te porositësi, prandaj kryerësi i punës mund të realizoj shpërblimin për punën e kryer. Në qoftë se është kontraktuar që porositësi do të bëjë kontrollimin dhe pranimin e pjesëve të punës ashtu siç janë kryer, atëherë kryerësi i punës ka të drejtë në shpërblim për pjesët e kryera të cilat porositësi i ka kontrolluar dhe lejuar edhe në rastin kur këto punë të kryerësit të punës janë zhdukur te ai pa fajin e tij (neni 627 i LMD-së).

¹⁹³ Po aty, fq. 7/8/2011.

E drejta e pengut te kontrata e veprës

Kryerja e punëve të porositësit në raste të caktuara që të ndërmerren veprime me të cilat do të sigurohet realizimi i kërkesave të kryerësit të punës, ka të drejtë pengut në sendet që i ka prodhuar ose riparuar – ndrequr. Prandaj me dispozitën e nenit 628 të LMD-së është sanksionuar duke u parashikuar mundësia e krijimit të pengut. Kjo është paraparë për sigurimin e inkasimit të kërkesave për punën e kryer siç është shpërblimi, shpërblimi në emër të materialit të shpenzuar dhe për kërkesat tjera që sajohen në bazë të kontratës së veprës. Pra në këto raste kryerësi i punës ka të drejtë në pengun e sendeve, të cilat i ka prodhuar, përkatësisht i ka ndrequr si dhe sende të tjera që ia ka dorëzuar porositësi në lidhje me punën e tij, gjerë sa këto sende i mbanë dhe gjerë sa nuk pushon ti mbajë sipas vullnetit të tij. Konstituimi i pengut i siguron kryerësit të punëve që të jetë i suksesshëm në realizimin e kërkesave të veta që janë në lidhje me kontratën e veprës – sipërmarrjes.

Lidhja e kontratës së veprës me ankand

Sipas të drejtës së detyrimeve për lidhjen e çdo kontrate, njëra palë bën ofertë, kurse pala tjetër e pranon ofertën. Parimisht kjo është mënyra më e rëndomtë e lidhjes së kontratave në qarkullimin e mallrave dhe në dhënien e shërbimeve. Por, ka raste kur ftesa për kryerjen e veprës artistike ose për dhënien e zgjidhjes teknike të punëve që duhet të bëhet me ankand. Ky është rast kur për kryerjen e punëve kërkohet që të angazhohet kryerësi më i mirë i punëve. Kësisoj, kërkesa iu drejtohet personave të caktuar ose të pacaktuar për të lidhur kontratën me pjesëmarrësin në ankand, zgjidhjen e të cilit e pranon komisioni. Nëse komisioni i caktuar vërteton se pjesëmarrësi në ankand publik i plotëson kushtet e caktuara për kryerjen e punëve të caktuara, atëherë me të lidhet kontrata. Ftesa e bërë nëpërmjet të ankandit publik krijon obligimin që ofertuesi ta lidhë kontratën për kryerjen e punëve të caktuara me subjektin i cili ofron çmimin më të ulët, por këtë nuk do të bëjë me kryerësin e punës nëse në ankand ofertuesi e ka përjashtuar rrethanën se kush e ofron çmimin më të ulët (neni 604 par. 2 të LMD-së). Kontrata e veprës – sipërmarrjes si edhe kontratat tjera shuhet pas krijimit të efekteve të caktuara. Shuarja e saj mund të bëhet edhe me krijimin e pjesërishëm të efekteve ose pas krijimit të pjesës dërmuese të këtyre efekteve. Shuarja në këtë mënyrë e kësaj kontrate shkakton që të shuhet efektet e saj, meqenëse në disa raste nuk shuhet së ekzistuari kjo kontratë.

Shuarja e kontratës me marrëveshjen e palëve

Kontrata e veprës lidhet me marrëveshjen e porositësit dhe të kryerësit të punës. Prandaj, këto subjekte e kanë të drejtën ta shuajnë këtë kontratë, sepse ajo është vepër e tyre. Pasi që kontrata për veprën – sipërmarrjen është konsesuale shuarja e saj bëhet me dakordim gojor.

Shuarja e kontratës më përmbushjen e saj

Kontrata shuhet kur kryhet puna ose arrihet rezultati dhe këtë punë ose rezultat e pranon porositësi. Kjo mënyrë e shuarjes së kontratës është mënyra më e përshtatshme, më e mirë si dhe më normale e shuarjes së kësaj kontrate.

Shuarja e kontratës për shkak të mosekzekutimit

Kur njëra ose pala tjetër nuk përmbushin detyrën e vet, kjo kontratë mund të zgjidhet për shkak të mospërmbushjes, përkatësisht mosekzekutimit të saj. Këtë mund ta kërkoj si porositësi ashtu edhe kryerësi i punës. Porositësi mund ta zgjidhë këtë kontratë për mosekzekutim, nëse kryerësi i punës personalisht nuk kryen punën ose nuk arrin rezultatin e caktuar sepse kontrata ka qenë e lidhur intuitu personae. Pastaj, kryerësi i punës mund ta zgjidhë kontratën për mosekzekutim nëse porositësi e jep materialin i cili nuk është i përshtatshëm për kryerjen e punës ose arritjes së rezultatit. Kurse porositësi mund ta zgjidhë kontratën nëse puna e kryer ka të meta materiale, madje këtë kontratë mund tas zgjidhë kur kryerësi i punës vonohet ose bie në vonesë dhe kur mungesat e bëjnë punën e kryer të papërdorshme, apo nuk i eviton të metat gjerë në skadimin e kohës së caktuar.

Përveç shuarjes së kontratës për shkak të mosekzekutimit, vetëm do ti përmendim pa u lëshuar edhe në shtjellimin e tyre edhe disa forma të tjera të shuarjes sikur janë: me dorëheqje, për shkak të vdekjes nëse ajo është lidhur intuitu persona nga kryerësi i punës, shuarja e kontratës nga arsyeja dhe shkaqet e paaftësisë së kryerësit të punëve dhe shuarja e kontratës e cila mundet në jetën praktike për tu shkaktuar si me falimentimin e porositësit ashtu edhe me falimentimin e kryerësit të punës.

Dallimet e kontratës së veprës dhe të kontratës së shitjes

Dallimi kryesor midis kontratës së veprës dhe asaj të shitjes është se kjo kontratë është kontratë intuitu personae, kurse kontrata e shitjes nuk është.

Me anë të kontratës së veprës – sipërmarrjes kryhet puna e caktuar, ose arrihet rezultat i pritur me shpërblim të caktuar, kurse me anën e kontratës së shitjes bartet pronësia prej një subjekti në subjekt tjetër me çmim të caktuar. Pastaj të kontrata e veprës prodhohet sendi sipas porosisë ose arrihet rezultati sipas porosisë, ndërkaq të kontrata e shitjes bëhet tjetërsimi i sendit prej një subjekti në subjektin tjetër. Tek kontrata e veprës – sipërmarrjes, kryerësi vepron sipas porosisë së porositësit, kurse të kontrata e shitjes, shitësi i prodhon sendet sipas konceptcionit të tij ose të tjetrit dhe të i lëshojë në qarkullim. Në këtë kontekst po ti referohemi me kujdes dispozitave relevante nga neni 601 par. 1,2, 3 të LMD-së¹⁹⁴, janë përcaktuar raportet e kontratës së veprës–sipërmarrjes dhe kontratës së shitjes. Konform dispozitave të sipërcituara, rezulton se kontrata me të cilën njëra palë obligohet që ta prodhojë sendin e luajtshëm të caktuar nga materiali i tij konsiderohet, përkatësisht trajtohet si kontratë për shitjen (neni 601 par. 1 i LMD-së).

Mirëpo kontrata ngel kontratë e veprës – sipërmarrjes, në qoftë se porositësi obligohet ta jap pjesën esenciale të materialit të prodhimit të sendit (neni 601 par. 2 i LMD-së)¹⁹⁵. Por, për çdo rast kontrata konsiderohet si dhe trajtohet si kontratë e veprës – sipërmarrjes, nëse kontraktuesit kanë pasur parasysh posaçërisht punën e kryerësit të punës (neni 601 par. 3 i LMD-së).

¹⁹⁴ Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (“Gazeta Zyrtare e RSFJ-së”, nr.29), 26 maj 1978, fq.1239.

¹⁹⁵ Po aty, fq. 1239.



Mr.sc. Kemajl ADEMAJ



Mr.sc. Bahri HYSENI

MARKAT TREGËTARE

Hyrje

Marka tregtare, si e arritur e punës njerëzore, është pjesë e pronësisë industriale, e cila së bashku me të drejtën e autorit, përbën Pronësinë Intelektuale, si lloj specifik i të drejtave pronësore absolute. Ju qasëm këtij punimi, me shpresë se sado pak do të arrijmë që ta sqarojmë aspektin teorik, historik dhe praktik të kësaj lëmie juridike, aq të rëndësishme dhe me interes, për marrëdhëniet tregtare në dy shekujt e fundit, e posaçërisht për epokën në të cilën po kalojmë. Motiv i posaçëm për të ju qasur kësaj problematike ishte edhe fakti se, në literaturën tone juridike, të pakta janë temat të cilat ju kanë kushtuar pronësisë intelektuale dhe pronësisë industrial gjegjësisht të drejtës së markës tregtare, si e drejtë absolute, e të cilat në kohën më të re, edhe te ne kanë një përdorim të shpeshtë si në sferën teorike ashtu edhe në te praktike. Për ta bërë më të kuptueshëm, sqarimin e materies për të cilën bëhet fjalë në këtë tekst, për shkaqe praktike dhe metodologjike, u përcaktuam që përmbajtjen e tekstit ta strukturojmë si vijon:

- a) Historia dhe zhvillimi i markave tregtare,
- b) Nocioni i të drejtës në markat tregtare,
- c) Regullativa ligjore ndërkombëtare, e cila rregullon të drejtën në marke tregtare,
- d) Regjistrimi i markave tregtare,
- e) Të drejtat e titullarit të markës tregtare, nga e drejta në markën tregtare,
- f) Mbrojtja juridike e përdoruesit të markës tregtare: a). Mbrojtja juridiko civile dhe b). Mbrojtja juridiko penale dhe c). Mbrojtja juridiko administrative.

Gjatë shkrimit të këtij punimi, jemi bazuar në literaturën ekzistuese, rregullativën ligjore, burimet nga interneti dhe praktikën juridike dhe profesionale nga lëmia e përmendur. Duke qenë të bindur se një punim i tillë, paraqet vetëm një përpjekje modeste, që çështjen e trajtuar ta bëjmë sa më të afërt lexuesve dhe praktikuesve të të kësaj materie, me respekt, pranojmë, mirëpresim dhe vlerësojmë çdo vërejtje qëllim mirë e cila do të kontribuonte në ngritjen e nivelit të tekstit të shkruar nga ana jonë.

1. Historia dhe zhvillimi i Markave tregtare

Paraqitjen e markave tregtare, në formën fillestare, e hasim që nga kohrat e lashta, atëherë kur zejtarët rikrijonin nënshkrimin e tyre, ose “markën” në produktet e tyre artistike apo në mjetet e punës. Në atë kohë marka tregtare shfrytëzohej vetëm sa për tu identifikuar pronari i një malli të caktuar. Me fjalë të tjera, marka përdorej për të ruajtur pronën personale nga vjedhja apo humbja. Me zgjerimin e tregtisë dhe me daljen e sajë jashtë përmasave të fisit, funksioni i markave tregtare filloi të ndryshoj, si në aspektin ekonomik, ashtu edhe në aspektin juridik, pra u paraqit nevoja që kjo lëmi të rregullohet me ligj, si për aspektin e përdorimit ashtu edhe të mbrojtjes.

Markat tregtare, e posaçërisht damkat tregtare, janë të vjetra me mija vite. Në porcelanin kinez dhe qeramikën Greke dhe Romake, mijëra vite para erës sonë, janë vendosur damkat, simbole të njerëzve ose punëtorive sipërmarrëse të cilët i kanë prodhuar, e të cilat kanë paralajmëruar për prejardhjen, kualitetin dhe vlerën e vërtetuar të prodhimit. Pronarët e kopeve të kafshëve, kanë pasur secili simbolin e vet, gjë të cilën me hekur të nxehtë e kanë shënjuar në secilën nga kafshët e kopesë, në mënyrë që të tregonin pronësinë e tyre mbi to. Në këtë kohë marka tregtare (mallore) ka pas për obligim që të tregojë pronësinë, si dhe autorësinë ose prejardhjen e prodhimeve dhe shërbimeve.¹⁹⁶

Ligjet e para me të cilat rregullohej marka tregtare së pari u shfaqën gjatë periudhës industriale në Francë në vitin 1857, në Angli më 1862, pastaj në Shtetet e Bashkuara të Amerikës më 1870. Rasti i parë gjyqësorë u zhvillua në Angli, i cili titullohej: Southern kundër How. Ky rast shënoi lindjen e ligjit për markat tregtare në këtë shtet dhe ju dha formë ligjeve për marke tregtare në shumë shtete të botës.

¹⁹⁶ Marrë nga: "<http://hr.wikipedia.org/wiki/Brand>"

Me këtë rast u bë zhvendosja e fokusit primar të ligjit për marke tregtare, nga keqpërdorimi-problemi i vendosjes së markës së konkurrentit në produktet e veta, në parandalimin e konkurrencës jolojale përmes keqpërdorimit të markave. Sipas trajtimit historik të këtij rasti nga gjykatat dhe studiuesit, rasti ilustron faktin se marka tregtare funksionon si garantues i cilësisë, orientues për konsumatorët që kërkojnë produkte të sigurta, si masë siguruese se shpërblimet nga shitja e mallrave u shkojnë investitorëve të cilët posedojnë emër tregtar¹⁹⁷ i cili përfaqëson qëllim dhe reputacion të mirë dhe njëkohësisht mbron të drejtat dhe detyrimet që ndërlidhen me pronën, të njohur si markë tregtare, më konkretisht si lloj i veçantë i pronësisë industriale, e cila së bashku me të drejtën e autorit paraqet tërësinë e llojit specifik të të drejtës pronësore, e njohur si e drejta e pronësisë intelektuale.

Me zhvillimin e hovshëm të marrëdhënieve tregtare, sidomos në shek XIX dhe XX, mbrojtja dhe trajtimi i markës tregtare, gjithnjë e më tepër mori kahen e mbrojtjes së prodhuesve dhe konsumatorëve nga “plagjiatorët” në marrëdhëniet prodhuese dhe tregtare, të cilët duke përdorur forma jolojale në marrëdhëniet tregtare, përpos tjerash, nuk ngurrojnë që edhe markat tregtare të mbrojtura dhe me renome, ti përdorin pa autorizim ose ti falsifikojnë në mënyra të ndryshme. Kuptohet shtytësi kryesor për ndërmarrjen e veprimeve të tilla, është dëshira joreale për afarizëm sa më të madh të subjekteve tregtare të cilët dëshirojnë-pretendojnë që pa mundë real tua kalojnë rivalëve të tyre, duke provuar që të keqpërdorin apo thjeshtë të uzurpojnë renomenë e huaj.¹⁹⁸ Sot, e drejta në markat tregtare, përdoret fillimisht për mbrojtjen e interesave të ndërmarrjeve, por njëkohësisht shërben dhe në mbrojtjen e interesave të konsumatorëve. Markat tregtare u mundësojnë konsumatorëve të zgjedhin në mes të shumë mallrave dhe shërbimeve që sot ofrohen në treg, dhe ato pretendojnë që me besnikëri të tregojnë dhe t’i sigurojnë konsumatorët, se të gjitha mallrat të cilat janë me një markë tregtare, vijnë nga i njëjti burim. Gjithashtu përmes tyre, sigurohen prodhuesit, se marka e tyre tregtare, në të cilën kanë investuara para dhe mundë, në mënyrë të sigurt do të jetë e mbrojtur juridikisht, nga keqpërdoruesit eventual të markës tregtare.

¹⁹⁷ Mbrojtja dhe zbatimi i markave tregtare, Për EMSG-Menaxhimi Ekonomik për Stabilitet dhe Zhvillim, Sponsoruar nga USAID 2008, përgaditur nga Luljeta Plakolli-Kasumi, LL.M., Modulim I, Bazat dhe qëllimet e markave tregtare, fq.3.

¹⁹⁸ Prof.Dr. Mehdi J. Hetemi, Mbrojtja e tregut të lirë nga konkurrenca jolojale (aspekte krahasimore), Prishtinë, 2004, fq.27.

Historikisht, markat tregtare edhe në Shqipëri dhe në trevat tjera shqiptare, në formën e tyre arkaike, janë paraqitur shumë herët dhe atë në formë të damkave dhe shenjave, të cilat kryesisht shërbenin për identifikimin dhe shënjimin e sendit, me qëllim të ruajtjes së pronësisë mbi sendin, kurse në formën bashkëkohore, Pronësia Industriale (pronësia industriale në përgjithësi e edhe marka tregtare në veçanti) në Shqipëri i ka fillimet e saj në vitin 1920. Nga burimet arkivore të kohës mësojmë se tregtarët shqiptarë kanë qenë tepër të ndjeshëm ndaj ruajtjes së produkteve të tyre nga falsifikatorët.

Për të realizuar këtë gjë ata kërkonin mbrojtjen e prodhimeve të tyre me anën e regjistrimit të Markës. Certifikata e parë e Regjistrimit daton në 16 Prill 1920. Janë burimet arkivore ato që na mundësojnë të mësojmë se Shqipëria mund të renditet denjësisht krahas vendeve të rajonit e më gjere si një vend ku Marka dhe rëndësia e mbrojtjes së saj nuk i kanë fillesat tani por qysh në fillimet e shekullit të njëzetë. Sistemi i saporeferuar më sipër pati fuqi deri në vitin 1944. Edhe gjatë viteve të sistemit monist në Shqipëri, konkretisht në vitin 1957. Qeveria e asaj kohe me një vendim të saj in njohu regjistrimin e Markave të huaja në Shqipëri.

Në këtë vit Dhoma e Tregtisë plotësonte formalitetet dhe dokumentacionin përkatës për regjistrimin e markave tregtare të huaja në Shqipëri, në bazë të dispozitave ligjore në fuqi “Për Markat e Prodhimit dhe Tregtisë”. Pas rënies së sistemit monist, me VKM (Vendimin e Këshillit të Ministrave) nr.135 datë 22.03.1993 u krijua i Zyra e Patentave në vartësi të Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë për regjistrimin dhe mbrojtjen e patentave, markave tregtare dhe dizenjove industriale dhe emërtimeve të origjinës. Tani Ligji Nr.9947, Datë 07/07/2008, "Për Pronësinë Industriale", ka për qëllim rregullimin e sistemit të dhënies dhe të mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale.¹⁹⁹

Gjithashtu edhe në Kosovë, shquar në të kaluarën historike të saj, hasim një zhvillim përafërsisht të njëjtë të paraqitjes dhe zhvillimit të markave tregtare. Edhe në Kosovë, markat tregtare gjegjësisht shënimet e mallrave, në formën e tyre arkaike, janë paraqitur shumë herët dhe atë në formë të damkave dhe shenjave, të cilat kryesisht shërbenin për identifikimin dhe shënjimin e sendit, me qëllim të ruajtjes së pronësisë mbi sendin dhe identifikimin e pronarit të sendit, për ta dalluar atë (mallin) nga mallrat e

¹⁹⁹<http://webcache.googleusercontent.com/search?q=cache:XvDHOc0XFEJ:www.alpto.gov.al/home.asp%3F1%3Dal+ligji+per+markat+tregtare&cd=7&hl=en&ct=clnk&source=www.google.com>

tjera dhe njëkohësisht për të shprehur, cilësinë e mallit, krenarinë e pronarit për sasinë dhe cilësinë, supremacinë ndaj mallrave të konkurrentëve etj.

Një formë të tillë arkaike, edhe sot e hasim, në trevat fshatare kryesit në vendbanimet të cilat merren me blegtori, në atë formë ku pronari i kopesë së deleve me shenja dalluese damkosë-markon-shënjon delet e tij gjegjësisht të gjitha delet e kopesë së tij. Ata me mirëbesim rregullojnë këto shenja “marka” dhe nuk lejojnë që në kuadër të një treve, të shënohen dy kope delesh me të njëjtën shenjë “markë”. Përpos kësaj hasim edhe në shumë relikte të ngjashme, si shënimi i firmave dhe “markave” shenjave dalluese në mallrat zejtare e etj. Deri në vitin 1999, markat tregtare në Kosovë, përcaktoheshin dhe rregulloheshin në bazë të Ligjeve të cilat vlenin për territorin e RSFJ-së, dhe ligjeve të KSAK-së, kurse pas vitit 1999 kjo çështje fillimisht u rregullua me rregullore të UNMIK-ut, kurse tani është e përcaktuar me Ligji Nr. 02/L-54 Për Markat Tregtare të datës 23 shkurt 2006, të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës.

Kuvendi i Kosovës, për të rregulluar dhe mbrojtur në mënyrë më efektive, markat tregtare dhe format tjera të pronësisë Industriale, ka nxjerr Ligji Nr. 03/L - 170 Për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, Ligji Nr. 03/L – 170, 29 dhjetor 2009 dhe Ligjin për Dizajnin Industrial nr.02/ L-45²⁰⁰. Udhëzimin administrativ për organizimin dhe funksionimin e Zyrës për pronësi industriale, Nr 2007/06, të datës: 19.03.2007, Udhëzimi administrativ për përfaqësimin e të drejtave të pronësisë industriale nr. 2008/16, të datës: 19.09.2008, Udhëzimin Administrativ për aplikimet e Patentave, Markave Tregtare, Dizajnëve Industriale, Patentave të lëshuara, Markave tregtare dhe Dizajnëve Industriale të njohura para hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, Nr. 2007/14, të datës 19.09.2008, Udhëzimi administrativ për procedurat e regjistrimit të markave tregtare nr. 2008/13, i datës:17.09.2007. Nga e gjithë kjo që u cek më lartë, me të drejtë mund të konstatojmë se Kosova tani ka krijuar rregullativën e nevojshme për sigurimin e mbrojtjes adekuate të markave tregtare, në përputhshmëri me normat e direktivave sipas konventave ndërkombëtare si dhe në pajtueshmëri me legjislacionin dhe praktikën e UE-së dhe vendeve anëtare të saj.

²⁰⁰ Për më tepër Ministria e Tregtisë dhe Industrisë e Republikës së Kosovës, ka nxjerrur edhe udhëzimin administrativ Nr.2008/16 për përfaqësimin e të drejtave të pronësisë industriale të datës 19.09.2008, Udhëzimin administrativ nr.2007/06 Për organizimin dhe funksionimin e Zyrës për Pronësinë Industriale të datës 19.03.2007 e tj.

Duke pas parasysh zhvillimin e tregtisë edhe në përmasa ndërkombëtare, kaheër është paraqitur nevoja që markat tregtare të përkufizohen dhe rregullohen edhe me akte të karakterit ndërkombëtar. Krejt kjo me qëllim të harmonizimit të rregullativës ligjore të çdo shteti veç e veç, me qëllim të sigurimit të kushteve për qarkullimin e lirë të mallrave dhe shërbimeve dhe mbrojtjen e markës tregtare, si një komponentë e rëndësishme në marrëdhëniet tregtare. Prandaj, në Evropë harmonizimi është arritur përmes Direktivave të BE-së, të cilat kanë për qëllim largimin e barrierave që do të pengonin synimet e tregut të përbashkët të paraparë në Traktatin e Komuniteti Ekonomik Evropian (EEC)

2. Nocioni, i të drejtës në markat tregtare

Marka tregtare është shenjë dalluese që u vihet prodhimeve të ndryshme për të treguar llojin, cilësinë dhe ndërmarrjen ose vendin ku janë prodhuar, prodhim me cilësitë caktuara, që mban një shenjë të tillë. *Markë shqiptare (e huaj). Marka e fabrikës (e uzinës). Mall pa markë.*²⁰¹

Marka tregtare, si pjesë e pronësisë industriale, ashtu si edhe e drejta e autorit, është e drejtë subjektive dhe si e tillë i përket grupit të të drejtave absolute.²⁰²

Titullari i drejtave nga pronësia industriale ka të drejtën e përdorimit, të drejtën e disponimit, përveç rasteve përjashtimore, si dhe të drejtën e kompensimit kur një e drejtë konkrete bartet për shfrytëzim tek subjekti tjetër. Në rast të shkeljes së të drejtës, titullari mundë të kërkoj mbrojtje juridike-gjyqësore. Për realizimin e mbrojtjes gjyqësore ushtrohet padia konkrete. Gjykata, natyrisht se jep vendim konkret, sipas të cilit urdhëron ndalimin e cenimit të të drejtave të cilat rrjedhin nga pronësia industriale gjegjësisht marka tregtare dhe kompensimi i dëmit i cili i është shkaktuar pronarit.²⁰³ Termi pronësi industriale, rrjedhë nga katalogut nga neni 1 të Konventës së Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale, për patentën, modelin, mostrën industriale, varruat mallore dhe të shërbimeve, emrin tregtar, shenjën ose emrin e origjinës. Në kohën më të re, konsiderohet se dhe përparimi teknik dhe know-how (dija dhe përvoja) gjithashtu janë kategori të pronësisë industriale. E përbashkët e të gjitha formave të pronësisë industriale është se, të gjitha ato janë të drejta të karakterit absolut

²⁰¹ Akademia e shkencave shqiptare, Fjalor i shqipes së sotme, Botimi i dytë i ripunuar, Botimet Teona, Tiranë, 2002, fq. 731.

²⁰² Prof Dr. Osman Kadriu, Hyrje në të drejtën civile, Shkup 2008, fq.287

²⁰³ Op.cit., fq.290.

(pra veprojnë erga omnes), përpos përparimit teknik dhe know-how, të cilat kanë karakter relativ, sepse karakteri i veprimit absolut të këtyre të drejtave, ekziston vetëm deri sa ato janë sekrete, pasi që nëse zbulohet sekreti mbi të cilin bazohen këto forma të pronësisë industriale, atëherë çdo person i tretë mundë të shërbehet me to pa kufizime, me kusht që deri te këto njohuri të ketë ardhur në mënyrë origjinere dhe të ndershme.²⁰⁴

Marka tregtare është e shprehur dhe regjistruar si: emër, fjalë, shenjë, simbol ose kombinim i tyre, që përdoret për të identifikuar një shërbim apo produkt të një shitësi dhe për të bërë ndryshimin nga konkurrentet. Marka është një fjalë, simbol, vizatim, apo këmbimin i fjalëve, i frazave, simboleve apo vizatimeve që identifikojnë dhe dallojnë burimin e mallrave të një pale nga ato të një pale tjetër. Përkufizimi i markës se shërbimit është i njëjtë me atë të markës tregtare, me përjashtim që ato identifikojnë dhe dallojnë burimin e shërbimeve dhe jo produktet.

1. **Markë “me fjalë”**, është: kur shenja dalluese është e përbërë nga fjalë.
2. **Markë “me figurë”**, është kur shenja dalluese është e përbërë nga figura dhe/ose nga vizatime.
3. **Markë “me figurë dhe fjalë”**, është kur shenja dalluese përbëhet nga Fjalë dhe Figura dhe /ose Vizatime.²⁰⁵

Sipas rregullativës ligjore në Kosovë, shenjat të cilat mund të mbrohen gjegjësisht të kenë epitetin e Markës tregtare janë:

- Të gjitha shenjat, në veçanti fjalët, duke përfshirë edhe emrat personal, vizatimet, shkronjat, numrat, markat zërore (audio), trajtat tredimensionale, duke përfshirë edhe trajtën e mallrave ose mbështjelljes apo paketimin tjetër të tyre, ngjyrat, kombinimet e ngjyrave, që janë në gjendje të dallojnë një mall ose shërbim që ofrohet nga një ndërmarrje nga mallrat dhe shërbimet që ofrohen nga ndërmarrje të tjera, mund të mbrohen si marka tregtare.
- Shenja që përbëhet vetëm nga forma, nuk mund të mbrohet si markë tregtare nëse forma në fjalë:
 - a. rezulton nga natyra e vetë mallit;
 - b. është e nevojshme për të arritur një rezultat teknik; ose
 - c. i jep vlerë thelbësore mallit përkatës.

²⁰⁴ Enciklopedija Imovinskog prava I prava udruzenog rada I-III tom prvi, Novinsko-Izdavacka ustanova, Sluzbeni List SFRJ, Beograd, 1978-Grupa autora, deo, Industrijsko vlasnistvo, dr.Albert Verona, fq.617-619.

²⁰⁵ website: www.cci.al

- Kudo që në këtë ligj shfrytëzohet termi “markë tregtare”, ky term përfshin gjithashtu edhe markën kolektive tregtare dhe markën e certifikimit.²⁰⁶

Marka krijon identitet të produktit dhe mundëson besnikërinë e konsumatoreve ndaj tij. Marka krijon identifikim të konsumatorit për produktin që blen, pasi që konsumatori nëpërmjet markës arrin të dallojë burimin e origjinës së një produkti apo shërbimi. Në këtë mënyrë, marka paraqet kartë vizitën reale të Biznesmenit, dhe Produktit. Marka njëkohësisht paraqet edhe mjetin nëpërmjet të cilit konsumatori bënë zgjedhjen e produktit ndërmjet shumë produkteve të tjera. Marka krijon besnikërinë tek konsumatori dhe i kursen në kohë, me rastin e blerjes së produkteve, pasi që konsumatori i beson markës të cilën e njih dhe kështu e merre mallin e dëshiruar duke qenë i njohur paraprakisht (nëpërmes markës tregtare), për cilësinë, kualitetin dhe prejardhjen e mallit të konsumatori.

Të drejtat e dhëna nga marka tregtare konsistojnë në mundësinë e përdorimit në mënyrë ekskluzive të Markës për të bërë dallimin e produkteve dhe shërbimeve të fabrikuara apo të hedhura nga tregu i huaj në vendin tonë (aty ku është bërë regjistrimi i Markës). Në shumë Aktivitete ekonomike, Marka është vlera kryesore në Kompani. Vlera e markave të njohura botërore, arrin shumën prej miliarda dollarësh. Marka, megjithëse është e mirë jo materiale, ka një vlerë ekonomike shumë të madhe, sidomos për ato Kompani të cilat kanë për qëllim identifikimin e produktit me Markën.

Në një ilustrim figurativ po paraqesim disa nga markat tregtare të njohura, për opinionin.²⁰⁷



²⁰⁶ Neni 3. I Ligjit për Markat tregtare Nr. 02/L-54, i datës 23 shkurt 2006.

²⁰⁷ Marrë nga: <http://hr.wikipedia.org/wiki/%C5%BDig>

Fig.1. Marka të njohura botërore të mallrave dhe shërbimeve



Fig.2 Marka të njohura cigaresh

Fig.3 Marka të njohura, të produkteve të ndryshme



Fig.4. Marka të njohura botërore, në lëminë e prodhimit të automobilave.

Shumë teoricienët qëllim kryesor të markës tregtare konsiderojnë njohjen ose dallimin e prodhime. Kotleri në librin e tij *Marketing management* markën tregtare ja dedikon dallimin e prodhimit të një ose një grupi prodhuesish si dhe për dallimin nga prodhimet e konkurrentëve. Arritje të madhe në të kuptuarit e markës tregtare ka bërë Jean Noel Kapferer në librin *Brand management* (Menagjmenti i markës tregtare) kur ka konstatuar se

marka tregtare nuk është prodhim, por përbërja e prodhimit dhe për këtë e njëjta paraqitet si kategori metafizike.

Elementet e markës

Elementet e markës, të cilët nganjëherë quhen edhe identitete të markës, konsiderohen elementet të cilët është e mundur që juridikisht të regjistrohen dhe të mbrohen, e që përbëjnë:

- **Emrin e markës** – *Brand name* – Pjesën e markës e cila mundë të zhigohet ose damkoset, e cila përbëhet nga fjalët, shkronjat dhe numrat.
- **Shenjën e markës** – *Brand mark* – Identitetin vizual të markës. Pjesën e pashprehur me fjalë por të dukshëm për tu vërejtur të markës. Si që janë simboli, dizajni, kombinimet e ngjyrave e etj.
- **Shenja mbrojtëse** – *Grade mark* – Shenja ligjore e cila tregon se pronari ka të drejtën ekskluzive për përdorimin e markës ose pjesëve të sajë, p.sh. shenjat: ® ©.

Vlera e markës tregtare

Markat tregtare kanë vlerën e tyre në treg, por pak nga kompanitë e mëdha e dinë se sa është vlera e markës së tyre tregtare pasi që është vështirë të llogaritet vlera e saktë e sendit që varet nga, bie fjala, vlerësimi i konsumatorëve dhe njohurisë e tyre lidhur me markat tregtare në qarkullimin e mallrave.

Vlera e tregut të markës tregtare, përmban konsekuencat e marketingut të investuara në qeverisjen e markës tregtare. Vlera e markave të njohura tregtare, e shprehur në tregues financiar mundë të jetë në qindra miliona dollar amerikan. Gjithashtu, ekzistojnë shumë metoda sipas të cilave llogaritet dhe caktohet vlera e tregut të markës tregtare,²⁰⁸

²⁰⁸ Metoda e njohur për caktimin e vlerës së tregut të markës tregtare është *masa e kompenzimit* të cilën e kanë zhvilluar Longman dhe Moran. Sipas këtij modeli, tregues qenësorë të vlerës së tregut të markës tregtare është shkalla e blerjes së përsëritur, gjithashtu me pjesëmarrjen tregtare. Kjo shkallë tregon sa konsumator të cilët kanë blerë markën e caktuar tregtare herën e fundit, këtë do ta bëjnë edhe herën e ardhëshme. Do të thotë se vlera e tregut të markës, është më e madhe nëse shkalla e përsëritjes është më e madhe.

Përpos blerjes së përsëritur, aspekti kuantitativ i vlerës së markës tregtare mundë të shiqohet edhe përmes pjesëmarrjes në treg, të hyrave dhe profitit, shkallës së kthimit në mjetet e investuara dhe dallimet në qmim në krahasim me konkurentët kryesor.

Vlera kualitative e markës tregtare paraqet: perceptimin e kualitetit, knaqëshmërinë ose jokënaqëshmërinë e konsumatorëve-shfrytëzuesve, lojalitetin e tyre, përparsitë konkurente të mallrave dhe shërbimeve-Nxjerrë nga: <http://hr.wikipedia.org/wiki/Brand>" Kategorija: Ekonomski pojmovi

Markat private

Markat private - private label – mundë të ndahen në: 1. *Marka tregtare ekonomike private karakteristike e të cilave është çmimi I ultë, por edhe kualiteti I ultë. Ato, zakonisht tregtarëve u shërbejnë për të vënë kontrollin ndaj prodhuesve dhe* 2. *Markat tregtare private të premisë, zakonisht tregtarët i shfrytëzojnë në fazën e dytë të aplikimit të markave tregtare private. Kualiteti i tyre është i njëjtë si edhe te prodhimet e grupit të njëjtë të grupit të mallrave, por çmimi i tyre është më i ultë.*

Markat tregtare globale

Ndërmarrjet të cilat internacionalizojnë afarizmin e tyre, ballafaqohen me problemet e zgjedhjes së markës tregtare me tregjet ndërkombëtare. **Standardizimi** – një emër, shenjë, slogan i markës – është e përbashkët për të gjitha tregjet, ose **adaptimi** – përshtatja specifike të çdo vendi.

Përparësitë e markës globale: 1. Markat tregtare globale mundësojnë zbatimin e ndërrimeve ekonomike me ndërrimet territoriale, si në: zhvillimin e markave, promovimin e markave, paketimin dhe përgatitjen të prodhime të ndryshme, me të cilat arrihen kursime të cilat krijojnë pozicion më të mirë në konkurrencën e tregut, 2. Markat globale kanë përparësi në zhvillimin e vetëdijes për markat.

Konsumatorët-shfrytëzuesit janë të ndikuar nga marka edhe kur udhëtojnë në botën e jashtme, 3. Numri më i madh i markave globale drejtpërsëdrejti asocion në vendin e prodhuesit, duke ndërtuar me këtë imazhin e vendit prej nga vjen prodhimi.²⁰⁹

3. Regullativa ligjore ndërkombëtare, e cila rregullon të drejtën në markat tregtare

Me qëllim të rregullimit të materies nga markat tregtare, sot janë nxjerrë shumë konventa ndërkombëtare dhe direktiva, të cilat mundësojnë rregullimin uniform të regjistrimit, përdorimit dhe brohoritjes së markave tregtare. Tani, tregtia dhe qarkullimi i mallrave, as qe mundë të merret me mend si një veprimtari vetëm e brendshme-kombëtare.

²⁰⁹ Marrë nga: "<http://hr.wikipedia.org/wiki/Brand>"
Kategoria: Ekonomski pojmovi

Pra kjo lëmi, pa karakterin ndërkombëtarë të sajë, as që mundë të merret me mend. Kjo edhe ka kërkuar dhe kërkon, nevojën gjithnjë e më të dhe për rregullativen juridike të karakterit ndërkombëtarë. Në mesin e shumë instrumenteve ndërkombëtare, Instrumentet më të njohura ndërkombëtare dhe të BE-së të cilat rregullojnë Markat Tregtare janë:

- ❖ Konventa e Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale (20 Mars 1883, e administruar nga Organizata Botërore për Pronësi Intelektuale-OBPI, me 172 Shtete Kontraktuese), e cila njëherit është traktati i parë ndërkombëtarë, në fushën juridike të Pronësisë Intelektuale, e cila vendosë rregulla dhe parime të përbashkëta për të gjitha shtetet kontraktuese.
- ❖ Marrëveshja e Madridit për Regjistrimin Ndërkombëtar të Markave Tregtare (1891), si dhe Protokollin që i përket Marrëveshjes së Madridit (1989), e administruar nga OBPI, i ashtuquajturit Sistem i Madridit, iu mundëson pronarëve të markave tregtare që ti regjistrojnë markat e tyre në të njëjtën kohë në shumë shtete anëtare, në vend se të aplikojnë veç e veç në secilin shtet. Pra, sipas kësaj marrëveshje, Pronarit të markës tregtare, i jepet një Regjistrim Ndërkombëtar, për markën tregtare.
- ❖ Marrëveshja TRIPS (e administruar nga Organizata Botërore e tregtisë-OBT, është marrëveshja më gjithëpërfshirëse ndërkombëtare, e cila kërkon nga shtetet anëtare të veprojnë në pajtim me dispozitat përmbajtjesore të traktateve të administruara nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale (OBPI), p.sh. Konventa e Madridit dhe Sistemi i Madridit.
- ❖ Direktiva e Parë e Këshillit 89/104/EEC (1988)-, i përafrohet ligjet për markat tregtare të Shteteve Anëtare, por njëkohësisht duke mos penguar fushëveprimin territorial të ligjeve të tyre kombëtare.
- ❖ Rregullorja e Këshillit (EC) Nr. 40/94, për Markën Tregtare të Komunitetit (27 shtete anëtare), i mundëson pronarit të markës tregtare, që me një aplikacion të vetëm ta regjistrojë markën tregtare në të gjitha shtetet anëtare të kësaj Rregulloreje.²¹⁰

4. Regjistrimi i markave tregtare

Për ta fituar cilësinë e të drejtës së mbrojtur me ligj, marka tregtare duhet të jetë e regjistruar në Regjistrin e Markave Tregtare, të themeluar dhe mbajtur nga Zyra për Patentim në përputhshmëri me Pjesën IV të Ligjit për markat

²¹⁰ Mbrojtja dhe zbatim i markave tregtare, Për EMSG-Menaxhimi Ekonomik për Stabilitet dhe Zhvillim, Sponsoruar nga USAID 2008, përgaditur nga Luljeta Plakolli-Kasumi, LL.M., Moduli 2.4, Instrumentet Kryesore Ndërkombëtare dhe ato të Acquis Communitarie të BE-së relevantet për Markat tregtare, fq.3-4.

tregtare Nr. 02/L-54, të datës 23 shkurt 2006, të përshkruar në nenin 58, ku përcaktohet se: Zyra e Patentave mban një Regjistër të Markave Tregtare (“Regjistri i Markave tregtare” ose “Regjistri”) dhe kur të flitet për regjistrime në këtë Ligj (posaçërisht shprehja “markë e regjistruar tregtare”) bëhet fjalë për regjistrimet në këtë regjistër, përveç nëse nuk është përcaktuar ndryshe.

- Në regjistrin e markave tregtare, sipas këtij ligji, hyjnë:
 - a. markat e regjistruara tregtare;
 - b. veçoritë e transaksioneve të cilat kanë ndikim në markën e regjistruar tregtare; dhe
 - c. çështje të tjera që mund të përcaktohen.

- Regjistri i markës tregtare mbahet në formën e përcaktuar, dhe duhet të mundësoj:
 - a. shikimin e regjistrit nga ana e publikut, dhe
 - b. furnizimin me kopje të vërtetuara ose të pa vërtetuara, ekstrakte, të aplikacioneve në regjistrin e markës tregtare.

Në mënyrë ilustruese, kemi paraqitur, disa nga markat tregtare të regjistruara në Kosovë²¹¹.

Shembulli nr.1.

(111) 135

(151) 10/02/2010

(181) 25/02/2013

(210) 2943

(220) 06/10/2008

(300) 25/02/2003

(732) Colgate-Palmolive Company, a Delaware corporation, 300 Park Avenue, New York, New York, US

(540)



²¹¹ Shembujt nga nr.1/3, jan marrë, nga Buletini Zyrtar i Zyrës së Pronësisë Industriale, pran Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Prishtinë, nr.01 Prishtinë më 09/12/2010.

(591) E Kuqe, kaltër, verdhë, bardhë.
(511) 3 Pastë për dhëmbë.
(740) Ragip Malushaj Kodra e Diellit, Qendra Tregtare.lok.60
Prishtinë/Kosovë.

Shembulli nr.2.

(111) 230
(151) 01.03.2010
(181) 07.02.2011
(210) 722
(220) 29.05.2008
(300) 07.02.2001
(732) SWEDISH MATCH INDUSTRIES AKTIEBOLAG; Vastra
Drottningvagen,
S-52222 Tidaholm, SE
(540)



(591) Ngjyrat: ngjyra e kuqe, e zezë, e verdhe dhe e bardhë
(511) 34 Duhan, pajisje për duhanpirës; qibrit; shkrepëse.
(740) “ PRISHTINA PATENT ” , Rr. Ilaz Agushi Nr. 114 Prishtinë /
Kosovë

Shembulli nr.3

(111) 960
(151) 06/04/2010
(181) 13/03/2009
(210) 2537
(220) 25/09/2008
(300) 13/03/1989
(732) TDR d.o.o. Obala Vladimira Nazora 1, 52210 Rovinj, HR
(540)



(591) E kaltër e mbyllur, ngjyrë e artë dhe e bardhë.

(511) 34 Filtër cigare.

(740) “Prishtina Patentë”, Rr. Ilaç Gushi Nr. 114 Prishtinë/Kosovë.

Nga ana tjetër, fakti që marka tregtare është regjistruar në Regjistrin e markave tregtare, nuk bën pjesë në shkaqet e refuzimit të një kërkesë për regjistrim. Kjo bën pjesë në të drejtën e pronarit të mëparshëm të markës që të vendosë nëse do të lejojë ose kundërshtojë regjistrimin e saj.²¹²

Procedurat për regjistrimin e markës tregtare

Janë radhitur në nenin 33 deri 49 të Ligjit, kurse kushtet tjera për regjistrim gjithashtu janë paraparë në Udhëzimin administrativ (UA) nr. 2007/13 mbi Procedurat e Regjistrimit të Markave tregtare të lëshuar nga Ministria për Tregti dhe Industri.

Regjistrimi i markës tregtare kalon nëpër disa faza: Kërkimi i markës tregtare, Parashtrimi i kërkesës, Procesi i shqyrtimit të aplikacionit, Publikimi dhe kundërshtimi dhe në fund Regjistrimi i markës tregtare.

Efekti i Markave të regjistruara tregtare dhe të drejtat që barten me regjistrimin e Markës tregtare

Pronari i markës së regjistruar tregtare mban të drejta ekskluzive lidhur me mallrat ose shërbimet e mbuluara nga regjistrimi, si vijon: a. shfrytëzimi i markës tregtare, b. autorizimin për të tjerët për shfrytëzimin e markës

²¹² <http://uccial.al/al/faqe/zyra-e-markave-dhe-patentave>

tregtare, c. lejimin e shfrytëzimit nga të tjerët; ose d. të shfrytëzojë mjete juridike kundër shkeljes së markës tregtare sipas nenit 14 të këtij ligji.

Shkelja e një marke të regjistruar tregtare

Në kuptim të këtij ligji, do të thotë shkelje të cilësdo nga të drejtat e pronarit të markës së regjistruar tregtare. Të drejtat e pronarit të markës së regjistruar tregtare, hyjnë në fuqi prej datës së regjistrimit të markës tregtare sipas nenit 41.3 të Ligjit. Pavarësisht nga neni 13.3 i këtij ligji: a. asnjë procedurë për shkeljen e të drejtave të pronarit të markës tregtare nuk mund të iniciohen para datës së publikimit të regjistrimit të markës tregtare; dhe b. asnjë shkelje sipas nenit 82 të këtij ligji, para kësaj date nuk do të merret për bazë.²¹³

Shkelja e të drejtës së Markës së regjistruar tregtare

Asnjë person ose ndërmarrje gjatë aktiviteteve tregtare nuk mund të shfrytëzojë një shenjë që është në masë substanciale identike, ose e ngjashme me një markë të regjistruar tregtare pa lejen e pronarit të markës tregtare. Shfrytëzimi i paautorizuar i markës tregtare konsiderohet si shkelje e të drejtave pronësore mbi markën e regjistruar tregtare.²¹⁴

Marrëveshja e klasifikimit NICE

Me qëllim të regjistrimit të një marke tregtare, paraqitësi I kërkesës për regjistrim të markës tregtare, fillimisht duhet të përcaktuar klasa të cilës i takojnë mallrat dhe shërbimet për të cilat regjistrohet marka. Kjo bëhet në bazë të Klasifikimit Ndërkombëtar (NICE) të Mallrave dhe Shërbimeve për Qëllim të Regjistrimit të Markave, e cila është e themeluar përmes një marrëveshjet arritur në Konferencën Diplomatike në Nicë, në vitin 1957.

Në bazë të këtij klasifikimi, mallrat dhe shërbimet të cilat identifikohen në aplikacionin për regjistrim të markës tregtare, duhet të organizohen në klasë të numëruara, duke i futur kështu në grupe mallrat e ngjashme ose përkatëse. Marrëveshja NICE rregullisht shqyrtohet nga OBPI, dhe për çdo pesë vite del nga një version i ri. Që nga janari i vitit 2007 aplikohet Botimi i IX i Marrëveshjes së Klasifikimit NICE. Në këtë botim ekzistojnë 34

²¹³ Shih nenin 13 të Ligjit për market tregtare.

²¹⁴ Neni 14.1 i Ligjit të përmendur.

klasë të mallrave (1 deri në 34) dhe 11 klasë të Shërbimeve (35 deri në 45). Edhe Kosova e përdorë Marrëveshjen e klasifikimit NICE.

Regjistrimi ndërkombëtar i Markave Tregtare-Sistemi i Madridit

Sistemi i Madridit për regjistrimin ndërkombëtar të Markave Tregtare, përbëhet prej dy traktateve: Marrëveshjes së Madridit lidhur me Regjistrimin Ndërkombëtar të Markave, e cila është arritur në vitin 1891 dhe ka hy në fuqi më 1892 dhe Protokollit për Marrëveshjen e Madridit, i cili u operacionalizua me 1 Prill 1996. Ky sistem siguron regjistrimin e markës tregtare në shumë shtete përmes një aplikacionit vetëm të paraqitur në Byronë Ndërkombëtare të Organizatës Botërore për Pronësi Intelektuale (OBPI).

Edhe kjo formë e regjistrimit, bëhet duke kaluar etapat e regjistrimit si vijon: Paraqitja e kërkesës, Regjistrimi, Lajmërimi, dhe Publikimi, Shqyrtimi i Aplikacionit nga Zyrat Kombëtare të Shteteve të Emëtuara Kontraktuese dhe në fund Regjistrimi. Nëse kërkesa për regjistrim ndërkombëtar është parashtruar në bazë të Marrëveshjes, regjistrimi i sajë do të jetë efektiv për 20 vite, me mundësi vazhdimi edhe për 20 vite të tjera, kurse nëse kërkesa për regjistrim ndërkombëtar është parashtruar në bazë të Protokollit, regjistrimi i sajë do të jetë efektiv për 10 vite, me mundësi vazhdimi edhe për 10 vite të tjera.

Regjistrimi i Markave Tregtare Komunitare (MTK)

Regjistrimi i Markave Tregtare Komunitare (MTK) siguron regjistrimin e një marke tregtare në 27 vende anëtare të Bashkimit Evropian me një aplikacion të vetëm të paraqitur në Zyrën për Harmonizim të Tregut të Brendshëm, e cila xhindet në Alicante, në Spanjë. Vetëm aplikuesit nga shtetet anëtare të BE-së dhe shtetasit e vendeve jashtë BE-së të cilët janë pale të Konventës së Parisit mundë të aplikojnë për një MTK.

Meqenëse Komuniteti Evropian përfaqëson një treg të vetëm, për dallim nga regjistrimi ndërkombëtar i bazuar në Sistemin e Madridit, në këtë formular nuk nevojitet të merohet një shtet i caktuar i BE-së. Përkundrazi MTK është e vlefshme në mbarë Komunitetin Evropian. Me fjalë të tjera, me marrjen e MTK-së, sigurohet mbrojtja në mbarë Unionin Evropian. Gjithashtu

regjistrimi i një MTK-je sajë do të jetë efektiv për 10 vite, me mundësi vazhdimi edhe për 10 vite të tjera.²¹⁵

5. Të drejtat e titullarit të markës tregtare, nga e drejta në markën tregtare

Titullari i markës tregtare, ka të gjitha të drejta të cilat i ka pronari i të drejtave ndaj kategorive tjera të të drejtave absolute. Pra ai ka të drejtën e disponimit, shfrytëzimit dhe tjetërsimit, sipas kushteve të përcaktuara me ligj.

Të drejtën e disponimit të markës tregtare

Pronari i sajë e realizon, ashtu që vetëm ai është personi i cili mundë ta disponoj dh eta paraqes sit ë vetën markën tregtare, të cilën e ka regjistruar dhe me të cilën prezanton prodhimet e tija në treg. Askush tjetër, nuk ka të drejtë që markën me të njëjtin emër ta përdorë gjegjësisht ta regjistroj për prodhime nga lëmia e caktuar. Pronari i sajë është i vetmi, ai që mund ti përdorë shenjat, shkronjat, numrat, ngjyrat e etj., të cilat i ka regjistruar si markë të tij tregtare.

Të drejtën e shfrytëzimit të markës tregtare

Pronari i markës tregtare, e manifeston në atë mënyrë që markën e tij të regjistruar, lirshëm dhe pa pengesë e përdorë në prodhimet e tija, në ambalazhe, reklama dhe forma tjera, në atë mënyrë që përmes sajë shprehë dhe përfiton nga reputacioni i tij në treg. Duke u bazuar në këtë të drejtë të tij, pronari është i vetmi i autorizuar që ka të drejtë dhe mundësi të vendosë, se a dëshiron ta mbrojë edhe më tutje këtë të drejtë, apo të njëjtën ta braktisë.

Të drejtën për tjetërsimin e markës tregtare

Gjithashtu pronari i sajë e realizon nga vet e drejta në markën tregtare si e drejtë absolute e llojit të vet. Nga kjo, del se pronari i një marke tregtare, është ai i cili vendosë se a dëshiron që të drejtën e tij markën tregtare, ta bartë në personat e tretë. Kjo bëhet përmes kontratës së caktuar e njohur si licencë, e me të cilën pronari i të drejtës e bartë markën tregtare në një

²¹⁵ Mbrojtja dhe zbatimi i markave tregtare, Për EMSG-Menaxhimi Ekonomik për Stabilitet dhe Zhvillim, Sponsoruar nga USAID 2008, përgaditur nga Luljeta Plakolli-Kasumi, LL.M., Moduli 4, fq.4-8.

person tjetër, për një kohë të caktuar, për një territor të caktuar, për një çmim të caktuar dhe me kushte tjera specifike të caktuara në kontratë.

Dhe në fund në dorën e vet pronarit të markës tregtare, është e drejta që ai ta mbrojë markën e tij tregtare, përmes mekanizmave juridik, të caktuar me ligj.

6. Mbrojtja juridike e Markave Tregtare

Duke pas parasysh rëndësinë e markave tregtare për qarkullimin ekonomik-tregtar të çdo vendi dhe duke pas parasysh çrregullimet të cilat mundë ti bëhen tregut të lirë, prodhuesve dhe konsumatorëve, nëse markat tregtare shkelen, duke u uzurpuar në mënyrë ilegale ose duke u falsifikuar, si dhe duke ndërmarrë veprime tjera me të cilat shkelet e drejta në markën tregtare, shoqëria ka përcaktuar mbrojtjen e kësaj të drejte dhe këtë e ka rregulluar me ligj.

Nga dispozitat e Ligjit për Markat Tregtare, shihet se nuk ekziston një qartësi e detajuar sa i përket mbrojtjes së markave tregtare, kjo për faktin se ligji nuk paraqet dispozita të qarta lidhur me llojet e pretendimeve të cilat pronari i markës tregtare mund ti paraqes, p.sh. për kompensimin e dëmit material ose jomaterial, për padinë kundër shkeljes së markës tregtare. Për më tepër, në ligj e askund tjetër nuk ekzistojnë as dispozita e as kriteret, e as ekspert me kompetencë, të cilët do të bënin llogaritjen e saktë të dëmit të shkaktuar (ashtu si që është sqaruar në fusnotën nr. 14.), dhe gjithashtu ligji nuk paraqet zgjidhje të mjaftueshme dhe nuk përcakton masat juridike të cilat duhet ndërmarrë ndaj shkelësve potencial, të cilët de fakto ende nuk kanë shkelur të drejtën e markës tregtare, por që potencialisht mundë të pritet shkelja, nga ana e tyre.

Ligji parasheh se, Pronari i Markës së regjistruar tregtare mund iniciojë një procedurë juridike në rast të shkeljes të drejtës së markës tregtare dhe se Pronari i Markës së regjistruar tregtare mund iniciojë një procedurë juridike në rast të shkeljes së të drejtës së markës tregtare, kurse sa i përket mjeteve juridike në dispozicion të pronarit të markës tregtare, sqaron se të gjitha mjetet juridike të cilat janë në dispozicion të pronarëve tjerë të të drejtave tjera pronësore do të jenë në dispozicion edhe për pronarët e markave të regjistruara tregtare.²¹⁶

²¹⁶ Më hollësisht shif nenin 18 të Ligjit për markat tregtare.

Nga kjo shihet se mjetet juridike kundër shkeljes së markës tregtare, duhet kërkuar në Ligjet tjera sistemore, si: Ligjin për detyrimet, Ligjin për Procedurën Kontestimore, Kodin Penal të Kosovës dhe Kodin e procedurës penale të Kosovës. Nga kjo edhe mund të përfundojnë se pronari i markës tregtare, në rast shkelje të saj, mund të ndërmerr masat juridike për mbrojtjen e markës, dhe atë në procedurë civile, penale dhe administrative.

Procedura civile - Në rast të shkeljes së markës tregtare, pronari i markës tregtare, mund të paraqes rastin e shkeljes në gjykatë, duke filluar procedurë civile-kontestimore. Kompetencë lëndore për zgjidhjen e kontesteve të tilla ka gjykata Ekonomike e Qarkut (Pas ristrukturimit të sistemit gjyqësorë në Kosovë, kjo bije në kompetencë lëndore të Departamentit për çështje Tregtare, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë) nëse edhe shkelësi i markës tregtare është person juridik, kurse kjo çështje bie në kompetence gjykata së qarkut të kompetencës së përgjithshme, nëse shkelësi i markës tregtare është person fizik.

Parimisht edhe këtu parashihet që palët në kontest, të provojnë që fillimisht, kontestin ta zgjidhin me marrëveshje jashtëgjyqësore. Parimisht pronari i markës tregtare, i cili pretendon se i është shkelur e drejta, para se të ngritë padinë, palës tjetër i dërgon një të ashtuquajtur “Letër ndërprerje dhe abstenimi“ që në zhargonin juridik njihet edhe si, Vërejtje para padisë, përmes së cilës palës tjetër i kërkon ndërprerjen e shkeljes dhe arritjen e ujdisë lidhur me kompensimin e dëmit, nëse dëmi tani më është shkaktuar. Kjo shkresë shërben si dëshmi se pala e cila kërkon mbrojtjen e të drejtës, paraprkasht ka bërë përpjekje që të arrijë marrëveshjen. Pas ngritjes së padisë (nëse nuk ka pas suksese përpjekja për marrëveshje jashtëgjyqësore), në procedurë kontestimore, barra e provës bije mbi paditësin, pra ai duhet të siguroj të gjitha provat me të cilat vërteton faktet, të cilat tregojnë se shkelja vërtetë ka ekzistuar gjegjësisht ekziston.²¹⁷

Në procedurë civile, pronari i markës tregtare nga gjykata mundë të kërkojë që e njëjta të nxjerrë Urdhër, për ti asgjësuar ose hequr shenjën e falsifikuar mbi mallrat, ose t’i asgjësoj vet mallrat, artikujt ose materialet, të kërkoj urdhër për ti dorëzuar mallrat, materialet ose artikujt që paraqesin shkeljen e markës tregtare që ato të dorëzohen tek pronari i markës ose tek ndonjë person tjetër neutral.

²¹⁷ Shif nenin 89 të Ligjit për market tregtare.

Përveç masave të përmendura, pronari i markës tregtare, nëse vërtetohet shkelja e të drejtës, gjykatës mundë ti kërkojë që me aktgjykim të ja kompensoj dëmin e shkaktuar material dhe jomaterial²¹⁸ konform nenit 189-192 dhe 200.

Procedura penale

Personi i cili pretendon se i është shkelur marka tregtare, ka të drejtë që të paraqes edhe një kallëzim penal, në Prokurorin publike komunale. Kjo për faktin se në Kodin Penal të Kosovës, është përcaktuar se çdo përdorim i paautorizuar i emrit tregtar, markës tregtare, ose dizajnit, me qëllim të mashtrimit të blerësve ose konsumatorëve, lidhur me mallrat ose shërbimet e caktuara-paraqet vepër penale (Neni 241 i Kodit-Veptra penale: Përdorimi i paautorizuar i firmës, markës apo i modelit të huaj), kurse neni 245 i Kodit gjithashtu përcakton se, është vepër penale edhe çdo krijim ose përdorim të markave, masave dhe peshave të falsifikuara, me qëllim të përdorimit të tyre si të vërteta gjatë zhvillimit të afarizmit dhe kjo njihet si vepra penale: Prodhimi dhe shfrytëzimi i shenjave të etiketave, masave dhe peshave të rreme.

Për veprën penale nga neni 421, është paraparë dënimi për shkelësin deri në 2 vjet dhe konfiskimi i mallrave me të cilat është bërë shkelja e markës tregtare, kurse për veprën penale nga neni 245, është paraparë dënimi prej 3 muajve deri në 5 vjet dhe gjithashtu konfiskimi i markave të falsifikuara si dhe mjeteve të cilat kanë shërbyer për krijimin e markave të falsifikuara.

Procedura administrative

Edhe sanksionet dhe masat administrative, aplikohen me rastin e mbrojtjes së pronarit të markës tregtare. Në shumicën e vendeve të rajonit ekzistojnë inspektorate të ndryshme të themeluara në kuadër të ministrisë së tregtisë dhe industrie të cilat veprojnë në mbrojtjen e markave tregtare. Përpos këtyre inspektorateve, veprojnë edhe Dogana dhe policia, e që të gjitha me një bashkërendim të aktiviteteve të tyre, paraqesin një organizim solid për të ju kundërvënë shkelësve të të drejtave të cilat burojnë nga markat tregtare.

Organet e përmendura kanë, kompetence që të hyjnë dhe kërkojnë në çdo treg ose objekt afarist, të lëshojnë urdhra për ndërprerjen e veprimeve

²¹⁸ Më hollësisht, shif nenin 189/192 dhe 200 të Ligjit për marrëdhëniet detyrimore ("Gazeta Zyrtare e RSFJ" nr.29/1978.).

kundërvajtëse, të caktojnë gjopa dhe të revokojnë lejen e punës për personat kundërvajtës, fizik ose juridik. Tek ne jo është kompetence e Inspektorit të tregut dhe Doganës. Në këtë aktivitet, ndihmesë të çmueshme jep edhe Zyra për pronësi industriale gjegjësisht për markat tregtare, e cila nuk vepron aktivisht por jep mendime profesionale lidhur me ekzistimin e shkeljes së markës.

Mjetet administrative konsiderohen si më të volitshme për sa i përket shpenzimeve material dhe kohore. Por procedura administrative, është efikase vetëm në rastet kur shkelja është evidente, gjersa në rastet e komplikuar për tu vërtetuar ekzistimi ose jo ekzistimi i shkeljes, pala doemos duhet ti drejtohet gjykatë.

Me funksionalizimin e Ndërmjetësve në Kosovë, të cilët sipas ligjit për ndërmjetësim duhet të fillojnë veprimtarinë së shpejti, mendojmë se edhe ndërmjetësit do të kenë mundësi që disa konteste lidhur me shkeljen e markës tregtare, ti kryejnë në procedurë jashtëgjyqësore. Gjithashtu edhe Arbitrazhi, mendojmë se mundë të jep kontribut të çmueshëm në zgjidhjen efikase, të shpejtë, me pak shpenzime dhe me fleksibilitet, të të gjitha kontesteve të cilat lindin nga shkelja e markës tregtare dhe mbrojtja e sajë, natyrisht nëse për këtë pajtohen palët në kontest.

Në teorinë dhe doktrinën e të drejtës tregtare, hasim edhe mendime lidhur me Sanksionet shoqërore, si ato të cilat i aplikon shoqëria e organizuar përmes gjyqeve të kompetencës së përgjithshme, ashtu edhe gjyqeve të nderit dhe arbitrazheve qoftë institucionale apo ad hoc, si dhe sanksionet që i aplikon shoqëria e paorganizuar, përmes veprimeve individuale të cilat i ndërmarrin qarqet ekonomike dhe konsumatorët.²¹⁹

Përfundimi

E drejta në Markat tregtare, si pjesë e të Drejtës së pronësisë Industriale, me zhvillimin e marrëdhënieve tregtare si në aspektin kombëtar edhe në atë ndërkombëtar, tani më është zhvilluar në nivel të degës së të drejtës, e njohur si e drejta e markave tregtare.

Rëndësia e sajë gjithnjë e më tepër vihet në pah, duke u ngritur në nivelin e çështjeve tejet të domosdoshme për qarkullimin e mallrave në tërësi. Sot as

²¹⁹ Prof.Dr. Mehdi J.Hetemi Mbrojtja e tregut të lire nga konkurrenca jolojale (aspekte krahasimore), Prishtinë, 2004, fq.202-203.

nuk mundë të merret me mend, qarkullimi i mallrave, pa definimin dhe rregullimin e markave tregtare.

Pasi që, në kohën e sotme qarkullimi i mallrave, ka arritur nivelin pothuajse tërësisht ndërkombëtarë, edhe nevoja për rregullimin e çështjes së përdorimit, shfrytëzimit dhe tjetërsimit të markave tregtare, ka lindur nevojën e domosdoshme të rregullimit ndërkombëtar të kësaj materie, e ashtu edhe nevojën e domosdoshme të unifikimit të rregullativës së brendshme të çdo shteti, me rregullativën ndërkombëtare të kësaj lëmie juridike.

Për shkak të rrethanave tani më të njohura, Kosova, në fillim të këtij shekulli, pati nevojë të nxjerrjes së legjislacionit, në të gjitha fushat e jetës. Përpos tjerash, kjo ndoshta edhe ishte mundësi e mire për harmonizimin e rregullativës ligjore, në përputhje me legjislacionet e shteteve më të zhvilluara dhe demokratike, Edhe në lëmin e Markave Tregtare, u nxorën Ligje. Rregullore, Udhëzime dhe Urdhëresa administrative, të cilat rregullojnë çështjen e Markave Tregtare.

Gjithashtu, sipas legjislacionit tonë, paraqiten një mori subjektsh kompetente të cilat janë të angazhuara në mbrojtjen e Markave Tregtare, si që janë: Prokuroritë dhe Organet gjyqësore (në procedurë civile dhe penale), Organet Administrative, Doganore, Policore, Komuniteti i biznesit, shoqëria civile dhe konsumatorët.

Duke pas parasysh, faktin se një problematikë e tillë tani më është e përditshme, kuptohet se edhe përpos përpjekjeve që shoqëria ka bërë për rregullimin e sajë, s'do mend se, nuk është e mundur që të zhduket në tërësi tentative dhe vet keqpërdorimi i markave tregtare, e paraqitur në formë të falsifikimit, keqpërdorimit dhe formave tjera të uzurpimeve të markave tregtare.

Kjo njëkohësisht paraqet nevojë imanente, që personat të cilët janë kompetent për vendosjen lidhur me mbrojtjen e markave tregtare, duket të jenë të pajisur me njohuri jo vetëm elementare për markat tregtare, pasi që kjo edhe është kusht i domosdoshëm për mbrojtjen e kësaj të drejte si e drejtë absolute. Posaçërisht njohuri të larta, duhet të kenë prokurorët, gjyqtarët, doganierët, organet policore të ngarkuara me përcjelljen e kësaj lëmie, organet administrative kompetente dhe inspektoratet dhe në fund njohuri solide nga kjo lëmi duhet të kenë edhe komuniteti i biznesit dhe konsumatorët.

Për tu arritur kjo objektive, nevojitet një informim i vazhdueshëm i subjekteve të përmendura, hartimi i literaturës origjinale ose të përkthyer, me qëllim që e drejta e markave tregtare në veçanti dhe e drejta e pronësisë industriale në përgjithësi ashtu si edhe e drejta e autorit (të gjitha të njohura sit ë drejta të pronësisë intelektuale) të mos jenë temë e panjohur (për të mos thënë temë tabu) për studentët tanë dhe profesionistët sidomos të lëmisë juridike.



Prenk Palushi



Mehmet Ndrecaj



Elheme Jashari

KONFLIKTI ADMINISTRATIV – PADIA

Konflikti administrativ²²⁰ mund të zhvillohet vetëm kundër akteve administrative. Në teorinë juridike, nocioni i aktit administrativ kuptohet në mënyra të ndryshme, duke aplikuar pikëpamjen qoftë materiale, qoftë organizative - formale.

Akti administrativ është ai akt me të cilin organi shtetëror, organizata a bashkësia tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike vendose mbi ndonjë të drejtë apo detyrim të ndonjë personi të caktuar ose të ndonjë organizatë në ndonjë çështje administrative.

Akti administrativ mund të jetë objekt i konfliktit administrativ, që të mund të jetë objekt i konfliktit administrativ duhet t'i plotësojë këto kushte:

- **vendimi duhet të nxirret nga ana e organit shtetëror, organizatës ose bashkësisë tjetër që ushtron autorizime publike,**
- **akti administrativ duhet të jetë i nxjerrë në ndonjë çështje administrative,**

Për kuptimin e aktit administrativ nuk është qenësor vetëm karakteri dhe cilësia e organit që e nxjerr, as karakteri i vet aktit, as materia për të cilën është fjala ose lëmi për të cilën nxirret ai akt, sepse te gjitha këto elemente bashkërisht i japin percaktueshmerine dhe përmbajtjen e plote ndriçimit të qeshjes juridike.

- **me akt duhet të vendos mbi ndonjë të drejtë ose detyrim të individit a organizatës**

²²⁰Prof.Dr. Esat Stavileci, Hyrje në Shkencat Administrative, Prishtinë 1997 faqet 182,183

Akti i këtillë duhet të ketë karakter të aktit administrativ konstitutiv dhe deklarativ. Një akt që të mund të jete objekt i konfliktit administrativ ai duhet të vendos mbi ndonjë të drejtë ose detyrim të individit ose të organizatës së caktuar. Andaj, objekt i konfliktit administrativ nuk mund të jenë aktet të cilat nuk mund të prodhojnë efekte juridike, përkatësisht të kenë pasojë juridike për individët ose organizatat.

Kështu p.sh, vetëm aktet e pushtetit mund ta plotësojnë këtë kusht dhe të jenë objekt i konfliktit administrativ sepse aktet e punës (veprimtarisë), nuk mund të jenë objekt i konfliktit administrativ. Me aktin që mund të jetë objekt i konfliktit administrativ duhet që të njihet ose të mos njihet ndonjë e drejtë, të caktohet detyrimi, të zvogëlohet ose të priset ndonjë detyrim i individit ose i organizatës.

Për akte të tilla, rëndom thuhet se janë akte vendosëse ose konstitutive. Për akte deklarative zakonisht thuhet se janë akte të atilla me të cilat nuk vendoset, përkatësisht nuk ndryshohet një marrëdhënie dhe se kundër tyre, parimisht, nuk do të mund të zhvillohej konflikti administrativ.

Mirëpo, nëse me akte deklarative vendoset mbi ndonjë të drejtë ose detyrim ose akti i tillë mund të ndikojë në njohjen ose mosnjohjen e ndonjë të drejte, atëherë edhe kundër akteve të tilla gjithsesi mund të zhvillohet konflikti administrativ.

- akti administrativ duhet të jetë konkret dhe individual

Akt konkret²²¹ është ai akt me të cilin vendoset mbi të drejtën dhe detyrimin e individit konkret dhe të organizatës konkrete. Kundër tij mund të zhvillohet konflikti administrativ. Duhet të kihet parasysh që ky kusht ekziston edhe atëherë kur akti administrativ u përket më shumë personave dhe organizatave, sepse akti administrativ mund t'u përket më shumë personave, të cilët duhet të theksohen sipas emrit. Këtë kusht e plotësojnë edhe ato akte administrative të cilat, në të vërtetë, nuk i theksojnë saktësisht dhe sipas emrit personat e caktuar, por i theksojnë në atë mënyrë ashtu që lehtë mund të shihet e të dihet se kujt i përkasin ato akte.

Akti administrativ mund të jetë objekt i konfliktit administrativ vetëm atëherë nëse fjala është për aktin administrativ përfundimtar të nxjerrë në

²²¹Prof.Dr. Esat Stavileci, Hyrje në Shkencat Administrative, Prishtinë 1997 faqe 184

procedurën administrative. Kjo domethënë se konflikti administrativ mund të hapet kundër aktit administrativ kundër të cilit nuk ekziston mundësia e ankesës në procedurën administrative, qoftë për shkak se akti i tillë është nxjerrë nga ana e organit të shkallës së dytë, qoftë për shkak se është nxjerrë nga ana e organit të shkallës së parë, pra, kur ai bëhet përfundimtar, pasi sipas ligjit të veçantë, nuk ka mundësi për paraqitje të ankesës kundër tij.

Me këtë rast duhet vënë në pah se të gjitha këto elemente për të cilat deri me tash u bë fjalë janë të natyrës kumulative që domethënë, mungesa e njërit nga këto elemente, në çdo rast konkret, i pamundëson aktit administrativ që të trajtohet si objekt i konfliktit administrativ, e nëse konflikti administrativ është i hapur, atëherë gjykata do ta hedhë padinë poshtë, ngase akti i tillë nuk është akt administrativ.

Llojet e konfliktit administrativ

Ekzistojnë kritere të ndryshme sipas të cilave mund të bëhet ndarja e konflikteve. Në botë kjo ndarje bëhet në konflikte administrative objektive e subjektive dhe në konflikte administrative mbi ligjshmërinë e akteve administrative dhe në konflikte të juridiksionit të plotë.

- Konfliktet administrative objektive dhe subjektive

Këtu është me rendësi të theksojmë se ekzistojnë kryesisht dy kritere sipas të cilave bëhet kjo ndarje. Si një nga kriteret për ndarje të tillë merret qëllimi i konfliktit administrativ. Nga kjo rezulton se konflikti administrativ objektiv ka për qëllim mbrojtjen e së drejtës subjektive, situatës juridike subjektive, ndërkaq konflikti administrativ objektiv, në radhë të parë, ka për qëllim mbrojtjen e së drejtës objektive, përkatësisht situatës juridike objektive.

Si kriter i dytë për ndarjen e konflikteve administrative në subjektive dhe objektive merret lloji i aktit që mund të jetë objekt i konfliktit administrativ” Konfliktet administrative subjektive²²² janë nga ato konflikte të cilat mund të hapen kundër akteve të përgjithshme (akteve normative).

Por, në këtë rast duhet të kihet parasysh se konfliktet objektive dhe subjektive, nuk mund të përputhen sipas kriterëve të akteve dhe sipas kriterëve të qëllimit. Domethënë është e mundshme që një konflikt të jetë i

²²²Prof.Dr. Esat Stavileci, Hyrje në Shkencat Administrative, Prishtinë 1997 faqe 185

përcaktuar sipas kriterit të qëllimit si objektiv, sepse kryesisht ka për qëllim mbrojtjen e ligjshmërisë, ndërkaq sipas kriterit të aktit, do të binte në grupin e konflikteve administrative subjektive, me që ka për objekt aktin administrativ.

Duhet të kihet parasysh se ka konflikte që mund të përcaktohen si subjektive dhe sipas kriterit të qëllimit të konfliktit, edhe sipas kriterit të aktit që mund të jetë objekt i konfliktit administrativ. Krahas konfliktit administrativ objektiv, ekziston edhe konflikti administrativ subjektiv.

Kështu për shembull, prokurori publik në ish-Jugosllavi, mund të ngrëjë padi në kushte të caktuara në konfliktin administrativ me qëllim të mbrojtjes së situatës juridike objektive, përkatësisht me qëllim të mbrojtjes të së drejtës objektive dhe jo për mbrojtjen e situatës juridike subjektive.

Do të ishte gabim sikur të pohonim se te konflikti administrativ subjektiv nuk mbrohet, krahas situatës juridike subjektive, edhe situata juridike objektive, sepse është e evidente se nuk ka të drejta individuale dhe interesa juridike pa të drejtën objektive kjo bëhet aq më parë, sepse në interesin e ligjshmërisë është që të mbrohen e të realizohen të drejtat individuale dhe interesat juridike të cilat dalin nga e drejta objektive. Nga kjo rregull, kuptohet se ka përjashtime të caktuara.

- Konflikti mbi ligjshmërinë e aktit administrativ dhe konflikti i juridiksionit të plotë

Kur është fjala për konfliktin mbi ligjshmërinë e aktit administrativ duhet të kihet parasysh se këtu është fjala për konfliktin e tillë kur gjykata, duke vendosur në të shqyrton vetëm çështjen e ligjshmërisë së aktit kontestues administrativ. Me një fjalë, në konfliktin mbi ligjshmërinë, gjykata vlerëson atë se me aktin administrativ kontestues a është shkelur ligji në kuptimin material ose formal.

Ne këtë konflikt pra, nuk hyhet në vendosjen e pasojave juridike të aktit të tillë administrativ, por vetëm në ligjshmërinë e tij. Te konfliktet e ligjshmërisë së aktit administrativ, aktgjykimi i cili nxirret me atë rast, nuk ka efekt të drejtpërdrejt juridik, por ekzekutimi i aktgjykimit kalohet në kompetencën e atij organi, akti i të cilit është anuluar.

Qëllimi i konfliktit mbi ligjshmërinë e aktit administrativ është abrogimi i aktit të paligjshëm administrativ nëse konstatohet se ai është i paligjshëm.

Andaj, edhe ky konflikt quhet konflikt i kufizuar administrativ apo konflikt për anulimin e aktit administrativ. Kur gjykata çmon se akti i kontestuar administrativ është i paligjshëm, ajo e anulon dhe i urdhëron organin kompetent që të nxjerrë akt tjetër administrativ në pajtim me mendimin juridik të gjykatës së paraqitur në aktgjykim. Te ky konflikt fjala është për atë që, në radhë të parë, të mënjanohet paligjshmëria të cilën e ka prodhuar një akt administrativ.

Vendimi i gjykatës në këtë konflikt ndikon vetëm indirekt në situatën juridike individuale. Pra, çështja e ligjshmërisë këtu është parësore, andaj shqyrtohet vetëm ligjshmëria e aktit administrativ. Konflikti mbi ligjshmërinë ka njëkohësisht edhe qëllim objektiv për sigurimin e mbrojtjes gjyqësore të drejtave të qytetarëve, të organizatave e të bashkësive të tjera.

Konflikti i juridiksionit²²³ të plotë ka për qëllim vetëm mbrojtjen e të drejtave subjektive dhe jo si konflikti mbi ligjshmërinë, qëllimi i të cilit është mbrojtja e parimit të ligjshmërisë, edhe mbrojtjen e të drejtave përkatësisht interesave juridike të qytetarëve.

Konfliktet e juridiksionit të plotë paraqiten qoftë pavarësisht, qoftë lidhur me konfliktet mbi ligjshmërinë e aktit administrativ. Me këtë rast duhet të theksojmë se konfliktet e juridiksionit të plotë janë shumë të llojlojshme në sistemet juridike pozitive të disa vendeve. Në konfliktin e juridiksionit të plotë vet gjykata e vendos marrëdhënien kontestuese.

Gjithashtu, në konfliktin e juridiksionit të plotë, gjykata mund të vendos edhe duke zbatuar çmuarjen e lirë, pra të vlerësoj jo vetëm ligjshmërinë, por edhe oportunitetin e aktit të kontestuar administrativ. Në konfliktet e juridiksionit të plotë autorizimet e gjykatës janë shumë më të mëdha se sa në konfliktet mbi ligjshmërinë e akteve administrative, pikërisht për shkak se në konflikte të këtilla gjykata nuk kufizohet vetëm në anulimin e aktit administrativ por in meritum vendos çështjen konkrete administrative.

Palët në konfliktin administrativ

Palët në konfliktin administrativ janë: paditësi, ana e paditur dhe personi i interesuar.

²²³Prof.Dr. Esat Stavileci, Hyrje në Shkencat Administrative, Prishtinë 1997 faqe 186

Paditësi në konfliktin administrativ

E drejta e padisë në konfliktin administrativ paraqet të drejtën subjektive. Në atë kuptim, padinë mund ta shfrytëzoj secila palë që konsideron se me aktin administrativ i është shkelur ndonjë e drejtë subjektive, ose interes i drejtpërdrejt personal i bazuar në ligj.

Personi i cili me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të veta subjektive ose interesave të drejtpërdrejta të bazuara në ligj paraqet padi në konfliktin administrativ quhet paditës në konfliktin administrativ. Është rregull që paditës në konfliktin administrativ të jetë ai individ ose ai person juridik dhe subjekt tjetër i cili ka marrë pjesë në procedurën administrative si palë, përkatësisht mbi të drejtën ose detyrimin e të cilit është vendosur në aktin administrativ.

Mirëpo, kjo nuk do të thotë që paditës në konfliktin administrativ nuk mund të jetë edhe personi i cili nuk ka marrë pjesë si palë në procedurën administrative, kuptohet nëse me aktin e këtillë administrativ cenohet e drejta e tij ose interesi i drejtpërdrejtë personal i bazuar në ligj. Nga kjo del qartë se për ekzistimin e legjitimitetit të paditësit në konfliktin administrativ mjafton që pala thjeshtë të konsideroj se me aktin administrativ i cili i përket asaj shkelet ndonjë e drejtë e saj ose interes i drejtpërdrejt i bazuar në ligj.

Me këtë rast, interesi mund të jetë personal, i drejtpërdrejt dhe i bazuar me ligj. Interesi është i bazuar në ligj nëse buron nga ndonjë normë juridike. Interesi personal ekziston atëherë nëse i takon personalisht paditësit dhe jo dikujt tjetër, qofte ai edhe person i afërm i paditësit. Duhet të kihet parasysh se personat juridike në konfliktin administrativ mbrojnë si interesat e veta të përgjithshme dhe kolektive dhe interesat personale.

Akti administrativ nuk mund të goditet, për atë ai eventualisht do të mund të ketë pasoja të pakëndshme për paditësin, por nevojitet që ato t'i prodhojë drejtpërdrejt dhe menjëherë²²⁴. Ndërkaq, a ekziston shkelja e ndonjë të drejte ose interesi juridik dhe i interesit të drejtpërdrejt personal i bazuar në ligj apo jo, atë e konstaton gjykata me zgjidhjen e konfliktit administrativ.

²²⁴ Prof.Dr. Esat Stavileci, Hyrje në Shkencat Administrative, Prishtinë 1997 faqe 187

Gjykata ka për detyrë që gjatë procedurës të kujdeset se a ekziston legjitimacioni aktiv i paditësit për fillimin e konfliktit administrativ, përkatësisht se me aktin administrativ a preket në të drejtat subjektive ose në interesin juridik të paditësit dhe nëse konstaton se nuk ekziston ndonjë nga këto elemente, ajo ka për detyrë që padinë ta hedh poshtë me vendim.

Ana e paditur në konfliktin administrativ

Në konfliktin administrativ anë e paditur është organi akti i të cilit kontestohet. Kjo do të thotë që anë e paditur është çdo organ shtetëror, përkatësisht organizata apo bashkësia tjetër e cila ushtron autorizime publike, akti i së cilës kontestohet me padi.

Është rregull se anë e paditur është organi shtetëror, përkatësisht organi, akti i të cilit është bërë përfundimtar. Por, konflikti administrativ mund të hapet edhe kundër akteve administrative të shkallës së parë në ato raste, kur me ligj është përjashtuar mundësia e paraqitjes së ankesës dhe kur vendimi i shkallës së parë është bërë përfundimtar në procedurën administrative.

Është me rëndësi të dihet se kush e përfaqëson anën e paditur në rastin kur fjala është për të ashtuquajturat akte të përbëra administrative, domethënë kur me ligj ose dispozita të tjera të bazuara në ligj është caktuar që në një çështje vendosin dy ose me shumë organe dhe secili prej tyre ka për detyrë që të vendose mbi atë çështje.

Këto organe, me këtë rast, do të merren vesh se cili prej tyre do të nxjerrë vendimin ashtu që në vendimin e tillë duhet të theksohet akti i organit tjetër. Në raste të këtilla, palë e paditur në konfliktin administrativ konsiderohet organi i cili e ka nxjerrë aktin e tillë. Nëse kundër vendimit të shkallës së parë nuk ka vend ankesa në procedurën administrative, organi që e ka nxjerrë vendimin konsiderohet palë e paditur në konfliktin administrativ. Ndërkaq, nëse ankesa kundër vendimit të tillë është e lejueshme, atëherë do të konsiderohet se organi i paditur në konfliktin administrativ është ai organ, i cili ka vendosur me rastin e ankesës në procedurën administrative.

Nga ana tjetër, kur akti administrativ nxirret nga një organ me pëlqimin paraprak, ose me vërtetimin dhe lejimin, pas mendimit të marrë të organit tjetër ana e paditur në konfliktin administrativ është gjithmonë ai organ, i cili e ka nxjerrë aktin e tillë dhe jo ai organ, i cili në çfarëdo mënyre ka marrë pjesë në nxjerrjen e aktit të tillë administrativ.

Në fund, anë e paditur në konfliktin administrativ mund të jetë edhe organi i cili është dashur ta nxjerrë aktin përkatës administrativ përfundimtar dhe nëse nuk e ka nxjerrë brenda afatit të caktuar aktin administrativ përfundimtar, dhe nëse mund të hapet konflikti administrativ para gjykatës kompetente.

Nëse nga dita kur palës i është dorëzuar akti administrativ përfundimtar deri ne ditën e ngritjes se padisë ne konfliktin administrativ ka pushuar se ekzekutuari organi i cili e ka nxjerrë aktin e tillë administrativ, atëherë ane a paditur do të jete organi i cili, përndryshe, është pasardhës juridik i organit te suprimuar²²⁵.

Personi i interesuar në konfliktin administrativ

Përveç pjesëmarrësve te obligueshëm ne konfliktin administrativ, paditësit dhe anës se paditur, pale ne konfliktin administrativ mund te jete edhe pjesëmarrësi eventual i konfliktit, apo personi i interesuar, domethënë personi i internuar, te cilit anulimi i aktit administrativ do ti shkaktonte dem direkt ne konflikt.

Personi i interesuar gjithmonë ka interes i cili është i kundërt me interesin e paditësit, d.m.th, nëse paditësi me konfliktin administrativ ka invers qe akti i kontestuar te anulohet, personi i interesuar ka interes qe akti i tillë te mbete dhe padia te refuzohet. Vërtetë, personi i interesuar është ai person i nuk është i kënaqur me aktin e kontestuar administrativ, e nëse do te ndodhte kjo, ai do te mund te ishte paditës ne konfliktin administrativ.

Personi i interesuar do te ekzistojë gjithmonë kur është fjala për qeshjen administrative dypalëshe ose shumëpalëshe.

Ne te vërtetë, ai do te ekzistojë gjithmonë ne konfliktin administrativ kur me aktin e kontestuar administrativ është vendosur ne qeshjen administrative e cila i përket dy ose me shumë personave te cilët ne procedurën administrative kane marre pjese me interesa te kundërta, ndërsa procedura ka përfunduar me vendimin e kontestuar ne dobi te njëres pale dhe ne dem te palës tjetër, e cila për këtë shkak vendimin e tillë e kundërshton ne konfliktin administrativ.

²²⁵ Prof.Dr. Esat Stavileci, Hyrje në Shkencat Administrative, Prishtinë 1997 faqe 188

Është e natyrshme se në raste të tilla anulimi i vendimit të kontestuar do të ishte në dem të asaj pale, në dobi të se çiles ka përfunduar procedura, andaj edhe i njihet pozita e palës në konfliktin administrativ. Përheq personave juridike, konfliktin administrativ si persona të interesuar mund të paraqiten edhe personat private.

Kështu për shembull, edhe në konfliktin të cilin e fillon prokurori publik përkatës kundër aktit administrativ me të cilin është shkelur ligji në dobi të individit ose organizatës apo bashkësisë tjetër, individit apo personi juridik në dobi të cilit është shkelur ligji, ka gjithmonë pozitën e personit të interesuar.

Padia në konfliktin administrativ

Padia në konfliktin administrativ, është një mjet juridik për realizimin e një të drejtë nga pala e caktuar, nga shkelja e ligjit në dëm të saj nga organet e administratës publike gjatë nxjerrjes së aktit administrativ në procedurës administrative.

Në procedurën administrative konflikti administrativ fillon nga momenti i paraqitjes së padisë Gjykatës Supreme të Kosovës.²²⁶ Me anë të padisë pala mund të kërkojë që akti administrativ të:

- anulohet ose të shpallet i pavlefshëm;
- nxjerrjen e aktit administrativ, i cili nuk është nxjerr në afatin ligjor;
- kthimin e sendeve të marra dhe kompensimin e dëmit që shkaktohet me ekzekutimin e aktit administrativ të kundërshtuar.

Afati për paraqitjen e padisë në konfliktin administrativ

Padia në konfliktin administrativ paraqitet brenda afatit ligjor prej (30) ditësh, nga dita e pranimit të aktit administrativ nga pala. Ky afat është edhe në rastet kur akti administrativ i është dërguar organit të autorizuar i cili ka të drejtë që të paraqet padi. Nëse akti administrativ palës nuk i është dërguar mund të paraqet padi brenda afatit (60) ditësh nga dita e dorëzimit të aktit administrativ, në favor të së cilës është nxjerrë akti administrativ.

²²⁶ Ligji Per Konfliktet Administrative nenet 26, 27, 28

Opinion: Në këtë rast afati ka qenë dashtë të jetë jo brenda (30) ditësh nga dita e pranimit të aktit administrativ, por (30) ditë pas ditës së pranimit të aktit administrativ. Ngase nuk duhet të llogaritur në afat dita kur pala e pranon aktin administrativ, afati në këtë rast duhet të filloj të rrjedh pas ditës së pranimit.

Mënyra e dorëzimit të padisë

Ekzistojnë disa mënyra ligjore të dorëzimit të padisë në gjykatë si:

- Drejtpërdrejtë duke e dorëzuar në gjykatë
- Me anë të postës – Rekomandë
- Duke e deklaruar në procesverbal, në këtë rast si ditë e dorëzimit në gjykatë merret dita kur është deklaruar në procesverbal.

Në rastin kur padia nuk i dorëzohet gjykatës, por ndonjë organit tjetër që nuk është kompetent, ndërkohë arrin në gjykatë pas kalimit të afatit ligjor për paraqitjen e padisë, do të merret si në kohë nëse paraqitja e saj në organin tjetër vije si pasojë e mos dijës apo e gabimit të hapur të parashtruesit të padisë - palës.

Rastet kur mund të filloj konflikti administrativ

Konflikti administrativ mund të filloj në këto raste:

Nëse organi i shkallës së dytë nuk nxjerr vendimin brenda afatit prej (30) ditësh ose në një afat më të shkurtër të caktuar me ligj, me dispozita të veçanta të ankimit të palës kundër vendimit të organit të shkallës së parë, ndërsa as në afatin tjetër prej 7 ditësh me një kërkesë të bërë nga ana e palës, pala mund të filloj konfliktin administrativ sikur të ishte refuzuar ankesa. Në mënyrë të njëjtë pala mund të veprojë edhe në rastin kur për kërkesën e tij/saj nuk është nxjerrë vendim nga organi i shkallës së parë ndaj të cilit nuk mund të parashtrohet ankesa.

Në këtë rast pala mund të bëjë kërkesë në organin e shkallës së dytë nëse ky organi i shkallës së parë nuk ka nxjerrë vendim në afat prej (60) ditësh ose në një afat më të shkurtër të paraparë me ligj. Kundër vendimit të organit të shkallës së dytë pala mund të filloj konfliktin administrativ, por mundet edhe në raste kur organi i shkallës së dytë nuk nxjerrë vendim.²²⁷

²²⁷ Ligji për konfliktet Administrative nenet 29,30,31,32

Përmbajtja e padisë

Padia në konfliktin administrativ për të qenë sa më e plotë dhe e qartë duhet ti përmbajë disa elemente që janë të rëndësishme për gjykatën sipas së cilës mund të veprojë më lehtë: Në padi duhet të përfshihen:

1. Emërtimi i Gjykatës të cilës i parashtrahet padia
2. Emri, Mbiemri dhe Vendbanimi- selia e paditësit dhe e palës së paditur
3. Arsytet e ngritjes së padisë

Propozimi për anulimin apo shfuqizimin e aktit administrativ

Padisë duhet që ti bashkëngjiten kopjet e padisë dhe të provave tjera për palët në konflikt dhe personat tjerë të interesuar. Në rast se me padi kërkohet kthimi i sendit apo kompensimi i dëmit, duhet shtrohet edhe kërkesa e caktuar në pikëpamje të sendit apo shumës së dëmit të pësuar.

Paditësi mund të heqë dorë nga padia derisa të mos merret vendimi, në rastin konkret gjykata e pezullon me vendim. Gjithashtu paditës mund ta zgjeroj kërkesëpadinë deri në përfundimin e shqyrtimit, ndërsa kur shqyrtimi nuk zhvillohet derisa të mos nxjerrët vendimi i gjykatës kompetente.

Çështja paraprake

Kur marrja e vendimit nga gjykata që zhvillon konfliktin administrativ, varet nga zgjidhja e çështjes parake e ndonjë gjykata tjetër apo organi tjetër, atëherë Gjykata që zhvillon konfliktin administrativ mund të vendos për atë çështje nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe, ose e ndërprejë procedurën deri sa të zgjidhet çështja në organin tjetër kompetent. Vendimi i gjykatës mbi çështjen paraprake ka efekt juridik vetëm në konfliktin administrativ të cilën ajo çështje është zgjidhur.

Të metat e padisë

Në procedurën e konfliktit administrativ mund të ndodhë që padia të ketë disa të metat me anë të së cilës nuk mend të veprohet më tutje, pa i hequr këto të meta nga paditësi. Të meta e padisë janë:

- Padia nuk është e plotë, është e pakuptueshme ose ka të meta tjera. Në këtë rast kryetari i e fton paditësin, që brenda afatit pre (8) ditësh ti mënjanoj të metat e padisë, duke e udhëzuar për të metat që duhet mënjeluar dhe pasojat ligjore që do lindin në rast se nuk i heq të metat.
- Nëse paditësi brenda afatit ligjor nuk i mënjanon të metat e padisë, kurse ato janë të tilla që e pamundësojnë zhvillimin e procedurës, gjykata hedhë poshtë me vendim padinë **në rastin kur nuk konstaton se akti administrativ i kontestuar është i pavlefshëm.**

Gjykata e hedhë poshtë padinë edhe në rastet kur:

- Padia është paraqitur pas kalimit të afatit, ose është e parakohshme
- Akti që kontestohet me padi nuk është akt administrativ
- Është e qartë se me aktin e kontestuar administrativ nuk prekën të drejtat e paditësit ose interesi i tij i drejtpërdrejtë i bazuar në ligj
- Kundër aktit administrativ, i cili kontestohet me anë të padisë, mund të bëhet ankimi, kurse ankimi nuk është bërë fare apo nuk është bërë në kohën e duhur
- Në rastet kur sipas dispozitave ligjore nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ
- Ekziston vendimi i formës së prerë, i nxjerrë në konfliktin administrativ për të njëjtën çështje. Në këto raste gjykata mund ta hedhë poshtë padinë në çdo fazë të procedurës.

Në rast se gjykata nuk e hedhë poshtë padinë në bazë të rrethanave që u përmendën më lartë, ndërsa konstaton që akti i kontestuar përmban të meta esenciale, e që e pengojnë të çmuarit e ligjshmërisë së aktit, e anulon me aktgjykim.

Opinion: Sipas nenit 33 par. 3 të Ligjit për Konfliktin Administrativ shprehimisht thuhet se: Nëse paditësi brenda afatit ligjor nuk i mënjanon të metat e padisë, kurse ato janë të tilla që e pamundësojnë zhvillimin e procedurës, gjykata hedhë poshtë me vendim padinë **në rastin kur nuk konstaton se akti administrativ i kontestuar është i pavlefshëm.** Pra në këtë rast kemi të bëjmë me të metat e padisë ku hedhet poshtë padia si çështje procedurale. Në rastin kur gjykata konstaton se akti i kontestuar është i pavlefshëm atëherë hynë në çështjen kryesore dhe duhet që të miratoj

apo refuzoj padinë dhe aktin konkret ta anuloj apo shfuqizojë e jo ta hedhë poshtë padinë për të meta procedurale.

Nxjerrja e aktit administrativ gjatë procedurës gjyqësore

Kur organi administrativ gjatë procedurës gjyqësore nxjerrë aktin administrativ, me anë të së cilit revokohet apo shfuqizohet akti administrativ, kundër të cilit është ngritur konflikti administrativ, ose nxjerr më vonë aktin administrativ organi në fjalë është i obliguar ta njoftojë paditësin por edhe gjykatën.

Në këtë rast gjykata fton paditësin që në afat prej (15) ditësh të deklarohet me atë se a është i kënaqur me aktin administrativ të nxjerrë më vonë, heq dorë nga padia, pjesërisht apo tërësisht apo padinë e zgjeron edhe për aktin tjetër administrativ të nxjerrë më vonë nga organi administrativ. Në rast kur paditësi deklaron se me aktin administrativ të nxjerrë më vonë është i kënaqur, apo nuk e jep deklaratën brenda afatit ligjor, gjykata do të merr vendim mbi pezullimin e procedurës. A në rastin kur paditës deklaron se me aktin administrativ të nxjerrë më vonë nuk është i kënaqur, gjykata do ta vazhdojë procedurën.

Kur gjykata nuk e hedhë poshtë padinë për arsyet e lartpërmendura, ose nuk e anulon aktin administrativ gjykata ia dërgon nga një kopje të padisë dhe provave tjera për përgjegjës në padi palës së paditur dhe personave tjerë të interesuar. Në afat prej (30) dite nga dita e dorëzimit të padisë pala e paditur ka të drejtë që të jap përgjigje në padi. Pala e paditur në rastin konkret duhet që ti dërgoj të gjitha shkresat e lëndës, nëse pala e paditur nuk i dërgon shkresat e lëndës ose deklaron se nun mund ti dërgoj, gjykata vendos për çështjen edhe pa shkresa të lëndës.

Gjykata gjatë shqyrtimit të pasisë dhe kërkesëpadiisë me aktgjykim:

- E aprovon (miraton) padinë ose e refuzon padinë
- Nëse padia aprovohet gjykata e anulon aktin administrativ të kontestuar

Kur gjykata me aktgjykim e anulon aktin administrativ të kontestuar, mundet që nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat provat faktet japin bazë të sigurt për këtë çështje me aktgjykim vendos për çështjen administrative. Aktgjykimi i gjykatës e zëvendëson aktin e anuluar.

Përfundim

Nga të gjitha ato që u përmendën më lartë mendojmë që, Ligji i Konfliktit Administrativ duhet që në të ardhmen të pësojë ndryshim në disa pjesë pasi që ka nevojë, duke e krahasuar me ligjin e mëparshëm administrativ i cili sipas mendimit tonë e rregullon më mirë këtë fushë. Tani me Ligjin mbi Gjykatat ku do të themelohen gjykatat themelore dhe kompetente në zgjidhjen e konflikteve administrative do të ishte mirë që të jenë gjykatat themelore apo seksionet e veçanta të cilat do të formoheshin për një gjë të tillë, kjo do të ishte një hap përpara. Tani vetëm Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës ka kompetencë për të vendosur për paditë rreth konflikteve administrative.



Sherife Seferi-Tahiri

POSEDIMI

Nocioni i Posedimit

Posedimi është pushteti faktik mbi një send. Posedimi si institut juridik paraqet një gjendje faktike të mbrojtur nga e drejta pozitive. Posedimi nuk është e drejtë sendore por vetëm pushtet faktik mbi sendin.²²⁸ Pushteti juridik mbi sendin i takon vetëm pronarit të vërtetë.

Ligji për pronësinë dhe te drejtat tjera sendore, përcakton se” Personi i cili e ushtron pushtet faktik mbi një send është posedues i drejtpërdrejtë”.²²⁹

Gjithashtu me këtë ligj parashihet se “Posedues jo i drejtpërdrejtë është personi i cili e jep posedimin e një sendi bazuar në një peng, qira, depozitë, marrëveshje ose raporte juridik të ngjashme që i japin personit tjetër të drejtën e posedimit të sendit për një kohë të caktuar”.²³⁰

Ndërsa Kodi Civil i Shqipërisë në nenin 304 ka paraparë se ”Posedimi është sundimi efektiv i një personi mbi një send dhe mbi të drejtat e tjera reale mbi atë. Posedimi mund të ushtrohet drejtpërsëdrejti ose nga një person që mban sendin”.²³¹

Posedimi edhe pse gëzon mbrojtje juridike, ai nuk konsiderohet e drejtë sendore. Mbrojtja e posedimit nga gjykatat nuk nënkupton mbrojtjen e një të drejte subjektive, por mbrohet pushteti faktik i fundit mbi sendin.

²²⁸ Prof. Abdulla Aliu, E drejta sendore, faqe 51.

²²⁹ Ligji për Pronësinë dhe te drejtat tjera sendore, Nr.03/L-154, neni 103

²³⁰ Si në 2, neni 109 par.1

²³¹ Kodi Civil i Shqipërisë, neni 304.

Rëndësia e Posedimit

Posedimi ka rëndësi të madhe si për të drejtën civile ashtu edhe për të drejtën sendore. Ai që e posedon sendin supozohet që është pronar ose titullar i ndonjë te drejte. Meqenëse poseduesi e ka pushtetin faktik ai në një mënyrë gëzon mbrojtje juridike.²³²

Rëndësi të tjetër të madhe ka ngase posedimi e sidomos ai me mirëbesim dhe i ligjshëm paraqet fakt juridik që ndikon në fitimin e të drejtës së pronësisë apo ndonjë të drejtë tjetër, respektivisht mund të shkaktoje shuarjen e ndonjë të drejte sendore të titullarëve të tjerë.

Në nenin 27 par 2 të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore thuhet “Personi i cili e posedon sendin e luajtshëm si pronarë, e fiton pronësinë mbi frutat e sendit me ndarjen frutave nga ky send”. Ndërsa ne nenin 28 par. 1 te po këtij ligji thuhet ” Një person i cili ka në posedim pronësor një send të luajtshme për dhjetë (10) vite pa ndërprerje të posedimit e fiton pronësinë mbi këtë send me përfundimin e kohës prej dhjetë (10) vjetëve (fitimi me parashkrim), në qoftë se në fillimin dhe gjatë kohës prej dhjetë (10) viteve ai nuk ishte në dijeni se nuk i takonte e drejta e pronësisë”. Dispozitat e nenit 40 të Ligjit për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore parasheh se “Personi i cili me mirëbesim e ka njëzetë (20) vjet në posedim të pandërprerë një paluajtshmëri ose një pjesë të saj, e fiton pronësinë në të. Personi i cili e ka dhjetë (10) vjet në posedim të pandërprerë një paluajtshmëri dhe nëse ai është regjistruar si posedues pronësor në kadastër e fiton pronësinë në paluajtshmërinë ose në ndonjë pjesë të saj, në qoftë se brenda këtij afati nuk është regjistruar ndonjë kundërshtim lidhur me regjistrimin.²³³

Gjithashtu posedimi ka rëndësi të madhe për shkak se kryen funksionin e publicitetit të të drejtave, kur për objekt janë sendet e luajtshme të cilat mund të shihen.

Poseduesi edhe ne rastet kur nuk është pronar mund te përgjigjet për dëmin e shkaktuar, në bazë të përgjegjësisë objektive.

Kuptimi tradicional (Romak) dhe kuptimi modern i posedimit

E drejta romake për të ekzistuar posedimi ka kërkuar që të plotësohen dy

²³² Prof. Abdulla Aliu, E drejta sendore, faqe 54

²³³ Ligji për pronësinë dhe te drejtat tjera sendore, Nr.03/L-154, neni 40.

kushte: zotërimi i sendit (corpus) dhe dëshira (animus) vullneti që sendin ta mbajë për veti.²³⁴ ndërsa kuptimi modern i posedimit kërkon vetëm pushtetin faktik mbi sendin ndërsa manifestimi i dëshirës që sendin ta mbajë për vete nuk kërkohet.

Në bazë të këtij kuptimi posedimin e ka çdo herë pronari i sendit dhe në këto raste posedimi është posedim pronësor, mirëpo ka raste kur posedimin e ka edhe pengmarrësi, ose qiramarrësi të cilët sendin e mbajnë si të huajin dhe në këtë rast këtë posedim e quajmë posedim përdorues jo pronësor. Edhe ky posedim gëzon mbrojtje juridike.²³⁵

Posedimi pronësor është atëherë kur poseduesi ka edhe pronësinë ose sillet ndaj sendit si pronar i tij, ndërsa posedimi përdorues është atëherë kur poseduesi nuk është pronar i sendit dhe nuk sillet ndaj tij si pronar.

Objekti i posedimit

Objekt i posedimit natyrisht se janë sendet. Mund të jenë sendet e sendet e paluajtshme dhe sendet e luajtshme, individualisht të përcaktuara. Këtu bëjnë pjesë edhe frytet e shkëputura.

Për të qenë objekt i posedimit sendi duhet të jetë në qarkullimin juridik. Sendet që janë në përdorim të përgjithshëm nuk mund të jenë objekt i posedimit si p.sh. rrugët publike, parqet publike etj.

Posedimi i të drejtës

Kur dikush nuk e ka pushtetin e plotë faktik ndaj sendit, por vetëm pushtet të atillë që është përmbajtje e ndonjë të drejte sendore tjetër, ai e ka posedimin e të drejtave. D.m.th. se objekti i posedimit mund të jetë edhe një e drejtë servituti, e drejta në barrën reale, e drejta e obligacionit që janë rezultat i ndonjë pune juridike.²³⁶

Me nenin 259 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtave tjera Sendore, thuhet se "Në qoftë se poseduesi i një paluajtshmërie dominuese pengohet në ushtrimin e një servituti sendor të regjistruar në regjistrin e të drejtave në

²³⁴ Dr. Ivo puhan, E drejta Romake.

²³⁵ Prof.Abdulla Aliu, E drejta sendore, faqe 55.

²³⁶ Prof.Abdulla Aliu, E drejta sendore, faqe 57.

paluajtshmëri, atëherë poseduesi përshtatshmërisht e gëzon të njëjtën mbrojtje të posedimit sikurse pronari.²³⁷

Ndërsa Kodi Civil i Shqipërisë në nenin 304 parasheh se "Posedimi është sundimi efektiv i një personi mbi një send dhe mbi të drejtat e tjera reale mbi atë".²³⁸

Poseduesi i të drejtave është kryerje faktike e përmbajtjes esenciale të ndonjë të drejte të lidhur me vullnetin që përmbajtja e asaj të drejte të kryhet për veti.

Krijimi dhe shuarja e posedimit

Momenti i krijimit të posedimit paraqet rendësi të madhe në të drejtën sendore.

Posedimi krijohet në konstituimin e pushtetit faktik ndaj sendit ose të drejtës që është objekt i posedimit.

Fitimi i posedimit

Posedimi mund të fitohet në dy mënyra: origjinere dhe derivateve. Fitimi origjiner i posedimit është kur posedimi fitohet pa vullnetin apo kundër vullnetit të poseduesit të deritanishëm. Fitimi i posedimit bëhet pra pa marrë parasysh paraardhësin.

Te fitimi derivativ posedimi bëhet me vullnetin e poseduesit paraardhës, që nënkupton kalimin e posedimit nga një posedues në poseduesin tjetër. Do të thotë fitimi derivativ bëhet me dorëzimin e sendit dhe dorëzimi i sendit nënkupton konstituimin e posedimit.²³⁹

Kemi kalimin e thjeshtë të sendit në posedim (prej dore në dore), dorëzimin simbolik (ja dorëzon çelësat) si dhe dorëzimin vetëm në bazë të deklarimit të vullnetit.

Kodi Civil i Shqipërisë ka paraparë se "Posedimi fitohet me anë veprimesh juridike, me trashëgim dhe me pushtim. Ai që ka fituar posedimin me

²³⁷ Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, Nr.03/L-154, neni 259

²³⁸ Kodi Civil i Shqipërisë, neni 304.

²³⁹ Prof. Abdulla Aliu, E drejta sendore, faqe 59.

mirëbesim, mund të bashkojë në posedimin e vet, edhe kohën e posedimit me mirëbesim të personit nga i cili ka fituar sendin”.²⁴⁰

Bashkëposedimi dhe posedimi i përbashkët

Meqenëse në të drejtën sendore ekziston bashkëpronësia për ketë arsye edhe gjendja faktike mund të paraqitet si bashkëposedim. Te e drejta e pronësisë, servituti, bashkëposedimi, pushtetin faktik të poseduesit e ushtrojnë sipas pjesëve alikuote.

Bashkëposedimi ekziston nëse sendin e caktuar të cilin bashkëposedusit e përdorin sipas pjesëve alikuote ai që ka 1/3 e pushtetit faktik e përdor sendin 1 herë në krahasim me atë që e ka pushtetin faktik të vëllimi 2/3 i cili e përdor sendin 2 herë më shume se i pari.

Edhe ligji i aplikueshëm e parasheh bashkëposedimin në nenin 108 ku thotë se “Nëse disa persona e kanë bashkëposedimin në një send, e drejta e një personi për përdorimin sendit në raport me të tjerët dhe mbrojtja individuale e poseduesit për posedimin e tij është e kufizuar me të drejtën e personave të tjerë për përdorimin e sendit ashtu siç është paraparë përdorimi”.²⁴¹

Ndërsa posedimi i përbashkët ekziston atëherë kur dy e më shumë persona e ushtrojnë pushtetin faktik mbi sendin dhe nuk dihet vëllimi i ushtrimit faktik deri sa të ndahet sendi i përbashkët në posedim. Te posedimi i përbashkët poseduesit nuk kanë të drejtë që posedimin ta ushtrojnë në mënyrë të pavarur.

Llojet e posedimit

Posedimi i drejtpërdrejt dhe posedimi i tërthortë

Posedimi i drejtpërdrejtë ekziston atëherë kur personi drejtpërdrejtë ose përmes të të autorizuarit ushtron pushtetin faktik mbi sendin.

Posedimi i tërthortë ekziston atëherë kur pushtetin faktik mbi sendin e ushtron përmes një personi tjetër, i cili në bazë të frytë gëzimit, kontratës mbi pengun, qirasë, shërbimit, e ka sendin ne posedim të drejtpërdrejtë.²⁴²

²⁴⁰ Kodi Civil i Shqipërisë, neni 309.

²⁴¹ Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, Nr.03/L-154, neni 108.

²⁴² Prof. Abdulla Aliu, E drejta sendore, faqe 63

Për pronarin ky lloj posedimi është posedim indirekt, ndërsa për mbajtësin e sendit në bazë të punës juridike kemi posedim të drejtpërdrejtë.

Posedimi i ligjshëm dhe jo i ligjshëm

Posedimi i ligjshëm është posedim i cili mbështetet në bazë juridike të vlefshme si p.sh. pune juridike, vendim, okupim etj. Posedimi i paligjshëm është posedim i cili nuk mbështetet në ndonjë bazë juridike. Nëse posedimi e ka bazën juridike të vlefshme, ka mundësi që të bëhet edhe pronar përmes institutit të parashkrimit fitues.

Posedimi i vërtetë dhe jo i vërtetë

Posedim i vërtetë është ai i cili fitohet në mënyrë të rregullt me bazë të rregullt, me dorëzim të lejueshëm të sendit në pushtet faktik. Posedim i vërtetë ose i qetë është ai posedim i cili nuk është fituar me viciam ose precaris, që do të thotë me forcë, mashtrim ose keqpërdorimin e besimit. Ndërsa në rastet kur posedimi bëhet me forcë, mashtrim ose keqpërdorim të besimit atëherë ekziston posedimi jo i vërtetë.

Posedimi jo i vërtetë bëhet posedim i vërtetë pas kalimit të kohës brenda së cilit personi nga i cili është marrë sendi nuk ka ndërmarrë veprime për ta mbrojtur të drejtën e vet të posedimit.²⁴³

Posedimi me mirëbesim dhe posedimi me keqbesim

Posedues me mirëbesim është ai që nuk di apo nga rrethanat e arsyeshme nuk duhet të dinte se sendin që e posedon nuk është i tij. Gjithashtu parashihet se mirëbesueshmëria e posedimit supozohet. Posedues me keqbesim është ai i cili e ka ditur se pa autorizim e posedon sendin e huaj ose nga rrethanat ekzistuese është dashur ta dinte se nën pushtetin e vet faktik e ka sendin e huaj.

Posedues me keqbesim është edhe poseduesi me mirëbesim pas marrjes së padisë për kthimin e sendit, nëse poseduesi e ka humbur kontestin në gjykatë. D.m.th. mirëbesimi ndërpritet në momentin kur poseduesi merr dijeni se posedimi nuk i takon atij.²⁴⁴

²⁴³ Prof. Abdulla Aliu, E drejta sendore, faqe 64

²⁴⁴ Prof. Abdulla Aliu, E drejta sendore, faqe 65

Mbajtësi i sendit në posedim gjithmonë supozohet se është me mirëbesim deri sa nuk vërtetohet e kundërta. Poseduesi me keqbesim mund të jetë ligjor (me kontrate) dhe i vërtetë, sepse është dorëzuar sendi por me keqbesim ngase e ka ditur se blen sendin e vjedhur.

Efektet juridike te posedimi me mirëbesim

Posedimi ka efekt të veçantë sa i përket shpenzimeve të krijuara gjatë posedimit. Kemi shpenzimet e domosdoshme, shpenzimet e dobishme dhe shpenzimet e luksit. Shpenzimet e domosdoshme, u pranohen si poseduesit me mirëbesim ashtu edhe atij me keqbesim nëse kanë sjellë deri tek ruajtja e sendit nga shkatërrimi (shpenzimet për ruajtjen e shtëpisë nga rrënimi).

Shpenzimet e dobishme janë ato shpenzime të cilat e rrisin vlerën e sendit. Këto shpenzime poseduesit me mirëbesim iu pranohen të gjitha sipas kriterit objektiv deri në vlerën sa ka ndërhyrë. Ndërsa poseduesit me keqbesim i njihen këto shpenzime sipas kriteri subjektiv do të thotë se çfarë është fitim për pronarin.²⁴⁵

Shpenzimet e luksit janë ato shpenzime që bëhen vetëm për zbukurimin e sendit ose për shkak të komoditetit të sendit. Këto shpenzime nuk i njihen asnjërit posedues, ndërsa u lejohet jus tollendi-e drejta e heqjes nëse nuk dëmtohet sendi kryesor, kurse sa i përket poseduesit me keqbesim ky mund të detyrohet ti heq nëse urdhërohet nga pronari.

Efektet juridike lidhur me frytet

Kemi frytet natyrore dhe frytet civile. Sa u përket fryteve natyrore poseduesi me mirëbesim ka të drejtë mbi frytet dhe ai i fiton ato me vjelje dhe nuk ka përgjegjësi për to derisa ka ekzistuar posedimi. Ndërsa poseduesi me keqbesim nuk bëhet pronar i fryteve dhe ai përgjigjet për tërë kohën që ka qenë në posedim. Ai përgjigjet si për frytet e vjela ashtu edhe për ato të pavjela të cilat konsiderohen si fitim i munguar.

Sa u përket fryteve civile, poseduesi me mirëbesim i mban frytet civile dhe i kthen ato që i ka mbledhur para se të arrijnë (qiraja e marr për një vit). Ndërsa poseduesi me keqbesim i kthen të gjitha frytet civile si ato të vjela ashtu edhe ato të pavjela.

²⁴⁵ Prof.Avdulla Aliu, E drejta sendore, faqe 66

Mbrojtja e posedimit

Edhe pse posedimi nuk është e drejtë sendore ai gëzon mbrojtje juridike. Askush nuk mund ta cenoje pushtetin faktik në mënyrë arbitrare, por vetëm me ndihmën e organeve kompetente, poseduesi i sendit ka të drejtë në mbrojtje nga shqetësimet (pengimet) ose nga marrja e sendit nga posedimi, në këtë rast poseduesi zhvishet nga posedimi i sendit.

Për mbrojtjen e posedimit ekzistojnë dy padi:

1. Padia për pengimin e posedimit dhe
2. Padia për kthimin e posedimit.

Këto padi ndryshe quhen edhe padi posesore.²⁴⁶ Mund te përdoret edhe vetëmbrojtja në kushtet kur është e lejuar vetëndihma. Poseduesi ka të drejtë në vetëndihmë kundër çdo subjekti i cili në mënyrë të kundërligjshme e shqetëson në ushtrimin e posedimit, që ja ka marrë sendin.

Për ta përdorur ndihmën duhet të plotësohen disa kushte siç janë:

1. Rreziku të jetë i drejtpërdrejtë,
2. Vetëndihma të jetë e nevojshme, dhe
3. Veprimi me vetëndihmë t' i përgjigjet rrethanave të rrezikut.²⁴⁷

Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore ka paraparë se “Poseduesi mund të përdorë forcën e arsyeshme për mbrojtje nga veprimet e paligjshme në pengimin e posedimit të tij, në qoftë se ndërhyrja është atëçastshme dhe janë ndërmarrë masat adekuate (proporcionale) për mbrojtje, menjëherë me paraqitjen e ndërhyrjes (rrezikut)”.²⁴⁸

Kodi Civil i Shqipërisë këtë e njëh si mbrojtje të atëçastshme ku me nenin 310 parashihet se “Poseduesi ka të drejtë të kundërshtojë aty për aty, duke përdorur një mbrojtje të përshtatshme, çdo veprim që ka për qëllim cenimin ose zhveshjen nga posedimi. Kur sendi është marrë me dhunë ose fshehurazi, poseduesi ka të drejtë ta marrë atë menjëherë ose në ndjekje e

²⁴⁶ Prof. Abdulla Aliu, E drejta sendore, faqe 67

²⁴⁷ Prof. Abdulla Aliu, E drejta sendore, faqe 67

²⁴⁸ Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, Nr.03/L-154, neni 112 par.1

sipër, por duke evituar veprimet e dhunës që nuk pajtohen me rrethanat e ngjarjes²⁴⁹

Mbrojtja gjyqësore nga trazimi, respektivisht nga marrja e posedimit mund të kërkohe brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e njoftimit për pengimin dhe kryesin, e më së largu brenda afatit prej një viti nga dita e pengimit të bërë. Nëse paditësi ka marrë vesh për pengim ose marrje pasi ka kaluar një vit nuk mund të paraqesë padinë poseduese. Poseduesi në këto raste paraqet padinë për mbrojtjen e pronësisë.

Paditë poseduese janë padi sumare, të shkurta dhe të shpejta. Gjykata duhet të veprojë në mënyrë urgjente për të vendosur lidhur me posedimin. Gjykata për posedimin vendos me aktvendim.

Mbrohet çdo posedim, qoftë ai i tërthortë ose i drejtpërdrejtë, me mirëbesim ose keqbesim, i ligjshëm apo i paligjshëm.

Pengim posedimi është çdo akt me të cilin pengohet ushtrimi normal i pushtetit faktik ekonomik që e përmban posedimi, për shembull nëse një person e pengon pronarin të shfrytëzojë pronën e vet që e ka në posedim, ose një person e pengon tjetrin ta shfrytëzojë servitutin për kalim rrugor.

Kemi pengim posedimi edhe në rastin kur i padituri e ka prishur mekanizmin e derës hyrëse kryesore dhe e ka nderuar atë, me të cilin veprim ia ka pamundësuar paditësit shfrytëzimin e qetë të banesës.²⁵⁰

Me padinë për pengim posedim kërkohe dy gjëra; 1) ndërprerja e pengimit dhe 2) ndalesa e pengimit. Kur kemi pengim posedim, paraqitet padia për pushimin e pengimit të posedimit.

Gjykata siguron mbrojtjen sipas gjendjes së fundit të posedimit dhe pengimit të bërë, me ç'rast nuk ka ndikim e drejta për posedimin, baza juridike e posedimit dhe mirëbesueshmëria e mbajtësit. Edhe mbajtësi që posedimin e ka fituar me force fshehtas ose me keqpërdorimin e besimit ka të drejtë për mbrojtje, përveç ndaj personit nga i cili ne mënyrë të tillë e ka realizuar posedimin.

²⁴⁹ Kodi Civil i Shqipërisë, neni 310.

²⁵⁰ Prof.V.Ristiç dhe prof.M.Ristiç, doracak per zbatimin e procedures kontestimore, faqe 268

Nëse poseduesi privohet nga posedimi në mënyrë të kundërligjshme, poseduesi mund të kërkojë rivendosjen e posedimit prej personit ndërhyrës, i cili në raport me poseduesin është në posedim me të meta. Nëse poseduesi pengohet në posedim në mënyrë të kundërligjshme, atëherë poseduesi mund të kërkojë nga penguesi mënjanimin e pengesave. Nëse priten pengime në të ardhmen, poseduesi mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore. Kërkesa kundër ndërhyrjes në posedim është e përjashtuar në qoftë se poseduesi e ka posedimin me të meta në raport me penguesin ose të drejtën e paraardhësit të penguesit.²⁵¹

Me vendimin mbi kërkesën për mbrojtjen nga pengimi i posedimit caktohet ndalimi i trazimit të mëtejshëm të posedimit nën kërcënimin e gjobës, respektivisht kthimit të posedimit që është marrë, si dhe masa tjera të nevojshme për mbrojtje nga pengimi i mëtejshëm. Fakti se në pasurinë publike nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë që do të thotë se as personit i cili e ka uzurpuar të mirën publike (te përgjithshme) nuk mund ti ofrohet ndihme juridike në kuptim të mbrojtjes së posedimit.

Nuk mund të kërkojë mbrojtje juridike për shkak të pengimit në posedim të mirave publike që janë në përdorim të të gjithë qytetarëve sepse në këto të mira askush nuk mund të fitojë pronësinë dhe të drejtat tjera sendore.²⁵²

Shuarja e posedimit

Meqenëse posedimi është pushteti faktik mbi sendin, me humbjen e këtij pushteti humb edhe posedimi. Zhveshja nga pushteti faktik duhet të jetë kundër vullnetit të poseduesit. Posedimi shuhet edhe me shkatërrimin e sendit që është objekt i posedimit, me bartjen e sendit personit tjetër (me dhurimi, shitjen).

Po ashtu humbje të posedimit kemi edhe kur sendi i kthehet poseduesit, respektivisht pronarit në bazë të padisë për rikthimin e sendit në posedim ose në bazë të padisë për mbrojtjen e pronësisë actio reivindicatio dhe padisë publiciane, në rast se këto padi përfundojnë me sukses.²⁵³

²⁵¹ Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, Nr.03/L-154, neni 113.

²⁵² Doracak për zbatimin e Ligjit për marrëdhëniet themelore juridike pronësore, autori Mr.Radmilla Petaković, faqe 152

²⁵³ Prof.Abdulla Aliu, E drejta sendore, faqe 71.



Flamur Bogaj

PROVAT DHE TË PROVUARIT

Hyrje

Zhvillimi historik i procesit të të provuarit në procedurën penale

Procedura penale dhe procesi i të provuarit në Athinën antike zhvillohej para trupit gjykues të quajtur “Heliaja” të cilën e përbënin gjyqtarë joprofesionist të zgjedhur nga radha e qytetarëve të lirë. Në të vërtetë Heliaja-Kuvendi ishte gjyq kryesor të cilën e themeloi Soloni për çështje politike dhe të cilën e përbënin 6 mijë qytetarë të quajtur heliast të cilët zgjidheshin me short e të cilët ndaheshin në dhjetë degë²⁵⁴ me nga 500 gjyqtarë, ku 1000 të tjerë ishin zëvendës gjyqtarë.

Shqyrtimi gjyqësorë zgjaste vetëm një ditë, në të nuk ekzistonte prokuror publik e as mbrojtës. Gjyqtari duhej të betohej se do të gjykonte sipas ligjeve e kur në ndonjë rast nuk kishte ligje do të gjykonte sipas ndërgjegjes së pastër. Përveç trupit gjykues Heliaja, në Athinë gjykonte edhe Këshilli i Aeropagut.²⁵⁵

Për pjesën dërmuese të veprave penale si paditës paraqitej i dëmtuari ose përfaqësuesi i tij ligjor e të cilat përbënin procedurën private apo “dike” kurse për krim kundër shtetit si paditës mund të paraqitej secili qytetar pavarësisht se a ishte i dëmtuar apo jo, të cilin e caktonte populli dhe e përbënte procedurën publike apo “grafe” ku në këtë rast padia nuk mund të tërhiqej. Paditësi privat ose ai publik ia dorëzonte padinë arkondit i cili pas përgatitjes e caktonte shqyrtimin gjyqësor dhe tërë çështjen ia dorëzonte gjykatës. Përndryshe brenda një dite gjykohej një padi publike apo katër padi private.

²⁵⁴ Dr. Ejup Sahiti, Argumentimi në procedurë penale fq. 31 Prishtinë 1999

²⁵⁵ Po aty

Në procesin e të provuarit, paditësi i pari e mbante bisedën e akuzës, njëherësh duke i prezantuar gjykatës dëshmitarë dhe dokumente, i cili vet i merrte në pyetje dëshmitarët e tillë e mund ta merrte në pyetje edhe të pandehurin. Pastaj mbrojtjen e realizonte i pandehuri ose mbrojtësi i tij të cilët po ashtu para gjykatës prezantonin dëshmitarë të cilët po ashtu i merrnin në pyetje. Pas përfundimit të fjalës së palëve, gjyqtarët votonin për fajin e të pandehurit. Vendimi gjyqësor merrej me shumicë votash. Votimi bëhej duke lëshuar guralecë, fasule apo gjësunde tjera. Guri apo fasulja e bardhë ishte votë²⁵⁶ për dënim, kurse e zeza për dënim.

Siç shihej në Athinë palët i propozonin provat, ndërsa gjykata ishte pasive. Si provë ekzistonte pohimi i të pandehurit, dëshmia e dëshmitarit, dokumentet dhe indiciet. Çmuarja e provave bëhej sipas bindjes së lirë të gjykatës. Mirëpo vlen të theksohet se trupi gjykues i përbërë prej qindra gjyqtarësh nuk ishte në gjendje që nëpërmjet procesit analitik të provave dhe sintezës së tyre çdoherë t'i çmonte provat, por bindjen për fajin e të pandehurit e formonte më tepër në bazë të aftësive oratorike të palëve, me ç'rast merreshin edhe vendime të atilla për të cilat më vonë, qytetarët e Athinës pendoheshin. (i tillë ishte edhe gjykimi i Sokratit, ku trupin gjykues kundër tij e kanë përbërë 501 gjyqtarë²⁵⁷).

Procedura penale dhe procesi i të provuarit në drejtën Romake – Për shkak të ekzistimit të gjatë të shteti romak, analizës së procedurës penale dhe procesit të të provuarit duhet bërë sipas periudhave të zhvillimit në kohën e vjetër, në kohën e Republikës Romake dhe në kohën e Perandorisë Romake. Në kohën e vjetër Romake pushteti ishte i përqendruar në duart e prijësit ushtarak i cili kishte edhe pushtet gjyqësor. Në këtë kohë edhe i zoti i shtëpisë “pater familias” gjithashtu posedonte pushtet të madh ndëshkues ndaj anëtarëve të familjes ku anëtarin e familjes mund ta ndëshkonte edhe me vdekje.

Me rënien e demokracisë ushtarake dhe asaj mbretërore vie pushteti i magistratit i quajtur “coercitio” e me këtë u kufizua edhe e drejta e shqiptimit të dënimit me vdekje. Me këtë rast i gjykuari me vdekje mund të kërkonte që për dënimin e shqiptuar me vdekje të vendos populli²⁵⁸ në kuvendin popullor apo për t'i shpëtuar dënimit me vdekje i dënuari vullnetarisht mund të shkonte jashtë vendit “Exilium”.

²⁵⁶ Po aty, fq. 33

²⁵⁷ Po aty, fq. 32

²⁵⁸ Po aty, fq. 34

Në kohën e Republikës Romake, procedura penale ishte e tipit akuzues sipas parimit të ligjshmërisë dhe se ekzistonte e drejta e ushtrimit të padisë popullore “actio popularis”, ku për padi të rreme parashihej dënimi infamy me stigmatizimin e shkronjës “k” në ballë të paditësit. Padia ushtrohej me shkrim ose gojarisht në procesverbal. Me ngritjen e padisë caktohej edhe data e gjykimit, ku me këtë rast paditësi nuk mund ta ndryshonte akuzën. Gjyqi i quajtur “kuestia” përbëhej nga gjyqtarë joprofesionist prej 32 deri 75 të zgjedhur me short. Shqyrtimi gjyqësorë mbahej me dyer të hapura sipas parimit të publicitetit, gojor, të drejtpërdrejtë dhe kontradiktor. Vendimi gjyqësor nuk mund të apelohej.²⁵⁹

Në procesin e të provuarit barra e provës i takonte paditësit. Shqyrtimi fillonte me fjalën e paditësit i cili e mbështeste akuzën, i ofronte gjykatës dëshmitarë të cilët vetë i merrte në pyetje, ofronte dokumente. Edhe i pandehuri kishte të drejtë t’i ofrojë gjykatës dëshmitarë, t’i merrte në pyetje, t’ju bënte pyetje dëshmitarëve të paditësit, sipas parimit të pyetjeve kryqore. Si provë mund të përdorej: pohimi i të pandehurit, dëshmia e dëshmitarit, dokumentet dhe indiciet.

Pohimi i të pandehurit merrej si provë e plotë dhe më nuk verifikohej. Në këtë kohë nuk ekzistonte obligim i përgjithshëm për të dëshmuar. Kështu që nuk lejohej që skllavi i liruar të dëshmojë ndaj ish padronit as ndaj të afërmeve të tij. Pastaj nuk lejohej dëshmimi i pasardhësve ndaj paraardhësit të tij etj. Nëse vinte deri te dëshmimi përmes formave të mundimit atyre u nënshtrohej vetëm dëshmitari skllav, të cilin e merrte në pyetje gjyqtari me ç’rast hartonte procesverbal dhe ajo nxirrej si prove. I pandehuri kishte të drejtë të thërras edhe dëshmitarë që nuk dinin asgjë për çështjen penale, por që ishin në gjendje të deklaropin mbi karakterin e mirë të të pandehurit. Këta zakonisht ishin dëshmitarë-persona të njohur publik të cilët shprehnin mendimin e favorshëm para gjykatës për të pandehurin²⁶⁰.

Në kohën e Perandorisë Romake, sikurse pushteti politik ashtu edhe ai gjyqësorë përqendrohej në duart e perandorit i cili gjykonte veprat më të rëndësishme, ndërsa Senati zhvillonte gjykim kur i pandehuri ishte senator, ndërsa në të gjitha rastet tjera gjykimin e zhvillonin nëpunësit perandorak në të cilët perandori e kishte deleguar funksionin e gjykimit. Përkundër periudhës së republikës romake ku vlente parimi i ligjshmërisë në kohën e

²⁵⁹ Po aty, fq. 35

²⁶⁰ Po aty, fq. 36

perandorisë romake vlente parimi se as perandori e as senati dhe gjyqtarët perandorak nuk ishin të lidhur me dispozita ligjore, përkundër ekzistimit të tyre. Gjykimi mbahej me dyer të mbyllura, ku mund të prezantonin vetëm persona nga shtresat e larta.

Në këtë periudhë vinte në shprehje angazhimi i gjykatës në procedimin e provave nëpërmjet pyetjes së të pandehurit, të dëshmitarëve, zbatimit të torturës ndaj të pandehurit që vinte nga shtresat e ulëta dhe dëshmitarit. Tortura zbatohej edhe ndaj të pandehurve që vinin nga shtresat e larta për vepra të rënda penale, siç ishte tradhtia²⁶¹. Edhe në këtë periudhë, çmuarja e provave bëhej sipas bindjes së lirë të gjyqtarit, por se pohimi i të pandehurit duhej të verifikohej. Çka është me rëndësi kah fundi i shekullit të III-të epokës së re vlente rregulla se: “Sipas dëshmisë së një dëshmitari të vetëm nuk mund të konsiderohej një fakt i vërtetuar”, por nevojitej dëshmia e pajtueshme e dy dëshmitarëve juridikisht pa të meta. Vendimi gjyqësorë mund të apelohej²⁶².

Procedura penale dhe procesi i të provuarit në të drejtën e Sheriatit – Në kohën e injorancës në Mekë dhe në tërë gadishullin Arabik ekzistonin gjyqtarë të fisit të quajtur “Hakem”, të cilëve u drejtoheshin palët për zgjidhjen e konfliktit. Gjyqtarët e tillë ishin njerëz të rëndomtë, joprofesionist, por të njohur si njerëz të mençur dhe të ndershëm. Me atë rast gjykohej në bazë të dokeve dhe rezonimit të lirë të gjyqtarit.

Aktgjykimi ishte i paatakushëm dhe në momentin e shqiptimit i ekzekutueshëm. Pas formimit të shtetit të parë mysliman në Medinë në vitin 622 të epokës së re, gjyqësia i’u besua shtetit. Si ligj shërbente libri i shenjtë “Kur’ani” dhe hadithi i profetit Muhamed. Funkcionin gjyqësor në të drejtën e sheriatit e ushtronin gjyqtarët të quajtur “kadi”, si gjyqtarë individual profesionist²⁶³.

Në procedurë penale të së drejtës së sheriatit përdorehin mjetet racionale të provës, të cilat palët i paraqitnin para gjykatës. Ndryshe si provë para kadiut përdoren: pohimi i të pandehurit, dëshmia e dëshmitarit, beja dhe shkresat. Pohimi i të pandehurit –“ikrar”, i cili është madhor dhe i shëndosh nga mendja, konsiderohej si provë e plotë. Te pranimi i të pandehurit se ka kryer akt seksual kundërligjor, i pandehuri para kadiut duhej në intervale kohore ta përsëriste pohimin e kjo bëhej në mënyrë që të pandehurit t’i lihej kohë

²⁶¹ Po aty, fq. 37

²⁶² Po aty, fq. 38

²⁶³ Po aty, fq. 47

për të menduar për pasojat e pranimit e eventualisht edhe ta tërhiqte pohimin.

Nga ana e juristëve në kohën e të drejtës së shariatit kundërshtojnë nxjerrja e pohimit nga i pandehuri përmes dhunës, ngase mendohej se i pandehuri mund të jetë edhe i pafajshëm. Kjo gjënë mbështetje edhe në parimin, “Se më mire është të gabohet në falje se sa në ndëshkim”.

Dëshmia e dëshmitarit – shehade, zë vend të rëndësishëm në të drejtën e shariatit e cila jepej para kadiut në prezencë të palëve me qëllim të argumentimit të së²⁶⁴ drejtës së dikujt. Është interesant se për t’u konsideruar një person dëshmitar ai duhet të ishte i lirë, mysliman, madhor, mentalisht i shëndosh dhe të jetë në gjendje gojarisht të dëshmojë, ndërsa dëshmia e dëshmitarit i cili i fsheh detajet e rastit nuk pranohej.

Nga kjo që u cek më lartë nuk pranohej që jomuslimani dhe femra të jenë dëshmitar kur shqiptojnë dënimi “hadd” sidomos për disa inkriminime që gjenden në Kur’an,²⁶⁵ si vepra penale me karakter fetar. Është interesant se në të drejtën e shariatit sidomos te ato gjykime kur shqiptojnë dënimi “hadd”, me rastin e dëshmitarit dëshmitari i nënshtrohej të ashtuquajturës “tezkije” që donë të thotë dëlirje-kullim i dëshmitarit me anën e së cilës kërkohej informata mbi personalitetin e dëshmitarit se a është i mire dhe i drejtë për të dëshmuar²⁶⁶.

Në të drejtën e shariatit në procesin e të provuarit më së shpeshti kërkohej dëshmia e dy dëshmitarëve, ndërsa për provimin e aktit seksual kundërligjor të burrit të martuar dhe të gruas së martuar ku parashihet dënimi me vdekje, për vërtetimin e atij akti domosdo kërkohej deklarimi i pajtueshëm i katër dëshmitarëve të ndershëm të cilët duhet të dëshmojnë se me sytë e vet e kanë shikuar aktin seksual e në rast se nuk arrihej dëshmia e pajtueshme e katër dëshmitarëve, konsiderohej se vepra e akuzuar nuk është argumentuar, andaj dëshmitarët e tillë i ekspozoheshin rrezikut për vepër penale të shpifës për kurvëri me ç’rast secili dëshmitar dënohej me 80 goditje kamxhik.

Më tutje në rast së dëshmisë së rreme, sipas Ebu²⁶⁷ Hanifes, dëshmitari nxirret në pazar “suk” ku opinioni botërisht bëhet me dije për dëshminë e tij të rreme. Betimi-Jemin në të drejtën e shariatit shërben si mjet provues

²⁶⁴ Po aty, fq. 50

²⁶⁵ Po aty, fq. 51

²⁶⁶ Po aty, fq. 52

²⁶⁷ Po aty, fq. 53

ndihmës për përforsimin e thënieve të ndonjëres palë. Betimi bëhet para kadiut, kur njëra palë nuk disponon prova të mjaftuara për ta rrëzuar pretendimin e palës tjetër. Beja ofrohet nga personat mysliman, madhor dhe mentalisht të shëndoshë dhe duhet të jetë bërë pa trysni fizike e psikike.²⁶⁸

Vlen të theksohet se në rast kur paditësi nuk arrin të argumenton se i pandehuri ka kryer vepër penale, nga i pandehuri kërkohet të betohet se është i pafajshëm e në rast se i pandehuri refuzon atëherë beja i ofrohet paditësit.

Sa i përket shkresave si prova në procedure gjyqësore në të drejtën e shariatit ato më tepër ishin prezentë në procedurë civile, mirëpo për ta sqaruar çështjen që kërkon njohuri të posaçme, kadiu mund të thërras edhe ekspert dhe përkthyes.

Procesi i të provuarit në procedurën e gjykatave kanonike – Pas shkatërrimit të perandorisë romake, përpos në Itali ku edhe më tej zbatohet procedura penale romake, vie dominimi dhe roli i kishës katolike në realizimin e pushtetit gjyqësor.²⁶⁹

Kisha veçanërisht kujdesej për gjykimin e veprave penale siç ishin: Herezia, Shizma (veprime që synon ndarjen e kishës) më pas Apstazia (braktisja e besimit në Zot, besimi në djall), Simonia etj, vepra penale që cenonin organizimin dhe besimin kishtar. Procedura penale kanonike ua ka hapur rrugën provave racionale dhe botëkuptimit romak lidhur me provat. Si provë përdorej: Pohimi, Dëshmimi, Shkresat dhe Indiciet.

Sa i përket pohimit ai nuk mund të merrej me dhunë dhe duhej të verifikohet, pra kisha katolike ishte kundër dhunës, torturës dhe dënimit me vdekje, përderisa do të ndryshojë qëndrim më vonë për shkak të rrezikut që ndjente ndaj përhapjes së herezisë. Mbi këtë bazë përpos gjykatave kanonike si gjykata të rregullta-ordinere u krijuan drejtpërdrejtë nga papa edhe gjykatat inkuizitore-inordinere me qëllim që të pengohet përhapja e Herezisë.²⁷⁰

Zbatimi i procedurës që e zhvillonin gjyqtarët inkuizitor ishte sumare e shkurt, pa ngurrim dhe pa shumë formalitete. Të pandehurit nuk iu

²⁶⁸ Po aty, fq. 54

²⁶⁹ Po aty, fq. 56

²⁷⁰ Po aty, fq. 59

komunikoheshin fare emrat e denoncuesve, as emrat e dëshmitarëve, pastaj lejohej dëshmimi i dëshmitarëve të rremë, i të bashkakuzuarve etj.

Po ashtu gruaja dhe fëmijët e të pandehurit konsideroheshin të përshtatshëm po qe se dëshmonin kundër të pandehurit e në mungesë të provave nga i pandehuri nxirrej pohimi me aplikimin e torturës, gjë që deri atëherë kisha katolike e kishte refuzuar sikurse që ka qenë kundër dënimit me vdekje e i cili dënim tashmë ishte i shpeshtë duke e djegur të pandehurin në turrën e drunjve.²⁷¹

Procedura gjyqësore dhe procesi i të provuarit në të drejtën zakonore shqiptare – E drejta zakonore shqiptare është rezultat i mos ekzistimit të pushtetit qendror i cili me forcën e autoritetit të vet do të hartonte dhe do të zbatonte juridiksion, po në mungesë të sajë janë krijuar rregullat e sjelljes-normat zakonore me të cilat është plotësuar zbrazësit në lëmin juridike. Kësisoj ekzistonte Kanuni i Lekë Dukagjinit, Kanuni i Skënderbeut, Zakoni i Mus Ballgjinut, Kanuni i Papa Zhulit, Kanuni i Idriz Sulit.²⁷²

Këto kanune përveç tjerash përmbanin një sistem normash juridiko-penale dhe procedurale sipas të cilave ndëshkoheshin kryerësit e veprave penale. Në kohët e lashta zgjedhjen e konflikteve e ndihmonin ndërmjetësit e caktuar ku në popuj të ndryshëm ishte i njohur instituti i ashtuquajtur gjyq popullor i përbërë nga gjyqtarë²⁷³ joprofesionist të zgjedhur nga radha e popullit. Më vonë krijohen edhe kuvende - këshille të pleqve të përbërë nga krerët e fiseve ose njerëz të ndershëm, ku pleqëria në një vendim gojor vendoste si për fajësinë e të pandehurit ashtu edhe për dënimin e tij.²⁷⁴

Procedura penale para pleqërisë ishte akuzatore ku për fillimin e saj duhej të ekzistonte padia gojore e të dëmtuarit. Shqyrtimi gjyqësor para pleqërisë fillonte me dëgjimin e paditësit, duke e pyetur të akuzuarin, me analizimin e provave, dhe marrjen dhe komunikimin e vendimit të palëve.

Kanuni i Lekë Dukagjinit parasheh një varg mjetesh të provës dhe prova në procedim të pleqërisë, ku secila palë i ofron argumentet e veta.²⁷⁵ Barra e provave i takonte paditësit mirëpo kur i pandehuri mohonte veprën, barra e provave në atë rast i takonte edhe atij.

²⁷¹ Po aty, fq. 61

²⁷² Po aty, fq. 71

²⁷³ Dr. Ejup Sahiti, E drejta e procedurës penale fq.16 Prishtinë 2005

²⁷⁴ Po aty, fq. 17

²⁷⁵ Dr. Ejup Sahiti, Argumentimi në procedurë penale fq.76 Prishtinë 1999

Vlen të theksohet se sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit dhe në gjykimet e pleqërisë vlente instituti i “marimit” apo pajtimit në mesë palëve, ku pleqëria në çdo rast përpiquej në arritjen e kompromisit në mes palëve me qëllim të shuarjes së konfliktit.²⁷⁶

Në procedurë para pleqërisë Kanuni i Lekë Dukagjinit njih si mjetet racionale të provës ashtu edhe mjetet irracionale të provës. Si mjete racionale të provës njihen; pohimi i të pandehurit, dëshmimi i dëshmitarit, mendimi i ekspertit, kapucari (hetuesi apo detektivi privat), ndjekja e gjurmëve, garantët, këqyrja në vend të ngjarjes, flagranca, fjala nderit dhe shkresat. Ndërsa si mjete irracionale të provës përdorehin; beja dhe betarët, bartja e gurit në krah, gjyqi hyjnor.²⁷⁷

Procesi i të provuarit në procedurë penale bashkëkohore – Në teori të së drejtës së procedurës penale tipi mikst quhet edhe tip bashkëkohorë i procedurës penale. Me kodin penal të Francës të vitit 1808 faktikisht është formuar tipi mikst dhe i cili është rezultat i zhvillimit historik të së drejtës së procedurës penale, ndërsa inovacionet e tij janë shprehje e nevojave të botës bashkëkohore. Procedura penale bashkëkohore e Evropës kontinentale ndahej në fazën përgatitore ku hynte gjurmimi dhe hetimi dhe në shqyrtim kryesor me marrje dhe komunikim të aktgjykimit. Duhet cekur se në mes të këtyre stadeve qëndronte edhe faza e akuzimit me kontroll eventual të akuzës.

Funksionin e ndjekjes e realizon prokurori shtetëror ose publikë, ndërsa të hetimet e ushtron gjykata përmes gjyqtarit hetues, ndërsa në disa shtete që kanë tip të përzierjes së procedurës penale këto dy funksione i ushtron prokurori publik, siç është rasti edhe me Kodin e Procedurës penale të Kosovës.²⁷⁸ Pra deri këtu kemi të bëjmë me elemente të procedurës inkuizitore, ndërsa faza e dytë e tipit të përzier ajo e shqyrtimit kryesor ka të bëjë me elemente të procedurës akuzuese si p.sh aktiviteti i palëve rreth propozimit të provave pastaj respektimi parimeve procedurale, ndërsa elementet e procedurës inkuizitore në këtë stad të procedurës, është roli i gjykatës në vërtetimin e fakteve meqë ajo ka rol aktiv.²⁷⁹

²⁷⁶ Po aty, fq. 78

²⁷⁷ Po aty, fq. 81

²⁷⁸ Po aty, fq. 95

²⁷⁹ Po aty, fq. 96

Për më tepër për procedurën penale bashkëkohore dhe procesin e të provuarit, më gjerësisht do të flasim si më poshtë ku do të shtjellojmë provat dhe procesin e të provuarit sipas Kodit të Procedurës penale të Kosovës.

Provat dhe procesi i të provuarit sipas Kodit të Procedurës Penale të Kosovës

Kuptimi i Provës

Vepra penale është vepër e kundërligjshme e cila është përcaktuar me ligj si vepër penale, tiparet e së cilës janë përcaktuar me ligj dhe për të cilën me ligj është paraparë sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm.²⁸⁰ Posa të paraqitet dyshimi se është kryer një vepër penale paditësi i autorizuar e fillon procedurën penale në të cilën gjykata duhet të analizojë çështjen penale duke u përpjekur të ndriçojë faktet që kanë të bëjnë me veprën penale dhe kryerësin e saj.²⁸¹

Andaj rrethanat e kryerjes se veprës penale dhe fajësia e të pandehurit mund të përcaktohen vetëm me anë të provave. Mirëpo për arritjen e qëllimit të procedurës penale që kryerësit përgjegjës të veprës penale t'i shqiptohet sanksioni penal i merituar është e domosdoshme që të vërtetohen faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, në mënyrë të saktë dhe të plotë duhet të konstatohet e vërteta. E vërteta nënkupton vërtetimin e plotë të të gjitha fakteve relevante juridike nga të cilat varet zbatimi i të drejtës penale materiale duke e përputhur gjendjen e vërtetuar faktike me ngjarjen reale e cila është marrë si vepër penale.²⁸²

Në teori të së drejtës së procedurës penale me rastin e vendosjes së çështjes penale rreth procesit të të provuarit përdoren terme dhe nocione të ndryshme si p.sh: nocioni fakt, provë-argument, dëshmi, mjet i provës-mjet provues, burim i provës e të tjera.

Fakti – është ekzistimi objektivo real i ndonjë sendi, dukurie, procesi, ndodhie, cilësie apo raporti i vërtetuar në mënyrë mendore perceptuese. Faktet të cilat duhet vërtetuar në procedurë penale quhen fakte juridike

²⁸⁰ Kodi penal i Kosovës neni 6

²⁸¹ Dr. Ejup Sahiti, E drejta e procedurës penale fq.54 Prishtinë 2005

²⁸² Po aty fq. 131

relevante dhe si të tilla janë objekt i të provuarit²⁸³, ku mbi këtë bazë dallojmë faktet juridike relevante, indiciet dhe faktet ndihmëse.

Faktet juridike relevante janë të gjitha faktet ekzistuese ose që kanë ekzistuar të cilat janë përfshirë në kushtet që i parashtron e drejta penale material për shqiptimin e sanksionit penal, faktet që gjenden në kushtet në të cilat e drejta e procedurës penale e lidh detyrimin e gjykatës që të zhvillojë procedurë penale si dhe faktet të cilat gjenden në kushtet nga të cilat varet mënyra e ushtrimit të veprimeve procedurale.

Në procedurë penale duhet bërë përpjekje që faktet të vërtetohen në mënyrë direkt, qoftë përmes perceptimit personal të gjykatës, qoftë përmes perceptimit të personave tjerë. Vërtetimi i këtyre fakteve bëhet përmes provave direkt e në mungesë të tyre organi procedurës ato i vërteton përmes provave indirekte, që nënkupton se organi i procedurës vërteton ekzistimin e ndonjë fakti i cili në të vërtetë nuk është juridikisht relevant, por që nga ekzistimi i tij në bazë të eksperiencës me besueshmëri më të madhe apo më të vogël logjikisht mund të konkludohet se ekziston një fakt juridikisht relevant. Faktet e tilla quhen indicie.

Pra për organin e procedurës indiciet janë burime njoftimesh për faktet juridike relevante, prandaj organi i procedurës edhe i vërteton, ngase në një anë ato janë fakte e në anën tjetër ato janë prova për vërtetimin e fakteve tjera²⁸⁴. Me fjalë të tjera faktet indiciale shërbejnë në momentin e parë si udhërrëfyes, që shpijnë drejt qëllimit për njohjen e së vërtetës objektive për ekzistimin e veprës dhe të kryerësit, pra indiciet janë fakte në të cilat këto veprime fillojnë dhe me të cilat ndriçohet dhe provohet vepra penale dhe kryerësi i saj²⁸⁵. Ndërsa gjendja faktike në procedurë penale është tërësi e fakteve vendimtare (fakteve juridike relevante). Ajo është gjendje e konstatuar me vendim gjyqësor, gjendje në të cilën mbështetet vendimi gjyqësor.

Të gjitha përpjekjet procedurale duhet të orientohen në atë që gjendja faktike e konstatuar të përputhet me të vërtetën materiale, që ajo të jetë shprehje e saj, sepse vetëm atëherë mund të konsiderohet se gjendja faktike është gjendje e vërtetuar saktë dhe drejtë²⁸⁶.

²⁸³ Po aty fq. 133

²⁸⁴ Po aty fq. 134

²⁸⁵ Prof.Dr. Vesel Latifi, Kriminalistika fq. 59 Prishtinë 2006

²⁸⁶ Dr. Ejup Sahiti, Argumentimi në procedurë penale fq.112 Prishtinë 1999

Ndërsa me nocionin provë-argument në procedurë penale kuptojmë çdo të dhënë e cila në procedurë gjyqësore flet për saktësinë e ndonjë fakti relevant. Me fjalë të tjera prova është burim njohurish për faktet që vërtetohen në procedurë penale të cilat i përdorë organi që i vërteton ato. Termat “argument” dhe “ e dhënë”, janë sinonime e nocionit provë. Procesi i të provuarit, i cili me analizë dhe përdorim të provave në procedurë penale siguron verifikimin apo njohjen e një fakti quhet provim – argumentim.

Mjetet e provës

Provat që flasin për saktësinë e ndonjë fakti juridik relevant në procedurë penale fitohen me ndihmën e mjeteve të provës. Mjeti i provës paraqitet si burim i provës. Ai është instrument nëpërmjet të cilit transmetohet përmbajtja e provës nga burimi i saj deri te gjykata. Si mjete të provës në procedurë penale paraqiten personat p. sh. (i pandehuri, dëshmitari, eksperti të cilët japin deklarime që shërbejnë si provë), sendet p.sh. (shkresa, instrumente dhe objekte të ndryshme) dhe veprime të ndryshme p.sh. (marrja në pyetje, tortura, këqyrja)²⁸⁷.

Mirëpo gjendja faktike duhet të vërtetohet përmes mjeteve të lejuara të provës dhe se çdo burim i të dhënave nuk mund të jetë mjet i provës, meqë një gjë e tillë do të thoshte pranim i maksimës sipas së cilës “qëllimi arsyeton mjetin”, çka në procedurë penale paraqet rrezik potencial për arbitraritet në procedim të provave²⁸⁸.

Dihet se ligjet procedurale bashkëkohore e ndalojnë përdorimin e forcës dhe mjeteve tjera për të shtyrë të pandehurin me forcë që të deklaroj se është i inkriminuar në veprën penale edhe pse nuk përjashtohet mundësia që organi i procedurës në ndonjë rast konkret të devijojë ashtu që të mos i respektojë rregullat procedurale të marrjes së provës në mënyrë ligjore.²⁸⁹

Një gjë e tillë ka ardhur sidomos në shprehje në tipin inkuizitor të procedurës penale ku procesi i të provuarit mbështetej në prova të drejtpërdrejta gjegjësisht në dëshminë e dy dëshmitarëve madhorë e në rast të mospësigurimit të tyre ajo mbështetej në pohimin-pranimin e të pandehurit e cila konsiderohej provë e plotë (probatio plena) apo mbretëreshë e provave (regina probationum) e cila merrej nga i pandehuri pasi që ndaj tij ex lege zbatohet tortura.

²⁸⁷ Dr. Ejup Sahiti, E drejta e procedurës penale fq.135 Prishtinë 2005

²⁸⁸ Po aty fq. 136

²⁸⁹ Po aty fq. 136

Kështu zbatimin e torturës e lejonte gjykata me vendim ku pohimi i dhënë si pasojë e torturës duhej të verifikohej çdo 24 orë në të kundërtën tortura vazhdohej. Tortura si mjet për sigurimin e provës-pohimin e të pandehurit është zbatuar një kohë të gjatë.²⁹⁰

Ligjet procedurale bashkëkohore e ndalojnë përdorimin e forcës, kërcënimit dhe të mjeteve tjera me qëllim që nga i pandehuri të nxirret pohimi, pra provat dhe pohimi i të pandehurit i nxjerr me torturë apo me mjete tjera jonjerëzore apo poshtëruese nuk lejohet të përdoren si prova në asnjë procedurë, përveç rasteve që udhëhiqen kundër kryerësve të torturës.²⁹¹

Ekzistojnë gjithashtu edhe disa forma të marrjes së provave, lejimi i të cilave është diskutabil siç është marrja e deklaramit të të pandehurit me mashtrim, dredhi²⁹² ose duke i zbuluar reagimet intime psikologjike (me narkoanalizë), si dhe me vërtetimin e saktësisë së deklaramit me zbulimin e reagimeve biologjike të personit (me lie detector) të cilat më vonë do të përdreshin si provë në procedure penale.

Nga çka u tha më lartë del se në procedurë penale me qëllim të gjetjes së të vërtetës është e mundur të përdoret si provë çdo burim i njohjes i cili kontribuon për ndriçimin e veprës dhe kryerësit të saj dhe të shërbehet me të gjitha ato mjete të provës të cilat nuk janë në kundërshtim me parimet e procedurës penale, njëherësh duke pasur kujdes të rreptë për ndalesat që i vë ligji në atë drejtim.

Klasifikimi i provave

Meqë në procedurë penale hasim në prova të ndryshme e rrjedhimisht hasim edhe kritere të ndryshme në klasifikimin e tyre. Mbi këtë bazë hasim në klasifikimin në prova akuzuese dhe mbrojtëse, të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, provat origjinale dhe të prejardhura, provat personale dhe materiale, provat e plota dhe jo të plota etj.

Prova akuzuese dhe mbrojtëse - janë ato prova të cilat i shkojnë në favor akuzës, ndërsa mbrojtëse janë ato prova që i shkojnë në favor mbrojtjes-pandehurit. Kjo është e rregulluar edhe me nenin 7 paragrafi 2 të Kodit të Procedurës penale të Kosovës, ku thuhet se gjykata, prokurori publik dhe

²⁹⁰ Dr. Azem Hajdari, Procedura penale – Komentar fq. 17 Prishtinë 2010

²⁹¹ Fond za humanitarno pravo, Pravicno sudjenj-prirucnik fq. 121 Beograd 2000

²⁹² Dr. Ejup Sahiti, E drejta e procedurës penale fq.136 Prishtinë 2005

policia që marrin pjesë në procedurë penale detyrohen që me vëmendje dhe me përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë të vërtetojnë faktet kundër të pandehurit si dhe ato në favor të tij²⁹³.

Ndërsa me nenin 46 po të Kodit të Procedurës penale të Kosovës, në nenin 46 paragrafi 3 thuhet se në rastin e hetimit të veprave penale, prokurori publik detyrohet të analizojë provat dhe faktet fajësuese dhe shfajësuese gjatë hetimit të veprave penale dhe të sigurojë që hetimi të kryhet duke respektuar të drejtat e të pandehurit dhe që mbledhja e provave të mos bëhet në kundërshtim të nenit 153 të këtij Kodi e që nënkupton se provat e marruar me shkelje të dispozitave të procedurës penale janë të papranueshme.²⁹⁴ Kjo nënkupton se prokurori nuk duhet të thirret vetëm në prova akuzuese, por duhet t'i ketë në konsideratë edhe ato prova që i shkojnë në favor të pandehurit.

Provat e drejtpërdrejta dhe të tërthorta – E drejtpërdrejtë konsiderohet ajo provë e cila e provon ekzistimin ose mosekzistimin e faktit kontestues në mënyrë direkte. Provë direkte konsiderohet p.sh. dëshmia e dëshmitarit okular i cili drejtpërsëdrejti e ka shikuar kryerjen e veprës penale, pastaj deklarimi i të pandehurit, mendimi i ekspertit, këqyrja, ndërsa e tërthortë konsiderohet ajo provë e cila kontribuon në vërtetimin e faktit kontestues në mënyrë indirekte, pra me këto prova në mënyrë indirekte vërtetohet ekzistimi apo mosekzistimi i ndonjë fakti në bazë të të cilit konkludohet se ekziston ose nuk ekziston fakti relevant kontestues.²⁹⁵

Provat origjinale dhe të prejardhura – Provë origjinale është ajo provë e cila merret drejtpërdrejtë nga burimi i saj, p. sh. dëshmia e dëshmitarit, pohimi i të pandehurit, shkresat dhe dokumentet origjinale, ndërsa provë e prejardhur konsiderohet ajo provë për të cilën organ i procedurës mëson tërthorazi nga ndonjë burim tjetër e jo nga burimi i saj i drejtpërdrejtë.

Provat personale dhe materiale - Provat personale janë njohuritë e drejtpërdrejta ose të tërthorta të individit ose të shumë personave, ndërsa prova materiale janë sendet, dokumentet.

²⁹³ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës neni 7 paragrafi 2

²⁹⁴ Kodi i procedurës penale të Kosovës neni 46 paragrafi 3

²⁹⁵ Dr. Ejup Sahiti, E drejta e procedurës penale fq.138 Prishtinë 2005

Provat e plota dhe jo të plota - Provë e plotë konsiderohet ajo provë e cila në tërësi e provon të vërtetën ose të pavërtetën e faktit kontestues, kurse prova jo e plotë këtë e bën vetëm pjesërisht.²⁹⁶

Objekti i të provuarit – (Thema probandi)

Me aktgjykim konstatohet nëse është kryer vepra penale, kush e ka kryer atë dhe çfarë sanksioni është shqiptuar, pastaj vendoset për kërkesën pasurore juridike, për shpenzime të procedurës penale e të tjera. Nisur nga kjo objekt të provuarit në procedurë penale është tërë ajo që është e rëndësishme për marrjen e aktgjykimit. Në përcaktimin e objektit të provës gjykata ka rol të posaçëm sepse ajo përcakton se cilat fakte konsiderohen si të rëndësishme në rastin konkret.

Në bazë të kësaj që u tha mund të konkludohet se objekt i provës janë faktet juridike relevante si bie fjala çështja penale, përshkrimi faktik i veprës penale, karakteristikat e kryesit të saj dhe të gjitha faktet dhe rrethanat e rëndësishme për ndriçimin dhe zgjedhjen e ligjshme të saj.²⁹⁷

Është e nevojshme të theksohet se të gjitha faktet të cilat shërbejnë si bazë për vendim gjyqësor, sipas rregullit duhet të provohen para gjykatës në mënyrë të drejtpërdrejtë. Rrjedhimisht konsiderohet se nuk duhet të provohen faktet vijuese

Faktet e qarta - Janë ato fakte të cilat vetvetiu janë të njohura, p.sh. nuk është e nevojshme të provohet se personi i shtyrë në moshë është madhor.

Faktet notore - Janë ato fakte natyrore ose njerëzore ose situata politike nga e kaluara ose nga e tanishmja të cilat u janë të njohura një rrethi të gjerë personash-fakte të njohura botërisht, prandaj si të tilla ato nuk ka nevojë të provohen (manifesta probatione non indigent). p sh. është fakt notor se 1 janari është festë, dita e tërmetit e vërshimet ose dita e përfundimit apo fillimit të luftës.²⁹⁸

Prezumimet – Disa fakte në procedurë penale në bazë të eksperiencës së përgjithshme që më parë supozohen, prezumohen, merren se ekzistojnë pa u vërtetuar në rastin konkret. Faktet e tilla i quajmë prezumime.

²⁹⁶ Po aty, fq. 142

²⁹⁷ Dr. Ejup Sahiti, Argumentimi në procedurë penale fq.166 Prishtinë 1999

²⁹⁸ Po aty, fq. 171

Prezumimi nuk është hipotezë, nuk përmban një etapë në veprimtarinë provuese që e lehtëson atë, por e shkurton veprimtarinë provuese. Zakonisht në teori flitet për prezumime natyrore dhe juridike. Prezumim natyrorë do të ishin prezumimet të cilat që më parë merret se një fakt ekziston dhe se atë nuk duhet provuar, sepse për ekzistimin e atij fakti flet rrjedha natyrore e çështjes, eksperiencia e arritur në një numër të rasteve nga jeta.

Prezumimi më i rëndësishëm në këtë drejtim është prezumimi se kryesi i veprës penale është njëri normal dhe me gjendje shëndetësore mendore të shëndoshë, prandaj ky fakt nuk ka nevojë të vërtetohet. Prezumimi juridik ekziston atëherë kur ligji prezumon (supozon) se ekziston një fakt relevant të cilin nuk ka nevojë me e provuar.²⁹⁹ Prezumimi juridik kupton lirim nga procesi i të provuarit të disa fakteve.

Lirimi mund të jetë i përhershëm (absolute) dhe i përkohshëm (relativ). Lirimi është i përhershëm atëherë kur nuk lejohet provimi i së kundërtës së asaj që prezumohet dhe me këtë rast kemi të bëjmë me prezumim të parrëzueshëm, p.sh. prezumim i tillë është kur pas përfundimit të hetimit i dëmtuari si paditës apo paditësi privat në afat prej 8 ditësh nga dita kur është njoftuar se prokurori është tërhequr nga ndjekja dhe ky brenda këtij afati nuk ngreh aktakuzë apo padi private, konsiderohet se është tërhequr nga ndjekja ose konsiderohet se nuk është i interesuar të ndjekë.

Ndërkaq prezumimi juridik relativ është prezumim i rrëzueshëm, sepse vlen derisa të mos provohet e kundërta, p.sh. te rasti kur paditësi subsidiar apo ai privat i cili është thirrur me rregull nuk ka ardhur në seancë kryesore konsiderohet se është tërhequr nga aktakuza. Në situatë të tillë vlen ky prezumim derisa të provohet e kundërta, që i prezantojnë gjykatës të dhëna me të cilat e arsyetojnë mosardhjen ku mund të kërkojnë kthimin në gjendjen e mëparshme (restitutio in integrum). Krejt në fund duhet thënë se një prej prezumimeve më të rëndësishme është prezumimi i pafajësisë së të pandehurit.³⁰⁰

Faktet të cilat nuk bënë të vërtetohen - Ligji nganjëherë ndalon vërtetimin e disa fakteve të cilat sipas parimeve të përgjithshme do të ishin objekt verifikimi në procedurë konkrete, këtu është fjala për vepër penale nga neni 189 i Kodit Penal të Kosovës, “Zbulimi i rrethanave personale dhe familjare”, që mund ta kryej ai i cili paraqet ose përhap diç nga jeta

²⁹⁹ Dr. Ejup Sahiti, E drejta e procedurës penale fq.145 Prishtinë 2005

³⁰⁰ Dr. Ejup Sahiti, Argumentimi në procedurë penale fq.173 Prishtinë 1999

personale ose familjare e ndonjë personi e që mund ta dëmtojë prestigjin e tij.

Kështu kodi penal e ndalon vërtetimin e saktësisë apo të pasaktësisë së asaj që paraqitet ose përhapet në lidhje me jetën personale ose familjare të një personi,³⁰¹ përveç në rastet shprehimisht me ligj siç e rregullon edhe paragrafi 3 i nenit 189 të KPK-së, ku thotë: Se personi nuk është penalisht përgjegjës nëse veprimi është bërë gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, politike ose ndonjë aktiviteti tjetër politik në mbrojtje të një të drejte ose të një interesi të drejtë.³⁰²

Fiksionet—Me fikSION kuptojmë vënien e një gjendje faktike të konstruktuar artificialisht në vend të gjendjes faktike reale. Me fjalë të tjera fikSIONI juridik është rregull juridike sipas të cilës merret se një fakt është i saktë, apo se ekziston edhe pse dihet se ai fakt nuk është i saktë apo se nuk ekziston.

Fiksionet kanë qenë të njohura në të drejtën romake ku embrioni i njeriut (fetus) konsiderohej fëmijë i lindur po që se asisoj mund të mbrohen interesi e tij. Zbatimin e fikSIONIT e hasim në masë të madhe në të drejtën e Sheriatit. Duhet theksuar edhe pse parimisht lejohet mundësia e përdorimit të fikSIONEVE juridike është mirë kurdo që është e mundshme t’ju iket përdorimit të tyre. Fiksionet sipas rregullit përjashtohen nga e drejta penale dhe procedurale si të kundërta me të vërtetën materiale.³⁰³

Barra e provës- (onus probandi)

Me barrë të provave kuptohet e drejta dhe obligimi i subjektit procedural që t’i paraqesë provat me të cilat vërtetohen faktet relevante në të cilat bazohet vendimi gjyqësorë.³⁰⁴ Në tipin akuzator barra e provave qëndronte ekskluzivisht në paditësin, i pandehuri kishte mundësi të ofroj prova për pafajësinë e vet, por jo edhe obligim, kurse gjykata ishte pasive. Tipi akuzator i procedurës penale e ka bazën që nga koha e Republikës në Romë dhe prej asaj kohe vllente parimi “Actare non probante, Reus absodvitur.

Po që se paditësi nuk provon, “i pandehuri lirohet”, në tipin inkuizitor funksioni i ndjekës kalon në duar të gjykatës edhe prandaj barra e provave i

³⁰¹ Po aty, fq.177

³⁰² Kodi Penal i Kosovës neni 189

³⁰³ Dr. Ejup Sahiti, Argumentimi në procedurë penale fq.178 Prishtinë 1999

³⁰⁴ Azem Hajdari, Procedura penale – Komentar fq. 389 Prishtinë 2010

takonte asaj, në tipin e përzier barra e provave bie në palët proceduralo penale e pikësëpari në paditësin e autorizuar me qëllim që të konstatohet e vërteta materiale.³⁰⁵

Ndonëse në Kodin e procedurës penale të Kosovës nuk është përcaktuar se kush duhet ta ketë barrën e provave. Mirëpo në bazë të disa dispozitave mund të arrihet në përfundim se kujt i takon barra e provës. Rrjedhimisht paditësit të autorizuar i takon detyra që të paraqesë prova për ndriçimin e veprës penale.

Kur është në pyetje i pandehuri, meqë realizimi i së drejtës së tij, kryesisht mund të bëhet përmes paraqitjes së provave të cilat i kundërvihen akuzës, mbi këtë bazë edhe ligjvënësi ia njëh edhe të pandehurit të drejtën e paraqitjes së provave e këtë të drejtë ligjvënësi ia njëh edhe gjykatës posaçërisht të drejtën që të administrojë prova të cilat nuk i kanë propozuar palët ose ato nga të cilat propozuesi ka hequr dorë.

Provat juridikisht të pavlefshme

Prova të papranueshme konsiderohen ato prova të cilat me ligj trajtohen si të tilla dhe të cilat në asnjë rast nuk mund të paraqesin bazën mbi të cilën gjykata do ta vendos çështjen penale konkrete.³⁰⁶ Kodi i Procedurës Penale të Kosovës përmban norma me të cilat përcakton se kur mënyra e caktuar e marrjes së ndonjë prove e bën provën të pavlefshme dhe përcakton pasojat juridike në rast të përdorimit të tyre me rastin e marrjes së vendimit gjyqësorë.

Kësisoj me rastin e marrjes së deklaramit të të pandehurit ose të dëshmitarit, ndalohet që liria e të pyeturit për të formuluar dhe shprehur mendimin e tij, të ndikohet nëpërmjet keqtrajtimit, lodhjes së shkaktuar, ndërhyrjes fizike, përdorimit të drogës, torturës, shtrëngimin ose hipnotizimin e të tjera ose ndalesa që të mos emërohet për ekspertim eksperti i cili është dashur të përjashtohet. Nëse gjykata e ka marrë deklaramin e të pandehurit, dëshmitarit ose ekspertit në formë të tillë, në deklaram të tyre nuk mund të mbështetet vendimi gjyqësor. Pra deklaramet e marra kësisoj nga i pandehuri, dëshmitari apo eksperti juridikisht janë prova të pavlefshme.³⁰⁷

³⁰⁵ Dr. Ejup Sahiti, E drejta e procedurës penale fq.146 Prishtinë 2005

³⁰⁶ Azem Hajdari, Procedura penale – Komentar fq. 390 Prishtinë 2010

³⁰⁷ Dr. Ejup Sahiti, E drejta e procedurës penale fq.147 Prishtinë 2005

Kodi i Procedurës Penale të Kosovës i konsideron si prova të papranueshme: deklarin e të pandehurit kur i është mohuar e drejta për të formuluar dhe shprehur mendimin me anë të lodhjes së tij, keqtrajtimit, ndërhyrjes fizike, përdorimit të drogës, aplikimit të torturës, kanosjes, premtimit për ndonjë përfitim, dobësimin të kujtesës e të tjera.

Pastaj si provë e papranueshme konsiderohen edhe rastet e dëshmitarëve, kur personi nuk mund të pyetet si dëshmitar-dëshmitarët e privilegjuar (rastet kur personi i cili me deklarin e vet do ta shkelte detyrën e ruajtjes së fshehtësisë zyrtare ose ushtarake, mbrojtësi për atë që i pandehuri i ka besuar dhe i bashkëpandehuri derisa zbatohet procedura e përbashkët) personi që nuk është i detyruar të dëshmojë-janë të liruar nga dëshmimi e ai është dëgjuar pa e njoftuar për këtë të drejtë, (rastet e bashkëshortit legjitim dhe atij jashtëmartesor me të pandehurin, personat e gjinisë së gjakut në vijë të drejtë me të pandehurin dhe ata në vijë anësore deri në shkallën e tretë ose të krushqisë deri në shkallë të dytë, prindi adoptues ose fëmija i adaptuar i të pandehurit, personin fetar për çka i pandehuri i është rrëfyer, mbrojtësi, mbrojtësi i viktimës, mjeku, punëtori social, psikologu për faktet që i kanë mësuar me rastin e ushtrimit të veprimtarisë së tyre), kur personi është fëmijë, i cili nuk e kupton të drejtën e tij për të refuzuar dëshmimin, kur dëshmia e dëshmitarit është marrë me forcë, me kanosje ose me ndonjë formë dhe mënyrë të ndaluar me ligj, deklarimi i ekspertit, kur për ekspert është caktuar person i cili nuk mund të caktohet për ekspert, këqyrja ose rikonstrukcioni i vendit të ngjarjes së ushtruar nga ana e prokurorit publik ose policisë e i pandehuri dhe mbrojtësi i tij nuk janë njoftuar për ndërmarrjen e veprimit të tillë, kontrolli i personit, i shtëpisë ose i lokaleve të tjera i zbatuar në kundërshtim me dispozitat e procedurës penale pa urdhër të gjyqtarit të procedurës paraprake ose urdhri i tillë është në kundërshtim me ligjin ose kontrolli është zbatuar në kundërshtim me urdhrin e lëshuar, prova është marrë përmes masës së fshehtë dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit në bazë të urdhrin të paligjshëm e të tjera.

Për derisa po flasim për provat e papranueshme duhet shtuar se Kodi i procedurës penale të Kosovës me nenin 234 paragrafi 2 (pyetjet kapcioze) gjithashtu ndalon që pyetjet të cilat i bëhen të pandehurit të mbështetën në supozimin që i pandehuri ka pranuar diçka që ai nuk ka pranuar³⁰⁸ apo që ka thënë diçka e që në realitet nuk ka thënë.

³⁰⁸ Po aty, fq.148

Pra pyetjet e tilla janë pyetje dhelparake në të cilat fshihet kurthi për të pyeturin. Ato mund të paraqesin rrezik në gjetjen e së vërtetës, prandaj si të tilla janë të ndaluara si metodë e pyetjes në procedure penale.³⁰⁹

Ndonëse Kodi i Procedurës Penale të Kosovës nuk përmban ndalesën e shtruarjes së pyetjeve sugjestive, një gjë e tillë konsiderohet e ndaluar që kur aplikohet tortura dhe format tjera të ndaluara për ta marrë deklarin-pohimin e të pandehurit. Pyetjet e tilla janë të ndaluara ngase e cenojnë lirinë e vendosjes së të pandehurit.³¹⁰

Pra pyetjet sugjestive janë të dëmshme, ngase e largojnë të pandehurin, dëshmitarin nga deklarimi i drejtë nga ajo që do të përgjigjej sikur të shtrohet pyetja drejtë. Pyetjet sugjestive thënë shkurt janë ato të cilat përmbajnë në vete atë se si duhet përgjigjur.³¹¹

Mosrespektimi i formës proceduese të parashikuar për marrjen në pyetje të të pandehurit, dëshmitarit apo ekspertit, ka për pasojë atë që deklarimi i tillë siç thamë edhe më lartë konsiderohet provë e papranueshme. Andaj në përgjithësi provat e marruara në kundërshtim me dispozita ligjore, Kodi i procedurës penale të Kosovës i radhit në dispozitat që flet për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, neni 403, paragrafi 1 nënparagrafi 8.

Mbi këtë bazë duhet bërë përpjekje që gjykata me rastin e marrjes së vendimit të ketë kujdes që këto prova ti veçojë nga shkresat e lëndës. Këtë e përcakton edhe Kodi i procedurës penale të Kosovës, ku e detyron gjykatën që në çdo fazë të procedurës penale të sigurojë që asnjë provë e papranueshme, referencë a dëshmi në provën e tillë të mos përfshihet në shkresa ose të mos paraqitet në shqyrtim gjyqësor a në seancë dëgjimi para shqyrtimit gjyqësorë.

Prova e tillë sipas propozimit të palëve apo sipas detyrës zyrtare veçohet nga shkresat e lëndës dhe e vulosur ruhet në gjykatë ndaras nga shkresat dhe provat tjera.³¹²

³⁰⁹ Dr. Ejup Sahiti, Argumentimi në procedurë penale fq.132 Prishtinë 1999

³¹⁰ Dr. Ejup Sahiti, E drejta e procedurës penale fq.149 Prishtinë 2005

³¹¹ Dr. Ejup Sahiti, Argumentimi në procedurë penale fq.130 Prishtinë 1999

³¹² Dr. Ejup Sahiti, E drejta e procedurës penale fq.150 Prishtinë 2005

Pranimi i provës

Çështja e pranimit të provës është çështje e rëndësishme në procesin e të provuarit. Në të vërtetë, kur në procedurë penale shtrohet për trajtim çështja e pranimit të provës, i tërë interesimi shtrihet në procedurën që duhet zbatuar në drejtim të shpalljes së një prove si të papranueshme.³¹³

Për pranimin e provës vendos gjykata me kërkesë të palës ose sipas detyrës zyrtare e kjo është paraparë në nenin 154 paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës. Në paragrafin e dytë të po të njëjtit nen, thuhet se: "Çështja lidhur me pranimin e provës mund të ngitet nga pala në kohën kur prova i paraqitet gjykatës dhe në rast të veçantë në seancën për konfirmim të aktakuzës.

Përjashtimisht mund të ngritët më vonë, nëse çështjet nuk i janë bërë të njohura palës në kohën kur prova është paraqitur, ose ekzistojnë rrethana tjera të justifikueshme. Në mungesë të kërkesës së palës, gjykata mund të vendosë mbi pranimin e provës sipas detyrës zyrtare kurdoherë që gjatë procedurës lind dyshimi mbi ligjshmërinë e provës. Ndërsa në paragrafin tre të po të njëjtit nen thuhet se: "Aktvendimin që e merr gjykata mbi pranueshmërinë e provës duhet arsyetuar.

Nëse ky aktvendim merret në fazën e procedurës paraprake i njëjti mund të kundërshtohet në afatin prej 48 orësh për të cilën ankesë vendos kolegji i tre gjyqtarëve.³¹⁴

Kur jemi këtu nuk duhet lëshuar rastin pa e përmendur edhe dispozitën e nenit 264 paragrafi 3 të Kodit të procedurës penale të Kosovës ku thuhet se: "Para se aktakuza të merr formë të prerë, gjyqtari i cili zbaton procedurën për konfirmim të aktakuzës, sipas detyrës zyrtare rishikon pranueshmërinë e materialit të mbledhur (Dispozitat e nenit 154 zbatohen përshtatshëmish Pranimi i Provës).

Pas pranimit të materialit të mbledhur së bashku me aktakuzën, gjyqtari u lëshon palëve aktvendim me shkrim lidhur me ligjshmërinë e urdhrin për masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit, ndërsa palët kanë të drejtë ankese brenda 72 orëve për të cilën ankesë vendos kolegji i 3 gjyqtarëve. Pra kjo mundësi është paraparë me Kodin e Procedurës Penale

³¹³ Azem Hajdari, Procedura penale – Komentar fq. 394 Prishtinë 2010

³¹⁴ Kodi i procedurës penale të Kosovës neni 154 paragrafi 1, 2 dhe 3

të Kosovës të rregullohet qysh më parë, para se lënda të shkojë në shqyrtim kryesor në mënyrë që të eliminohen të metat procedurale eventuale lidhur me pranueshmërin e provës.³¹⁵

Rrjedha procedurale e procesit të të provuarit

Rrjedha e procesit të të provuarit rreth vërtetimit të fakteve kalon nëpër fazën e marrjes së provës, shqyrtimit dhe verifikimit të provës dhe të çmuarjes së provës.

Marrja e provës

Me marrje të provës kuptojmë gjetjen dhe zbulimin e provave si dhe fiksimin procedural të tyre. Të zbulosh një provë do të thotë të konstatosh se ekziston dikush i cili di diçka lidhur me faktet e rëndësishme, se a ekziston farë gjurme e veprës penale apo farë objekti i cili do të shërbente si provë në procedurë penale. Provën mund ta paraqesin palët pastaj organet shtetërore, organizatat e biznesit dhe subjekte të tjera juridike.

Fiksimi procedural i provës bëhet pasi që të zbulohet prova, Forma me e përhapur e fiksimit të provës është prova me shkrim siç është p.sh. procesverbali mbi marrjen në pyetje të pandehurit, dëshmitarit, e të tjera, por ato mund edhe të fiksohen edhe duke u incizuar audio vizuelisht ose me stenogram.³¹⁶ Mbi këtë bazë po e përmendim sentencën e njohur latine nga tipi i procedurës inkuizitore ku thuhej: “Quad non est in actis, non est id mundo”- Çka nuk është në shkresa nuk ekziston”, pasi që nga ajo kohë çdo veprim procedural nga marrja në pyetje e të pandehurit, dëshmitarëve e të tjera fiksohej në procesverbal dhe ato përbënin shkresa të lëndës e mbi bazën e tyre jo vetëm që merrej vendimi gjyqësor, por mbi bazën e tyre vendoste edhe kolegji gjyqësorë me rastin e apelimit.³¹⁷

Shqyrtimi dhe verifikimi i provës

Procesi i shqyrtimit të provave detajisht është rregulluar me dispozita të Kodit të procedurës penale të Kosovës, si p.sh. pyetja e të pandehurit, pyetja e dëshmitarit e të tjera. Shqyrtimi i provave është aktiviteti më i rëndësishëm i procedurës provuese nëpërmjet të cilit gjykata mëson për faktet juridike relevante në procedurën penale. Vetëm në kuadër të kësaj

³¹⁵ Kodi i procedurës penale të Kosovës neni 364 paragrafi 3

³¹⁶ Dr. Ejup Sahiti, E drejta e procedurës penale fq.152 Prishtinë 2005

³¹⁷ Po aty, fq. 12

faze të procedurës provuese gjykata e vërteton gjendjen faktike e cila do të jetë bazë për marrjen e aktgjykimit.

Shqyrtimi i provës është proces në të cilin organi procedural duke e hulumtuar dhe analizuar përmbajtjen e secilës provë përcakton raportin e saj ndaj faktit juridik relevant kontestues. Kështu, p.sh. kur kemi të bëjmë me dëshmitarin shqyrtimi i provës kupton sigurimin e dëshmisë nëpërmjet pyetjes së dëshmitarit.³¹⁸ Në procedurë penale provat shqyrtohen dhe analizohen sipas formës së caktuar ku së pari prezantohen provat e propozuara nga paditësi pastaj nga mbrojtësi ose i pandehuri dhe në fund provat të cilat trupi gjykues ka urdhëruar të mblidhen sipas detyrës zyrtare.

Prova e marrë dhe e shqyrtuar duhet të verifikohet ashtu që të eliminohen zbrazësit dhe paqartësitë. Verifikimi i provës bëhet duke analizuar edhe prova të tjera, pastaj duke e krahasuar me prova të tjera. Kështu p.sh. për verifikim të saktësisë së një dëshmie nevojitet zbatimi i rikonstruksionit, në rastin tjetër ballafaqimi ose njohja apo leximi i procesverbalit me të cilin deklarimi verbal i të pyeturit i dhënë në shqyrtim gjyqësor nuk përputhet.

Çmuarja e provave

E tërë veprimtaria e organeve proceduese në mbledhjen dhe verifikimin e provave paraqet anën e jashtme të procesit të të vepruarit, ndërsa veprimtaria mendore-logjike e cila sjell te njohja e fakteve dhe zbulimi i së vërtetës lidhur me veprën penale përbën anën e brendshme të këtij procesi.

Me rastin e çmuarjes së provave gjykata një fakt kontestues e merr si të vërtetë apo të pavërtetë dhe kështu konstaton të vërtetën në procedurë penale. Çmuarja e provave është proces operimi mendor i ndërlikuar për realizimin e të cilit për shkak të njohurisë së ligjshmërive të mendimit logjik, është e nevojshme edhe njohja e psikologjisë gjyqësore e cila merret me studimin e ligjshmërive rreth formimit dhe manifestimit të vetëdijes së pjesëmarrësve procedural.

Çmuarja definitive e provave sipas rregullit bëhet me rastin e procedimit të tyre në shqyrtim gjyqësor apo në seancë për këshillim dhe votim.

³¹⁸ Po aty, fq. 153

Gjatë zhvillimit historik të procedurës penale dhe procesit të të provuarit, njihen dy teori të çmuarjes së provave: teoria legale e vlerësimit të provave dhe teoria e çmuarjes së lirë të provave.

Teoria legale e çmuarjes së provave

Teoria legale e çmuarjes së provave është zbatuar në procedurë inkuizitore e në disa vende ka gjetur zbatim deri në fund të shekullit XIX. Sipas teorisë legale, me rastin e çmuarjes së provave për vërtetimin e saktësisë së fakteve kontestuese të një çështje penale, gjykata ka qenë e detyruar t'ia njoh secilës provë atë vlerë të cilin që më parë ia ka caktuar ligji.

Duke u mbështetur në këtë teori gjykata nuk gjykon sipas bindjes së vet të krijuar me rastin e analizës së provave, por këtë e bënë në bazë të provave vlerën e të cilave e ka caktuar ligjvënësi. I pandehuri mund të gjykohej vetëm në bazë të provave të drejtpërdrejta, kurse në bazë të provave të tërthorta mund të lejohet zbatimi i torturës ndaj të pandehurit, me ndihmën e të cilit fitohej prova e drejtpërdrejt-Pohimi.

Disa prova si p.sh. pohimi i të pandehurit ose dëshmia e dy dëshmitarëve konsideroheshin prova të plota dhe kësaj këtyre provave në krahasim me provat tjera u jepej vlera provues e plotë. Meqenëse në procedurë mjaft shpesh ishte e pa mundur të sigurohej dëshmia e dy dëshmitarëve, gjykata orientohej në marrjen e pohimit të të pandehurit nëpërmjet zbatimit të torturës e cila lejohej edhe me vendim gjyqësorë e mbi bazën e kësaj dolën në dritë teoria legale e çmuarjes së provave.

Teoria legale e çmuarjes së provave i ka pasur dy variante: teoria legale pozitive dhe negative. Sipas teorisë legale pozitive gjykata ishte e detyruar të marrë si të provuar një fakt juridik relevant kur plotësoheshin kushtet e parapara ligjore (nëse ishte siguruar provë e plotë) dhe në bazë të tyre të jepte aktgjykim dënues pavarësisht nga bindja e saj e brendshme.

Teoria legale negative gjithashtu kërkonte që për dënim të të pandehurit të plotësohet numri dhe kualiteti i caktuar i provave, por me rastin e marrjes së vendimit gjykata edhe vet i vlerësonte ato prova sipas bindjes se brendshme dhe kësaj jepte aktgjykimin.³¹⁹ Teoria legale ka edhe një institut të ri gjykata mund të shqiptojë edhe aktgjykimin me të cilin i pandehuri lëshohet nën gjykim, që nënkupton se i pandehuri as nuk shpallet fajtor e as nuk

³¹⁹ Po aty, fq. 155

lirohet nga akuza por lëshohet nën gjykim, që nënkuptonte se i akuzuari edhe më tej mbetej i dyshimtë pasi që ndonëse i liruar në mungesë të provave, pozita e tij ka qenë mjaft e pasigurt pasi që në çdo moment kundër tij mund të rifilloj procedura ndërsa ai nuk ka mundur të mbrohej me arsyetimin se çështja e tij një herë është gjykuar në formë të prerë.

Teoria e çmuarjes së lirë të provave

Teoria e çmuarjes së lirë të provave vjen në shprehje në tipin akuzator të procedurës penale. Kjo teori është në kundërshtim me teorinë legale të çmuarjes së provave. Kjo teori bazohet në parimin e së vërtetës materiale apo teorisë së bindjes së brendshme të gjyqtarit. Gjyqtari është i lirë t'i besojë ose të mos i besojë provës së proceduar, por ai nuk mund të dal jashtë kufijve ligjor që kanë të bëjnë qoftë me mbledhjen e provave qoftë me procedimin e tyre në shqyrtim gjyqësor.³²⁰

Çmuarja e lirë e provave mund të bëhet në dy mënyra. Sipas mënyrës së parë gjykata i çmon provat lirisht, pa qenë e kufizuar në ndonjë formë ligjore, por vetëm në bazë të bindjes që e ka krijuar me rastin e analizës së provës pa pasur obligim që për bindjen e vet të paraqesë llogari.

Një mënyrë e tillë e çmuarjes së provave ekziston te Juria-Porota e tipit anglosakson nga e cila fare nuk krijohet arsyetimi i verdiktit të saj. Mënyra e dytë e çmuarjes së lirisë të provave gjithashtu bazohet në bindjen e brendshme të lirisë së gjykatës, e cila pikësëpari është rezultat i vlerës objektive të provave e cila shndërrohet në rezultat subjektiv-bindje të lirë të gjyqtarit.

Mirëpo bindja e lirë e krijuar në këtë mënyrë duhet të argumentohet përmes arsyetimit të aktgjykimit në mënyrë që çdokush të njoftohet se si ka ardhur gjykata deri te bindja konkrete.

Prandaj bindja e lirë e kuptuar në këtë mënyrë paraqet teorinë progresive të çmuarjes së lirisë të provave.

Në të drejtën tonë të procedurës penale, çmuarja e provave bëhet sipas teorisë progresive të çmuarjes së provave.

³²⁰ Po aty, fq. 156

Gjykata ka për detyrë që me ndërgjegje të vlerësoj çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrë konkluzion se a është provuar një fakt neni 387 par. 2 të Kodit të procedurës penale të Kosovës. Gjykata është e obliguar që në arsyetim të aktgjykimit t'i paraqesë në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye e merr një fakt si të provuar ose si të paprovuar neni 396 par. 7 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Llojet e provave dhe trajtimi i tyre

Në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës nuk ekziston ndonjë dispozitë e posaçme për të treguar në mënyrë të gjeneralizuar të gjitha llojet e provave mbi të cilat gjykata mund të mbështesë vendimin e saj. Kjo nuk do të thotë se mungojnë tërësisht dispozitat ligjore që adresojnë këtë çështje.

Për rrjedhojë, Kodi i Procedurës Penale të Kosovës përmban një numër të konsiderueshëm të neneve të veçanta në të cilat trajtohen disa³²¹ nga provat veç e veç. Dispozitat e tilla adresojnë çështje të deklarimit të të pandehurit, dëshmisë së dëshmitarit, ekspertimit, këqyrjes dhe rikonstruksionit, provave materiale e të tjera.³²²

I pandehuri si mjet provues dhe deklarimi i tij si provë në procedurën penale

Me qëllim të vërtetimit të fakteve juridike relevante në procedurë penale, organet proceduese gjurmajnë burimet e njohjes, duke kërkuar gjurmët reale të ngjarjes që kanë ngelur në botën e jashtme, marrin në pyetje personat që supozohet se u është e njohur diç për ato fakte. Në këtë drejtim të pandehurit si subjekt procedural, të cilin e ngarkon dyshimi se ka kryer veprë penale, për çka është vënë në lëvizje procedura penale, i takon vend i posaçëm.

Deklarimi i tij si provë personale, shërben si provë në procedurë penale. Meqë deklarimi i të pandehurit është provë e rëndësishme edhe pjesëmarrja e të pandehurit në procedurë po ashtu është e rëndësishme së madhe, qoftë për vërtetimin e fakteve që kanë të bëjnë me ekzistimin ose mosekzistimin e veprës penale, qoftë për vërtetimin e atyre fakteve që përcaktojnë cilësitë e

³²¹ Azem Hajdari, Procedura penale – Komentar fq. 403 Prishtinë 2010

³²² Po aty, fq. 404

kryerësit të veprës penale si, bie fjala: përgjegjësia penale. Qëndrimi ndaj veprës penale, gjendja psikike e tij e të tjera.³²³

I pandehuri mund të shërbejë si mjet provues pasiv dhe aktiv. Pasiv në rastet kur ndaj tij me qëllim verifikimi të të dhënave të rëndësishme për gjendjen e tij shëndetësore fizike e shpirtërore apo për sigurimin e provave materiale, bëhet shikimi-kontrolli i tij ose i sendeve të tij apo bëhet fotografimi ose merren vijat papilare të tij e të tjera. Ndërsa ekzistojnë disa prova të cilat organet proceduese mund ti arrijnë vetëm me pjesëmarrjen aktive të pandehurit, sepse ato prova zënë fill dhe manifestohen nëpërmjet veprimit të të pandehurit.

Këtu pikë së pari mendohet në deklarimin e të pandehurit me të cilat a i shpreh njohuritë e veta përkitazi me faktet e rëndësishme. Përveç shprehjes verbale, ekzistojnë edhe mundësi të shumta të shprehjes me gjestikulim, me mimikë, me tërë sjelljen e një personi me rastin e pyetjes së tij. Në të gjitha rastet e sipërpërmendura, organi i procedurës, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të pandehurit, shërbehet me të si burim njohjeje.

Kësisoj, i pandehuri mund të konsiderohet si mjet provues aktiv. Mirëpo pavarësisht faktit se deklarimi i të pandehurit si provë paraqet problem, ngase sikurse edhe më parë e edhe sot i pandehuri sipas rregullit nuk dëshiron të ofrojë prova kundër vetës apo thënë ndryshe ai është bartës i funksionit mbrojtës,³²⁴ prapëseprapë deklarimi i tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet si dhe për rrethanat tjera që i referohen përgjegjësisë së tij janë të rëndësishme për ndriçimin e çështjes penale, ngase ai më së miri e ka të njohur ngjarjen penale, andaj asnjë e drejtë nuk heq dorë nga deklarimi i të pandehurit si provë në procedurë penale e me këtë i nënshtrohet verifikimit dhe vlerësimit sipas bindjes së lirë të gjyqtarit.³²⁵

Dëshmitari si mjet provues dhe deklarimi i tij si provë në procedurën penale

Dëshmia është provë e rëndësishme që ndeshet pothuajse në të gjitha çështjet penale për të cilat zhvillohet procedurë penale. Si e tillë ajo shërben për vërtetimin e rrethanave të kryerjes së veprës penale, për zbulimin e motivit të saj dhe vërtetimin e fajësisë së të pandehurit. Me fjalë të tjera,

³²³ Dr. Ejup Sahiti, Argumentimi në procedurë penale fq.217 Prishtinë 1999

³²⁴ Po aty, fq. 221

³²⁵ Po aty, 224

dëshmia është deklarim i personit fizik lidhur me perceptimet shqisore të tij për faktet e rëndësishme nga e kaluara të dhëna në formë procedurale para organit kompetent.

Në dëshminë e tij, dëshmitari i shpreh perceptimet e veta lidhur me faktet të cilat janë me rëndësi për ndriçimin e çështjes penale, përndryshe dëshmitari nuk duhet t'i shpreh konkludimet e veta e as të shpreh mendimin e vet, por duhet vetëm të dëshmojë atë që me shqisat e veta e ka vërejtur.³²⁶

Rëndësia e dëshmisë së dëshmitarit si provë në procedurë penale, është evidente. Dëshmia shumë shpesh paraqitet si provë e jo rrallë herë ajo paraqitet si provë e vetme për ndriçimin e një çështje penale konkrete. Është fakt se me rastin e marrjes, vlerësimit dhe përdorimit të dëshmisë si prove në procedurë penale, provë e cila sikurse edhe deklarimi i të pandehurit, varet nga ligjshmëritë e psikologjisë së deklaratës, paraqiten vështirësi të konsiderueshme.³²⁷

Këto vështirësi kanë të bëjnë me të metat e dëshmisë që fshihen në atë provë, ku mbi këtë bazë qysh më herët janë bërë përpjekje për klasifikim dhe seleksionim të dëshmitarëve, në mënyrë që të sigurohet që të merren si provë për vendim gjyqësor vetëm dëshmitë e dëshmitarëve pa të meta.

Sa i përket vlerës provuese të dëshmisë si provë në procedurë penale, ekzistojnë tri pikëpamje: E para, thekson se deklaratat e dëshmitarëve janë material provues themelor dhe për to flitet si për të vetmin mbështetës të besueshëm të së vërtetës.³²⁸ E dyta, përfaqëson qëndrimin se dëshmia e dëshmitarit është provë më së paku e besuar. Dhe së fundi pikëpamja e tretë, konsiderohet pikëpamje realiste. Ajo i refuzon dy pikëpamjet e para si pikëpamje ekstreme, duke konsideruar se deklaratat të dëshmitarit nuk duhet veshur vlerë më të madhe provuese në krahasim me provat e tjera, as që bën a priori të hidhet si e papërshtatshme.

Duke i përmendur këto tri pikëpamje padyshim shtrohet pyetja e rolit dhe e rëndësisë reale të dëshmisë në sistemin e provave penale.³²⁹ Është fakt se njeriu si pjesë përbërëse e botës materiale, varet nga determinues material në përgjithësi. Veç kësaj, atë e karakterizon edhe komponent tjetër,

³²⁶ Azem Hajdari, Procedura penale – Komentar fq. 415 Prishtinë 2010

³²⁷ Dr. Ejup Sahiti, Argumentimi në procedurë penale fq.233 Prishtinë 1999

³²⁸ Po aty, fq. 269

³²⁹ Po aty, fq. 270

komponent emocionale dhe shoqërore. Ai qëndron në marrëdhënie reciproke të përhershme me njerëz tjerë.

Më tutje njeriu e përcjellin edhe përjetimet e brendshme të mbështetura në jetën e tij shpirtërore. Prandaj për sqarim të rrethanave të caktuara të çështjes penale, dëshmia e dëshmitarit asgjë nuk ka humbur nga rëndësia e saj, aq më pak kur kemi të bëjmë me rrethanat që i përkasin të ashtuquajturit ambient shoqëror dhe ndodhive shoqërore të rëndësishme për procedurë penale.

Prandaj aktualiteti i dëshmisë, përkundër dobësive që mund të paraqiten në atë drejtim, është evident dhe mund të thuhet se si provë është i pazëvendësueshëm³³⁰ dhe shfrytëzimi i kësaj prove në procedurë penale është i pashmangshëm. Mirëpo gjithnjë nevojitet kujdes me rastin e shfrytëzimit të saj, duke mos ngurruar për përcaktimin e ekspertimit psikiatrik ose psikologjik të personalitetit të dëshmitarit rreth faktit se a është në gjendje të dëshmojë drejtë për atë që e ka perceptuar me shqisat e tij.³³¹

Ekspertimi si mjet provues dhe mendimi i ekspertit si provë në procedurën penale

Detyrë themelore në procedurë penale është vërtetimi i fakteve juridike relevante nëpërmjet të cilave arrihet deri te konstatimi i gjendjes faktike dhe gjetja e së vërtetës materiale.³³² Mirëpo në procedurën e ndriçimit dhe të vërtetimit të fakteve juridike relevante të një çështje penale shpeshherë gjykatës i nevojiten njohuritë nga shkenca natyrore ose teknike, njohuri të cilat gjyqtari si jurist nuk i disponon.

Prandaj për vërtetimin e tyre me vendim të gjykatës mund të angazhohen në procedurë penale personat të cilët në bazë të kualifikimit profesional dhe të shkathhtësisë së fituar në profesion, i vështrojnë faktet, rrethanat ose dukuritë dhe për to japin mendimin e vet. Personat e tillë i ndihmojnë gjykatës në vërtetimin e fakteve kontestuese dhe quhen ekspertë.

Eksperti pra, është person profesional i cili është thirrur nga gjykata që në procedurë penale të jep konstatimin dhe mendimin për faktet kontestuese konkrete. Me ushtrimin e ekspertimit eksperti, në bazë të kualifikimit

³³⁰ Po aty, fq. 271

³³¹ Po aty, fq. 272

³³² Po aty, fq. 273

profesional dhe dijës së vet, i vështron faktet kontestuese dhe për to jep mendimin me çka kryen veprimin procedural të ekspertimit. Ekspertimi përbëhet prej dy pjesësh: prej konstatimit dhe mendimit. Konstatimi ka të bëjë me perceptimin e fakteve në bazë të vëzhgimit të drejtpërdrejtë të tyre, ndërsa mendimi përfshin konkludimet e ekspertit deri të cilat ka ardh në bazë të eksperiencës së vet, por gjithnjë duke i respektuar dispozitat ligjore³³³.

E mbi bazën e kësaj ekspertimi konsiderohet provë në procedurë penale dhe si e tillë i nënshtrohet vlerësimit të gjykatës. Prandaj, gjyqtari është i lirë dhe i pavarur në vlerësimin e mendimit të ekspertit. Mendimi i ekspertit nuk e lidh gjykatën (përveç kur ai përputhet me provat tjera) dhe gjyqtari është i lirë në çmuarjen e saktësisë së tij. Ai ka të drejtë të dyshojë në³³⁴ saktësinë e ekspertizës, ku mbi këtë bazë mund të kërkojë përsëritjen e ekspertimit ose edhe superekspertizë.

Sidoqoftë, gjykata e çmon mendimin e ekspertit në mënyrë analitike dhe në lidhje me provat e tjera e pastaj e nxjerr konkludimin e vet mbi vlerën dhe kontributin e saj në ndriçimin dhe zgjidhjen e çështjes penale, me ç'rast përcaktohet vlera provuese përfundimtare e ekspertimit për çështjen penale konkrete.

Këqyrja dhe rikonstruksioni

Këqyrja si burim i provës ndërmerret kur për vërtetimin ose sqarimin e ndonjë fakti të rëndësishëm në procedurë nevojitet vrojtimi i drejtpërdrejtë, në mënyrë që të vërtetohen saktë dhe sa më objektivisht rrethanat materiale të cilat kanë të bëjnë me veprën penale.

Sipas mundësive, këqyrjen duhet bërë pa zhegitje në mënyrë që të zbulohen dhe të fiksohen provat dhe kështu ato të sigurohen nga shkatërrimi. Këqyrjen ose rikonstruksionin e vendit të ngjarjes mund ta urdhërojë dhe kryej prokurori publik apo policia ose gjykata (gjyqtari i procedurës paraprake dhe kryetari i trupit gjykues) për të shqyrtuar provat e mbledhura ose për të qartësuar faktet e rëndësishme për procedurë penale.

Për t'u konsideruar valid këqyrja dhe rikonstruksioni i vendit të ngjarjes i kryer nga policia apo prokurori publik, duhet që i pandehuri ose mbrojtësi i

³³³ Dr. Ejup Sahiti, E drejta e procedurës penale fq.172 Prishtinë 2005

³³⁴ Po aty, fq. 177

tij të njoftohen për ushtrimin e veprimit të tillë. Ata kanë të drejtë të marrin pjesë në kryerjen e veprimeve të tilla, mirëpo mospjesëmarrja e tyre pas njoftimit të bërë, nuk e pengon zbatimin e këqyrjes ose të rikonstruksionit të vendit të ngjarjes.

Me rastin e zbatimit të këqyrjes ose të rikonstruksionit mund të thirret edhe eksperti nëse mendohet se prezenca e tij është e domosdoshme për dhënien e konstatimit dhe mendimit. Me rastin e ndërmarrjes së këqyrjes së vendit ku është kryer vepra penale hartohet procesverbali ku shënohen të dhënat me rëndësi për këqyrjen dhe për vërtetimin e identitetit të sendeve (përshkrimi, përmasat dhe madhësia e objekteve ose e gjurmëve), bëhen skica, vizatime, plane, fotografi, incizime filmike e teknike, të cilat i bashkëngjiten procesverbalit³³⁵.

Këqyrjen e vendit të ngjarjes duhet dalluar nga rikonstruksioni i vendit të ngjarjes. Derisa këqyrja bëhet menjëherë pas kryerjes së veprës penale me qëllim të zbulimit dhe të konservimit të gjurmëve të veprës penale, rikonstruksioni i ngjarjes bëhet një kohë të konsiderueshme pas kryerjes së veprës penale, zakonisht kur çështja penale ka arritur në shqyrtim kryesor e zakonisht me qëllim të eliminimit të kundërthënieve ndërmjet provave të paraqitura.

Provat materiale

Gjatë zhvillimit historik të procedurës penale një kohë të gjatë ka pasur përpjekje, që e vërteta të arrihet nëpërmjet dëshmitarëve dhe pohimit të të pandehurit. Mirëpo me kalimin e kohës dhe kërkimit të së vërtetës në procedurë penale, theks i veçantë i kushtohet provave materiale.³³⁶

Provë materiale konsiderohet çdo objekt i cili është i rëndësishëm për ndriçimin e fakteve të rëndësishme me rastin e zgjidhjes së një çështjeje penale. Këto prova për nga numri janë të shumta dhe të llojllojshme. Ato mund të grupohen në: Veglat dhe mjetet për kryerjen e veprës penale (p.sh. arma, mjetet për falsifikim e të tjera), Sendet e prodhuara të veprës penale (p.sh. paraja ose shkresa e falsifikuar e të tjera), Sendet e fituara me vepër penale të cilat mund të jenë objekt i veprës penale (sendet e vjedhura), ose sendet e fituara si shpërblim për veprën e kryer penale (sendet ose vlerat e

³³⁵ Po aty, fq. 178

³³⁶ Po aty, fq.179

marra si ryshfet), Sendet në të cilat gjenden gjurmët e veprës penale apo gjurmët e luftës së kryerësit me viktimën e të tjera.³³⁷

Pra provat materiale janë të shumta dhe të llojllojshme andaj për të mos thënë se është e pamundur, themi se është vështirë që të numërohen një e nga një.

Prandaj sendet e ndryshme që kanë lidhje me veprën penale dhe kryerësin e saj janë indicie të cilat janë në gjendje që gradualisht të çojnë te vend i ngjarjes, te kryerësi, nga i dyshuari te i pandehuri, nga probaliteti te vërtetësia.³³⁸

Të provuarit me ndihmën e provave materiale, kur kemi të bëjmë me objekte, sipas nevojës mund edhe të kombinohen edhe me prova tjera, p.sh. me dëshminë e dëshmitarit dhe nëpërmjet procesit të njohjes. Në të vërtetë, nëse është e nevojshme të vërtetohet se a e njëj dëshmitari sendin e paraqitur si provë, së pari kërkohet nga ai ta përshkruajë atë dhe t'i paraqesë shenjat dhe karakteristikat dalluese të tij, pastaj sipas mundësisë së bashku me sendet e tjera i tregohet sendi për njohje.³³⁹

Objektet-sendet fizike që kanë ndonjë lidhje me çështjen penale, lidhje e cila mund të argumentohet me provat që procedohen në procedurë penale, mund të shërbejnë si burim njoftimi për vërtetimin e fakteve në procedurë penale. Ato e shprehin këtë veti provuese atëherë kur me rastin e prezantimit të tyre në procedurë³⁴⁰ organi i procedurës bën këqyrjen e tyre.

Objektet fizike që kanë lidhje me çështjen penale manifestojnë veti provuese edhe kur këqyrja e tyre bëhet nëpërmjet procesit të ekspertimit. Objektet fizike mund të jenë edhe bartës të provave atëherë kur prova është fiksuar në to, si bie fjala dokumentet në të cilat janë bërë shënime me shkrim, vizatime ose skica që përmbajnë fakte që vërtetohen në procedurë penale ose incizimet e fituara me regjistrime teknike të fakteve të bëra me ndihmën e instrumenteve vizuale, auditive ose të kombinuara vizuelo - auditive. Vetë dokumenti p.sh. letra që përmban tekstin e inkriminuar, deklaratën e shënuar e të tjera, si dhe regjistrimet teknike letra e fotografisë, shiriti, filmi e të tjera konsiderohen mjete të provës, ndërsa përmbajtja e

³³⁷ Dr. Ejup Sahiti, Argumentimi në procedurë penale fq. 296 Prishtinë 1999

³³⁸ Dr. Ejup Sahiti, E drejta e procedurës penale fq.180 Prishtinë 2005

³³⁹ Dr. Ejup Sahiti, Argumentimi në procedurë penale fq. 297 Prishtinë 1999

³⁴⁰ Dr. Ejup Sahiti, E drejta e procedurës penale fq.180 Prishtinë 2005

shkresës apo përmbajtja e incizimit është provë që shërben për vërtetimin fakteve në procedurë penale.

Dokumentet – Nocioni dokument si provë në procedurë penale kuptohen shënimet me shkrim që përmbajnë fakte që vërtetohen në procedurë penale si dhe deklarata dhe komunikata me shkrim në të cilat figurojnë faktet e tilla si dhe vizatimet dhe skicat nga të cilat faktet e tilla mund të vërtetohen. Në kuadër të dokumenteve bëjnë pjesë shënimet e shënuara në shkresat të ndryshme si p.sh. certifikata, vendime e shkresa të tjera të organeve shtetërore, certifikata, dëftesa dhe shkrime të tjera të instucioneve që kryejnë autorizime publike, libra afariste, vërtetime, shkresa, raporte, letra e komunikime tjera të qytetarëve e të tjera.

Të gjitha dokumentet që hartohen, bëhen me qëllim që dikush më vonë të mund t'i përdorë të dhënat për faktet që figurojnë në të, pavarësisht se ai dokument a është publik apo privat. E dokumentet e ndryshme nëse paraqitet si fakt në procedurë penale i njëjti mund të paraqitet si provë për të cilin gjykata sikurse edhe të provat tjera vendos mbi pranueshmërinë e tij si provë, ku fillimisht organi i procedurës duhet të vërtetojë se a ka ai dokument cilësi të provës, kush është autori i saj, si i di autori faktet e shënuara në dokument, ku veç autorit a ka marrë pjesë edhe dikush tjetër në hartimin e dokumentit dhe kur është hartuar dokumenti. Dokumenti zyrtar zakonisht i ka këto të dhëna, por pavarësisht kësaj, siç thamë më lartë vlerën provuese të dokumenteve e çmon gjykata sikurse të çdo prove tjetër.

Forma procedurale e përdorimit të dokumentit si provë është leximi i dokumentit i cili më pas i bashkëngjitet shkresave të lëndës.³⁴¹ Në kuadër të provave materiale duhet kujtuar edhe regjistrimet teknike të cilat realizohen përmes incizimeve audio, vizuale ose të kombinuara audio-vizuale përmes fotografisë, filmimit, incizimit magnetofonik, magnetoskopik, videofonik e të tjera. Regjistrimi ia mundëson hartuesit ose cilitdo që disponon me të që në ndonjë moment të mëvonshëm me riprodhimin e tij hollësisht të konstatojë, se si ka ndodhur ngjarja e regjistruar apo se si është dukur një fenomen në momentin e regjistrimit.

Me këtë rast nuk ka dilema rreth regjistrimeve teknike të bëra në procedurë penale, ato paraqesin dilemë kur kryhen nga personat jashtë procedurës penale.³⁴² Mirëpo duke pasur parasysh se incizimet janë lloj i objekteve-

³⁴¹ Po aty, fq. 182

³⁴² Po aty, fq. 183

sendeve fizike që mund të shërbejnë si provë në procedurë penale, mbi këtë bazë çdo objekt që mund të shërbejë si provë duhet të merret nga ai që e disponon atë për t'u përdorur si provë. Nga kjo del se, regjistrimet teknike jo vetëm që mund por, parimisht patjetër duhet të përdoren për vërtetimin e fakteve në procedurë penale. Mirëpo para se regjistrimi teknik i bërë nga personat e tjerë jashtë procedurës penale të përdoret në cilësi të provës, duhet të verifikohet se a janë plotësuar kushtet që e bëjnë të mundshëm përdorimin e një prove. Kësisoj, duhet të vërtetohet se kush e ka bërë regjistrimin, a mos është ndryshuar-falsifikuar incizimi, e të tjera.

Në fund çmuarjen e asaj se çka përmbajnë regjistrimet teknike audio, vizuale ose të kombinuara e bën gjykata sipas teorisë së vlerësimit të lirë të provave, duke i pasur parasysh edhe provat e tjera konkrete.³⁴³ Kur themi duke i pasur parasysh edhe provat tjera konkrete, duhet pasur parasysh se, rritja e përdorimit të provave materiale në procedurë penale e ulë rolin e dëshmisë së dëshmitarit.

Kombinimi i dëshirueshëm i materialit provues në një çështje penale do të arrihej kur provat materiale sqarohen dhe vërtetohen me dëshmi të dëshmitarëve, ndërsa dëshmia e dëshmitarit vërtetohet dhe përkrahet me prova materiale. Prandaj vlera e çdo prove materiale në çdo çështje penale duhet të çmohet së bashku me provat e tjera sipas teorisë së vlerësimit të lirë të provave.³⁴⁴

³⁴³ Po aty, fq. 184

³⁴⁴ Po aty, fq. 185



Latif Xhemali



Sabit Rama

E DREJTA E AUTORIT

Qëllimi

Qëllimi i këtij shkrimi është ofrimi i një kontributi modest në shpjegimin e Veprës së Autorit si krijim i intelektit të personit fizik e në raste të caktuara edhe atij juridik, të Drejtën e lindur në bazë të këtij krijimi (E Drejta e Autorit), mbrojtjen e kësaj të drejte, me theks të veçantë në mbrojtjen e të drejtës autoriale në veprat audio vizuale, në mënyrë që opinionit e veçanërisht komunitetit të mediave tu vihen në dispozicion të dhëna sado qofshin ato modeste lidhur me këtë institut juridik.

AUTORI - është personi fizik i cili e ka krijuar veprën.

AUTOR - konsiderohet personi emri i të cilit, pseudonimi apo shenja e tij është theksuar në ekzemplarët e akteve ose veprave ose është shënuar apo theksuar në shfaqjen e veprës, derisa nuk provohet ndryshe. Përbashimisht, personi fizik ose juridik emërtimi i të cilit ose emri theksohet në mënyrë të zakonshme në veprën filmike konsiderohet prodhues i asaj vepre, derisa nuk provohet ndryshe.

Përveç autorit, bartës i të drejtës së autorit mund të jetë edhe personi që nuk është autor, por që në përputhje me ligjin në fuqi, ka fituar të drejtën e autorit.

VEPRA E AUTORIT - është krijim origjinal i intelektit të autorit, e shprehur në një formë të caktuar, pavarësisht nga: vlera artistike, shkencore apo të tjera, destinimi i saj, madhësia, përmbajtja dhe mënyra e shprehjes, si dhe lejueshmëria e deklarimit publik.

TË DREJTAT E AUTORIT - përfshijnë të drejtat e bazuara në pronën intelektuale, të cilat u përkasin autorëve lidhur me punën e tyre në fushën letrare, shkencore dhe artistike.

E DREJTA E AUTORIT - është e drejtë e posaçme, e cila i takon autorit si subjekt i pronës intelektuale mbi veprën e vet.

Zhvillimi historik i të drejtës së autorit

Lindja e të drejtës së autorit është e lidhur ngushtë me lindjen e teknologjisë së shtypit si metodë e re e të shkruarit dhe kopjuarit, që për herë të parë u shfaq në Angli. Para se të fillonte të përdorej shtypi, për të kopjuar shkrimin përkatësisht punën e dikujt tjetër është dashur që të investohet shumë kohë dhe mund, kështu që nuk kishte arsye për ndonjë shqetësim të madh për kopjimet ilegale, apo si filloi të quhej më vonë, piraterinë, ngase kopjimet dhe shumëzimet e pa autorizuara ishin përjashtim i rrallë.

Teknologjia e shtypit, bëri një kthesë pozitive në sferën e të shkruarit duke krijuar lehtësi të mëdha, shkurtim të kohës e mundit dhe zvogëlim të shpenzimeve për të shkruar një libër apo një produkt tjetër. Mundësitë e mëdha të teknologjisë së shtypit, filluan ti keqpërdorin kopjuesit dhe tregtarët ilegal të veprave të ndryshme, të cilët filluan të përdorin metoda të reja më të avancuara të piraterisë, për të kopjuar e shumëzuar më lehtë, më shpejt dhe me çmim më të lirë, një libër apo një produkt tjetër, duke cenuar kështu të drejtat morale dhe ekonomike të autorit.

Me qëllim të parandalimit të piratërisë, shkruarit e librave, tipografët, libërlidhësit dhe shitësit e librave në Angli u organizuan me një shoqatë që njihet si “Shoqata e Librave”.

Shoqata e Librave siguroi për veti monopolin për veprimtarin e botimeve, kurse shkrimtarët paguheshin vetëm për punën e tyre dhe nuk gëzonin asnjë të drejtë për krijimet e tyre. Ky monopol i “Shoqatës së librave” vazhdoi deri në vitin 1709, kur Anglia aprovoj një akt ligjor, që njihet si Ligji i pare për të Drejtën e Autorit, sipas të cilit të drejtat ekskluzive për punën e tyre u takojnë autorëve e jo botuesve.

Edhe pse ky ligj ka shërbyer si model për të formësuar ligjet për të drejtat e autorit të shumë vendeve tjera, duke e vendosur autorin në qendër të mbrojtjes, sot ligjet për të drejtën e autorit hartohen për ti shërbyer edhe interesit të përgjithshëm publik.

KAPITULLI I

1. Çka është e drejta e autorit

E drejta e autorit, është termi i cili përfshin një grup të të drejtave të cilat iu njihen krijuesve për punën e tyre në krijimin e një vepre letrare, shkencore ose artistike. E drejta e autorit i takon autorit me vetë faktin e krijimit të veprës. Për të gëzuar mbrojtjen e së drejtës së autorit nuk kërkohet plotësim paraprak i çfarëdo formaliteti administrativ.

Autori gëzon të drejtat morale dhe ekonomike në lidhje me punën e tij nga casti i krijimit të veprës që përfshijnë:

- a. autorizimet ekskluzive personale për të mbrojtur pacenueshmërinë e veprës së autorit dhe personalitetin e autorit (në vijim: të drejtat morale të autorit),
- b. autorizimet ekskluzive ekonomike për të mbrojtur interesat ekonomike të autorit (në vijim: të drejtat ekonomike të autorit),
- c. autorizimet tjera të autorit (në vijim: të drejtat tjera të autorit).

Ky konglomerat i të drejtave ka qëllim për ta mbrojtur krijimtarinë e autorit nga përvetësimet, shfrytëzimet dhe abuzimet e ndryshme që mund ti kërcënohen veprës së autorit, në rend të parë për ruajtjen e origjinalitetit të krijimit pa përjashtuar edhe mbrojtjen e interesit ekonomik të autorit, që mund të shërbej si stimulim i kreativitetit të përgjithshëm, e me këtë edhe në vet zhvillimin e shoqërisë.

Thënë thjeshtë, e drejta e autorit shërben për ti baraspeshuar interesat e pronarëve të drejtës e autorit me interesat e përgjithshme me qëllim të avancimit në përparimin e shoqërisë.

2. Objekti i mbrojtjes i të drejtave të autorit

E drejta e autorit dhe lista e veprave përafërta të mbrojtura me të drejtën e autorit mund të ndryshojë nga shteti në shtet varësisht nga kriteriumet që merren për bazë me rastin e përcaktimit të këtyre të drejtave. Për shembull Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk ofrojnë mbrojtje për veprat që nuk janë fiksuar në formë të prekshme (fizike).

Kryesisht, përmbledhja e veprave që mbrohen nga e Drejta e Autorit bëhet në bazë të kategorive përkatësisht zhanreve të caktuara p.sh. letrare,

muzikore,dramatike, kinematografike, kurse ligjet shtetërore përcaktojnë edhe ndarjen më specifike.

Ligji i Republikës së Kosovës Nr. 2004/45, për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Përafërta në nenin 1 të tij përcakton veprat për të cilat do t'iu ofrohet mbrojtje nga e Drejta e Autorit, duke i kategorizuar në:

- Të drejtat e autorit që, në bazë të pronës intelektuale, u takojnë autorëve përkitazi me
- veprat e tyre në lëmin e letërsisë, shkencës dhe artit (në vijim: e drejta e autorit);
- Të drejtat që, në bazë të pronës intelektuale, janë të afërta me të drejtën e autorit (në vijim: të drejtat e afërta) dhe u takojnë:
 - a. interpretuesve përkitazi me interpretimet e tyre,
 - b. prodhuesve të fonogrameve përkitazi me fonogramet e tyre,
 - c. producentëve të filmit përkitazi me videogramet e tyre,
 - d. organizatave të radios e të televizionit (Transmetuesve) përkitazi me emisionet e tyre,
 - e. prodhuesve të bazave të të dhënave përkitazi me bazat e tyre të të dhënave,
 - f. botuesve përkitazi me botimet e tyre.

I njëjti ligj nga neni 8. deri në nenin 11, në mënyrë taksative numëron verat autoriale të cilave do tu sigurohet mbrojtje juridike, kurse në nenin 12. përcakton krijimet pa mbrojtje juridike siç janë: idetë, parimet, udhëzimet, procedurat, zbulimet ose konceptet matematikore si të tilla, pastaj ligjet zyrtare, aktet nënligjore dhe rregullativat e tjera, materialet zyrtare dhe botimet e organeve parlamentare, qeveritare e të organizatave tjera që kryejnë funksione publike, si dhe parashtrirat e aktet e tjera në procedurat administrative ose gjyqësore dhe lajmet e ditës me informacionet e ndryshme që kanë karakter të raportimeve të rëndomta të shtypit, radios e televizionit.

Megjithatë, kjo liste nuk duhet të merret si përfundimtare sepse veprat që janë përcaktuar në këtë ligj përbëjnë vetëm kategoritë themelore të veprave me të drejtë autoriale, me ç'rast mund të kërkohet mbrojtje e së drejtës së autorit edhe për veprat që nuk përfshihet në të, por i takojnë njëres prej kategorive të lartë përmendura.

Ligji i Kosovës për të Drejtën e Autorit ofron mbrojtje edhe për veprat e papublikuara, veprat e prejardhura, dhe koleksionet e veprave.

Veprat e papublikuara - do të gëzojnë mbrojtje nga e drejta e autorit në mënyrën e njëjtë sikurse të ishte e botuar.

Veprat e prejardhura - nëse merret një vepër e krijuar nga dikush tjetër e që tash më ekziston dhe përkthehet nga gjuha origjinale në gjuhën tuaj amtare, përkthimi konsiderohet si vepër e prejardhur dhe gëzon mbrojtje të së drejtës së autorit, kuptohet që përkthimi i veprës duhet të bëhet me autorizimin e autorit ndryshe konsiderohet si shkelje e të drejtës së autorit.

Vepra e prejardhur mund të jete edhe përshtatja, aranzhmani muzikor dhe përpunime tjera të një vepre ekzistuese ose material tjetër.

Parimet e zbatimit dhe mbrojtjes së të Drejtës Autoriale, lidhur me masat administrative, inspektimi, mbrojtja juridiko-civile dhe penale, të përcaktuara me, këtë ligj, zbatohen në përputhje me rregullat e përgjithshme të procedurës administrative, kundërvajtëse, civile dhe penale.

3. Kushtet për mbrojtjen e të drejtës së autorit

Duke marrë parasysh shembujt e lartpërmendur, autori gëzon mbrojtje juridike për të drejtat morale dhe ekonomike në lidhje me punën e tij nga çasti i krijimit të veprës. Nuk kërkohet regjistrimi apo plotësimi i kritereve të ndryshme për të siguruar të drejtën e autorit. P.sh. në bazë të ligjit të SHBA-ve vepra konsiderohet (e krijuar) prej momentit të fiksimit të saj në formë të prekshme të shprehjes.

Në anën tjetër në baze të Ligjit të Kosovës vepra mbrohet prej momentit të krijimit dhe nuk ka nevojë të fiksohet në formë të prekshme të shprehjes. Neni 8 i Ligjit të Kosovës për të drejtën e Autorit thotë se veprat e mbrojtura nga e drejta e autorit janë vepra që shprehen në çdo mënyrë, thënë thjeshtë fiksimi nuk është kusht për gëzimin e mbrojtjes së të drejtës së autorit në bazë të Ligjit të Kosovës si është rasti në disa legjislacione tjera.

Për të gëzuar mbrojtjen të drejtës së autorit, secila prej veprave të lartpërmendura duhet të jetë origjinale. Por niveli i origjinalitetit që kërkohet dallon nga shteti në shtet, nga se disa shtete kërkojnë standard më të lartë të origjinalitetit, disa shtete tjera kërkojnë standard shumë më të ultë.

Në rastin gjyqësor *Ladbroke Kundër William Hill* (1964), gjykata ka shprehur se fjala origjinalitet nuk kërkon mendim origjinal ose shpikës, vetëm se vepra nuk është e kopjuar dhe vjen nga autori.

Konventa e Bernës dhe Marrëveshja TRIPS, len të lira shtetet që sipas vlerësimeve të veta të kanë të drejtë të trajtojnë çështjet e standardit për mbrojtjen e të drejtës së autorit. Mbi këtë bazë Ligji i Kosovës për të drejtën e autorit e përmend kërkesën e origjinalitetit në nenin 8, i cili përcakton veprat që mbrohen me të drejtën e autorit dhe kushtet për atë mbrojtje duke thënë se Vepra të autorit janë krijimet intelektuale origjinale ne lëmin e letërsisë, shkencës dhe artit.

Me termin origjinalitet lidhur me të drejtën e autorit, mund të kuptohen dy origjinalitete: ajo që është e lidhur me personalitetin e autorit-origjinaliteti i autorit dhe ajo që është e lidhur me rezultatet e krijimtarisë së autorit-origjinaliteti i veprës.³⁴⁵

Në legjislaturat kontinentale/evropiane, nuk është bërë harmonizimi i kërkesës për origjinalitetin. Përderisa Gjermania njihet për kritere të larta të kërkesës për origjinalitet, Anglia është njohur për kriter mjaft të ulta.

Një harmonizim më i avancuar është bërë vetëm për bazat e të dhënave, përmes Direktivave Evropiane për bazat e të dhënave, si dhe për fotografit përmes Direktivave tjera te Përafërta.

Pasi që Kosovës i mungojnë rastet nga praktika gjyqësore është vështir të thuhet se çfarë niveli të origjinalitetit kërkohet, por gjatë vlershmit të kërkesës për origjinalitet gjykata duhet të marr parasysh gjithmonë nivelin e kreativitetit të përdorur gjatë krijimit të veprës në fjalë. Idetë, udhëzimet, procedurat ose konceptet matematikore nuk mund të gëzojnë mbrojtje të së drejtës së autorit për shkak të mungesës së origjinalitetit. Ajo çka mbrohet me të drejtën e autorit është mënyra e shprehjes se këtyre ideve dhe fakteve. Gjykata duhet të kërkojnë nivele të caktuara të kreativitetit dhe origjinalitetit të përdorur gjatë shprehjes së këtyre fakteve ose ideve. Kjo mund të sqarohet më së miri përmes këtij shembulli.

Askush nuk mund të kërkojë të drejtën e autorit nëse thotë se “Barack Obama” është kryetari i 44 i SHBA-ve. Është fakt dhe secili e di këtë gjë.

³⁴⁵ Prof.Dr.Abdullah Aliu, E drejta e Autorit, Prishtinë 2004 faqe 13.

Por nëse ndonjëri fillon të shkruaj ndonjë tregim për kryetarin Obama, atëherë ky tregim mbrohet me të drejtën e autorit sepse ai ka mbledhur të gjitha faktet, ka përdorur nivel të caktuar të kreativitetit personal në analizimin e këtyre fakteve dhe ka dalë me tregimin e vet të pavarur për kryetarin Obama.

4. Kohëzgjatja e mbrojtjes së të drejtës së autorit

Konventa e Bernës për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike dhe Konventa ndërkombëtare për mbrojtjen e interpretuesve, prodhuesve të Fonogrameve dhe subjekteve transmetuese, e njohur si Konventa e Romës, përcakton kohëzgjatjen minimale të mbrojtjes së të drejtave të cilat përcaktohen në to, duke u lënë Shteteve Kontraktuese lirinë e përcaktimit të kohëzgjatjes më të gjatë. Në bazë të konventës së Bernës kohëzgjatja minimale është jeta e autorit + 50 vite pas vdekjes se tij.³⁴⁶

Ekzistojnë dallime të shumta ndërmjet legjislacionit kombëtar që rregullojnë kohëzgjatjen e mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta, dallime që nuk paraqiten vetëm ndërmjet kontinenteve, por edhe brenda vet Bashkimit Evropian. Gjithashtu ekzistojnë dallime edhe në mënyrën e llogaritjes së këtyre kohëzgjatjeve, kështu që me qëllim të lehtësimit të funksionit të tregut të brendshëm, Komisioni Evropian ka bërë hapa të caktuar për harmonizimin e legjislacioneve Kombëtare. Në këtë drejtim, Direktiva 2006/116/EC për kohëzgjatjen e mbrojtjes të drejtës së autorit dhe të drejtat tjera të përafërta e ka harmonizuar kohëzgjatjen e mbrojtjes së të drejtës së autorit në 70 vite pas vdekjes së autorit ose 70 vite pasi që vepra vihet në dispozicion të publikut në mënyrë të ligjshme.

Ligji për mbrojtjen e të drejtës së autorit në Kosove, rregullon kohëzgjatjen e mbrojtjes dhe mënyrën e llogaritjes së kësaj kohëzgjatje në pajtim me direktivën e lartpërmendur, ashtu që e drejta e autorit zgjat tërë jetën dhe 70 vite pas vdekjes së tij (neni 62.1).

E drejta e autorit për vepra anonime dhe veprat e botuara me pseudonim zgjat 70 vite, dhe fillon nga momenti i hapjes së ligjshme të veprës (neni 62.2). Nëse autori e hap identitetin e tij gjatë kësaj periudhe, kohëzgjatja e mbrojtjes vlen për jetën e tij plus 70 vite pas vdekjes së tij.

³⁴⁶ Konventa e Bernës për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike 09.09.1886 neni 7.1.

E drejta e autorit ne veprën me bashkautorësi zgjat 70 vite gjatë jetës se secilit autori dhe 70 vite nga vdekja e bashkautorit që ka jetuar i fundit.

Ne rastet e veprave kolektive, e Drejta e Autorit zgjat 70 vite pas hapjes së ligjshme te veprës. Kur kohëzgjatja nuk fillon nga vdekja e autorit dhe vepra nuk është e hapur ligjërisht, e drejta e autorit zgjat 70 vite nga krijimi i tij.

Kur kohëzgjatja e mbrojtjes llogaritet nga dita e hapjes së ligjshme të veprës dhe vepra hapet në vëllime, pjesë-pjesë, vazhdimi, kohëzgjatja e mbrojtjes llogaritet ndaras për secilin nga këto elemente.

KAPITULLI II

1. Instrumentet kryesore ndërkombëtare dhe të BE-së për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta

Ligjet për të drejtën e autorit kanë natyrë territoriale që do të thotë se ato mund të dallojnë nga njëra tjetra varësisht prej shtetit. Disa shtete kanë kriteret më të larta të mbrojtjes së të drejtave të autorit për disa vepra, kurse disa shtete tjera mund të preferojnë kriteret më të ulta.

Për ti standardizuar këto dallime në shtetet e ndryshme, ndër vite janë miratuar instrumente të ndryshme ndërkombëtare. Në nivel të Evropës, ky harmonizim bëhet nëpërmjet direktivave të Komisionit Evropian.

Dokumentet/aktet më të rëndësishme ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtën e autorit janë:

1.1 Konventa e Bernës për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike (1886)

Konventa e Bernës është ndikuar shumë nga Ligji i Francës i cili autorin e veprës kreative e vë në qendër të mbrojtjes, në vend të rolit ekonomik të drejtës së autorit, i cili pasqyrohet me ligjin Amerikan. Në bazë të ligjit të Francës, autori i ka të drejtat natyrore në krijimin e tij sepse ai ka dhënë kontribut intelektual në atë vepër dhe për këtë arsye nuk ka nevojë për ligj që ti njihet kjo e drejtë.

Si rrjedhojë Konventa e Bernës ka hequr çdo formalitet për të drejtën e autorit për të gjitha shtetet që kanë aderuar në të. Me fjalë tjera, në bazë të

konventës së Bernës nuk ka nevojë të bëhet kërkesë për regjistrimin të drejtave të autorit por këtë të drejtë fitohet automatikisht që nga momenti i krijimit të veprës. Një gjë tjetër e cila është trajtuar dhe ndryshuar në Konventën e Bernës është edhe njohja ndërkombëtare e të drejtave të autorit. Para miratimit të konventës, personi që ka gëzuar të drejtën e autorit në shtetin A, ai nuk ka mundur të gëzojë të drejtën e autorit edhe në shtetin B dhe anasjelltas.

1.2 Konventa Universale të Drejtave të Autorit (1952)

Është miratuar në Gjenevë dhe administrohet nga Organizata e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e kombeve të Bashkuara (UNESCO). Kjo Konvente ishte hartuar si Kompromis për ato shtete të cilat nuk dëshironin të bëhen pjesë e Konventës së Bernës për shkak të kushteve të përcaktuara në të. Shteteve që kishin refuzuar ta nënshkruanin Konventën e Bernës ju ishte dhënë mundësia që prapë të jenë pjesë e një lloji marrëveshjeje ndërkombëtare. Edhe shtetet nënshkruese të konventës së Bernës gjithashtu u bënë anëtare të UCC për të siguruar që veprat që janë krijuar në shtetet e Bernës të gëzojnë mbrojtje edhe në shtetet tjera që nuk ishin pjesë e Bernës.

1.3 Konventa e Romës për mbrojtjen e interpretuesve, prodhuesve të fonogrameve dhe organizatave transmetuese (1961)

Për dallim nga Konventa e Bernës e cila është traktat ndërkombëtar më gjithë përfshirës, Konventa e Romës është e kufizuar vetëm për interpretuesit, prodhuesit e fonogrameve dhe organizatat/subjektet transmetuese. Ajo administrohet bashkërisht nga WIPO, UNESCO, dhe ILO. Kjo Konventë mbron një interpretuesi (qoftë aktor këngëtar, muzikant kërcimtar etj.) me rastin e transmetimit i interpretimeve të drejtpërdrejta të tyre ose fiksimit i interpretimeve të drejtpërdrejta pa pëlqimin e tyre. Gjithashtu kjo konventë mbron edhe prodhuesit e fonogrameve dhe ju jep atyre të drejtën ekskluzive për të autorizuar ose ndaluar riprodhimin e fonogrameve të tyre në mënyrë të drejtë ose tërthortë, sikurse që ju ofron mbrojtje edhe organizatave të transmetuesve duke iu dhënë atyre të drejtën ekskluzive për të autorizuar ose ndaluar të drejtat e caktuara siç janë: ritransmetimi dhe fiksimit i programeve të tyre.

1.4 Marrëveshja TRIPS (1994)

Administrohet nga OBT-ja dhe përcakton disa standarde minimale të formave të ndryshme të pronës intelektuale. Ajo i detyron shtetet anëtarë të

saj të përfshijnë disa kërkesa në legjislacionin e tyre kombëtar sa i përket të drejtës së autorit, përfshirë të drejtat e interpretuesve, prodhuesve të fonogrameve dhe organizatave të transmetuesve.

Kërkesa kryesore sa i përket të drejtës së autorit janë:

- të drejtat e autorit duhen të jepen në mënyrë automatike pa formalitete siç janë sistemi i regjistrimit të mbrojtjes ose përsëritjes së saj,
- programet e kompjuterit duhet të trajtohen nga ligjet kombëtare për të drejtat e autorit si “vepra letrare” dhe ti kenë të njëjtat kushte të mbrojtjes,
- përjashtimet kombëtare nga e drejta e autorit (siç është shfrytëzimi i drejt) duhet të kufizohet nga testi tri-hapësh i Bernës,
- marrëveshja TRIPS gjithashtu njihet edhe për përcaktimin e procedurave të zbatimit, të mjeteve juridike dhe procedurat për zgjedhjen e kontesteve.

1.5 Traktati i së drejtës së autorit të WIPO (1996)

Mbron programet kompjuterike dhe i trajton ato si “vepra letrare”. Në Bashkimin Evropian ky traktat zbatohet përmes direktivave të ndryshme të BE, siç janë: direktiva 91/250EC-e cila e cila krijon mbrojtjen e të drejtës së autorit për Softuer, direktiva 96/9/EC- për mbrojtjen e të drejtës së autorit për bazat e të dhënave dhe direktiva 2001/29/EC e cila ndalon pajisjet për shmangen e masave të mbrojtjes teknike siç është menaxhimi i të drejtave digjitale.

2. Direktivat më të rëndësishme të Bashkimit Evropian

Direktiva 2001/29/EC për harmonizimin e aspekteve të caktuara të së drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta në shoqërinë informative apo siç njihet shkurt Direktiva Evropiane, e cila harmonizon ligjet kombëtare të shteteve anëtare të BE-së për mbrojtjen e të drejtës së autorit për të gjitha veprat e publikuara në internet, telefon celular dhe pajisje digjitale.

Direktiva 2006/116/EC për harmonizimin e Kohëzgjatjes së Mbrojtjes së të drejtës së Autorit - harmonizon kohëzgjatjen e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta në të gjitha shtetet anëtare të BE-se. Kjo direktivë e ka zgjatur mbrojtjen të drejtës së autorit në 70 vite pas vdekjes së autorit, kurse

për të drejtat e përafërta, direktiva ofron 50 vite mbrojtje të këtyre të drejtave.

Direktiva 96/9/EC Parlamenti Evropian dhe Këshillit të datës 11 mars 1996 për mbrojtjen ligjore të bazës së të dhënave apo siç njihet shkurtimisht Direktiva e Bazës së të dhënave, është direktiva më kundërthënëse e Komisionit Evropian e cila ngrit shumë pikëpyetje për efikasitetin e saj. Kjo Direktivë ekskluzivisht e rregullon të drejtën e autorit për bazat e të dhënave dhe harmonizon mbrojtjen ligjore të bazave të të dhënave në tërë shtetet anëtare të BE-së.

Përveç mbrojtjes së të drejtës së autorit për mbledhjen dhe aranzhimin e të dhënave ose materialeve tjera, kjo konventë gjithashtu ofron edhe të ashtuquajturën mbrojtje “sui generis”. Kjo mbrojtje, është formë tërësisht e re e të drejtës së pronësisë intelektuale e cila e zgjeron mbrojtjen jo vetëm në mbledhjen dhe aranzhimin e të dhënave ose materialeve të tyre (që mbrohen nga e drejta e autorit), por prodhuesit të bazës së të dhënave i jepet e drejta ekskluzive për të parandaluar nxjerrjen dhe shfrytëzimin e pa autorizuar të përmbajtjeve të bazës së të dhënave.

Kjo direktivë është kundërshtuar fuqishëm nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës e cila për dallim nga Evropa i ofron mbrojtje vetëm kreativitetit, i cili është shfrytëzuar në mbledhjen dhe sistematizimin e të dhënave ose informacioneve tjera, por jo edhe vet të dhënave ose informacionit.³⁴⁷

3. Ligji i Kosovës për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta dhe përputhja e tij me instrumentet ligjore ndërkombëtare dhe ato të BE-së

E drejta e autorit dhe të drejtat e përafërta në Kosovë rregullohen me Ligin për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta (Ligji Nr 2004/45), që është miratuar nga Kuvendi i Kosovës me datën 29 qershor 2006 dhe është shpallur me anë të rregullores së UNMIK-ut 2006/46 të datës 24 gusht 2006. Ky ligj i rregullon të drejtat që dalin nga e drejta e autorit dhe të drejtat e përafërta, administrimin e të drejtës së autorit dhe të drejtat e përafërta, si dhe mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të drejtat e përafërta.

Në bazë të Ligjit për të Drejtën e Autorit dhe të drejtat e përafërta autori gëzon tri grupe të të drejtave: të drejtat ekonomike, të drejtat morale dhe

³⁴⁷ Luljeta Plakolli-Kasumi, LL.M, Te drejtat e autorit dhe te drejtat e perafërta Moduli 1 fq.6

autorizimet tjera të autorit. Në pajtim me Konventën e Bernës dhe direktivat Evropiane, ligji nuk kërkon ndonjë formalitet për të drejtat e autorit, por kjo e drejtë i takon autorit nga vet fakti se ai është krijuesi i veprës.³⁴⁸

Neni 2 i Konventës së Bernës ia lë në diskrecion legjislacioneve vendore të vendeve të Bashkimit të vendosin nëse vlera nuk do të mbrohet po që se nuk janë fiksuar në ndonjë formë materiale (fizike). Legjislacioni i Kosovës nuk përmban ndonjë kërkesë të tillë që do të thotë se një vepër nuk ka nevojë të fiksohet (shprehet) në formë materiale në mënyrë që të gëzoj mbrojtje. Në këtë drejtim, Ligji i ofron mbrojtje edhe veprave gojore si p.sh. fjalimet, leksionet, tregimet dhe veprat e ngjashme të shprehura gojarisht.

Neni 2-bis i Konventës së Bernës edhe në këtë rast ja lë legjislacionit kombëtar në diskrecion ti përjashtoj fjalimet politike dhe fjalimet e bëra gjatë procedurave gjyqësore nga kjo mbrojtje. Për dallim nga neni 2-bis i Konventës së Bernës, Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta përjashton materialin dhe publikimet zyrtare të parlamentit, qeveris dhe organizatave tjera që kanë kompetencë të zyrave publike por nuk thotë ndonjë gjë për fjalimet politike (Neni 12-c). Ligji është më se i qartë sa i përket fjalimeve të bëra gjatë procedurave gjyqësore, sepse neni 12 (e) thotë se parashtrësat dhe aktet tjera administrative dhe procedurat gjyqësore nuk i nënshtrohen mbrojtjes së të drejtës së autorit.

Sa i përket të drejtave ekonomike, Ligji i Kosovës për të drejtën e autorit i jep autorit të drejtën për shfrytëzimin e veprave në formë lëndore, jo lëndore dhe të modifikuar. Në pajtim me nenin 14 të Konventës së Bernës, ndër të tjera ligji e jep edhe të drejtën e riprodhimit (riprodhimit) (Neni 22.2), kurse në pajtim me nenin 11 dhe 11-bis të Konventës së Bernës, Ligji jep të drejtën e interpretimit publik dhe komunikimit të performancës publikut, të drejtën e transmetimit (Neni 22.3) dhe në fund në pajtim me nenin 12 të Konventës së Bernës, përcakton të drejtën e përpunimit dhe përshtatjes të veprave audiovizuale.

Në pajtim me direktivën për Kohëzgjatjen e Mbrojtjes së të drejtës së Autorit, ligji mundëson mbrojtjen e të drejtës së autorit gjatë jetës plus 70 vite pas vdekjes së tij, përkundër Konventës së Bernës që mundëson mbrojtje gjatë jetës plus 50 vite pas vdekjes së autorit.

³⁴⁸ Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta neni 6 dhe neni 7.

Ligji i Kosovës për drejtën e autorit përmban dispozita të posaçme për veprat e caktuara të mbrojtura me të drejtën e autorit siç janë veprat audiovizuale, programet kompjuterike veprat e krijuara gjatë marrëdhënies së punës dhe veprat e krijuara në shkollë. Në pajtim me Konventën e Romës, Marrëveshjen TRIPS, Traktatin e WIPO-s dhe Direktivat e KE-se, për interpretimet dhe Fonogramet, Ligji përmban dispozita të posaçme për të drejtat e interpretuesve, prodhuesve të Fonogrameve, producentëve të filmit, të drejtat e krijuesve të bazës së të dhënave dhe ato të botuesve.

Pjesa IV ligjit për të drejtën e autorit parasheh edhe menaxhimin dhe administrimin kolektiv të drejtave, por fatkeqësisht nuk ka sistem të shëndoshë të menaxhimit kolektiv e as ndonjë organ të qëndrueshëm administrativ i cili do të merret në mënyrë kompetente me këto çështje. Neni 169 i ligjit përcakton se Qeveria themelon Zyrën për Mbrojtjen e të Drejtave të pronës intelektuale brenda 18 muajve pas shpalljes së këtij ligji të shpallur në gusht të vitit 2006.


Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, në gjysmën e vitit 2010 ka ndërmarrë disa hapa për themelimin dhe funksionalizimin e kësaj zyre, por mund të thuhet se deri më tani pjesa e IV e këtij ligji mbetet efektive vetëm në letër dhe se në këtë drejtim mbetet shumë për tu dëshiruar.

Nga konstatimi i më sipërm bënë përjashtim Komisioni i Pavarur për Media (KPM), i themeluar me Ligji Nr. 02/L-15 PËR KOMISIONIN E PAVARUR TË MEDIAVE DHE TRANSMETIMIN, e që është autoriteti i vetëm në territorin e Kosovës përgjegjës për menaxhimin, rregullimin dhe caktimin e resurseve të spektrit të frekuencave të transmetimit dhe për dhënien e licencave për shfrytëzimin e frekuencave transmetuese.

PM, bazuar në Ligjin Nr. 02/L-15 dhe në aktet nënligjore, Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencimit e Kodin e Etikës për Mediat Elektronike, ka ngritur raste ligjore, duke shqiptuar sanksione në gjoba dhe të tjera, ndaj mediave elektronike, çdo herë kur përmes monitorimit të mediave ose në rast të ndonjë ankese është vërtetuar se ndonjëri medium ka bërë shkelje duke transmetuar ndonjë vepër filmike, program apo vepër tjetër, me të drejtë autoriale, pa siguruar paraprakisht marrëveshje të vlefshme për transmetim.

Sado që puna e cekur e KPM-së, ka dhënë rezultate konkrete në mbrojtjen administrative të të drejtës së autorit, funksionalizimi më i shpejtë i Zyrës për Mbrojtjen e të Drejtave të pronës intelektuale, në kuadër të Ministrisë së

Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe reformimi i mëtejshëm i sistemit gjyqësor, ku një numër të konsiderueshëm të lëndëve do ta përbëjnë edhe rastet e menaxhimit dhe mbrojtjes së të drejtave të autorit, shteti i Kosovës do të bëjë edhe një hap më përpara drejt integritimit Evropian.



Minire Xhamabazi

EKZEKUTIMI I BURGIMIT PËR TË MITUR

1. Kuptimi, qëllimi dhe karakteristikat e përgjithshme të burgimit për të mitur

Burgimi për të mitur është lloj i posaçëm i dënimit që mund të shqiptohet ndaj kryesve të mitur të veprave penale. Ky dënim mund të shqiptohet vetëm përjashtimisht dhe për llojet e veprave penale shumë të rënda të kryera nga të miturit. Sipas nenit 29 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, qëllimi i burgimit për të mitur është që të kontribuohet në rehabilitimin dhe në zhvillimin e kryerësit të mitur, veçanërisht në edukimin e të miturit, edukimin e specializuar, aftësimin dhe zhvillimin e duhur profesional të tij.

Përveç kësaj, burgimi për të mitur duhet të ndikojë pozitivisht në të miturin përmes mbrojtjes, ndihmës dhe mbikëqyrjes për ta parandaluar recidivizmin. Burgimi për të mitur mund të shqiptohet vetëm nëse janë plotësuar kushtet e përgjithshme për të, të parapara me legjislacionin penal. Respektivisht, në pajtim me nenin 30 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, burgimi për të mitur mund të shqiptohet ndaj kryerësit të mitur i cili ka arritur moshën gjashtëmbëdhjetëvjeçare dhe ka kryer vepër penale të dënueshme me burgim prej më shumë se pesë vitesh, në rastet kur shqiptimi i masës edukative nuk do të ishte adekuate për shkak të peshës së veprës penale, pasojave të saj dhe nivelit të përgjegjësisë.

Sipas dispozitave të legjislacionit penal për të mitur, burgimi për të mitur nuk mund të kalojë maksimumin e burgimit të paraparë për veprën penale, por ai mund të jetë më i ulët se minimumi i burgimit të paraparë për vepër penale (neni 31 paragrafi 1). Ndërkaq, ky dënim nuk mund të shqiptohet në kohëzgjatje më pak se gjashtë muaj as më shumë se pesë vjet dhe shqiptohet në muaj dhe ditë të plota. Maksimumi i burgimit për të mitur është dhjetë vjet për vepra të rënda penale të dënueshme me burgim afatgjatë, ose kur i

mituri ka kryer së paku dy vepra penale në bashkim, ku secila prej tyre është e dënueshme me burgim prej më shumë se dhjetë vjet (neni 31 paragrafi 2).

Siç mund të vërehet, burgimi për të mitur është dënim i posaçëm, i cili për nga karakteri dhe qëllimi që synon të arrijë, është specifik, nga fakti se në të njëjtën kohë është dënim, por edhe me shumë elemente të masës edukuese. Ky dënim ka mjaft karakteristika të përbashkëta si dhe disa dallime në krahasim me dënimet që u shqiptohen kryesve madhor të veprave penale. Këto karakteristika gjejnë shprehje në qëllimin që dëshirohet të arrihet, i cili është shumë i ngjashëm me qëllimin e masave edukative, pastaj me kushtet e shqiptimit dhe të matjes së tij, në matjen për veprat penale në bashkim etj. Po ashtu, këto veçori, veçmas gjejnë shprehje edhe me rastin e ekzekutimit të burgimit për të mitur.

2. Karakteristikat e përgjithshme të ekzekutimit të burgimit për të mitur

Ekzekutimi i burgimit për të mitur manifeston disa ngjashmëri por edhe dallime në krahasim me ekzekutimin e dënimit me burgim ndaj madhorëve. Zakonisht trajtimi ndaj të miturve të dënuar gjatë ekzekutimit të këtij dënimi përshkohet më tepër me masa të përmirësimit, edukimit, riedukimit, të angazhimit në punë, aktivitete edukativo-arsimore dhe aktivitete të ndryshme kulturo-zbavitëse dhe sportive, gjithnjë duke pasur për qëllim ofrimin e mbrojtjes dhe të ndihmës ndaj të miturve, ushtrimin e mbikëqyrjes ndaj tyre, aftësimin nga ana profesionale, zhvillimin e përgjegjësisë personale si dhe riedukimin e suksesshëm të tyre.

Me Kodin e Drejtësisë për të Mitur janë paraparë vetëm disa dispozita të përgjithshme dhe specifike që kanë të bëjnë me ekzekutimin e burgimit për të mitur, ndërsa më detajisht këto çështje rregullohen me Ligjin mbi ekzekutimin e sanksioneve penale. Kjo është paraparë në nenin 130 paragrafi 2 të Kodit të Drejtësisë, në të cilin shprehimisht thuhet: “Dispozitat e Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale për ekzekutimin e dënimit me burgim zbatohen përshtatshmërisht për ekzekutimin e burgimit për të mitur në rastet kur nuk janë në kundërshtim me këtë ligj”.

Burgimi për të mitur ekzekutohet në institucionet korrektuese për të mitur, të cilat institucione janë themeluar për këtë qëllim. Dispozitat e Kodit parashohin mundësinë që ky lloj i dënimit mund të ekzekutohet edhe në pavijone të veçanta të institucionit korrektues për të rritur. Institucioni korrektues për të mitur është i tipit gjysmë të mbyllur, e vetëm

përfundimisht të miturit mund ta mbajnë dënimin në institucionin korrektues të tipit të mbyllur (neni 132 paragrafi 1).

Sipas rregullit, të miturit e mbajnë dënimin me burgim për të mitur në institucionin korrektues për të mitur derisa të mbushin moshën njëzet e tri vjeçare, ndërsa pjesën tjetër të dënimit ata vazhdojnë ta mbajnë në institucionin korrektues për të rritur. Por, në raste të veçanta, personave të dënuar që kanë mbushur moshën njëzet e tri vjet mund t'u lejohet qëndrimi në institucionin korrektues për të mitur nëse kjo është e nevojshme për përfundimin e përgatitjes ose aftësimin të tyre profesional, apo nëse pjesa e mbetur e dënimit të tyre që duhet mbajtur nuk është më e gjatë se gjatë muaj.

Mirëpo, ata në asnjë mënyrë nuk mund të qëndrojnë në institucionin korrektues për të mitur pasi të kenë mbushur njëzet e shtatë vjet (neni 132 paragrafi 3). Është obligim i drejtorit të institucionit korrektues ku ekzekutohet dënimi me burgim për të mitur, që çdo vit t'ia paraqesë raportin gjykatës e cila e ka shqiptuar dënimin për të mitur për sjelljen e të miturit dhe ekzekutimin e burgimit për të mitur.

Gjatë ekzekutimit të dënimit me burgim për të mitur, atyre iu mundësohet shkollimi, edukimi, riedukimi dhe aftësimi profesional. Atyre iu mundësohet punë e dobishme edukative me shpërblim përkatës, lehtësime dhe inkurajimi i kontakteve mes të miturve me botën e jashtme përmes letrave, telefonit, pranimin e vizitave, vizitave në shtëpi, aktiviteteve sportive dhe realizimit të shumë të drejtave të tjera dhe beneficioneve. Po ashtu, dispozitat në fuqi kërkojnë që edhe personeli penitenciar që trajton të miturin të posedoj aftësi dhe njohuri nga fusha të ndryshme, e veçmas nga lëmi i pedagogjisë dhe psikologjisë.

Sipas nenit 130 paragrafi 1 i Kodit të Drejtësisë për të Mitur, dispozitat e këtij kodi që rregullojnë dërgimin, pranimin, qëndrimin dhe shtyrjen e ekzekutimit, caktimin e grupeve arsimore, të drejtat në vizita dhe angazhimin në ushtrime fizike, përcaktimin e punës dhe edukimin, mundësinë e shkollimit të rregullt, dënimet disiplinore të të miturve në institucionet edukative dhe procedurat për ankesa dhe lutje, gjithashtu vlejné edhe për ekzekutimin e dënimeve me burgim për të miturit.

Sipas rregullit, të miturit e mbajnë dënimin me burgim për të mitur bashkarish. Mirëpo, ka edhe përjashtime nga kjo rregull. Respektivisht, i mituri mund të ndahet nga të miturit e tjerë me kërkesën e vet, nëse për këtë

ekzistojnë arsye e justifikueshme, ose në bazë të urdhrin të drejtorit të institucionit korrektues.

Sipas nenit 133 paragrafi 3 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, drejtori i institucionit korrektues mund ta urdhëroj të miturin që të ndahet nga personat e tjerë të dënuar, pa kërkesën e të miturit, vetëm nëse masa e tillë është e nevojshme:

- Për të parandaluar rrezikun për jetë apo shëndet të të miturit a personave tjerë;
- Për të parandaluar kërcënimin ndaj sigurisë së institucionit korrektues të shkaktuar nga prania e vazhdueshme e të miturit brendapërbrenda popullacionit të burgut.

Të miturit, gjatë qëndrimit në institucionin korrektues, mund t'i lejohet pushimi nga dy herë në çdo vit, i cili pushim zgjatë deri në tridhjetë ditë dhe lejohet vetëm kur nuk mbahen mësimet (neni 134). I mituri gjatë qëndrimit në institucion korrektues ka të drejtë të qëndrojë të paktën 3 orë në ditë jashtë lokaleve të mbyllura. Ndërkaq, ndaj të miturit nuk mund të caktohet masa e vetmisë si dënim disiplinor (neni 135 paragrafi 2).

3. Lirimi me kusht i personave të mitur të dënuar

Lirimi me kusht është institucion i rëndësishëm të cilin e njohin të gjitha legjislacionet penitensiare të shteteve të shoqërisë bashkëkohorë, të cilat e kanë pranuar sistemin modern të ekzekutimit të dënimit me burgim. Ai paraqet një mjet të rëndësishëm për nxitjen dhe stimulimin e personave të dënuar në procesin e risocializimit të tyre.

Dispozitat juridiko pozitive të cilat i referohen lirimit me kusht të personave të mitur të dënuar në Kosovë janë paraparë me ligjet e aplikueshme të fushës penale dhe të ekzekutimit të sanksioneve penale ndaj të miturve. Sipas legjislacionit penal në fuqi institucioni i lirimit me kusht ka të bëjë me lirimin e të dënuarit nga mbajtja e dënimit para se ta kryejë dënimin e plotë nëse i ka plotësuar kushtet e caktuara.

Sipas Kodit të Drejtësisë për të Mitur, personi i mitur i dënuar me burgim për të mitur mund të lirohet me kusht nëse e ka mbajtur së paku një të tretën e dënimit që i është shqiptuar (neni 32 paragrafi 1). Ky është kushti objektiv që ka të bëjë me kohën e kaluar gjatë mbajtjes së dënimit. Por, të miturit

nuk mund t'i caktohet lirimi me kusht para se të ketë qëndruar gjashtë muaj në institucionin korrektues, përkatësisht në paralelen për të mitur.

Kjo kohë është e nevojshme që të kalojë, pasi që konsiderohet se gjatë kohës më të shkurtër se gjashtë muaj nuk mund të arrihet qëllimi i burgimit për të mitur. Po ashtu, edhe minimumi i përgjithshëm i këtij dënimi, siç është theksuar më lartë, është gjashtë muaj.

Në Kodin e Drejtësisë për të Mitur është paraparë mundësia që kur lejohet lirimi me kusht, gjykata mund të shqiptojë masën e mbikëqyrjes së shtuar nga ana e prindit, prindit adoptues ose kujdestarit apo organit të kujdestarisë, e cila mund të zgjasë deri në përfundimin e dënimit të shqiptuar (neni 32 paragrafi 2). Natyrisht se shqiptimi i kësaj mase ka rëndësi të madhe, pasi që ajo ndihmon të miturin që të kyçet me sukses në jetën shoqërore.

Sipas dispozitave të legjislacionit penal të Kosovës, për lirimin me kusht vendos paneli për lirimin me kusht.³⁴⁹ Themelimi i këtij paneli, sipas gjendjes aktuale, është kompetencë e rezervuar e UNMIK-ut, përkatësisht Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut. Sipas nenit 129 të Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, paneli për lirimin me kusht përbëhet prej një gjyqtari dhe dy gjyqtarëve laik të cilët posedojnë njohuri dhe përvojë në psikologji, kriminologji, psikiatri, pedagogji, sociologji dhe shkenca të tjera shoqërore lidhur me lirimin me kusht.

Paneli për lirimin me kusht vendos në bazë të kërkesës së të miturit apo propozimit të drejtorit të institucionit korrektues për të mitur. Pas paraqitjes së kërkesës apo propozimit për lirimin me kusht, drejtori i institucionit korrektues, panelit për lirimin me kusht ia dorëzon kopjen e dosjes personale të personit të dënuar dhe raportin mbi personin e dënuar të përpiluar nga ekipe profesionale e institucionit korrektues.

Zakonisht ky raport përfshin: llojin e veprës penale të të miturit; qëndrimin e tij ndaj veprës penale, viktimës dhe familjes së viktimës; ndonjë vepër penale të kryer më parë nga ai; rrethanat e tij familjare dhe të kaluarën shoqërore; gjendjen e tij fizike dhe psikologjike; sjelljen e tij në institucionin korrektues dhe suksesin e arritur; planet pas lirimit; përkrahja

³⁴⁹ Deri me nxjerrjen e Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale (Rregullorja e UNMIK-ut nr.2004/46, të datës 19 nëntor 2004), për lirimin me kusht ka vendosur komisioni për lirimin me kusht i përbërë prej 5 anëtarëve. (Gjerësisht shih: R.Gashi, Lirimi me kusht i personave të dënuar në legjislacionin dhe praktikën kosovare, E drejta, nr.2/2004, Prishtinë, fq.39-57).

që mund t'i ofrohet pas lirimit dhe ndonjë rrethanë tjetër që tregon se ai nuk do të kryejë vepër të re penale (neni 128 paragrafi 5 i Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale). Paneli për lirim me kusht sistematikisht shqyrton lëndët e personave të mitur të dënuar, të cilët kanë plotësuar kushtet për shqyrtim.

Pas vendosjes, paneli e lëshon vendimin e arsyetuar mbi dhënien apo refuzimin e lirimit me kusht. Nëse refuzohet lrimi me kusht, në vendim duhet të ceket edhe data e rishqyrtimit të lëndës nga ana e panelit. Respektivisht, vendimi i panelit për lirim me kusht duhet të jetë arsyetuar.

Personi i mitur i liruar me kusht duhet të manifestojë sjellje të mira gjatë kohës në liri. Nëse i dënuari i mitur gjatë kohës së lirimit me kusht nuk u përmbahet obligimeve të caktuara ose kryen ndonjë vepër penale, lrimi me kusht mund të revokohet. Sipas dispozitave të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, gjykata mund ta revokoj lirim me kusht nëse gjatë kohës së lirimit me kusht i mitur kryen vepër penale për të cilën shqiptohet burgimi apo burgimi për të mitur prej së paku gjashtë muaj (neni 32 paragrafi 3).



Valbona Dervodeli

DËNIMI, QËLLIMI DHE LLOJET

Që nga kohërat më të lashta shoqëritë njerëzore dhe grupet e ndryshme kanë bërë përpjekje për pengimin e kriminalitetit dhe sjelljeve të rrezikshme në shoqëri dhe që atëherë ka pasur reagime ndaj veprimeve dhe sjelljeve të ndryshme të cilat kanë cenuar interesat, vlerat dhe normat më vitale të individëve, grupeve dhe bashkësive të caktuara³⁵⁰.

Dënimi është lloji më i vjetër i sanksionit penal, ka lindur nga gjakmarrja dhe kompozicioni, si forma të para të reagimit të shoqërisë ndaj veprave të ndaluara të individëve. Gjerë në fund të shekullit XIX dënimi ka qenë i vetmi lloj i sanksionit penal, edhe sot dënimi është sanksion themelor, shqiptohet më së shpeshti ndaj kryerësve të veprave penale³⁵¹.

E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t'i privohet qëllimisht jeta, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim me vdekje i dhënë nga një gjykatë, kur krimi ndëshkohet me këtë dënim nga ligji³⁵². Çdo kush ka të drejtën e lirisë dhe të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj³⁵³.

Për t'u shqiptuar një dënim duhet të ekzistojë vepra penale, elementet e saj, siç janë: sjellja e njeriut (veprimi ose mosveprimi), rrezikshmëria shoqërore, përcaktimi i një vepre penale, pasoja, lidhja shkakësore mes veprimit (mos veprimit) dhe pasojës, përgjegjësia penale.

Një vepre penale po t'i mungojë ndonjë nga elementet e vënë në pikëpyetje ekzistencën e saj, që d.m.th. nuk kemi vepër penale, siç përcaktohet edhe

³⁵⁰ Halili, dr. Ragip penologjija shkenca mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, 2005, Prishtine, faqe 29,

³⁵¹ Salihu, dr. Ismet E drejta penale 2005 Prishtine, faqe 431

³⁵² Konventa Evropiane e te Drejtave te Njeriut, neni 2,

³⁵³ Konventa Evropiane e te Drejtave te Njeriut, neni 5,

me nenin 6 të KPK-së, se vepra penale është vepër e kundërligjshme e cila është e përcaktuar me ligj si vepër penale tiparet e së cilës janë të përcaktuara me ligj dhe për të cilën me ligj është paraparë sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm.

Dënimi përbëhet nga këto elemente:

- a. dënimi duhet të paraqes vlerësim negativ, moralo-etik ndaj veprës penale dhe kryerësit,
- b. dënimi duhet të paraqes një të keqe e cila e godet personin i cili ka kryer vepër penale,
- c. dënimi duhet të ketë qëllimin e caktuar i cili dëshirohet dhe arrihet me ekzekutimin e tij,
- d. dënimi duhet të jetë i përcaktuar me ligj, po që se dënimi nuk është i paraparë me ligj nuk mund të shqiptohet, ky element është i njohur edhe në maksimën latine, NULLA POENA SINE LEGE,
- e. dënimi mund të shqiptohet vetëm ndaj kryerësve të veprave penale që janë penalisht të përgjegjshëm,
- f. dënimin mund ta shqiptojë vetëm gjykata³⁵⁴

Karakteristikat e dënimit:

- a. sipas të drejtave penale bashkëkohore, dënimi duhet të jetë personal,
- b. dënimi duhet të jetë human- mos të shkaktojë mundim dhe përbuzje të delinkuentit dhe dëmtim të shëndetit,
- c. dënimi duhet të jetë legjitim – gjykata duhet të shqiptojë llojin dhe lartësinë e dënimit aq sa është i domosdoshëm për mbrojtjen e shoqërisë nga kriminaliteti dhe përmirësimin e fajtorit,
- d. dënimi duhet t'i godas njësoj kryerësit e veprave penale pa marrë parasysh përkatësin nacionale, fetare, racore, politike etj.
- e. dënimi duhet të jetë proporcional me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të kryesit,
- f. dënimi duhet të jetë i ndarë,
- g. dënimi duhet të jetë i revokueshëm,
- h. dënimi duhet të jetë i përmirësueshëm³⁵⁵.

³⁵⁴ Salihu, dr. Ismet E drejta penale 2005 Prishtine, faqe 432-433

³⁵⁵ Salihu, dr. Ismet E drejta penale 2005 Prishtine, faqe 433-434-435

BAZA – juridike e dënimit është në të drejtën, e domosdoshme të shoqërisë që të mbrohet nga kriminaliteti, të luftohet kriminaliteti duke zbatuar mjete të dhunshme, siç është dënimi.

Qëllimi i dënimit

Qëllimet e dënimit janë:

1. Të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprës penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij,
2. Të përmbajë personat e tjerë nga kryerja e veprës penale³⁵⁶

Filozofi i lashtë grek Platoni, qëllimin e dënimit e ka përcaktuar në këtë mënyrë “Kush ndëshkohet në mënyrë të drejtë duhet të bëhet i mirë dhe të përfitojë nga dënimi, ose ai duhet të bëhet shembull për të tjerët. Kështu ata do të shikojnë çfarë ai vuan dhe do të frikësohen të vuajnë edhe ata”

Pra qëllimi që një person të privohet nga liria është që ai të riedukohet, risocializohet, të bëhet i dobishëm për rrethin familjar, dhe kur të lirohet të jetë më i përgjegjshëm për veprimet e tij në të ardhmen.

Se çka arrihet me zbatimin e dënimit janë shfaqur mendime dhe teori të ndryshme filozofike dhe juridike, e të cilat mund të radhiten në tri grupe themelore:

1. Teoritë absolute
2. Teoritë relative dhe
3. Teoritë e përziera apo eklektike.
 - a. Sipas teorisë absolute – qëllimi i dënimit është hakmarrja ndaj personit që kryen veprë penale si e metë kryesore e kësaj teorie është se këto në tërësi injorojnë qëllimin social të dënimit.
 - b. Sipas teorisë relative – dënimi nuk duhet të jetë qëllim në vete por mjet për mbrojtjen e shoqërisë nga kriminaliteti, platformë kryesore është preventiva e kriminalitetit.
 - c. Teoritë e përziera më së miri e përcaktojnë qëllimin që duhet të arrijë dënimi.

³⁵⁶ Kodi Penal i Kosovës neni 34

Sipas përfaqësuesve të kësaj teorie, qëllimi i dënimit nuk mund të arrihet vetëm me represion (hakmarrje) por jo edhe vetëm me preventivë. Kryesi i veprës penale duhet të dënohet për shkak se ka kryer vepër të dëmshme, por ai duhet të dënohet edhe me qëllim mos të kryejë më vepër të kundërligjshme, pra të përmirësohet.

Qëllimi i dënimit sipas të drejtës penale të Kosovës

Sipas KPK-së del se e drejta jonë e përvetëson preventivën e posaçme (speciale) dhe të përgjithshme (gjeneral) si qëllim të dënimit, në nenin 34 të Kodit Penal është përcaktuar qëllimi i përgjithshëm i dënimit. Si në legjislacionin penal të çdo shteti, ashtu edhe te ne, lloji dhe lartësia e dënimit përcaktohet sipas intensitetit dhe sasisë së të keqes që kryesi i veprës penale ia ka shkaktuar individit dhe shoqërisë.

Dënimi krahas qëllimit të preventivës individuale dhe të përgjithshme duhet të përmbushë edhe qëllimin e drejtësisë duhet të jetë i drejtë, vetëm dënimi i drejtë mund të shuajë ndjenjën e hakmarrjes³⁵⁷.

Llojet e dënimeve

Neni 6 parag. 2 i Konventës Evropiane të të Drejtave të njeriut thotë “Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht”

Në nenin 1 parag. 2 të Kodit Penal është shkruar se, askujt nuk mund t’i shqiptohet sanksionin penal ose masë e trajtimit të detyrueshëm për një vepër penale, nëse para kryerjes së veprës ligji nuk e përcakton veprën si vepër penale dhe nuk parasheh sanksion penal ose mos të trajtimit të detyrueshëm për atë vepër³⁵⁸. I njëjti parim shkruhet në nenin 7 të Konventës Evropiane.

Nga burimet e së kaluarës lidhur me dënimet kuptojmë se në testamentin e vjetër të Biblës, është e njohur rregulla që bazohet në shpagim - zhdëmtim “sy për sy”, “dhëmbë për dhëmbë”, apo me Sheriat është e njohur, goditja me shkop, gjoba, prerja e gjymtyrës.

³⁵⁷ Salihu Dr. Ismet E drejta Penale 2005, Prishtine, faqe 438 – 439 -440 – 441

³⁵⁸ Salihu Dr. Ismet E drejta Penale 2005, Prishtine, faqe 443

E drejta Penale e Kosovës njeh 5 lloje të dënimeve, neni 36, 41, 54 këto janë:

1. Dënimi me burgim afatgjatë,
2. Dënim me burgim,
3. Dënim me gjobë,
4. Dënimet alternative,
5. Dënimet plotësuese.

E drejta jonë nuk e njeh dënimin me vdekje, ky lloj dënimi është abroguar më 12 dhjetor të vitit 1999, në Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 1999\24, ndërsa me Rregulloren nr. 1999/59, është paraparë dënim me burgim afatgjatë (21-40 vjet) në vend të dënimit me vdekje.

Në nenin 35 të Kodit Penal dënimet ndahen në:

- a) Dënime kryesore,
- b) Dënime alternative dhe
- c) Dënime plotësuese³⁵⁹.

Sipas nenit 36 të KPK-së, dënimet kryesore janë:

- a. Dënimi me burgim afatgjatë,
- b. Dënimi me burgim dhe
- c. Dënimi me gjobë³⁶⁰.

Me shqiptimin e dënimit me burg njeriut i merret liria e qarkullimit, ndërsa te dënimi me gjobë pasuria. Dënimi me burg për herë të parë është paraparë në Kodin Penal të Francës të vitit 1791.

Dënimi me burg, në krahasim me dënime të vrazhda (gjymtimet fizike), kishte për qëllim edukimin dhe arsimimin e personave me vetëdije të ulët të arsimit.

1. Dënimi me burgim afatgjatë- shqiptohet në kohëzgjatje prej 21 deri 40 vjet. Në Kodin Penal neni 37 parag. 4, është paraparë që kryesit e veprës penale lirimi me kusht mund t'i jepet pasi t'i ketë mbajtur $\frac{3}{4}$ e këtij dënimi.

³⁵⁹ Kodi Penal i Kosoves neni 35

³⁶⁰ Kodi Penal i Kosoves neni 36

2. Dënimi me burgim – është i paraparë për numrin më të madh të veprave penale. Minimumi i përgjithshëm i dënimit me burgim është 15 ditë, ndërsa maksimumi i përgjithshëm është 20 vjet (neni 38 parag. 1) në KPK është paraparë që në të gjitha rastet e mundshme, në vend të dënimit me burgim sidomos të burgimit afatshkurtër, të shqiptohen dënimet alternative apo dënimi me gjobë. Në parag. 3 të nenit 38 të Kodit Penal është paraparë që “kur gjykata cakton dënim me burgim të zëvendësohet me gjobë ose me punë në dobi të përgjithshme, por me pëlqimin e kryerësit”.
3. Dënimi me gjobë bënë pjesë në llojet e dënimeve pasurore. Dënimi me gjobë është i vetmi lloj i dënimit i cili mund të shqiptohet si dënim kryesor dhe plotësues. (neni 39 parag. 1). Minimumi dhe maksimumi i përgjithshëm i këtij lloji të dënimit është 50 €, minimumi, maksimumi i përgjithshëm është 25.000 €, ndërsa kur vepra penale është kryer me qëllim të fitimit maksimumi i gjobës është 500.000 €. Sipas nenit 39 parag. 3 të KPK-së, nëse personi i dënuar nuk është në gjendje ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata mund të lejoj që dënimi të paguhet me këste por pa kaluar dy vite, e nëse nuk është në gjendje brenda kësaj periudhe të paguaj me pëlqimin e personit të dënuar mund ta zëvendësoj gjobën me një urdhër për punë në dobi të përgjithshme (neni 40 i KPK-se)³⁶¹.

Dënimet alternative (neni 41 i KPK-së)

Qëllimi kryesor i dënimeve dhe masave tjera alternative është që në të gjitha rastet të luftohet kriminaliteti pa u ekzekutuar dënimi me burgim.

1. Dënimet alternative janë:

- 1.1 Dënimi me kusht dhe
- 1.2 Gjysëmliria.

2. Kur gjykata shqipton dënimin me kusht, gjykata mund të shqiptojë:

- a. Urdhrin për trajtim të detyrueshëm rehabilitues,
- b. Urdhri për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues dhe
- c. Urdhrin për punë në dobi të përgjithshme.

Sipas dispozitës së Kodit Penal, me rastin e caktimit të dënimit me kusht, gjykata ia shpall personit të dënuar dënimin dhe të njëjtën kohë urdhëron që

³⁶¹ Kodi Penal i Kosoves neni 39 par.3

ky dënim të mos ekzekutohet nëse personi i dënuar për kohën të cilën e cakton gjykata (koha e verifikimit) e cila nuk mund të jetë më e shkurtë se një vit dhe as më e gjatë se 5 vjet, nuk kryen vepër tjetër penale (neni 43 parag. 2).

Kur gjykata shqipton dënim me burgim deri në një vit mund të urdhërojë ekzekutimin e dënimit me gjysmë liri, për shkak të detyrimeve të personit të dënuar lidhur me punën, arsimimin, kualifikimin ose aftësimin profesional, përgjegjësit esenciale familjare, apo nevojën për trajtim apo rehabilitim mjekësor. Kur e vuan dënimin në gjysmë liri personi i dënuar detyrohet të kthehet në burg pas kryerjes së detyrimeve jashtë burgut brenda kohës së caktuar nga gjykata (nenin 53 i KPK-se).

2.1. Sipas parag. 1 të nenit 49 të KPK-së gjykata mund të shqiptojë dënim me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues në rast se personi i dënuar e ka shkelur ligjin për herë të parë dhe është i varur nga droga ose alkooli, nëse gjykata konsideron se faktori kryesor që ka ndikuar në kryerjen e veprës penale është alkooli ose droga dhe se trajtimi i suksesshëm do të zvogëlonte rrezikun për kryerjen e veprës së re penale, pas shqyrtimit të raportit të shërbimit sprovues.

2.2 Gjkata mund të shqiptojë dënim me kusht me urdhrin për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues, nëse konsideron se integrimi i të dënuarit në shoqëri arrihet më mirë përmes mbikëqyrjes nga ana e shërbimit sprovues pas shqyrtimit të dosjes së shërbimit sprovues.

2.3 Gjkata mund të shqiptojë kryerësit dënimin me kusht me urdhër për punë në dobi të përgjithshme të paraparë në parag. 1 të nenit 44 të KPK-së, nëse gjykata e shpall dënimin me gjobë deri në 2.5000 €, ose me burgim deri në një vit. Puna në dobi të përgjithshme mund të caktohet vetëm me pëlqimin e personit të dënuar (parag. 1 neni 52). Shqiptohet në kohëzgjatje prej së paku 30 orë, e më së tepërmi 240 orë pune. Orët e caktuara nga gjykata duhet të kryhen brenda një viti (neni 52 parag. 2 e 3).

Dënimet plotësuese

Janë lloje të posaçme të sanksioneve penale mund të shqiptohen së bashku me dënimin kryesor ose alternativ. Në të drejtën penale është paraparë që krahas dënimit kryesor, duhet paraparë edhe sanksione tjera penale plotësuese për parandalimin e kriminalitetit dhe risocializimi i personave të dënuar. Këto dënime shqiptohet me qëllim t'i merren apo kufizohen disa të drejta ku me dënim kryesor nuk mund t'i merren.

Në dënime plotësuese bëjnë pjesë:

- a. gjoba,
- b. heqja e të drejtës për t'u zgjedhur,
- c. ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik,
- d. ndalimi i ushtrimit të profesionit, i aktiviteteve ose detyrës,
- e. ndalimi për të drejtuar automjetin,
- f. marrja e lejes së vozitjes,
- g. marrja e sendit,
- h. urdhri për publikimin e aktgjyqimit,
- i. dëbimi i të huajit nga territori i Kosovës (par. 2 neni 54 i KPK-së)



Bahtie Ademi

URDHRI PËR MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE

Njeriu historikisht nëpër periudha të ndryshme shoqërore ka jetuar dhe ka krijuar familje. Familja është bashkësi vitale e prindërve dhe fëmijëve të tyre dhe personave të tjerë në gjini, njëkohësisht familja është bërthamë natyrore dhe themelore e shoqërisë dhe si e tillë gëzon të drejtën në mbrojtje³⁶².

Personat në marrëdhënie familjare konsiderohen ata të cilët janë të fejuar, apo ishin të fejuar, janë të martuar, janë në bashkësi jashtëmartesore apo ishin në bashkësi jashtëmartesore, bashkëjetojnë në ekonomi të përbashkët ose që bashkëjetuan në një ekonomi të tillë, përdorin një shtëpi të përbashkët, janë në lidhje gjaku, martesë, adoptimi, krushqie apo janë në lidhje kujdestarie duke përfshirë prindërit, gjyshërit, vëllezërit, motrat, nipat, hallat, tezet, xhaxhallarët, dajallarët. Janë prindër të një familje të përbashkët dhe janë palë në një kontest nga marrëdhënia familjare³⁶³.

Për shkak të rëndësisë së madhe që ka familja e njëjta ka qenë objekt trajtimi i akteve ndërkombëtare, ashtu që Deklarata e përgjithshme mbi të drejtat e njeriut e Asamblesë të OKB-së në dispozitat e saja thotë se: familja është si një krijesë e rëndësishme shoqërore, është bërthamë e natyrshme dhe themelore, ashtu që ka të drejtën e mbrojtjes nga shoqëria dhe shteti³⁶⁴.

Po ashtu edhe akti më i lartë në vendin tonë Kushtetuta e Republikës së Kosovës i kushton një rëndësi të posaçme familjes ashtu që në kapitullin për të drejtat dhe liritë themelore theksohet se “familja gëzon mbrojtje të veçantë nga shteti në mënyrën e rregulluar me ligj”³⁶⁵.

³⁶² Ligji për Familjen e Kosovës nr. 2004/32 neni 2.

³⁶³ Ligji për mbrojtjen nga dhuna në Familje nr. 03/L - 182 neni 2.

³⁶⁴ Deklarata e përgjithshme mbi të drejtat e njeriut e OKB neni 16 par. 3.

³⁶⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 37 par. 3

Raportet në familje në shumicën e rasteve janë të shëndosha dhe normale, por fatkeqësisht nga ndonjëherë ndodhë që sjelljet mes anëtarëve të familjes janë jo të rregullta, devijante ashtu që mund të shkaktohet dhuna në familje dhe të rrezikohet funksionimi i familjes, ashtu që shteti për mes fuqisë së normës juridike duhet të intervenoi për rregullimin e këtyre raporteve.

Në këtë drejtim edhe veprat penale të kryera tek personat në marrëdhënie familjare si: lëndimi i lehtë trupor, lëndimi i rëndë trupor, shtrëngimi, kanosja, privimi i kundërligjshëm i lirisë dhe veprat penale kundër integritetit seksual të parapara në Kodin Penal të Kosovës, ligjvënësi ka bërë me qenë të kualifikuara³⁶⁶.

Duke pasur parasysh rëndësinë e familjes dhe funksionimin normal të raporteve familjare dhe mbrojtjen e të drejtave të anëtarëve të familjes është nxjerrë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/12 e dt. 07.05.2003, për mbrojtjen kundër dhunës në familje³⁶⁷.

Kjo Rregullore për kundër faktit që ka pasur një ndikim në mbrojtjen nga dhuna në familje, e njëjta ka pasur edhe disa të meta përkatësisht paqartësi të cilat kanë paraqitur dilema me rastin e zbatimit praktik të saj. Në këtë Rregullore për personin përgjegjës është përdorur herë termi i paditur e herë i pandehur, çka fillimisht me rastin e zbatimit të saj nëpër gjykata ka pasur dilema se a duhet të veprohet sipas rregullave të procedurës kontestimore apo penale, andaj për shkak të zbrazëtirave që ka pasur kjo Rregullore është paraqitur nevoja për ndryshimin e saj, dhe me dt. 29.07.2010 është nxjerr dhe ka hyr në fuqi Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje.

Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje është nxjerrë me qëllim të parandalimit të dhunës në familje në të gjitha format e saj, me masa të përshtatshme ligjore duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve, dhe personave me aftësi të kufizuar.

Çka është dhuna në familje

Sipas Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje - dhunë në familje do të thotë³⁶⁸:

³⁶⁶ Kodi Penal i Kosovës neni 153 par. 4, 154 par. 3, 160 par. 2, 161 par. 3, 162 par. 4, 193 par. 3 nën par. 8, 195 par. 4 nën par. 8, 196 par. 4 nën par. 7 dhe 198 par. 5 nën par. 8.

³⁶⁷ Rregullorja e UNMIK –ut 2003/12 për mbrojtjen kundër dhunës në familje.

³⁶⁸ Se çka është **dhunë në familje** është e rregulluar me nenin 2 pika 1.2. të Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje.

- një ose më shumë veprime të qëllimshme që i bënë një person personit tjetër me të cilin është apo ka qenë në marrëdhënie familjare, duke përdorur forcën fizike ose presionin psikik të ushtruar ndaj anëtarit tjetër të familjes,
- shkaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale apo cenimi i dinjitetit,
- sulmi fizik pa marr parasysh pasojat,
- -ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë,
- përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të përruljes së personit tjetër,
- marrëdhënia seksuale pa pëlqim dhe keqtrajtimi seksual,
- kufizimi i kundërligjshëm i lirisë së lëvizjes ndaj personit tjetër,
- dëmtimi apo shkatërrimi i pasurisë dhe kanosja që ta bëjë këtë,
- vënia e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen fizike, emocionale dhe ekonomike,
- hyrja apo largimi me dhunë nga Banesa e përbashkët apo banesën e personit tjetër,
- rrëmbimi.

Kryerës i dhunës në familje është personi i cili ka kryer një apo më tepër vepra të dhunës në familje, ndërsa viktimë është personi i cili i është nënshtruar dhunës në familje³⁶⁹.

Gjykata si organ kompetent

Lidhur me kërkesën e palës së mbrojtur vendos Gjykata Komunale, në territorin e të cilës pala e mbrojtur e ka vendbanimin apo vendqëndrimin, me ç' rast kjo gjykatë është kompetente që pas shqyrtimit të kërkesës të jep urdhër për mbrojtje ose urdhër për mbrojtje emergjente. Me urdhër mbrojtje ose me urdhër për mbrojtje emergjente shqiptohen masat me të cilat do të parandalohet dhuna në familje të cilës dhunë i është ekspozuar personi përkatësisht pala e mbrojtur³⁷⁰.

Gjykata me urdhër mbrojtje apo me urdhër mbrojtje emergjente mund t'i shqiptojë një apo më tepër masa mbrojtëse, e masat mbrojtëse janë:

³⁶⁹ Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje neni 2 pika 1.5. dhe 1.6.

³⁷⁰ Juridiksionin e gjykatës dhe masat mbrojtëse i ka rregulluar neni 3 par. 1 dhe par. 4 i Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje.

- trajtimi psikosocial,
- ndalimi i ofrimit viktimës së dhunës në familje,
- ndalimi i shqetësimit personave të ekspozuar dhunës,
- largimi nga banesa, shtëpia apo hapësira tjetër e banimit,
- shoqërimi viktimës së dhunës,
- trajtimi mjekësor nga varësia prej alkoolit dhe substancave psikotropike,
- marrja e sendit, si dhe
- masat mbrojtëse pasurore.

Akti me të cilin kërkohet mbrojtja nga dhuna në familje quhet KËRKESË, e cila mund të ushtrohet përmes përfaqësuesit të autorizuar si dhe përmes mbrojtësit të viktimave. Kërkesën për urdhër mbrojtje ose urdhër mbrojtje emergjente mund ta paraqesë³⁷¹:

- pala e mbrojtur,
- përfaqësuesi i autorizuar i palës së mbrojtur,
- mbrojtësi i viktimave me pëlqimin e palës së mbrojtur,
- përfaqësuesi i Qendrës për Punë Sociale në Komunën ku pala e mbrojtur ka vendbanimin, apo vendqëndrimin në rastet ku viktimë është i mituri, si dhe
- OJQ-të që janë familjarizuar me problemin e viktimës.

Për veç këtyre personave kërkesën për dhënien e urdhrit për mbrojtje emergjente mund ta ushtrojnë edhe personi me të cilën pala e mbrojtur ka lidhje familjare dhe personi i cili është në dijeni të drejtpërdrejtë për një apo më tepër vepra të dhunës në familje ndaj palës së mbrojtur.

Kërkesa për urdhër mbrojtje ose urdhër mbrojtje emergjente paraqitet me shkrim ose gojarisht, ndërsa gjykata lidhur me këto kërkesa duhet të vendos brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve. Me rastin e vendosjes lidhur me kërkesën prezent duhet të jenë: pala e mbrojtur, përfaqësuesi i autorizuar ose mbrojtësi i viktimave, kryesi i dhunës ose përfaqësuesi i autorizuar, parashtruesi i kërkesës, përfaqësuesi i Qendrës për punë Sociale i Komunës në të cilën jeton përherë ose përkohësisht parashtruesi i kërkesës i moshës 18 (tetëmbëdhjetë) vjet, ose nuk ka zotësi të veprimit dhe dëshmitarët të cilët gjykata i konsideron të domosdoshëm. Gjykata e shqyrton kërkesën për urdhër mbrojtje emergjente brenda 24 (njëzet e katër) orëve³⁷² pas

³⁷¹ Neni 13 par. 1 të Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje

³⁷² Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje neni 16 par. 1.

parashtrimin të kërkesës. Brenda këtij afati gjykata mban seancë në të cilën duhet të jenë prezent për veç palëve si tek urdhri për mbrojtje, sipas nevojës mund të bëhet shqiptimi i urdhrit mbrojtës në mungesë të kryesit të dhunës në familje duke shfrytëzuar edhe mjetet tjera alternative duke përfshirë edhe ato elektronike.

Pas mbajtjes së seancës gjykata merr aktvendim, i cili duhet të ekzekutohet menjëherë. Vendimi iu dërgohet dhe atë: kryesit të dhunës në familje, Policisë së Kosovës, Qendrës për punë sociale si dhe palëve të tjera në procedurë. Aktvendimi përmban masën mbrojtëse, mos zbatimi i urdhrit mbrojtës është vepër penale, kohëzgjatja e urdhrit për mbrojtje nuk mund të jetë më e gjatë se 12 (dymbëdhjetë) muaj, por me mundësi vazhdimi deri në 24 (njëzetë e katër) muaj. Te urdhri për mbrojtje emergjente është karakteristikë se brenda 8 (tetë) ditëve, nga dita e dhënies së këtij urdhri duhet të bëhet verifikimi i urdhrit për mbrojtje emergjente.

Mjeti juridik³⁷³

Kundër aktvendimit të urdhrit për mbrojtje mund të ushtrohet ankesë brenda afatit 8 (tetë) ditor, nga dita e pranimit, ndërsa kundër aktvendimit të urdhrit për mbrojtje emergjente pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese brenda afatit prej 3 (tri) ditësh, nga dita e pranimit të vendimit, mirëpo ankesa nuk e ndalon ekzekutimin e urdhrit mbrojtës apo urdhrit për mbrojtje emergjente. Varësisht prej rrethanave dhe propozimit të palës së mbrojtur, gjykata vendos që urdhri për mbrojtje dhe urdhri për mbrojtje emergjente të mbetet në fuqi, të ndryshohet apo të hiqet.

Gjatë kohës kur nuk punon gjykata në bazë të kërkesës - Policia e Kosovës jep urdhër të mbrojtjes së përkohshme emergjente. Ky urdhër zgjat deri në fund të ditës së ardhshme kur punon gjykata. Shqiptimin e këtij urdhri e bënë Shefi i njësitit Rajonal të Policisë së Kosovës dhe ky urdhër ka për qëllim sigurimin e shëndetit dhe mirëqenien e palës së mbrojtur.

Shkelja e urdhrave mbrojtës³⁷⁴

Mos zbatimi dhe shkelja qoftë pjesërisht ose në tërësi e urdhrave për mbrojtje, urdhrave për mbrojtje emergjente ose për mbrojtje të përkohshme emergjente paraqet vepër penale, të dënueshme me dënim me gjobë prej 200

³⁷³ Mjetin juridik e rregullon neni 19 i Ligjit për mbrojtje nga dhuna në familje

³⁷⁴ Neni 25 i Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje

(dyqind) € deri në 2000 (dy mijë) €, apo me burgim deri në 6 (gjashtë) muaj, dhe se ndjekja për këto vepra penale bëhet ex officio. Përsëritja e shkeljes së urdhrave konsiderohet rrethanë rënduese për kryerësin e veprës penale.

Në fund do theksuar se me qëllim të zvogëlimit të rasteve të dhunës në familje, duhet të angazhohen të gjitha subjektet e shoqërisë si: Institucionet Arsimore lidhur me vetëdijesimin e popullatës shkollore për rëndësinë e familjes dhe pasojat që rrjedhin nga përdorimi i dhunës në familje, ngase familja e shëndoshë do të thotë edhe shoqëria e shëndoshë. Pastaj Institucionet tjera përkatëse për sigurimin e kushteve për strehimin dhe trajtimin e duhur të personave viktimë e dhunës në familje. Po ashtu edhe Gjykatat duhet me kohë dhe brenda afateve të përcaktuara ligjore t'i trajtojnë lëndët që kanë të bëjnë me dhunën në familje, për shkak të rrezikut në të cilin ndodhen viktimat e kësaj dhune.



Islam Azemi



Behar Ymeri

ADOPTIMI, ME NJË VËSHTRIM TË VEÇANTË NË TË DREJTËN TONË

Historik i shkurtër

Adoptimi (birësimi) është një institut i lashtë juridik dhe shoqëror. Në kuptimin sociologjik, adoptimi paraqitet qysh para lindjes së shtetit dhe të drejtës, por që ka ndryshuar me zhvillimin e shoqërisë³⁷⁵. Nga aty janë edhe karakteristikat e këtij instituti dhe qëllimet e tij kanë qenë të ndryshme në periudha dhe vende të ndryshme. Për këtë arsye edhe në kohën tonë ky institut është rregulluar juridikisht në mënyrë të ndryshme në vende të ndryshme³⁷⁶.

Ky institut ka qenë i njohur që në Romën e lashtë, në Greqi, Egjipt, Mesopotomi dhe Babiloni. Gjatë kohës, ka ndryshuar edhe qëllimi i adoptimit, si p.sh. në kohën e lashtë qëllim dominues i adoptimit të fëmijëve të kushërinjve ose fëmijëve të proletarëve të varfër, ka qenë nevoja e mbrojtjes së pasurisë së qytetarëve të pasur dhe ruajtja e vazhdimësisë së familjes, të traditës dhe të kultit të familjeve të qytetarëve pa fëmijë.

Kjo tregon se adoptimi i meshkujve madhorë atëherë nuk bëhej për mbrojtjen e interesave të të adoptuarit, por para së gjithash për shfrytëzimin e punës së tij dhe për mbrojtjen e interesave të gjenit, pra të familjes e cila adoptonte (birësonte) personat meshkuj madhorë³⁷⁷. Disa vende të botës nuk e njohin adoptimin si institut juridik dhe shoqëror. Madje, adoptimi është i ndaluar edhe me norma ligjore.

³⁷⁵ Vojislav Bakić, E Drejta Familjare fq. 267

³⁷⁶ Po aty, fq. 268

³⁷⁷ Prof. Dr. Hamdi Podvorica, E Drejta Familjare, fq. 203

Në vendet ku u zhvillua ky institut i rëndësishëm ka dominuar qëllimi privat juridik i adoptimit, ndonëse ka qenë i shprehur edhe qëllimi i tij shoqëror.

Nuk ka dyshim se adoptimi ka rëndësi edhe për birësuesit, ngase ata në këtë mënyrë plotësojnë dëshirat e veta për të qenë prindër dhe për të pasur fëmijë³⁷⁸.

Pengesën objektive të quajtur mospasje të fëmijëve, pa të cilën askush nuk ka mundur të bëhej prind, ata e eliminojnë me rrugë ligjore, duke i adoptuar fëmijët e mitur të lindur nga persona të tjerë dhe të mbetur pa përkujdesje prindërore.

Në shekullin e kaluar, ndryshe nga kohët e lashta, qëllimi parësor i adoptimit bëhet mbrojtja e interesave të fëmijëve të mitur në legjislacionet e shumë vendeve të botës, pra ndryshon qëllimi i adoptimit. Arsyet janë nga më të shumtat, sepse pas luftës së dytë botërore, një numër i madh i fëmijëve të mitur mbetën bonjakë (jetimë), pa përkujdesjen e domosdoshme të prindërore.

Në të drejtën e tanishme, adoptimi është një mënyrë shoqërore e mbrojtjes së fëmijëve të mitur. Qëllimi kryesor i adoptimit është që fëmijët pa prindër të fitojnë mbrojtjen prindërore dhe përkujdesjen, dhe që ata persona nga arsye të ndryshme nuk kanë fëmijë, të mundën ta kompensojnë këtë me adoptimin e fëmijëve të huaj³⁷⁹.

Mirëpo, që kjo mënyrë e mbrojtjes së fëmijëve të realizohet, duhet që ajo të bëhet në rrugën ligjore. Duke pasur parasysh pasojat juridike që shkakton adoptimi, shkallën e integritetit të të adoptuarit në familjen e adoptuesit, doktrina juridike njihë dy lloje të adoptimit: 1. adoptimin e plotë dhe 2. Adoptimin jo të plotë.

Adoptimi i plotë (adoptio plena). Adoptimi i plotë themelohet kur në mes adoptuesit dhe të adoptuarit krijohen marrëdhënie të njëjta sikurse mes prindërve natyror dhe fëmijëve, por edhe në raport me persona të tjerë si në gjini gjaku. I adoptuari shkëput plotësisht lidhjet me familjen e tij të origjinës. Ai hyn në familjen e adoptuesit, me të drejta dhe detyrime të plota sikurse të kishte lindur nga vetë adoptuesi.

³⁷⁸ Po aty

³⁷⁹ Veliki Pravni Prirucnik 2, Beograd 1972, fq 848

Me adoptimin e plotë fëmija humb të gjitha të drejtat dhe detyrimet ndaj të afërme biologjikë, si: të drejtat familjare, trashëgimore dhe të drejtat e tjera. Mirëpo, në të njëjtën kohë, këto të drejta dhe detyrime i fiton ndaj adoptuesit dhe të afërmeve të tij biologjikë.

Adoptimi jo i plotë (adoptio semi plena). Me adoptim jo të plotë duhet kuptuar vendosjen e marrëdhënieve prindërore vetëm mes adoptuesit dhe fëmijës që adoptohet si dhe pasardhësve të fëmijës, mirëpo te ky lloj i adoptimit janë të mundshme kufizimet që kanë të bëjnë me të drejtat lidhur me mbiemrin dhe të drejtën trashëgimore. Te ky lloj i adoptimit fëmija edhe më tej mbetet anëtar i familjes së vet biologjike. Kjo do të thotë se fëmija i adoptuar edhe më tej ruan marrëdhëniet gjinore me familjen e origjinës dhe me persona të tjerë në gjini të gjakut. Adoptimi jo i plotë është i shkëputshëm, ndërsa adoptimi i plotë është i pashkëputshëm³⁸⁰.

Adoptimi në të drejtën tonë ligjore

Ligji për Familjen i Kosovës, nuk e bënë ndarjen në adoptim të plotë dhe adoptim jo të plotë. Duke mos i pasur parasysh kriteret e njohura dhe të pranuar shkencore, rregullimi normativ i institutit të adoptimit në të drejtën tonë është specifik, dallon nga shumë të drejta të tjera, ngase përzier karakteristikat dhe veçoritë e veçanta të dy llojeve të birësimit, gjë kjo që është në pajtueshmëri me traditën dhe përvojën historike të zhvillimit të adoptimit³⁸¹.

Sipas nenit 167 të Ligjit për Familjen i Kosovës, me adoptim mes palës adoptuese dhe të adoptuarit themelohen të njëjtat të drejta dhe detyrime që ekzistojnë mes prindërve dhe fëmijëve³⁸². Me adoptim fëmija shkëput lidhjet me familjen e origjinës. Në bazë të nenit 11.1 të Ligjit për Trashëgimin e Kosovës, i adoptuari trashëgon në mënyrë të barabartë sikurse edhe pasardhësit i tij. Pra, ai humb të drejtën që të trashëgojë në familjen e origjinës prej momentit të adoptimit³⁸³.

Kush mund të jetë i adoptuar. Për të adoptuar një person duhet të plotësohen disa kushte: a) të jetë i lindur gjallë, b) të jetë fëmijë i mitur, c) të mos jetë në gjini gjaku me adoptuesin. Vetëm fëmija i lindur gjallë mund të adoptohet. Sipas nenit 189 të LFK, nuk mund të ketë themelim të adoptimit

³⁸⁰ Prof. Dr. Hamdi Podvorica, E Drejta Familjare fq. 205

³⁸¹ Po aty, fq.205

³⁸² LFK, neni 167

³⁸³ Ligji për Trashëgimin e Kosovës, neni 11.1

pas vdekjes së fëmijës. Sipas nenit 166 të LFK-së, është paraparë një periudhë provuese tremujore brenda së cilës duhet të provohet nëse mundet apo nuk mundet të arrihet qëllimi i adoptimit.

Nëse gjatë kësaj kohe provuese, mund të konstatohet se mund të arrihet qëllimi i adoptimit atëherë mund të lidhet adoptimi. Periudha provuese, do të iniciohet, mbikëqyret dhe vlerësohet vazhdimisht nga Organi i Kujdestarisë që gjykatës i siguron raport sipas nevojës. Disa vende kanë paraparë që fëmija mund të adoptohet vetëm pasi që të ketë mbushur moshën e caktuar me ligj. P.sh. Britania e Madhe ka paraparë që fëmija mund të adoptohet pasi të ketë mbushur moshën 6 mujore të jetës, Çekosllovakia – një vit. Me nenin 169 të LFK, është paraparë që pëlqimi për adoptim nuk mund të jepet para se fëmija të ketë mbushur tetë javë të jetës³⁸⁴.

Kusht tjetër për të adoptuar fëmijën është që fëmija i cili adoptohet të jetë i mitur. LFK ka paraparë në nenin 174 se mund të adoptohet vetëm fëmija i mitur. Mosqenia në gjini gjaku. Nuk mund të adoptohet fëmija i mitur që është në gjini gjaku me adoptuesin. Ky ndalim ka të bëjë me personat në gjini gjaku në vijë të drejtë pa kufij, pavarësisht nga shkalla e afërsisë, pra për të gjithë të paralindurit dhe të paslindurit. Po ashtu nuk mund të adoptojë as vëllai as motra vëllaun apo motrën e vet.

Kjo do të thotë se adoptimi është i ndaluar edhe mes personave në gjini gjaku në vijë të tërthortë deri në shkallë të dytë. Në nenin 177 të LFK-së, është paraparë se nuk mund të adoptohet personi në vijën e drejtë, as vëllai dhe motra. Kujdestari nuk mund të adoptojë të kujdesurin e vet përderisa organi kompetent të mos e shkarkoj nga detyra e kujdestarit³⁸⁵. Kush mund të jetë adoptues. Edhe adoptuesi duhet ti plotësoj disa kushte për të mundur me adoptuar fëmijën e mitur.

Ai duhet të plotësojë këto kushte, të cilat janë të precizuara me dispozita ligjore:

1. Adoptuesi duhet të ketë zotësinë për të vepruar,
2. Të ketë cilësitë e nevojshme personale për ushtrimin e suksesshëm të të drejtave dhe detyrimeve prindërore (neni 175 i LFK),

³⁸⁴ LFK, neni 189, neni 166, neni 169

³⁸⁵ prof Dr. Hami Podvorica, E Drejta Familjare fq. 2007

3. Të mos vuajë nga ndonjë sëmundje psikike e diagnostifikuar ose ka gjecje në pikëpamje psikike si dhe personi që lëngon nga ndonjë sëmundje ngjitëse që do të rrezikonin shëndetin e fëmijës,
4. Të ketë mbushur moshën 21 vjeçare.

Fëmijën e mitur mund ta adoptojnë edhe bashkëshortët. Në rastet kur bashkëshortët adoptojnë fëmijë, njëri prej tyre duhet të ketë mbushur moshën 25 vjeçare kurse tjetri moshën 21 vjeçare (neni 176 par. 1 dhe 2 i LFK). Nëse fëmijën e adopton vetëm njëri nga bashkëshortët, atëherë kërkohet edhe pëlqimi i bashkëshortit tjetër. Mirëpo, mund të ndodhë që njëri bashkëshort ta adoptojë fëmijën e bashkëshortit tjetër.

Në këtë rast fëmija i adoptuar, fiton statusin e fëmijës së përbashkët të bashkëshortëve. Po ashtu, është e nevojshme që të ekzistoj edhe dallimi në moshë në mes të fëmijës së mitur dhe adoptuesit, sepse me adoptim krijohet ato raporte që krijohen në mes të prindërve dhe fëmijëve. Diferenca tepër e madhe në moshë mes adoptuesit dhe të adoptuarit, nuk është e lejueshme, ngase ndryshimi i theksuar në moshë pengon qëllimin e vërtetë që synon adoptimi³⁸⁶.

Pëlqimi i prindërve. Sipas dispozitave ligjore, kur fëmija i mitur ka gjallë të dy prindërit, ose njërin prej tyre kërkohet pëlqimi i tyre për adoptimin e fëmijës. Dhënia e pëlqimit ka rëndësinë e heqjes dorë nga e drejta prindërore. Sipas nenit 172 të LFK, deklarata e pëlqimit duhet ti deklarohet gjykatës dhe bëhet e plotfuqishme në kohën e dorëzimit.

Pëlqimi nuk mund të bëhet me kusht dhe me përcaktimin e kohës e as mund të bëhet nga përfaqësuesi. Ky pëlqim është i përvokueshëm, por mund të anulohet nëse është dhënë në lajthitje, shtrëngim ose mashtrim. Duke pasur parasysh faktin se adoptimi është në funksion të mbrojtjes së interesave të fëmijës të mitur dhe pa përkujdesje prindërore, kur është fjala për fëmijët e braktisur dhe lënë pa përkujdesje prindërore, ligjvënësi ka përcaktuar afatin kohor prej një viti për kthimin e prindit dhe për dhënien e pëlqimit për adoptim, por nëse brenda këtij viti prindi nuk kthehet dhe nuk jep pëlqimin për adoptim, adoptimi mund të bëhet edhe pa pëlqimin e tij, sepse pritja më e gjatë do të cenonte interesat e fëmijës³⁸⁷.

³⁸⁶ LFK, neni 175, neni 176.1.2, neni 172

³⁸⁷ Prof. Dr. Hamdi Podvorica, E Drejta Familjare, fq. 209

Procedura e adoptimit

Procedura e adoptimit është në kompetencë të gjykatës. Gjykata mund të kërkojë këshilla nga organi i kujdestarisë gjatë marrjes së vendimit mbi adoptim. Adoptimi themelohet me akt juridik. Ai themelohet në procedurë jo kontestimore para gjykatës me parashtrimin e propozimit nga prindi adoptues. Kompetenca tokësore për themelimin e adoptimit caktohet në bazë të vendbanimit të adoptuesit ose ku ata e kanë pasur vendbanimin e fundit të përbashkët si dhe para gjykatës sipas vendbanimit të të adoptuarit.

Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave

Në procedurën e adoptimit përjashtohet publiku. Kjo bëhet për faktin se duhet të ruhen interesat e fëmijës së mitur që adoptohet dhe ruajtja e fshehtësisë. Procesverbali dhe dokumentet e themelimit të adoptimit paraqesin sekret zyrtar. Vendimi për adoptim u dorëzohet vetëm palëve të cilat marrin pjesë në procedurën e adoptimit në pajtim me ligjin. Gjykata kompetente dhe Organi i kujdestarisë janë përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave dhe privatësinë e informacioneve, të mbledhura gjatë procesit të adoptimit³⁸⁸.

Shtetësia

Adoptues mund të jetë vetëm qytetari i Kosovës, përjashtimisht shtetasi i huaj mund të jetë palë adoptuese nëse fëmija nuk mund të adoptohet në Kosovë dhe ekzistojnë arsye të bazuara për veprimin e tillë nëse fëmija ka nevoja të veçanta dhe ka nevojë për trajtim të specializuar, që nuk mund ti ofrohet në Kosovë. Procedura për iniciimin e kërkesës për adoptim. (neni 182 i LFK).

Procedura për adoptim fillon me propozimin për adoptim nga ana e personit adoptues. Personi i cili kërkon të adoptojë, së bashku me prindërit e fëmijës së mitur që do të adoptohet, propozimin ia dorëzojnë gjykatës. Propozimit i bashkëngjitet pëlqimi i shkruar i prindërve biologjikë të fëmijës dhe dokumentet e tjera relevante. Pas paraqitjes së kërkesës në gjykatë, gjykata e përcjell lëndën për vlerësim profesional në Qendrën për Punë Sociale. Menaxheri i rastit, i caktuar nga QPS për vlerësimin e familjes, duhet të kërkojë nga prindërit adoptues ti plotësojnë dokumentet e nevojshme.

³⁸⁸ LFK, neni 162

Prindërit të cilët duan të adoptojnë fëmijë duhet ti dorëzojnë në MPMS këto dokumente:

kërkesën me shkrim të prindërve potencial adoptues, certifikatën e lindjes (për të dy prindërit), certifikatën e martesës (jo më të vjetër se gjashtë muaj), certifikatën e mjekut me të cilën dëshmohet aftësia e prindërve potencialë adoptues për adoptim të fëmijës, mendimin e psikologut (përshkrim i detajuar për prindërit potencialë adoptues), mendimin e ekspertëve profesionalistë nga shërbimi profesional brenda QPS, certifikatën ose vërtetimin mbi gjendjen ekonomike (përfshirë pasurinë), dokumentin mbi të ardhurat personale të prindërve adoptues (kontratat e punës, certifikatat për ushtrimin e veprimtarisë/biznesit etj.) fotokopjet e dokumenteve të identifikimit (letërnjoftimin), certifikatën nga gjykata se prindërit adoptues nuk janë nën hetime për ndonjë vepër penale, certifikatën nga gjykata me të cilën vërtetohet se nuk i është marrë e drejta prindërore dhe zotësia e veprimit³⁸⁹.

Gjykata ka të drejtë të mbledhë të dhëna dhe dëshmi të tjera nga organi i kujdestarisë, nga shërbimet shoqërore dhe nga ekspert të tjerë në lëmin e përkujdesjes së fëmijës mbi kushtet e adoptimit.

Miratimi i kërkesës për adoptim

Nëse gjykata konstaton se janë plotësuar kushtet për adoptim të parapara me LFK, do të themelojë adoptimin. Për themelimin e adoptimit nevojitet prania e adoptuesit, e bashkëshortit të tij, e prindërve, përkatësisht kujdestarit të të adoptuarit, si dhe prania e të adoptuarit kur është më i vjetër se 10 vjet, me përjashtim kur deri në këtë moshë ka qenë në kujdes juridik, ruajtje dhe edukim te personi që dëshiron të adoptojë.

Deklarata e pëlqimit të palëve pjesëmarrëse duhet të shënohet në procesverbalin e procedurës. Pas përfundimit të procedurës së adoptimit duhet të nënshkruhet procesverbali nga palët dhe duhet t'u lexohet personave prezentë. Gjykata është e detyruar që të mbajë të gjitha shënimet dhe ti ruaj dokumentet për personat e adoptuar dhe procesin e adoptimit.

³⁸⁹ Gazeta "Kosova sot" dt. 12 korrik 2011, fq 8-9 –vaji që e përcjell nënën gjithë jetën

Regjistrimi

Në bazë të nenit 188 të LFK, gjykata kompetente ia dërgon menjëherë procesverbalin për themelimin e adoptimit organit kompetent për regjistrim në librin amëz të të lindurve, palës dhe organit të kujdestarisë. Adoptuesi regjistrohet si prind i të adoptuarit. Me këtë rast organi i kujdestarisë mund të ndryshojë emrin e parë të fëmijës ose atij t'ia bashkëngjisë një ose më shumë emra të tjerë. Ai mund ta bëjë këtë vetëm kur konstaton se është në interesin më të mirë të fëmijës³⁹⁰.

Periudha provuese

Adoptimi, si rregull nuk do të themelohet derisa adoptuesi të kujdeset për fëmijën për një kohë të arsyeshme të përcaktuar nga gjykata por që nuk kalon periudhën tre mujore. Kjo periudhë kohore do të iniciohet, mbikëqyret dhe vlerësohet vazhdimisht nga Organi i Kujdestarisë e cila gjykatës i siguron raport sipas nevojës. Gjykata merr vendim në fund të gjykimit. Mirëpo, gjykata mund të vazhdoj gjykimin për një periudhë shtesë deri në tre muaj nëse në mes palëve ka mospajtime ose për shkak të rrethanave të tjera të arsyeshme, të cilat janë vënë në dijeni nga organi i kujdestarisë ose nga ekspertët për fëmijë të përfshirë në procedurë³⁹¹.

Refuzimi i kërkesë për adoptim

Nëse gjykata, pas çmuarjes së të gjitha rrethanave dhe provave të siguruara dhe mendimit të marrë sipas detyrës zyrtare, gjen se adoptimi do të jetë i dëmshëm për të adoptuarin, apo se me adoptim do të dëmtohen interesat e fëmijës që adoptohet, ajo me aktvendim do ta refuzojë kërkesën për adoptim.

Shuarja e adoptimit

Me nenin 198 të LFK, është paraparë mundësia që adoptimi të shuhet ex officio, që nënkupton faktin se adoptimi është i shkëputshim. Gjykata kompetente mund të shuajë marrëdhënien e adoptimit me procedurë të veten, nëse për çfarëdo arsye kjo bëhet e nevojshme për mirëqenien e fëmijës³⁹².

³⁹⁰ LFK, neni 188

³⁹¹ LFK, neni 166

³⁹² LFK, neni 198

Pasojat e shuarjes

Sipas nenit 199, shuarja e adoptimit ka efekt vetëm në të ardhmen. Me shuarjen e adoptimit marrëdhënia e fëmijës dhe pasardhësve të tij me kushërinjtë e mëparshëm bazuar në adoptim ndërprehet së bashku me të drejtat dhe detyrat e krijuara³⁹³.

Pasojat në mbiemër. Me shuarjen e adoptimit, fëmija humb të drejtën që të bartë mbiemrin e adoptuesit si mbiemër të tij. Gjykata kompetente mundet me kërkesë të fëmijës, të vendosë që fëmija të mbajë mbiemrin që ka fituar përmes adoptimit, nëse fëmija ka interes të arsyetuar që ta bartë këtë mbiemër³⁹⁴.

Adoptimi - si parashihet me Konventën evropiane për adoptim

Sipas Konventës Evropiane për Adoptim (2008) dhe Konventës Evropiane për Adoptimin e Fëmijëve të vitit 1967, parashikohet adoptimi i fëmijës, i cili në momentin paraqitjes së kërkesës për adoptimin e tij/saj nga ana e adoptuesit, të mos ketë mbushur moshën 18 vjeçare, të cilët nuk janë dhe nuk kanë qenë në martesë, nuk janë dhe nuk kanë hyrë në partnership të regjistruar (këtë e parasheh vetëm Konventa e re evropiane për adoptim e vitit 2008) dhe sipas ligjit mos të llogariten madhor³⁹⁵.

Praktika aktuale e adoptimit të fëmijëve në Kosovë

Një Raport i OSBE-së (Edicioni i gjashtë - gusht 2010) për adoptimin e fëmijëve në Kosovë, zbulon një shumëllojshmëri konfuzë të praktikave. Në këtë raport thuhet se, birësimet nuk gjykohen ekskluzivisht nga gjykatat, siç parashihet me Ligjin për Familjen, përderisa gjykatat gjykojnë disa raste të birësimit, shumica e birësimeve sot gjykohen nga organet administrative, në rend të parë nga QPS-të, por në disa raste nga Paneli për Vendosijen e Fëmijëve pa Përkujdesje Prindërore në Strehim dhe Birësim (Adoptim), i cili panel është themeluar me Udhëzimin Administrativ Nr. 5/2006, nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, që vepron sipas autoritetit në kuptim të këtij udhëzimi.

Prandaj, në këtë raport më tej thuhet se, OSBE është në veçanti e brengosur për këtë praktikë për tri arsye.

³⁹³ LFK, neni 199

³⁹⁴ LFK, neni 200

³⁹⁵ Arta Selmani Adoptimi – mbrojtja juridike për fëmijët pa prindër.... material i marrë nga interneti fq. 8

Së pari, Udhëzimi Administrativ është një urdhër i lëshuar nga dega e ekzekutivit, dhe si i tillë është formë detyësore ose plotësuese e legjislativit. Është shkelje serioze e sundimit të ligjit që të lejohet një legjislacion plotësues ta mbizotërojë legjislacionin parësor me të cilin është drejtpërdrejtë në konflikt.

Së dyti, Udhëzimi Administrativ ishte lëshuar në bazë të Ligjit mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare në kohën kur ky i fundit ka përfunduar së rregulluari çfarëdo kategorie të birësimeve, pasi që Ligji për Familjen hyri në fuqi katër muaj të plota para lëshimit të Udhëzimit Administrativ.

Së treti, tipari qendror i Udhëzimit Administrativ është dallimi që bënë ndërmjet dy kategorive të fëmijëve, fëmijëve të braktisur dhe atyre prindërit e të cilëve janë të njohur, një dallim që përmban diskriminimin pa kurrfarë justifikimi të arsyeshëm, dhe i cili, si i tillë shkel ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, konstatohet në këtë raport³⁹⁶.

Adoptimet brenda Kosovës

Ligji për Familjen nuk bënë dallim ndërmjet procedurës që duhet të ndiqet në rast të fëmijës së braktisur dhe procedura që duhet të ndiqet në rast të fëmijës prindërit e të cilit janë të njohur (përveç pjesëve të veçanta lidhur me atë se si duhet të iniciohet kërkesa për birësim – neni 182 i LFK). Përkundër kësaj, OSBE ka mësuar se në Kosovë është de facto i vendosur sistemi i adoptimit në dy nivele, ku shumica e rasteve që përfshijnë fëmijët prindërit e të cilëve janë të njohur gjykohen nga gjykatat, ndërsa shumica e rasteve që përfshijnë fëmijët e braktisur vendosen ose nga QPS-të ose nga paneli për vendosjen e fëmijëve, që është në kundërshtim si me Ligjin për Familjen ashtu edhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut³⁹⁷.

Përfundimi

Në përfundim të këtij raporti të OSBE, nxirret ky konstatim: Korniza ligjore në Kosovë parasheh që birësimet të gjykohen nga gjykatat. Kur organet administrative vazhdojnë të vendosin birësimet përkundër mungesës së mandatit ligjor, sundimi i ligjit zbehet në masë. Kur ato e bëjnë këtë, mbështetur në institucionin e legjislacionit detyësor, i cili bie drejtpërdrejtë

³⁹⁶ Raporti i OSBE – Edicioni i 6, 2010, Procedura e birësimit të fëmijëve në Kosovë, - Seksioni për Monitorimin e Sistemit Juridik, fq.8

³⁹⁷ po aty, fq. 8

në konflikt me legjislacionin parësor që rregullon fushën e birësimeve, ndarja e pushteteve – aq vitale për funksionim të çfarëdo shoqërie demokratike – dobësohet. Kur kjo praktikë bëhet me aprovim të heshtur të gjykatave, pavarësia e gjyqësorit vihet në pikëpyetje.

Kjo do të thotë se praktika aktuale për adoptime bie në kundërshtim me ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, në radhë të parë për shkak se përbënë shkelje të kornizës ligjore në Kosovë. Masa më e mirë për mbrojtje të të drejtave të njeriut në çfarëdo shoqërie është ajo se në çfarë mase janë ato mbrojtje në dispozicion të anëtarëve më të ndjeshëm të shoqërisë. Fëmijët e braktisur janë në mes anëtarëve më të ndjeshëm të shoqërisë në Kosovë, dhe si të tillë duhet t'u jepet mbrojtja maksimale që është në dispozicion sipas ligjit. Kur institucionet zgjedhin të përjetësojnë atë që në efekt është sistem diskriminues i birësimeve në dy nivele, ku fëmijët e braktisur bien në nivelin e poshtëm, komprometohet zotimi i Kosovës për të drejtat e njeriut³⁹⁸.

³⁹⁸ po aty, fq. 15



Lutfi Shala



Nehat Qelaj

I DËMTUARI - AUTORIZIMET DHE TË DREJTAT E TIJ NË PROCEDURË PENALE

Me rastin e kryerjes së veprës penale përveç interes të përgjithshëm, në të shumtën e rasteve, cenohen edhe interesat e personave fizik. Në fakt, nga kryerja e veprave penale të ndryshme personave të caktuar mund të shkaktojë pasoja në dëmtimin dhe cenimin e vlerave të personit apo të personave ndaj të cilëve ato janë drejtuar. Në këtë aspekt personi i dëmtuar me veprën penale ka të drejtë të kërkojë procedimin e fajtorit, mbrojtjen e interesave të veta personale dhe të kërkojë zgjidhjen e kërkesës pasurore juridike që rezulton nga vepra penale.

Sipas Kodit të Procedurës Penale më tej KPPK-së, i dëmtuar është personi të cilit çfarëdo e drejte personale ose pasurore i është shkelur ose i është rrezikuar me veprën penale³⁹⁹.

Pozita procedurale e të dëmtuarit gjatë zhvillimit historik të procedurës penale ka shënuar një lëvizje graduale, e cila karakterizohet me posedimin e autorizimeve të caktuara për realizimin e funksionit të ndjekjes.

Në të drejtën bashkëkohore, duke pasur parasysh faktin se edhe pse ndjekja penale në të shumtën e rasteve bëhet sipas detyrës zyrtare nga prokurori publik, megjithatë edhe të dëmtuarit në një mase të caktuar i jepet mundësia të ndikoj në rrjedhën e procedurës penale.

Bazuar në parimin akuzator të procedurës penale dhe dispozitave të KPPK-së funksionin e ndjekjes në procedurë e ushtron paditësi i autorizuar dhe procedura për ndjekje fillohet vetëm me kërkesën e paditësit të autorizuar. Sipas KPPK-së si paditës i autorizuar për ushtrimin e këtij funksioni është prokurori publik për vepra penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare e për disa vepra penale procedura mundë të filloj vetëm me propozimin e të dëmtuarit.

³⁹⁹ KPPK neni 151 par. 5

Njëherit dispozitat e këtij kodi të dëmtuarit i japin autorizime që ai vetë të inicioj procedurën-ndjekjen penale si paditës subsidiar, për veprat që ndiqen sipas detyrës zyrtare por që prokurori nuk ka filluar, ka pushuar apo është tërheq nga ndjekja penale dhe si paditës privat për vepra penale të caktuar sipas kodit penal ku ndjekja penale fillohet me padi private.

Pra sipas dispozitave të KPPK, “Paditës i autorizuar”⁴⁰⁰ është prokurori publik, paditësi privat ose paditësi subsidiar. Ndërsa “Paditës subsidiar”⁴⁰¹ është i dëmtuari i cili, nën kushtet e parapara me këtë Kod, ushtron ndjekjen për vepra penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare, dhe “Paditës privat”⁴⁰² është i dëmtuari, i cili ushtron ndjekjen për vepra penale për të cilat ligji penal parasheh padi private.

I dëmtuari⁴⁰³ si palë në procedurë mund të paraqitet edhe me rastin e paraqitjes së kërkesës pasurore juridike dhe ankesës.

I dëmtuari si paditës subsidiar

Prokurori publik si subjekt themelor i procedurës penale ka për detyrë të ndjek kryesin e veprës penale të cilat ndiqen ex officio kur çmon se janë plotësuar kushtet ligjore për ndjekje. Mirëpo në disa raste prokurori publik mund të arrij në përfundim që në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për ndjekje, në një situatë të tillë prokurori mund të mos e filloj ndjekjen apo edhe të tërhiqet nga ndjekja e filluar.

Në këtë drejtim Kodi i Procedurës Penale ka paraparë mundësinë që i dëmtuari, përveç rasteve kur prokurori publik pezullon, pushon ose shmanget nga ndjekja penale (nenet 226 dhe 227) apo nëse prokurori publik gjen se nuk ka vend për ndjekje penale ose gjatë procedurës është tërhequr nga ndjekja penale e filluar, i dëmtuari të paraqitet si paditës subsidiar në procedurë penale të veprat penale të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare. Paditës subsidiar mund të paraqitet vetëm personi i dëmtuar me veprën penale.

Sipas dispozitave të KPPK-së, i dëmtuari në afat prej tetë (8) ditësh, prej ditës kur është informuar, duhet të deklaroj se a ndërmerr ndjekjen.

⁴⁰⁰ KPPK neni 151 par. 8

⁴⁰¹ KPPK neni 151 par. 9

⁴⁰² KPPK neni 151 par. 10

⁴⁰³ KPPK neni 151 par. 16

Po që se i dëmtuari nuk është informuar, deklaratën se dëshiron të ndërmarr ndjekjen mund ta jep para gjykatës brenda tre (3) muajve prej ditës kur prokurori publik e ka hedhur kallëzimin penal, apo nga dita kur është marrë aktvendimi mbi pushimin e procedurës (neni 62 par 4)

Nëse paditësi subsidiar vdes gjatë rrjedhës së afatit për ndërmarrjen e ndjekjes, ose gjatë zhvillimit të procedurës bashkëshorti i tij, bashkëshorti jashtëmartesor, fëmijët, prindërit, të adaptuarit, adaptuesit, vëllezërit dhe motrat brenda tre (3) muajsh nga dita e vdekjes mund ta ndërmarrin ndjekjen apo të deklarojnë se procedurën e vazhdojnë.

Po që se prokurori publik tërhiqet nga akuza në shqyrtim gjyqësor, i dëmtuari detyrohet që menjëherë të deklarojë se a dëshiron ta vazhdojë ndjekjen, nëse i dëmtuari nuk është i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor edhe pse është thirrur me rregull ose thirrja nuk ka mund t'i dorëzohet sepse nuk i ka paraqitur gjykatës adresën as vendqëndrimin, konsiderohet se nuk dëshiron të vazhdojë ndjekjen.

Mirëpo, kur i dëmtuari nuk është thirr me rregull, ose është thirr me rregull por për shkaqe të arsyeshme nuk ka mundur të vijë në shqyrtimin gjyqësor në të cilin prokurori publik është tërhequr nga ndjekja, i dëmtuari ka të drejtë të kërkojë rivendosjen e afatit (neni 63).

I dëmtuari si paditësi subsidiar është subjekt themelor në procedurën penale, ai ka të drejtë të njëjta me prokurorin publik, përveç atyre që prokurori publik i takojnë si organ shtetëror, ka të drejtë që gjatë të gjitha fazave të procedurës penale të vë në dukje faktet dhe të propozoj prova për të vërtetuar ekzistimin e veprës penale dhe të kryerësit të saj, ka të drejtë të propozoj prova, t'i bëjë pyetje të akuzuarit, dëshmitarëve dhe ekspertëve, të bëjë vërejtje dhe të paraqesë propozime.

Po ashtu mund t'i paraqes gjyqtarit kërkesë me shkrim për masën mbrojtëse ose urdhrin për anonimitet kur ka rrezik serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin apo anëtarët e familjeve të tyre (neni 169 par. 1).

Gjyqtari i procedurës paraprake apo kryetari i trupit gjykues e njoftojnë paditësin subsidiar për të drejtat e sipërpërmendura (neni 61 i KPPK-së). Në qoftë se paditësi subsidiar është fëmijë ose është privuar nga zotësia e veprimet, veprimet procedural i ndërmerr përfaqësuesi ligjor në emër të tij.

Por paditësi subsidiar që ka mbushur gjashtëmbëdhjetë vjet është i autorizuar që vetë të jap deklarata dhe të ndërmerr veprime në procedurë (neni 66 i KPPK). Paditësi subsidiar ose përfaqësuesi i tij ligjor mund t'i ushtrojnë të drejtat e tyre në procedurë edhe nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar.

Në procedurë që zbatohet në bazë të kërkesës së paditësit subsidiar, prokurori publik ka të drejtë të riaktivizohet dhe të ndërmarr ndjekjen e të mbroj akuzën (neni 65), në situatë të tillë paditësi subsidiar përsëri mbetet vetëm si i dëmtuar, por me mundësi që me ankesë ta atakojë aktgjykimin sipas të gjitha bazave për të cilat ai mund të goditet (neni 399 par 3)

I dëmtuari si paditës privat

Duke u mbështetur në parimin e oficialitetit të ndjekjes penale, sipas të cilit me rastin e ndjekjes së veprave penale merret për bazë interesi i përgjithshëm shoqëror, shumica e veprave penale ndiqen sipas detyrës zyrtare. Mirëpo në Kodin Penal të Kosovës ekzistojnë edhe disa vepra penale ndjekja e të cilave nuk bëhet sipas detyrës zyrtare, por sipas dispozicionit të palës së dëmtuar, tek veprat penale ku rrezikshmëria është relativisht e vogël, ose në rastet kur ekzistojnë marrëdhëniet të ngushta ndërmjet të pandehurit dhe të dëmtuarit.

Në rastin e ndjekjes, paditësi privat si person i dëmtuar me veprën penale, ndjekjen e zhvillon në bazë të interesit dhe vullnetit të vetë. Në këto vepra penale për shkaqe të sipërshënuara, e posaçërisht me qëllim që të mos ndikohet keq në marrëdhëniet familjare midis të dëmtuarit dhe të pandehurit, ligjvënësi ka lënë paditësit privat, që duke u udhëhequr me interesin e tyre personal dhe duke i vënë në peshojë ndjenjat e veta të çmojë se a duhet të paraqesë padi private apo jo.

Paditësit privat i është lënë që me rastin e ndjekjes të udhëhiqet me interesat e veta, por kjo e drejtë nuk bënë të keqpërdoret duke e trazuar të pandehurin vend e pa vend, në këtë drejtim janë paraparë afate konkrete brenda të cilave mund të veprojnë paditësi privat, ndërsa veprimtaria e tij gjithashtu i nënshtrohet kontrollit gjyqësor.

Padia private mundë të paraqitet brenda tre (3) muajve prej ditës kur personi i autorizuar për paraqitjen e saj ka mësuar për veprën penale dhe për kryesin e saj, nëse paditësi privat brenda këtij afati i drejtohet për ndërmjetësim ndërmjetësit të autorizuar për pajtim (neni 228 i KPPK-së), afati për

paraqitje të padis private fillon të ec nga dita kur procesi i ndërmjetësimit para ndërmjetësit ka përfunduar pa sukses, dhe nëse procedura nuk ka përfunduar brenda tre (3) muajsh me kalimin e këtij afati, ndërsa kur ndërmjet ndërmjetësit është arritur pajtimi, paditësi privat e humb të drejtën e paraqitjes së padisë private (neni 54 par 3).

Për shkak të vlerësimit jo të njëjtë të fakteve të cilat e përcaktojnë veprën penale në procedurë mund të paraqitet dilema rreth asaj se kush duhet të jetë paditës i autorizuar në rastin konkret. Në të vërtetë nuk përjashtohet mundësia që për një çështje penale konkrete, të paraqitet si paditës i autorizuar prokurori publik në një anë dhe paditësi privat në anën tjetër.

Në këtë rast, meqë është e pamundur që për një çështje penale të zhvillohen dy procedura penale, gjykata duhet të shqyrtoj çështjen penale sipas njëres akuzë duke e pushuar procedurën lidhur me akuzën tjetër, ose të pushoj procedurën lidhur me njëren akuzë deri sa të përfundoj procedura e filluar sipas akuzës tjetër.

Po ashtu është e mundur që i dëmtuari, duke konsideruar se është fjala për veprën penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, të paraqesë kallëzim penal, ndërsa gjatë procedurës të konstatohet se fjala është për veprën penale e cila ndiqet me padi private.

Në rastin e tillë kallëzimi penal konsiderohet si padi private e paraqitur në kohë të duhur po që se është paraqitur brenda afatit të parashikuar për padi private.

Paditësi privat, sikurse edhe paditësi subsidiar, mundet vet ta ushtroj funksionin e ndjekjes ose këtë e bënë nëpërmjet përfaqësuesit procedural. Padia private mund të ngritet edhe pas vdekjes së paditësit privat (neni 57). Paditësi privat, me deklaratën e vet të dhënë gjykatës në të cilën zhvillohet procedura, mund të tërhiqet shprehimisht ose heshtazi nga padia private deri të përfundimi i shqyrtimit gjyqësor. Si do që të jetë paditësi privat e humb të drejtën që përsëri të paraqitet me padi private.

Tërheqja shprehimisht nënkupton situatën kur paditësi privat gjatë zhvillimit të procedurës, por para përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, deklaron gojarisht në gjykatë (duke e shënuar këtë në procesverbal), ose me parashitje se tërhiqet nga padia private. Tërheqja heshtazi ekziston atëherë kur paditësi privat nuk paraqitet në shqyrtim gjyqësor me gjithë që është thirrur me rregull sepse, përveç rasteve të parashikuara me kode,

konsiderohet se është tërhequr nga padia (neni 60 par. 1), ndonëse edhe paditësit privat i lejohet rivendosja e afatit.

Paditësi privat si palë proceduralo–penale ka të drejtë që gjatë gjithë fazave të procedurës penale, t'i vejë në dukje faktet dhe të propozoi prova për të vërtetuar ekzistimin e veprës penale dhe të kryesit të saj, si dhe për vërtetimin e kërkesës pasurore juridike. Në shqyrtim gjyqësor ka të drejtë të propozoj prova, t'i bëjë pyetje të akuzuarit, dëshmitarëve dhe ekspertëve, të bëjë vërejtje dhe të paraqes propozime e të jep deklarata të tjera.

Gjatë procedurës mund t'i paraqes gjyqtarit kërkesë me shkrim për masën mbrojtëse ose urdhrin për anonimitet kur ka rrezik serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin apo anëtarët e familjeve të tyre (neni 169 par. 1). Gjyqtari i procedurës paraprake, apo kryetari i trupit gjykues, e njoftojnë paditësin privat për të drejtat e sipërpërmendura (neni 61).

Autorizimet e të dëmtuarit në realizimin e të drejtave tjera në procedurë penale.

Një pjese e konsiderueshme e veprave penale kanë për pasojë dëmtimin dhe cenimin e vlerave të personit apo të personave ndaj të cilëve ato janë drejtuar, ky dëm mund të jetë shëndetësor, moral dhe material. Personi i dëmtuar me veprën penale ka të drejtë të kërkojë procedimin e fajtorit, në këtë aspekt ai mund të ushtroj propozim për ndjekje penale, të paraqitet në cilësi të paditësit subsidiarë për veprat penale të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare, apo të paditësit privat të veprat penale që ndiqen me padi private.

Për të gjitha këto cilësi kemi folur më lartë, ndërsa në rastin konkret do të flitet për pozicionin e të dëmtuarit në procedurë penale karshi shtruarjes dhe zgjidhjes së kërkesës pasurore juridike që rezulton nga vepra penale dhe realizimit të drejtave tjera gjatë procedurës penale. Çështjet të cilat do të adresohen këtu janë trajtuar në nenet 78-82 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

Organi kompetent që zbaton procedurën penale, gjatë gjithë rrjedhës së procedurës penale duhet të ketë parasysh nevojat e arsyeshme të të dëmtuarve, veçanërisht të fëmijëve, personave të moshuar, personave me çrregullime ose me paaftësi mendore dhe viktimave të dhunës seksuale a gjinore (neni 78 i KPPK-së).

Ky kujdes i veçantë i referohet kryesisht kategorive të personave të cilët ose nuk kanë aftësi për tu kujdesur për interesat e tyre, ose të cilët për shkak të natyrës së veprës penale të kryer janë sjellë në pozitë të palakmueshme që vetë të kujdesen për mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Në rastet kur i dëmtuari është fëmijë ose person i paaftë për veprime juridike, përfaqësuesi i tij ligjor është i autorizuar që ti japë të gjitha deklaratat dhe të ndërmarrë të gjitha hapat të cilat i dëmtuari është i autorizuar që ti ndërmerr (neni 79 par 1 I KPPK-së).

Sipas zgjidhjes së dhënë në këtë dispozitë prindi i të miturit, gjegjësisht kujdestari i personit të cilit i është hequr zotësia për të vepruar, kanë të drejtë dhe detyrë që gjatë zhvillimit të procedurës penale t'i ndërmarrin të gjitha veprimet të cilat janë në funksion të mbrojtjes së interesave të këtyre personave, kur ata kanë cilësinë e personit të dëmtuar në procedurë penale. Përfaqësuesi ligjor i këtyre personave, ka autorizime që të japë të gjitha deklaratat fuqiplote dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet të cilat vetë i dëmtuari ka autorizim t'i ndërmarr sipas dispozitave ligjore.

I dëmtuari i cili ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjet është i autorizuar vetë të japë deklaratat dhe të ndërmarrë hapa në procedurë (neni 79 par 2 I KPPK-së).

Këtu është fjala për personat e dëmtuar që kanë mbushur moshën 16 vjeçare, për të cilët ligji ka paraparë mundësinë që ata vetë të japin deklaratat fuqiplote dhe të ndërmarrin veprime procedurale, si që rezultojnë nga zgjidhja personave të tillë ju jep mundësi që të jenë aktivë në procedurë penale përballë mbrojtjes së interesave të tyre.

Por në anën e këtyre personave mund të qëndroi pa ndonjë pengesë, përfaqësuesi ligjor në mënyrë që ti kontribuohet mbrojtjes më efektive të atyre interesave. I dëmtuari dhe përfaqësuesi i tij ligjor, mundë t'i ushtrojnë të drejtat e tyre në procedurë edhe nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar⁴⁰⁴, (neni 81 par. 1 I KPPK-së), kështu kur ata dëshirojnë të lirohen nga barra ose që mbrojtja e interesave të tyre në procedurë penale të realizohet në mënyrë më profesionale mundë të angazhojnë përfaqësues të autorizuar.

Si përfaqësues i tillë mundë të angazhohet gjithsecili person që ka aftësinë për të vepruar, por që duke marrë për bazë misionin e përfaqësimit do të

⁴⁰⁴ KPPK neni 81 par. 3

ishite e preferueshme që në pozicionin e tillë të angazhohet personi me kualifikime juridike përkatësisht avokati.

I dëmtuari, përfaqësuesi i tij ligjorë dhe përfaqësuesi i autorizuar, detyrohen të njoftojnë gjykatën për çdo ndryshim të adresës ose të vendqëndrimit (neni 81 par. 2 I KPPK-së), ata mbeten të detyruar ta njoftojnë gjykatën edhe për qëllimin që kanë për të ndërruar adresën ose vendqëndrimin e tyre. Kjo detyrë reflekton nevojën që gjatë zhvillimit të procedurës penale të evitohen aq sa është e mundur vështirësitë në komunikimin e organit të procedurës me këta subjekte.

Përfaqësuesi i autorizuar, detyrohet ti mbrojtë të drejtat e të dëmtuarit, veçanërisht integritetin e tij gjatë marrjes në pyetje pranë organit që zbaton procedurën, të paraqes dhe të përfaqësojë kërkesën pasurore juridike. Me këtë është e qartë se përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar që në procedurë penale të angazhohet maksimalisht për mbrojtjen e të drejtave të të dëmtuarit, gjegjësisht viktimës, në kuadër të përmbushjes së këtyre detyrave ai duhet të kujdeset që në mënyrë të veçantë të mbroj integritetin e viktimës gjatë marrjes në pyetje pranë organit të procedurës.

Përveç kësaj ai ka detyrë që me konsekuencë ta përfaqësojë kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit t'i vë në pah të gjitha rrethanat që vërtetojnë ekzistimin e kësaj kërkesë dhe lartësinë e saj, në çdo rast, kur kërkesa në fjalë është drejtuar në drejtim të kompensimit të dëmit ose të prishjes së veprimit juridik.

Mbrojtësi i viktimave nga njësia për mbrojtjen e viktimave i ndihmon të dëmtuarit në mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe sipas rastit, edhe si përfaqësues i autorizuar i të dëmtuarit⁴⁰⁵, kështu që ndihmësi i viktimave mund të angazhohet drejtpërdrejt në procedurë penale në mbrojtjen e viktimave si dhe në mbrojtjen e të drejtave të tyre edhe në cilësinë e përfaqësuesit të autorizuar, në këtë rast ai vepron konform autorizimeve të cilat Kodi i Procedurës Penale ia njeh përfaqësuesit të autorizuar.

Mbrojtësi i viktimave nga njësia për mbrojtjen e viktimave i ndihmon të dëmtuarit në mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe sipas rastit, edhe si përfaqësues i autorizuar i të dëmtuarit⁴⁰⁶, kështu që mbrojtësi i viktimave mund të angazhohet drejtpërdrejt në procedurë penale në mbrojtjen e

⁴⁰⁵ KPPK neni 81 par. 4

⁴⁰⁶ Po aty

viktimave si dhe në mbrojtjen e të drejtave të tyre edhe në cilësinë e përfaqësuesit të autorizuar, në këtë rast ai vepron konform autorizimeve të cilat Kodi i Procedurës Penale ia njeh përfaqësuesit të autorizuar.

Siç shihet Kodi i Procedurës Penale ka paraparë edhe mundësinë, që të dëmtuarve t'u ofrohet ndihma nga një njësi e veçantë që merret vetëm me mbrojtjen e viktimave, e cila njësi tash funksionon si divizion i departamentit për qasje në drejtësi në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë që funksionon në të gjitha regjionet e Kosovës dhe që është i vetmi në shtetet në rajon e që rrjedh nga modaliteti i sistemit të drejtësisë së SHBA-ve.

Kjo njësi deri me formimin e Ministrisë së Drejtësisë ka qenë në kuadër të Departamentit të Drejtësisë dhe është formuar më qëllim që t'u ofrohet ndihmë të dëmtuarve në procedurë penale, në cilësinë e përfaqësuesit të autorizuar.

Mbrojtësi i viktimave nga ky njësit respektivisht Divizioni për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave të dëmtuarit-ve në veçanti viktimave të pësuar nga veprat penale që rrjedhin si pasojë e dhunës në familje, veprave penale të trafikimit me qenie njerëzore, kundër integriteti seksual, abuzimit të fëmijëve, gjatë zhvillimit të procedurës penale i ndihmon në realizimin e të drejtave të tyre që parasheh sistemi i drejtësisë në Kosovë, ju ofron përkrahje institucionale, ju ndihmon të kenë qasje në sistemin e drejtësisë, u jep këshilla dhe informim ligjor, i informon për procedurat ligjore i shoqëron para dhe gjatë procedurave gjyqësore me pëlqimin e viktimës, referon tek ndihma përkatëse tek organet që ofrojnë ndihmë dhe përkrahje ligjore, sociale, siguron strehim të përkohshëm dhe siguri.

Pra siç shihet për të dëmtuarin është një beneficion mjaft i dobishëm dhe një e drejtë substanciale që i siguron KPPK-së përmes këtij divizioni – (Divizioni për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave.) Në kodin e procedurës penale gjegjësisht në nenin 82, është e rregulluar çështja edhe e përfaqësimit të kategorive të caktuara të personave, që duhet të kenë përfaqësues të autorizuar, gjatë gjithë fazave të zhvillimit të procedurës si dhe mënyra e angazhimit të tij.

I dëmtuari ka përfaqësues të autorizuar nga fillimi i procedurës kur:

- është fëmijë;
- është në marrëdhënie familjare me të pandehurin.

Procedura zbatohet për vepra penale nga neni 139 i kodit penal të Kosovës ose për vepra penale kundër integritetit seksual nga kapitulli XIX i kodit penal, përveç veprave penale nga neni 203 i kodit penal të Kosovës.

I dëmtuari ka çrregullime ose paaftësi mendore ose gjykata çmon se i dëmtuari është i pazoti për t'u mbrojtur dhe i nevojitet ndihma e përfaqësuesit të autorizuar.

Me këtë zgjidhje i dëmtuari përkundër nevojës që mund të ketë përfaqësues ligjorë, mbetet i detyruar që të përfaqësohet nga përfaqësuesi i autorizuar, mirëpo, ky përfaqësim nuk ka të bëjë me të gjithë personat që në procedurë mundë të kenë cilësinë e personit të dëmtuar.

Ne fakt përfaqësimi i detyruar i të dëmtuarit përfshin rastet kur ai është fëmijë ose i mitur, është në marrëdhënie familjare me të pandehurin, procedura zbatohet për vepra penale nga neni 139 i kodit penal të Kosovës ose për vepra penale kundër integritetit seksual nga kapitulli XIX i kodit penal, përveç veprave penale nga neni 203 i kodit penal të Kosovës, i dëmtuari ka çrregullime ose paaftësi mendore ose gjykata çmon se i dëmtuari është i pazoti për t'u mbrojtur dhe i nevojitet ndihma e përfaqësuesit të autorizuar vlen të theksohet fakti se përfaqësuesi i autorizuar ka obligim ligjor që t'i mbrojë të drejtat e personit të dëmtuar, veçanërisht integritetin e tij gjatë marrjes në pyetje nga organi i procedurës por edhe në lidhje me realizimin e kërkesës pasurore juridike të tij.

Në rastet kur i dëmtuari apo përfaqësuesi i tij ligjorë, nuk angazhon përfaqësues të autorizuar, kryetari i gjykatës apo autoriteti kompetent që zbaton procedurën në fazën paragjyqësore cakton përfaqësues të autorizuar sipas detyrës zyrtare me shpenzime të shtetit⁴⁰⁷. Kjo mënyrë e caktimit vjen në shprehje atëherë kur i dëmtuari ose përfaqësuesi i tij ligjor nuk kanë caktuar përfaqësuesin e tillë.

Pavarësisht mënyrës së caktimit të tij, autorizimet e përfaqësuesit të autorizuar janë identike dhe ato kanë të bëjnë me ushtrimin e veprimeve procedurale në interes të të dëmtuarit.

Organi i cili e zbaton procedurën penale është i detyruar që ta njoftoi të dëmtuarin për të gjitha të drejtat të cilat i takojnë në procedurë. Këtë njoftim në varësi të fazës në të cilën ndodhët zbatimi i procedurës penale, e bënë

⁴⁰⁷ KPPK neni 82 par. 2

prokurori publik, gjyqtari i procedurës paraprake ose kryetari i trupit gjykues. Informimi i tillë është paraparë në interes të mbarëvajtjes së procedurës penale lidhur me çështjen penale konkrete⁴⁰⁸.

Të drejtat e të dëmtuarit

Kodi i procedurës penale në mënyrë shprehimore i parasheh të drejtat e të dëmtuarit dhe i mbron të drejtat e tij të garantuara me kushtetutë dhe ligj.

I dëmtuari sipas dispozitave ligjore në fuqi ka të drejtë që gjatë të gjitha fazave të procedurës penale të prezantojë të gjitha faktet dhe të propozojë prova me rëndësi për vërtetimin e veprës penale, për gjetjen e kryerësit të veprës ose vërtetimin e kërkesës së tij pasurore juridike⁴⁰⁹.

I dëmtuari me qëllim të tij dhe me qëllim të vërtetimit të ekzistimit të kërkesës pasurore juridike, gjatë shqyrtimit gjyqësor mund të propozojë prova, tu parashtroj pyetje të pandehurit, dëshmitarëve dhe ekspertëve, të bëjë vërejtje në deklaratimet e pjesëmarrëseve të tjerë të procedurës, të japë sqarime për provat e parashtruara, të hapë deklarata që kanë të bëjnë me çështjen penale dhe kërkesën pasurore juridike si dhe të paraqesë propozime konkrete.

Në fakt i dëmtuari mund të propozojë marrjen e provave të caktuara si dhe vërtetimin e fakteve relevante të cilat i referohen veprës penale, kryerësit të saj dhe ekzistimit të kërkesës pasurore juridike.

Në pajtim me dispozitat e KPPK-së i dëmtuari ka të drejtë të shikojë procesverbalin, shkresat dhe sendet që shërbejnë si provë⁴¹⁰, me qëllim që të realizojë kontakt me të gjitha të dhënat që shërbejnë si provë në procedurë penale. Në këtë aspekt, ai së pari ka të drejtë të shikojë procesverbalin dhe shkresat e sendet të cilat trajtohen si provë në procedurë. Kjo e drejtë e tij është në funksion të krijimit të kushteve që i dëmtuari të mund të japë vërejtje në to, gjegjësisht të deklarohet lidhur me to dhe kështu ti kontribuojë arritjes të vërtetës objektive në procedurë penale, e aq më tepër realizimit të interesave të tij.

Në procedurë penale i dëmtuari ka të drejtë të ushtrojë ankesë kundër aktgjyqimit të gjykatës sa i përket sanksioneve penale të shqiptuara për veprat penale kundër jetës dhe trupit, kundër integritetit seksual, kundër

⁴⁰⁸ KPPK neni 80 par. 5

⁴⁰⁹ KPPK neni 80 par. 2

⁴¹⁰ KPPK neni 80 par. 4

sigurimit të trafikut publik dhe për shpenzimet e procedurës. Po ashtu në çdo fazë të procedurës mund t'i paraqes gjyqtarit kërkesë me shkrim për masën mbrojtëse ose urdhrin për anonimitet kur ka rrezik serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin apo anëtarët e familjeve të tyre (neni 169 parg. 1).

Ka të drejtën e ankesës kundër aktvendimit për konfirmim aktakuzë, të filloj ndjekjen duke i paraqitur gjykatës propozimakuze kur prokurori publik brenda një muaji pas pranimit të kallëzimit penal nuk paraqet propozimakuze dhe nuk e lajmëron të dëmtuarin për hedhjen e kallëzimit penal (neni 464 KPPK-së).

Kërkesa pasurore juridike

Një nga të drejtat më të rëndësishme e të dëmtuarit është edhe e drejta për dëmshpërblim apo siç njihet nga terminologjia juridik si e drejta për kërkesën pasurore juridik. Kjo e drejtë vjen në shprehje atëherë kur të dëmtuarit i është cenuar apo dëmtuar gjegjësisht i është shkaktuar një dëm i caktuar me rastin kryerjes së veprës penale.

Sipas dispozitave ligjore në fuqi, i dëmtuari ka të drejtë të paraqesë kërkesë pasurore juridike në procedurë penale në pajtim me nenin 108 par 1 i KPPK-së⁴¹¹. Siç u cek me lartë me rastin e kryerjes së veprës penale personit të dëmtuar mund t'i shkaktohet dëm material dhe moral. Pavarësisht nga ajo se ndjekja e kryerësit të veprës penale bëhet sipas detyrës zyrtare apo me padi private, kërkesa pasurore juridike si rrjedhojë e kryerjes së veprës penale vendoset në procedurë penale me propozimin e personave të autorizuar në qoftë se kjo nuk e zvarrit procedurën në mënyrë të konsiderueshme.

Propozimin për realizimin e kërkesës pasurore juridike në procedurë penale mund ta paraqesë i dëmtuari, trashëgimtarët e tij ose personat në të cilët sipas rregullave të së drejtës civile ka kaluar kërkesa. Në qoftë se me veprën penale është dëmtuar pasuria në pronësi publike, shtetërore ose shoqërore, organi ose personi i cili është i autorizuar të kujdesët për mbrojtjen e kësaj pasurie, mund të merr pjesë në procedurë penale në pajtim me autorizimet që i ka sipas ligjit⁴¹².

Kërkesa pasurore juridike mund të paraqitet në tri drejtime:

⁴¹¹ KPPK neni 80 par. 1

⁴¹² KPPK neni 108 par. 1

- personi i autorizuar mund të kërkojë kompensimin e dëmit të shkaktuar,
- kthimin e sendit,
- prishjen e veprimit juridik të caktuar.

Në emër të kompensimit të dëmit i dëmtuari mund të kërkojë kompensimin si të dëmit material (dëmit real-damnum emergens), fitimin e humbur (lucrum cesans) e po ashtu edhe kompensimin e dëmit moral i cili ka të bëjë me lëndimin e ndonjë të mire personale, nderit, prestigjit, përjetimit të dhembjes fizike ose shpirtërore etj.

I dëmtuari me kërkesën pasurore juridike mund të kërkojë kthimin e sendit (p.sh te vepra penale e vjedhjes neni 252 i KPPK-së), në qoftë se sendi i marrë është në gjendje të rregullt. S'ka dyshim se i dëmtuari edhe në këtë rast mund të kërkojë kompensimin e dëmit mirëpo duke pasur parasysh faktin se sendi i marrë më rastin e kryerjes së veprës penale mund të ketë vlerë të posaçme për të dhe ai mund të mos jetë i kënaqur me kompensimin e dëmit andaj Kodi i procedurës penale i njëhë mundësinë që të kërkojë kthimin e sendit.

I dëmtuari në procedurë penale, me kërkesën pasurore juridike, mundë të kërkojë edhe prishjen e veprimit juridik, i cili ka karakter juridiko pasuror, (p.sh kontrata e lidhur me forcë ose duke e vënë palën e dëmtuar në lajthim etj).

Propozimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike në procedurë penale i paraqitet organit të cilit i paraqitet kallëzimi penal, ose gjykatës në të cilën zhvillohet procedura. Propozimi mund të paraqitet deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor në gjykatë të shkallës së parë. Kur personi i autorizuar nuk ka paraqitur propozim për realizimin e kërkesës pasurore juridike në procedurë penale deri në kohën e ngritjes së aktakuzës, njoftohet se propozimin mund ta paraqes deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor në gjykatë të shkallës së parë.

Është më rëndësi të theksohet se personi i autorizuar për paraqitjen e propozimit ka për detyrë që të shënoj qartë kërkesën e vetë dhe të paraqesë prova për vërtetimin e saj⁴¹³.

⁴¹³ KPPK neni 109

Personat e autorizuar për paraqitjen e kërkesës, deri në fund të shqyrtimit gjyqësor mund të tërhiqen nga realizimi i kërkesës pasurore juridike në procedurë penale dhe atë ta realizon në kontest civil. Në rast të tërheqjes nga propozimi, propozimi nuk mund të përsëritet, përveç nëse me Kodin e Procedurës Penale është paraparë ndryshe.

Kur kërkesa pasurore juridike pas paraqitjes së propozimit, e para përfundimit të shqyrtimit gjyqësor ka kaluar në personin tjetër sipas rregullave të së drejtës pasurore, thirret ai person që të deklarohet se a donë të mbetet pranë propozimit. Kur personi i thirrur rregullisht nuk i përgjigjet thirrjes, konsiderohet se është tërhequr nga propozimi⁴¹⁴.

Përndryshe, gjykata që zhvillon procedurën e merr në pyetje të pandehurin për faktet e shënuara në propozim dhe i hulumton rrethanat që janë të rëndësishme për vërtetimin e kërkesës pasurore juridike.

Mirëpo, edhe para se të paraqitet propozimi i tillë, gjykata ka për detyrë të mbledh provat dhe të shikoj çka është e nevojshme për marrjen e vendimit lidhur me kërkesën. Kur me hulumtimin e kërkesës pasurore juridike procedura penale do të zvarritej në mënyrë të konsiderueshme, gjykata kufizohet në mbledhjen e atyre të dhënave, vërtetimi i të cilave më vonë nuk do të jetë i mundur, ose do të ishte dukshëm i vështirësuar⁴¹⁵ (neni 111 i KPPK-së).

Për kërkesë pasurore juridike vendos gjykata, në aktgjykim me të cilin i pandehuri shpallet fajtor gjykata mundë të vendos për kërkesën pasurore juridike në tersi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon të dëmtuarin në kontest civil. Mirëpo, kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk japin bazë të sigurve për gjykim të plotë as për gjykim të pjesëshëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike ta realizon në kontest civil.

Kur gjykata merr aktgjykim lirues ose refuzues, ose kur me aktvendim pushohet procedura penale, të dëmtuarin e udhëzon në kontest civil. Kur gjykata shpallet inkompetente për procedurë penale, e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën mundë ta paraqes në procedurë penale, e cila do të fillohet ose do të vazhdohet nga gjykata kompetente.

⁴¹⁴ KPPK neni 110

⁴¹⁵ KPPK neni 112

Nga çka u tha më lartë del se kur paraqitet kërkesa pasurore juridike për zgjidhje në procedurë penale gjykata penale duhet, krahas ndriçimit të çështjes penale, të ndriçoj edhe të dhënat të cilat kanë të bëjnë me kërkesë pasurore juridike dhe në fund, të vendos edhe lidhur me këtë kërkesë.

Veprimtaria gjyqësore lidhur me kërkesën pasurore juridike zhvillohet me procedurë të ashtuquajtur procedurë e ad-heziona, (procedura e bashkangjitur me procedurën penale), rrjedhimisht KPPK-së, kërkon nga gjykata penale që ta zgjidh edhe kërkesën pasurore juridike.

Mirëpo, në qoftë se zgjidhja e saj e zvarrit procedurën penale në mënyrë të konsiderueshme, e në anën tjetër çështja penale është ndriçuar, atëherë gjykata penale vendos për çështjen penale, ndërsa të dëmtuarin me kërkesë pasurore juridike e udhëzon në kontest civil.

Gjykata, mundë ta ndryshoj aktgjykimin e formës së prerë me të cilin në procedurë penale është vendosur për kërkesën pasurore juridike vetëm me rastin e rishikimit të procedurës penale ose me kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Jashtë këtyre rasteve i dëmtuari apo trashëgimtarët e tij mund të kërkojnë ndryshimin e aktgjykimit të formës së prerë të gjykatës penale vetëm në kontest civil nëse ekzistojnë kushtet për rishikim sipas dispozitave që vlejnë për procedurë kontestimore⁴¹⁶.

⁴¹⁶ KPPK neni 115



Aziz R. Shaqiri

PARIMI I LIGJSHMËRISË ME VËSHTRIM TË VEÇANTË NË LEGJISLACIONIN TONË PENAL

I. Vështrime të përgjithshme

Fjala “ligjshmëri” do të thotë, të qenit në përputhje me ligjin. Por ligji duhet të jetë në harmoni me kushtetutën, si akt më i lartë juridik i një vendi. Në shoqërinë bashkëkohore edhe kushtetuta duhet të jetë në harmoni me standardet ndërkombëtare të pranuar nga shtetet e civilizuar, në mënyrë që të hapërohet me shoqëritë demokratike bashkëkohore.

Parimi i ligjshmërisë është parim fundamental i shtetit ligjor në shoqërinë demokratike bashkëkohore. Ky parim ka rëndësi të madhe për mbrojtjen dhe sendërtimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe qytetarit. Qëllimi themelor i këtij parimi ka qenë dhe mbetet, mënjanimi i arbitraritetit gjatë interpretimit të normave juridike dhe vendosjes së lëndëve përkitazi me raportet mes personave fizikë dhe juridikë, personave fizikë dhe juridikë në njërën anë dhe shtetit në anën tjetër si dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe qytetarit si kategori kushtetuese dhe ndërkombëtare.

Synimi i këtij parimi nuk është realizuar në mënyrë homogjenë gjatë gjitha fazave të zhvillimit të shoqërisë njerëzore⁴¹⁷, por as në të gjitha shtetet, e kjo kështu nuk është as tani në botën bashkëkohore. E shkak i realizimit heterogjen është karakteri i rregullimit shoqëror-juridik dhe politik në shtetet e ndryshme, mënyra e përcaktimit të këtyre shteteve lidhur me ndërtimin e demokracisë, mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut por edhe shkalla e zhvillimit të gjithëmbarsëm të shoqërisë në këto shtete.

Ligjshmëria është parim me rëndësi, në të drejtën kushtetuese edhe në fushat tjera të së drejtës. Por, në të drejtën penale ky parim është themelor,

⁴¹⁷ D.Basta , Liria dhe e Drejta, Novi Sad,1994, faqe 126

meqë përcaktueshmëria e veprës penale dhe e sanksionit penal së bashku me masat e trajtimit të detyrueshëm paraqet njëërën prej karakteristikave esenciale të së drejtës penale bashkëkohore.

Duke pasur parasysh rëndësinë e madhe të këtij parimi, i njëjti është ngritë në kategori kushtetuese dhe të akteve ndërkombëtare, në formë të deklaratave, konventave dhe pakteve, të cilave do të ju qasemi në vijim.

Kështu, parimi i ligjshmërisë është përcaktuar në shumë kushtetuta të Evropës dhe të botës, edhe atë, në nenin 16 të Kushtetutës së Mbretërisë së Holandës, në nenin 31 të Kushtetutës së Kroacisë, në nenin 28 të Kushtetutës së Sllovenisë, në nenin 29 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 33 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës etj.

Parimi i ligjshmërisë ka vlerë të përgjithshme për të drejtat nacionale penale por edhe për të drejtën penale bashkëkohore, meqë i njëjti paraqet domosdonë e sundimit të drejtësisë kundër arbitraritetit që mund të shprehet ndaj vlerave jetike të njeriut dhe shoqërisë në përgjithësi, duke i mbrojtur juridikisht këto vlera nga kryerësit e veprave penale, por edhe duke i mbrojtur ata nga keqpërdorimet arbitrare të organeve shtetërore që janë të autorizuar të zhvillojnë procedurë kundër tyre.

Ose siç thoshte penalisti i njohur gjerman Anselm Foerbach, se ky parim nuk është vetëm një mjet në duar të organeve të shtetit për t'u mbrojtur nga kryerësit e veprave penale, por edhe mjet mbrojtës për t'u mbrojtur kryerësit e veprave penale nga keqpërdorimet arbitrare që mund t'i bëjnë organet shtetërore ndaj tyre⁴¹⁸.

II. Historiku i paraqitjes dhe zhvillimit të parimit të ligjshmërisë

Që nga momenti i paraqitjes së shtetit, u shtrua nevoja që pushtetit shtetëror t'i caktohen kufizimet, në mënyrë që ushtrimi i këtij pushteti të mund të kontrollohet. Për ta mbrojtur në mënyrë sa më efektive integritetin, pavarësinë, të drejtat dhe liritë e njeriut dhe qytetarit nga keqpërdorimet e mundshme të pushtetit shtetëror, ishte e nevojshme kufizimi dhe kontrollimi i këtij pushteti. Ky kufizim arrihet me institucionin e ligjshmërisë, sipas të cilit organet shtetërore si krijuese të së drejtës, në të njëjtën kohë edhe duhet t'i nënshtrohen të drejtës.

⁴¹⁸ Mr.sc.Bajram Ukaj, artikulli Parimi i ligjshmërisë, në revistën për çështje juridike dhe shoqërore " E Drejta", nr.2, Prishtinë, 2002, fq.69 dhe 70,

Për sendërtimin e parimit të ligjshmërisë në sistemin juridik, e posaçërisht në të drejtën penale, që e nevojshme të kaloj një kohë e gjatë, me sakrificë të mëdha të forcave progresive. Ky parim ishte i njohur qysh herët, mirëpo afirmimi i tij u shpreh në gjysmën e dytë të shekullit XVIII.

Përpjekjet e para për kufizimin e pushtetit absolut të mbretit u bënë në Angli, me miratimin e Kartës së Madhe të Lirive më 15 qershor 1215, të njohur si Magna Carta Libertatum, me të cilin akt shtetëror -juridik në nenin 39 përcaktohej: “Asnjë njeri i lirë nuk do të arrestohet dhe nuk do të burgoset, ose të privohet nga pasuria, ose të shpallet jashtë ligjit, ose të dëbohet, ose në ndonjë mënyrë tjetër të hidhet në fatkeqësi,... përveç se në bazë të një vendimi të ligjshëm të marrë prej të barabartëve të tij dhe në bazë të ligjit të vendit”⁴¹⁹.

Po ashtu edhe me Ligjin mbi të Drejtat (Bill of Rights) të vitit 1689, si akt kushtetues në Angli, me të cilin shpallen dhe garantohen të drejtat dhe liritë e individëve, në masë të madh kufizohet pushteti absolut mbretëror. Kështu, me nenin 2 të këtij akti kushtetues përcaktohet: “Se është joligjorë pushteti që disponon të drejtën e sundimit pa ligj ose të zbatimit të ligjit nga ana e pushtetit mbretëror, sikurse është pranuar e vepruar më parë”, kurse në neni 12 përcaktohet: “Se çdo shqiptim i dënimeve me të holla dhe i gjobitjes së individëve para se të jenë gjykuar, është joligjor dhe i pavlefshëm”⁴²⁰. Me këto dy nene, po ashtu u proklamuan elementet fillestare të parimit të ligjshmërisë.

Për futjen e parimit të ligjshmërisë në të drejtën penale janë angazhuar juristë dhe filozofë të njohur të shekullit XVIII. Mirëpo, për afirmimin e parimit të ligjshmërisë, kontribut të posaçëm kanë dhënë Monteskie në veprën “De l’esprit des lois” të botuar në vitin 1748, Volteri, Didro, avokati Servan, Cezario Bekario, Anselm Fojerbah etj.

Autori i parë i cili ka paraparë parimin e ligjshmërisë, në veprën *Traite de delitë et des peines* (Veprat penale dhe dënimet mund të parashihen vetëm me ligj) të botuar në vitin 1764 është Cezario Bekario, kurse formulimin konciz të këtij parimi në gjuhën latine “Nullum crimen, nulla poena sine lege” për herë të parë e ka bërë penalisti i shquar gjerman Arsel Fojerbah.

419 Më gjerësisht për këto dy akte kushtetuese shih: Dr. Z. Gruda, Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut II, Dokumente, Prishtinë, 2001, 3-6 si dhe 6-7, Dr. Hilmi Ismaili, Burime të zgjedhura juridiko-historike I, Prishtinë, 2001, faqe 99-105 dhe 123-124

420 Po aty

Ky formulim i shprehur në gjuhën latine, në gjuhën shqipe do të thotë: “Një vepër nuk mund të konsiderohet vepër penale dhe kryerësi i saj nuk mund të dënohet, nëse më parë nuk është paraparë me ligj”⁴²¹.

Elemente të caktuara të parimit të ligjshmërisë gjejmë edhe në nenin 8, në Deklaratën e Virgjinisë mbi të Drejtat (Bill of Rights) të aprovuar njëzëri në Kuvendin e Virgjinisë më 12 qershor 1776, në të cilin thuhet: “ Që të gjitha veprat e dënueshme ose penale, për të cilat parashikohet dënimi me vdekje, njeriu ka të drejtë të kërkojë që t’i komunikohen shkaku dhe natyra e aktakuzës, ... se askush nuk mund të privohet nga liria përpos në bazë të ligjit të vendit ose të aktgjykimit të atyre që janë të barabartë me të”.

Mirëpo, përkufizimi i plotë të parimit të ligjshmërisë u bë në Deklaratën për të drejtat e njeriut dhe qytetarit, të cilin e aprovoi Kuvendi Kombëtar i Francës më 12.08 1789, edhe atë në nenin 8, në të cilin thuhet: “Vetëm ligji mund të vendos dënime të rrepta dhe domosdo të qarta dhe askush nuk mund të dënohet, përpos në bazë të ligjit të miratuar e të shpallur para deliktit, të zbatuar në mënyrë ligjore”.

Këtë parim po ashtu në dispozitat e tij e përmban edhe Deklarata për të drejtat e njeriut dhe qytetarit, të cilën po ashtu e ka aprovuar Kuvendi Kombëtar i Francës më 24.06 1793, pas revolucionit të vitit 1789, e cila ndryshe quhet edhe Kushtetuta e Jakobinëve, edhe atë në nenin 14 thuhet: “Askush nuk guxon të gjykohet ose dënohet para se të merret në pyetje ose të ftohet sipas dispozitave dhe vetëm në bazë të ligjit, të shpallur para kryerjes së veprës penale. Ligji që do të dënonte për vepra penale të bëra para ekzistimit të tij, do të ishte dhunë, veprimi retroaktiv i dhënë ndonjë ligji do të ishte krim”.

Parimi i ligjshmërisë është sanksionuar për herë të parë më Kodin Penal të Napolonit në vitin 1811, ashtu që gjatë shekullit të XIX i njëjti u parapa në të gjitha kodet penale të Evropës dhe të botës. Më vonë, ky parim u parapa edhe me Kodin Penal të Republikës së Kosovës në nenin 1. Ky parim me kalimin e kohës përveç që u ngrit në kategori kushtetuese, i njëjti fitoi edhe dimension ndërkombëtar duke u inkorporuar në shumë akte ndërkombëtare.

421 Më gjerësisht shih : Dr. Ismet Salihu, E drejta penale- Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2003, fq. 133 dhe 134.
Dr.Z.Gruda, Mbrotja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut, Dokumente II, Prishtinë , 2001, fq. 6-7 si dhe 10-12.

III. Parimi i ligjshmërisë në të drejtën ndërkombëtare penale

Siç u theksua edhe më lartë, parimi i ligjshmërisë përveç asaj që ishte parim fundamental i të drejtës penale nacionale, duke u ngritur edhe si kategori kushtetuese, i njëjti u përvetësua edhe si parim themelor në të drejtën penale ndërkombëtare.

Parimi i ligjshmërisë u përcaktua në shumë akte të rëndësishme ndërkombëtare siç janë: Deklarata e përgjithshme e të drejtave të njeriut, Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, Konventa Amerikane për të drejtat e njeriut, Deklarata e Kajros për të drejtat e njeriut në Islam, Karta Arabe për të drejtat e njeriut etj.

1. Deklarata e përgjithshme për të drejtat e njeriut

Kjo deklaratë është aprovuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-ës më 10 dhjetor 1948, dhe e njëjta për herë të parë paraqet përmbledhje të të drejtave civile, ekonomike, politike kulturore, sociale si dhe të drejtave dhe lirive tjera themelore. Kjo Deklaratë paraqet një Kartë të Madhe të Lirive për gjithë bashkësinë njerëzore, meqë të drejtat dhe liritë themelore kanë të bëjnë me gjithë anëtarët e bashkësisë njerëzore, pa dallim race, seksi, gjuhe, religjioni, prejardhje nacionale ose të cilësive tjera.

Deklarata përcakton parimin e ligjshmërisë në nenin 11 paragrafi 2, në të cilin thuhet: “Askush nuk mund të dënohet për veprime ose mosveprime, të cilat në kohën kur ato janë kryer, nuk përbënin një vepër penale sipas të drejtës së brendshme ose asaj ndërkombëtare. Po ashtu, nuk do të shqiptohet asnjë dënim më i rëndë se ai që ishte paraparë në kohën kur është kryer vepra penale”. Kjo deklaratë ka shërbyer si bazament për shumë akte tjera ndërkombëtare, duke paraparë edhe parimin e ligjshmërisë.

2. Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut

Kjo konventë është miratuar më 05 nëntor 1950 në Romë , ashtu që në nenin 7 paragrafi 1 dhe 2. duke përcaktuar parimin e ligjshmërisë thuhet: “ Paragrafi 1. Askush nuk mund të dënohet për një veprim dhe mosveprim, i cili në kohën e kryerjes nuk përbënte shkelje të ligjit sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare, po ashtu, për këtë veprim nuk mund të shqiptohet një dënim më të rëndë se ai që parashikonte ligji në kohën e kryerjes së veprës penale. Paragrafi 2. Ky nen nuk do të ndikojë në gjykimin

ose ndëshkimit të një personi penalisht të përgjegjshëm për një veprim ose mosveprim, i cili në kohën e kryerjes, paraqet vepër penale sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës, të njohur nga kombet e qytetëruara”.

3. Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike

Ky pakt është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 16 dhjetor 1966, ashtu që në mënyrë të ngjashme sikurse në dy aktet e lartcekura, në nenin 15 paragrafi 1 dhe 2. parasheh parimin e ligjshmërisë, ku thuhet:

Paragrafi 1. Askush nuk do të dënohet për veprime ose mosveprime, të cilat nuk paraqesin shkelje sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare në kohën e kryerjes së tyre. Gjithashtu nuk mund të shqiptohet një dënim më i rëndë se ai që mund të shqiptohet në kohën e kryerjes së veprës penale. Në qoftë se, pas kësaj shkelje, ligji parashikon një dënim më të lehtë, kryerësi i veprës duhet të përfitojë nga kjo, me plotësimin se,

Paragrafi 2. Asgjë në këtë nen nuk duhet interpretuar sikur është kundër gjyqimit ose ndëshkimit të një njeriu për veprime ose mosveprime, të cilat në kohën e kryerjes së tyre janë cilësuar si kriminale sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës, të njohur nga e gjithë bashkësia ndërkombëtare “.

4. Deklarata e Kajros për të drejtat e njeriut në Islam

Kjo deklaratë është miratuar në Kajro më 05 gusht 1990 dhe në neni 19 paragrafi d) përmban disa elemente të parimit të ligjshmërisë, ku thuhet: “ nuk do të ketë krim apo ndëshkim, përpos atyre që parashihen me dispozitat e Sheriatit “.

5. Karta Arabe për të drejtat e njeriut

Kjo Kartë është miratuar nga Këshilli i Lidhjes Arabe dhe është proklamuar në vitin 1994, ashtu që në nenin 19 thuhet: “Garantohet për të gjithë njerëzit barazia para ligjit dhe siguria e ligjit. Sharia përcaktohet si baza e vetme e gjyqimeve mbi krimet dhe ndëshkimet “.

Me aprovimin e këtyre akteve ndërkombëtare fillon një etapë e re historike, ashtu që parimi i ligjshmërisë ngritët në dimension ndërkombëtar, duke u trajtuar si parim fundamental i së drejtës penale ndërkombëtare.

IV. Vështrim i veçantë i parimit të ligjshmërisë në legjislacionin penal të Republikës së Kosovës

Parimi i ligjshmërisë si kategori kushtetuese përveç që është paraparë me nenin 33 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, është paraparë edhe me nenin 1 të Kodit Penal të këtij shteti, në tekstin e mëtutjeshëm KPK-s.

Në nenin 1 të KPK-s thuhet :

- 1) Veprat penale, sanksionet penale dhe masat e trajtimit të detyrueshëm përcaktohen vetëm me ligj.
- 2) Askujt nuk mund t'i shqiptohet sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm për një vepër penale nëse para kryerjes së veprës ligji nuk e përcakton veprën si vepër penale dhe nuk parasheh sanksion penal ose masa të trajtimit të detyrueshëm për atë vepër”.

Nga përmbajtja tekstuale e kësaj dispozite, ku parimi i ligjshmërisë është përcaktuar, rezultojnë tri elemente esenciale, të cilat konsistojnë në atë se:

1. Vepra penale mund të përcaktohet vetëm me ligj,
2. Vetëm me ligj mund të përcaktohen sanksionet penale dhe masat e trajtimit të detyrueshëm dhe se,
3. Vepra penale duhet të jetë e përcaktuar para se të jetë kryer dhe sanksioni penal si dhe masa e trajtimit të detyrueshëm duhet të jenë të përcaktuara para se të jetë kryer vepra penale.

1. Vepra penale mund të jetë e përcaktuar vetëm me ligj

Në kuptim të nenit 6 të KPK-së, “vepra penale është vepër e kundërligjshme e cila është e përcaktuar me ligj si vepër penale, tiparet e së cilës janë të përcaktuara me ligj dhe për të cilën me ligj ...”. Nga kjo rezulton se të përcaktosh veprën penale me ligj, do të thotë të përcaktosh në mënyrë abstrakte dhe precize të gjitha tiparet e figurës së veprës penale.

Për të sendërtuar parimin e ligjshmërisë në të drejtën penale, është me rëndësi të veçantë që figura e veprës penale të jetë precize dhe e qartë, në mënyrë që gjatë zbatimit mos të ketë interpretime arbitrare nga ana e organit shtetëror kompetent. Poqë se, figura e veprës penale është jo e saktë dhe e pa qartë, atëherë me këso normash juridike nuk mund të luftohet kriminaliteti, arbitrariteti dhe keqpërdorimet e organeve shtetërore. Për hir të respektimit në mënyrë vullnetare dhe sjelljes së qytetarëve konform

dispozitive ligjore, ata duhet të njoftohen me kohë dhe në mënyrë të përshtatshme, për atë se cilat veprime ose mosveprime janë të ndëshkueshme.

2. Vetëm me ligj mund të caktohet sanksioni penal dhe masa e trajtimit të detyrueshëm

Në kuptim të nenit 1 paragrafi 2 të KPK-s, përkitazi me përcaktimin e sanksionit penal është paraparë: “ vepra penale është ..., tiparet e së cilës janë të përcaktuara me ligj dhe për të cilën me ligj është paraparë sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm”.

Nga kjo rezulton se të përcaktosh sanksionin penal ose masën e trajtimit të detyrueshëm me ligj do të thotë të përcaktosh në mënyrë abstrakte llojin dhe lartësinë e sanksionit penal ose llojin e masës së trajtimit të detyrueshëm dhe kohëzgjatjen e tyre, ashtu që të njëjtat, poqë se nuk janë të përcaktuara me ligj, para se të jetë kryer vepra penale, nuk do të mund t’i shqiptohen askujt. Ky element i parimit të ligjshmërisë është garanci për zbatimin e tij në të drejtën penale, me rastin e shqiptimit të sanksionit penal dhe masës së trajtimit të detyrueshëm kundër kryerësit të veprës penale.

3. Vepra penale duhet të jetë e përcaktuar para se të jetë kryer dhe sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm duhet të jenë të përcaktuara para se të jetë kryer vepra penale

Ky element i parimit të ligjshmërisë është i paraparë me nenin 1 paragrafi 2 të KPK-s, me përmbajtje siç është cekur më lartë.

Nga ajo rezulton se është i ndaluar shqiptimi i sanksionit penal ose i masës së trajtimit të detyrueshëm për të gjitha veprat penale para se të jenë kryer të njëjtat.

Përcaktueshmëria e elementeve të figurës së veprës penale, rrezikshmëria shoqërore e veprimeve dhe mosveprimeve inkriminuese, kundërligjshmëria dhe fajësia e kryerësit të veprës penale, duke ndërlidhur edhe mundësinë e njoftimit të qytetarëve për sjelljet e ndaluara dhe llojin si dhe lartësinë e sanksionit penal, e bëjnë shqiptimin e sanksionit penal adekuat, të arsyeshëm për risocializimin e kryerësve të veprave penale si dhe ngritjen e përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve për mos shkeljen e dispozitive pozitive ligjore.

Në fushën e të drejtës penale, parimi i ligjshmërisë është specifik dhe konsiston në atë që:

- të gjitha organet gjyqësore, me rastin e shqiptimit të sanksioneve penale ose masave të trajtimit të detyrueshëm ndaj kryerësve të veprave penale, të njëjtat duhet ta zbatojnë ligjin që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale,
- vetëm me ligj përcaktohen veprat penale, sanksionet penale dhe masat e trajtimit të detyrueshëm si dhe procedura për shqiptimin e tyre dhe
- vetëm ligji e jo e drejta zakonore është burim i vetëm i të drejtës penale,
- rëndësia juridike e parimit të ligjshmërisë konsiston në jetësimin e pesë postulateve përkatësisht kërkesave, e ato janë:
- vetëm ligji është burim i të drejtës penale – nullum crimen sine lege scripta,
- ndalohet aplikimi i analogjisë – nullum crimen sine lege stricta,
- ndalohet veprimi retroaktiv i ligjit – nullum crimen sine lege praevia,
- që ligjdhënësi me rastin e përcaktimit të veprave penale duhet të shërbëhet me shprehje të qarta dhe precize, në mënyrë që të evitohet çdo arbitraritet eventual i organeve kompetente shtetërore të cilat interpretojnë dhe zbatojnë ligjet penale - nullum crimen sine lege certa,
- që ligji i cili përcakton veprën penale, të përcakton edhe sanksionin penal ose masën e trajtimit të detyrueshëm – nullum crimen nulla poena sine lege⁴²².

Pasi që, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë kategori kushtetuese, atëherë edhe kufizimi i tyre mund të bëhet sipas dispozitave ligjore të cilat pa tjetër duhet të jenë në harmoni me dispozitat kushtetuese.

Ndër të tjera , kufizimi i lirisë së lëvizjes gjatë të gjitha fazave të procedurës penale, me theks të veçantë kur kemi privimin nga liria të të dyshuarit pa urdhër të gjykatës , ky kufizim i lirisë duhet të jetë në pajtim me ligjin , me

⁴²² Dr.Ismet Salihu,E drejta penale – pjesa e përgjithshme, Prishtinë,2003,faqe 136-137, Dr.Franjo.Baçiq, E drejta penale – pjesa e përgjithshme, Zagreb, 1995, faqe 60 dhe 61, Mr.sc.Bajram Ukaj , artikulli Parimi i ligjshmërisë, në revistën për çështje juridike dhe shoqërore “ E Drejta “ , nr. 2, Prishtinë, 2002, faqe 74 dhe 75. si dhe Ligjëratat e Avokat Ramë Gashit, Kodi Penal i Kosovës, pjesa e përgjithshme – pjesa e parë, përkritazi me parimin e ligjshmërisë, për Institutin Gjyqësor të Kosovës, gusht 2008

kushtetutën e vendit si akt më i lartë juridik por edhe me aktet gjegjëse ndërkombëtare.

Parimi i ligjshmërisë, për t'u zbatuar në praktikë në mënyrë sa më të plotë , edhe atë në pikëpamje penalo-juridike, është më se e domosdoshme që në një shtet:

- tri pushtetet shtetërore të jenë të pavarura, me theks të veçantë pushteti gjyqësor, meqë i njëjti duhet të ushtrohet në bazë të Kushtetutës, Ligjit dhe akteve tjera të atij shteti por edhe të akteve ndërkombëtare,
- të mbretëroj shteti ligjor, ashtu që mbi ligjin mos të jetë askush,
- të jetësohen parimet demokratike në çdo pore të jetës, me theks të veçantë që në epiqendër të sistemit të jenë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe qytetarit si dhe mbrojtja e tyre sipas standardeve ndërkombëtare,
- të jetë e harmonizuar nomenklatura ligjore me standardet ndërkombëtare, në mënyrë që të hartohet në mënyrë progresive me shtetet e qytetëruara bashkëkohore,
- të jenë të harmonizuara dispozitat ligjore me dispozitat e kushtetutës, si akt më i lartë juridik i një vendi, si dhe
- të ngritët vetëdija e qytetarit, që në mënyrë permanente të mbrohet ligjshmëria në çdo pore të shoqërisë, ashtu që të gjithë së bashku me organet kompetente shtetërore të mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore të tyre, sigurinë dhe pavarësinë e vendit por edhe paqen si në nivel vendi ashtu edhe jashtë tij,
- tek e fundit , parimi i ligjshmërisë ka lind dhe është zhvilluar pas shumë sfidave të forcave progresive, andaj edhe jetësimi i këtij parimi në praktikë është e drejtë dhe detyrë e çdo qytetari, meqë përmes këtij parimi mbrohet mirëqenia e tij, e në botën tonë bashkëkohore edhe më gjerë⁴²³.

⁴²³ Dr. Ismet Salihu, E drejta penale - pjese e përgjithshme, Prishtinë, 2002, faqe 138, Mr. Sc. Bajram Ukaj, artikulli Parimi i ligjshmërisë, në revistën për çështje juridike dhe shoqërore, "E Drejta ", nr.2 faqe 76-78.



Naser FONIQI

PARABURGIMI SIPAS KODIT TË PROCEDURËS PENALE TË KOSOVËS DHE KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Një ndër masat të cilat mund të përdoren për të siguruar praninë e të pandehurit, pengimin e ri kryerjes së veprës penale dhe sigurimin e suksesshëm të zhvillimit të procedurës penale është edhe paraburgimi.

Me rastin e arrestimit personi që i nënshtrohet paraburgimit gëzon këto të drejta:

- informohet në gjuhën që ai e kupton për arsyet e arrestimit;
- të heshtë dhe të mos përgjigjet në asnjë pyetje, përveç dhënies së informatave për identitetin e tij;
- nëse nevojitet, t'i sigurohet përkthimi falas;
- të shfrytëzoi ndihmën e mbrojtësit dhe t'i caktohet mbrojtës nëse nuk ka mundësi të paguaj për ndihmë ligjore;
- për arrestimin e tij të lajmëroj ose të kërkoj nga policia ta lajmëroj anëtarin e familjes ose ndonjë person tjetër sipas zgjedhjes së tij;
- të ketë kontroll dhe trajtim mjekësorë duke përfshirë edhe trajtimin psikiatrik dhe
- kur personi i arrestuar është shtetas i huaj, ai ka të drejtë ta njoftoj dhe komunikoj gojarisht ose me shkrim me zyrën e ndërlidhjes, me misionin diplomatik të shtetit të tij.

Paraburgimi është masa më e rëndë që mund t'i urdhërohet të pandehurit dhe për këtë arsye urdhërohet vetëm kur me masat tjera më të buta nuk mund të arrihet qëllimi i masave nga kapitulli i XXX i Kodit Penal të Kosovës. Me rastin e vendosjes për masën e paraburgimit, gjykata detyrohet t'i marr parasysh kushtet e përcaktuara dhe të siguroj që të mos zbatohet këto masë kur mjafton ndonjë nga masat tjera të parapara me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës. Sipas nenit 279 të KPPK, paraburgimi mund të caktohet

vetëm nën kushtet dhe në pajtim me procedurat e parapara me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës.

Paraburgimi duhet të reduktohet në kohën sa më të shkurtër të mundshme dhe kur i pandehuri mbahet në paraburgim, të gjitha organet që ndërmarrin veprime në procedurën penale detyrohen të veprojnë brenda afateve të parapara me Kodin e Procedurës Penale të Kosovës. Kjo masë mund të hiqet në çdo fazë të procedurës penale, posa të pushojnë shkaqet për caktimin e tij. Për këtë arsye aktvendimi për caktimin dhe vazhdimin e paraburgimit, janë vendimet e vetme të gjykatës me të cilat procedura nuk përfundohet në formë të prerë, e ndaj të cilave është e lejuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë⁴²⁴.

Paraburgimi, përveç në rastin e paraparë me nenin 306, paragrafi 4 dhe neni 393, paragrafi 1, i KPPK, gjithnjë caktohet me kërkesë të prokurorit publik. Gjykata sipas nenit 281, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, mund të caktoj paraburgimin ndaj një personi nëse:

- Ekziston dyshimi i bazuar se personi i tillë ka kryer vepër penale;
- Përbushet njëri nga kushtet e mëposhtme;
- (i) Kur ai fshihet, kur identiteti i tij nuk mund të vërtetohet ose kur ekzistojnë rrethana tjera që tregojnë se ekziston rreziku i ikjes së tij;
- (ii) Kur ka arsye për të besuar se ai do t'i asgjësoj, fshehë, ndryshoj ose falsifikoj provat e veprës penale, ose kur rrethanat e posaçme tregojnë se ai do të pengoj rrjedhën e procedurës penale, duke ndikuar në dëshmitarë, në të dëmtuar, në bashkëpjesëmarrës, etj;
- (iii) Kur pësia e veprës penale, mënyra ose rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, karakteristikat e tij personale, sjellja e mëparshme, ambienti dhe kushtet nën të cilat ai jeton ose ndonjë rrethanë tjetër personale tregojnë rrezikun se ai mund të përsëris veprën penale, mund ta përfundoj veprën e tentuar penale ose ta kryej veprën penale për të cilën është kanosur ta kryej;
- Masat e parapara me nenin 268, paragrafi 1, të këtij kodi do të ishin të pamjaftueshme për të siguruar praninë e personit të tillë, të parandaloj përsëritjen e veprës penale dhe të siguroj zbatimin e suksesshëm të procedurës penale.

Sipas nenit 282, të KPPK, paraburgimin e cakton gjyqtari i procedurës paraprake i gjykatës kompetente, brenda 48 orësh nga ndalimi policor, në

⁴²⁴ KPPK neni 451, par. 4,

bazë të kërkesës me shkrim të prokurorit publik, pas seancës së dëgjimit të palëve, për të gjitha çështjet të cilat mund të jenë të rëndësishme për zbatimin e masave nga ky kapitull.

Kur personi i arrestuar nuk angazhon mbrojtës brenda 24 orëve, gjykata ia cakton mbrojtësin sipas detyrës zyrtare. Paraburgimi caktohet me aktvendim me shkrim, i cili përfshin emrin dhe mbiemrin e personit që paraburgoset dhe të dhënat tjera personale, kohën e saktë të arrestimit, kohën e sjelljes te gjyqtari i procedurës paraprake, kohën e marrjes në pyetje për paraburgim, veprën penale për të cilën akuzohet, bazën ligjore për paraburgim, njoftimin për të drejtën në ankesë, arsyetimin e fakteve vendimtare që e kanë shkaktuar caktimin e paraburgimit, duke përfshirë edhe arsyet për dyshim të bazuar se personi ka kryer vepër penale. Aktvendimi për caktimin e paraburgimit i dorëzohet personit përkatës, mbrojtësit të tij dhe prokurorit publik. Secila palë mund të paraqes ankesë brenda 24 orëve nga koha e dorëzimit të aktvendimit. Për ankesën vendos kolegji i gjykatës përkatëse, i përbërë prej tre gjyqtarëve profesionalë, brenda 48 orëve nga paraqitja e saj.

I paraburgosuri mund të mbahet në paraburgim më së shumti një muaj nga dita e arrestimit në bazë të aktvendimit të parë. Pas kësaj kohe, ai mund të mbahet në paraburgim vetëm me aktvendim të gjykatës për vazhdimin e paraburgimit.

Para ngritjes së aktakuzës paraburgimi nuk mund të zgjas më shumë se:

- Tre muaj kur procedura zbatohet për vepër penale të dënueshme me më pak se pesë vjet;
- Gjashtë muaj kur procedura zbatohet për vepër penale të dënueshme me burgim mbi pesë vjet;
- Përveç afateve të shënuara më lart, para ngritjes së aktakuzës paraburgimi mund të vazhdohet më së shumti:
- Nëntë muaj kur procedura zbatohet për vepër penale të dënueshme me më pak se pesë vjet burgim ose
- Dymbëdhjetë muaj kur procedura zbatohet për vepër penale të dënueshme me të paktën pesë vjet burgim, ndërsa në rrethana të jashtëzakonshme kur mosparaqitja e aktakuzës brenda afatit të paraparë ndërlihet me ndërlikueshmërinë e rastit ose me faktorë të tjerë që nuk mund t'i atribuohen prokurorit publik.

Nëse aktakuza nuk ngritet brenda afatit të paraparë, i paraburgosuri lirohet. Paraburgimi i caktuar nga gjyqtari i procedurës paraprake mund të zgjatet nga kolegji prej tre gjyqtarëve profesionalë, jo më shumë se dy muaj, ndërsa

paraburgimi i caktuar prej tre gjyqtarëve profesionalë mund të zgjatet nga gjyqtari i procedurës paraprake, jo më shumë se një muaj. Ndaj çdo aktvendimi për vazhdimin e paraburgimit mund të ushtrohet ankesa brenda 24 orëve.

Me pëlqimin e prokurorit publik, gjyqtari i procedurës paraprake, gjatë zbatimit të hetimeve, sipas detyrës zyrtare, në çdo kohë mund ta heqë paraburgimin. Kur prokurori publik dhe gjyqtari i procedurës paraprake nuk mund të arrijnë marrëveshje për heqjen e paraburgimit, gjyqtari i procedurës paraprake kërkon që për këtë çështje të vendosë kolegji prej tre gjyqtarësh. Ky kolegji merr aktvendim brenda 48 orëve nga pranimi i kërkesës nga gjyqtari i procedurës paraprake. Paraburgimi mbahet në lokale të posaçme të paraburgimit ose në pjesë të ndarë të institucionit për vuajtjen e dënimeve me burgim. Personat e gjinive të ndryshme, ata që kanë marrë pjesë në kryerjen e veprës së njëjtë penale, ata që vuajnë dënimin dhe personat që kanë përsëritur veprën penale, nuk mund të vendosen në të njëjtën dhomë.

Gjatë mbajtjes së paraburgimit, i paraburgosuri mund të mbajë dhe shfrytëzoj sende për përdorim personal, për mbajtje të higjienës, pajisje për dëgjimin e mediave publike, publikime, literaturë të ndryshme, para dhe sende tjera të lejuara. I paraburgosuri ka të drejtë në tetë orë pushim pandërprerë, brenda 24 orëve dhe së paku 2 orë në ditë lëvizje në ambient të hapur. Personi i cili gjendet në paraburgim mund të kryej punë të ndryshme, për punën e kryer ka të drejtë pagese, të mbajë pastërtinë në lokalet e paraburgimit, të merret me aktivitete që i përgjigjen aftësive fizike dhe mendore, brenda mundësive dhe kushteve me të cilat disponon institucioni dhe me kusht që të mos dëmtoj rrjedhën e procedurës penale.

Me lejen e gjyqtarit të procedurës paraprake, nën mbikëqyrjen e personit të caktuar, i paraburgosuri mund të vizitohet nga farefisi, mjeku apo persona të tjerë, duke respektuar rregullat e institucionit të paraburgimit. Sipas nenit 295, të KPPK, gjyqtari i procedurës paraprake ose kryetari trupit gjykues mund të shqiptoj dënim disiplinor të ndalimit ose kufizimit të vizitave a korrespondencave ndaj të burgosurit që ka bërë shkelje disiplinore, të parapara me nenin 295, paragrafi 2, i KPPK. Kryetari i gjykatës kompetente mbikëqyr trajtimin e të paraburgosurve.

Paraburgimi sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut


Edhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në nenin 5 të saj, parasheh se çdo person ka të drejtën e lirisë dhe sigurisë. Sipas këtij neni

askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve dhe në përputhje me procedurën ligjore:

- a. kur burgoset ligjërisht, pas një dënimi të dhënë nga një gjykatë kompetente;
 - b. kur arrestohet ose burgoset ligjërisht për moszbatim të një urdhri të dhënë nga gjykata në përputhje me ligjin ose për të garantuar përmbushjen e një detyrimi të parashikuar nga ligji;
 - c. kur është arrestuar dhe paraburgosur për t'u dërguar përpara autoritetit gjyqësor kompetent, kur ka arsye të besueshme për të dyshuar që ai ka kryer një vepër penale, ose kur ka motive të arsyeshme për të besuar se është e domosdoshme që të pengohet të kryej një vepër penale ose të largohet pas kryerjes së saj;
 - d. kur është fjala për heqjen e lirisë së një të mituri ligjërisht, për të cilin është vendosur për edukimin të mbikëqyrur, ose për heqjen e rregullt të lirisë së tij, me qëllim për ta dërguar përpara autoritetit gjyqësor kompetent;
 - e. kur është fjala për heqjen ligjërisht të lirisë së një personi për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve, të një të çmenduri, të një alkooliku, të një toksikomani ose të një vagabondi;
 - f. kur është fjala për arrestimin ose burgimin e ligjshëm të një personi me qëllim që të ndalohet hyrja e tij e parregullt në atë vend, ose kundër të cilit është duke u kryer një procedurë dëbimi ose ekstradimi;
2. Çdo person i arrestuar duhet të informohet, brenda një afati sa më të shkurtër dhe në një gjuhë që ai e kupton, për arsyet e arrestimit të tij dhe në lidhje me akuzën që i bëhet.
 3. Çdo person i arrestuar dërgohet menjëherë përpara një gjykatësi ose magjistrati tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet gjatë procedurës. Lirimi mund të kushtëzohet me një garanci që siguron paraqitjen e personit të interesuar përpara gjykatës.
 4. Çdo person të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të paraqes ankim përpara një gjykate me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe urdhëroi lirimin, në qoftë se burgimi është i paligjshëm.
 5. Çdo person, viktimë e një arrestimi ose një burgimi në kushte të kundërta me dispozitat e këtij neni ka të drejtë për dëmshpërblim.



Shashivar Hoti



Sadije Abdullahu –Sahiti

EKZEKUTIMI NË LLOGARINË BANKARE: KONFISKIMI DHE BARTJA E SHUMËS

PJESA E PARË

Ekzekutimi sipas dispozitave të ligjit të vjetër mbi ekzekutimin (1978)

Duke pas për bazë se çështja e përmbarimit në llogarit bankare para hyrjes në fuqi të ligjit të ri i cili ka hyrë në fuqi në qershor të vitit 2008 është rregulluar me ligjin e vjetër të vitit 1978 të LPP, si dhe duke pas për bazë se në dispozita kalimtare të LPP ë vitit 2008 konkretisht në nenin 302⁴²⁵ të këtij ligji është potencuar se lëndët e filluara në punë me ligj të vjetër të vitit 1978 edhe pse ligji i ri ka hyrë në fuqi procedura përmbarimore duhet zhvillohet sipas ligjit të vjetër. Andaj, duhet të japim një vështrim të shkurtër se si rregullohet çështja sipas këtij ligji të vitit 1978 LPP. Ekzekutimi i kërkesës në të holla – Kompetenca tokësore-territoriale.

Për të vendosur mbi propozimin për përmbarim për ekzekutimin e kërkesës në të holla kompetente është gjykata ku debitori e ka vendbanimin, nëse nuk i dihet vendbanimi i debitorit atëherë mund të merret për bazë vendqëndrimi i tij, andaj në paragrafin e me sipër cituar vlejnjë dispozita ligjore edhe për zbatimin e përmbarimit edhe ndaj personave juridik, konkretisht aty ku gjendet selia e debitorit është kompetente gjykata për të vendosur në çështjen përmbarimore andaj sipas dispozitave ligjore për caktimin e kompetencës tokësore merret për bazë edhe filial e personit juridik ku të gjitha janë të rregulluara me dispozita ligjore të nenit 91 LPP⁴²⁶.

⁴²⁵ Ligji i Procedures Permbarimore viti 1978

⁴²⁶ Po aty

Përrjashtimi nga ekzekutimi

Nëse ndaj një debitori gjykata ka lejuar propozimin për përmbarrim nuk do të thotë se gjitha mjetet që janë në llogari bankare të debitorit mund të bëhen mjet ekzekutimi sepse sipas dispozitave ligjore të nenit 92⁴²⁷ LPP prej paragrafit 1 e deri në paragrafin 10 janë mjetet të cilat janë të përjashtuara nga përmbarrimi andaj të njëjtat nuk mund të përmbarrohen sepse nga vet ligji janë të përjashtuara dhe gjykata gjatë zbatimit të përmbarrimit duhet jetë e kujdesshme lidhur me zbatimin e përmbarrimit.

Mënyra e zbatimit të përmbarrimit

Ekzekutimi i kërkesës në të holla zbatohet sipas LPP, ekzistojnë dy faza :

Faza e nxjerrjes së aktvendimit mbi ndalimin e mjeteve që gjenden në llogari bankare. Faza e nxjerrjes së aktvendimit mbi bartjen e mjeteve nga llogaria e debitorit në llogarinë e kreditorit. Gjykata është e obliguar të veprojnë sipas titullit përmbarrimor ndërsa zbatimin sipas propozimit për përmbarrimin të parashtruar nga kreditori, andaj në praktikën gjyqësore hasim raste kur kreditori mund të kërkojë vetëm ndaljen e mjeteve monetare në llogari bankare, dhe nuk ka parashtruar kërkesë edhe për bartjen e mjeteve në llogarinë bankare të tij. Andaj kreditori sipas dispozitave ligjore është paraparë që në kohëzgjatje prej tre muajve duhet të bëjë kërkesë për bartjen e mjeteve monetare, në të kundërtën gjykata do të pezullojë procedurën përmbarrimore. Të gjitha janë paraparë në dispozita të nenit 94 LPP⁴²⁸.

Vëllimi i ekzekutimit

Aktvendimi mbi ndalesën dhe bartjen e kërkesës në të holla zbatohet vetëm në shumë që i nevojitet për pagesën e kërkesës në të holla si dhe shpenzimet procedurale të parapara në titull ekzekutiv dhe shpenzimeve të krijuara gjatë zhvillimit të procedurës përmbarrimore të parapara në nenin 95 LPP⁴²⁹.

Radha dhe përparësia e zbatimit

Radha dhe përparësia e lidhur me drejtën e zbatimit për përmbarrim përcaktohet sipas datës së marrjes së propozimit për përmbarrim nga gjykata

⁴²⁷ Po aty

⁴²⁸ Ligji i Procedurës Përmbarrimore vitit 1978

⁴²⁹ Po aty

ku i dorëzohet bankës për zbatim, ku e njëjta sipas ligjit është e obliguar të bëjë renditjen e kërkesave për zbatimin e tyre. Kërkesat e ndalura i barten kreditorit sipas propozimit të tij, dhe aktvendimi mbi bartje mund të nxirret vetëm pasi që aktvendimi mbi ndalim ka marrë formën e prerë.

Zbatimi i përmbarimit

Bartja e kërkesës është e zbatuar atëherë kur vendimi të jetë dorëzuar debitorit të debitorit- bankës dhe mjetet janë bartur në llogarinë e kreditorit me hollësisht janë paraparë në dispozitat e nenit 107 LPP⁴³⁰.

PJESA E DYTË

Ekzekutimi i mjeteve në llogarinë bankare sipas Ligjit të Procedurës Përmbarimore (2008)

Kompetenca territoriale

Duke pas për bazë se çështja e përmbarimit për kërkesa në të holla janë të parapara në dispozita ligjore të nenit 102 LPP ku kompetente për vendosjen në këtë çështje përmbarimore është gjykata në territorin e të cilës gjendet vendbanimi i debitorit apo vendqëndrimi i tij. Dispozitat e këtij neni kanë të bëjnë me vendbanimin apo vendqëndrimin e debitorëve personave fizik dhe zbatohen në mënyrë të përshtatshme edhe për selinë e personave juridik.

Përmbarimi sipas llogarisë bankare

Në bazë të dispozitave të nenit 144 LPP⁴³¹ përmbarimi për realizimin e kërkesave në të holla ndaj debitorit, përmbarimi mund të zbatohet në gjitha mjetet monetare që i ka në llogari debitorit përveç nëse me ligj është paraparë diçka ndryshe. Me aktvendimin për përmbarim të lejuar nga gjykata mjetet monetare të evidentuara në llogarinë e debitorit, banka me aktvendim urdhërohet që mjetet të kalojnë nga llogaria bankare e debitorit në llogarinë bankare të kreditorit. Gjykata me aktvendim për përmbarim do ta detyroj bankën që ta njoftoj gjykatën për të gjitha ndryshimin e llogarisë bankare të debitorit se a ka mjete të mjaftueshme për ekzekutimin e vendimit si dhe si dhe transaksionet tjera kalimi i mjeteve monetare në

⁴³⁰ Po aty

⁴³¹ Ligji i Procedure Përmbarimore viti 2008

llogari tjetër brenda bankës si dhe ndryshimi i llogarisë bankare ku më konkretisht janë të parapara në nenin 145 LPP⁴³².

Radha e Pagesave

Me dispozita të nenit 146 LPP⁴³³ është paraparë se radha e pagesave që e bënë banka është sipas kohës së arritjes së aktvendimit me të cilin urdhërohet përmbarimi. Dhe banka për këtë mban evidencë të veçantë për radhitjen e aktvendimeve për përmbarim sipas ditës dhe kohës së arritjes së përmbarimit.

Pagesa Periodike

Banka në bazë të aktvendimit për përmbarim është urdhëruar që të bëjë pagesën periodike, banka zbaton një vendim të tillë të paraparë në dispozita të nenit 147 al 3 LPP⁴³⁴ ku banka mban evidencë të tillë me pagesat periodike.

Veprimi nëse nuk ka mjete në llogarinë bankare.

Nëse llogaria bankare nuk ka mjete të mjaftueshme apo nuk ka mjete fare në llogarinë e debitorit banka është e obliguar që ta njoftoj me një njoftim të veçantë gjykatën kompetente, por nëse brenda asaj banke debitori ka një llogari tjetër dhe në atë llogari ka mjete monetare të mjaftueshme për ekzekutimin e vendimit, banka është e obliguar që nga llogaria tjetër e debitorit ti bart mjetet në llogarinë e kreditorit. Nëse banka nuk arrin në tërësi ta përmbush kërkesën e kreditorit, nga shkaku se nuk ka mjete të mjaftueshme në llogarinë e debitorit, banka mban evidencë të posaçme dhe e njëjta është e obliguar që posa të arrin mjete monetare në llogarinë e debitorit ti bart në llogarinë e kreditorit.

Përmbarimi ndaj debitorëve Solidar

Në qoftë se sipas dokumentit përmbarimor ka dy apo me tepër persona që janë përgjegjës solidar atëherë gjykata sipas kërkesës së propozuesit për përmbarim mund të caktoj radhën e pagesës së debitorëve solidar, nëse ndonjëri nuk ka në llogarinë bankare mjete atëherë fillon me debitorin tjetër solidarë, atëherë aktvendimi për përmbarim i dërgohet bankës ku gjendet

⁴³² Po aty

⁴³³ Po aty

⁴³⁴ Po aty

llogaria e debitorit tjetër. Nëse ndonjëri nga debitorët e përmbush obligimin në tërësi dhe mjetet barten në llogarinë e kreditorit, e njëjta nuk vepron ndaj debitorëve të tjerë.

Përmbartimi në llogarinë Bankare të personit juridik

Si palë në procedurën përmbartimore përveç personave fizik në cilësinë e debitorit mund të jetë edhe personi juridik, nëse personi juridik ka llogari bankare në disa banka atëherë vlejné dispozitat e nenit 150 LPP⁴³⁵.

Përmbartimi për mjete në llogarinë revizore. Në qoftë se përmbartimi bëhet me qëllim të përmbushjes së kredisë në mjetet tjera në llogari devizore mjetet barten duke i llogaritur në euro apo në valuta tjera sipas kursit bankar në ditën e bartjes, duke ju referuar dispozitave ligjore të nenit 152 LPP⁴³⁶. Nëse kreditorit në dokumentin ekzekutiv i është konstatuar pagesa në të holla që kanë valutë të huaj apo debitori ka llogari në valutë të huaj me aktvendim urdhërohet banka në të cilin vend ndodhet llogaria devizore e debitorit.

Sekuestrimi në llogarinë bankare më pëlqimin e debitorit

Debitori ka të drejtë të jap pëlqimin që të përmbush kërkesën e kreditorit që të sekuestrohen drejtpërdrejtë nga llogaria e tij bankare dhe të barten në llogarinë e kreditorit, dokumenti i vërtetuar nga debitori prodhon të njëjta efekte si aktvendimi i formës së prerë.

Përgjegjësia e bankës për dëmin e shkaktuar

Banka nëse nuk vepron në pajtim me aktvendimin për përmbartim dhe urdhëresat tjera të gjykatës, është përgjegjëse për dëmin e shkaktuar propozuesit për përmbartim, sipas rregullave të përgjegjësisë të drejtës civile për shpërblimin e dëmit, për realizimin e kredive në të holla në përshtatshmëri zbatohen dispozitat e nenit 102⁴³⁷ dhe 144 LPP⁴³⁸.

⁴³⁵ Ligji I Procedures Përmbartimore vitit 2008

⁴³⁶ Po aty

⁴³⁷ Po aty

⁴³⁸ Po aty

Transferi i shumës së konfiskuar

Pasi që aktvendimi të ketë marrë formën e prerë i urdhërohet bankës që nga xhirollogaria e debitorit të bart në xhirollogarinë e kreditorit, dhe për shërbimet e kryera banka e njofton me shkrim gjykatën.



Musa Xh.DRAGUSHA

STANDARDET PROFESIONALE DHE ETIKE TË AVOKATIT **Në funksion të procedurave të drejta, të efektshme e të paanshme** **gjqësore**

1. Hyrja

Një sistem efektiv dhe korrekt gjyqësor është fundamental për çdo shoqëri. Në kontekstin e Kosovës, kjo është e rëndësishme edhe më të madhe, në dritë të ekzistimit të klimës politike dhe sociale dhe natyrës vitale të sistemit të tillë për sukses. Rëndësia e vendosjes së standardeve të larta profesionale dhe etike si dhe pajisja me ekspertizën e mjaftueshme ligjore është e nevojshme sidomos në kushtet e Kosovës, ku perceptimi tradicional i komunitetit për sistemin e drejtësisë, për shkak të përvojës historike është i një niveli tejet zhgënjyes.

Në situatën kur procedurat gjyqësore përcillen me të meta evidente si: me besim të komprometuar historik, mosnjohje në vazhdim të standardeve dhe praktikave ndërkombëtare, pa arritur të shënoj shkëputjen e domosdoshme nga praktikat e kaluara te trajtimi rutinor i rasteve, detyrat për përmirësime janë të vazhdueshme. Kur krejt kësaj i shtohen të metat dhe dështimet në përgatitjen profesionale, etikën dhe kompetencën e avokatëve në përfaqësimin e rasteve para gjykatave atëherë krejt e qartë bëhet pasqyra për gjendjen në të cilën ndodhet edhe sot sistemi i drejtësisë kosovare dhe mënyrën se ai si i këtillë si perceptohet nga komuniteti të cilit do të duhej që ti shërbej.

Nga kjo dalin edhe detyrimet e të gjitha degëve të drejtësisë për përpjekje të shtuara në reformimin e procedurave gjyqësore. Nga këtu, edhe më e madhe detyrimi i avokaturës-si degë e rëndësishme e sistemit të drejtësisë, në mënyrë që të shtoj ndikimin në përmirësimin e administrimit të drejtësisë, përparimin e sistemit të judikaturës dhe përmirësimin e vazhdueshëm të ligjit, në veçanti ndikimin në efektshmërinë, paanshmin dhe transparencën e procedurave gjyqësore.

Derisa pranohet që kryesorja për mbrojtjen e të drejtave të të pandehurit është roli i mbrojtësit, nga ana tjetër dihet se gjeneratat e tanishme të avokatëve kanë pak përvojë në ushtrimin e profesionit nën kërkesat e standardeve ndërkombëtare⁴³⁹. Korniza ligjore dhe procedurat me standarde të larta ndërkombëtare kërkojnë kualifikim, arsimim dhe profesionalizëm⁴⁴⁰. Ndërsa, nga ana tjetër monitorimet e shumta objektive të sistemit të drejtësisë identifikojnë se mbrojtësit akoma vazhdojnë të reflektojnë rolin e mbrojtësit nga sistemi i kaluar juridik, sepse ata shpesh anashkalojnë detyrat për mbrojtje të efektshme⁴⁴¹.

Kosova e pas vitit 1999, ka qenë në një situatë unike, profesioni ligjor i ishte ekspozuar ndikimeve ndërkombëtare të të dyja sistemeve juridike, anglosaksone dhe kontinentale, ndërsa avokatëve u imponohej një llojllojshmëri e paparë e praktikave, procedurave dhe metodologjive. Me këtë shfaqet nevoja për avokatin ta merr përsipër përgjegjësinë për klientin e vet. Përparime duhet shënuar: në analizën e argumenteve mbrojtëse; paraqitjen e dëshmive mbështetëse në seancë; kundërshtimet e dëshmive të papranueshme, zbulimin e dëshmive shfajësuese së bashku me paraqitjen në mënyrën e duhur të rrethanave lehtësuese⁴⁴².

⁴³⁹ Sipas Ligjit për avokaturën dhe ndihmën tjetër juridike (G.z. Kosovës Nr. 49/2009) e drejta për të ushtruar profesionin e avokatit fitohet me regjistrimin në regjistrin e avokatëve (që mbahet nga OAK). E drejta për t'u regjistruar i takon çdo personi që përmbush kushtet si në vijim...6) të meritojë besimin për të ushtruar profesionin e avokaturës, kurse për bartësit e funksioneve në drejtësi edhe: f) të mos jetë shkarkuar apo pezulluar si gjyqtar apo avokat; g) të mos jetë përfshirë në ndonjë aktivitet që është në kundërshtim me profesionin e avokatit në veçanti në ndonjë veprimtari që cenon pavarësinë e tij/saj profesionale.

⁴⁴⁰ Vlerësimet...tregojnë për një profesion të avokatit, i cili ka bërë hapa të rëndësishëm në reformën ligjore, por që ende është duke bërë mundime t'i tejkalojë kufizimet për përfaqësim të trashëguara nga Jugosllavia socialiste e pas luftës së dytë botërore; të rehabilitohet nga kufizimet dhe konflikti i vitit 1990... t'i përshtatet ekonomisë së tregut me zhvillimin e sektorit privat. Indeksi i Reformës së Profesionit Ligjor për Kosovë, ABA-CEELI, Prishtinë, korrik 2004, fq. 7.

⁴⁴¹ Në një rast pranë gjykatës së qarkut në Gjiilan/Gnjilane që kishte të bëjë me akuzat për posedim të paligjshëm të armëve, seance ishte shtyre më 26 tetor 2004 për shkak të mungesës së avokatit mbrojtës. Gjykata kishte thirrur avokatin mbrojtës i cili kishte dështuar ta informojë gjykatën se ishte në pushim vjetor. Në një rast pranë gjykatës së qarkut në Gjiilan, që kishte të bëjë me akuzat për vjedhje me dhunë, plaçkitje dhe vjedhje të rëndë, OSBE-ja ka vërejtur një mungesë të përsëritur të avokatit mbrojtës. Avokatët mbrojtës në mënyrë konsistente kishin anashkalluar detyrat e tyre duke ia bartur autorizimin për përfaqësim njëri tjetrit gjatë seancave të ndryshme gjyqësore. Për shembull, në disa raste një avokat mbrojtës i përfaqësonte prej tetë deri në nëntë të akuzuar. Një sjellje e tillë vazhdoi deri kur njëri nga avokatët mbrojtës, gjatë një seance gjyqësore të mbajtur më 14 maj 2003, u ankua se ai nuk mund të vazhdoi të zëvendësoi kolegët e tij. Të pandehurit deri në atë moment kishin duruar një mbrojtje jo të qëndrueshme dhe të përgatitur keq. Për më tepër shiko: OSCE-Misioni në Kosovë, SMSJ-Po aty

⁴⁴² Megjithatë, duhet përmendur që shpesh opinioni mund ta fitojë një përshtypje të gabuar për reformimin e profesionit ligjor, edhe për shkak që janë të pranueshme edhe në shoqëritë me të zhvilluara se Kosova. Për shembull, sipas Këshillit të Odave dhe Shoqatave të Avokatëve të Unionit Evropian (CCBE), në vitin 2002 në Poloni, profesionin e avokatit e kanë ushtruar 22,048 persona. Nga ai numër, vetëm 5,315, ose 24% prej tyre ishin avokatë. Marre nga Indeksi i Reformës së Profesionit Ligjor për Kosovë, ABA-CEELI, Prishtinë, korrik 2004

Legjislacioni i ri i drejtësisë penale, së bashku me Kodin e etikës profesionale⁴⁴³ përcakton rregulla për rolin e ri të avokatëve dhe avokatisë në përgjithësi e të cilat në thelb bëjnë një rivendosje të rolit e pozitës së tij⁴⁴⁴.

2. Disiplinimi për shkeljen e rregullave të etikës profesionale⁴⁴⁵

a) Sistemi i vetë disiplinës

Është sistemi i pare i njohur dhe konsiston në procedurën e disiplinës tërësisht përbrenda organizatës. Sistemi tradicional i disiplinës i ndërtuar brenda Odës është treguar tejet joefikas dhe i paqëndrueshëm. Ai ishte i bazuar dhe funksionet në tërësi sipas relikteve të së kaluarës. OAK, nuk kishte arritur të bëjë përmirësime strukturore dhe të ndërtojë një sistem të konsoliduar i cili do të ishte i qëndrueshëm dhe efikas. Derisa strukturat e Odës një sistem të mëvetësishëm të disiplinës e shikojnë si kusht të domosdoshëm për një avokaturë të pavarur, në shumë analiza jashtë saj, në rrethanat aktuale kjo pasqyrohej si e papërshtatshme⁴⁴⁶.

Kështu, Oda edhe pse në njërin anë kishte miratuar një Kod të etikës i cili siguron standarde të kënaqshme etike, ajo nuk ka arrit që të vendosë një sistem i cili në mënyrë efikase do të mbikëqyrë dhe përcjell respektimin e

⁴⁴³ Procedura disiplinore brenda një komuniteti kaq te vogël është shumë e vështirë, por duhet të zhvillohet me qëllim që komuniteti ta fitojë respektin dhe besueshmërinë e profesionit. "Të gjitha skemat e ndërlikuara të korrupsionit janë bërë me ndihmën e avokatëve, ndërsa nuk ka asnjë rast të heqjes së lejes së avokatit ose të ushtrimit të ndikimit avokat-avokat, kundër korrupsionit.", Tisne dhe Smilov, Nga Poshtë - Lart: Vlerësimi i Shënimeve mbi Përpjekjet Anti-korrupsion në Evropën Juglindore, Seria e Studimeve Politike 2004; Rrjeti i Fondacionit Soros 69. Cituar nga: Indeksi i Reformës së Profesionit Ligjor për Kosovë, ABA-CEELI, Prishtinë, korrik 2004.

⁴⁴⁴ OAK, qysh në vitin 2000, me përkrahjen e partnereve ndërkombëtar ka aprovuar një Kod të sjelljes së avokateve i cili pas amandamentimeve të mëvonshme, sipas vështrimeve komparative del të jete me i zhvilluar në rajon (Shiko: Kodi i Etikës Profesionale për Avokate, Tabela dhe Arkiva e OAK, Prishtinë, Qamil Hoxha, 10/3 ose edhe Web-site e Oak. Sipas Parimeve Themelore mbi rolin e avokateve, neni 15. "Avokatët duhet të respektojnë në çdo kohë, në mënyrë të besueshme interesat e klientëve të tyre."

⁴⁴⁵ Sa për të krahasuar: Gjyqtaret mund të shkarkohen nga detyra ose të ndëshkohen vetëm për sjellje të konsideruar si të pahijshme dhe përmes një procesi transparent dhe të udhëhequr nga kriteret objektive. Sipas rregullores KGJPK-ja është përgjegjëse për procedurën disiplinore së bashku me shërbimin e inspeksionit gjyqësor (SHIGJ), të departamentit të drejtësisë (DD). Rregullorja mbi KGJPK-ne e përkufizon sjelljen e pahijshme si në vijimi: a) kryerja e një veprë penale; b) mospërfillja e funksioneve gjyqësore; c) veprimi që është i papajtueshëm me detyrën e një gjyqtari për të qene i pavarur dhe i paanshëm; d) vënia në pozite, për shkak të sjelljes personale ose të ndonjë shkakut tjetër, që është e papajtueshme me kryerjen e detyrës së tij; ose e) shkelja e kodit të etikës profesionale. Indeksi i Reformës së Sistemit gjyqësor për Kosovë, ABA-CEELI, Prishtinë, 2004, fq. 45 dhe 46

⁴⁴⁶ Procedura disiplinore ndaj avokatëve duhet të sillet para një komiteti disiplinor të paanshëm, të themeluar nga profesioni ligjor, para një organi të pavarur statutor, apo para gjykatës dhe duhet të jetë lëndë e një shqyrtimi të pavarur gjyqësor - Neni 28 Parimet themelore mbi rolin e avokateve, Havana, Kube, 27 gusht deri 7 shtator 1990. E tërë procedura disiplinore duhet të përcaktohet në pajtim me kodin e sjelljes profesionale dhe standardet dhe etikët e pranuar profesionale të profesionit ligjor dhe në dritën e këtyre parimeve, Po aty, neni 21

këtyre standardeve⁴⁴⁷. Shpejt u vërtetua se mbikëqyrja e standardeve të reja-të konsoliduar etike nuk do të mund të bëhej me një sistem të vjetër të disiplinës dhe me një administrim të vjetër të tij. Jo vetëm nga jashtë por edhe nga brenda ky sistem është kritikuar si i paqëndrueshëm. Dhe nga kjo standardet e reja etike, megjithëse plotësisht brenda Odës u vendosën nën një sistem të ri me një administrim të ri dhe efikas⁴⁴⁸.

b) Sistemi i disiplinës nën autoritetin gjyqësor

Zgjedhja e parë, si opcion për tejkalimin e gjendjes së shkaktuar me mosfunksionimin e sistemit arkaik të vetëdisiplinimit, shihej në kalimin e tërësishëm të mbikëqyrjes së etikës në një organ jashtë strukturave të Odës. Kjo zgjedhje i referohet joefikasitetit të sistemit aktual dhe paafësisë së strukturave të organizatës për administrim efikas të tij. Pranohet se një autoritet që do të kishte fuqinë e imponimit të vendimeve të veta, do të ishte zgjedhja më e mirë për dalje nga situata e tanishme. Ky autoritet do të mund të ishte shumë më efikas se sa strukturat e brendshme, me vet faktin se posedon fuqinë autoritative, element ky që u mungon strukturave të disiplinimit të ngritura përbrenda organizatës⁴⁴⁹. Dhe, përkundër çasjeve të ndryshme për strukturën e këtij sistemi, për autoritet kërkohet Gjykata Supreme e Kosovës-respektivisht një kolegji i veçantë në kuadër të kësaj gjykate.

Në praktikat e shteteve me një sistem mjaft efikas të disiplinës në të cilat haset kjo zgjedhje, organi i cili vendosë për përgjegjësinë disiplinore të avokatëve përbëhet edhe nga një numër i konsiderueshëm i anëtarëve nga radhët e avokatëve. Mendimet që preferojnë këtë zgjedhje nuk janë për një përbërje të këtillë të autoritetit gjyqësor në procedurat në të cilat vendoset për përgjegjësinë disiplinore të avokatëve. Këto trupa shihen të jenë të

⁴⁴⁷ "Sistemi disiplinor duhet t'i adresojë çështjet e jokompetentes dhe korrupsionit me qëllim të ndërtimit të besueshmërisë dhe besimit tek publiku", Indeksi i Reformës së Profesionit Ligjor për Kosovë, ABA-CEELI, Prishtinë, korrik 2004.

⁴⁴⁸ Sa për krahasim, derisa sistemi i vjetër arkaik, pre shtate vite kishte arritur të menaxhoj vetëm 4 raste disiplinore, sistemi i ri disiplinor i ndërtuar mbi përvojat komparative e i ambientuar në rrethanat kosovare, për dy vite të funksionimit ka arritur të menaxhoj plotësisht 123 raste. Për më tepër shiko të dhënat e Zyrës disiplinore të OAK, Prishtinë, Qamil Hoxha, 10/3,

⁴⁴⁹ Presioni në mes të kolegëve të komunitetit juridik mund të rezultojë në ndërhyrje në disa raste të ndjeshme...Për shkak të numrit të vogël të avokatëve zyrtarët e gjykatave në përgjithësi kanë përvojë paraprake me avokatët e caktuar. Një përqindje e vogël e avokatëve i përfaqësojnë shumicën e rasteve penale të profilit të lartë dhe këta avokatë kanë reputacion. Të anketuarit kanë raportuar se avokatët me më përvojë dhe të mirënjohur trajtohen ndryshe. Me një popullatë të vogël (më pak se 2 milion) dhe numër të madh të rasteve penale që kanë mbetur që nga konflikti dhe pasojat e vitit 1999, opinioni publik është i njohur me avokatët më eminentë. Lëndët e ndjeshme nga aspekti etnik kanë një publicitet të gjërë dhe opinioni i përcjellë me vëmendje. Përveç kësaj, presioni dhe raportimi i mediave shpesh rezultojnë në një shkallë të lartë të interesimit të publikut. Shiko Indeksi i Reformës së Sistemit gjyqësor për Kosovë, Vëllimi II, ABA-CEELI, Prishtinë, 2004,

përbëra vetëm nga gjyqtarë. Kjo zgjidhje, përherë tërheq me vete edhe kompetencën e licencimit- duke kërkuar që licencimin e avokatëve ta bëjë autoriteti më i lartë gjyqësor, i cili edhe do të vendosë për përgjegjësinë disiplinore.

c) Sistemi i përzier

Zgjedhja e dytë e këtij opcioni dukej më e afërt me rrethanat kosovare dhe më mirë korrespondonte me realitetin e ri, duke mos e zhvendosur sistemin e përgjegjësisë për shkeljet e rënda jashtë Odës. Kështu, brenda Odës do të vepronte një sistem efikas, i konsoliduar dhe mirë i administruar i përgjegjësisë disiplinore për shkeljet e lehta të rregullave etike, kurse përgjegjësia për shkeljet e rënda do të kalonte në një autoritet të pavarur e më të lartë, e që kryesisht vështrohej të ishte autoriteti më i lartë gjyqësor⁴⁵⁰. Ky opcion, përherë e lë të hapur çështjen e kompetencave për licencimin e avokatëve, duke mos e favorizuar Odën për kompetencë rreth licencimit, veçse autoritetin jashtë saj.

Me gjithë përparësitë dhe të metat, përvojat tregojnë se asnjëri nga këto dy sisteme nuk do të jenë efikas nëse nuk mbështeten në procedura dhe instrumente të efektshme disiplinimi.

3. Vështrime mbi rolin dhe pozitën e avokaturës në Kosovë

Në Kosovë tanimë ekziston një kornizë në lidhje me organizimin dhe ushtrimin e avokatisë, me përcaktime të qarta për rolin, përgjegjësitë dhe sjelljen e avokatëve të ndërtuara mbi garancionet kushtetuese të pavarësisë profesionale⁴⁵¹. Madje, krahas kësaj edhe vet korniza e re ligjore, veçanërisht në drejtësinë penale, tani ka përcaktuar instrumente të qarta ligjore në lidhje me rolin dhe sjelljen e tyre në procedurën penale⁴⁵².

Kështu, Kodi i Procedurës Penale, vendos principet dhe rregullat e një procedure inkvizitore, me përkufizime të qarta të rolit të ndarë të gjyqësisë,

⁴⁵⁰ Shumë lende paraqiten në gjykate, se sa zgjidhen, kështuqë numri lendeve akumulohet shumë shpejte. Në përgjithësi, gjyqtarët vet i klasifikojnë lendet dhe vendosin se sipas ciles renditje do të merren në shqyrtim. Krahas kësaj, avokatët shpeshherë paraqesin kërkesa me shkrim gjykates, duke kërkuar prioritet në zgjidhjen e lendeve urgjente. Një rast i ri mund të zgjidhet shumë me shpejte përderisa rasti i vjetër pret zgjidhjen dhe anasjelltas. Për më tepër të anketuarit janë ankuar se ngarkesa me lende paraqet një mundësi për të qene pre i korrupsionit. Në baze të intervistave, palet dhe avokatët shpeshherë shkojnë të referenti dhe paraqesin kërkesa të pavend që ai të pershpejtojë rastin. Indeksi i Reformës së Sistemit gjyqësor për Kosovë, Vellimi II, ABA-CEELI, Prishtinë, 2004, fq. 49

⁴⁵¹ Neni 111 Kushtetutes së Republikës së Kosovës

⁴⁵² Shiko institucionet e veçanta të KPPK.

prokurorisë dhe funksioneve mbrojtëse në mënyrë që secili të funksionojë pavarësisht në kryerjen e përgjegjësisë të veta. Prokurori vihet në qendër të procedurës, por nga ana tjetër edhe mbrojtjes i sigurohet vendi i merituar me rol shumë më proaktiv se që e ka pasur me legjislacionin e mëparme. Për të dy këto palë janë siguruar pozita të barabarta dhe një “barazi e armëve”. Kurse, gjykata nga ana tjetër, tani vihet në pozitën e mbikqyrësit të procedurës duke u zhveshur pothuajse plotësisht nga pozitat e kontrolluesit të saj. Të drejtat e viktimave janë të siguruar plotësisht së bashku me mundësitë e pjesëmarrjes së tyre në ndjekjen penale. Kodi promovon një rol të veçantë për policinë në procedurën penale, por duke caktuar rregulla të veçanta kontrolli dhe mbikëqyrjeje ndaj veprimeve të saj. Ai e “shtyn” momentin e fillimit të hetimeve që nga arrestimi i të dyshuarit, por i garanton atij një sistem mirë të dizajnuar të drejtash ligjore, duke i bërë kështu, për herë të parë, standardet ndërkombëtare në rregulla vendore, në thelb të së cilave janë të drejtat e garantuara përmes procedurës së efektshme, të drejtë dhe të paanshme ligjore ndaj secilit që është nën pretendimet e akuzës⁴⁵³.

Sipas Kushtetutës, avokatura si pjesë e sistemit ushtrohet si profesion i pavarur⁴⁵⁴. Pavarësia e avokatisë realizohet veçanërisht pastaj garantohet me instrumente të veçanta të përmbajtura në Ligjin mbi Avokatinë, midis të cilave edhe përmes ushtrimit të pavarur të profesionit të avokatit si profesion i lirë, ofrimit të ndihmës juridike në mënyrë të pavarur, organizimit të avokatëve përmes Odës së Avokatëve të Kosovës, si organizatë e pavarur publike; autorizimit të Odës së Avokatëve për nxjerrjen e akteve normative me qëllim rregullimin dhe organizimin e avokaturës (kodin e etikës profesionale, tarifës për kompensimin e avokatëve, rregulloren mbi Zyrën e Përbashkët të Avokatëve, rregulloren mbi themelimin, organizimin dhe funksionimin e Shoqërive të Avokatëve, rregulloren mbi procedurën disiplinore, rregulloren mbi regjistrimin e avokatëve të huaj, aktet e tjera të nevojshme për organizimin dhe rregullimin e avokatisë), autorizimet e OAK që të inicioj procedurë gjyqësore në rastet e dhënies së ndihmës juridike, nga personat e paautorizuar, autoritetin ekskluziv për dhënien e të drejtës për ushtrimin e profesionit të avokatit, pjesëmarrjes në sistemin e ndihmës juridike falas që financohet me mjete publike, autorizimet e vendosjes së detyrimeve për arsimin e vazhdueshëm të avokatëve, obligimeve të autoriteteve që avokatit ti sigurojnë të takojë personin e mbrojtur prej tij në mënyrë private dhe pa

⁴⁵³ Po aty

⁴⁵⁴ Neni 111 Kushtetutes se Republikes se Kosoves

kufizim kohor, në çdo gjendje të kufizimit të lirisë personale, autorizimet për shqiptimin e masave disiplinore në rastet e shkeljes së detyrave gjatë ushtrimit të profesionit, natyrën e Odës si organizatë e obliguar profesionale me cilësi të personit juridik, autoritetin ekskluziv të saj për rregullimin dhe kontrollimin e profesionit të Avokatit në Kosovë, misionin e veçantë për promovimin e të drejtave themelore të njeriut dhe në avancimin demokratik të shoqërisë, autorizimet për dhënien e iniciativave tek organet kompetente për nxjerrje të ligjeve⁴⁵⁵.

4. Rregullat ligjore për veprimin e avokatëve në shërbim të procedurave të drejta, efektshme dhe paanshme penale

Korniza e re ligjore, veçanërisht në drejtësinë penale, tani ka përcaktuar instrumente të qarta ligjore në lidhje me rolin dhe sjelljen e avokatëve⁴⁵⁶. Këto së bashku me rregullat e tjera të veçanta krejt në mënyrë që legjislacioni vendor të garantoj standardet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me procedurat e drejta, të paanshme dhe të efektshme gjyqësore⁴⁵⁷.

Sipas ligjit çdo i pandehur ka të drejtë të ketë mbrojtës gjatë gjithë fazave të procedurës penale⁴⁵⁸, kurse për mbrojtës mund të angazhohet vetëm avokati i cili është anëtar i Odës së Avokatëve, por të cilin mund ta zëvendësojë praktikanti i avokatisë⁴⁵⁹. Kur procedura zbatohet për veprë penale të dënueshme me të paktën pesë vjet burgim, praktikanti i avokatisë mund ta zëvendësojë avokatin vetëm nëse e ka kaluar provimin e judikaturës⁴⁶⁰. Pranë Gjykatës Supreme të Kosovës të pandehurin mund ta përfaqësojë vetëm avokati⁴⁶¹. Një i pandehur mund të ketë deri në tre mbrojtës dhe e drejta për mbrojtje konsiderohet se është e mjaftueshme kur në procedurë merr pjesë njëri nga mbrojtësit⁴⁶².

⁴⁵⁵ Për më tepër shiko Ligjin mbi Avokatin

⁴⁵⁶ Per kete shiko rregullat e reja te misheruara ne Kodin e Procedures Penale te Kosoves(janë ne vecanti autorizimet e gjykates per shkarkimin dhe perjashtimin e avokatit mbrojtës nga rasti per shkak te papergaditjes, mosefikasitetit dhe jokompetences). Qysh. Standardet për Kosovën te aprovuara edhe nga Këshilli i Sigurimit të KB-së në deklaratën e tyre të 12 dhjetorit 2003 impononin detyra ne lidhje me strukturen dhe kornizen ligjore te Odës së Avokatëve të Kosovës ,duke konfirmuar qendrimin se”Kosova, si çdo shoqëri, ka nevojë për një shoqatë të fortë të avokatëve.”Shiko Standardet per Kosoven. 18.Po,aty,neni70 par.2

⁴⁵⁷ Kjo me se miri bëhet e ditur ne ndryshimit dhe plotesimit te fundit te KPPK,ku shprehimisht thuhet se kjo është bere :”me qëllim te krijimit te kushteve me te favorshme dhe shtimin e efikasitetit te punes ne gjykata e prokurori ne kosove,ne perputhje ,me standardet evropiane dhe nderkombetare”.Shiko Ligjin Nr.03/L-003 per ndryshimin dhe plotesimin e KPPK Nr.2003/26,Qëllimi.

⁴⁵⁸ KPPK,neni 69 par.1

⁴⁵⁹ Po aty,neni 70 par.1 ,fjalialia e pare

⁴⁶⁰ Po aty,neni 70 par.1 ,fjalialia e dytë

⁴⁶¹ Po aty,neni 70 par.1 ,fjalialia e tretë

⁴⁶² Po aty,neni,71

Me tutje, para çdo marrje në pyetje të të dyshuarit ose të pandehurit, policia, prokurori publik, gjyqtari i procedurës paraprake ose kryetari i trupit gjykues udhëzon të dyshuarin ose të pandehurin për të drejtën e tij në angazhimin e mbrojtësit dhe se mbrojtësi mund të marrë pjesë gjatë marrjes në pyetje⁴⁶³. Mbrojtësi në procedurën penale i gëzon të drejtat e njëjta që ia njëh ligji edhe të pandehurit, përveç atyre që shprehimisht i janë të rezervuara personalisht të pandehurit⁴⁶⁴.

Mbi këto përcaktime legjislacioni procedural i drejtësisë penale, për herë të parë përmban edhe kërkesa të veçanta në lidhje me standardet e mbrojtjes, e që në fakt lidhen me nivelin e ekspertizës, kompetencën dhe efektshmërinë e ndërmarrjes së veprimeve. Krejt kjo për të siguruar përmbushjen e kërkesave që imponojnë standardet ndërkombëtare për procedurat e drejta, të efektshme dhe të paanshme gjyqësore⁴⁶⁵. Kështu, në bazë të kërkesës së të pandehurit ose me pëlqimin e tij, kryetari i gjykatës mund të shkarkojë mbrojtësin e caktuar i cili nuk e ushtron si duhet detyrën⁴⁶⁶. Në vend të mbrojtësit të shkarkuar, kryetari i gjykatës cakton një mbrojtës të pavarur me përvojë dhe kompetent në pajtim me natyrën e veprës penale, kurse për shkarkimin e mbrojtësit njoftohet Oda e Avokatëve të Kosovës⁴⁶⁷.

Mbrojtësi i cili nuk pranon detyrën që i është besuar ose që tërhiqet prej saj duhet njoftuar menjëherë organin e procedurës dhe atë që e ka caktuar lidhur me refuzimin ose tërheqjen e tij⁴⁶⁸. Tërheqja nuk ka efekt derisa të pandehurit të mos i sigurohet një mbrojtës i ri sipas zgjedhjes së tij ose sipas detyrës zyrtare dhe deri në përfundim të afatit të caktuar që mund t'i jetë dhënë mbrojtësit zëvendësues për t'u njohur me shkresat dhe provat⁴⁶⁹. Avokatët mbrojtës për cenimin e detyrave të të pandehurve gjatë kryerjes se avokaturës përgjigjen para organeve të Odës së avokatëve sipas rregullave të cilat i nxjerr Oda e në pajtim me ligjin⁴⁷⁰. Kështu, sipas Ligjit mbi Avokatinë avokati mund të refuzoj të jap ndihmë në rast se kjo do të ishte në dëm të interesit të palës apo në rast se dhënia e ndihmës juridike do të

⁴⁶³ Po aty, neni 69 par.2

⁴⁶⁴ Po aty,

⁴⁶⁵ Shiko fus.19

⁴⁶⁶ KPPK, neni 75.4

⁴⁶⁷ Po aty, neni 4 (Po duhet theksuar se deri me tani Zyra disiplinore e OAK nuk ka pranuar qofte edhe një Njoftim te vetem per shkarkimin e avokatit per shkak te mospërmbushjes se detyrave te veta, edhe pse Raportet e monitorimeve objektive tregojne per shumë raste te këtilla ne praktike. Per kete shiko Raportet e OSCE-Seksioni i Monitorimit te Sistemit Ligjor, ne pjesët qe kane te bëjnë me mbrojtjen efektive).

⁴⁶⁸ Po aty, neni 76.par.1

⁴⁶⁹ Po aty, neni 76 par.3 (Njëjte edhe Kodi i etikes profesionale për avokate, Prishtine, 07.07.2007, Arhiva e OAK, Qamil Hoxha, 10/3

⁴⁷⁰ Per Kodin e Etikes Profesionale per Avokate dhe funksionimin e sistemin disiplinor per avokat ne Oden e avokateve te Kosoves, Web-site: oak-ks73@ org.com

ishite në kundërshtim me parimet e procedurës ku do të merrte pjesë si avokat⁴⁷¹.

Nga ana tjetër, avokati ka për detyrë të refuzoj dhënien e ndihmës juridike në rast se po për atë çështje juridike i ka dhënë ndihmë juridike palës kundërshtare, ai apo avokati nga zyra e njëjtë apo si praktikant i avokatit ka kryer praktikën të avokati i cili i ka dhënë ndihmë juridike kundër palës ose në të njëjtën çështje juridike ka vepruar si gjykatës, prokuror publik, avokat publik apo person zyrtar i organit të administratës⁴⁷².

Në qoftë se i pandehuri në rastin e mbrojtjes së detyruar nuk angazhon mbrojtës, e angazhimin nuk e bën askush në pajtim me nenin 69, paragrafi 6 të KPPK, kryetari i gjykatës ose organi kompetent që e zbaton procedurën në fazën paraprake cakton mbrojtës sipas detyrës zyrtare në shpenzime publike⁴⁷³. Kur mbrojtësi caktohet sipas detyrës zyrtare pasi të jetë ngritur aktakuza, i pandehuri njoftohet për këtë me rastin e dorëzimit të aktakuzës⁴⁷⁴. Kur i akuzuari në rastin e mbrojtjes së detyruar mbetet pa mbrojtës gjatë procedurës dhe nëse ai nuk angazhon mbrojtës tjetër, kryetari i trupit gjykues ose organi kompetent që e zbaton procedurën në fazën paraprake sipas detyrës zyrtare cakton një mbrojtës të ri në shpenzime publike⁴⁷⁵. Në bazë të kërkesës së të pandehurit ose me pëlqimin e tij, kryetari i gjykatës mund të shkarkojë mbrojtësin e caktuar i cili nuk e ushtron si duhet detyrën⁴⁷⁶. Në vend të mbrojtësit të shkarkuar, kryetari i gjykatës cakton një mbrojtës të pavarur me përvojë dhe kompetent në pajtim me natyrën e veprës penale. Oda e Avokatëve të Kosovës njoftohet për shkarkimin e mbrojtësit.

Mbrojtësi i cili nuk pranon detyrën që i është besuar ose që tërhiqet prej saj duhet njoftuar menjëherë organin e procedurës dhe atë që e ka caktuar lidhur me refuzimin ose tërheqjen e tij⁴⁷⁷. Tërheqja nuk ka efekt derisa të

⁴⁷¹ Ligji mbi Avokatine ,neni 11.Kurse nga ana tjeter. sipas Kodit te Etikes”Avokati nuk guxon ta refuzojë mbrojtjen në çështjet penale për shkak se mbrojtja është e vështirë, se ekzistojnë prova të pamohueshme mbi veprën e kryer, se pala ka pranuar kryerjen e veprës, për shkak të peshës së veprës dhe reagimet e opinionit publik(neni 37 i Kodit te Etikes).

⁴⁷² Kodi i Etikes Profesionale per Avokate,neni 25.

⁴⁷³ KPPK,neni 73 par.2

⁴⁷⁴ KPPK,po aty

⁴⁷⁵ Po aty,par.3

⁴⁷⁶ Po aty,neni 75.4.Keshtu,tani sipas vet ligjit procedural gjykata ka ne dore masat per te siguruar respektimin e strandaredve mbi gjykimin e drejte,efektiv dhe paanshem ,edhe ne raport me sjelljen e paleve ne procedure. Kurse ne raport me avokatin mbrojtjes ligji ne kete menyre per here te pare percakton standardet e kompetences dhe ekspertizes profesionale

⁴⁷⁷ Po aty,neni 76.par.1 . Oda e Avokatëve informohet për shqiptimin e gjobës ndaj anëtarit të saj ose praktikantit të avokaturës

pandehurit të mos i sigurohet një mbrojtës i ri sipas zgjedhjes së tij ose sipas detyrës zyrtare dhe deri në përfundim të afatit të caktuar që mund t'i jetë dhënë mbrojtësit zëvendësues për t'u njohur me shkresat dhe provat⁴⁷⁸.

Parimisht, për shkelje të caktuara të rregullave të sjelljes në procedurat ligjore para gjykatës, ligji përcakton autoritetin gjyqësor për sanksionim. Kështu, Gjykata e dënon me gjobë deri në 250 EURO mbrojtësin, të dëmtuarin, paditësin privat, paditësin subsidiar, përfaqësuesin e autorizuar ose përfaqësuesin ligjor, i cili në parashtrësë ose gojarisht ofendon gjykatën apo personin që merr pjesë në procedurë⁴⁷⁹. Aktvendimin lidhur me dënimin e merr gjyqtari apo kolegji para të cilit është dhënë deklarata, e kur ajo është bërë në parashtrësë e merr gjykata e cila duhet të vendosë për parashtrësën. Për dënimin e avokatit apo të praktikantit të avokatisë njoftohet Oda e Avokatëve⁴⁸⁰.

Pastaj, Gjykata gjatë rrjedhës së procedurës mund t'i shqiptojë gjobë deri në 250 EURO mbrojtësit, përfaqësuesit të autorizuar ose përfaqësuesit ligjor, të dëmtuarit, paditësit subsidiar ose paditësit privat kur veprimet e tij janë të drejtuara qartë në zvarritjen e procedurës penale. Për më tepër, kur mbrojtësi në shqyrtim gjyqësor prish rendin ose nuk u nënshtrohet urdhrave të kryetarit të trupit gjykues për mbajtjen e rendit, kryetari i trupit gjykues ia tërheq vërejtjen. Kur vërejtja është e pasuksesshme, trupi gjykues mund të urdhëroj që i akuzuari të nxirret jashtë gjykatores, kurse personat tjerë jo vetëm që mund t'i nxjerrë jashtë, por mund t'i dënojë me gjobë deri në 1.000 €⁴⁸¹.

Mbrojtësit ose përfaqësuesit të autorizuar trupi gjykues mund t'ia mohojë të drejtën për të mbrojtur ose përfaqësuar klientët e tyre në shqyrtim gjyqësor kur pas dënimit ata vazhdojnë të prishin rendin dhe në këtë rast kërkon nga pala që të angazhojë një mbrojtës tjetër apo përfaqësues të autorizuar. Kur i akuzuari nuk mund të angazhojë mbrojtës tjetër menjëherë, apo kur gjykata atë nuk mund ta caktojë më vonë pa e dëmtuar mbrojtjen, shqyrtimi gjyqësor ndërpritet ose shtyhet. Kur paditësi privat ose paditësi subsidiar nuk mund të angazhojë menjëherë tjetër përfaqësues të autorizuar, trupi gjykues mund të vendos ta mbajë shqyrtimin gjyqësor pa përfaqësues të autorizuar, nëse pas vlerësimit të kujdesshëm të të gjitha rrethanave çmon se mungesa e përfaqësuesit të autorizuar nuk i dëmton interesat e personit të

⁴⁷⁸ Po aty, neni 76.3

⁴⁷⁹ KPPK, neni 85, par. 1

⁴⁸⁰ KPPK, neni 85, par. 1 si dhe neni 336 par. 5

⁴⁸¹ KPPK, neni 336, par. 1

cilin ai e përfaqëson. Kur gjykata e largon nga gjykatorja ose e gjobit anëtarin e avokaturës apo avokatin praktikant për prishjen e rendit, për këtë e njofton Odën e Avokatëve⁴⁸².

5. Standardet etike për avokat në favor të procedurave të drejta, efektshme dhe paanshme penale

Edhe rregullat etike sikur janë në funksion të drejtëpërdrejtë të kërkesave për procedura të drejta, të efektshme dhe të paanshme gjyqësore. Kodeksi profesional parashtron rregulla të veçanta për sjelljen e avokatit në procedurat ligjore të cilat zhvillohen para gjykatave⁴⁸³. Kështu, avokati ka për detyrë të kujdeset, që palës t'i ofrojë mbrojtje të nevojshme juridike sa më shpejtë që është e mundur si dhe të pamundësojë çdo zvarritje dhe keqpërdorim të drejtave para gjykatave dhe organeve tjera⁴⁸⁴. Nëse është në interes të palës të cilën e përfaqëson, avokati para fillimit të procedurës apo edhe gjatë procedurës duhet të insistojë që kontesti në mes tyre të zgjidhet me marrëveshje duke i bërë të njohura paraprakisht palës përparësitë e zgjidhjes së kontestit me marrëveshje⁴⁸⁵.

Avokati duhet ta këshilloj palën e vet t'u shpreh respektin e duhur gjyqtarëve⁴⁸⁶. Avokati, në kryerjen e profesionit të vet, ka për detyrë që gjithnjë të ruajë autoritetin e gjykatave, organeve të administratës dhe autoriteteve tjera pranë të cilave jep ndihmë juridike dhe të shpreh respektin e duhur ndaj tyre⁴⁸⁷. Avokati duhet ta mbroj klientin në përputhje me rregullat juridike. Assesi nuk duhet t'i japë gjyqtarit me vetëdije ndonjë informatë të rrejshme ose të natyrës së tillë që ta shtyjë të gaboj⁴⁸⁸. Gjatë kryerjes së profesionit të avokatit, me sjelljet e veta, duhet të përvetësoj dhe forcoj besimin e klientit, të organeve të judikaturës dhe të organeve të tjera para të cilave ai paraqitet⁴⁸⁹.

Avokati nuk duhet t'i japë shpresa të rreme palës që e mbron dhe përfaqëson, madje edhe nëse ka pasur shumë suksese më përpara⁴⁹⁰. Avokati

⁴⁸² KPPK, neni 336, par. 6

⁴⁸³ Kodi i Etikës Profesionale për Avokate, neni 1

⁴⁸⁴ Po aty, neni 30. Sic po shihet edhe Kodi i Etikës ka vendosur detyra ndaj avokateve që lidhen me plotësimin e standardeve për procedurat e efektshme gjyqësore

⁴⁸⁵ Po aty, neni 31.

⁴⁸⁶ Po aty, neni 48

⁴⁸⁷ Po aty, neni 42

⁴⁸⁸ Po aty, neni 50

⁴⁸⁹ Po aty, neni 7. Sipas Parimeve Themelore mbi rolin e avokateve, neni 12 "Avokatët duhet të mbajnë gjatë tërë kohës, nderin dhe dinjitetin e profesionit të tyre, si pjesë esenciale e administratimit të drejtësisë.

⁴⁹⁰ Po aty, neni 28

është i obliguar të marrë mbrojtjen e ofruar të të pandehurit, pavarësisht nga personaliteti i të pandehurit dhe lloji i veprës, si dhe të përfaqësojë palën e dëmtuar në çështjet penale⁴⁹¹. Avokati ka për detyrë të kujdeset, që palës t'i ofrojë mbrojtje te nevojshme juridike sa më shpejtë që është e mundur si dhe të pamundësojë çdo zvarritje dhe keqpërdorim të drejtave para gjykatave dhe organeve tjera ku paraqitet⁴⁹².

Është në natyrën e misionit të tij, që nuk mund të ketë marrëdhënie besimi, në qoftë se dyshohet në ndershmërinë, çiltërinë, drejtësinë dhe sinqeritetin e avokatit⁴⁹³. Me paraqitjet e tij pranë gjykatave, avokati duhet të arsyetojë dhe të vërtetojë bindjen, se është bashkëpunëtor në zbatimin e ligjit dhe në mbrojtjen e të drejtave themelore të qytetarëve dhe të interesave të tyre⁴⁹⁴. Paraqitja e avokatit para gjykatave, organeve të administratës dhe autoriteteve tjera si me shkresa ashtu edhe me gojë, duhet të jetë sa më reale, e përmbledhur dhe në masën që nuk shkon në dëm të mbrojtjes së interesit të klientit. Avokati, para gjykatës, nuk duhet të japë deklarata fyese ose mendime nënçmuese mbi vendimet e tyre, ose pa arsye, të kërkojë përjashtimin e gjyqtarëve, t'i akuzoj ata, etj⁴⁹⁵.

Avokati duhet ta mbrojë klientin në përputhje me rregullat juridike. Assesi nuk duhet t'i japë gjyqtarit me vetëdije ndonjë informatë të rrejshme ose të natyrës së tillë që ta shtyjë të gabojë⁴⁹⁶. Gjatë përfaqësimit avokati është i obliguar ta ruajë pavarësinë e tij të plotë, të liruar nga çdo trysni, posaçërisht nga ato që dalin nga interesat e tij vetjake ose nga ndikimet e jashtme. Ai duhet t'i shmanget çfarëdo cenimi të pavarësisë së tij dhe të respektoj etikën e tij profesionale⁴⁹⁷.

Avokati nuk guxon t'i pranojë punët që nuk janë në përputhje me thirrjen e tij dhe që të dëmtonin pavarësinë, reputacionin dhe prestigjin e avokaturës⁴⁹⁸. Avokati duhet t'i shmanget çfarëdo cenimi të pavarësisë së tij dhe të kujdeset të mos e lërë pas dore etikën profesionale duke dashur t'i pëlqejë klientit të vet. Me paraqitjet e tij pranë gjykatave avokati duhet të

⁴⁹¹ Po aty, neni 33

⁴⁹² Po aty, neni 49

⁴⁹³ Po aty, Neni 7

⁴⁹⁴ Po aty, neni 43

⁴⁹⁵ Po aty, neni 44

⁴⁹⁶ Po aty, neni 50. Megjithatë është standard i pranuar në lidhje me mbrojtjen se "Avokatet, në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga e drejta kombëtare dhe nderkombëtare dhe duhet që në çdo kohë të veprojnë lirisht dhe me ngulm, në pajtim me ligjin dhe standardet e njohura dhe etikën e profesionit ligjor".

Partimet Themelore mbi rolin e avokateve, neni 14

⁴⁹⁷ Po aty, neni 9

⁴⁹⁸ Po aty, neni 10

arsyetojë dhe të vërtetojë bindjen se është bashkëpunëtor në zbatimin e ligjit dhe në mbrojtjen e të drejtave themelore të qytetarëve dhe të interesave të tyre⁴⁹⁹. Avokati para gjykatës nuk guxon të jap deklarata fyese ose mendime nënçmuese mbi vendimet e tyre ose pa arsye të kërkojë përjashtimin e gjyqtarëve, t'i akuzojë ata etj.

Madje edhe rregullat që Kodi i përcakton për avokatin në sjelljen e tij në raport me palën kundërshtare shkojnë në favor të standardeve për procedurat e drejta dhe të efektshme. Kështu, avokati duhet të sillet me respekt dhe dinjitet edhe ndaj kundërshtarit, duke u përpjekur që të krijoj kushtet që kontesti të zgjidhet sa më shpejt dhe në interesin e të dyja palëve. Avokati nuk duhet ta shfrytëzojë mosdijen, lajthimin ose frikën e palës kundërshtare, veçanërisht nëse ajo nuk ka përfaqësues juridik, për të arritur sukses të pajustificueshëm për palën e vet⁵⁰⁰. Avokati nuk mund të kontaktojë me palën kundërshtare pa i njoftuar përfaqësuesit e saj dhe palën e vet. Në të gjitha rrethanat avokati duhet ta ketë parasysh karakterin kontradiktorë të debateve. Ai, vjen fjala, nuk mund të kontaktojë me një gjyqtar lidhur me një lëndë pa e njoftuar për këtë punë palën kundërshtare ose avokatin e saj⁵⁰¹. Ai nuk mund t'i dorëzojë dokumente, shënime ose dëshmi të tjera një gjyqtari para se ato t'i komunikohen në kohën e duhur palës kundërshtare ose avokatit të saj, përpos në rastin kur veprimet e këtilla lejohen sipas rregullave të procedurës që zbatohen.

Për ruajtjen e prestigjit të avokaturës, avokati sipas rregullit duhet që palët t'i pranoj në zyrën e tij. Nuk është e preferueshme që avokati punët t'i kryejë në korridoret e gjykatave, në objektet hoteliere dhe në vendet të tjera të papërshtatshme, përveç në rastet kur nuk disponon me zyrë të përshtatshme⁵⁰². Avokati mund të paraqitet publikisht, në televizor, në radio, ose në shtyp mbi çështjet me interes shkencore të përgjithshëm, ose përjashtimisht mbi çështje të caktuara. Avokati duhet t'i shmanget njoftimit të opinionit publik mbi çfarëdo veprimtarie që ka të bëjë me punën e tij ose me jetën e tij private të cilat mund ta cenojnë reputacionin e tij si avokat. Avokati paraqitet në opinion me masë. Ai duhet t'i shmanget ndërhyrjes së tij të shtrembëruar duke kërkuar publicitetin profesional⁵⁰³.

⁴⁹⁹ Po aty, neni 43

⁵⁰⁰ Po aty, neni 55

⁵⁰¹ Po aty, neni 56

⁵⁰² Po aty

⁵⁰³ Po aty. Megjithatë konstatohen edhe dukuri : “ Të gjithë të anketuarit kanë vërejtur se avokatët shpesh identifikohen me klientët dhe kauzën e klientit...Sikur publiku ashtu edhe avokatët e pranojnë identifikimin me klientët si një gjendje të cilën avokatët patjetër duhet ta pranojnë, veçanërisht kur ata/ato i përfaqësojnë të pandehurit kriminelë.” Indeksi i Reformes së Profesionit Ligjor për Kosovë, ABACEELI, Prishtine, korrik 2004. Pastaj është shënuar se:”Në seancën gjyqësore ... avokatët ...janë kërcënuar nga i dëmtuari. Ai ka kërcënuar

2.5. Angazhimi ex officio i avokatit - shërbim drejtësisë

2.1. Detyrimet ligjore

Legjislacioni penal duke reflektuar në tërësi standardet ndërkombëtare, sikurse edhe garancionet e konfirmuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës i garanton të drejtën e çdo personi të dyshuar në ndihmën e mbrojtësit sipas zgjedhjes së vet⁵⁰⁴. Në pajtim me këtë çdo person i privuar nga liria ka të drejtë në shërbimet e mbrojtësit që nga arresti e tutje⁵⁰⁵.

Gjykata ose secili autoritet tjetër i cili e drejton procedurën penale detyrohet ta njoftojë të pandehurin për të drejtën e tij në mbrojtës që nga marrja në pyetje për herë të parë⁵⁰⁶. Nëse i pandehuri nuk angazhon mbrojtës për të siguruar mbrojtjen, kurse mbrojtja është e detyrueshme, të pandehurit i caktohet mbrojtës i pavarur me përvojë dhe me kompetencë në përputhje me llojin e veprës penale dhe sipas kushteve të parapara me këtë Kod⁵⁰⁷.

Edhe me tej, të pandehurit i cili nuk mund ti paguaj shpenzimet mbrojtëse dhe për këtë arsye nuk mund të angazhoj mbrojtës të pavarur me përvojë dhe me kompetencë konform me llojin e veprës penale, me kërkesë të tij i caktohet një mbrojtës i pavarur që paguhet nga mjetet e buxhetit kur kjo është në favor të drejtësisë⁵⁰⁸.

Korniza pra, njeh tri sisteme të angazhimit të avokatit mbrojtës në procedurën penale:

- nga vet i pandehuri, sipas zgjedhjes së vet⁵⁰⁹
- nga autoriteti i cili e zbaton procedurën, ex officio⁵¹⁰
- nga shpenzimet publike, me kërkesën e të pandehurit⁵¹¹

Ligji përmban një varg dispozitash për të siguruar garancitë e realizimit të kësaj të drejte, e që përfshijnë edhe detyrimet e autoriteteve ligjore për të

avokatët me fjalët "hajt se kini punë ju me mua, më vonë, pasi po i mbron kriminelët", Lajm, e përditshme informative, Prishtinë, E ejte, 5 prill 2007, fq.9

⁵⁰⁴ shiko nenin 12 KPPK

⁵⁰⁵ Po aty par.6

⁵⁰⁶ Po aty par.5

⁵⁰⁷ neni 12 par.3 KPPK

⁵⁰⁸ po aty, par.4

⁵⁰⁹ neni 12 KPPK etj

⁵¹⁰ Shiko KPPK

⁵¹¹ Po aty

njohur dhe udhëzuar personin e dyshuar respektivisht të pandehur për këtë të drejtë⁵¹².

1.2.Detyrimet etike për shërbim drejtësisë

Edhe vet Kodi i etikës, sikur duke ndjekur kërkesat e ligjvënësit, parashtron për avokatët kërkesa për angazhimet e ndihmës juridike “pro bono” dhe në sistemin e angazhimeve ex officio, madje mbi standardet të caktuara në këto raste. Kështu, Avokati nuk duhet pa arsye ta refuzoj rastin juridik që i është caktuar sipas detyrës zyrtare, nga gjykata apo Oda⁵¹³. Dhënia e ndihmës juridike përfituesve të sistemit të ndihmës juridike falas, që i plotësojnë kriteret e përcaktuara me legjislacionin në fuqi është detyrë nderi e avokatëve, të cilën duhet ta bëjnë njësoj me kujdes dhe ndërgjegje, si kur punojnë me palët e tjera. Avokati nuk ka të drejtë të kërkoj nga klienti shpenzime të panevojshme. Po që se klienti kërkon ndihmën juridike falas, avokati duhet ta njoftojë për këtë mundësi. Nëse nuk parashihet ndihma juridike falas dhe klienti nuk ka mundësi ta paguajë avokatin, ndihma juridike mund t’i jepet falas, ngase për klientët që gëzojnë ndihmë sociale, dhënia e ndihmës falas është pjesë e detyrimit tradicional dhe e ndershmërisë së avokatit. Avokati duhet të ofroje ndihmë juridike falas (pro bono) nëse për këtë obligohet nga OAK⁵¹⁴. Sipas Kodit të etikës: Avokati nuk duhet ta refuzojë mbrojtjen në çështjet penale për shkak se mbrojtja është e vështirë, se ekzistojnë prova të pamohueshme mbi veprën e kryer, se pala ka pranuar kryerjen e veprës, për shkak të peshës së veprës dhe reagimet e opinionit publik⁵¹⁵. Secili avokat e ka për detyrë që të jetë vigjilent dhe të sigurojë funksionimin e mirë të radhës së punës së avokatëve në sistemin e ndihmës juridike⁵¹⁶.

3. Një kornizë mbi sistemin e integruar të ndihmës juridike

3.1. Në lidhje me kornizën

Në Kosovë, për sigurimin e ndihmës juridike për të gjithë ata të cilëve do t’u mohohej qasja efektive në drejtësi nga mungesa e mjeteve të

⁵¹² neni 73 par.2 ,3 e 5(i vendosur me Ligjin Nr.03/L-003 per ndryshimin e plotesimin e KPPK)dhe neni 74 KPPPK).

⁵¹³ neni 11 i Kodit te Etikes Profesionale per avokatine

⁵¹⁴ neni 85

⁵¹⁵ neni 34 i Kodit te Etikes

⁵¹⁶ Po aty neni 82

mjafueshme, është themeluar sistemi i integruar i ndihmës juridike, me rregulloren për Ndhimën Juridike: UNMIK/REG/2006/36. Midis sistemeve të ndryshme për përkrahjen e personave të cilët e kanë të vështire qasjen në drejtësi për shkak të mungesës së mjeteve financiare, ky Ligj ka rregulluar edhe sistemin e financimit të cilët përfitojnë nga ky sistem.

Ndihma juridike e cila funksionon në bazë të këtij sistemi në çështje penale mbulon përfaqësimin ligjor në të gjitha fazat e procedurës penale, duke përfshirë hetimin, dorëzimin, shqyrtimin gjyqësor, dënimin dhe ankesën kur ka gjasa të arsyeshme të burgosjes pas dënimit;

Sipas kësaj OAK është e detyruar që të siguroj listën e plote të avokatëve nëpër qarqe nga regjistri i avokatëve, duke pasur parasysh disponimin e tyre, gatishmërinë për të shërbyer, përvojën dhe lëminë e ekspertizës⁵¹⁷. Pastaj, sigurimin që listat e shërbimit për ofrimin e ndihmës juridike nëpër qarqe të përfshijnë një numër të arsyeshëm avokatësh për grupet e cënueshme.

Sipas UNMIK/REG/2006/26, përfaqësimin në gjykata e ushtrojnë ekskluzivisht anëtarët e Odës së Avokatëve të Kosovës⁵¹⁸. Listat për avokatët e disponueshëm dorëzohen në Zyrën Koordinuese çdo 3 (tre) muaj, në mënyrë që të sigurohen shërbimet për kërkuesit e ndihmës juridike falas në kontinuitet. Zyra bashkërenditëse cakton avokatët për listën e shërbimit nëpër qarqe nga regjistri i avokatëve të siguruar nga Oda e Avokatëve të Kosovës.

2. Normativa e OAK në lidhje me angazhimin e avokatëve në skemën e ndihmës juridike

⁵¹⁷ Mu për qëllim të krijimit të mundësisë që qytetarët të përfitojnë shërbimet me të larta të përfaqësimit në mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të veta, e mbështetur në bazën e krijuar me Ligjin e ri mbi Avokatimne, OAK ka krijuar rregullativem dhe ka fillu pajisjen me licence të avokateve të huaj në rastet para gjykatave të Kosovës. Psh.a. Rejnës ishte një qytetar holandez që ishte me banim në Belgjikë dhe e kishte marrë një diplomë belge në fushën e drejtësisë por të cilit ishte mohuar e drejta që të bëhet avokat pasiqë ligji beleg kerkonte shtetesi belege. Gjykata belege i kerkoi GJED-it që të marrë një vendim. GJED-i deklaroi se rregulla mbi trajnimin e njëjtte me vendasit është një nga masat themelore ligjore brenda komunitetit (neni 43 traktati Ii KE-se) Gjykata vazhdoi të besonte se rregulla e trajnimit kombëtar është efektive edhe nëse Keshilli deshton që të kalojë këto udhëzime të zbatueshme. Rajners ishte një depertim i madh për juristet. (Vendimi i GJED-id mbi kufijte e tokës në Rejnës v. Belgjikë 1974)

⁵¹⁸ Në parim çdo qytetar i BE-se e ka të drejtën që të shkojë dhe të punoj ose të ushtrojë në një shtet tjetër anëtar. Neni 43 deri 48 të Traktatit të KE-se i japin çdo qytetari të drejtën që të themelojë një ushtrim të perhershëm ose biznes në një vend tjetër të BE-se (udhëzimi 89/48/KEE, dhe udhëzimi 98/5/KE që rrjedhën nga traktati i KE-se). Sidoqoftë shtetet anëtare e mbajnë një kontroll rregullues mbi profesionet e tyre ligjore. Normalisht me arritje në shtetin mikeshtë aplikonen rregulla ndaj ushtrimeve profesionale të migrantit.

Sipas Ligjit mbi Avokaturën dhe Ndhimën tjetër Juridike avokati ka për detyrë ti jap ndihmë juridike palës e cila i është drejtuar për atë ndihmë⁵¹⁹.

Ndërsa sipas Kodit të Etikës Profesionale avokati nuk duhet pa arsye ta refuzoj rastin juridik që i është caktuar sipas detyrës zyrtare, nga gjykata apo Oda⁵²⁰. Në mënyrë specifike në rastet penale avokati është i obliguar të marrë mbrojtjen e ofruar të të pandehurit, pavarësisht nga personaliteti i të pandehurit dhe lloji i veprës, si dhe të përfaqësoj palën e dëmtuar në çështje penale⁵²¹. Mandje, avokati nuk duhet ta refuzoj mbrojtjen në çështjet penale për shkak se mbrojtja është e vështirë, se ekzistojnë prova të pamohueshme mbi veprën e kryer, se pala ka pranuar kryerjen e veprës, për shkak të peshës së veprës dhe reagimet e opinionit publik⁵²².

Bazuar në legjislacionin në fuqi, OAK u ka vënë në dispozicion organeve të zbatimit të ligjit Regjistrin e avokatëve, duke përfshirë Policinë (zyrat e ndalimit, arrestimit dhe paraburgimit), prokurorit dhe gjykatat. Prokurorive dhe gjykatave për çdo vit kalendarik u dorëzohen regjistrat ku janë të përfshirë avokatët, selit dhe kontaktimi i tyre, në mënyrë që ato të realizojnë detyrimet ligjore për caktimin/angazhimin e avokatit mbrojtës në të gjitha rastet kur për këtë i obligon ligji.

3. Praktikrat aktuale për zbatimin e ndihmës

3.1. Përpilimi i listave të avokatëve në kujdestari nga ana e Odave regjionale

Degët Regjionale të cilat janë forma të organizimit territorial të OAK, përpilojnë me rregull Listat e avokatëve të çështjeve penale nën kujdestari, kanë për detyrë që të identifikojnë avokatët dhe pas marrjes së pëlqimit prej tyre për të pranuar angazhimin në dhënien e ndihmës juridike sipas sistemit të kujdestaris të përpilojnë Listat me emrat dhe kontaktimin me këta avokat. Listat e këtilla duhet të rishikohen në menyre periodike në mënyrë që të përcillet funksionimi i tyre.

3.2. Shpërndarja e Listave nëpër Qendrat e arrestimit policor dhe të paraburgimit nëpër Stacionet policore, Prokurori dhe Gjykata

⁵¹⁹ neni 16 par.1

⁵²⁰ neni 33

⁵²¹ Shiko ligjin

⁵²² neni 34

Listat e avokatëve në kujdestari ju shpërndahen të gjitha qendrave të arrestimit policor dhe të paraburgimit nëpër Stacionet policore, Prokurori dhe Gjykata. Në këtë mënyrë autoriteti që e zbaton procedurën do të kishte mundësi që menjëherë në veprimin e parë procedural, personit:

- ti ofroj listën e avokatëve në mënyrë që ai të bëjë zgjedhjen e avokatit të vet/sipas zgjedhjes së vet respektivisht,
- të caktoj ex officio avokatin nën kujdestari.

3.3. Praktikrat e paqëndrueshme të angazhimit të avokatëve sipas detyrës zyrtare në Kosovë

Në vend të përfundimit

Në Gjykatat dhe në Prokuroritë e Kosovës një grup i ngushtë i avokatëve vazhdimisht gjenden të angazhuar sipas detyrës zyrtare. Një numër i caktuar i avokatëve angazhohen vazhdimisht nga gjyqtarë e prokuror të caktuar. Kjo e vë opinionin nën dyshime për angazhimet e këtyre avokatëve. Madje për më tepër kjo situatë nxit dhe shqetësime më të gjëra, kurse të avokatët e tjerë edhe reagojnë të vazhdueshme. Kjo edhe për shkakun se zyrtarët e zbatimit të ligjit (prokurorët e gjyqtarët) rrallëherë u vënë në dispozicion të dyshuarve (pandehurve apo arrestuarve) listat e avokatëve veçse në vend të kësaj bëjnë vet "rekomandime" mbi "lidhjet e afërta"⁵²³.

Derisa në njërin anë ligji shumë qartë kërkon nga Kryetari i gjykatës ose organi kompetent i cili zbaton procedurën në fazën paraprake të vendosë për kërkesën dhe cakton mbrojtës⁵²⁴, d.m.th me aktvendim. Kurse mbrojtësi i caktuar njëherë mund të caktohet për shkaqe të arsyeshme⁵²⁵. Në anën tjetër në praktike veprohet ndryshe dhe dispozitat ligjore sa i përket kësaj nuk zbatohet nga gjyqtarët e prokurorët, ata thjeshtë "thërrasin" avokatët duke u lënë pastaj këtyre mundësin që vet të merren vesh për angazhimet "private" në rast. Avokatët në kundërshtim me ligjin dhe duke shkelur rëndë etikën profesionale pastaj merren vesh me palën (të pandehurin a të afërmit e tij) duke negociuar edhe marrëveshjen për pagesën e mbrojtjes dhe realizuar kështu edhe pagesat për mbrojtjen e ofruar. Madje kjo praktik sikur rrezikon detyrimin që avokatët e zgjedhur për mbrojtjen sipas detyrës zyrtare të jenë

⁵²³ Psh sipas shënimeve zyrtare që posedon Oda regjionale e Prizrenit, në regjionin në të cilin vepron kjo Dege, Policia regjionale, ex officio për një vit tre avok janë angazhuar në 2.000 raste, kurse të gjithë të tjerët, pra përmbi 86 tjerë, vetëm në 46 raste, Arkiva e Degës regjionale të Prizrenit, Prizren, 2011.

⁵²⁴ neni 74 par.3 KPPK

⁵²⁵ neni 75 par.1 dhe 2 KPPK

individ me integritet dhe të jenë të aftë me kualifikime dhe ushtrime të duhura në ligj.

Në situatën kur mosbesimi i publikut në gjyqësi është më i ulte se kurrë, nevoja për përmirësimin e perceptimit është po aq e rëndësishme për të arritur standardet e synuara. Praktika e këtillë sikur kjo që ngritet në këtë shkresë jo që rrit dyshimet në sytë e publikut e shkakton pakënaqësi të shumica e avokatëve po edhe nxitë dyshime më të thella.

Ngase ndikon në rrënimin e besimit në drejtësi kjo praktikë duhet të ndërpritet menjëherë nën masat urgjente dhe në vend të kësaj duhet vendosur instrumenti ligjor lidhur me angazhimin e avokatëve sipas detyrës zyrtare nga gjyqtarët e prokurorët. Duhet masa për të tejkaluar këtë praktik dhe për të vendosur funksionimin e instrumenteve ligjore në lidhje me këtë, sepse autoritet janë të detyruara që ta bëjnë këtë. Rrumbullakësimi i kornizës ligjore të drejtësisë penale duhet të përcillet me ndryshimin rrënjësor të praktikave gjyqësore. Tani ato duhet ofrojnë garanci se të drejtat e secilit janë të siguruar⁵²⁶. Për aplikimin e drejtë, korniza ligjore, shtron para zbatueseve një angazhim shtesë në mënyrë që të arrihet shkëputja e domosdoshme nga praktikat e kaluara që vejnë në dyshim idealet e drejtësisë.

Siç po shihet, në mënyrë më të shumanshme duhet rishikuar ndikimin e avokatëve në praktikat e dëmshme ndaj procedurave të drejta dhe të efektshme penale, e kjo si parakusht për ndërtimin e besimit aq të nevojshëm të komunitetit në organet e drejtësisë. Nuk ka dilemë se “Mungesa e profesionalizmit, etikës, shkathtësive dhe njohurive ndikon si në punën e avokatëve ashtu edhe në atë të gjyqtarëve e të prokurorëve si dhe perceptohet si një pengesë serioze në funksionimin e sundimit të ligjit”⁵²⁷.

Ndjenja e mos-përfaqësimit adekuat në gjykata shton mosbesimin e përgjithshëm të publikut në sistemin gjyqësor⁵²⁸. Megjithatë ekzistojnë ende mundësi që avokatet të përmirësojnë shkathtësitë dhe profesionalizmin e tyre⁵²⁹.

⁵²⁶ Psh sa për krahasim aplikantët e suksesshëm gjerman në SHBA mundem pastaj ti keshillojnë klientët gjerman vetëm mbi qeshtjet që kanë të bëjnë me ligjin e SHBA-se dhe ligjin nderkombëtar dhe janë të parandaluar që ti përfaqësojnë klientët në seancat gjyqësore.

⁵²⁷ Twining Project, C1-Mbështetja për OAK, ”Analiza e nevojave të trajnimit, fq. 1, Brosseau, Dietrich, Merz, Gastone, Borchert, Prishtine, 13.11.2009, Arhiva e OAK, rr. Qamil Hoxha, 10/3 dhe Web site e OAK.

⁵²⁸ Po aty

⁵²⁹ Po aty



Liridon Maloku

EKZEKUTIMI I MASAVE EDUKATIVE

1. Shqyrtime të përgjithshme

Si çdo vend në botë, edhe Kosova po përballet me sfida të shumta. Një ndër sfidat më të rënda është prania e delikuencës së të miturve si pjesë e kriminalitetit të përgjithshëm. Në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian delikuenca e të miturve llogaritet për një mesatare prej 15 % e të gjithë krimeve të cila mundet të rritet gjeri në 22%.⁵³⁰ Ndërsa sipas të dhënave statistikore shihet se kriminaliteti i të miturve në Kosovë është në një shkallë të konsiderueshme i pranishëm në strukturën e gjithëmbarshme të kriminalitetit dhe sillet rreth 10%.⁵³¹

Megjithëkëtë, te miturit duhen të trajtohen si viktime e jo si kriminel, sado që sjelljet e tyre të jenë të rrezikshme, por nuk do të thotë se ata do të falen nga sjelljet e tyre, por duhet të trajtohen me mirë gjatë rrjedhës së procedurës dhe të zgjedhën masat me adekuate që duhen të aplikohen ndaj tyre.⁵³² Masat edukative konsiderohen masat themelore në kuadrin e masave dhe dënimeve të zbatueshme ndaj të miturve. Me shqiptimin dhe ekzekutimin e këtyre masave ushtrohet rehabilitimi, mbrojtja dhe ofrimi i ndihmës ndaj kryesve të mitur të veprave penale në mënyrën më efektive sa me sanksionet tjera ndaj të miturve. Kjo në të shumtën e rasteve bëhet edhe pa izolimin e tyre nga ambienti i mëparshëm familjar dhe shoqëror.

Sistemi i drejtësisë për të mitur synon mirëqenien e të miturit dhe siguron që çdo reagim ndaj kryerësve të mitur të jetë gjithmonë në proporcion me rrethanat e kryerësit dhe veprës penale.⁵³³ Kodi i Drejtësisë për të Mitur

⁵³⁰ Konkluzionet e Komisionit Ekonomik dhe shoqëror evropian mbi parandalimin e delikuencës së të miturve (2006/C 110/13), faqe 3, pika 1.4

⁵³¹ Azem Hajdari, E drejta e procedurës penale e të miturve, Prishtinë, 2005 faqe 16.

⁵³² Vesel Latifi, Fenomenologjia dhe struktura e delikuencës së mitur dhe luftimi e saj në KSA të Kosovës "Përparimi" nr.4/1988, Prishtinë, faqe 383.

⁵³³ Rregullat standarde minimale të Kombeve të Bashkuara për administrimin e drejtësisë për të mitur

përmban dispozita të shumta që u referohen ekzekutimit të masave edukative ndaj të miturve. Ky kod ka përfshirë edhe disa risi, ndryshime dhe avancime në fushën e ekzekutimit të këtyre masave, të cilat kanë për qëllim rritjen e efikasitetit të tyre, mbrojtjen dhe ofrimin ndihmës ndaj tyre si dhe luftimin dhe parandalimin e suksesshëm të delikuençës së të miturve.

Sipas këtij kodi, si risi është edhe parashikimi i shërbimit sprovues, si organ i cili ka kompetenca mjaft të gjera në ushtrimin përgjegjësive lidhur me ekzekutimin e masave edukative.

Kodi i Drejtësisë për të Mitur ka paraparë tri lloje masa edukative:

1. masat disiplinore,
2. masat e mbikëqyrjes së shtuar dhe
3. masat institucionale.
- 4.

Gjatë ekzekutimit të këtyre masave zbatohen disa parime dhe rregulla të caktuara, të cilave duhet t'u përmbahen organet që janë të përfshira në zbatimin e tyre.

2. Parimet e përgjithshme mbi ekzekutimin e masave edukative

Në Kodin e Drejtësisë për të Mitur janë paraparë disa parime dhe rregulla të caktuara gjatë ekzekutimit të masave edukative ndaj të miturve (nenet 84-88). Si organe qendrore që janë të lidhura me ekzekutimin e masave edukative janë gjykata që ka shqiptuar masën edukative dhe shërbimi sprovues. Kësisoj, sipas nenit 84 paragrafi 1 “gjykata që ka shqiptuar masën edukative (“gjykata kompetente”) është kompetente për mbikëqyrjen e ekzekutimit të masës edukative dhe për lëshimin e urdhrave lidhur me ekzekutimin e masës edukative”. Ndërkaq, më tutje në këtë nen përcaktohet roli dhe funksioni i shërbimit sprovues në ekzekutimin e masës edukative.

Sipas paragrafit 2 të këtij neni, “shërbimi sprovues që ndodhet në territorin ku i mituri ka banim të përhershëm apo të përkohshëm (“shërbimi sprovues kompetent”) ka kompetenca për ushtrimin e përgjegjësive lidhur me ekzekutimin e masës edukative. Shërbimi sprovues kompetent e ruan kompetencën edhe nëse vendbanimi i përhershëm apo i përkohshëm i të miturit ndryshon më vonë”. Si parim tjetër mjaft i rëndësishëm që përcaktohet me këtë kod është edhe respektimi i personalitetit dhe dinjitetit

(Rregullat e Pekinit), miratuara nga rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme 40/33 e datës 29 nëntor 1985.

të të miturve gjatë ekzekutimit të masave edukative. Ky parim ka ardhur në shprehje në nenin 85 të këtij kodi. Kësisoj, sipas paragrafit 1 të këtij neni “Masat edukative ekzekutohen duke respektuar personalitetin edhe dinjitetin e të miturve, duke inkurajuar zhvillimin e tyre fizik, moral dhe intelektual, si dhe duke mbikëqyrë shëndetin e tyre fizik dhe mendor”.

Ekzekutimi i këtyre masave duhet bazuar në programin individual që duhet t’i përshtatet personalitetit të të miturit dhe duhet të jetë në pajtim me të arriturat bashkëkohore. Ky program duhet të jetë i mbështetur në analizat gjithëpërfshirëse që kanë të bëjnë me të miturin, shkaqet dhe llojin e veprës penale si dhe të shkallës së arsimimit, zhvillimit të të miturit dhe rrethanave tjera familjare (neni 85 paragrafi 3). Po ashtu, ky program duhet të përfshijë edhe mjetet motivuese që ndikojnë në zhvillimin dhe aftësimin e të miturit.

Sipas rregullit, shpenzimet për ekzekutimin e masave edukative paguhet nga buxheti i shtetit. Por, me këtë kod parashihet që edhe prindërit dhe personat e tjerë që janë të obliguar me ligj të kujdesen për të miturin obligohen që të kontribuojnë në pagimin e shpenzimeve për ekzekutimin masave edukative (neni 86 paragrafi 2).

Në praktikën gjyqësore dhe në ekzekutimin të këtyre masave parashtrohet dilema rreth nivelit apo shumës së kontributit të prindërve apo i personave tjerë që të kontribuojnë në pagimin e shpenzimeve të ekzekutimit të masës edukative. Është obligim i gjykatës që ka marrë aktvendimin mbi shqiptimin e masës edukative që të caktojë lartësinë e këtij kontributi të shpenzimeve, varësisht prej gjendjes financiare të prindërve apo personave të cilët me ligj detyrohen të kujdesen për të miturin. Me këtë rast, si rregull, së pari merret aktvendimi mbi shqiptimin e masës edukative dhe pastaj vazhdon procedura lidhur me caktimin e nivelit të këtij kontributi.

Nëse në praktikën e përditshme paraqiten rrethana që kanë të bëjnë me gjendjen financiare të këtyre obliguesve, pra nëse ajo keqësohet apo përmirësohet, atëherë në çdo rast gjykata kompetente ka të drejtë që ta ndryshojë vendimin lidhur me nivelin e kontributit (neni 86 paragrafi 4).

Masat edukative ndaj të miturve fillojnë të ekzekutohen pas vendimit të formës së prerë të gjykatës dhe kur konstatohet se nuk ka pengesa juridike për ekzekutimin e tyre.

Vendimin e formës së prerë gjykata ia dërgon institucionit të autorizuar apo individit për ekzekutim brenda tri ditëve nga dita kur vendimi merr formë të

prerë. Vendimit për ekzekutim ajo ia bashkangjetë edhe dokumentet tjera siç janë: certifikata e lindjes, dëftesën e shkollës ose dokumentin për transferim, raportin e kontrollit mjekësor, të dhënat nga dosja penale për vepra të mëhershme penale, procedurën e zbatuar dhe raportin e lëshuar nga shërbimi sprovues (neni 87 paragrafi 2). Po ashtu, edhe institucioni apo individi që e pranon vendimin e fillon ekzekutimin e masës brenda tri ditësh nga pranimi i vendimit.

Siç mund të vërehet, afatet për fillimin e procedurës dhe ndërmarrjen veprimeve të tjera që kanë të bëjnë me ekzekutimin e masave edukative janë të shkurtra dhe ato duhet të respektohen. Kjo bëhet me qëllim që ekzekutimi i këtyre masave të rrjedh pa probleme.

3. Ekzekutimi i masave disiplinore

Masat disiplinore ndaj të miturve konsiderohen masat më të lehta edukative që mund të shqiptohen ndaj kryesve të mitur. Këto masa kryesisht shqiptohen për vepra të lehta penale. Zakonisht kemi të bëjmë me persona të mitur që kanë kryer vepra penale si rezultat i pakujdesisë së tyre dhe të mungesës së përgjegjësisë personale. Këtu nuk kemi të bëjmë me një personalitet i cili ka devijuar në aspektin social dhe psikik, por veprimi dhe sjellja kriminale është me tepër rezultat i disa rrethanave dhe situatave të rastit prandaj konsiderojmë se me masa më të lehta mund të ndikojë që personi i tillë të përmirësohet dhe të heq dorë nga sjellja e tillë devijante apo delikente.

Kur gjykata ndaj të miturit shqipton ndonjë masë apo dënim në radhë të parë duhet të këtë parasysh interesin e të miturit, veçmas duhet të këtë kujdes:

- llojin e veprës penale që e ka kryer i mituri;
- moshën e të miturit;
- nivelin e zhvillimit psikologjik të miturit;
- karakterin dhe prirjet e tij;
- motivet që e kanë shtyrë në kryerjen e veprës penale;
- shkallen e edukimit të tij;
- mjedisin dhe rrethanat jetësore të tij;
- masat e shqiptuar më parë ndaj tij.⁵³⁴

⁵³⁴ Bajram Ukaj, E drejta nr.1-2/2008, faqe 112-113

Kodi i Drejtësisë për të Mitur parasheh dy lloje të masave disiplinore:

1. Qortimi gjyqësor dhe
2. Dërgimi i të miturit në qendrën disiplinore.

3.1 Qortimi gjyqësor

Qortimi gjyqësor është masa më e lehtë edukative që mund të shqiptohet ndaj kryesve të mitur të veprave të lehta penale. Sipas nenit 21, paragrafi 1 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, gjykata e shqipton këtë masë kur ajo konsiderohet e mjaftueshme dhe në interes të miturit për të ndikuar pozitivisht në sjelljen e tij. Me anën e kësaj mase gjykata e bënë me dije të miturin për dëmin e shkaktuar dhe veprën penale si dhe në të njëjtën kohë i'a tërheqë vërejtjen të miturit se nëse në të ardhmen sërish kryen vepra penale, ndaj tij do të shqiptohet një masë apo dënim më i rëndë (neni 21 paragrafi 2 i Kodit të Drejtësisë për të Mitur).

Sipas raportit të Shërbimit Sprovues të Kosovës (në vijim SHSK-ja) në Mitrovicë, ku përfshihen të dhëna mbi shqiptimin e kësaj mase rezulton, se Gjykata në përdhën e viteve 2004-2007 janë shqiptuar gjithsejtë 26 qortime gjyqësore, ndërsa SHSK-ja në Mitrovicë në këtë periudhë i ka punuar gjithsejtë 49 anketa sociale, në disa raste duke rekomanduar edhe masat edukative për rastin e paraqitur në trajtim.⁵³⁵

3.2. Dërgimi në qendrën disiplinore

Masat edukative-përmirësuese e dërgimit në qendrën disiplinore për të miturit që kanë kryer sjellje delikvente, ekzekutohet në qendra të veçanta disiplinore që themelohen vetëm për këtë qëllim. Këto qendra mund të funksionojnë edhe në kuadër të institucioneve të tjera edukuese- arsimore ose në kuadër të enteve dhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtje sociale. Ndryshe nga legjislacioni i mëparshëm i cili ka përmbajtur dispozita më detaje lidhur me ekzekutimin e kësaj mase, me këtë kod parashihen dispozita më të pakta, të cilat rregullojnë këtë fushë. Masa disiplinore e dërgimit në qendër disiplinore ekzekutohet në qendra disiplinore për të mitur, të cilat themelohen për këtë qëllim.

⁵³⁵ Raporti i Shërbimit Sprovues të Kosovës dega në Mitrovicë, Nëntor 2008

Gjykata është e obliguar që të caktojë numrin e orëve të qëndrimit të të miturit në qendrën disiplinore. Kjo masë zakonisht ekzekutohet prej orës 08-20. Nëse personit të mitur i është shqiptuar masa e qëndrimit dhe vendosjes në qendrën disiplinore për kohe më të gjatë, atëherë ai duhet të vendoset aty, pa shkëputje nga procesi i vijimit të shkollimit⁵³⁶.

Gjatë qëndrimit në qendrën disiplinore krahas trajtimit edukativ dhe pedagogjik, i mituri duhet të angazhohet edhe në aktivitetet e dobishme në pajtim me moshën e tij, shkathtësitë dhe interesat me qëllim të zhvillimit të ndjenjës së përgjegjësisë së tij. (neni 22 paragrafi 4). Po ashtu, gjatë ekzekutimit të kësaj mase duhet pasur kujdes që i mitur të vijojë me rregull shkollimin apo punën e tij.

Sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi, është obligim i prindit, prindit adoptues apo kujdestarit që të sigurojnë vizita të rregullta të të miturit në qendrën disiplinore (neni 90 paragrafi 1). Ndërsa është obligim i qendrës disiplinore që të njoftoj gjykatën kompetente kur i mituri nuk paraqitet në kohën e caktuar në qendrën disiplinore apo kur ndërpret vizitat e tij të rregullta. Lidhur me ekzekutimin e kësaj mase, qendra disiplinore mban shënime dhe përpilon raporte me shkrim mbi efektet dhe rezultatet e ekzekutimit të kësaj mase që kanë të bëjnë me përmirësimin e të miturit, të cilat raporte i dërgohen gjykatës kompetente për inspektim dhe shërbimit sprovues kompetent.

Sipas zyrtarëve të SHSK-së një ndër problemet me të cilën ballafaqohen është mungesa e qendrave edukuese në regjion të Mitrovicës, dhe ata pohojnë se bashkëpunim kanë vetëm me një organizatë e cila quhet “Shtëpia e Shpresës”, ku në këtë institucion organizohet aktivitete edukative për delikuentet e mitur, por numri është shumë i kufizuar në raport me rastet që paraqiten. Sipas raportit të Shërbimit Sprovues në Regjionin e Mitrovicës, ku përfshihen të dhëna mbi shqiptimin e kësaj mase rezulton se Gjykata në përdhën e viteve 2004-2007 nuk e ka shqiptuar as një masë edukative të dërgimit në qendrën disiplinore, po ashtu as SHSK-ja në Mitrovicë nuk ka punuar as një anketë sociale lidhur me këtë masë edukative.⁵³⁷

⁵³⁶ Ragip Halili, Penologjia (shkenca mbi ekzekutimin e sanksioneve penale), Prishtinë, 2005, faqe 262.

⁵³⁷ Raporti i SHSK-se, op.cit.

4. Ekzekutimi i masave të mbikëqyrjes së shtuar

Masat e mbikëqyrjes së shtuar, si masa të karakterit jashtë institucional, kanë rëndësi të madhe në pengimit dhe luftimin e sjelljeve devijante të të miturve. Ato po gjejnë një aplikim të gjerë në praktikën gjyqësore të shumë shteteve. Kjo nga fakti pasi që ato për nga natyra dhe përmbajtja e tyre janë më të përshtatshme për realizimin e konceptit të luftimit të kriminalitetit të të miturve, pa e privuar të miturin nga liria.⁵³⁸

Qëllimi i mbikëqyrjes është të zvogëloj keqbërjen e serishme dhe t'i ndihmoj integritet të keqbërësit në shoqëri në një mënyrë që e minimizon dëshirën për t'iu kthyer krimi.⁵³⁹ Sipas Kodi i Drejtësisë për të Mitur (neni 20 paragrafi 3) si masa të mbikëqyrjes së shtuar janë:

1. Mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit, prindit adoptues ose kujdestarit të të miturit;
2. Mbikëqyrja e shtuar nga familja tjetër dhe
3. Mbikëqyrja e shtuar nga organi i kujdestarisë.

4.1. Mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindit, prindit adoptues ose kujdestarit

Një mbrojtje dhe një asistencë sa më të gjer duhet ti jepen familjes, që është element i natyrshëm dhe themelor i shoqërisë, sidomos për formimin e saj, dhe për aq kohe sa ajo ka përgjegjësin për mbajtjen dhe edukimin e fëmijëve të varur.⁵⁴⁰ Gjykata do të shqipon këtë mase nëse plotësohen dy kushte:

Kushti i parë është që vepra penale të jetë kryer për shkak të mos ushtrimit të mbikëqyrjes dhe edukimit nga ana e prindërve, adoptuesit, apo kujdestarit.

Kushti i dytë është se kjo mase edukues mund të shqiptohet nëse konstatohet se prindërit adoptues apo kujdestari i të miturit kanë mundësi dhe aftësi ta ushtrojnë mbikëqyrjen dhe edukimin e tij.⁵⁴¹

⁵³⁸ Ismet Salihu, E drejta penale për të mitur, Prishtinë, 2005 faqe 42-44

⁵³⁹ Rregullat standarde minimale për masat jo ndëshkimore (Rregullat e Tokios), rezoluta 45/110 e datës 14 dhjetor 1990, 10.1 të miratuar me rezolutën 45/110 të Asamblesë së Përgjithshme të 14 Dhjetorit 1990 faqe 5, neni 10.

⁵⁴⁰ Pakti ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore të miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme me Rezolutën e saj 2200 A (XXI) të datës 16 dhjetor 1966, neni 10.

⁵⁴¹ Salihu, op.cit., faqe 42-44

Ekzekutimi i masës së mbikëqyrjes së shtuar nga ana e prindit, prindit adoptues ose kujdestarit, sipas nenit 91 të këtij kodi, fillon kur prindërit, prindërit adoptues apo kujdestari pranon aktvendimin e formës së prerë mbi shqiptimin e kësaj mase edukative. Qëllimi i shqiptimit dhe ekzekutimit të kësaj mase është që të shtohet mbikëqyrja në sjelljet dhe jetën e të miturit nga ana e atyre që edhe sipas ligjit janë të obliguar që të kujdesen për edukimin dhe zhvillimin e drejtë të tyre. Masa e mbikëqyrjes së shtuar nga ana e prindit, prindit adoptues ose kujdestarit nuk mund të zgjasë më pak se tre muaj e as më gjatë se dy vjet (neni 20, paragrafi 3). Gjatë ekzekutimit të kësaj mase i mitur qëndron në familjen e vet, por prindërit e tij, prindërit adoptues apo kujdestari janë të obliguar që të kujdesen dhe të ushtrojnë mbikëqyrje të shtuar ndaj tij. Ata janë të obliguar që t'i respektojnë urdhrat dhe udhëzimet e gjykatës e cila ka shqiptuar masën edukative. Po ashtu, ata duhet të lejojnë edhe organin e shërbimit sprovues që të verifikojë ekzekutimin e kësaj mase kur një gjë e tillë urdhërohet nga gjykata (neni 92 paragrafi 1). Po ashtu, sipas nenit 93 paragrafi 1 prindërit, prindërit adoptues ose kujdestari i të miturit dhe shërbimi sprovues janë të obliguara që ta informojnë gjykatën kompetente mbi përparimin e ekzekutimit të kësaj mase.

Ndërkaq, shërbimi sprovues është i obliguar që ta informojë gjykatën edhe për mos përmbushjen e detyrimit të veçantë nga i mituri në pajtim me nenin 26 të këtij kodi dhe pengesat e tjera që kanë të bëjnë me ekzekutimin e kësaj mase. Nëse gjatë ekzekutimit të kësaj mase lindin probleme, mosmarrëveshje dhe konteste ndërmjet prindërve, prindërve adoptues ose kujdestarit të të miturit dhe shërbimit sprovues, atëherë ky konflikt zgjidhet përmes gjykatës kompetente. Ndërkaq, varësisht nga rezultatet që arrihen gjatë ekzekutimit të kësaj mase, me propozimin e shërbimit sprovues ose me vetiniciativë, gjykata mundet që këtë masë ta suprimojë ose ta zëvendësoj me ndonjë masë tjetër edukative.⁵⁴²

Sipas raportit të SHSK-së në Mitrovicë, ku përfshihen të dhëna mbi shqiptimin e kësaj mase rezulton se Gjykata në periudhën e viteve 2004-2007 janë shqiptuar gjithsejtë 84 masa të tilla, ndërsa mbikëqyrje e shtuar nga prindërit në verifikim të SHSK-se janë shqiptuar në 10 raste, ndërsa SHSK-se në Mitrovicë në këtë periudhë kohore i ka punuar gjithsejtë 46

⁵⁴² Regjep Gashi, Ekzekutimi i masave dhe dënimeve ndaj të miturve (Me Ligjin Penal për të Mitur), Dispensë Prishtinë, 2007, faqe 22.

anketa sociale, në disa raste duke rekomanduar edhe masat edukative për rastin e paraqitur në trajtim.⁵⁴³

Andaj qeveritë duhen te krijojnë një politik që është e favorshme për rritjen e fëmijëve në ambiente familjare stabile dhe harmonike. Familjet që kanë nevojë për ndihem për ti zgjedhur rrethanat e pasigurisë ose te konfliktit, shteti duhet t'iu ofroj shërbimet e nevojshme.⁵⁴⁴

4.2. Mbikëqyrja e shtuar në familjen tjetër

Masa e mbikëqyrjes së shtuar në familjen tjetër zakonisht në rastet kur për shkaqe objektive prindërit, adoptuesi apo kujdestari nuk janë në gjendje ta ushtrojnë zbatimin e kësaj mase për arsye të pa aftësisë fizike dhe psikike si p.sh., për shkak të sëmundjeve të ndryshme, gjenden jashtë shtetit, janë duke mbajtur dënimin me burg etj., ose edhe për shkak të rrethanave personale të tyre (janë alkoolist, narkoman etj.).⁵⁴⁵ Këto rrethana dhe të ngjashme bëjnë që gjykata të vendos që mbikëqyrja e shtuar të zbatohet në një familje tjetër. Natyrisht se familja tjetër duhet të plotësojë disa kushte të caktuara si dhe të pajtohet me zbatimin e masës së shqiptuar.

Në rend të parë kërkohet që në të mbretërojnë një ambient i shëndoshë familjar dhe të ketë kushte për ofrimin e mbikëqyrjes së shtuar. Sipas nenit 94 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, gjykata kompetente me propozimin e shërbimit sprovues kompetent e cakton familjen në të cilën vendoset i mituri ndaj të cilit është shqiptuar kjo masë. Është detyrë e shërbimit sprovues që para se t'ia dorëzojë propozimin gjykatës, duhet të analizojë dhe studiojë personalitetin e të miturit dhe strukturën sociale dhe psikologjike të familjes në të cilën ai do të vendoset. Dispozitat e këtij kodi sugjerojnë dhe obligojnë se në kushtet e njëjta, përparësi duhet dhënë familjes me të cilën i mituri është në lidhje farefisnore apo është i lidhur emocionalisht me të (neni 94 paragrafi 3). Edhe në rast shqiptimi të kësaj mase gjykata përcakton obligimet dhe detyrat të caktuara për zbatimin e masave konkrete ndaj personit të mitur.

Familjes tjetër, gjykata i shtron obligime që ti përmbush disa aktivitete dhe veprime që kanë të bëjnë me edukimin, shkollimin, dhe mbikëqyrjen e

⁵⁴³ Raporti i SHSK-se, op.cit.

⁵⁴⁴ Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për parandalimin e delikucencës së mitur (Udhëzimet e Riadit) të miratuara dhe të shpallura me rezolutën 45/112 të Asamblesë së Përgjithshme me 14 Dhjetor 1990 sesioni i 68-të plenar, faqe 3, neni 13.

⁵⁴⁵ Halili, op.cit., faqe 261.

personit të mitur. Sipas nenit 95 të këtij kodi, shërbimi sprovues dhe familja në të cilën vendoset i mituri nënshkruajnë marrëveshje me shkrim që i rregullon të drejtat dhe detyrimet e përbashkëta. Në këtë kontratë përcaktohen obligimet që i merr përsipër familja ndaj të miturit si dhe kushtet dhe afati i qëndrimit të personit të mitur. Nga ana tjetër, po ashtu në këtë kontratë rregullohet obligimi i bartjes së shpenzimeve të vendosjes, ushqimit dhe shpenzimeve tjera që lindin gjatë kohës së qëndrimit të personit të mitur në familjen tjetër. Familja tjetër dhe organi i kujdestarisë, gjithashtu obligohen që në mënyrë të rregullt ta informojnë gjykatën lidhur me ecuritë e realizimit dhe zbatimit të kësaj mase.

Me urdhër të gjykatës, familja në të cilën vendoset i mituri duhet të lejojë shërbimin sprovues ta verifikojë ekzekutimin e kësaj mase. Me qëllim që ekzekutimi i kësaj mase të zbatohet me sukses, shërbimi sprovues i ofron ndihmë të nevojshme familjes në të cilën është i vendosur i mituri. Po ashtu, gjatë ekzekutimit të kësaj mase, i mituri mban lidhje të përhershme me familjen e tij, përpos kur gjykata kompetente urdhëron ndryshe në bazë të propozimit të shërbimit sprovues (neni 96).

Në rastet kur rrethanat në familjen ku është vendosur i mituri ndryshojnë dhe e vështirësojnë ekzekutimin e kësaj mase, atëherë gjykata sipas detyrës zyrtare ose në bazë të propozimit të shërbimit sprovues mund të urdhërojë ndryshimin e vendit për të miturin, duke e dërguar atë në një familje tjetër (neni 97). Kjo masë edukuese mund të zgjasë më së paku tre muaj dhe më së tepërmi dy vjet. Varësisht nga suksesi i arritur gjatë ekzekutimit të kësaj mase, sipas propozimit të shërbimit sprovues apo me vetiniciativë gjykata mundet që masën e shqiptuar ta pushojë apo ta zëvendësojë me një masë tjetër edukative.⁵⁴⁶ Në regjionin e Mitrovicës kjo masë edukative nuk është shqiptuar nga ana e Gjykatës brenda kësaj periudhe kohore, çka do të thotë se as shërbimi sprovues nuk e ka bërë asnjë anketë sociale.⁵⁴⁷

4.3. Mbikëqyrja e shtuar nga organi i kujdestarisë

Në praktikë ndodhin situata dhe raste të cilat vërtetojnë se personi i mitur nuk mund të qëndrojë në familjen e vet por as të vendoset në ndonjë familje tjetër me qëllim të ushtrimit të mbikëqyrjes së shtuar. Gjatë ekzekutimit të kësaj mase, gjykata sipas nenit 26 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur mund të cakton detyrime të posaçme ndaj të miturit si: personalisht t'i kërkojë falje

⁵⁴⁶ Gashi, op.cit., faqe 30-35.

⁵⁴⁷ Raporti i SHSK-se, op.cit.

palës së dëmtuar; palës së dëmtuar t'ia kompensojë dëmin në pajtim me gjendjen financiare të të miturit; të vijojë rregullisht shkollimin; të pranojë punësimin ose të aftësohet për një profesion i cili i përshtatet shkathtësive dhe aftësive të tij; të përmbahet nga çfarëdo kontakti me individë të caktuar që mund të kenë ndikim negativ tek i mituri; të pranojë këshilla psikologjike; të mos vizitojë vende ose mjedise të caktuara që mund të kenë ndikim negativ tek i mituri dhe të përmbahet nga përdorimi i drogës dhe i alkoolit. Organi i kujdestarisë posa ta marrë aktvendimin mbi shqiptimin e kësaj mase e cakton zyrtarin përgjegjës nga organi i kujdestarisë për ekzekutimin e masës dhe lidhur me këtë e informon gjykatën kompetente (neni 99 parag.2). Personi zyrtar duhet të kujdeset për shkollimin e të miturit, për kyçjen e tij eventuale në aktivitete e dobishme dhe për largimin e tij nga ambienti që ndikon dëmshëm në formimin e tij. Gjithashtu ky person zyrtar ndërmer masa te nevojshme për mjekim, sigurimin, mbrojtjen shëndetësore, dhe sigurimin e kushteve tjera te nevojshme për jetë normale te personit te mitur.

Organi i kujdestarisë harton planin e punës që duhet të zbatohet lidhur me ekzekutimin e kësaj te mbikëqyrjes se shtuar. Ky plan përmban detyrime dhe obligime si te personit te miturit ashtu edhe te organeve te kujdestarisë. Personi zyrtar është i obliguar që personalisht dhe me rregull të mbaj kontakt me personin e mitur te organizoj biseda, vizita dhe mënyra te tjera te përshtatshme te ndikimit dhe mbikëqyrjes. Gjatë ekzekutimit të kësaj mase është obligim i gjykatave, zyrave të prokurorive, shkollave dhe institucioneve të tjera që të ndihmojnë dhe bashkëpunojnë me organin e kujdestarisë në ekzekutimin e kësaj mase edukative. Po ashtu, edhe prindi, prindi adoptues apo kujdestari i të miturit janë të obliguar që ta informojnë organin e kujdestarisë lidhur me pengesat eventuale në ekzekutimin e masës së tillë. Personi zyrtar i organit të kujdestarisë kujdeset dhe merr masa të nevojshme që kanë të bëjnë me shkollimin e të miturit, kyçjen e tij në aktivitetet e dobishme shoqërore, mjekimin, sigurimin si dhe sigurimin e kushteve të tjera të nevojshme për zhvillimin e drejtë të të miturit.

Organi i kujdestarisë, po ashtu është i obliguar që ta informojë gjykatën kompetente edhe lidhur me mos përmbushjen e detyrimeve të posaçme të shqiptuara sipas nenit 26 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur nga ana e të miturit, si dhe për çfarëdo pengese në ekzekutimin e masës edukative. Kohëzgjatja e kësaj mase edukative është jo më e shkurtër se tre muaj dhe jomë e gjatë se dy vjet. Sipas raportit të SHSK-së në Mitrovicë, ku përfshihen të dhëna mbi shqiptimin e kësaj mase edukative, rezulton se Gjykata në përrudhën e viteve 2004-2007 janë shqiptuar gjithsejtë 23 masa te

mbikëqyrjes se shtuar nga ana e organit të kujdestarisë, dhe 3 raste i ka shqiptuar me detyrime te veçanta vijim te rregullt shkollor, ndërsa SHSK-ja ne Mitrovicë ne këtë periudhe i ka punuar gjithsejtë 56 anketa sociale, ne disa raste duke rekomanduar edhe masat edukative për rastin e paraqitur ne trajtim.⁵⁴⁸

5. Ekzekutimi i masave edukative institucionale

Vendosja e personave te mitur ne ente dhe institucione te veçanta arsyetohet edhe me faktin se ambienti i deritanishëm ka pasur ndikim negativ dhe vlerësohet se është e domosdoshme qe ata te largohen edhe ne mënyre fizike për një kohë te caktuar nga ai ambient, me qëllim te eliminimit te ndikimeve te tilla dhe krijimit te shprehive e vetive te reja konstruktive. Në nenet 102-126 të këtij kodi, janë paraparë disa dispozita të përgjithshme që kanë të bëjnë me ekzekutimin e masave edukative institucionale. Kështu, sipas nenit 102 të këtij kodi, i mituri ndaj të cilit ekzekutohet masa edukative institucionale, krahas të drejtave të parapara me këtë kod, gëzon edhe të drejtat sikurse edhe personat madhorë të dënuar me burgim. Edhe me këto dispozita parashihet shtyrja e ekzekutimit të këtyre masave për shkaqe të arsyeshme, në bazë të kërkesës së të miturit ose prindit të tij, prindit adoptues ose kujdestarit ose me propozimin e shërbimit sprovues.⁵⁴⁹

Lidhur me shtyrjen e masës vendos gjykata kompetente. Po ashtu, sipas nenit 106 të këtij kodi, me kërkesën e të miturit apo prindit të tij, prindit adoptues ose kujdestarit, ose me propozimin e drejtorit të institucionit ku ekzekutohet masa edukative institucionale, kjo masë mund të pezullohet për arsye të justifikueshme deri në tre muaj, e përjashtimisht, për qëllime të trajtimit, pezullimi mund të vazhdojë deri në përfundim të trajtimit. Ndërkaq, dispozitat e Ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale mbi shtyrjen dhe pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim zbatohen përshtatshmërisht edhe për shtyrjen dhe pezullimin e ekzekutimit të masave edukative institucionale (neni 109 Kodit te Drejtësisë për të Mitur).

5.1. Dërgimi në institucionin edukativ

Ekzekutimi i kësaj mase bëhet në institucionin për edukimin e të miturve. Këto janë institucione të veçanta edukative që ndërtohen për këto qëllime ose ekzekutimi i kësaj mase mund të bëhet edhe në institucione ekzistuese

⁵⁴⁸ Raporti i SHSK-se, op.cit.

⁵⁴⁹ Gashi, op.cit., faqe 17.

edukative si: konvikte, shtëpi të nxënësve dhe institucione të ngjashme në të cilat gjenden të miturit dhe të rinjtë në procesin e arsimimit dhe shkollimit të tyre. Lidhur me zgjatjen e kësaj mase, gjykata nuk vendos gjatë marrjes së vendimit, por varet nga procesi i riedukimit dhe permisimit të personave të mitur. Në këtë drejtim hartohet një planë i veçanta i punesë dhe aktivitetit me persona të mitur. Në këto institucione zhvillohet një aktivitet i dendur me personat e mitur dhe ofrohen kushte themelore për shkollim, arsimim dhe aftësim profesional dhe kushte të tjera për formimin e drejtë të personalitetit të tyre, në mënyrë që të ndikohet në ndryshimin e sjelljeve dhe qëndrimeve negative dhe evitimin e të metave të tyre. Personat e mitur të cilët janë vendosur në këto ente edukative, këtë masë e mbajnë në kushte të njëjta me të miturit tjerë të moshës së tyre të cilët gjenden në këto ente. Natyrisht se personat e mitur e mbajnë këtë masë në kushte të njëjta me të miturit e tjerë. Respektivisht, vetëm drejtori i institucionit edukativ dhe edukatori përgjegjës i të miturit njoftohen për shqiptimin e masës edukative ndaj të miturit.

Në ekzekutimin e masës së dërgimit në institucionin edukativ roli i shërbimit sprovues është i madh. Kjo masë ekzekutohet nën mbikëqyrjen e shërbimit sprovues kompetent. Sipas nenit 111 shërbimi sprovues kompetent ka autorizim për të urdhëruar të miturin të paraqitet në institucionin edukativ. Po ashtu, ky shërbim është i detyruar që të caktojë një person, i cili bënë transportin e të miturit në institucionin edukativ. Institucioni edukativ në të cilin ekzekutohet kjo masë është i obliguar që ta njoftojë gjykatën kompetente lidhur me ecurinë e ekzekutimit të kësaj mase dhe ndryshimet që vërehen në procesin e riedukimit, në mënyrë që gjykata të ketë mundësi që të ndërmarr masa në drejtim të ndërprerjes së kësaj mase apo zëvendësimit të saj me ndonjë masë tjetër. Posaçërisht është problematik çështja e vendosjes së personave të mitur delikuentë në institucione të rregullta siç janë konviktet, internatet, dhe qendrat shkollore etj. meqenëse këto institucione nuk dëshirojnë që në gjirin e vet të kenë të mitur problematik dhe delikuent. Prandaj, kjo masë sidomos në praktiken gjyqësore është zbatuar rrallë.

5.2. Dërgimi në institucionin edukativo-korrektues

Dërgimi në institucionin edukativo-korrektues është masë më e rëndë institucionale, e cila ekzekutohet në institucionin edukativo-korrektues të themeluar për këtë qëllim. Sipas nenit 113 paragrafi 1 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, ky institucion është i tipit gjysmë të hapur dhe të hapur. Sipas dispozitave të këtij ligji, femrat që i nënshtrohen kësaj mase vendosen në

sektorin e femrave të institucionit edukativo-korrektues, ndërkaq madhorët dhe të miturit që kanë mbushur moshën 18 vjeçare, vendosen në sektorin e veçantë të këtij institucioni (neni 113 parag. 2 dhe 3).

Institucioni edukativo-korrektues u ofron të miturve mbrojtje, ndihmë dhe mbikëqyrje me qëllim të riedukimit dhe arsimimit të suksesshëm të tyre. Gjatë ekzekutimit të kësaj mase, veçmas theksohet se personave të mitur duhet t'u sigurohen kushte për arsimim dhe aftësim profesional të tyre. Atyre gjithashtu duhet t'u mundësohet edhe mbajtja e lidhjeve me familjen si dhe përfshirje e tyre në aktivitetet te ndryshme brenda entit, posaçërisht u mundësohet marrja me aktivitete te lira kulturore zbavitëse dhe sportive. Personeli i shtëpisë edukuese-përmirësuese, veçmas angazhohet për zhvillimin dhe formimin e vetive dhe shprehive pozitive te personave te mitur gjate qëndrimit ne këto institucione edukative.

Ne kuadër te shtëpisë edukuese-përmirësuese, nuk ka kushte për vijimin e arsimimit dhe shkollimit me te larte, atëherë personave te mitur u bëhet e mundur që të vijojnë mësimet dhe jashtë shtëpisë edukuese-përmirësuese, kuptohet, nën kontrollin dhe mbikëqyrje te edukatorit. Gjykata kompetente që ka shqiptuar masën edukative të dërgimit në institucionin edukativo-korrektues e urdhëron të miturin që të paraqitet ditën e caktuar për të filluar ekzekutimin e kësaj mase. Periudha kohore ndërmjet marrjes së urdhrit dhe ditës së paraqitjes në institucion nuk duhet të jetë më e shkurtër se tetë ditë dhe as më e gjatë se pesëmbëdhjetë ditë (neni 114 paragrafi 2). Po ashtu, gjykata kompetente duhet ta informojë edhe institucionin edukativo-korrektues për datën kur i mituri duhet të paraqitet dhe ia dorëzon vendimin e formës së prerë dhe të gjitha të dhënat e nevojshme që janë mbledhur gjatë zhvillimit të procedurës së zhvilluar.

Në rastet kur i mituri i ftuar me rregull nuk paraqitet në institucionin edukativo-korrektues, gjykata urdhëron transportimin e tij deri në institucion. Ndërkaq, nëse ai fshihet apo ndodhet në arrati, gjykata urdhëron letërreshtimin. Kodi i Drejtësisë për të Mitur përmban edhe dispozita që kanë të bëjnë me pranimin e të miturit në institucionin edukativo-korrektues, vendosjen e tij, klasifikimin dhe dispozita të tjera që kanë të bëjnë me pozitën e të miturve gjatë qëndrimit në institucion. Sipas nenit 116 të këtij kodi, personi i mitur posa të pranohet në institucionin edukativo-korrektues, së pari konstatohet identiteti i tij, arsyet e shqiptimit të masës dhe organi që ka shqiptuar masën edukative. Më pas ai i nënshtrohet kontrollit mjekësor, i cili duhet të bëhet brenda 24 orëve nga arritja e tij në institucion. Me këtë rast, emri i të miturit, arsyet dhe organi që ka shqiptuar

masën edukative, data dhe koha për pranimin e tij në institucion korrektues shënohen në regjistër.

Pas kryerjes së këtyre veprimeve, i mituri dërgohet në sektorin e kontrollit personal, në të cilin ai qëndron deri në gjashtëdhjetë ditë, në mënyrë që të përpilohet programi individual. Ky program individual i trajtimit të miturit duhet të jetë rezultat i një pune të përbashkët të ekipës multidisiplinare, në të cilën janë të përfshirë ekspertë të ndryshëm të institucionit korrektues. Në hartimin e këtij programi marrin pjesë ekspertë të lëmenjve të ndryshëm si: psikologë, pedagogë, punëtorë social, mjekë, juristë, kriminologë, penologë etj. Të miturit gjatë qëndrimit në institucionin edukativo-korrektues ndahen në grupe edukative në pajtim me moshën e tyre, zhvillimin mendor dhe karakteristikat e tjera dhe veçoritë e programit të individualizimit. Zakonisht grupet e të miturve duhet të jenë deri në njëzet veta dhe të udhëhiqen me një edukator të veçantë.

Personave të mitur duhet t'u mundësohet marrja me ushtrime fizike për të ruajtur shëndetin e tyre si dhe të kalojnë së paku tri orë jashtë lokaleve të mbyllura gjatë kohës së lirë. Po ashtu, ata duhet të kenë mundësi që të merren edhe me sport dhe aktivitete të tjera fizike. Personave të mitur, gjatë qëndrimit në institucionin edukativo-korrektues i'u takon brenda ditës tri racione ushqimi i llojllojshëm me vlerë klorike e cila nuk mund të jete nën masën prej 3500 kalorish. Atyre po ashtu iu sigurohen edhe ndërresat, veshmbathja dhe rrobat të cilat duhet t'u përshtaten kushteve klimatike dhe stinëve të vitit.⁵⁵⁰ Ndërresat, rrobat dhe veshmbathja e të miturve duhet të mbahen në gjendje të pastër, të lahen me rregull dhe të kontrollohen në mënyrë permanente. Higjiena e të miturve dhe e lokaleve të institucionit edukativo-korrektues duhet të kontrollohet nga shërbimi i veçantë i institucionit.⁵⁵¹

Personat e mitur gjatë qëndrimit në institucionin edukativo-korrektues gëzojnë një numër të konsiderueshëm të drejtave. Kështu, sipas nenit 120 paragrafi 1 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, të miturin kanë të drejtë të vizitohet së paku një herë në javë deri në një orë në ditë nga prindi i tij, prindi adoptues, kujdestari, bashkëshorti, fëmija, fëmija i adoptuar dhe nga të afërmit e tjerë të gjakut në vijë të drejtpërdrejtë ose në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt. Po ashtu, sipas paragrafit 2 të këtij neni, i mitur ka

⁵⁵⁰ Halili op.cit., faqe 265.

⁵⁵¹ Ibid, faqe 263.

të drejtë të vizitohet së paku njëherë në muaj edhe nga personat e tjerë të cilët nuk kanë ndikim negativ në ekzekutimin e masës edukuese.

Të miturit kanë të drejtë në letërkëmbim të zgjeruar, pra përveç me anëtarët e familjes së tyre, edhe me persona të tjerë. Gjithashtu edhe marrja e pakove është një e drejtë e pakufizuar e tyre. Edhe e drejta në punë e të miturve është e drejtë themelore e tyre. E drejta në punë është njëkohësisht edhe obligim i tyre, ngase përmes punës krijohen shprehi dhe të miturit aftësohen për jetë të pavarur pas daljes nga insitucioni edukativo-korrektues. Personat e mitur kanë të drejtë në pushim vjetor prej tridhjetë ditësh, të cilin pushim mund ta shfrytëzojnë jashtë lokaleve të institucionit edukativo-korrektues. Po ashtu, edhe drejtori i institucionit korrektues mund t'i lejojë të miturit pushim shtesë nga institucioni për arsyt e natyrës edukative, profesionale, familjare ose edhe të arsyeve të tjera të natyrës sociale deri në pesëmbëdhjetë ditë çdo vit (neni 120 paragrafi 3). Personat e mitur të cilët kanë treguar sjellje të mira dhe kanë arritur rezultate në procesin e shkollimit, të punës dhe aktiviteteve tjera në institucionin institucional mund të fitojnë edhe benificione të caktuara. Këto benificione apo privilegje kanë të bëjnë me shfrytëzimin e pushimit në familje, të drejtën e zgjeruar në pranimin e pakove, pranimin e vizitave jashtë institucionit korrektues, pushimin deri në shtatë ditë, daljen e lirë në qytet, vizita në grupe në manifestime kulturore, zbavitëse e sportive etj.

Ndaj të miturve mund të shqiptohen edhe masa apo dënime disiplinore. Në nenin 122 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, shprehimisht thuhet se dispozitat mbi procedurat disiplinore dhe dënimet e zbatueshme për personat e dënuar me burgim të parapara me Ligjin mbi ekzekutimin e sanksioneve penale zbatohen përshtatshmërisht për të miturin i cili i nënshtrohet masës së dërgimit në institucionin edukativo-korrektues. Por, kuptohet se ka edhe përjashtime në këtë drejtim. Kësisoj, sipas nenit 122 paragrafi 2, të miturit nuk mund t'i shqiptohet izolimi në qeli të veçantë si dënim disiplinor. Ndërkaq, me rastin e vendosjes së të miturit në njësinë e veçantë të institucionit edukativo-korrektues si dënim disiplinor duhet të merret parasysh respektimi i disa kushteve të caktuara si: kjo periudhë kohore nuk mund të jetë më e gjatë se pesëmbëdhjetë ditë; i mitur nuk vendoset vetëm në njësinë e veçantë; i mituri ka të drejtë të kalojë së paku tri orë jashtë lokaleve të mbyllura gjatë kohës së lirë etj.

Kjo masë institucionale mund të zgjatë prej një viti deri në pesë vjet (neni 28 paragrafi 3). Sipas të dhënave statistikore rezultojnë se Gjykata e ka shqiptuar vetëm një rast të tillë, ku sipas shërbimit sprovues kanë hasur

shumë vështirësi në mbikëqyrjen e ekzekutimit të kësaj mase edukative, me faktin se nuk ka institucione për një gjë të tillë.

5.3. Dërgimi në institucionin për kujdes të posaçëm

Masa edukative e dërgimit në institucionin për kujdes të posaçëm i shqiptohet personit të mitur i cili ka kryer vepra penale për shkak të çrregullimeve dhe ngecjeve të tij bisopsikike dhe kur kjo është në interesin më të mirë të të miturit. Çdo i mituri i cili vuan nga sëmundjet mendore, duhet të shërohet në një institucion të specializuar, nën drejtimin e pavarur mjekësor. Duhet të ndërmerren hapa, në marrëveshje me agjencitë e duhura, për të siguruar çdo vazhdim të nevojshëm të përkujdesjes shëndetësore, mendore pas lirimit.⁵⁵² Në këto raste fjala është për persona shurdhmemec, persona të verbër, persona me zhvillim të vonuar psikik dhe persona të mitur me çrregullime tjera shpirtërore dhe psikike.

Ekzekutimi i masës së dërgimit në institucionin për kujdes të posaçëm bëhet në institucione të posaçme të mbrojtjes sociale, ku i mituri i gëzon të drejtat dhe detyrimet e njëjta sikurse të miturit e tjerë. Sipas dispozitave të kodit në fuqi, shërbimi sprovues kompetent është i autorizuar për dërgimin e të miturit në institucionin e kujdesit të posaçëm (neni 123). Nëse i mituri, ndaj të cilit është shqiptuar kjo masë refuzon ta zbatojë atë apo arratiset, atëherë shërbimi sprovues duhet ta njoftojë menjëherë gjykatën kompetente dhe stacionin policor kompetent, në mënyrë që i mituri të transportohet deri në institucion. Gjatë transportimit të miturit, ai shoqërohet edhe nga zyrtari mjekësor. Kjo masë ka rëndësi të madhe në procesin e aftësimit dhe rehabilitimit të personave të mitur me aftësi të kufizuara apo me ngecje në zhvillimin psiko-fizik dhe për pengimin e veprimeve kriminale të tyre.

Nisur nga natyra e kësaj mase, me kod nuk është caktuar kohëzgjatja e saj. Mirëpo, në pajtim me nenin 29 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, gjykata që e ka shqiptuar këtë masë, është e obliguar që çdo gjashtë muaj ta rishikoj nevojën për qëndrimin e mëtejshëm të të miturit në institucionin e kujdesit të posaçëm, e veçmas kur i mituri arrin moshën tetëmbëdhjetë vjeçare. Është obligim i institucionit për kujdes të posaçëm dhe i shërbimit sprovues që ta informojnë gjykatën kompetente lidhur me përparimin gjatë ekzekutimit të kësaj mase. Sipas rregullit, i mituri qëndron në institucionin e kujdesit të posaçëm deri në moshën tetëmbëdhjetëvjeçare, e nëse është e

⁵⁵² Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të miturve që janë privuar nga liria, rezuluta 45/113 të datës 14 dhjetor 1990, H, 49

nevojshme, ky qëndrim mund të zgjatet edhe më tej me lejen e drejtorit të institucionit. Këto janë rastet kur është e nevojshme përfundimi i procesit të shkollimit dhe aftësimit të tij apo edhe për shkaqe të tjera të arsyeshme.

6. Shqyrtimi, zëvendësimi dhe pushimi i ekzekutimit të masave edukative

Me Kodin e Drejtësisë për të Mitur është paraparë mundësia që gjatë ekzekutimit të masave edukative, gjykata të ketë mundësi çdo gjashtë muaj ta rishqyrtojë vendimin e vet dhe varësisht nga suksesi i arritur të vendos për ndryshimin apo pushimin e ekzekutimit të masës edukative. Kjo e drejtë i është dhënë gjykatës me qëllim që ajo të jetë aktive edhe pas shqiptimit të masës dhe në bashkëpunim me drejtorin e institucionit apo qendrës ku ekzekutohet masa edukative, dhe me shërbimin sprovues ta përcjellin ekzekutimin e masës edukative në mënyrë që të realizohet qëllimi i masës edukative përkatëse. Autorizimet e tilla që u janë dhënë gjykatës burojnë nga dispozitat e këtij kodi. Kësisoj, në nenin 127 paragrafi 1 shprehimisht thuhet: “Çdo gjashtë muaj, drejtori i institucionit apo qendrës, ku ekzekutohet masa edukative gjykatës dhe shërbimit sprovues kompetent i dorëzon raport për sjelljen e të miturit dhe suksesin e ekzekutimit të masës. Varësisht nga suksesi i ekzekutimit të masës, drejtori paraqet propozim për ndryshimin apo pushimin e ekzekutimit të masës edukative”.

Po ashtu, krahas përcjelljes së ekzekutimit të masës edukative përmes raportit të drejtorit të institucionit apo qendrës, dispozitat e këtij kod obligojnë gjyqtarin për të mitur që çdo gjashtë muaj t’i vizitojë të miturit e vendosur në institucion apo qendër, dhe përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me të miturit dhe zyrtarët e drejtpërdrejtë të përfshirë në ekzekutimin e masës edukative institucionale dhe pas shqyrtimit të shënimeve të institucionit apo qendrës, konstaton nëse të miturit trajtohen në mënyrë korrekte dhe në pajtim me kodin, dhe nëse masat edukative institucionale kanë qenë të suksesshme (neni 127 paragrafi 2).

Gjyqtari për të mitur, menjëherë pas vizitës e informon shërbimin sprovues kompetent dhe institucionin apo qendrën në të cilën ekzekutohet masa edukative për të metat apo vërejtjet eventuale që mund të ketë. Pas informatave të tilla, shërbimi sprovues menjëherë bën kontrollime adekuate dhe ndërmerr masa për korrigjimin e parregullsive, duke e informuar gjykatë kompetente për veprimet e ndërmarra (neni 127 paragrafi 3). Në bazë të raportit të drejtorit të institucionit apo qendrës në të cilën ekzekutohet masa edukative dhe raportit të shërbimit sprovues si dhe të

njohurive të fituara gjatë vizitave dhe kontaktit me të miturin, gjykata kompetente e rishqyrton ekzekutimin e masës edukative çdo gjashtë muaj. Po ashtu rishqyrtimi i ekzekutimit të masës edukative mund të bëhet edhe me kërkesën e të miturit, prindërit të tij, prindërit adoptues apo kujdestarit, qendrës, institucionit apo vendit ku ekzekutohet masa edukative ose shërbimit sprovues (neni 128 paragrafi 2). Lidhur me kërkesën për rishqyrtim nga kategoria e personave dhe subjekteve të përmendura vendos trupi gjykues për të mitur i gjykatës kompetente brenda tetë ditësh nga pranimi i kërkesës.

Ankesa kundër këtij vendimi mund të dorëzohet në gjykatën e shkallës së dytë brenda tri ditësh nga pranimi i vendimit (neni 128 paragrafi 3). Gjatë rishqyrtimit të ekzekutimit të masës edukative, gjykata merr parasysh raportet e shërbimit sprovues dhe të drejtorit të institucionit apo qendrës ku ekzekutohet masa si dhe dëgjon të miturin, prindin e tij, prindin adoptues apo kujdestarin, avokatin mbrojtës, prokurorin publik dhe shërbimi sprovues (neni 128 paragrafi 4). Pas përfundimit të rishqyrtimit të ekzekutimit të masës edukative, gjykata kompetente në pajtim me nenin 128 paragrafi 5 ka mundësi që të vazhdojë ekzekutimin e masës edukative, të pushojë ekzekutimin e mëtejme të masës edukative apo ta zëvendësojë me një masë më të lehtë edukative. Vetëm përjashtimisht, gjykata, masën edukative mund ta zëvendësojë me një masë më të rëndë edukative në rastin kur i mituri nuk i ka përmbushur detyrimet e posaçme në pajtim me nenin 26 të Kodit të drejtësisë për të Mitur (paragrafi 6 i nenit 128). Në nenin 129 të këtij kodi janë paraparë rastet dhe arsyet se kur mund të pushojë ekzekutimi i masës edukative apo ajo të zëvendësohet me masë tjetër edukative.

Sipas të dhënave të gjykatës në regjionin e Mitrovicës procedura gjyqësore është pezulluar për dy raste. Zakonisht rastet e tilla kanë të bëjnë me zbulimin e rrethanave të tjera, fakteve dhe provave të reja që nuk kanë ekzistuar ose nuk kanë qenë të njohura kur është marrë vendimi, apo edhe të kalimit të një kohe të caktuar nga koha kur vendimi mbi shqiptimin e masës edukative është bërë i formës së prerë.⁵⁵³

Andaj nga e gjithë kjo që u trajtua më lart mund të vijmë në përfundim se **Gjykatat dhe Prokurorit** si dhe institucionet tjera kompetente duhen doemos të shfrytëzojnë disa rregulla psikologjike taktike gjatë gjithë rrjedhjes së procedurës penale ndaj të miturve, siç janë:

⁵⁵³ Gashi, op.cit., faqe 32

- a)** Biseda me fëmijë dhe me të mitur duhet të përgatitet mirë, të fiksohet në mënyrë të saktë vendi dhe koha, dhe në parim, të zhvillohet vetëm një herë. Biseda duhet të zhvillohet hollësisht dhe në mënyrë të plotë.
- b)** Në përgatitjen e bisedës, është e nevojshme të kontaktohet me prindërit, sepse ndihma e tyre është e domosdoshme që të vendoset një raport dhe bashkëpunim i mirë me fëmijë. Ndonjëherë është e dobishme të kontaktohet edhe me autoritetet shkollore, drejtorin, psikologun dhe kujdestarin e klasës. Prania e prindërve dhe e personave të tjerë, ndërkaq, nuk është asses e dëshirueshme gjatë zhvillimit të drejtpërdrejtë të bisedës informative. Ndikimi sugjestiv i prindërve dhe qëndrimi i tyre i anshëm mund të ndikojë në sigurinë më të madhe të fëmijëve, kështu që ai mund të imagjinojë dhe të shtrembërojë faktet.
- c)** Biseda duhet të zhvillohet sa më parë, sidomos nëse është fjala për fëmijën më të ri dhe për të miturin. Parimi kriminalistik i operativitetit dhe të shpejtësisë në rast të fëmijëve dhe të të miturve është mjaft i rëndësishëm, sepse kujtesa e tyre dobësohet shpejt ose bllokohen nëse janë të ngjyrosura me afekte, dhe për shkak të veprimit sugjestiv të të rriturve, të farefisit dhe të moshatarëve.
- d)** Para vetë bisedës, duhet të zhvillohet biseda hyrëse me qëndrim të sigurtë me qëllim të krijimit të besimit që e lehtëson kontaktin.
- e)** Të mos lejohet që fëmija ose i mituri të ndjejë se ai është personaliteti kryesor në ngjarje dhe në veprim, sepse pastaj është vështirë të frenohen dhe të kontrollohen thëniet dhe sjelljet e tij.
- f)** Deklaratat kategorike dhe pohimet që nuk i përgjigjen gjendjes faktike nuk duhet të kundërshtohen menjëherë me sulmin ndaj personalitetit të tij, sepse kjo mund të shtojë kryeneçësinë dhe kokëfortësinë e tij. Thëniet e tilla duhet të kundërshtohen gradualisht me anë të rezonimit të argumentuar dhe logjik.
- g)** Të përdoren fjalët dhe gjuha me të cilën flet fëmija dhe e cila për te është e qartë dhe e kuptueshme.
- h)** Gjatë bisedës, fëmija dhe i mituri duhet të nxiten, të lavdërohet gatishmëria dhe përpjekja e tij që të ndihmojë, të lavdërohen dhe të theksohen veçoritë, inteligjencia, sinqeriteti dhe trimëria e tij, etj.⁵⁵⁴

⁵⁵⁴ Mujo Hasković, Psikologjia, Sarajevë-Prishtinë FSK/5-2006, faqe 32-33



Shabi Idrizi

PROCEDURA E SHKURORËZIMIT

I. Hyrje

Martesa është institucion i rëndësishëm i së drejtës familjare, dhe paraqet marrëdhënie të jetës së përbashkët e të vazhdueshme midis një burri dhe një gruaje, ndërkaq në disa shtete edhe marrëdhënie midis dy personave me gjini të njëjtë (në shtete të cilët kanë të legalizuar martesën midis personave me gjini të njëjtë). Të gjitha legjislacionet nacionale japin definicionin e institucionit të martesës - Martesa është bashkësi e regjistruar ligjërisht në mes të dy personave të sekseve të ndryshme, me anë të së cilës lirshëm vendosin që të jetojnë së bashku me qëllim të krijimit të familjes. Mashkulli dhe femra kanë të drejtë të lidhin martesë dhe të formojnë familje pa ndonjë kufizim në bazë të racës, kombësisë apo religjionit, si dhe janë të barabartë gjatë lidhjes së martesës, vazhdimit të martesës dhe zgjidhjes së saj.

Marrëdhëniet në mes bashkëshortëve themelohen në vendim të lirë të burrit dhe gruas për të lidhur martesë, në barazinë ndërmjet tyre, respektim të ndërsjellët dhe ndihmës reciproke. Barazia e bashkëshortëve si në rastin e lidhjes së martesës, gjatë martesës si dhe në rast shkurorëzimi garantohet edhe me dokumentin më të rëndësishëm ndërkombëtarë-Deklaratën Universale të të drejtave të njeriut (neni 16.al.1). Siç e cekta edhe më lart, martesa është marrëdhënie e vazhdueshme por jo e përhershme sepse e njëjta mund edhe të zgjidhet me vdekjen e njërit nga bashkëshortët, me shpalljen e njërit nga bashkëshortët e zhdukur për të vdekur, me anulimin e martesës dhe me shkurorëzimin e saj. Në këtë punim do të bazohem vetëm në ndarjen e martesës me anë të institucionit të shkurorëzimit, duke u fokusuar në procedurën e parapare në LFK për shkurorëzim dhe të një krahasimi të formave të aktgjyqimit i cili praktikohet tek në Kosovë me ato të cilat praktikohen në Republikën Federale të Gjermanisë.

Procedura e shkurorëzimit

Shkurorëzimi është institucion i të drejtës familjare i cili mundëson zgjidhjen e martesës së plotfuqishme. Shkaqet janë nga më të ndryshmet, duke filluar nga shkurorëzimet që bëhen me marrëveshje të bashkëshortëve, shkurorëzimet fiktive, si dhe shkurorëzimet si alternativë e vetme e shërimit të marrëdhënieve të çrregulluara bashkëshortore.

Mirëpo, duke u bazuar në dispozitat e LFK para se të hyhet procedurës së shkurorëzimit, gjykata dhe çdo person tjetër i interesuar për prishjen e martesës duhet të ketë parasysh parimet themelore të përgjithshme si në vijim:

- institucioni i martesës duhet të ruhet
- bashkëshortët në martesë e cila është shkëputur duhet të inkujarohen të marrin të gjitha hapat e zbatueshëm, përmes këshillimit për martesë, procedurave të pajtimit të parapara në këtë ligj, ose tjera për ta ruajtur martesën
- martesë e cila në mënyrë të pakthyeshme është shkëputur duhet të shuhet:
 - a. me një minimum shqetësimi për palët dhe fëmijët e prekur,
 - b. të zgjidhet në atë mënyrë që të promovoj sa më mirë marrëdhënie të vazhdueshme mes palëve dhe fëmijëve të prekur si është e mundur nga rrethanat dhe
 - c. pa shpenzime të paarsyeshëm të përfshira në lidhje me procedurat që duhet ndjekur në sjelljen e martesës në një përfundim dhe
- se çdo rrezik për të keqe ose dhunë ndaj bashkëshortëve dhe fëmijëve duhet të shmanget (neni 59 i LFK).

2. Shkurorëzimi

Mbi të gjitha parakushtet tjera, martesë duhet të bazohet në dashurinë, respektin, barazinë dhe ndihmën reciproke, mirëpo në rast të disekuilibrit dhe mosrespektimit të këtyre parimeve jeta bashkëshortore mund të bëhet e padurueshme për vazhdimin e suksesshëm të saj. Pra, shkurorëzimi është pasojë e mosmarrëveshjeve dhe grindjeve permanente midis partnerëve. Shkurorëzimi është institucion i lashtë, dukuri përbërëse dhe e pandashme e

martesës. "Volteri thoshte se shkurorëzimi lind disa javë pas martesës. Do të thotë, atëherë kur lind martesë, lind edhe shkurorëzimi.

Si institucion i së drejtës familjare dhe pjesë e marrëdhënieve të jo-qëndrueshme martesore, shkurorëzimi daton që nga e drejta romake, mirëpo, të dhënat statistikore japin një pasqyrë të rritjes së numrit të shkurorëzimeve gjatë kësaj periudhe të tranzicionit dhe mvetësimit ekonomik të partnerëve. Në rastet kur jeta e përbashkët tani më nuk është alternativa e vetme për të vazhduar më tej, shumica e bashkëshortëve përgatiten ti përballen sfidës së jetesës në mënyrë të pavarur dhe të ndarë. E gjitha kjo është pasojë e problemeve të papërballueshme të cilat i përkasin martesës së tyre, duke pasur të drejtën e vendimmarrjes së përbashkët se a do ti japin asaj fund me anë të institucionit të shkurorëzimit. Martesa mundet të zgjidhet vetëm me vendim të gjykatës

Njëri apo të dy bashkëshortët me marrëveshje të dyanshme mundet të kërkojnë shkurorëzim duke parashtruar padi në gjykatën kompetente. E drejta për ngritjen e padisë për shkurorëzim nuk mund të kalohet te trashëgimtarët, por trashëgimtarët e paditësit mundet të vazhdojnë procedurën e filluar për të verifikuar bazën e padisë. Nëse njëri nga bashkëshortët paraqet padi për shkurorëzim, kurse bashkëshorti tjetër me së voni deri në deri në përfundimin e seancës kryesore gjyqësore, deklaron shprehimisht se nuk e kundërshton bazushmerinë e kërkesëpadisë, do të konsiderohet se bashkëshortët kanë paraqitur propozim të përbashkët për shkurorëzim me marrëveshje (neni 68 I LFK).

Në rastet e marrëveshjes së përbashkët të bashkëshortëve gjykata e cila zhvillon procedurën e shkurorëzimit e ka shumë më lehtë të sjell vendimin për ndarjen e tyre. Mjet juridik për iniciimin e procedurës së shkurorëzimit përveç marrëveshjes (propozimit) së përbashkët të bashkëshortëve është edhe kërkesa e njërit bashkëshort pra me anë të padisë së ngritur nga ana e njërit bashkëshort. Bashkëshorti mund të kërkojë shkurorëzim kur marrëdhëniet martesore janë çrregulluar seriozisht ose në mënyrë të vazhdueshme, ose kur për shkaqe të tjera është zgjidhur në mënyrë të pathyeshme. Shkaqet e shkurorëzimit janë mes tjerash: jeta e padurueshme e bashkëshortëve, shkelja e besnikërisë bashkëshortore, veprat penale kundër jetës së bashkëshortit, keqtrajtimi serioz, lenia qëllimkeqe dhe e paarsyeshme, sëmundja psikike e pashërueshme dhe paaftësia e vazhduar për të vepruar, ndërprerja e paarsyeshme e jetës faktike për më shumë se një vit dhe shkurorëzimi me marrëveshje të dyanshme. Bashkëshortët nuk do të parashtrjnë padi për shkurorëzim gjatë shtatzënisë së gruas dhe derisa

fëmija i tyre i përbashkët ti ketë mbushur një vit .Se bashku me propozimin për shkurorëzim me marrëveshje të dyanshme, bashkëshortët janë të detyruar të parashtrijnë marrëveshjen me shkrim për përkujdesje, edukim dhe ushqim të fëmijëve të tyre të përbashkët si dhe propozimin me shkrim mbi atë se si kontaktet personale mes fëmijës dhe të dy prindërve do të garantohen në të ardhmen. Leja për shkurorëzim mund të mos jepet ose mund të shtyhet edhe pse martesë ka dështuar vetëm në raste të veçanta nëse dhe përderisa ruajtja e martesës bëhet për arsye specifike, të domosdoshme për interesin e fëmijës.

Gjatë procedurave të kontesteve martesore, gjykata me vendim duke u bazuar në padi, mund të caktojë masa të përkohshme për sigurimin e mbajtjes financiare për bashkëshortin dhe vendosjen e tij. Në kontestet martesore kompetencën territoriale përveç gjykatës me kompetence të përgjithshme territoriale e ka edhe gjykata në territorin e të cilës bashkëshortët kanë pasur vendbanimin e fundit të përbashkët. Procedurën në kontestet martesore në shkallen e parë e zhvillon dhe i merr vendimet kolegji i përberë prej një gjyqtari dhe dy gjyqtarëve porote, kurse në shkallen e dytë kolegji prej tre gjyqtarëve. Kujdestari mund të parashtrijë padi për shkurorëzim në emër të bashkëshortit i cili vuan nga sëmundjet psikike të diagnostifikuara, ose në emër të personit të paaftë për të vepruar vetëm me pëlqimin e mëparshëm të Organit të Kujdestarisë. Publiku përjashtohet nga procedurat e kontestit martesor.

Aktgjykimi për shkurorëzim duhet të merret pas një periudhe të përpjekjeve për pajtim të zhvilluar nga gjykata në seanca të veçanta përveç kur:

1. një nga bashkëshortët është i paaftë për të vepruar,
2. kur një apo të dy bashkëshortët jetojnë jashtë vendit,
3. kur nuk dihet vendbanimi i njërit nga bashkëshortët.

Periudha e pajtimit do t'u mundësojë bashkëshortëve një periudhe për të shqyrtuar dhe vlerësuar vendimin e tyre duke marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe pasojat. Në kontestin e shkurorëzimit gjykata është e detyruar të tentojë të arrijë pajtimin formal. Aktgjykimi për shkurorëzim u dërgohet palëve vetëm pas përfundimit të procedurës dhe vetëm nëse pajtimi nuk ka pasur sukses. Kur gjykata udhëheq procedurën e pajtimit të bashkëshortëve, ajo do të caktojë seancë të veçantë në përpjekje për të arritur pajtimin përderisa konstaton se gjasat për arritjen e pajtimit akoma ekzistojnë. Në seancën për përpjekjen që të arrihet pajtimi ftohen të dy bashkëshortët për të

marrë pjesë personalisht. Nëse njëri ose të dy bashkëshortët edhe pse janë ftuar në mënyrë të rregullt, mungojnë nga seanca për përpjekjen që të arrihet pajtimi, dhe asnjëri prej tyre nuk e arsyetojnë mungesën, gjykata do të çmojë se a do të caktoj seancën e re për përpjekjen e arritjes së pajtimit ose do të konsideroj se pajtimi ka dështuar.

Kur njëri ose të dy bashkëshortët të cilët me propozimin e përbashkët kanë filluar procedurën për shkurorëzim me marrëveshje nuk paraqiten në seancën për përpjekjen që të arrihet pajtimi, dhe mungesa e tyre nuk arsyetohet, do të konsiderohet se kanë hequr propozimin. Nëse bashkëshortët kanë një apo më shumë fëmijë të përbashkët të mitur, procedura e pajtimit zhvillohet para Organit të Kujdestarisë duke zbatuar metodat e punës sociale, metoda tjera profesionale dhe duke shfrytëzuar shërbimet e këshillimores për martesë dhe familje si dhe institucioneve tjera profesionale.

Procedurat duhet të mbështeten nga parimet e vullnetit të mirë dhe bashkëveprimit. Në raste tjera, procedurën e pajtimit të bashkëshortëve e zbaton gjykata nëse kryetari i kolegjit gjyqësor nuk e çmon se do të ishte e arsyeshme që procedura e pajtimit ti kalojë Organit të Kujdestarisë. Në shkresën me të cilën procedura e pajtimit i kalon Organit të Kujdestarisë do të shënohen dhe adresat e bashkëshortëve, data e fillimit të procedurës për shkurorëzim si dhe shkaqet kryesore për të cilat kërkohet shkurorëzimi. Nëse në martesë ka fëmijë të mitur do të shënohen edhe të dhënat për fëmijët. Për procedurën e pajtimit, përveç Organit të Kujdestarisë në territorin e të cilit ndodhet vendbanimi ose vendqëndrimi i të paditurit, është kompetent edhe Organi i Kujdestarisë në territorin e të cilit bashkëshortët kanë pasur vendbanimin e fundit të përbashkët. Kur procedura fillon me propozimin për shkurorëzim me marrëveshje të dyanshme, kompetent për procedurën e pajtimit të bashkëshortëve është Organi i Kujdestarisë në territorin e të cilit bashkëshortët kanë pasur vendbanimin e fundit të përbashkët.

Në procedurën e pajtimit, Organi i Kujdestarisë konstaton se çfarë kushte për jetë dhe zhvillim ndodhen fëmijët e përbashkët të bashkëshortëve dhe ndërmerr të gjitha masat e nevojshme që të sigurojë edukimin, sigurinë dhe mbajtjen financiare, duke u përpjekur që të arrij marrëveshje ndërmjet bashkëshortëve në mënyrë që të mbrojnë interesat e fëmijëve. Procedura e pajtimit pranë Organit të Kujdestarisë nuk mund të zgjasë më shumë se tre muaj, por mund të vazhdohet, nëse bashkëshortët pajtohen që të vazhdojnë një procedurë të këtillë pas përfundimit të këtij afati.

Organi i Kujdestarisë është i detyruar pa vonese të dërgojë në gjykatë raportin me shkrim lidhur me rezultatin e procedurës së pajtimit. Kur procedura ka filluar me propozimin e bashkëshortëve për shkurorëzim me ane të marrëveshjes së dyanshme, faktet në të cilat është mbështetur propozimi nuk hetohen më, sidoqoftë gjykata mund të vendose që të zhvillohet procedura e provave, sikurse sipas padisë për shkurorëzim, nëse në procedurën e pajtimit çmon se për arsye fundamenale fëmijët e përbashkët të mitur kërkojnë që të ruhet martesë. Nëse bashkëshortët kanë fëmijë të përbashkët gjykata mund t'i hetoj faktet dhe ta zbatojë procedurën e provave rreth pjesës së propozimit të bashkëshortëve që ka të bëjë me ruajtjen, edukimin dhe mbajtjen financiare të fëmijëve, nëse bindet se propozimi i prindërve lidhur me këto çështje nuk ofron garanci të nevojshme se interesat e fëmijëve të tyre të mitur ose të paafët me këtë marrëveshje do të mbrohen në masë të duhur. Faktet në të cilat pala e mbështet kërkesën e vet në kontestet martesore gjykata mund të konsideroj si të kontestueshme edhe atëherë kur ato fakte janë të pa kontestueshme ndërmjet palëve.

Në kontestet martesore nuk mund të nxirret aktgjykimi për shkak të mungesës ose të aktgjykimit në bazë të pranimit. Në kontestet për shkurorëzim paditësi mund të tërheqë padinë deri në përfundimin e seancës kryesore gjyqësore pa pajtimin e të paditurit, kurse me pajtimin e të paditurit derisa procedura nuk ka përfunduar në formë të prerë. Propozimin e përbashkët për shkurorëzim me marrëveshje bashkëshortët mund ta tërheqin derisa aktgjykimi mbi shkurorëzimin të marrë formën e prerë. Do të konsiderohet se është tërhequr propozimi edhe kur nga propozimi heq dorë njëri bashkëshort. Aktgjykimi me të cilin zgjidhet martesë sipas propozimit të përbashkët të bashkëshortëve për shkurorëzim me marrëveshje të përbashkët mund të goditet vetëm për shkak:

1. Të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore ose
2. Për arsye se propozimi është dhënë në lajthim ose nën ndikimin e shtrëngimit, ose të mashtrimit.

Nëse martesë është zgjidhur ose është anuluar me aktgjykimin e formës së prerë, vendimi për shkurorëzimin, përkatësisht për anulimin e martesës nuk mund të goditet me mjete të jashtëzakonshme juridike.

4. Pasoja Juridike të Shkurorëzimit tek Bashkëshortët dhe Fëmijët

Bashkëshortët janë ata të cilët duhet të mbartin pasoja të përfundimit të martesës së tyre me anë të shkurorëzimit, duke mos lejuar që ata të njëjtat të reflektohen tek fëmijët. Mirëpo, juridikisht një gjë e tillë nuk është e mundur. Fëmijët ndikohen nga kjo ndarje, nga vetë fakti që ata janë të detyruar të jetojnë me njërin prind. Kur bashkëshortët kanë fëmijë të përbashkët, atëherë personeli profesional i Qendrës për punë sociale udhëheq procedurën për pajtimin e bashkëshortëve. Nëse seanca për pajtimin e bashkëshortëve është e pasuksesshme atëherë ekipi profesional i Qendrës për punë sociale jep mendimin dhe propozimin për ruajtjen, edukimin e fëmijëve, dhe bazuar në faktet dhe të dhënat profesionale, gjykata në seancën kryesore vendos edhe për edukimin, ushqimin dhe ruajtjen e fëmijëve. Bashkëshortët mundet që me marrëveshje të përbashkët të zgjidhin çështjen e ndarjes së fëmijëve. Nëse nuk ekziston marrëveshja midis tyre lidhur me përkujdesjen e fëmijëve atëherë, gjykata ex officio sjell vendimin për ruajtjen, edukimin dhe ushqimin e fëmijëve.

Viteve të fundit është dukuri prezente veçanërisht, problematika e prindërve që jetojnë në shtetet e Evropës Perëndimore se nëse i është besuar ruajtja edukimi i fëmijëve prej tyre kërkohet vendimi gjyqësor mbi ushtrimin e së drejtës prindërore vetëm nga njëri prind (në gjuhën gjermane njihet si Sorgerecht), kurse te ne nënkupton heqjen e drejtës prindërore për njërin prind, kurse në gjykatat tona rrallë aplikohet, edhe pse duke u bazuar në LFK, konkretisht nenin 143 paragraf 3 është paraparë që prindit të cilit i besohet ruajtja dhe edukimi i fëmijës i njëjti e ushtron të drejtën prindërore, dhe se aplikimi i kësaj dispozite kur kërkohet nga palët do të kursente ata nga shpenzimet e panevojshme që në procedurë jokontestimore të bëjnë kërkesë për heqjen e drejtës prindërore e cila merr edhe kohë por edhe shpenzime të panevojshme për palët dhe se mundet të zgjidhet gjatë procedurës së shkurorëzimit me aplikimin e kësaj dispozite, në anën tjetër do i lironte gjykatat tona të merren me çështjen e njëjtë, pra edhe nga numri i lëndëve.

Edhe pse fëmijëve i ndahen njërit prind, me anë të shkurorëzimit nuk mund të ndërpritet marrëdhënia prindërore, ajo marrëdhënie familjare midis fëmijëve dhe prindërve ekziston edhe pas ndarjes. Çiftet të cilët kanë fëmijë dhe të cilët kanë vendosur të jetojnë të ndarë, duhet të vazhdojnë të sjellin vendime të përbashkëta sa i përket mirërritjes dhe edukatës familjare të fëmijës. Shkurorëzimi në të shumtën e rasteve nuk ndikon negativisht tek fëmijët që jetojnë ndaras nga njëri prind, në krahasim me mosmarrëveshjen

dhe grindjet e vazhdueshme që mund të kenë çiftet. Edhe pse të ndarë nga fëmijët, çiftet vazhdojnë të jenë prindërit e tyre përkundër moskoordinimeve që kanë ndërmjet vete për çështje tjera jetësore, mirëpo, në çdo vendimmarrje të tyre në prioritet duhet të kenë interesin më lartë të fëmijëve.

Pasojat personale të shkurorëzimit duhet të ndikojnë drejtpërdrejtë tek ish-bashkëshortët, e assesi tek fëmijët, sepse ata nuk janë aspak fajtorë për situatën jetësore që ua krijojnë prindërit. Edhe pse shkurorëzimi është alternativa më e dhimbshme për fëmijët, mirëpo në situata të veçanta paraqet zgjedhje të vetme në një martesë ku mbisundon grindja e jo marrëveshja, dashuria dhe respekti. Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve e fituar gjatë martesës, nuk ndahet në procedurën e shkurorëzimit, por zhvillohet procedurë e veçantë, kontestimore - nëse ekziston mosmarrëveshja (kontesti) për ndarjen e saj, dhe jokontestimore - nëse bashkëshortët janë marrë vesh si do ta ndajnë atë pasuri të fituar bashkërisht.

5. Përfundimi

Në fund duhet theksuar rëndësia e institucionit të shkurorëzimit, shikuar në prizmin e shërimit të problemeve familjare. Edhe pse nuk pajtohem që familja e themeluar të ndahet pa arsye të forta dhe të bazuara, e veçanërisht nëse në atë familje ka fëmijë, jam ithtarë i mendimit që nuk duhen duruar veprime të cilat sjellin cenimin e një jete të shëndoshë familjare. Edhe pse fëmijët në fillim mund të zhgënjehen nga prindërit e tyre dhe të humbin shpresat për një jetë të lumtur familjare, kur vetëdijesohen ata mund të arsyetojnë veprimin e tyre. Mirëpo, interesi i fëmijëve duhet të jetë një prioritet përkundër interesit personal të ish-bashkëshortëve. Pra, duke pasur parasysh faktin se në vendin tonë janë duke ndodhur shkurorëzime të shumta dhe të gjithë ne e dimë që shkurorëzimet sjellin shumë vështirësi në jetën shoqërore për familjen dhe fëmijët e tyre, gjë që i shpien deri te amoraliteti i shoqërisë duke u marr me veprime antiligjore dhe antishoqërore, duhet të marrim masa dhe strategji të ndryshme për parandalimin e shkurorëzimeve.



Teuta Ibrahim



Valbona Selimaj



Rrustem Begolli

ETIKA GJYQËSORE DHE PROKURORIALE, RËNDËSIA E TË QENURIT I DREJTË, I PAANSHËM DHE I PAVARUR

ZYRA E PROKURORIT DISIPLINOR DHE QËLLIMI I FUNKSIONIMIT TË MIRË TË SISITEMIT TË DREJTËSISË

1. Etika Gjyqësore dhe Prokuroriale, rëndësia e të Qenurit i/e Drejtë, i/e Paanshëm/e dhe i/e Pavarur

Gjyqtarët dhe Prokurorët duhet t'i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të drejtë dhe të paanshme. Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale të Gjyqtarëve dhe Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale të Prokurorëve janë hartuar për të ngritur integritetin në sistemin e drejtësisë. Kodet janë të hartuara që të parandalojnë keqpërdorime faktike të pushtetit dhe gjithashtu të parandalojnë paraqitjen e konflikteve të interesave dhe paraqitjen e sjelljes jokorrekte.

Etika gjyqësore e prokuroriale është kusht që gjyqësori dhe sistemi i prokurorisë të gëzojnë atë shkallë pavarësie funksionale, shumë të domosdoshme për funksionin e mirëfilltë të shtetit dhe së drejtës. Regjimi i rregullave të Etikës në një vend dhe kohë të caktuar, nuk është gjë tjetër veç se, një zgjidhje, që shoqëria përkatëse i ka dhënë çështjes së raportit mes legalitetit dhe moralitetit. Puna e gjyqtarit dhe prokurorit duhet gjithnjë të karakterizohet nga disa parime kyçe, siç janë: Pavarësia dhe paanshmëria – parime këto kryesore të funksionimit normal dhe efikas të së drejtës. Çështja e etikës gjyqësore e prokuroriale është një çështje me rëndësi kushtetuese e ligjore, e sidomos një çështje shumë madhore për sistemin e drejtësisë. Pavarësia dhe paanshmëria është çështje jetike në sistemin e drejtësisë, dhe për shoqërinë si tërësi.

Duke u mbështetur në atë që u cek më lartë edhe Statuti për gjyqtarët⁵⁵⁵ synon që të sigurojë kompetencën, pavarësinë dhe paanësinë që çdo individ pret në mënyrë legjitime nga gjykatat dhe nga secili gjyqtar të cilëve u besohet mbrojtja e të drejtave të individit. Ai përjashton çdo dispozitë dhe çdo procedurë të një natyre që do të dëmtonte besimin në këtë kompetencë, këtë pavarësi dhe këtë paanësi. Kjo kartë përmban dispozitat që mundësojnë më së miri garantimin e arritjeve të atyre objektivave.

I. Zbatimi i drejtë i ligjit – gjykimi i drejtë dhe publik

Gjyqtari ka detyrë dhe obligim respektimin e ligjit gjithnjë me detyrim që ti përmbahet ligjit. Përgjegjësia e gjyqtarit është të vendos në bazë të fakteve dhe ligjit. Gjyqtari luan rol aktiv në shqyrtimin e rasteve para tij, duke shtjelluar të gjitha provat dhe faktet që do të kontribuonin në vendimmarrjen e drejtë dhe meritore të çështjes. Gjyqtari ka detyrë që gjatë ushtrimit të përgjegjësisë të tij/saj gjyqësore të sigurohet se lëndët trajtohen me drejtësi dhe efikasitet. Kjo nënkupton në veçanti detyrën për t'u siguruar se të gjitha palët i nënshtrohen dëgjimit të drejtë dhe se të drejtat procedurale të palëve respektohen gjatë procedurës si dhe të shmangin çdo zvarritje⁵⁵⁶ dhe çdo formë të mosparaqitjes apo mospërfilljes në punë.

Gjykatat janë të vetmet institucione në gjendje të zgjidhin konfliktet e përhershme private apo publike.⁵⁵⁷ Gjykatat përforcojnë autoritetin shtetëror si dhe mbrojnë individin nga përdorimi arbitrar i pushtetit shtetëror. Gjykatat ekzistojnë, për të dhënë drejtësinë për të garantuar lirinë, për të përforcuar rendin social, për të ruajtur sundimin e ligjit, për të krijuar kushte për mbrojtje të barabartë, dhe për të bërë proces të drejtë sipas ligjit. Pra, sundimi i ligjit, mbrojtja e barabartë dhe procesi i drejtë gjyqësor dhe i paanshëm, janë vlera të vërteta të një gjykate të pavarur dhe të paanshme të themeluar me ligj. Pra, sundimi i ligjit, mbrojtja e barabartë dhe procesi i drejtë gjyqësor dhe i paanshëm janë vlera të vërteta të një gjykate të pavarur dhe të paanshme të themeluar me ligj.

⁵⁵⁵ Karta evropiane mbi statutin për gjyqtarët

⁵⁵⁶ Kodi i etikës dhe sjelljes profesionale për gjyqtarë Nr. 2006/8 III. Rregullat specifike të sjelljes profesionale nën A. Kodi i Procedurës Penale – neni 5, Ligji mbi procedurën kontestimore – neni 10

⁵⁵⁷ Moduli Etika Gjyqësore përgatitur nga Jetish Maloku, kryeprokuror në PPQ Gjilan dhe Gent Ibrahim, drejtor i Institutit për studime publike dhe ligjore në Tiranë

II. Besueshmëria në sistemin gjyqësor/prokuroria

Jeta personale dhe profesionale e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve duhet të krijojë besueshmëri në sistemin e drejtësisë. Për sa i takon integritetit, sjellja gjyqtarëve dhe prokurorëve duhet të jetë konsistente, në përputhje me karakterin moral të lartë që është një kriter për detyrën e gjyqësorit dhe prokurorisë. Gjyqtarët dhe prokurorët duhet të jenë të ndërgjegjshëm në çdo kohë për detyrën e tyre, për të mbajtur lart qëndrimin dhe reputacionin e gjykatës dhe prokurorisë. Drejtësia dhe paraqitja e të qenurit i drejtë në sistemin e drejtësisë janë me rëndësi për besueshmërinë e publikut.

Gjyqtari vepron në çdo kohë në atë mënyrë që nxit besimin e publikut për dinjitetin, integritetin dhe pavarësinë e pushtetit gjyqësor⁵⁵⁸. Kjo zbatohet jo vetëm në jetën profesionale të gjyqtarëve, por edhe në jetën e tyre private⁵⁵⁹, kur veprimet e një gjyqtari mund të dëmtojnë imazhin e drejtësisë në sytë e publikut, gjë që do të ndikonte në imazhin e gjyqësorit në tërësi⁵⁶⁰.

Prokurori gjatë gjithë kohës vepron në çdo kohë në atë mënyrë që nxit besimin e publikut për dinjitetin, integritetin efektivitetin dhe paanshmërinë e prokurorëve⁵⁶¹. Kjo vlen jo vetëm në jetën profesionale të prokurorëve, por edhe në jetën e tyre private, kur veprimet e një prokurori mund të dëmtojnë imazhin e prokurorit në sytë e publikut, duke ndikuar kështu në të gjithë institucionin e shërbimit prokurorial⁵⁶².

III. Pavarësia

Fjala pavarësi do të thotë liri, autonomi dhe paprekshmëri ndaj urdhrave të jashtme, ndikimi ose kontrolli. Në kontekst të kësaj kur merret vendimi nëse një gjykatë është e pavarur, Gjykata Evropiane merr në konsideratë⁵⁶³:

- a. mënyrën e emërimit të gjyqtarëve;
- b. kohëzgjatjen e detyrës së tyre;

⁵⁵⁸ Kodi i Etikës dhe sjelljes profesionale për gjyqtar Nr. 2006/8, I. Parimet e përgjithshme nën 1.

⁵⁵⁹ Gjykatësit mund të kenë jetën e tyre private, por, ato aktivitete nuk duhet të dëmtojnë besimin e popullit në gjyqësorin.

⁵⁶⁰ Kodi i etikës dhe sjelljes profesionale për gjyqtar Nr. 2006/8, I. Parimet e përgjithshme nën 3.

⁵⁶¹ Kodi i etikës dhe sjelljes profesionale për prokuror Nr. 2006/8, I. Parimet e përgjithshme nën 1.

⁵⁶² Kodi i etikës dhe sjelljes profesionale për prokuror Nr. 2006/8, I. Parimet e përgjithshme.

⁵⁶³ pavarësia institucionale dhe pavarësia funksionale. Pavarësia në kuptimin institucional, nënkupton procedurën e emërimit dhe zgjedhjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve, në përputhje me garancat dhe standardet e gjyqësisë së pavarur. Pavarësia në kuptimin funksional, nënkupton lirin nga ndërhyrja në procedurat gjyqësore nga ana e autoritetit ekzekutiv dhe legjislativ gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

- c. ekzistencën e garancive kundrejt presioneve të jashtme dhe çështjen nëse organi përfaqëson një dukje të pavarësisë objektive;

Gjyqtarët në punën e tyre është i pavarur dhe vendos në bazë të ligjit. Gjyqtarët marrin vendim në bazë të provave që shqyrtohen dhe verifikohen në shqyrtimin gjyqësor⁵⁶⁴. Në ushtrimin e detyrave të tyre, gjyqtarët duhet që të jenë të pavarur nga të gjitha ndikimet apo autoritete jashtë sistemit. Ata nuk duhet që të jenë pjesë e asnjë aktiviteti apo organizate, pozicion që mund të dëmtojë apo ndikojë në pavarësinë e tyre⁵⁶⁵. Fjala “pavarësi” është e ngjashme me fjalën “i lirë” POR pavarësia në gjyqësi NUK nënkupton lirinë për të neglizhuar detyrat apo lirinë për të qenë i ngathët nga pikëpamja intelektuale, as lirinë për të qenë i njëanshëm për njërën palë apo palën tjetër. Pavarësi është një koncept me rëndësi të madhe që do të udhëheqë gjyqësorin në përgjithësi dhe gjyqtarët individual në veçanti. Pavarësia është një detyrim për gjyqtarin në raport me shoqërinë. Respektimi i këtij detyrimi nga ana e gjyqtarit bënë të mundur që ai të vendosë për çështjet në gjykim në mënyrë të ndershme dhe të paanshme, bazuar në ligj dhe fakte pa kurrfarë influence (frike) nga jashtë.

E vetmja formë e ligjshme e ndikimit mbi një trup gjyqësor është ajo që ndodh në sallën e gjykimit në mënyrë publike, nga palët në proces, dhe përfaqësuesit e tyre ligjor. Pavarësisht nga kush vjen ndikimi – një ministër, një politikan, një zyrtar i lartë, një gazetar, ose një anëtar i familjes, në çdo rast ky ndikim duhet të injorohet nga gjyqtari, i cili duhet të bëjë të mundur që vendimet e tija të jenë plotësisht të pandikuara nga marrëdhëniet e tija familjare, shoqërore ose politike.

III. 1. Elementet e pavarësisë gjyqësore

Elementet themelore të pavarësisë gjyqësore janë⁵⁶⁶:

- vendimet gjyqësore janë të pavarura;
- vendimet gjyqësore nuk mund të rikontrollohen përveç procedurave të apelit nga një instancë me e lartë e gjykatës e parashikuar me ligj.

Autoriteti: sistemi gjyqësor /gjyqtarët duhet të kenë pavarësi të plotë për sa i përket punës të tyre, për të vendosur për kompetencat e tyre siç janë të

⁵⁶⁴ Kodi i Procedurës Penale neni 8

⁵⁶⁶ Gjyqtari ndërkombëtar John N. Fields (Trial Court Judge, Retired Michigan, USA)

parashikuara me ligj, ata duhet të jenë të lirë të marrin vendime të pavarura sipas kërkesave të parashikuar me ligj, pa shtrëngime, nga çfarëdo influence, presione, kërcënime ose ndërhyrje (direkte apo indirekte), nga jashtë për çfarëdo lloj arsyeje.

III. 1. Mënyra e emërimit të gjyqtarëve - kohëzgjatja e detyrës së tyre

Autonomi financiar:

- Gjykatat duhet të jenë financiarisht të pavarura.
- Ndarja e pushteteve: promovimi dhe respektimi i parimeve të ndarjes së pushteteve ne 1. Gjyqësor 2. Ekzekutiv 3. Legjislativ.⁵⁶⁷
- Kjo ndarje ndihmon të sigurohet se ligji zbatohet në mënyrë të paanshme dhe të qëndrueshme, pa marrë parasysh kush është në pushtet, dhe pa ndonjë ndikim të paligjshëm nga ndonjë burim tjetër.

Përkufizime të qarta të rolit të ndarë të gjyqësisë, prokurorisë dhe funksioneve mbrojtëse (avokaturës) në mënyrë që secili të funksionoj pavarësisht në kryerjen e përgjegjësisë të tyre.

IV. Paanshmëria dhe sjellja

Paanshmëria është cilësia themelore që duhet ta karakterizoj punën e një gjyqtari apo prokurori⁵⁶⁸. Lidhur me paanshmërinë⁵⁶⁹, gjyqtarët dhe prokurorët duhet të ushtrojnë funksionet e tyre me paanshmëri të plotë si dhe të garantojnë dukjen e paanshmërisë. Perceptimi se një gjyqtar apo prokuror nuk është i paanshëm, mund të lind si një rezultat i një sërë faktorësh si dyshimi i arsyeshëm për një konflikt interesi, mënyra e sjelljes së një gjyqtari apo prokurori, veprimtaria jashtë gjyqësore e gjyqtarit apo prokurorit etj.

Nga kjo rrjedh se: nëse gjyqtari është i njëanshëm – paraqet dyshim për objektivitetin e gjykatës dhe kërcënohet drejtësia thelbësore dhe të drejtat e barabarta. Nëse prokurori është i njëanshëm – paraqitet dyshimi për motivin, vlerën dhe drejtësinë e ndjekjes penale. E zvogëlon besimin mbi sistemin e drejtësisë. Përfshinë komunikimin verbal dhe jo verbal

⁵⁶⁷ Rasti i Terry Schiavos

⁵⁶⁸ Parimet themelore të KB për pavarësinë e Gjyqësorit. Më tepër për paanshmërinë: Vendosni pa ndërhyrje, pa ndonjë ndikim, pa trysni, pa kufizime, pa kërcënime drejtpërdrejt apo tërthorazi, nga kush do qoftë, për çfarëdo arsye.

⁵⁶⁹ Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut të Këshillit të Evropës, ka miratuar rezolutën me 10 parime bazë, për Etikën Gjyqësore, mbi të cilat duhet të bazohet sjellja e gjyqtarit, ndër të cilat theksohet parimi i paanshmërisë së gjyqtarëve dhe të integritetit të tyre moral.

Gjatë ushtrimit të detyrave gjyqësore, gjyqtari ka për detyrë që të sigurojë që ligji, duke përfshirë këtu edhe standardet e njohura ndërkombëtare, zbatohen në mënyrë të duhur dhe rastet të trajtohen me drejtësi duke iu shmangur qëndrimit diskriminues kundër çdo personi apo personave mbi çfarëdo baze, duke përfshirë gjininë, moshën, statusin martesore, gjuhën, paaftësisë mendore apo fizike, orientimin seksual, përkatësisë apo bindjen politike, prejardhjen etnike, kombësinë, besimin ose fenë, racën, prejardhjen shoqërore, statusin pronësor, të lindjes apo çdo status tjetër. Gjyqtari duhet të njohë vlerat e ndryshme kulturore për të kuptuar më mirë problemet shoqërore dhe personale të njerëzve me të cilët ai/ajo ndërvepron gjatë kryerjes së funksionit gjyqësor⁵⁷⁰.

Prokurorët do të shmangen nga diskriminimi mbi çfarëdo baze duke shmangur çdo sjellje diskriminuese ndaj çdo personi apo personave mbi çfarëdo baze, duke përfshirë gjininë, moshën, statusin martesore, gjuhën, paaftësisë mendore apo fizike, orientimin seksual, përkatësisë apo bindjen politike, prejardhjen etnike, kombësinë, besimin ose fenë, racën, prejardhjen shoqërore, statusin pronësor, të lindjes apo çdo status tjetër⁵⁷¹.

Koncepti i paanësisë mund të rrezikohet nga veprimi i shumë faktorëve të brendshëm ose të jashtëm siç janë⁵⁷² :

- ndjenja të forta personale mbi çështjen apo palët,
- interesa financiare të familjes,
- njohje personale,
- urdhra dhe komunikimet ex-parte,
- deklarata publike,
- ofertat për punësim dhe privilegje tjera pas largimit nga detyra,
- aplikacione për përjashtimin e gjyqtarit etj.

Koncepti i paanshmërisë shpeshherë dëmtohet në vetë sallën e gjyqit e sidomos nga vet gjyqtarët, e më pak nga prokurori i cili është palë në gjykim. Kjo ndodh kur një gjyqtar manifeston paragjykimin e tij, përmes fjalëve apo veprimeve që bën. Kjo mund të ndodh përmes veprimeve ose përdorimit të fjalëve kërcënuese e fyese, në adresë të palëve pastaj referimi i paarsyeshëm tek karakteristikat personale të palëve p.sh (origjina etnike, sociale, gjinore)etj, me ç'rast tregojnë se si një gjyqtar apo një prokuror

⁵⁷⁰ II. Rregullat specifike të etikës A. Veprimtaritë gjyqësore nën 2.

⁵⁷¹ Pika 9 nënë (d)

⁵⁷² Thjeshtë, thuhet Nëse “duket keq” – është e keqe në bazë të ligjit.

mund të manifestojë njëanshmëri në sallën e gjyqit. Pastaj bërja e vërejtjeve të pajustificuara në adresën e njërës palë, avokatit, fyerja e palëve apo dëshmitarëve, përdorimi i shprehjeve dhe padurimi i tij për të dëgjuar deri në fund shpjegimet e palëve, janë të gjithë këta faktorë që shkatërrojnë dukjen e paanshmërisë në punën e gjyqtarit, sepse ndjeshmëria e palëve në një proces gjyqësor është shumë e lartë, prandaj me çdo kusht duhet evituar dyshimet që lindin e që prekin në këtë parim specifik të etikës gjyqësore.

V. Përrjashtimi gjyqësor/prokurorial⁵⁷³

A. Kërkesa për të deklaruar/zbuluar konfliktet e mundshme të interesave që kanë të bëjnë me:

4. palët,
5. avokatët,
6. dëshmitarët,
7. familjen/të afërmit e familjes,
8. faktorët e tjerë.

Nëse, për ndonjë arsye, gjyqtari ndjen se nuk është në gjendje të veprojë ai/ajo duhet të ndërmarrë veprim të menjëhershëm duke përfshirë edhe heqjen dorë nga rasti dhe t'i kërkojë Kryetarit të Gjykatës ku ai/ajo shërben, ta përjashtojë nga rasti. Nëse gjyqtari gjendet në një situatë të tillë që vë në pikëpyetje pavarësinë e tij/saj, atëherë ai/ajo është i/e detyruar që palëve të përfshira t'ua bëjë të ditura faktet në lidhje me situatën dhe t'i informojë ata për përjashtimin e tij/saj të mundshëm;

Prokurori ka në veçanti përgjegjësinë të shmangë çdo konflikt të mundshëm interesi të bazuar mbi marrëdhëniet shoqërore apo familjare si dhe mbi marrëdhëniet financiare apo profesionale. Gjyqtari/Prokurori duhet të deklarojë bazat e konfliktit të mundshëm të interesave me shkrim ose gjatë seancës së shqyrtimit kryesor. Të lejoj palët që të konsultohen me avokatët e tyre në lidhje me përjashtimin pa praninë e gjyqtarit.

VI. Emërimi si gjyqtar/prokuror

- Me normë të plotë;
- Ndalohet ushtrimi i profesionit si avokat;
- Ndalohet të shërbejë si ndërmjetësues ose arbitër etj;

⁵⁷³ Kodi i Procedurës Penale –përjashtimi nenet 40,41,42,43,44,45, Ligji mbi procedurën kontestimore - përjashtimin nenet 67,68,69,70,71,72

- I shmanget konfliktit të interesave;
- Mbron integritetin dhe pavarësinë e sistemit gjyqësor.

VII. Shmangja e aktiviteteve politike dhe ndalesa e anëtarësimit në partitë politike

Gjyqtari/prokurori do t'i shmangen kontaktit ose kontributit në një parti politike ose nga një figurë publike kur merr vendimet në sistemin e drejtësisë. Kontakti politik ndikon në humbjen e besueshmërisë së publikut Anëtarësia e gjykatësit apo e prokurorit në një parti politike është e ndaluar dhe është shkelje e kodit të etikës dhe sjelljes profesionale.

VII. 1. Ushtrimi i veprimtarive tjera

Gjyqtari/ prokurori mund të ushtrojë veprimtari të tjera jashtë lëmisë së mandatit të tij/saj gjyqësor duke përfshirë ato veprimtari që janë mishërim i të drejtave të tij/saj si qytetar ose, të cilat përfaqësojnë interesat dhe pavarësinë e tij/saj profesionale. Kjo liri është e kufizuar vetëm për atë që veprimtaritë e jashtme janë të papajtueshme me besimin të gjyqtari, ose paanshmërinë, ose pavarësinë e gjyqtarit, ose gadishmërinë e kërkuar nga ai/ajo për t'u marrë në mënyrë të vëmendshme dhe brenda një periudhe kohore të arsyeshme me çështjet e sjella para tij/saj.

Në varësi të këtij neni, gjyqtari mund të angazhohet në veprimtaritë vijuese:

- a. të flasë, shkruajë, japë leksione, japë mësim dhe të marrë pjesë në veprimtari të tjera që kanë të bëjnë me ligjin, sistemin ligjor dhe me administrimin e drejtësisë, përfshirë angazhimin në këto veprimtari përmes organizatave apo agjencive joqeveritare që i përkushtohen atyre;
- b. të merret me art, sport dhe veprimtari të tjera shoqërore dhe çlodhëse si dhe të marrë pjesë në veprimtari civile dhe bamirëse⁵⁷⁴.

Anëtarësia është e ndaluar në ndonjë organizatë e cila e mbështet diskriminimin. Mbledhja personale e fondeve nga ana e gjyqtarëve në një kontribut monetar ose kontribut me mall për të përfituar organizata bamirëse është e ndaluar. Paraqitja e jo korrektësisë – perceptimi i publikut që administrimi i drejtë i drejtësisë mund të ndikohet nëse një individ ose biznes nuk jep donacionin e kërkuar.

⁵⁷⁴ Rregullat specifike të etikës - B. Veprimtaritë jogjyqësore, Prokurori: B. Veprimtaritë joprokuroriale

IX. Pranimiti i dhuratave, shërbimeve ose privilegjeve

IX. 1 Perceptimi i publikut

Publiku ndjen mundësinë potenciale se korrupsioni ndodh kur gjyqtari ose prokurori kërkon ose merr të holla, dhurata, shërbime ose privilegje, dhuratat e festave, dhurata tjera gjëra ose shërbime të cilat nuk i ofrohen publikut në tërësi

Kufizimi në pranimin e dhuratave, shërbimeve, ose privilegjeve aplikohet te: gjyqtarët/prokurorët anëtarët e tyre të familjes. Gjyqtarët dhe Prokurorët duhet të bëjnë deklaratë vjetore për interesat e tyre financiare për Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës.

X. Procedimi efikas dhe me kohë i rasteve

Përgjegjësitë etike për të kryer detyrat me profesionalizëm dhe me kujdes. Rastet gjyqësore duhet të paraqiten dhe të dëgjohen me kohë ashtu siç është paraparë me ligj. Shtyrjet nuk duhet të pranohen përveç nëse ekziston arsyeja e fortë, e shprehur në mënyrë specifike në sallën e gjykimit ose me shkrim. Drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar. Shtyrjet e bëra pa arsyetim të mirë zvogëlojnë besueshmërinë e publikut në sistemin e drejtësisë. Drejtësia fundamentale kërkon që të gjitha palët të trajtohen në mënyrë të barabartë. Privilegjet e veçanta për disa e zvogëlojnë besimin e publikut.

XI. Komunikimet EX-Parte

Përbëhet nga komunikimi verbal kur të gjitha palët nuk janë prezent ose nga komunikimi me shkrim të cilin nuk e marrin të gjitha palët. Drejtësia themelore kërkon që të gjitha palët:

- të kenë njohuri për të gjitha komunikimet që i janë bërë gjyqtarit.
- të jenë prezent gjatë komunikimeve verbale me gjyqtarin të kenë mundësinë për t'iu përgjigjur gjyqtarit në komunikim me shkrim.

Ndalimi i komunikimeve Ex-Parte tenton që të: parandalojë njëanshmërinë, shmang paragjykimet, krijojë besueshmërinë në publik

XII. 3. Shqyrtimi i sjelljes së policisë

Prokurorët do të analizojnë hollësisht dhe do të sigurojnë ligjshmërinë e sjelljes së policisë dhe do të raportojnë çdo sjellje të paligjshme.

Diskrecioni prokurorial autorizimi/refuzimi për të autorizuar kallëzimet penale kundër:

- oficerëve të policisë
- zyrtarëve publik
- të tjerëve

XIII. 4 Zyra e Prokurorit Disiplinor dhe qëllimi i funksionimit të mirë të sistemit të drejtësisë

Zyra e Prokurorit Disiplinor (ZPD)⁵⁷⁵ themelohet si organ i ndarë dhe i pavarur që i shërben si Këshillit Gjyqësor të Kosovës ashtu edhe Këshillit Prokurorial të Kosovës. Sa i përket sistemit gjyqësor, ZPD është përgjegjëse për hetimin e supozimeve për sjellje të pahijshme të gjyqtarëve dhe gjyqtarëve porotë dhe paraqitjen e provave dhe lëndës pranë Komisionit Disiplinor në mbështetje të veprimeve disiplinore për sjelljen e pahijshme.

Sa i përket sistemit prokurorial, Prokurori Disiplinor është përgjegjës për hetimin e supozimeve për sjellje të pahijshme të prokurorëve dhe paraqitjen e provave dhe lëndës pranë Komisionit Disiplinor në mbështetje të veprimeve disiplinore për sjelljen e pahijshme⁵⁷⁶.

ZPD në administrimin e funksioneve të saja vepron në mënyrë të pavarur dhe të paanshme. Asnjë person nuk ka të drejtë të ushtrojë ndikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, apo të përpiqet të ushtrojë ndikim mbi funksionet e Prokurorit Disiplinor sa i përket çfarëdo hetimi, rekomandimi apo paraqitjes së një lënde pranë Komisionit Disiplinor.

ZPD është përgjegjëse për iniciimin e hetimeve ndaj gjyqtarëve, gjyqtarëve porotë apo prokurorëve aty ku ekziston bazë e arsyeshme për të besuar që sjellja e pahijshme mund të ketë ndodhur si dhe për ofrimin e rekomandimeve dhe paraqitjes pranë Komisionit Disiplinor të provave në mbështetje të veprimit disiplinor.

⁵⁷⁵ Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës

⁵⁷⁶ Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës

Zyra e Prokurorit Disiplinor inicicion hetime në rastet kur:

1. pranë ZPD ekziston ankesa e paraqitur nga cilido person fizik apo juridik;
2. me vet iniciativë, kur ekziston bazë e arsyeshme për të besuar se një gjyqtar apo gjyqtar porotë mund të jetë përfshirë në sjellje të pahijshme.

Të gjitha ankesat, pavarësisht origjinës së tyre, dërgohen për hetim në ZPD. ZPD heton hollësisht të gjitha çështjet që i referohen, vendos nëse rekomandimet për veprime disiplinore duhet t'i paraqiten Komisionit Disiplinor si dhe njofton me shkrim Komisionin Disiplinor dhe gjyqtarët apo gjyqtarët porotë të dyshuar lidhur me rezultatin e hetimit. ZPD ka të drejtë të thërrasë dëshmitarët si dhe dokumentet e nevojshme për hetim dhe të përcaktojë nëse rekomandimet për veprim disiplinor duhet të paraqiten tek Komisioni Disiplinor. ZPD i paraqet Komisionit Disiplinor rekomandimet për veprime disiplinore si dhe provat në mbështetje të veprimit disiplinor për sjelljen e pahijshme.

XIII. 5 Sjellja e pahijshme

1. Sjellje të pahijshme ⁵⁷⁷, nga gjyqtari, gjyqtari porotë apo prokurori përbën:
 - 1.1. dënimi përfundimtar për një vepër penale, përpos kundërvajtjeve siç përkufizohet me ligj;
 - 1.2. neglizhencë në kryerjen, dështimin për të kryer apo abuzimin e funksioneve gjyqësore/prokuroriale;
 - 1.3. të dështuarit e kryerjes së funksioneve gjyqësore/prokuroriale në mënyrë të pavarur dhe të paanshme;
 - 1.4. shkelja e kodeve të zbatueshme të etikës.
2. Komisioni Disiplinor mund të pezullojë gjyqtarin, gjyqtarin porotë apo prokurorin me pagesë gjatë cilësdo fazë të hetimit apo gjatë procedurës disiplinore.

ZPD është mekanizëm i rëndësishëm për të ndihmuar në sigurimin e sistemit të drejtë dhe efikas të drejtësisë dhe sundimit të ligjit, i cili është

⁵⁷⁷ Neni 34 i Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës

njëri nga kushtet për funksionimin e shtetit të drejtë dhe demokracisë, garancion për arritjen e këtij qëllimi është gjyqësia/prokuroria e pavarur dhe e paanshme. Para së gjithash, ZPD përpiqet për përmirësimin e perceptimit të publikut ndaj gjykatave dhe prokurorive si dhe ndërtimin e këtij besimi në sistemin e drejtësisë në përgjithësi. ZPD gjithmonë respekton pavarësinë e gjykatave/prokurorive nuk ndërhyjnë dhe nuk shqyrton parashtrësia që kanë të bëjnë me pakënaqësinë e palëve kundër vendimeve gjyqësore. ZPD në punën e saj mundohet të ruajë kompetencën, dinjitetin, integritetin dhe paanshmërinë e gjyqësorit/prokurorisë.

LITERATURA

- Alishani, Dr. Alajdin “E Drejta e Detyrimeve – Pjesa e Posaçme”, Prishtinë, 2001;
- Alishani, Dr. Alajdin “E Drejta e Detyrimeve–Pjesa e Përgjithshme”, Prishtinë, 2003;
- Aliu, Dr. Abdulla, E drejta e Autorit, Prishtinë, 2004
- Antic, Oliver, dhe Balinovac, Zoran. (1996) Komentar Zakona o Nasljeđivanju. Beograd: Nomos.
- Baker, Raymond (2005). Capitalism's Achilles Heel. Wiley
- Begeja, S. Kriminalistika, Tiranë, 1997;
- Breda, R., Pedagogjia Familjare, Pejë, 2003;
- Brestovci, Dr. Faik, E drejta procedurale civile I, Prishtinë 2006,
- Brestovci, Dr. Faik, E drejta procedurale civile II, Prishtinë 2004
- Brestovci, Dr. Faik. (2000) E Drejta Procedurale Civile (Ribotim), Prishtinë: Enti i Teksteve Mësimore.
- Buletini Zyrtar i Zyrës së Pronësisë Industriale, pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Prishtinë, nr. 01 Prishtinë më 09/12/2010
- Code de procédur civile À jour au 1er juin 2011 République Française, versioni i plotësuar me 1 maj 2011,
- Code de procédure civile du Québec
- Code de procédure civile du Suisse
- CPC du 19 décembre 2008 *L'Assemblée fédérale de la Confédération Suisse*,
- Dauti, Dr. Nerxhivane “E Drejta e Detyrimeve”, Prishtinë, 2001;
- Deklarata e Përgjithshme e OKB mbi të Drejtat e Njeriut
- Direktiva e Parë e Këshillit 89/104/EEC (1988)
- Doracaku për Përgatitjen e Provimit të Jurisprudencës, Prishtinë 2009.
- Dragoti, E., Adoleshenti, Tiranë, 1999;
- Financial Action Task Force
- Fjalor i shqipes së sotme, Botimi i dytë i ripunuar, Botimet Teona, Tiranë, 2002, përgatitur nga Akademia e shkencave shqiptare.
- Fond za humanitarno pravo, Pravicno sudjenjë-prirucnik, Beograd 2000
- Fuga, Juliana. (2002) Trashëgimia. Tiranë: Ilar.
- G. Dudycha etj, Pssychlogy For Low Enforcement Officers, Springfilde, 1985;
- Galgano, Francesco. (1999) E Drejta Private. Përkth. Alban Brati. Tiranë: Luarasi.

- Gams, Andrija Hyrje në të drejtën civile, Përkthim në gjuhën shqipe, përkthyer nga Faruk Presheva, Prishtinë 1986,
- Gams, Andrija. (1986) Hyrje në të Drejtën Civile. (Bot. 3të). Prishtinë: Enti i Teksteve Mesimore.
- Gashi, Rexhep, Ekzekutimi i masave dhe dënimeve ndaj të miturve
- Global Money Laundering and Terrorist Financing Threat Assessment
- Hajdari, Dr. Azem Procedura penale – Komentar, Prishtinë 2010
- Hajdari, Dr. Azem, E drejta procedurës penale e të miturve Prishtinë 2005;
- Halili, Dr. Ragip “Penologjia”, Prishtinë 2000
- Halili, Dr. Ragip, Penologjia (shkenca mbi ekzekutimin e sanksioneve penale), Prishtinë,
- Hetemi, Dr. Mehdi “E Drejta Ndërkombëtare Tregtare – Afariste”, Prishtinë, 2007;
- Hetemi, Dr. Mehdi J., E drejta ndërkombëtare tregtare-afariste, Prishtinë 2007,
- Hetemi, Dr. Mehdi J., Mbrojtja e tregut të lirë nga konkurrenca jolojale (aspekte krahasimore), Prishtinë, 2004,
- <http://hr.wikipedia.org/wiki/Brand>, Kategorija: Ekonomski pojmovi
- <http://uccial.al/al/faqe/zyra-e-markave-dhe-patentave>
- <http://webcache.googleusercontent.com/search?q=cache:XvDHOc0XF EJ:www.alpto.gov.al/home.asp%3F1%3Dal+ligji+per+markat+tregtare &cd=7&hl=en&ct=clnk&source=www.google.com>
- http://www.ligjet.info/kodicivil/pjesa_v/titulli_ii/kreu_i_vii/7/8/2011;
- <http://www.mti-ks.org/?cid=1,381,1343&tpl=section.php>
- <http://www.unëkërkoj.com/lajme/up/universiteti> i parregullsisë/7/8/2011;
- <http://poslovnih/sklopiti-ugovor-o-djelu-ili-o-radu-162400.aspx>, 7/15/2011.
- Instrumente tjera Ndërkombëtare
- Islami, H., Panda, I., Spahiu, K., Hoxha, A., Procedura penale e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 1996;
- Kadriu, Dr. Osman, Hyrje në të drejtën civile, Shkup 2008,
- Karta Evropiane për Statutin e Gjykatësve
- Kodi Doganor dhe i akcizave, Kodi nr.03/L-109,
- Kodi i Drejtësisë për të mituri i Kosovës;
- Kodi i Etikës dhe Sjelljes Profesionale për gjyqtar, gjyqtarë porotë dhe prokurorë

- Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-003, të datës 03.11.2008, për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës.
- Kodi Penal i Kosovës
- Komiteti mbi të drejtat e Fëmijëve sesioni dyzet e katër i datës 15 janar –2 shkurt
- Komiteti i përgjithshëm nr. 10 (2007) të drejtat e fëmijëve në sistemin e drejtësisë për të mitur; 2007 Gjenevë,
- Konkluzionet e Komisionit Ekonomik dhe shoqëror evropian mbi parandalimin e delikuencës së të miturve Nr.2006/C 110/13 Faqe 3/4;
- Konventa e Bernës.
- Konventa e Parisit për Mbrojtjen e Pronësisë Industriale (20 Mars 1883)
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Politike dhe Civile
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës,
- Latifi, Dr. Vesel, Fenomenologjia dhe struktura e delikuencës së mitur dhe luftimi e saj në KSA të Kosovës "Përparimi" nr.4/1988, Prishtinë;
- Latifi, Dr. Vesel, Kriminologjia e delikuencës së miturve, Prishtinë, Rilindja,1982;
- Latifi, Dr. Vesel, Kriminologjia, Prishtinë 2006
- Latifi, Dr. Vesel, Politika kriminale, Prishtinë, 2008;
- Latifi, Dr. Vesel., Disa Vrojtme Mbi Sjelljet Delikente të të Miturve dhe Fëmijëve, „E drejta nr.1“, Prishtinë, 1997;
- Latifi, Dr. Vesel., Kriminologjia, Prishtinë, 2006.
- Layton, Julia. "How Money Laundering Works"
- Lazim Salihu, Doracak për dhënie të provimit të jurisprudencës botim i dytë.
- Ligji Antikorrupsion i Kosovës
- Ligji i Konfliktit Administrativ
- Ligji i Procedurës Jashtëkontestimore. Gazeta Zyrtare nr. 43/1986.
- Ligji i Procedurës Përmbartimore i vitit 2008
- Ligji i Procedurës Përmbartimore i vitit 1978
- Ligji i Republikës së Shqipërisë, Nr. 9947, Datë 07/07/2008, "Për Pronësinë Industriale",
- Ligji i vjetër për procedurën kontestimore i njohur me titullin "Zakona o parničnom postupku" i vitit 1977

- Ligji Kroat mbi ndryshimet dhe plotësimet e ligjit për procedurë kontestimore-“ Zakon o izmenama i dopunama zakona o parničnom postupku” nga data 14 korrik 2003.
- Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale;
- Ligji mbi Familjen i Kosovës
- Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, (“Gazeta Zyrtare e RSFJ-së”, nr.29), Beograd, 1978;
- Ligji mbi Procedurën Kontestimore
- Ligji Nr. 02/L-54 Për Markat Tregtare të datës 23 shkurt 2006
- Ligji Nr. 03/L - 170 Për masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale,
- Ligji Nr. 03/L – 170, 29 dhjetor 2009 dhe Ligjin për Dizajnin Industrial nr.02/ L-45
- Ligji nr. 03/L-196 për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit.
- Ligji Nr. 2004/45, mbi te drejtën e autorit dhe te drejtat e përafërta i miratuar 29 qershor 2006.
- Ligji nr.03/L-052 për Prokurorin Speciale të Republikës së Kosovës
- Ligji për Familjen e Kosovës, nr. 2004/32, Gazeta Zyrtare nr. 4, 1 shtator 2006
- Ligji për Familjen i Kosovës nr. 2004/32
- Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës
- Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës
- Ligji për mbrojtjen nga dhuna në familje
- Ligji për procedurën kontestimore i Malit të Zi “Zakon O Parničnom Postupku Sl. list RCG”, br. 76/06” Podgorica, 29. novembra 2006. g.
- Ligji për Trashëgiminë e Kosovës, Nr. 2004/26 Gazeta Zyrtare nr. 3, gusht 2006
- Ligjin Nr. 02/L-15, për KPM-në.
- Ligjit për marrëdhëniet detyrime (“Gazeta Zyrtare e RSFJ” nr. 29/1978.).
- Literaturë nga trajnimet e mbajtura ZPD nga gjyqtari ndërkombëtar John N. Fields (Trial Court Judge, Retired Michigan, USA) dhe Bernarde Foley inspektore e ZPD si dhe trajnerë ndërkombëtare
- Marrëveshja e Madridit për Regjistrimin Ndërkombëtar të Markave Tregtare (1891),
- Marrëveshja TRIPS

- Moduli Etika Gjyqësore përgatitur nga Jetish Maloku, kryeprokuror në PPQ Gjilan dhe Gent Ibrahim, Drejtor i Institutit për studime publike dhe ligjore në Tiranë,
- Mujo Hasković, Psikologjia, Sarajevë-Prishtinë FSK/5-2006, faqe 32-33;
- National Money Laundering Threat Assessment
- Nigel Morris-Cotterill book “Hoë not to be a money launderer”, 2nd edition (Silkscreen publication, 1998)
- Oruçi, Gani, E drejta familjare, Prishtinë, 1994,
- Pakti ndërkombëtar për të drejtat ekonomike sociale, dhe kulturore, 16 dhjetore 1966;
- Papandile, J., Vështrim Kriminologjik, Tiranë, 2000;
- Parimet e Bangalores për Sjelljen e Gjyqësisë
- Parimet themelore të KB për Pavarësinë e Gjyqësorit
- Plakolli - Kasumi, LL.M. Luljeta, E drejta e autorit dhe te drejtat e përafërta tetor 2009
- Plakolli - Kasumi, LL.M. Luljeta, Mbrojtja dhe zbatimi i markave tregtare, për EMSG-Menaxhimi Ekonomik për Stabilitet dhe Zhvillim, Sponsoruar nga USAID 2008.
- Podvorica, Dr. Hamdi E Drejta Familjare, Prishtinë 2011, Universiteti AAB
- Porodično Pravo, autor Vojislav Bakić, Savremena Administracija 1980, Beograd
- Protokolli që i përket Marrëveshjes së Madridit (1989)
- Raporti i OSBE, Edicioni i 6 2010, Procedura për birësimin e fëmijëve në Kosovë
- Raporti i Shërbimit Sprovues të Kosovës dega në Mitrovicë, Nëntor 2008.
- Rekomandimin Nr. R(94)12 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës
- Rregullat e Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e të miturve që janë privuar nga liria 14 dhjetore 1990;
- Rregullat Standarde minimale për masat jo- ndëshkimore (Rregullat e Tokios) e miratuar me rezolutën 45/10 të asamblesë së përgjithshme të 14 dhjetorit 1990;
- Rregullat standarde minimale të Kombeve të Bashkuara për administrimin e Drejtësisë 2005;
- Rregullore Nr. 2005/21 Mbi Shpalljen e Ligjit për Regjistrat e Gjendjes Civile të miratuar nga Kuvendi i Kosovës,

- Rregullore Nr. 2005/7 Për Shpalljen e Ligjit Mbi Trashëgiminë të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.
- Rregulloren nr. 2004/2 Mbi Pengimin e pastrimit të parave dhe veprave të ngjashme penale.
- Rregullorja e Këshillit (EC) Nr. 40/94, për Markën Tregtare të Komunitetit
- Rregullorja e UNMIK-ut, nr. 2003/12 për Mbrojtjen kundër dhunës në familje
- Sahiti, Dr. Ejup “E Drejta e Procedurës Penale”, Prishtinë 2005
- Sahiti, Dr. Ejup Argumentimi në procedurë penale, Prishtinë 1999
- Sahiti, Dr. Ejup E drejta e procedurës penale, Prishtinë 2005
- Sahiti, Dr. Ejup E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2005;
- Sahiti, Dr. Ejup E drejta e Procedurës Penale, Prishtinë, faqe 84-85
- Salihu, Dr. Ismet “E Drejta Penale” (Pjesa e Përgjithshme), Prishtinë 2005
- Salihu, Dr. Ismet E drejta penale për te mitur, Prishtinë, 2005;
- Selmani, Arta Adoptimi – Mbrojtje juridike për fëmijët pa prindër..., nga, material i marrë nga interneti
- Stavileci, Dr. Esat, Hyrje në Shkencat Administrative
- Structuring Financial Transactions to Evade Reporting Requirements Retrieved March 3, 2011
- Structuring Financial Transactions to Evade Reporting Requirements Retrieved March 3, 2011
- Tërësia e Rregullave Minimale të Kombeve të Bashkuara në Lidhje me Dhënien e Drejtësisë për të Mitur (Rregullat e Pekinit), Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme, në rezolutën e saj 40/33 të 29 nëntorit 1985, Përmbledhje Aktesh Ndërkombëtare, Tiranë, 1994.
- Udhëzimet e kombeve të bashkuara për parandalimin e delikuentëve të miturve
- Udhëzimet e Riadit, 14 dhjetore 1990;
- Udhëzimi administrativ i UNMIK-ut nr. 2006/15 për Themelimin e Departamentit Administrativ të Drejtësisë, të datës 30 shtator 2006
- Udhëzimi Administrativ nr. 05/2006 i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale
- Udhëzimi administrativ për përfaqësimin e të drejtave të pronësisë industriale nr. 2008/16, të datës: 19.09.2008,
- Udhëzimi administrativ për procedurat e regjistrimit të markave tregtare nr. 2008/13, i datës:17.09.2007

- Udhëzimin Administrativ për aplikimet e Patentave, Markave Tregtare, Dizajnëve Industriale, Patentevetë lëshuara, Markave tregtare dhe Dizajnëve Industriale të njohura para hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, Nr. 2007/14, të datës 19.09.2008,
- Udhëzimin administrativ për organizimin dhe funksionimin e Zyrës për pronësi industriale, Nr 2007/06, të datës: 19.03.2007,
- Uka, Dr. Bajram, Revista e Drejta nr.1-2/2008;
- Vasilika, H., Hyrje në Kriminologji dhe Penologji, Tiranë, 2000;
- Vedrish, Martin. dhe Klariq, Petar. (2003) Građansko Pravo. (Sedmo izminjēnjē i dopunjēno izdanjē). Zagreb: Narodne Novine d.d.
- Veliki Prani Priručnik 2. Jugoslavenski Pravni Sistem, Beograd 1972
- Verona, Dr. Albert, Pravo industrijskog vlasništva, Zagreb, 1978
- Verona, Dr. Albert, Enciklopedija Imovinskog prava i prava udruženog rada I-III tom prvi, Novinsko-Izdavačka ustanova, Sluzbeni List SFRJ, Beograd, 1978-Grupa autora, deo, Industrijsko vlasništvo,
- Vodineliq, V., Kriminalistika, Prishtinë, 1981;
- website: www.cci.al
- www.coe.moneyval
- www.counter.moneylaundering.com/
- www.egmontgroup.org
- www.investopedia.com/terms/m/moneylaundering.asp